



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORTI VJETOR 2018

Nr. 18

Prishtinë, 2019

Tabela e përmbajtjes

Fjala e Avokatit të Popullit	12
Institucioni i Avokatit të Popullit.....	14
Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit.....	14
Promovimi i të Drejtave të Njeriut	18
Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit	28
Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës	30
Pushteti legjislativ	30
Sistemi gjyqësor	35
Pushteti ekzekutiv	42
Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)	44
Shpronësimet e pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore	45
Kushtëzimi i regjistrimit të automjeteve	46
Pezullimi i veprimtarisë së OJQ-ve nga Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve ...	47
Pamundësia për ta përmbushur kriterin 15 vjeçar për realizimin e pensionit kontributpagues	49
E drejta në pension kontributpagues të moshës, si dhe e drejta në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë	50
Të drejtat civile të qytetarëve shqiptarë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci	50
Çështjet që ndërlidhen me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë	51
Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë	54
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	55
E drejta e qasjes në dokumente publike.....	71
Të drejtat e fëmijëve	75
Gjendja e të drejtave të fëmijëve.....	75
Korniza ligjore dhe të drejtat e fëmijëve	75
E drejta e fëmijëve në arsim	76
Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla	78
Fëmijët me aftësi të kufizuara	79
Fëmijët në situatë rruge	80
Të rinjtë/fëmijët viktimë të abuzimit me substanca narkotike	80
Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë organeve gjyqësore dhe administrative	81

Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve.....	82
Drejtësia për të mitur.....	83
Barazia para ligjit.....	85
Personat me aftësi të kufizuar	86
Diskriminimi në punë.....	91
E drejta për pension.....	99
Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale	102
Komunitetet LGBTI	106
Barazia gjinore	108
E drejta e pronës dhe e trashëgimisë.....	110
Dhuna në familje	112
Komunitetet pakicë	115
Kthimi dhe siguria	116
Shtetësia dhe regjistrimi civil	120
Të drejtat pronësore	123
Arsimi	125
Përdorimi i gjuhës.....	128
Liritë fetare në Kosovë	131
Aktivitetet e Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi (DMD).....	133
Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT).....	144
Metodologjia dhe organizimi i MKPT-së gjatë vitit 2018	145
Metodologjia e MKPT-së	145
Përbërja e MKPT-së	146
Trajnimet e stafit të MKPT-së.....	147
Aktivitetet e MKPT-së.....	147
Bashkëpunimi ndërkombëtar.....	148
Përmbushja e mandatit të MKPT-së gjatë vitit 2018	148
Vizitat e realizuara.....	148
Raportet me rekomandime të publikuara gjatë vitit 2018	149
Bashkëpunimi i institucioneve të vendit me MKPT-në	150
Të gjeturat gjatë vizitave dhe rekomandimet e dërguara autoriteteve kompetente.....	150
Stacionet policore	150

Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit	159
Rekomandimet e dërguara autoriteteve kompetente pas vizitave në qendra korrektuese dhe të paraburgimit	178
Qendra për Azilkërkues dhe Qendra e Mbajtjes për të Huajt	181
Institucionet e shëndetit mendor	187
Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës	187
Klinika Psikiatrike	192
Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë në Shtime	196
Institucionet e kujdesit social	201
Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF)	201
Instituti Special në Shtime (ISSh)	202
Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore	204
Përmbledhja e raporteve me rekomandime	206
Raporte sipas detyrës zyrtare (<i>Ex officio</i>)	206
Raport për rastin <i>Ex officio</i> nr. 731/2017 lidhur me vendimin e Inspektoratit Policor të Kosovës, i datës 29 dhjetor 2017, për anulimin e procesit të rekrutimit për Inspektor/Hetues, i shpallur më 24 korrik 2017	206
Raport për rastin <i>Ex officio</i> nr. 853/2016 lidhur me kriteret diskriminuese të vendosura nga Universiteti i Prishtinës	209
Raport për rastin <i>Ex officio</i> nr. 129/2018 në lidhje me zgjidhjen efektive të zvarritjeve të procedurës gjyqësore - shkelja e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm	212
Raport për rastin <i>Ex officio</i> nr. 355/2016 në lidhje me të drejtat civile të qytetarëve shqiptarë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të zhvendosur në Republikën e Kosovës	216
Raport për rastin <i>Ex officio</i> nr. 412/2017 në lidhje me vendimin për pagesën e provimit të maturës shtetërore, i datës 16.5.2017 me nr. 2-1843	219
Raport për rastin <i>Ex officio</i> nr. 235/2018 në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës, për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 vjetëve, si pasojë e largimit diskriminues nga puna	221
Raport për rastin <i>Ex officio</i> nr. 214/2018 në lidhje me arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës	223

Raport për rastin <i>Ex officio nr. 385/2016</i> në lidhje ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë	231
Raport për rastin <i>Ex officio nr. 687/2017</i> në lidhje me organizmin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale	234
Raport për rastin <i>Ex officio nr. 441/2018</i> në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut	235
Raport për rastin <i>Ex officio nr. 376/2018</i> në lidhje me kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete.....	236
Raport për rastin <i>Ex officio nr. 401/2018</i> në lidhje me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave	236
Raport për rastin <i>Ex officio nr. 12/2018</i> në lidhje me mosndërmarrjen e obligimeve pozitive nga organet kompetente për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti	238
Raport për rastin <i>Ex officio nr. 280/2016</i> në lidhje me cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm në Komunën e Obiliqit dhe të komunave të afërta që ndikohen nga problemi i njëjtë.....	239
Raporte bazuar në ankesa	241
Raport për rastin <i>A.nr. 890/2016</i> në lidhje me të drejtën në pension kontributpagues të moshës si dhe e drejta në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë	241
Raport për rastin <i>A.nr. 245/2016</i> në lidhje me detyrimet pozitive për hetime efektive dhe të drejtën në jetë	244
Raport për rastin <i>A.nr. 885/2016</i> lidhur me mosekzekutimin e vendimit KSIZ-HPCC/D/197/2005A&C, i datës 18/06/2005, i nxjerrë sipas lëndëve DS 000641 dhe DS004997	246
Raport për rastin <i>A.nr. 114/2018; A.nr. 122/2018</i> dhe <i>A.nr. 182/2018</i> , në lidhje me kushtin diskriminues në konkursin për punësim në Shërbimin Korrektues	248
Raport për rastin <i>A.nr. 185/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën <i>AC. nr. 29/2015</i>	250
Raport për rastin <i>A.nr. 716/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën <i>AC. nr. 1995/2015</i>	252
Raport për rastin <i>A.nr. 462/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën <i>AC.nr. 4643/2015</i>	253

Raport për rastin <i>A.nr. 796/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3703/2015.....	254
Raport për rastin <i>A.nr. 794/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 3200/2015.....	255
Raport për rastin <i>A.nr. 463/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1763/2015.....	257
Raport për rastin <i>A.nr. 206/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 863/2014.....	258
Raport për rastin <i>A.nr. 429/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr.3109/12	259
Raport për rastin <i>A.nr. 388/2014</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 239/2013.....	260
Raport për rastin <i>A.nr. 362/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 430/2015.....	261
Raport për rastin <i>A.nr. 561/2015</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamentin për Çështje Ekonomike, në lëndën C.nr. 649/2014	261
Raport për rastin <i>A.nr. 648/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën CA nr. 374/2014.....	262
Raport për rastin <i>A.nr. 721/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën CA. nr. 4667/2014.....	263
Raport për rastin <i>A.nr. 357/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr. 2210/07	264
Raport për rastin <i>A.nr. 57/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3297/2015.....	265
Raport për rastin <i>A.nr. 705/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3181/2015.....	266
Raport për rastin <i>A.nr. 55/ 2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3488/2015.....	266
Raport për rastin <i>A.nr. 864/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC nr.292/2016.....	267
Raport për rastin <i>A.nr. 375/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1865/2014.....	268
Raport për rastin <i>A.nr. 910/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën A.nr. 2263/2015	269

Raport për rastin <i>A.nr. 473/2016</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr.1874/11	270
Raport për rastin <i>A.nr. 410/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.Nr. 3451/2015	271
Raport për rastin <i>A.nr. 722/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr. 3077/13	272
Raport për rastin <i>A.nr. 235/2017</i> lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr.724/2014.....	273
Raport për rastin <i>A.nr. 533/2017</i> lidhur me mosnjohjen e gradës Master për kualifikimet e fituara sipas sistemit të studimeve universitare pesëvjeçare sipas sistemit të para Bolonjës.....	274
Raport për rastin <i>A.nr. 186/2017</i> përkitazi me pretendimet e ankuesit për trajtim të pabarabartë të kandidatëve në konkursin publik, i datës 24 nëntor 2016, i shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për zgjedhjen e personelit akademik për mësimdhënës në Fakultetin Filozofik.....	276
Raport për rastin <i>A.nr. 432/2018</i> lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike	277
Raport për rastin <i>A.nr. 445/2018</i> lidhur me regjistrimin me numër të ri të lëndëve të cilat kthehen në rigjykim nga gjykata më e lartë.....	279
Raport për rastin <i>A.nr. 493/2018</i> lidhur me të drejtën e të dënuarave në arsim universitar	281
Raportet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese	283
Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren	283
Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.....	285
Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës për vizitat në stacionet policore	287
Raporti i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.....	290
Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll.....	292
Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën për Azilkërkues	293

Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike	294
Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën Edukuese - Korrektuese në Lipjan.....	296
Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë	297
Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitat në Stacionet Policore	298
Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës	300
Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës për vizitën në Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime	301
Raporti i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë	303
Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës për vizitat në Stacionet Policore.....	304
Letër rekomandimet	307
Letër rekomandim – Ex officio nr. 23/2018.....	307
Letër rekomandim – Ex officio nr. 127/2018.....	308
Letër rekomandim – Ankesa nr. 784/2018.....	309
Letër rekomandim – Ankesa nr. 747/2018.....	310
Letër rekomandim – Ankesa nr. 115 / 2018.....	311
Letër rekomandim – Ankesa nr. 484/2017.....	312
Letër rekomandim – Ankesa nr. 290/2017.....	314
Letër rekomandim – Ankesa nr. 28/2018.....	316
Letër rekomandim – Ankesa nr. 120/2017.....	317
Letër rekomandim – Ankesa nr. 171/2018.....	318
Letër rekomandim – Ankesa nr. 499/2017.....	319
Letër rekomandim – Ankesa nr. 683/2016.....	320
Letër rekomandim – Ankesa nr. 499/2015 dhe nr. 759/2017	321
Letër rekomandim – Ankesa nr. 275/2018.....	322
Letër rekomandim – Ankesa nr. 479/2018.....	323
Letër rekomandim – Ankesa nr. 666/2017.....	325
Letër rekomandim – Ankesa nr. 310/2018.....	327

Letër rekomandim – Ankesa nr.58/2018.....	328
Letër rekomandim – Ankesa nr. 823/2017.....	329
Letër rekomandim – Ankesa nr. 519/2018.....	330
Mendimet Juridike të Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (<i>amicus curiae</i>)	333
Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në lidhje me çështjen e interpretimit të konceptit të “përvojës së punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike 333	
Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.252/2018 në lidhje me kërkesën për shqyrtimin e Kushtetutshmërisë në rastin KI-108/18.....	335
Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.215/2018 në lidhje me iniciimin në Gjykatën Kushtetuese të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës dhe vlerësimin e pajtueshmërisë me dispozitat kushtetuese.....	340
Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.903/2017 në lidhje me padinë e ankuesit z. Mufail Salihaj, kundër Universitetit Publik të Prishtinës “Hasan Prishtina”	342
Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.499/2017 në lidhje me Padinë e ankuesit z. Xhafer Kadrija, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së të Verbërve në Gjakovë, kundër Komunës së Gjakovës	345
Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me rastin Driton Hajdari, çështja nr. ED.nr. 155/18... 346	
Opinionet e Avokatit të Popullit	350
Opinion i Avokatit të Popullit për rastin A.nr. 421/2018 në lidhje me kriterin për dorëzimin e vendimit të nostrifikimit, për aplikim në konkursin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”	350
Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me faturimin e ujit për konsumatorët me ujëmatës të përbashkët.....	355
Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me parandalimin e nepotizmit në Universitetin e Prishtinës	356
Kërkesa për masën e përkohshme.....	361
Kërkesa e Avokati i Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e disa neneve të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate	361

Bashkëpunimi ndërkombëtar	369
Bashkëpunimi me homologë dhe organizata të tjera ndërkombëtare	373
Projektet me mbështetje të organizatave ndërkombëtare	376
Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare	379
Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë	380
Komunikimi me publikun dhe mediat	381
Financimi	385
Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës	385
Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018	386
Financimi i IAP-së nga donatorët	387
Statistikat	388
Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve për vitin 2018	388
Paraqitja grafike e statistikave për vitin 2018	395
Statistikat mbi treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike	399

Fjala e Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit, si kategori kushtetuese, i cili ka përgjegjësi mbikëqyrjen, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, ka vazhduar t'i ushtrojë këto detyra edhe gjatë vitit 2018, duke arritur të jetë institucioni më i besuar në vend.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcakton Avokatin e Popullit si institucion të pavarur në ushtrimin e detyrave, pa ndërhyrje nga organet, nga institucionet ose nga autoritetet tjera, të cilat ushtrojnë pushtet në Republikën e Kosovës. Në përputhje me këtë të drejtë, Avokati i Popullit vazhdimisht u ka bërë thirrje institucioneve publike që t'i respektojnë të drejtat dhe liritë e njeriut, të cilat janë të përcaktuara me Kushtetutë, me ligje dhe me konventa ndërkombëtare, të zbatueshme drejtpërdrejt në legjislacionin vendor.

Puna jonë përgjatë vitit 2018 më së miri pasqyrohet në këtë Raport, të 18-in me radhë, i cili ngërthen në vete kompilim të informatave për veprimet e Avokatit të Popullit pikërisht për mbikëqyrjen, për mbrojtjen dhe për promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore. Gjithashtu, në Raport është paraqitur gjendja e të drejtave të njeriut, e barazisë dhe e sundimit të ligjit.

Përmes këtij Raporti, po ashtu, ia paraqesim Kuvendit të Republikës së Kosovës një përmbledhje gjithëpërfshirëse të gjendjes së të drejtave të njeriut në vend, si obligim që buron nga Kushtetuta. Raporti, në të njëjtën kohë, mëton tërheqjen e vëmendjes së institucioneve që respektimin e të drejtave të njeriut të mos e lënë në mëshirën e veprimeve të lira politike, por, nëpërmjet instrumenteve ekzekutive, të sigurojnë zbatimin e tyre.

Nëpërmjet Raportit, jo vetëm që kemi ofruar diskursin e respektimit të të drejtave të njeriut në vend nga pushteti legjislativ, ekzekutiv, si dhe nga sistemi gjyqësor, por kemi paraqitur një raportim të detajuar lidhur me trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim në vend, për gjendjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe një raportim të thukët të Mekanizmit Kombëtar për të Drejtat e Njeriut.

Kalimi i Institucionit nga faza fillestare e themelimit të departamenteve profesionale e deri në fazën e funksionimit të plotë, proces i riorganizimit i paraparë edhe me Rregulloren e brendshme të këtij Institucioni, ka ndikuar në ngritjen efektive të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe fuqizimin e kapaciteteve për zbatimin e mandateve të besuara me Kushtetutë dhe me ligje.

Një analizim i detajuar për këtë vit raportues tregon se ky Institucion ka adresuar 263 rekomandime për institucionet publike të Republikës së Kosovës. Vëmendje e veçantë u është dhënë rasteve të hetuara Ex-Officio (hetime me vetiniciativë), që kanë të bëjnë kryesisht me shkelje të vazhdueshme të të drejtave dhe të lirive të njeriut, duke synuar efektin më të madh në përmirësimin e sistemit të mbrojtjes së këtyre të drejtave.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2018, arriti që t'i përmbushë 100 për qind të të gjitha masave të parapara për këtë Institucion lidhur me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Jemi të bindur se informacionet, konstatimet dhe rekomandimet e paraqitura në këtë Raport, do të marrin vëmendjen e duhur nga përfaqësuesit e Kuvendit të Republikës së Kosovës, të Qeverisë dhe të të gjitha institucioneve e palëve tjera të interesuara, në mënyrë që ky dokument të jetë një udhëzues për orientimin e politikave të funksionimit të shtetit, në pajtim me parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, të barazisë, të epërsisë së sundimit të ligjit, të transparencës, të llogaridhënies, si vlera të demokracisë. Vetëm orientimi i institucioneve që, nëpërmjet mekanizmave efektivë, të sigurojnë mbrojtje dhe realizim të të drejtave të njeriut, duke siguruar zbatim praktik, do të shërbejë si mënyrë e vetme për t'i tejkaluar sfidat e paraqitura në këtë Raport, e cila është domosdoshmëri e kohës.

Synimi kryesor i Institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse edhe i institucioneve të vendit tonë, është mbrojtja e të drejtave dhe e lirive të njeriut. Prandaj, së bashku do ta vazhdojmë zbatimin e obligimeve kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët të jenë në qendër të vëmendjes dhe t'i gëzojnë të drejtat që u takojnë.

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka përcaktuar Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) si kategori kushtetuese, përkatësisht si institucion të pavarur kushtetues.¹ Avokati i Popullit mbikëqyr, promovon dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.² Funksionin e tij Avokati i Popullit e ushtron në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, qëllimi i të cilit ka të bëjë me krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave fizikë dhe juridikë nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve tjera, të cilët ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme *autoritetet publike*), si dhe krijimin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.³

Po ashtu, Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë, i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.⁴

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, IAP-ja përbëhet nga: Avokati i Popullit, pesë (5) zëvendës të Avokatit të Popullit dhe nga personeli i IAP-së.⁵

Mandati i Institucionit të Avokatit të Popullit

Mandati i Avokatit të Popullit është përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilëve Avokati i Popullit pranon dhe heton ankesat nga çdo person, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, i/e cili/a pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë nga autoritetet publike në Kosovë.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrave dhe nuk pranon udhëzime ose ndërhyrje nga autoritetet publike, të cilat janë të detyruara t'i përgjigjen kërkesave të IAP-së dhe t'i paraqesin të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin.

Në kuadër të veprimtarisë së tij, IAP-ja udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit⁶, si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare për realizimin e detyrave të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj.⁷

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kapitulli XII, nenet 132 – 135.

² Po aty, neni 132.

³ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 1.

⁴ Po aty, neni 1, paragrafi 2.

⁵ Po aty, neni 5.

⁶ Po aty, neni 3, paragrafi 1.

⁷ Po aty, neni 3, paragrafi 3.

Në kuadër të kompetencave të tij, Avokati i Popullit zhvillon hetime për ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe aktet tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore (KEDNj)⁸.

Avokati i Popullit mund të zhvillojë hetime edhe me iniciativën e vet (*ex officio*) nëse dëshmitë, faktet, konstatimet ose njohuritë e fituara ofrojnë bazë për shkeljen e të drejtave të njeriut. Gjithashtu, Avokati i Popullit përdor ndërmjetësimin dhe pajtimin, si dhe mund t'u ofrojë shërbime të mira edhe qytetarëve të Republikës së Kosovës që ndodhen jashtë shtetit. Shërbimet e ofruara nga IAP-ja janë falas.

Nëse Avokati i Popullit gjatë kryerjes së hetimeve vëren se ka elemente të veprës penale, e informon organin kompetent për fillimin e hetimeve. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe të mbrojtjes nga diskriminimi. Avokati i Popullit nuk ndërhyt në rastet dhe në procedurat tjera gjyqësore, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave. Por Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Po ashtu, Avokati i Popullit mund të iniciojë çështje në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin për Gjykatën Kushtetuese⁹.

Në kuadër të IAP-së funksionon edhe Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese (MKPT).¹⁰

Avokati i Popullit, në kuadër të përgjegjësi si MKPT, është i obliguar që t'i vizitojë rregullisht dhe pa paralajmërim të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria (duke përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut), si dhe të krijojë mekanizëm të veçantë që do të kryejë të gjitha funksionet e MKPT-së. Avokati i Popullit bashkëpunon me mekanizmat ndërkombëtarë dhe vendorë në fushën e parandalimit të torturës si dhe formave të tjera të trajtimit apo ndëshkimit mizor, jonjerëzor dhe poshtëruës. Gjithashtu, Avokati i Popullit mund të japë sugjerime dhe rekomandime për personat dhe institucionet përgjegjëse ku mbahen personat e privuar nga liria, pa marrë parasysh llojin apo objektin dhe rrethanat e mbajtjes së tyre, për përmirësimin e trajtimit dhe kushteve të tyre.

Avokati i Popullit kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me legjislacionin tjetër në fuqi; mbledh të dhëna statistikore për çështjet e diskriminimit dhe të barazisë të paraqitura në IAP, të

⁸ Po aty, neni 16.

⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, paragrafi 2, neni 135, paragrafi 4, Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 10. Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, neni 29.

¹⁰ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17.

cilat edhe i publikon; publikon raporte dhe jep rekomandime për politikën dhe praktikën për luftimin e diskriminimit dhe promovimin e barazisë; bashkëpunon me partnerët socialë dhe OJQ-të që merren me çështje të barazisë dhe kundër diskriminimit si dhe me trupa të ngjashëm ndërkombëtarë me Avokatin e Popullit.¹¹

Avokati i Popullit ka edhe përgjegjësitë e theksuara ligjore: jo vetëm t'i hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit, por edhe të angazhohet për eliminimin e tyre; të hartojë dhe miratojë procedura të veçanta për pranimin dhe trajtimin e ankesave për fëmijët, si dhe krijimin e ekipit të specializuar për të drejtat e fëmijëve dhe të programit të përhershëm për vetëdijesimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe rolin e IAP-së për mbrojtjen e tyre; t'i bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe t'i rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoriteteve të tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut, të barazisë dhe jodiskriminimit; t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta; të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve si dhe nxjerrjen apo ndryshimin dhe plotësimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës; të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera për gjendjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut në Republikën e Kosovës; të rekomandojë harmonizimin e legjislacionit vendor me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe për liritë e njeriut, të barazisë dhe të diskriminimit, dhe të kryejë hulumtime për çështjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, të barazisë dhe të diskriminimit në Republikën e Kosovës; të bashkëpunojë, në pajtim me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, me të gjitha autoritetet vendore dhe ndërkombëtare që merren me mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut; të ruajë fshehtësinë e të gjitha informatave dhe të dhënave që i merr, duke i kushtuar kujdes të veçantë sigurisë së ankuesve, palëve të dëmtuara dhe dëshmitarëve, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (obligim ky që vlen për Avokatin e Popullit, zëvendësit e tij dhe personelin e IAP-së, edhe pas përfundimit të mandatit ose marrëdhënies së punës).¹²

Ankesat kundër administratës publike qytetarët mund t'i parashtrojnë sipas procedurës së thjeshtë dhe pa pagesë. Ankesat e drejtuara në IAP mund t'u referohen veprimeve, mosveprimeve ose vendimeve të administratës publike, që nga ankuesit mund të konsiderohen të padrejta ose të pafavorshme. Në shqyrtimet e ankesave të tilla, veprimet e juristëve të IAP-së kanë të bëjnë me ofrimin e këshillave juridike, me kërkim të të dhënave nga administrata publike, nga gjykatat dhe nga institucionet tjera të rëndësishme, lidhur me ankesat e paraqitura, si dhe me mbikëqyrjen e procedurave të caktuara administrative dhe gjyqësore.

Në rastet që kërkojnë veprime të menjëhershme, Avokati i Popullit paraqet kërkesa për masa të përkohshme. Nëse Avokati i Popullit konsideron se duhet të merren masa të

¹¹ Po aty, neni 16, paragrafët 13 deri 16.

¹² Po aty, neni 18.

menjëhershme nga autoritetet publike, ai mund të kërkojë ligjërisht që organi administrativ kompetent të ndërmarrë ose të suspendojë një veprim të veçantë, si masë e përkohshme për të parandaluar dëmtimin e papërmirësueshëm të ankuesve apo pasurisë së tyre.

Në qoftë se kërkesat për intervenim dhe përpjekjet për ndërmjetësim nuk janë të suksesshme, Avokati i Popullit mund të nxjerrë raport, duke siguruar analiza dhe paraqitje publike për shkelje të të drejtave të njeriut ose të ligjeve të aplikueshme, së bashku me rekomandime për institucionin publik, për të evituar shkeljet. Raportet janë metoda e fundit e institucionit për avokim. Raporti i drejtohet autoritetit që ka bërë shkelje, kurse kopja e raportit i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe organizatave të tjera përkatëse. Ndërsa raportin vjetor për vitin paraprak, Avokati i Popullit ia paraqet Kuvendit të Republikës së Kosovës deri më 31 mars të vitit vijues, i cili shqyrtohet në seancë plenare në Kuvend gjatë sesionit pranveror.¹³

Avokati i Popullit, me qëllim të përmbushjes sa më efektive të mandatit të përcaktuar me Kushtetutë dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit, në drejtim të obligimeve për nxjerrjen e rregullave të brendshme,¹⁴ më 18 janar 2017, ka miratuar *Rregulloren nr. 01/2017 për përshkrimin e detyrave të punës dhe klasifikimin e vendeve të punës në Institucionin e Avokatit të Popullit; Rregulloren nr. 02/2017 për procedurën e rekrutimit, emërimit dhe punës provuese të nëpunësve në Institucionin e Avokatit të Popullit dhe Rregulloren nr. 03/2017 për avancim në karrierë dhe transferimin e nëpunësve të Institucionit të Avokatit të Popullit*, të cilat janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (GZRK) më 23 janar 2017 dhe kanë hyrë në fuqi po atë ditë.

Kompetencat e Avokatit të Popullit për t'i shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga diskriminimi në përgjithësi dhe diskriminimi gjinor në veçanti janë paraparë me dy ligjet tjera bazike për të drejtat e njeriut (Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjin për Barazi Gjinore).

Kështu, sipas Ligjit për Barazi Gjinore, Avokati i Popullit është institucion i barazisë gjinore që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.¹⁵

Ndërsa, sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit është institucion i pavarur, i cili bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin, sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.¹⁶

Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në kuadër të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) është përgjegjëse për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.¹⁷

¹³ Po aty, neni 29.

¹⁴ Po aty, neni 37.

¹⁵ Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13.

¹⁶ Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 9.

Promovimi i të Drejtave të Njeriut

Edhe gjatë vitit 2018, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) si institucioni i vetëm kombëtar për të Drejtat e Njeriut në vend, ka vazhduar të ketë rol të rëndësishëm në drejtim të promovimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, gjithnjë duke marrë parasysh rrethanat e shoqërisë dhe divergjencën e komuniteteve, me synim të vetëm, fuqizimin e qytetarëve për t'i gëzuar e për t'i ushtruar të drejtat e njeriut, si dhe për t'i respektuar të drejtat e të tjerëve.

IAP-ja ka vazhduar me organizimin e aktiviteteve edukative, trajnimeve, fushatave informuese dhe vetëdijësuese, me qëllim të promovimit të respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, si kontribut në ndërtimin dhe në promovimin e një kulture universale për të drejtat njeriut, si dhe në parandalimin e shkeljeve apo abuzimeve të të drejtave të njeriut,

IAP-ja ka mbetur i përkushtuar në përmbushjen e objektivit të parë të Strategjisë dhe planit zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019, mbi ngritjen e besueshmërisë së qytetarëve në Institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore. Në këtë drejtim, IAP-ja ka vazhduar me përmbushjen e obligimit që dalin nga instrumentet dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit, për të promovuar dhe inkurajuar respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut për të gjithë, pa dallim.

Gjatë vitit raportues, IAP-ja ka vazhduar të jetë institucioni më i besuar në vend dhe më gjerë¹⁸, si rezultat i përkushtimit dhe i angazhimit në mbrojtjen dhe në promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në vend.

Përkushtimi i Avokatit të Popullit, në drejtim të përmbushjes së mandatit të tij, u vlerësua lart edhe përmes Raportit të Progresit të Komisionit Evropian për Kosovën 2018, i publikuar në prill të vitit 2018, sipas së cilit: *“Institucioni i Avokatit të Popullit ka vazhduar ngritjen e kapaciteteve me qëllim të shqyrtimit të rasteve, duke u bërë kështu Institucioni më i besuar në Kosovë”*. Për më tepër, IAP-ja, sipas Raportit për Zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, i publikuar në prill të vitit 2018, është vlerësuar si institucioni i vetëm që ka përmbushur në nivel vendi 100% të gjitha masat zbatuese të parapara për institucionin gjatë vitit 2017, lidhur me zbatimin e Programit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së.

Gjatë vitit 2018, IAP-ja, me qëllim të përmbushjes së mandatit kushtetues dhe ligjor për promovimin dhe bërjen të njohur të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, ka

¹⁷ Po aty, neni 10, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2.

¹⁸ *Barometrit e Ballkanit 2017, (Regional Cooperation Council (RCC): http://www.rcc.int/seeds/files/RCC_BalkanBarometer_PublicOpinion_2017.pdf, “Në pyetjen e parashtruar se sa shumë u besoni institucioneve të listuara (gjykatave dhe sistemit të drejtësisë; Parlamentit; Qeverisë; Ombudspersonit; Auditorit), për qëllimin e hulumtimit, 59% të respondentëve nga Kosova janë shprehur se kanë besim në Institucionin e Avokatit të Popullit, që e rangon më së larti në krahasim me institucionet e listuara nga vendet në regjion, për të cilat, besueshmëri shprehin më pak se gjysma e popullatës Public Opinion Survey, fq. 124 -125”*.

ndërmarrë një sërë aktivitete me karakter informuese, edukuese, vetëdijesuese për të drejtat e njeriut. Përmes trajnimeve, konferencave, kampanjave vetëdijesuese, tryezave të rrumbullakëta, punëtorive, pjesëmarrjeve në media etj., IAP-ja kontribuoi në vetëdijësimin dhe informimin e qytetarëve lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore, përfshirë shkeljet masive ose sistematike, të të drejtave të grupeve të ndryshme si individë, fëmijë parashkollorë, nxënës të niveleve të ndryshme, studentë vendorë dhe ndërkombëtarë, punëtorë, shërbyes civilë, prokurorë dhe gjykatës, policë, pensionistë etj.

Në ngritjen e performancës së Institucionit në drejtim të promovimit të punës së IAP-së dhe edukimit për të drejtat e njeriut, ka ndikuar angazhimi i Avokatit të Popullit, zëvendësve të Avokatit të Popullit dhe i gjithë stafit profesional. Departamenti i veçantë për promovimin e të drejtave të njeriut, Departamenti për Bashkëpunim, për Raportim dhe për Promovim të të Drejtave të Njeriut (DBRPDNj), si dhe departamentet tjera të IAP-së, kanë vazhduar me përkushtim përmbushjen e objektivit të parë të Strategjisë dhe planit zhvillimor të Institucionit të Avokatit të Popullit 2017-2019, përmes organizimit të aktiviteteve të ndryshme me karakter edukues dhe promovues, dhe po ashtu duke intensifikuar bashkëpunimin me organizatat ndërkombëtare, me shoqërinë civile, në kuadër të projekteve të zhvilluara në partneritet.

Duke pasur në konsideratë rolin dhe kontributin e rëndësishëm të mediave në promovimin e të drejtave të njeriut dhe përcjelljen e informatës te publiku, IAP-ja ka përforcuar bashkëpunimin me media, duke qenë vazhdimisht i pranishëm në programe dhe diskutime, por edhe përmes publikimeve, shpërndarjes së qëndrimeve dhe informacioneve për të gjeturat lidhur me gjendjen e lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë. Rëndësi të veçantë i është kushtuar promovimit dhe ngritjes së vetëdijesimit lidhur me rolin dhe mandatin e IAP-së edhe përmes mediave sociale dhe kampanjave mediale.

Më 22 janar 2018, IAP-ja ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Radiotelevizionin e Kosovës (RTK). Qëllimi i marrëveshjes për bashkëpunim është informimi i vazhdueshëm i publikut lidhur me të gjeturat e Avokatit të Popullit, publikimet dhe aktivitetet e realizuara nga IAP-ja, si dhe bashkëpunimi e koordinimi i veprimeve lidhur me aktivitetet dhe projektet që mund të zhvillohen me qëllim të promovimit të të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Aktivitetet promovuese të Institucionit të Avokatit të Popullit

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) ka vazhduar bashkëpunimin në fushën e të drejtave të njeriut me institucione vendore, organizata ndërkombëtare në Kosovë dhe me shoqërinë civile. Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë marrë pjesë në rreth 89 (tetëdhjetë e nëntë) tryeza diskutimi, 29 (njëzet e nëntë) konferenca, 37 (tridhjetë e shtatë) punëtori e 15 (pesëmbëdhjetë) seminare të organizuara nga bashkëpunëtorë institucionalë, organizata ndërkombëtare në vend dhe organizata joqeveritare. Gjatë këtyre aktiviteteve janë trajtuar tema të ndryshme nga fusha e të

drejtave dhe të lirive themelore të njeriut si: të drejtat e komuniteteve joshumicë, të drejtat e gruas, të drejtat e fëmijëve, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, të drejtat e komuniteteve të marginalizuara dhe të tjerë, e drejta e qasjes në dokumente publike, barazia gjinore, e drejta në arsim, çështjet mjedisore dhe ndikimi në të drejtat e njeriut, barazia dhe trajtimi pa diskriminim, kompensimi i viktimave të krimit etj.

Duke pasur parasysh rëndësinë e pazëvendësueshme të edukimit dhe të trajnimeve, si formë e promovimit mbi të drejtat e njeriut dhe mënyrë e vetme për fitimin e njohurive për realizimin efektiv të të gjitha të drejtave të njeriut, si dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit për promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut dhe të mandatit të IAP-së, Avokati i Popullit, gjatë vitit 2018, ka mbajtur rreth 22 (njëzet e dy) ligjërata me studentë të universiteteve publike dhe private në Kosovë. Studentët janë njoftuar me gjendjen e të drejtave të njeriut në vend, me bazën ligjor, kushtetuese, standardet ndërkombëtare, vlerat, parimet dhe mekanizmat për mbrojtjen e të drejtave në vend, si dhe me kompetencat, përgjegjësitë, rolin dhe misionin e IAP-së.

Avokati i Popullit ka organizuar edhe 7 (shtatë) trajnime me zyrtarë për të drejtat e njeriut në nivel komunal dhe trajnime për prokurorë të emëruar në detyrë, ku është prezantuar mandati kushtetues dhe ligjor i IAP-së, kompetencat dhe përgjegjësitë nga fusha e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe bërjes njohur të tyre, të arriturat e institucionit deri më tani dhe sfidat me të cilat vazhdon të ballafaqohet vendi sa i përket respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Në përpjekje për të promovuar të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe me qëllim të diskutimit të problemeve mjedisore me akterë të ndryshëm të institucioneve përgjegjëse shtetërore, më 22 nëntor 2018, IAP-ja, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Drejtësi (IKD), organizoi tryezën me temën: “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”. Në këtë tryezë, me qëllim të diskutimit të problemeve të shumta të natyrës mjedisore, të pranishëm ishin përfaqësuesit e organeve të drejtësisë, përfaqësues nga Policia e Kosovës, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësive diplomatike, shoqërisë civile dhe qytetarë. Tryeza u organizua me qëllim të diskutimit dhe adresimit të problemeve mjedisore si: zvarritja në prokurori dhe në gjykata e lëndëve mjedisore si dhe luftimi i problemeve mjedisore, ndër to edhe ndërtimet pa kriter, mbeturinat inerte e deponitë.

Në kuadër të kornizës së aktiviteteve, me qëllim të promovimit të të drejtave të komuniteteve, IAP-ja, më 17 dhjetor 2018, me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Kosovë, organizoi tryezë diskutimi lidhur me të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë për të drejtat e komunitetit turk në Kosovë. Tryeza ka pasur për qëllim zhvillimin e diskutimit të hapur me qytetarë të komunitetit turk, lidhur me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, adresimin e shqetësimeve të pjesëmarrësve lidhur me respektimin e të drejtave të tyre, si dhe prezantimi i rolit dhe mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit. Në drejtim të mbrojtjes, të respektimit dhe të promovimit të lirive dhe të drejtave të njeriut në Kosovë, me ç’ rast gjatë diskutimit të hapur, pjesëmarrësit në tryezë paraqitën problemet

me të cilat ballafaqohet komuniteti i tyre, si: përkthimi joadekuat i teksteve shkollore në gjuhën turke dhe mungesa e tyre, përdorimi i termave diskriminues në librat shkollor si dhe kufizimet lidhur me përdorimin e gjuhës amtare, të cilat probleme do të adresohen tutje nga ana e IAP-së.

Me rastin e shënimit të 10-dhjetorit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit, për të dytën herë radhazi, në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe shoqërinë civile në Kosovë, kanë organizuar aktivitetin e përbashkët “Çohu për të Drejtat e Njeriut”. Aktiviteti ka pasur për qëllim dërgimin e një mesazhi të fuqishëm për angazhim të shtuar, gjithëpërfshirës dhe ndërinstitucional për promovimin dhe edukimin mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Gjatë këtij aktiviteti, përfaqësues nga shoqëria civile, përmes fjalimeve të tyre, diskutuan për të drejtat e fëmijëve, për të drejtat e të rinjëve, për të drejtat e gruas, për të drejtat e të moshuarve, për të drejtat e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për të drejtat e komunitetit LGBTI, për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe për të drejtat e të kthyerve në Kosovë. Aktiviteti është përcjellë me PSA (storje të shkrutra me mesazhe edukuese për të drejtat e njeriut), për të gjitha të drejtat e lartpërmendura, të cilat janë realizuar nga BIRN. PSA-të janë transmetuar në TV dhe në media sociale. Aktiviteti është përcjellë me marshin tradicional, me pjesëmarrje të gjerë të shoqërisë civile, aktivistëve e qytetarëve, nën moton “Çohu për të Drejtat e Njeriut”. Aktiviteti është mbështetur nga GIZ-i.

Duke e konsideruar më se të nevojshëm forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me Institucionin e Avokatit të Popullit, me qëllim të adresimit të problemeve rreth mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut, më 18 dhjetor 2018, Avokati i Popullit organizoi konferencën: “Bashkëpunimi Institucional me Avokatin e Popullit”. Në konferencën në të cilën morrën pjesë përfaqësues të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal, të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të misioneve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare, u diskutuan të arriturat e IAP-së dhe rëndësia e bashkëpunimit ndërinstitucional me Institucionin e Avokatit të Popullit, dhe në veçanti, u theksua rëndësia e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, me qëllim të ngritjes së nivelit të respektimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në vendin tonë. Gjatë kësaj konference u promovuan edhe publikimet e vitit 2018: Parimet e Miradministrimit dhe Doracaku për mbrojtje nga Diskriminimi, përmbledhje të hartuara dhe publikuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare në Kosovë, me organizata joqeveritare dhe me shoqërinë civile, nëpërmjet projekteve

Ka vazhduar përkrahja e Institucionit të Avokatit të Popullit nga organizatat ndërkombëtare në vend, si: Komisioni Evropian, Këshilli i Evropës, OSBE, UNICEF, UNMIK, UNDP, dhe organizata të tjera që veprojnë në vend, nëpërmjet projekteve, me qëllim të ngritjes së kapaciteteve të IAP-së, si dhe kanë bashkëpunuar gjatë vitit për promovimin dhe edukimin për të drejtat e njeriut. Aktivitetet e dala nga projektet kanë

pasur ndikim të qëndrueshëm në ngritjen e performancës dhe në arritjen e rezultateve të larta në realizimin e mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Projekti “Forcimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin në Kosovë”, i mbështetur nga Këshilli i Evropës, nga Qeveria e Zvicrës dhe nga Qeveria e Norvegjisë, ka vazhduar me shumë sukses edhe këtë vit. Synimi i projektit është fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) për zbatimin e standardeve ndërkombëtare në fushën e parandalimit të torturës dhe të keqtrajtimit dhe për të rritur ndërgjegjësimin e akterëve përkatës mbi rolin dhe mandatin e MKPT-së.

Angazhimi i katër këshilltarëve të jashtëm ligjorë, në kuadër të këtij projekti, ka vazhduar të japë rezultat të lartë në fuqizimin e kapaciteteve të institucionit për zbatimin e mandatit i dalë nga Pakoja Ligjore për të drejtat e njeriut.

Në kuadër të projektit “OmbudsWatch – Promovimi i Rolit të Avokatit të Popullit në Kosovë”, i implementuar nga BIRN Kosova dhe ACDC (Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike) në partneritet me Institucionin e Avokatit të Popullit, i mbështetur nga Ambasada e Holandës në Kosovë, gjatë vitit 2018 janë implementuar disa aktivitete, qëllimi i të cilave ka qenë ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut. Përmes projektit janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Realizimi dhe publikimi i pesë PSA (storje të shkurtra me mesazhe edukuese për të drejtat e njeriut), të cilat kanë trajtuar tema të ndryshme si: vlerësimi i punës dhe i aktiviteteve të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit si Institucion Kombëtar për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut si: (Barometri i Ballkanit, Raporti i Progresit dhe Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA për vitin 2017); PSA për mbrojtjen dhe promovimin e së drejtës për qasje në dokumente publike; mbrojtjen dhe promovimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm; si dhe për rolin, mandatin dhe kompetencat e IAP-së.
- Realizimi i tri diskutime të hapura me shoqërinë civile dhe me mediat, për të drejtat e njeriut, në qytete të ndryshme të Kosovës si në: Prizren, Mitrovicë dhe Pejë; për të diskutuar rolin e Avokatit të Popullit në trajtimin e çështjeve në interes të publikut.
- Realizimi i konkursit për storjet më të mira gazetareske në çështjet e të drejtave të njeriut, me qëllim të inkurajimit të komunitetit të gazetarëve që, përmes storjeve të ndryshme, ta informojnë dhe ta vetëdijesojnë publikun për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në vend.
- Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve të stafit të IAP-së, përkitazi për promovimin e të drejtave të njeriut dhe punës së IAP-së, përmes mediave sociale dhe kampanjave mediale.
- Organizimi i aktivitetit përmbyllës për ndarjen e çmimeve për tri storiet më të mira gazetareske në çështjet e të drejtave të njeriut.

Si vazhdimësi e aktiviteteve në kuadër të projektit “Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut në Kosovë përmes shoqërisë civile aktive”, nën Instrumentin Evropian për Demokraci dhe të Drejta të Njeriut, zbatuar nga Instituti Kosovar për Kërkime dhe Zhvillim të Politikave (KIPRED), nga Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS) dhe nga Artpolis, janë mbajtur aktivitetet në vijim:

- Organizimi i punëtorisë me stafin e IAP-së, qëllimi i cilës ishte mbështetja e IAP-së në rishikimin e Strategjisë së Komunikimit dhe Strategjisë dhe Planit Zhvillimor të IAP-së 2017-2019.
- Organizimi i tryezës, më 14 qershor 2018, për lansimin e “Mekanizmit përcjellës të rasteve të shkeljeve të të drejtave të njeriut të Raportuara në Kosovë”, i cili mekanizëm paraqet përmbledhjen e të dhënave lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut të raportuara në Policinë e Kosovës, në prokuroritë, në gjykatat dhe në Institucionin e Avokatit të Popullit, përkritazi me dhunën në familje, me trafikimin me qenie njerëzore, me cenimin e të drejtave të komunitetit LGBT dhe me cenimin e të drejtave të gazetarëve.
- Realizimi i Forum Teatrit “Stigma – Kërko të Drejtën Tënde”, e cila adreson stigmën brenda shoqërisë lidhur me fatin e të mbijetuarave të dhunës seksuale në Kosovë, dhe gjithashtu promovon rolin dhe mandatin e Institucionit të Avokatit të Popullit në drejtim të promovimit, të mbrojtjes dhe të mbikëqyrjes së lirive dhe të drejtave të njeriut.

Gjatë vitit raportues ka vazhduar përkrahja e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kosovë. Aktivitetet e organizuara mes Avokatit të Popullit dhe OSBE-së janë:

- Në kuadër të projektit “Promovimi i sektorëve ligjorë dhe juridikë duke respektuar të drejtën e barazisë para ligjit, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, feja apo karakteristikat e tjera personale”, ka mbështetur Institucionin e Avokatit të Popullit në zhvillimin e ueb-faqes së re të institucionit dhe platformës “online” për raportet e OJQ-ve. Në këtë drejtim është lansuar ueb-faqja e re e IAP-së dhe platforma e qasshme në ueb-faqen e IAP-së, e cila është dizajnuar me qëllim të ofrimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstytucionale dhe pa kufizim, në të cilën platformë do të ekspozohen raportet dhe rekomandimet e organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile, që punojnë dhe kontribuojnë për të drejtat e njeriut në Kosovë.
- Avokati i Popullit, OSBE-ja së bashku me një grup të organizatave joqeveritare, të profileve të ndryshme, të përfaqësuar nga komunitetet joshumicë, personat me aftësi të kufizuara, forumet rinore, komuniteti i grave dhe grupet e marginalizuara, në muajin prill 2018, ka mbajtur një punëtori, në kuadër të së cilës është bërë shqyrtimi i planit të përbashkët të veprimit i hartuar në vitin 2017, si dhe është bërë përcaktimi i prioritetëve për vitin 2018.

- Tryeza e organizuar në qershor 2018, me organizatat joqeveritare, me shoqërinë civile dhe me përfaqësues të institucioneve publike, mbi të drejtën e qasjes në dokumente publike, me ç’ rast përfaqësuesit e IAP-së njoftuan të pranishmit me kornizën ligjore që rregullon fushën e qasjes në dokumente publike, praktikën e IAP-së përkitazi me të drejtën për qasje në dokumente publike, sfidat dhe kufizimet me të cilat ballafaqohen qytetarët gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.
- Në periudhën korrik–gusht 2018, ka organizuar ciklin e punëtorive “Unë jam NJERI dhe kam të DREJTA”, në 10 (dhjetë) komuna: Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë, duke përfshirë edhe pjesën veriore, Pejë, Gjiilan, Dragash dhe Graçanicë. Qëllimi i punëtorive ka qenë zgjerimi i njohurive dhe ngritja e vetëdijesimit për të drejtat e njeriut, çështjen e barazisë dhe mosdiskriminimit të të rinjtë e moshës 15-25 vjeç. Vëmendje e veçantë i është kushtuar gjithpërfshijes së të rinjve të komuniteteve: serb, turk, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak e goran. Përmes punëtorisë është përçuar ftesa për garën për poezinë dhe fotografinë më të mirë për të drejtat e njeriut “Të drejtat e njeriut përmes artit”. Qëllimi i aktivitetit ka qenë paraqitja e të drejtave të njeriut përmes artit, si dhe inkurajimi i të rinjve për të menduarit me reflektim përmes artit, për të drejtat e njeriut dhe shkeljet apo kufizimet e tyre.
- Aktiviteti përfundimtar më 10 dhjetor 2018, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, organizimi i ekspozitës me poezi dhe me fotografi të të rinjve nga mbarë Kosova, dhe ndarja e çmimeve për veprat më të mira artistike.
- IAP-ja, më 17 dhjetor 2018, me mbështetje të Misionit të OSBE-së në Kosovë, organizoi tryezë diskutimi lidhur me të drejtat e njeriut, me fokus të veçantë për të drejtat e komunitetit turk në Kosovë. Tryeza ka pasur për qëllim zhvillimin e diskutimit të hapur me qytetarë të komunitetit turk, lidhur me të drejtat e njeriut dhe për liritë themelore, adresimin e shqetësimeve të pjesëmarrësve lidhur me respektimin e të drejtave të tyre si dhe prezantimi i rolit dhe mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në kuadër të bashkëpunimit me UNICEF-in, IAP-ja ka realizuar takime të përbashkëta me qëllim të ngritjes së nivelit të respektimit të të drejtave të fëmijëve. Ndërsa me mbështetjen e UNICEF-it, dy përfaqësues të IAP-së morën pjesë në një vizitë studimore, e cila u mbajt më 23-24 tetor 2018, në Gjermani. Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi me punën dhe përvojat e institucioneve qeveritare dhe joqeveritare gjermane në fushën e delikucencës së të miturve.

IAP-ja ka vazhduar gjithashtu bashkëpunimin me Terre de Hommes, e cila gjatë vitit 2018 e kanë mbështetur IAP-në për realizimin e një trajnimit për stafin, lidhur me teknikat e intervistimit të fëmijëve si dhe janë në proces të krijimit të procedurave për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave që lidhen me çështjet e të drejtave të

fëmijëve, të cilat do të jenë shumë të dobishme për IAP, dhe në veçanti për Departamentin për të Drejtat e Fëmijëve.

Edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi dhe mbështetja nga UNMIK-u në promovimin e IAP-së nëpërmjet financimit të një fushate mediale, debateve mediale (në televizionet dhe radiot që veprojnë në pjesën e Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës Veriore), publikimin dhe shpërndarjen e broshurave, me qëllim të informimit të qytetarëve të Mitrovicës Jugore dhe Mitrovicës Veriore rreth të drejtave të njeriut, për rolin dhe mandatin e IAP-së. Ngritja e numrit të ankesave në IAP nga qytetarët e kësaj pjese është tregues i ndikimit pozitiv të projektit.

UNDP-ja, në periudhën 20 mars – 19 korrik 2018, e ka mbështetur Institucionin e Avokatit të Popullit me angazhimin e një këshilltari ligjor, me qëllim të rritjes së kapacitetit të Institucionit për të identifikuar çështjet sistematike të paraqitura në gjykata, që të veprojnë sipas mandatit *amicus curiae* apo edhe duke kontribuar në opinionet e Avokatit të Popullit për adresim në gjykatat themelore, në Gjykatën e Apelit ose në Gjykatën Supreme.

Po ashtu, IAP-ja, në bashkëpunim me UNDP-në, kanë iniciuar projektin që ka për synim t'i promovojë të drejtat e njeriut të garantuara me legjislacionin në fuqi dhe me instrumentet ndërkombëtare në vend, si dhe me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm, të dala nga Agjenda 2030. Projekti është mbështetur nga ambasada norvegjeze në Kosovë dhe do të implementohet gjatë vitit 2019.

Me rastin e shënimit të 10-dhjetorit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bashkëpunim me organizatat joqeveritare dhe me shoqërinë civile në Kosovë, kanë organizuar aktivitetin e përbashkët “Çohu për të Drejtat e Njeriut”. Aktiviteti është mbështetur nga GIZ-i.

Lansimi i ueb-faqes së re dhe platformës online për raportet e OJQ-ve, video spoteve dhe materialeve promovuese

Gjatë vitit 2018, IAP-ja ka lansuar ueb-faqen e re, e cila përmban informata të shumta lidhur me mandatin, veprimet, publikimet dhe qëndrimet e IAP-së. Në kuadër të ueb-faqes është vendosur edhe platforma e qasshme, e cila është dizajnuar me qëllim të ofrimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstucionale dhe pa kufizim, në të cilën platformë do të vendosen raportet dhe rekomandimet e organizatave joqeveritare dhe të shoqërisë civile, që veprojnë dhe që kontribuojnë për të drejtat e njeriut në vend.

IAP-ja, gjatë vitit 2018, në përmbushje të misionit të tij për edukim dhe informim mbi të drejtat e njeriut, ka hartuar materiale me karakter edukues dhe informues për të drejtat e njeriut, si fletëpalosje dhe broshura për misionin, kompetencat dhe mandatin e IAP-së, si dhe për mandatin dhe kompetencat e IAP-së në relacion me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Vlen të përmendet se, për herë të parë IAP-ja, gjatë vitit raportues, ka hartuar dhe publikuar dokumentet në vijim: Kodi me Parimet e miradministrimit, përmbledhje e

parimeve mbi bazën e të cilave do të duhej të funksiononte administrata shtetërore; Doracakun për mbrojtje nga diskriminimi, përmbledhje e informatava për njohje të të gjitha formave të diskriminimit, mekanizme mbrojtës nga diskriminimi si dhe informata për legjislacionin ndërkombëtar dhe vendor për mbrojtje nga diskriminimi; fletëpalosjen për promovimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, i përcjellë me informata relevante rreth kornizës ligjore në fuqi dhe mekanizme për mbrojtjen e kësaj të drejte; si dhe broshurën me informata lidhur me ditët më të rëndësishme ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, që ndërlidhen me mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtat e grave, të fëmijëve, të personave me nevoja të veçanta, të drejtat e grupeve të marginalizuara e të tjerë. Broshura përmban edhe një përmbledhje të instrumenteve ligjore ndërkombëtare dhe vendore në fuqi nga fusha e të drejtave të njeriut, si edhe informata relevante lidhur me simbolikën e ditëve ndërkombëtare që shënohen.

Është e rëndësishë së veçantë të theksohet se të gjitha materialet e lartpërmendura janë përgatitur në pesë gjuhë: shqipe, serbe, angleze, rome dhe turke; kjo me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe të respektimit të së drejtës për gjuhë dhe informim më të gjerë të të gjitha komuniteteve në Kosovë për të drejtat e njeriut si dhe për misionin dhe mandatin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Në periudhën raportuese IAP-ja ka lansuar dy video spote. Është lansuar video spoti "Know your rights" aplikacioni mobil, me qëllim të promovimit të platformës si dhe informimit të publikut për mënyrat e shfrytëzimit të aplikacionit mobil dhe video spoti për vetëdijësim dhe mbrojtje nga të gjitha format e diskriminimit, i cili është transmetuar si në TV ashtu edhe në media sociale. Gjatë vitit 2018 janë përgatitur edhe dy video spote për promovimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe vetëdijësimin e të rinjve për rrezikun e përdorimit të substancave narkotike, posaçërisht obligimin e shtetit për mbrojtjen e qytetarëve, parandalimin dhe trajtimin e individëve nën ndikimin e tyre, të cilat video spote do të lansohen dhe do të transmetohen gjatë vitit 2019.

Promovimi i të drejtave të fëmijëve

Me qëllim të edukimit dhe ngritjes së vetëdijësimin për të drejtat e njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar me fushata informuese me nxënësit dhe mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme në rajone dhe komuna të ndryshme të Kosovës. Gjatë këtij viti janë organizuar rreth 40 (dyzet) fushata informuese në shkolla fillore dhe të mesme, lidhur me rolin e IAP-së në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Qëllimi kryesor i organizimit të këtyre fushatave ka të bëjë me informimin e fëmijëve mbi rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, si dhe mundësinë e tyre në adresimin e rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut në IAP, ndër të tjerash edhe përmes platformës online "Njihuni me të drejtat e juaja".

Në mënyrë që të fuqizohet bashkëpunimi me shoqërinë civile, më 19 janar 2018, Avokati i Popullit ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi me Save the Children, me qëllim të

bashkëpunimit të ndërsjellët për promovimin e të drejtave të fëmijëve nëpërmjet fuqizimit të pjesëmarrjes së fëmijëve.

Ndërkaq, për nder të shënimit të 1 qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, janë organizuar aktivitete të ndryshme për fëmijët e moshave të ndryshme në 4 (katër) komuna të Kosovës, në: Prishtinë, Graçanicë, Prizren dhe Gjilan. Në këtë ditë fëmijët takuan Avokatin e Popullit, zëvendësit dhe përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, me ç'rast u diskutua për të drejtat e fëmijëve, ku fëmijët përmes vizatimeve, kuizeve dhe fotografive u informuan për të drejtat e njeriut, të drejtat e tyre, dhe misionin e IAP-së lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Me rastin e shënimit të 20 nëntorit, Ditës Universale të Fëmijëve, Avokati i Popullit ka pritur në takim fëmijë nga shkolla të ndryshme të Kosovës, ku u njoftuan lidhur me misionin dhe mandatin e IAP-së, të drejtat e njeriut, të drejtat e fëmijëve, si dhe adresimin e shkeljeve apo cënimeve të mundshme të të drejtave të tyre në IAP.

Promovim i të drejtave të personave me nevoja të veçanta

Edhe gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka vazhduar angazhimin e tij me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit, të mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave të personave me nevoja të veçanta. Si shenjë solidarizimi dhe përkrahjeje për personat me nevoja të veçanta, Avokati i Popullit, bashkë me bashkëpunëtorët e tij, kanë marrë pjesë në marshin protestues nën moton “Kosovë më Mbështet, Fuqizo të Drejtën Time”, e organizuar nga Shoqata Down Syndrome Kosova, me qëllim të shënimit të Ditës Botërore të Sindromës Down. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit premtoi përkrahje të plotë nga IAP-ja në përmirësimin e gjendjes dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me Sindromën Down, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të trajtohen në mënyrë të barabartë në të gjitha proceset e jetës.

Më 20 mars 2018, Avokati i Popullit, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, kanë vizituar Shoqatën “Down Syndrome Kosova” (DSK), me seli në Prishtinë, ku është diskutuar lidhur me problemet më të shpeshta me të cilat përballen fëmijët e prekur me sindromën down si: ofrimi i shërbimeve shëndetësore profesionale, gjithëpërfshirja në sistemin arsimor, si dhe integrimi i tyre përmes punësimit. Me këtë rast, Avokati i Popullit ka premtuar përkrahje të plotë nga IAP-ja në kuadër të nismave dhe aktiviteteve, që kanë për synim përmirësimin e gjendjes dhe mbrojtjen e të drejtave të personave me Sindromën Down.

Më 30 mars 2018, me rastin e shënimit të Ditës Botërore të Personave me Autizëm, Avokati i Popullit, i shoqëruar nga zëvendësit dhe bashkëpunëtorët, vizituan fëmijët me autizëm në Shkollën Filllore “Ismail Qemali” në Prishtinë, ku u informuan lidhur me vështirësitë me të cilat përballen fëmijët me autizëm, si: mungesa e transportit në shkolla, buxheti i kufizuar. Avokati i Popullit thekson nevojën e angazhimit shtesë të institucioneve përkatëse me qëllim të ofrimit të kushteve adekuate për të mundësuar që

edhe fëmijët me autizëm t'i vijojnë mësimet në shkollë në përputhje me nevojat e tyre specifike.

Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit

IAP-ja, në zyrat e saj, për çdo ditë pune (nga e hëna deri të premten) nga ora 8:00 - 16.00, pret qytetarët, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Ata priten nga këshilltarët ligjorë të IAP-së, të cilët i trajtojnë rastet me kujdes, konfidencialitet dhe profesionalizëm.

Për ta lehtësuar qasjen në IAP të qytetarëve të Kosovës, përveç Zyrës Qendrore në Prishtinë, IAP-ja ka edhe zyra rajonale në Ferizaj, Gjakovë, Gjiilan, Mitrovicën Jugore, Mitrovicën Veriore, Pejë, Prizren dhe Graçanicë.

Zyrat e IAP-së përbëhen nga stafi profesional që u shërben qytetarëve dhe përgjigjet në kërkesat dhe ankesat e tyre, si dhe mbron të drejtat që ata konsiderojnë se u janë shkelur.

Njëra nga format e qasjes më të lehtë të qytetarëve në IAP është organizimi i Ditëve të Hapura nga Avokati i Popullit dhe zëvendësit e tij. Ato organizohen në Prishtinë dhe në zyrat rajonale. Zyrat rajonale i njoftojnë qytetarët e komunave përkatëse për ditët e hapura, përmes publikimit të datave nëpër këto komuna, në mediat lokale dhe ueb-faqen zyrtare të IAP-së.

Format tjera të qasjes së qytetarëve në IAP janë edhe qasja përmes postës, përmes telefonit dhe përmes postës elektronike, që po përdoret gjithnjë e më shumë dhe e cila, në të shumtën e rasteve, aktualisht po përdoret për parashtrimin e ankesave nga qytetarët që jetojnë jashtë Kosovës. Në Zyrën Qendrore të IAP-së në Prishtinë ekziston edhe linja telefonike falas për raste urgjente, por edhe për raste të tjera të zakonshme.

Zyrtarët e IAP-së bëjnë vizita të rregullta në të gjitha burgjet dhe në vendet ku mbahen personat me liri të kufizuar në Kosovë. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, në bashkëpunim me autoritetet e Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe me autoritetet përgjegjëse të burgjeve në Kosovë, IAP-ja, që nga viti 2004, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare, të cilat hapen vetëm nga përfaqësuesit e IAP-së. Kjo praktikë ka dëshmuar se kutitë e vendosura nëpër burgje, përkatësisht në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, kanë ndihmuar shumë të burgosur ose të paraburgosur ta vënë kontaktin e parë me Avokatin e Popullit. Kutitë e tilla janë vendosur edhe në Entet dhe Qendrat e Shëndetit Mendor, gjë që lehtëson qasjen e pacientëve në IAP. Këto ente dhe qendra vizitohen rregullisht për çdo muaj nga përfaqësuesit e IAP-së.

Së fundmi, IAP-ja ka ndryshuar dizajnin e faqes zyrtare në të cilën tani mund të gjenden më shumë informacione rreth IAP-së dhe aktiviteteve të veta, e po ashtu ka ndryshuar adresën elektronike nga www.ombudspersonkosovo.org dhe info@ombudspersonkosovo.org në www.oik-rks.org dhe info.oik@oik-rks.org, e cila funksionon në mënyrë të rregullt dhe është në dispozicion të qytetarëve të Kosovës.

Gjendja e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës

Pushteti legjislativ

Duke pasur parasysh mandatin e Avokati i Popullit dhe rolin e tij mbikëqyrës mbi të gjitha pushtetet në strukturën shtetërore përkitazi me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, edhe gjatë vitit 2018, vazhdimisht e ka përcjellë procesin e hartimit, shqyrtimit dhe miratimit të ligjeve.

Në Programin legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për këtë vit, i miratuar më 20 dhjetor 2017,¹⁹ Avokati i Popullit ka vënë re se janë paraparë të shqyrtohen dhe të miratohen 75 projektligje, prej tyre 52 projektligje të reja dhe 23 projektligje për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese.

Nëse e krahasojmë programin legjislativ në tri vjetët e fundit, vihet re rënia e numrit të projektligjeve për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese. Në vitin 2016, programi legjislativ ka përmbajtur 50% projektligje për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese, përderisa në vitin 2017, kjo ka rënë në 42%, ndërsa në vitin 2018, numri i projektligjeve për ndryshim dhe plotësim të ligjeve ekzistuese ka rënë në 31%.

Për më tepër, Avokati i Popullit, ka analizuar listën e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, gjatë vitit raportues dhe ka vënë re se Kuvendi gjatë këtij viti ka miratuar 80 ligje, ndërkaq, deri në fund të dhjetorit 2018, 71 projektligje kanë qenë në procedurë në Kuvend. Kjo është tregues se Kuvendi ka tejkalluar pritshmëritë e parapara në Programin Legjislativ të Qeverisë për vitin 2018. Nga 80 ligjet e miratuara nga Kuvendi, 16 prej tyre (20%) janë ligje për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese. Edhe përkundër faktit se kjo shifër vazhdimisht ka shënuar rënie, Avokati i Popullit e konsideron se trendi i projektligjeve për plotësim dhe ndryshim të ligjeve vazhdon të jetë i madh. Në mënyrë që ligjet e sapo miratuara të mos rikthehen për plotësim dhe ndryshim vazhdimisht, kërkohet vëmendje e shtuar sa i përket cilësisë së hartimit të ligjeve, që nga faza fillestare e procesit legjislativ, në funksion të parimit të sigurisë dhe të qëndrueshmërisë juridike.

Sa i përket aspektit të miratimit të ligjeve, Avokati i Popullit ka vërejtur se gjatë vitit 2018, Kuvendi i Kosovës ishte më aktiv sesa në tri vjetët e kaluara. Gjatë vitit 2018, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar 80 ligje, për dallim nga viti 2015, kur Kuvendi kishte miratuar 56 ligje, përderisa në vitin 2016, 52 ligje, ndërkaq në vitin 2017, numri i ligjeve të miratuara në Kuvend ishte vetëm 21. Duhet theksuar se, sa i përket vitit 2017, numri i vogël i miratimit të ligjeve, ka ardhur si rezultat i ngjarjeve politike, si dhe vonesave në formimin e institucioneve, pas certifikimit të rezultateve të dala nga zgjedhjet qendrore të vitit 2017.

¹⁹ Mbledhja e 20 e Qeverisë së Republikës së Kosovës, Vendimi nr. 03/20, datë 20 dhjetor 2017.

Ashtu sikurse vitin e kaluar, edhe në vitin 2018, asnjë nga ligjet e miratuara nuk i përket legjislacionit me interes vital²⁰, ndërkohë që nuk janë miratuar disa projektligje të kësaj fushe që kanë qenë të parapara me Programin legjislativ për këtë vit.

Sa i përket kërkesave për interpretimin e dispozitave ligjore, që kanë arritur në IAP gjatë vitit 2018 (por jo vetëm), Avokati i Popullit e sheh jashtëzakonisht të nevojshme që ta theksojë edhe në Raportin e vet vjetor, se interpretimi i ligjeve nuk është kompetencë dhe mandat i tij.

I vetmi institucion që mund dhe duhet ta bëjë interpretimin autentik të dispozitave ligjore dhe të frymës së ligjeve të miratuara është Kuvendi i Republikës së Kosovës, si instancë ligjvënëse. Së këndejmi, Avokati i Popullit këshillon ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit që i ofron mbështetje Komisioneve parlamentare dhe vetë Kuvendit. Kjo do të reflektonte në drejtim të sqarimit të paqartësive apo përplasjeve që mund të paraqesin dispozitat ligjore, gjatë zbatimit të ligjeve.

Në raportet vjetore të viteve të kaluara, IAP-ja ka tërhequr vërejtjen për lëshimet evidente në procesin e hartimit të ligjeve dhe të projektligjeve të propozuara me ligjet ekzistuese. Me qëllim të konsolidimit të legjislacionit, ka rekomanduar fuqizimin e Drejtorisë për standardizim, përafrim dhe harmonizim ligjor të Kuvendit të Kosovës. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit vëren se Kuvendi ka themeluar Njësinë për Analiza Ligjore, e cila do të funksionojë në kuadër të Drejtorisë në fjalë, si dhe ka bërë rekrutimin e një pjese të stafit profesional që do ta përbëjnë këtë njësi. Avokati i Popullit e mirëpret themelimin dhe funksionalizimin e kësaj njësie dhe shpreson se kjo njësi do të ndikojë në përmirësimin e procesit legjislativ në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit vazhdon tërheqjen e vëmendjes se është e nevojshme që Qeveria të hartojë Planin e Përafrimit Ligjor, sipas të cilit Kuvendi i Republikës së Kosovës do ta monitoronte procesin e përafrimit të legjislacionit vendor me atë evropian. Në këtë drejtim, është e nevojshme që në këtë Plan, i cili monitorohet nga Komisioni Parlamentar për Integritim Evropian, të përfshihet edhe legjislacioni sekondar i miratuar nga Qeveria. Në mënyrë që Kuvendi të jetë sa më efikas në zbatimin e këtij plani, Avokati i Popullit konsideron se Qeveria dhe Kuvendi duhet të kenë një bashkëpunim të ngushtë, në funksion të hartimit dhe mbikëqyrjes së përafrimit të legjislacionit vendor me atë evropian.

Procesi i hartimit të ligjeve është përcjellë edhe me mungesën e konsistencës gjuhësore dhe terminologjike, si pasojë edhe e mungesës së terminologjisë unike juridike. Kjo dukuri ka shkaktuar vështirësi në zbatimin ligjeve përkatëse. Përkitazi me këtë, është e nevojshme që sa më shpejt të bëhet standardizimi i terminologjisë, nëpërmjet hartimit të fjalorit terminologjik juridik.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 81, amendamentet 2 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit ka vërejtur se njëra ndër vështirësitë e zbatimit të ligjeve rrjedh si shkak i metodës sipas të cilës ndryshohen dhe plotësohen ligjet. Në rastet e ndryshimit dhe plotësimit të ligjeve ekzistuese, pas miratimit nga Kuvendi, ato ndryshime nuk përfshihen në ligjin që është ndryshuar, por mbeten të ndara në formatin e një ligji. Një praktikë e tillë vetëm sa e vështirëson përdorimin e ligjeve, sepse kërkon përqendrim në dy apo më tepër ligje në vend se përqendrimi të jetë vetëm në ligjin bazik me ndryshimet e përfshira në të.

Avokati i Popullit e konsideron të nevojshme që me Ligjin për Aktet Juridike, në një kapitull të veçantë, të rregullohet procedura sipas së cilës, pas miratimit të ligjit, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit ekzistues, ato ndryshime dhe plotësime të përfshihen në ligjin bazik dhe të ekzistojë si një ligj i vetëm. Një rregullim i tillë do ta bënte me lehtë të qasshëm dhe me të përdorshëm legjislacionin që pëson ndryshime dhe plotësime.

Përkitazi me zbatimin e ligjeve, Avokati i Popullit ka vërejtur se, në sistemin tonë juridik, ndodhin shpesh raste ku një situatë faktike mbulohet nga dy a më shumë akte normative. Me qëllim të sqarimit se cilat akte normative kanë përparësi, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime nr. 441/2018 në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit i ka rekomanduar Gjykatës Supreme për të dhënë një Mendim Juridik për gjykatat e rregullta, përkitazi me interpretimin dhe zbatimin e akteve normative, në përputhje me tri parimet interpretuese: *lex specialis derogat legi generali*, *lex posterior derogat legi priori* dhe *lex superior derogat legi inferiori*. Gjithashtu, Avokati i Popullit i ka rekomanduar kryeministrit që të nxjerrë një akt administrativ, duke udhëzuar të gjitha institucionet dhe agjencitë qeveritare, që të interpretojnë dhe zbatojnë akte normative, në përputhje me tri parimet e lartpërmendura, si dhe t'i zbatojnë rregullat e propozuara në këtë Raport, për raste të konfliktit ndërmjet këtyre parimeve.

Avokati i Popullit e vlerëson si shumë të rëndësishëm procesin e kodifikimit të ligjeve. Përmes këtij procesi do të mundësohej përmbledhja (grumbullimi) e ligjeve, të cilat e rregullojnë fushën e njëjtë apo të përafërt në një dokument (Kod). Me fjalë të tjera, kodifikimi mundëson përmbledhjen e ligjeve nga lëmi i njëjtë, në një dokument të vetëm. Ky proces do të siguronte që i gjithë legjislacioni i një fushe apo i një resori të gjendet në një dokument dhe po ashtu do t'ia lehtësonte zbatuesve të ligjeve identifikimin dhe qasjen në ligjet e fushës së njëjtë. Lidhur me këtë çështje, viteve të kaluara, nëpërmjet opinioneve, IAP-ja i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që të fillojë me këtë proces.

Edhe pse Qeveria e Republikës së Kosovës, në Programin Legjislativ për vitin 2018, e ka paraparë që Kuvendit të Kosovës t'ia dërgojë Projekt Kodin Civil, më 29 nëntor 2018, një gjë e tillë nuk ka ndodhur gjatë vitit raportues. Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishëm përshpejtimin e procesit të hartimit nga Qeveria të Projekt Kodit Civil dhe dërgimin e tij në Kuvend.

Në Raportin Vjetor të vitit të kaluar, Avokati i Popullit kishte analizuar me vëmendje Rregulloren e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, duke konstatuar se është e nevojshme të bëhen ndryshime në dispozitën e cila rregullon punët e pambaruara (Neni 86 i Rregullores së Kuvendit). Sipas kësaj dispozite, në fund të mandatit të Kuvendit, ekziston detyrimi për të rinisur çdo punë nga e para. Një specifikim i tillë rrezikon t'i vonojë punët e Kuvendit, si dhe të pengojë mirëfunksionimin e institucioneve të tjera që janë në pritje të vendimeve të tij. Duke marrë parasysh këtë rrezik, detyrimi që Kuvendi t'i kthejë të gjitha punët në hapin e parë, në fillim të legjislaturës së re, do të mund të justifikohet vetëm nëse ka arsye të forta për një gjë të tillë. Lidhur me këtë, IAP-ja i pati adresuar rekomandime Kuvendit, për rregullimin e kësaj çështjeje, por nga informacionet që ka IAP-ja, merret vesh se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i ka marrë parasysh rekomandimet e IAP-së. Avokati i Popullit insiston se dispozita kontestuese në Rregulloren aktuale kërkon rishqyrtim dhe harmonizim në pajtim me frymën e rekomandimeve të adresuara nga Avokati i Popullit në vitin 2017.

Në funksion të përmbushjes së kompetencave kushtetuese dhe ligjore, në lidhje me rekomandimin për nxjerrjen e ligjeve të reja apo ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese apo akteve nënligjore, Avokati i Popullit ka publikuar raporte me rekomandime drejtuar institucioneve të Republikës së Kosovës si në vijim:

Avokati i Popullit, më 6 mars 2018, ka publikuar Raport me Rekomandime nr. 129/2018 dhe i ka rekomanduar Qeverisë së Republikës së Kosovës për:

- Ndërmarrjen e nismës legjislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, me të cilin do të përcaktoheshin mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Avokati i Popullit, më 30 gusht 2018, ka publikuar Raportin me Rekomandime nr. 687/2017 dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta bëjë:

- Ndryshimin/Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 106, paragrafi 4, i cili do të përcaktonte edhe publikimin e rezultateve përfundimtare të votave jashtë vendit;
- Ndryshimin/Plotësimin e Rregullës Zgjedhore 03/2013 neni 4, e cila do të përcaktonte vendndodhjen e kutive zgjedhore dhe rolin e zyrave konsullore/ambasadave në procesin zgjedhor.
- Ndryshimin/Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 96, të plotësohet ashtu që, përveç votimit me postë, të mundësohet edhe votimi fizik nëpërmjet zyrave konsullore apo ambasadave të shtetit përkatës në territorin e vendit të huaj.

Po ashtu, Avokati i Popullit, më 28 shtator 2018, ka publikuar Raport me Rekomandime nr. 441/2018 dhe ka rekomanduar që:

- Gjykata Supreme, në bazë të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, neni 22, par. 1, nënpar. 3 (“Gjykata Supreme (...) përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës”) të shpallë një mendim juridik duke udhëzuar që të gjitha gjykatat e rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë akte normative në përputhje me tri parimet interpretuese (*lex specialis derogat legi generali*, *lex posterior derogat legi priori* dhe *lex superior derogat legi inferiori*) dhe t’i zbatojnë rregullat e propozuara në këtë Raport për raste të konfliktit ndërmjet këtyre parimeve; dhe
- Kryeministri, në bazë të Kushtetutës, neni 94, par. 3 (“Kryeministri (...) siguron zbatimin e ligjeve”), ta nxjerrë një akt administrativ duke udhëzuar të gjitha institucionet dhe agjencitë qeveritare që të interpretojnë dhe zbatojnë akte normative në përputhje me tri parimet e lartpërmendura dhe t’i zbatojnë rregullat e propozuara në këtë Raportin nr. 441/2018, për raste të konfliktit ndërmjet këtyre parimeve.

Avokati i Popullit, më 5 tetor 2018, ka publikuar Raport me Rekomandime nr. 376/2018 dhe i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës që:

- Të ndryshojë Ligjin nr. 05/L-132 për Automjete, përkatësisht, ta fshijë nenin 43, par. 2 të tij;
- Të analizojë nëse Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, neni 30, par. 4 (“Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbarimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbarim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbarues në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbarimore”), po funksionon në atë mënyrë që po sigurohet, në nivel të mjaftueshëm, shlyerja e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor;
- Nëse neni 30, par. 4 i Ligjit për Kundërvajtje nuk është i mjaftueshëm, të shqyrtojë nëse ka një masë tjetër më pak të ashpër sesa neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete, me të cilën mund të arrihet qëllimi i shlyerjes së gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor.

Avokati i Popullit, më 29 nëntor 2018, ka publikuar Raport me Rekomandime nr. 445/2018 dhe i ka rekomanduar Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) që:

- Ta adresojë këtë çështje në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që Kuvendi, nëpërmjet legjislationit, të specifikojë afate për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore, duke specifikuar afatin maksimal që tolerohet nga inicimi i padisë e deri të vendimi i shkallës së parë, por edhe afatet e shqyrtimit në instancat tjera.
- Deri në nxjerrjen e një akti nga Kuvendi i Kosovës, KGJK-ja të nxjerrë një akt të brendshëm, i cili do t’i rregullonte afatet për kohëzgjatjen e një procedure

gjqësore, duke e specifikuar afatin maksimal që tolerohet nga inicimi i padisë e deri te vendimi i shkallës së parë, por edhe afatet e shqyrtimit në instancat e tjera.

- Në aktin e brendshëm gjithashtu të përcaktohet se rastet që kthehen në rigjykim duhet të trajtohen me prioritet në krahasim me paditë e reja.

Avokati i Popullit vlerëson se gjatë vitit 2018 ka pasur progres sa i përket propozimit dhe miratimit të ligjeve. Sidoqoftë, është e nevojshme që të punohet vazhdimisht jo vetëm në ngritjen kuantitative, por edhe në zhvillimin kualitativ të legjislacionit, në të gjitha nivelet e tij.

Sistemi gjyqësor

Pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Kosovës në shkurt të vitit 2008, si pjesë e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës ishin edhe gjyqtarët e EULEX-it, me funksione dhe kompetenca të përcaktuara sipas ligjeve/marrëveshjeve ndërkombëtare. Me ligjin²¹ e miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës ka përfunduar mbështetja ndërkombëtare nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë dhe sistemi gjyqësor i vendit është pavarësuar plotësisht me marrjen e përgjegjësive të rezervuara ligjore.

Bazuar në ligjin për përfundimin e mbështetjes ndërkombëtare, gjyqësorit i janë transferuar kompetencat dhe përgjegjësitë për luftimin e krimeve të rënda, si krimi i organizuar dhe luftimi i korrupsionit. Tani të gjitha hetimet penale dhe gjykimet do të kryhen nga gjykata me panele të përbëra nga gjyqtarët e Kosovës.

Po ashtu, ligji i ri për gjykatat²², ka fuqizuar Këshillin Gjyqësor të Kosovës, në fushën e menaxhimit dhe administrimit të gjyqësorit, pasi që ky ligj, në dispozitat kalimtare, ka shfuqizuar nenin 10 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.²³

Ky fuqizim i institucioneve të drejtësisë/gjyqësorit është si rezultat rritjes permanente të performancës së punës së gjyqësorit në aspektin e profesionalizmit të gjyqtarëve e prokurorëve në luftimin e të gjitha llojeve të krimit dhe ndarjen e drejtësisë. Ky përfundim i mirë i gjyqësorit ka marrë vlerësime pozitive edhe nga ana e misionit ndërkombëtar në fushën e sundimit të ligjit, i cili, që disa vite vazhdimisht e ka mbështetur gjyqësorin në ngritjen e kapaciteteve profesionale.

Plani strategjik i gjyqësorit 2014-2019²⁴, i cili ka përmbajtur objektiva të cilat kanë të bëjnë me përshejtimin e zgjidhjes së lëndëve gjyqësore, menaxhimin përkatës dhe

²¹ Ligji nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë, neni 2, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 21 / 29.6.2016.

²² Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 22, datë 18.12.2018.

²³ Ligji nr. 04/L-115 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës, neni 10.

²⁴ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Plani Strategjik i Gjyqësorit të Kosovës 2014-2019, faqe 14, 19, 22 dhe 26 www.kgjk-ks.org.

Ilogaridhënien, në mënyrë që sistemi gjyqësor të jetë sa më funksional dhe në shërbim të qytetarëve. Sipas raportit vjetor të punës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në fillim të vitit 2018²⁵, në sirtarët e gjykatave të vendit si lëndë të vjetra i kanë pasur 36.798 lëndë, ndërsa në vitin raportues janë zgjidhur 21.666 lëndë të vjetra, që lë të nënkuptohet për efektet pozitive të strategjisë në zvogëlimin e lëndëve të vjetra.

Sipas Këshillit Gjyqësor të Kosovës, si lëndë të vjetra trajtohen të gjitha lëndët, të cilat, nga data e paraqitjes së tyre kanë kaluar 24 muaj dhe nuk janë trajtuar nga ana e gjykatave.

Bazuar në numrin e ankesave të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit ndaj gjyqësorit, gjatë këtij viti raportues, nga analiza e përmbajtjes së tyre, konstatohet se një pjesë e qytetarëve ende kanë pakënaqësi në sistemin gjyqësor të vendit, për shkak se përballen me zvarritje të procedurave gjyqësore dhe për vendosjen e rasteve të tyre që presin me vite të tëra, mosekzekutim të vendimeve gjyqësore të plotfuqishme, vendime joefektive dhe dyshime në objektivitetin e gjykatësve në vendosjen e lëndëve të tyre.

Për Avokatin e Popullit është mjaft shqetësues fakti se, megjithatë qytetarët, për çfarëdo ankese lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore, e cila ka ndikuar në shkeljen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, nuk ka ndonjë mjet efektiv juridik karshi këtyre ankesave që si rezultat do të mund ta kishin pasur ndonjë lehtësim në formë të parandalimit të shkeljes apo në formë kompensimit.

Me qëllim të krijimit të një mekanizmi mbrojtës ligjor të të drejtave të qytetarëve në raport me gjyqësorin, Avokati i Popullit i ka rekomanduar²⁶ Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë: *“për ndërmarren e nismës legislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, me të cilin do të përcaktoheshin mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.”*

Avokati i Popullit vëren në vendimet e gjykatave, gjyqtarët në raste të pakta i referohen praktikës së GjEDNj-së dhe, në ato raste kur kjo ndodh, ato janë të përgjithësuara dhe jokonkrete në raport me rrethanat e rastit në praktikë. Vlen të ritheksohet që, sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës²⁷, të drejtat e njeriut interpretohen në pajtim me praktikën e GjEDNj-së.

Avokati i Popullit, sa i përket mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut, në lëmin e gjyqësorit, ka mandat të limituar dhe është i përcaktuar me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për

²⁵ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti vjetor i punës 2017, faqe 36.

²⁶ Ex officio nr. 129/2019 Raport me rekomandime për Qeverinë e Republikës Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë.

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste dhe në procedura ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me pretendimet për administrimin e drejtësisë, përkatësisht të zvarritjeve të procedurave gjyqësore në vendosjen e parashtrësave dhe zvarritjeve në ekzekutimin e vendimeve gjyqësore.²⁸

Zvarritja e procedurave gjyqësore

Për Avokatin e Popullit po ashtu mbetet shqetësues edhe, në këtë vit raportues, numri i lartë i paraqitjes së ankesave të qytetarëve kundër gjykatave që kryesisht kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore në vendosjen e rasteve të tyre.

Ankesat kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave lidhur me kontestet e natyrës civile, penale, administrative, pronësore, familjare, të detyrimeve, të punës, sociale²⁹, por shumica e lëndëve të zvarritura janë konteste pronësore. Zvarritjet janë si pasojë e numrit të lartë të rasteve të vjetra, të cilat, përkundër zvogëlimit të tyre, ende nuk janë zgjidhur tërësisht dhe paraqitja e rasteve të reja në gjykata.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës në raportin statistikor të gjykatave të tremujorit të II-të të vitit 2018 ka raportuar se numri i lëndëve të ngelura si të pazgjidhura është 264193.³⁰ Sipas këtij, raporti gjykatat kanë pasur në punë gjithsej 306829 lëndë gjyqësore, ndërsa kanë zgjidhur 42615, kurse në këtë periudhë qytetarët kanë parashtruar 27597 lëndë të reja gjyqësore.

Avokati i Popullit vëren se, kur bëhet fjalë për zvarritje procedurale, sidomos në lëndët që kalojnë nga një instancë në instancën tjetër, përgjatë procesit të shqyrtimit apo në situata kur rastet kthehen në rigjykim, gjykatat kanë tendencë që periudhën e vendosjes së rastit ta llogarisin prej ditës kur rasti i është kaluar asaj gjykate, ndërsa sipas praktikës së GjEDNj-së, periudha e llogaritjes për zgjidhjen e një rasti gjyqësor fillon prej ditës kur qytetarët e kanë paraqitur padinë në gjykatën kompetente.

Andaj, me qëllim të eliminimit të shkeljeve në të ardhmen, Avokati i Popullit i ka paraqitur Raport me Rekomandim³¹, me qëllim të rregullimit ligjor të çështjes lidhur me regjistrimin me numër të ri të lëndëve, të cilat kthehen në rigjykim nga gjykata më e lartë.

²⁸ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16.

²⁹ A.nr.185/2016 Raport me rekomandime, A.nr.716/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.462/2015 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.796/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.794/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.463/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.492/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën Themelore në Prishtinë, A.nr.388/2014 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.362/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.561/2015 Raport me rekomandime për Gjykatën Themelore në Prishtinë, A.nr.648/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.721/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.357/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën Themelore në Prishtinë, A.nr.705/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.55/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.375/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.473/2016 Raport me rekomandime për Gjykatën Themelore në Prishtinë, Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.722/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën Themelore në Prishtinë, A.nr.235/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit.

³⁰ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti statistikor i gjykatave, TREM II-të 2018, faqe 3.

³¹ A.nr.445/2018 Raport me rekomandime për Këshillin Gjyqësor të Kosovës.

E po ashtu nëpërmjet legjislacionit, të specifikojë afate për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore, duke specifikuar afatin maksimal që tolerohet nga inicimi i padisë e deri te vendimi i shkallës së parë, por edhe afatet e shqyrtimit në instancat tjera.

Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se gjykatat nuk trajtojnë me urgjencë kontestet nga marrëdhënia e punës³² ashtu sikur që kërkohet me Ligjin për procedurën kontestimore³³.

Se gjykatat vazhdojnë të ballafaqohen me numër të konsiderueshëm të lëndëve të vjetra që vazhdojnë të mbesin ende të pazgjidhura, si dhe numri i përgjithshëm i lëndëve civile, përveç që nuk është reduktuar, është vazhdimisht në rritje. Si rezultat i numrit të madh të lëndëve civile nëpër gjykata themelore, qytetarët detyrohen të presin periudha të gjata për t’iu shqyrtuar e finalizuar lënda

Situatës së rëndë lidhur me procedurat e stërzgjatura nëpër gjykata i kontribuon edhe mungesa e një mekanizmi të brendshëm ligjor, nëpërmes të cilit qytetarët të cilëve u është shkelur e drejta në një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, do të mund të kërkonin kompensim për shkak të shkeljes së kësaj të drejte.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar gjithsej 35 ankesa kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK). Ankesat kanë të bëjnë me zvarritjet procedurale në trajtimin e lëndëve nga DhPGjSK-ja. Më 31 janar 2017, Avokati i Popullit kishte përcjellë tek autoritetet përgjegjëse *Raportin me rekomandime Ex officio nr.44/2017* lidhur me shkeljet e të drejtave të njeriut të shkaktuara nga zvarritjet procedurale. Në Raport konstatohet se grumbullimi i lëndëve për DhPGjSK-në është rezultat i numrit të kufizuar me ligj të gjyqtarëve, zëvendësimit të shpeshtë të gjyqtarëve, në veçanti gjyqtarëve ndërkombëtarë dhe mungesës së këshilltarëve ligjorë dhe përkthyesve.

Avokati i Popullit kishte kërkuar ndërmarrje të masave nga autoritetet përkatëse të Republikës së Kosovës, konkretisht ndryshimin e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përkatësisht i dispozitës ligjore që kufizon numrin e gjyqtarëve në DhPGjSK, si një masë urgjente në rritjen e efikasitetit të DhPGjSK-së.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 12 korrik 2018, ka miratuar në parim Projektligjin nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme, i cili në nenin 4 [Përbërja, organizimi dhe emërimi] e heq kufizimin në numrin e gjyqtarëve, i cili do të hapë rrugë për rritjen e numrit të gjyqtarëve. Sidoqoftë, në qershor të vitit 2018, ka përfunduar mandati i gjyqtarëve të EULEX-it, që si pasojë ka pasur zvogëlimin akoma më të madh të numrit të gjyqtarëve, në ndërkohë që Kuvendi, që nga 12 korriku 2018, nuk ka marrë veprime të mëtutjeshme në miratimin e Projektligjit për Dhomën e Posaçme. Kjo ka shkaktuar që shkeljet e

³² A.nr.410/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.206/2017 Raport me rekomandime për Gjykatën e Apelit, A.nr.31/2018 – Rexhepi - Gjykata e Apelit, A.nr. 520/2018 – Behrami - Gjykata e Apelit

³³ Ligji nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore, neni 475.

identifikuara në *Raportin Ex officio nr. 44/2017* të vazhdojnë edhe gjatë këtij viti raportues duke shtuar këtu edhe rastet të cilat Avokati i Popullit i ka pranuar gjatë periudhës raportuese.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore

Në këtë vit raportues, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa ndaj gjyqësorit lidhur me zvarritjet në ekzekutimin, e në disa raste edhe për mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë edhe nga ana e autoriteteve shtetërore.

Në disa raste të hetimit të ankesave është vërejtur se organet shtetërore nuk i kanë ekzekutuar vendimet e plotfuqishme gjyqësore dhe se qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre sipas vendimeve gjyqësore, është dashur të vazhdojnë me procedurën e ekzekutimit në gjykata, sidomos me rastet e pensionimit të punëtorëve arsimorë dhe shëndetësorë, për shkak të mospagesës së tri pagave përcjellëse të pensionimit dhe pagës jubilarë.

Kjo ka ndikuar në krijimin e shpenzimeve materiale, humbje kohe, si nga ana e gjyqësorit, të qytetarëve dhe të vetë institucioneve shtetërore, përkundër ekzistimit të rregullativës ligjore të qartë dhe praktikës së rasteve të krijuara nga gjykata³⁴.

Për Avokatin e Popullit mbetet shqetësuese shkalla e ulët ekzekutimit të vendimeve gjyqësore në nivel vendi, që vërehet edhe sipas Raportit statistikor të gjykatave për tremujorin e II-të të vitit 2018 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës,³⁵ sa i përket lëndëve civile, tregon se gjykatat kanë pasur në punë 3696 lëndë, prej të cilave i kanë ekzekutuar 892, ndërsa 2804 kanë mbetur pa u ekzekutuar.

Me këtë rast, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen e autoriteteve përkatëse se, sipas KEDNj-së dhe praktikës së GjEDNj-së, ekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme është pjesë e së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm e që obligon ato për ndërmarrjen e masave të domosdoshme për realizimin e kësaj të drejte.

Përmbauesit privat

Të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e që në vete ngërthen edhe çështjen e vendimeve të formës së prerë në procedurën administrative dhe gjyqësore, përmbauesit privat e kanë fuqizuar, duke e përmirësuar nivelin e ekzekutimit të vendimeve administrative dhe gjyqësore³⁶ dhe qytetarëve u është ofruar mundësi më efikase dhe efektive në realizimin e të drejtave të tyre. Por në disa raste përmbauesit privat i kanë tejkaluar normat ligjore, të cilat i përcaktojnë kufizimet dhe përjashtimet lidhur me

³⁴ A.nr.132/2018 kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë.

³⁵ Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Raporti statistikor i gjykatave, TREM II-të 2018, faqe,38 www.kgjk-ks.org.

³⁶ Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaimore, neni 22, dokumenti përmbaues.

ekzekutimin e vendimeve³⁷, duke lëshuar urdhra përmbartimorë për ekzekutimin e vendimeve në bankat komerciale, me ç' rast kanë bllokuar llogaritë bankare të ankuesve.

Avokati i Popullit gjatë hetimit ka vërejtur se palëve u janë bllokuar llogaritë bankare tek bankat nga Përmbartuesi privat, për shkak të mos shlyerjes së borxheve, ndërsa kanë qenë shfrytëzues të pensioneve dhe këto të hyra janë bllokuar në procesin e ekzekutimit në kundërshtim me ligjin, ku përcaktohen kufizimet ligjore për shumatat të cilat nuk mund të jenë objekt i ekzekutimit³⁸. Pas ndërmjetësimit të Avokatit të Popullit me përmbartuesin/bankën private, për riprogramimin e borxhit, është arritur zgjidhja e çështjeve të ankuesve që llogaritë bankare e tyre të zhblokohet dhe ndalesat të behën në pajtim me ligjin.

Në rastin e një ankese të paraqitur ndaj Përmbartuesit privat, lidhur me mosekzekutimin e vendimit gjyqësor lidhur me pronën/trashëgiminë³⁹, kemi konstatuar se, përkundër veprimeve ekzekutive nga përmbartuesi, komuna nuk ka vepruar sipas urdhrat përmbartimor dhe vetëm pasi përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë kontaktuar me autoritetet komunale rasti është zgjidhur sipas kërkesës së palës.

Në ankesën e paraqitur lidhur me bllokimin e llogarisë bankare nga Përmbartuesi privat, dhe se iu pamundësuar marrja e pensionit bazik të moshës në shumën prej 75 Euro⁴⁰, se ndalesa është në kundërshtim me ligjin, këshilltari ligjor i Avokatit të Popullit, përkundër kërkesës për takim me Përmbartuesin privat, ende nuk ka mundur t'i verifikojnë faktet e rastit për shkak të zvarritjes së vazhdueshëm nga Përmbartuesi privat.

Në disa raste të ankesave të rasteve sociale ndaj Përmbartuesve privat lidhur me bllokimin e llogarive, për shkak të borxheve ndaj kompanisë publike të energjisë elektrike, pas ndërmjetësimit të rastit nga përfaqësuesi i Avokatit të Popullit me kompaninë, është arritur zgjidhje e rastit sipas kërkesës së palës.⁴¹

Po ashtu, në disa raste të ankesave kundër Përmbartuesve privat për zvarritje dhe mosekzekutim të vendimeve gjyqësore, është vërejtur se, përkundër veprimeve të ndërmarra ekzekutive, ato nuk kanë mundur që të ekzekutohen nga përmbartuesit, për shkak se aktvendimi për ekzekutim i gjykatës ka përmbajtur gabime në formulim dhe kjo e ka pamundësuar ekzekutimin⁴².

Por në shumë raste qytetarët i janë drejtuar Avokatit të Popullit me kërkesë për t'u këshilluar lidhur me urdhrat përmbartimorë të Përmbartuesit privat dhe në këto raste palët janë këshilluar për mundësinë ligjore/për të drejtën në shfrytëzimit të mjeteve juridike.

Por në të gjitha rastet e hetuara ka pasur shkelje të Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, neni 112, lidhur me kufizimet e përmbartimit, Avokati i Popullit u ka

³⁷ Ligji nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, neni 111, Përtjashtimi nga përmbartimi dhe neni 112 Kufizimi i përmbartimit.

³⁸ A. nr.437/2018 Gashi kundër Përmbartuesit privat në Prishtinë dhe bankës private TEB.

³⁹ A.nr.347/2018 Loshaj kundër Përmbartuesit privat.

⁴⁰ A.nr.460/2018 Mehani kundër Përmbartuesit privat.

⁴¹ A. nr.860/2018 Haxhija kundër Përmbartuesit privat në Pejë.

⁴² A. nr.714/2018 Nikqi kundër Përmbartuesit privat në Pejë.

rekomanduar përmbauesve që t'i ndryshojnë urdhrat përmbauesve në përputhje me ligjin, e të cilat janë zbatuar nga ana e tyre.

Përfaqësimi ligjor i qytetarëve

Në shumë raste qytetarët e vendit, bazuar në besimin të cilin e kanë ndaj institucionit, i janë drejtuar Avokatit të Popullit me kërkesë për hartimin e parashtrësve të ndryshme si në çështjet administrative, gjyqësore, për përfaqësimin e tyre në gjykatë, por në disa raste kanë kërkuar interpretimin e vendimeve gjyqësore, por edhe të këshillimit lidhur me rastet e tyre.

Një numër i konsiderueshëm i kërkesave kanë pasur të bëjnë me hartimin e parashtrësve të tyre në çështjet administrative, lidhur me çështjet e refuzimit të pensioneve të kategorive të ndryshme e deri në iniciimin e rasteve në gjykatë⁴³.

Në disa raste të ankesave, qytetarët kanë kërkuar që Avokati i Popullit t'i përfaqësojë ata në procedurat gjyqësore në lëndët e tyre që i kanë pasur, si: çështjet civile, penale⁴⁴, si dhe në çështjet/lëndët tek Përmbauesit privat.

Në të gjitha rastet e kërkesave të paraqitura, qytetarët janë njoftuar me kufizimet ligjore në mandatin e Avokatit të Popullit të përcaktuar me ligj⁴⁵, dhe palët janë udhëzuar të paraqiten tek Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, si një autoritet publik e ligjor për marrjen e shërbimeve të tyre.

Për shkak të dyshimeve në objektivitetin e trajtimit të lëndëve nga gjykata, qytetarët i kanë paraqitur kërkesë Avokatit të Popullit, që rastet e tyre të monitorohen nga ana e përfaqësuesit të tij, si në kontestet penale e po ashtu edhe në ato civile⁴⁶. Pasi që numri i kërkesave ka qenë mjaft i lartë, Avokati i Popullit vetëm në rastet e ndjeshme dhe sipas vlerësimit të natyrës së rastit i ka monitoruar seancat gjyqësore⁴⁷.

Ndihma juridike falas është kategori kushtetuese dhe u mundësohet qytetarëve që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare dhe nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi.

Por si sfidë për ofrimin e ndihmës juridike falas në raport me kërkesat e qytetarëve mbetet mungesa e mjeteve buxhetore, gjë që pamundëson ofrimin e ndihmës juridike për qytetarët në tërë territorin e Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për ndihmë juridike falas.

⁴³ A.Dullovi.S kundër Ministrisë së Punës dhe Mirëqenës Sociale (MPMS)A.,Galica.B kundër Departamentit të Pensioneve MPMS, A. Zeqiri A. kundër Departamentit MPMS.

⁴⁴ A.nr. Zenuni kundër Përmbauesit privat, A. Ramadani kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, A.Halitaj kundër Gjykatës Themelore në Pejë

⁴⁵ Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16.

⁴⁶ A.nr. Muli, Gjykata Themelore në Prishtinë, A.nr. Shabani, Gjykata Themelore në Gjilan, A.nr. Toska, Gjykata Themelore Pejë, A.nr.Bilalli, Gjykata Themelore në Prishtinë, A.nr. Veseli, Gjykata Themelore në Ferizaj.

⁴⁷ A.153/2018 Thaqi kundër Gjykatës Themelore në Prizren, A.593/2018 – Krasniqi, Gjykata Themelore në Prishtinë.

Në disa raste, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa të qytetarëve që kanë të bëjnë me mos përfaqësimin adekuat të tyre nga avokatët mbrojtës, të mosdhënies së shkresave të lëndës, të kërkesave financiare për mbrojtje jashtë tarifës së përcaktuar të Odës së Avokatëve të Kosovës (OEK)⁴⁸. Kjo e pengon realizimin e plotë të së drejtës për mbrojtje të të drejtave të njeriut në procedurat gjyqësore. Në disa raste, ankuesit kanë paraqitur edhe kërkesa për t'u këshilluar lidhur me adresimin e shqetësimeve të tyre në raport me avokatët e tyre mbrojtës, përkitazi me pretendimet për mos përfaqësim dinjitoz, mashtrim⁴⁹.

Në të gjitha këto raste, ankuesit janë njoftuar me të drejtën e tyre për ndërrimin e avokatëve, duke tërhequr autorizimin për përfaqësim si dhe për mundësinë e paraqitjes së ankesave në OAK.

OAK-ja ka një kornizë normative lidhur me standardet e punës dhe Kodin e Etikës për sjelljet e avokatëve, por ajo nuk ka arritur që të vendosë një sistem, i cili në mënyrë efikase do ta mbikëqyrë dhe do ta përcjell respektimin e këtyre standardeve.

Implementimi i rekomandimit të Avokatit të Popullit për krijimin e mekanizmit ligjor për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve

Avokati i Popullit, sa i përket mbrojtjes gjyqësore të të drejtave të qytetarëve, njëherësh rithekson kërkesën për zbatimin e rekomandimit⁵⁰ nga Qeveria e Republikës Kosovës dhe nga Ministria e Drejtësisë, për nevojën e krijimit të një mekanizmi ligjor të brendshëm, në kuptim të nenit 13 të KEDNj-së, i cili qytetarëve do t'ua garantonte të drejtën në mjete efektive juridike në rastet e shkeljes të së drejtës në zgjidhjen e rasteve të tyre brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe mosekzekutimin e vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, të drejta këto të përcaktuara me nenin 6 të KEDNj-së dhe të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Pushteti ekzekutiv

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), si mekanizëm i kontrollit, ka rol të rëndësishëm në forcimin e përgjegjshmërisë së administratës shtetërore. Gjithashtu mund të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë së administrimit nga zbulimi i rasteve të "keqadministrimit" deri te ngritja e vetëdijes së nëpunësve civilë, në pritjet e publikut, në lidhje me qeverisjen e mirë dhe miradministrimin. Kjo ndikon që sistemi administrativ të jetë më transparent dhe më i qasshëm për të gjithë qytetarët. Qeverisja e mirë, miradministrimi dhe të drejtat e njeriut gërshetohen në atë mënyrë që paraqiten të pandashme dhe fuqizojnë njëra-tjetrën. Të drejtat e njeriut duhet ta udhëheqin punën e organeve më të larta shtetërore dhe të ndikojnë në cilësinë e ligjeve, të politikave dhe të mjeteve tjera për rritjen e cilësisë së jetës.

⁴⁸ A.Regjepi.T. kundër avokatit mbrojtës, Oda Avokatëve të Kosovës, A. Smajli A. kundër avokatit mbrojtës, Oda Avokatëve të Kosovës A., Bublaku A. kundër avokatit mbrojtës, Oda Avokatëve të Kosovës.

⁴⁹ Sahiti kundër avokatit mbrojtës, Oda Avokatëve të Kosovës.

⁵⁰ Ex officio.nr.129/2019, Raport me rekomandime për Qeverinë e Republikës Kosovës dhe Ministrinë e Drejtësisë.

Këto të drejta nuk do të mund të respektoheshin pa organizimin e mirë të administratës, të përgatitur për respektimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe krijimit të mundësisë së ushtrimit të këtyre të drejtave.

Administrata publike përcakton tërësinë e aktiviteteve të kryera dhe të atyre që duhet të kryhen në atë mënyrë që t'u përgjigjen nevojave dhe interesit të përgjithshëm të qytetarëve. Së këndejmi, miradministrimi lidhet ngushtë me të drejtat dhe me liritë e njeriut dhe tashmë pranohet gjerësisht si standard i qeverisjes demokratike.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, marrëveshjet dhe instrumentet tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, kanë prioritet në aplikimin e tyre para legjislacionit vendor.

Avokati i Popullit, gjatë vitit raportues, ka pranuar gjithsej 529 ankesa kundër autoriteteve qeveritare, në nivel qendror dhe lokal, prej të cilave 229 janë hapur për hetim. Ndërkaq, 325 ankesa janë pranuar kundër komunave, prej të cilave 156 janë hapur për hetim. Shumica e ankesave kanë të bëjnë me mosreagimin e duhur të autoriteteve në kërkesat e qytetarëve, që përfshijnë mospërgjigje ndaj kërkesave dhe zvarritje në trajtimin e çështjeve të ngritura. Një numër i konsiderueshëm i ankesave kanë të bëjnë me refuzimin apo mostrajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike.

Përveç mos reagimit në kërkesat e qytetarëve, autoritetet përkatëse ekzekutive kanë përgjegjshmëri të ulët ndaj kërkesave dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet përkatëse kap 36%. Duhet rikujtuar se autoritetet publike kanë obligim kushtetues dhe ligjor për t'u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, me qëllim që të kontribuojë në ngritjen e etikës së punës së administratës dhe ngritjen e kulturës administrative në përgjithësi, e po ashtu me qëllim të informimit sa më të mirë të qytetarëve, gjatë vitit raportues ka lansuar një përmbledhje të quajtur "Parimet e Miradministrimit-Përmbledhje nga Avokati i Popullit". Kjo përmbledhje përmban dispozitat e ligjeve në fuqi, të cilat duhet të zbatohen nga organet e administratës me rastin e trajtimit të kërkesave të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Një çështje mjaft problematike, që përcjellë punën e organeve ekzekutive, ka të bëjë me kushtëzimet që u bëhen qytetarëve nga ana e ekzekutivit, qoftë në nivelin lokal, ashtu edhe në nivelin qendror të qeverisjes. Këto kushtëzime, kohëve të fundit, pa të drejtë, praktikohen edhe nga ndërmarrjet publike komunale.

Si rast konkret duhet ta përmendim kushtëzimin e qytetarëve për ta paguar tatimin në pronë në mënyrë që ata të mund ta regjistrojnë automjetet e tyre. Pastaj, rasti tjetër ka të bëjë me inkasimin e gjobave për kundërvajtje, të cilat duhet të paguhen nga qytetarët, me rastin e regjistrimit të veturës. Avokati i Popullit konsideron se rastet e detyrimit të inkasimit të dhunshëm, qoftë të tatimit në pronë, qoftë të gjobave për kundërvajtjeve, si

dhe obligimeve ndaj ndërmarrjeve publike komunale, do të duhej t'i nënshtroreshin një procesi gjyqësor, me vullnetin dhe kërkesën e palëve të afektuara.

Kushtëzimet në forma të ndryshme për të arritur te një inkasim i shpejtë, jo vetëm që paraqesin tendencë të anashkalimit të organeve të sistemit të drejtësisë, por nuk përkojnë as me vlerat kushtetuese të vendit.

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)

Avokati i Popullit ka vazhduar të pranojë ankesa kundër AKP-së. Gjatë vitit raportues kanë qenë gjithsej 30 ankesa, prej të cilave 16 janë hapur për hetim. Natyra e ankesave nuk dallon nga vitet e mëparshme, që do të thotë se kanë të bëjnë me situatat kur AKP-ja me vendim ua njeh të drejtën për 20% nga vlera e privatizimit punëtorëve të ndërmarrjeve shoqërore apo të drejtën në kompensim të pagave dhe kontributeve të papaguara me rastin e likuidimit të ndërmarrjeve shoqërore. Këto vendime nuk zbatohen shpejt për shkak se i nënshtrohen një procesi gjyqësor pranë DhPGJSK-së. Prosesi gjyqësor pranë DhPGJSK-së mund të mos jetë drejtpërdrejt në lidhje me vendimet individuale, por çfarëdo ankesë që ka të bëjë me privatizimin apo likuidimin e ndërmarrjes shoqërore të caktuar, drejtuar në DhPGJSK, pezullon zbatimin e vendimeve të lëshuara nga AKP-ja. Prandaj, procesi i shpërndarjes së mjeteve mbetet peng i përfundimit të proceseve që janë në shqyrtim pranë DhPGJSK-së. Kuptohet se kjo është procedurë e përcaktuar me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, por lidhur me këtë procedurë, ish-punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore, të cilëve u është njohur ndonjëra nga të drejtat, nuk njoftohen në mënyrë të duhur, që nënkupton se vendimet për njohjen e së drejtës nuk përmbajnë informata se mjetet nuk mund të shpërndahen deri në privatizimin apo likuidimin final të ndërmarrjes shoqërore, e cila përcaktohet me vendim të plotfuqishëm të DhPGJSK-së. Në mungesë të informatave dhe pasigurisë që krijohet rreth faktit se kur do të zbatohen vendimet për kompensim, palët shumë shpesh i drejtohen IAP-së me ankesa për moszbatimin e vendimeve të AKP-së.

Avokati i Popullit ka marrë informata nga AKP-ja se numri i përgjithshëm i përfituesve nga 20% i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore është 47 480. AKP-ja ka njoftuar se në DhPGJSK gjenden në shqyrtim proceset e privatizimit të diku rreth 80-90 ndërmarrjeve shoqërore dhe se numri aktual i përfituesve pritet të rritet. Për më shumë, janë edhe disa ndërmarrje shoqërore, prej të cilave disa me rreth 500 punëtorë, që do t'i nënshtrohen procesit të privatizimit dhe që do të ketë ndikim në shtimin edhe më të madh të numrit të përfituesve.

Sa i përket procedurave të likuidimit dhe vendimeve për të drejtën në kompensim të pagave dhe kontributeve të papaguara, AKP-ja ka njoftuar se Autoriteti i Likuidimit i AKP-së deri më tani ka marrë 91 031 vendime. Natyra e këtyre vendimeve është e ndryshme: 1. vendime me të cilat aprovet kërkesa për kompensim; 2. vendime me të cilat pjesërisht aprovet kërkesa për kompensim; dhe 3. vendime me të cilat refuzohet kërkesa për kompensim. AKP-ja ka njoftuar se një ndarje e saktë e numrit të kërkesave

është e pamundur të paraqitet nga AKP-ja, për faktin se AKP-ja nuk është e informuar për numrin e saktë të ankesave që paraqiten në DhPGjSK.

IAP-ja vlerëson se AKP-ja është një ndër autoritetet më bashkëpunuese me Avokatin e Popullit.

Sidoqoftë, Avokati i Popullit konsideron se problemi kryesor që e ka përcjellë punën e AKP-së është mungesa e informatave nga ana e qytetarëve, të përfshirë në proceset pranë AKP-së, në veçanti mosinformimi i palëve me rastin e lëshimit të vendimeve për njohje të së drejtës në kompensim. Së këndejmi, është e nevojshme të njoftohen palët se shpërndarja e mjeteve do të bëhet pasi që i gjithë procesi i privatizimit apo i likuidimit të ndërmarrjes shoqërore të përfundojë me vendime përfundimtare, të lëshuara nga DhPGjSK-ja. Kjo për shkak se vonesat në shpërndarjen e mjeteve shkaktohen për shkak të zvarritjeve të jashtëzakonshme në trajtimin e rasteve nga DhPGjSK-ja, për të cilën Avokati i Popullit ka ngritur shqetësimet e tij vazhdimisht.

Shpronësimet e pronave të paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore

Gjatë vitit 2018, Avokati i Popullit ka hetuar një rast në bazë të një anekese individuale, e që ka të bëjë me shpronësimin e pronave të paluajtshme të ish-N.SH. Kooperativa Bujqësore “Liria” në Bardhosh, me qëllim të ndërtimit të Autostradës Vermicë-Merdare.

Ankesa e paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit ngrit çështjen e kompensimit nga shpronësimi i tokave të KB “Liria” në Bardhosh. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka pasur komunikim fillimisht me AKP-në, si menaxhuese e pronave të ndërmarrjes shoqërore, e pastaj edhe me Qeverinë e Republikës së Kosovës si organ shpronësues.

AKP-ja ka shprehur qëndrimin se, në pajtim me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, punëtorët kanë të drejtë në 20% nga mjetet e realizuara nga shpronësimi i pronës së ndërmarrjeve shoqërore. AKP-ja ka insistuar që Qeveria ta bëjë kompensimin për pronën e shpronësuar, por nuk ka pranuar asnjë pagesë në emër të kompensimit për shpronësimin e tokave të KB “Liria” në Bardhosh.

Përkundër pohimeve të AKP-së se nuk ka pranuar kompensim për shpronësimin në fjalë, Avokati i Popullit ka marrë përgjigjen e Zyrës së Kryeministrit (ZKM) se pronat e paluajtshme të N.SH. Kooperativa Bujqësore “Liria” janë shpronësuar sipas Vendimit Përfundimtar Nr. 03/100, i datës 12.11.2012, për nevoja të ndërtimit të Autostradës Vermicë-Merdare, Sektori 9. Më tej në përgjigjen e ZKM-së thuhet se Departamenti i Shpronësimit, më 24 qershor 2014, nëpërmes shkresës me numër protokollit 3358/14, e ka njoftuar AKP-në se parcelat nr. 308-0, 304-2, 383-0, 384-0, 382-0, 381-5, 386-3, 386-4, ZK Bardhosh, janë kompensuar sipas Vendimit Përfundimtar Nr. 03/100, i datës 12 nëntor 2014.

Ky rast vazhdon të jetë i hapur në IAP dhe mbetet të përmbillet pasi të përmbillet në tërësi hetimi lidhur me rastin.

Kushtëzimi i regjistrimit të automjeteve

Sa i përket kushtëzimit nga ana e komunave me rastin regjistrimit të automjeteve me pagesën e tatimit në pronë, Avokati i Popullit vëren se, më 1 tetor 2018, ka hyrë në fuqi Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili me neni 29 [Pezullimi i shërbimeve komunale] përcakton se nëse debitori nuk i paguan detyrimet tatimore të papaguara në datën e përcaktuar për pagesë, Komuna, brenda tri (3) ditëve pune pas përfundimit të afatit për pagesë, pezullon shërbime të caktuara komunale për atë debitor, deri në pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara.

Për dallim nga Ligji nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili ka qenë në fuqi deri më 1 tetor 2018, i cili nuk ka përcaktuar pezullimin e shërbimeve komunale, por kushtëzimet i ka vënë në praktikë nëpërmes udhëzimeve administrative, ligji në fuqi përmban dispozita me të cilat komunave u lejohet pezullimi i shërbimeve komunale, që ka gjasa të jetë një formë e kushtëzimit, për të ardhur deri te inkasimi i shpejtë.

Përkitazi me ankesa të kësaj natyre, Avokati i Popullit pati publikuar Raportin me Rekomandime nr. 347/2015, me të cilin ka kërkuar nga Ministria e Financave dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme shfuqizimin e dispozitave të caktuara në dy Udhëzime Administrative, në të cilat bazoheshin komunat kur i kushtëzonin qytetarët. Në po të njëjtin Raport, Avokati i Popullit pati kërkuar nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ta ndryshojë qëndrimin e saj zyrtar të shprehur në Shkresën shpjeguese të datës 20 qershor 2012, drejtuar kryetarëve të komunave të Republikës së Kosovës dhe kryesuesit e kuvendeve komunale dhe të nxjerrë një qëndrim të ri me konstatimin se kushtëzimet për ofrimin e shërbimeve të qytetarëve nga ana e komunave me pagesën e tatimit në pronë nuk kanë bazë ligjore dhe janë në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe, si të tilla, nuk mund të aplikohen.

Rekomandimet e dala nga Raporti nr. 347/2015 jo vetëm që nuk janë zbatuar nga autoritetet përgjegjëse, por, për më tepër, Ligji nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, i cili ka hyrë në fuqi në tetor 2018, parasheh dispozita të kundërta me rekomandimet në fjalë.

Për më keq, është vërejtur se përpos kushtëzimit me pagesën e tatimit në pronë, qytetarët vazhdojnë të kushtëzohen edhe për pagesën e borxheve ndaj Ndërmarrjeve Publike Komunale, që po ashtu paraqet shkelje më vete.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka nxjerrë një Raport *Ex officio* Nr. 376/2018, lidhur me kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete. Avokati i Popullit, në bazë të vlerësimit të rrethanave, ka konstatuar se Ligji nr. 05/L-132 për Automjete, neni 43, paragrafi 2 (“Pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor”), paraqet shkelje të së drejtës së pronës, të garantuar me nenin 46, paragrafi 1 të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës (“E drejta e pronës është e garantuar”). Raporti i është drejtuar Kuvendit dhe Qeverisë dhe se Avokati i Popullit ka pranuar informata se ligji është në procedurën e ndryshimi në pajtim me rekomandimet e Avokatit të Popullit.

Sa i përket kushtëzimeve në përgjithësi, Avokati i Popullit vëren një tendencë të pushtetit ekzekutiv në ndërhyrjen e pushteteve tjera, në këtë rast gjyqësorit ose organeve të sistemit të drejtësisë në vend. Kjo për shkak se pushteti ekzekutiv, duke vënë në funksion kushtëzimet, përdorë rrugët e shkurtra për të ardhur deri te inkasimi. Avokati i Popullit konsideron se kjo bie ndesh me rendin juridik në vend, përkatësisht ndarjen e pushteteve dhe se veprime të tilla prekin të drejtat dhe liritë themelore të qytetarëve.

Pezullimi i veprimtarisë së OJQ-ve nga Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve

Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga disa OJQ për pezullimin e veprimtarisë së tyre nga Departamenti për Regjistrimin e OJQ-ve i Ministrisë së Administratës Publike.

Kushtetuta e vendit, në nenin 44, paragrafi 1 e garanton Lirinë e asociimit, e cila më tej rregullohet me Ligjin nr.04/L-57 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-qeveritare. Ky Ligj nuk parashih mundësinë e pezullimit të veprimtarive të OJQ-ve, por pezullimi i veprimtarisë së një OJQ-je përcaktohet me një akt nënligjor, përkatësisht me Udhëzimin Administrativ nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare (nenin 18, paragrafi 1). Sipas UA 02/2014, Departamenti kompetent i Ministrisë së Administratës Publike mund ta pezullojë veprimtarinë e OJQ-së, me kërkesë të institucioneve të autorizuara të sigurisë. Lidhur me këtë, në qoftë se nisemi nga praktika e GjEDNj-së, vlen parimi i ligjshmërisë, sipas të cilit kufizimi i të drejtave të njeriut, në këtë rast liria e asociimit, mund të bëhet vetëm me ligj. Rrjedhimisht, këtu vihen re dy gjëra: 1) pezullimi i aktivitetit të OJQ-ve parashihet vetëm me UA, që sipas GjEDNj-së nuk ka fuqi të mjaftueshme juridike të bëjë kufizime të këtilla të lirisë së asociimit, dhe 2) në kontekstin e Kosovës, pezullimi rregullohet me UA, i cili, si i tillë, nuk është paraparë dhe nuk është përcaktuar me Ligjin për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-qeveritare.

Avokati i Popullit, duke mos paragjykuar nëse autoritetet shtetërore kanë pasur arsye për ta pezulluar apo për ta ndaluar veprimtarinë e një OJQ-je, tërheq vëmendjen se kurdo kur mund të pretendohet se ekzistojnë rrethana për pezullimin apo ndërprerjen e veprimtarisë së ndonjë organizate joqeveritare, procesi duhet të respektojë mandatet dhe funksionet e organeve të ndjekjes dhe gjykatave. Praktika e deritanishme ka dëshmuar se një numri të OJQ-ve i është pezulluar apo ndaluar veprimtaria me dyshimet për financimin e terrorizmit,⁵¹ me anë të vendimeve administrative, përkatësisht vendimeve të Departamentit për Regjistrimin e OJQ-ve të MAP-it, ndërsa nuk ka informata nëse ndaj ndonjëres prej OJQ-ve të pezulluara apo ndaluara janë zhvilluar hetime penale apo është

⁵¹ US State Department Report 2017, Country Reports on Terrorism 2016 <https://www.state.gov/documents/organization/272488.pdf> (qasur më 15 janar 2018)

ngritura aktakuzë, duke marrë parasysh se financimi i terrorizmit përbën vepër të rëndë penale dhe do të duhej të trajtohej në pajtim me procedurën penale.

Për më tepër, Avokati i Popullit ngre shqetësimin se mbajtja në fuqi e UA nr. 02/2014 për Regjistrimin dhe Funksionimin e Organizatave Joqeveritare, lë hapësirë për ndërhyrjen e shtetit në punën e OJQ-ve. Obligimet e shtetit karshi lirisë së asociimit janë obligime negative, që nënkupton krijimin e kushteve të favorshme, por mosndërhyrje në lirinë e qytetarëve në këtë të drejtë. Gjithsesi, Avokati i Popullit, thekson se neni 44 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në paragrafin 3, saktëson: *“Organizatat ose aktivitetet që kanë për qëllim cenimin e rendit kushtetues, shkeljen e lirisë dhe të drejtave të njeriut, ose nxitjen e urrejtjes racore, kombëtare, etnike a fetare, mund të ndalohen me vendim gjyqësor të gjykatës kompetente.”*

Avokati i Popullit vëren se Projektligji për Lirinë e Asociimit në Organizata Joqeveritare është në procedurë në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe mbetet me shpresë se, për dallim nga ligji në fuqi, ligji i ri, në pajtim me frymën dhe përcaktimet kushtetuese, bashkë me procedurat e regjistrimit dhe funksionimit të OJQ-ve, do të përcaktojë qartësisht edhe rregullat se kur dhe në cilat rrethana mund të bëhet pezullimi dhe ndalimi i veprimtarisë së një organizate joqeveritare në Kosovë.

Ndërhyrjet e ministrit të Punëve të Brendshme për anulimin e procedurave të rekrutimit në Inspektoratin Policor të Kosovës

Më 29 janar 2018, Avokati i Popullit ka nxjerrë Raportin me Rekomandime nr. 731/2017, në lidhje me Vendimin e Inspektoratit Policor të Kosovës, i datës 29 dhjetor 2017, për anulimin e procesit të rekrutimit për Inspektor/Hetues, i shpallur më 24 korrik 2017. Avokati i Popullit ka vlerësuar se Vendimi i ministrit të atëhershëm të MPB-së për anulimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm dhe kërkesa e ministrit të MPB-së për nxjerrjen e vendimit nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së për anulimin e procesit të rekrutimit, i datës 29 dhjetor 2017, përbëjnë veprime që cenojnë të drejtën e kandidatëve në punë dhe në ushtrimin e profesionit, të drejtën në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si dhe të drejtën në mjete efektive juridike. Avokati i Popullit kishte vërejtur se në konkursin për Inspektor/Hetues në Inspektoratin Policor të Kosovës, ministri i Ministrisë së Punëve të Brendshme ka ndërhyrë në procedurat e rekrutimit duke marrë vendim për pezullimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e përzgjedhur sipas konkursit, edhe pse për këtë çështje nuk ka pasur kompetencë ligjore. Ministri kishte kërkuar anulimin e konkursit, gjë që ka ndodhur më 29 dhjetor 2017. Avokati i Popullit kishte vlerësuar se në rastin konkret ministri ka ndërhyrë në kompetencat e Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës duke mosrespektuar e Ligjin nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës, që është ligj bazik, i cili përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor të Kosovës, e po ashtu duke mosrespektuar Udhëzimin Administrativ nr. 01/2017 për procedurat lidhur me kushtet e punësimit dhe të punës për punëtorët e IPK-së. Avokati i Popullit kishte vlerësuar se ndërhyrje të tilla krijojnë pasiguri juridike të normave që përcaktojnë

kompetencat e subjekteve bartëse të institucioneve, e po ashtu, krijojnë pasiguri në normat që rregullojnë çështjet dhe procedurat e rekrutimit për punonjësit në institucionet e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar ministrit të Punëve të Brendshme dhe Kryeshefit të Inspektoratit Policor, që të ndërmarrin veprime konkrete në evitim të shkeljeve të identifikuar, por rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk ishin përfillur.

Sidoqoftë, kandidatët për Inspektor/Hetues në Inspektoratin Policor të Kosovës kishin ngritur rastin në Gjykatën Themelore në Prishtinë me ç’ rast gjykata u kishte dhënë të drejtë, rrjedhimisht kandidatët për inspektorë i kanë nënshkruara kontratat dhe kanë filluar punën në Inspektorat. Vërehet se Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte administruar si provë edhe Raportin me Rekomandime nr. 731/2017 të Avokatit.

Pamundësia për ta përmbushur kriterin 15 vjeçar për realizimin e pensionit kontributpagues

Avokati i Popullit përgjatë viteve ka pranuar ankesa nga kategoria e qytetarëve, të cilët nuk kanë arritur ta përmbushin njërin nga kriteret për njohje të pensionit kontributpagues, përkatësisht stazhin pensional kontributpagues, që është minimum 15 vjet.

Avokati i Popullit, më 6 prill 2018, e ka publikuar Raportin me Rekomandime, *Ex Officio* nr. 235/2018 dhe ua ka dërguar Qeverisë, Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrisë së Financave, në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës, për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 vjetëve si pasojë e largimit diskriminues nga puna.

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes mbi nevojën e rregullimit pozitiv të pensionit kontributpagues për kategorinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 vjetëve, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë.

Nga analiza e fakteve dhe ngjarjeve që kanë ndodhur pas vitit 1989, përkatësisht praktikës së largimit nga puna në kohën e masave të dhunshme, Avokati i Popullit ka konstatuar se ky proces ka qenë diskriminues. Nga hulumtimi i Avokatit të Popullit del se largimi nga puna në vitet e ‘90-ta pas vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, është bazuar në praktikë arbitrare dhe diskriminuese e zbatuar nga “organe të përkohshme”. Së këndejmi, Avokati i Popullit i ka rekomanduar autoriteteve përgjegjëse që të fillojnë ndryshimin e bazës ligjore dhe të propozojnë në Kuvendin e Republikës së Kosovës draft-ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, në mënyrë që kategoria e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuese, të përfitojnë nga pensioni kontributpagues.

Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje nga autoritetet përgjegjëse, brenda afatit të përcaktuar. Më 27 dhjetor 2018, pas insistimeve të vazhdueshme për të marrë informata

nga autoritetet përgjegjëse, lidhur me veprimet që ato planifikojnë t'i ndërmarrin në raport me rekomandimet, Avokati i Popullit ka pranuar një përgjigje me informatat se rekomandimi i Avokatit të Popullit është shqyrtuar nga Ministria e Financave dhe se rekomandimi duhet të përfshihet si gjithëpërfshirës e kompleks dhe se rekomandimi duhet të zë vend në politikat e ardhshme të MPMS-së dhe të Qeverisë, në koordinim me Ministrinë e Financave, si dhe në përgjithësi me ndryshimet ligjore, të zbatohet brenda mundësive buxhetore. Autoritete përgjegjëse nuk kanë dhënë ndonjë datë apo plan se kur mund të priten zhvillimet e para rreth rekomandimeve të Avokatit të Popullit, duke lënë edhe më tutje pezull çështjen e qytetarëve që kanë qenë dhe akoma vazhdojnë të mbeten viktimat të diskriminimit.

E drejta në pension kontributpagues të moshës, si dhe e drejta në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë

Avokati i Popullit ka pranuar ankesa individuale lidhur me të drejtën në pension kontributpagues të moshës, si dhe lidhur me të drejtën në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë. Sipas ankesave të pranuar, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe prej informatave nga terreni, kuptohet se MPMS-ja ka ndërprerë njërin nga pensionet të cilat qytetarët deri atëherë i kishin gëzuar, duke përfshirë edhe pensionin kontributpagues. Avokati i Popullit, në shkurt të vitit 2018, ka publikuar Raportin me Rekomandime - Rasti nr. 890/2016, me të cilin e ka trajtuar çështjen në fjalë, duke vënë në fokus ndërprerjen e pensionit kontributpagues, me ç' rast ka konstatuar se kushtëzimi në bazë të ligjit në ushtrimin e së drejtës mbi pensionin kontributpagues të moshës, me ushtrimin mbi një pension tjetër shkakton shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNj-së. Së këndejmi, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Qeverisë dhe MPMS-së që të ndërmarrin nisma për ndryshimin e ligjeve që rregullojnë çështjen e pensioneve, në mënyrë që e drejta në pension kontributpagues të mos afektohet. Rekomandimet e Avokatit të Popullit, përpos që nuk kanë marrë ndonjë përgjigje, qoftë nga Qeveria, qoftë nga MPMS-ja, kanë mbetur po ashtu të pazbatuara.

Të drejtat civile të qytetarëve shqiptarë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci

Një numër i qytetarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, përgjatë viteve janë shpërngulur në Kosovë, për arsye të ndryshme, si: siguria, aspektet sociale, ekonomike dhe të tjera. Një pjesë e tyre, në mungesë të dokumenteve personale, për kohë të gjatë janë duke u përballur me çështjen e mungesës së statusit për qëndrim ligjor, pa shtetësi efektive dhe dokumente personale identifikimi, brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime Ex Officio nr. 355/2016, me ç' rast ka shprehur shqetësimin rreth mënyrës së qëndrimit dhe të jetës së tyre, pasi në mungesë të statusit ligjor për qëndrim në Republikën e Kosovës, konsiderohet i pashmangshëm ballafaqimi me vështirësi në realizimin e një jete normale, bazuar në gëzimin të drejtave elementare të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Nëpërmjet rekomandimeve që i janë adresuar Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, me Raportin në fjalë, kërkohet profilizimi i numrit të saktë të këtyre qytetarëve të shpërngulur në Kosovë dhe ndërmarrja e masave të nevojshme për rregullimin e kuadrit ligjor, që ua mundëson atyre t'i gëzojnë të drejtat themelore dhe elementare të njeriut.

Bazuar në komunikimin që ka pasur IAP-ja me Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion, kuptohet se në këtë Departament janë duke e hartuar një udhëzim administrativ për trajtimin e personave që janë nga Presheva, Bujanoci dhe Medvegja dhe deri në fund të këtij viti do të jetë gati si akt dhe do të hyjë në fuqi me çka do t'u mundësohet këtyre qytetarëve pajisja me dokumentacion personal, të cilët janë duke jetuar në Kosovë.

Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga MPB-ja se në Ligjin për të Huaj janë bërë ndryshimet e nevojshme ligjore për adresimin e kësaj kategorie të personave dhe se MPB-ja është në fazën e hartimit të udhëzimit administrativ. Sipas pohimeve të MPB-së, grupi punues ka filluar punën në terren me qëllim të identifikimit të numrit të qytetarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të cilat janë duke qëndruar në territorin e Kosovës pa ndonjë status të definuar.

Çështjet që ndërlidhen me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit ka trajtuar një numër çështjesh që ndërlidhen me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë (MASHT).

Njëra ndër to ka të bëjë me Vendimin për pagesën e provimit të maturës, i datës 16 maj 2017, i nxjerrë nga MASHT-i, përkatësisht nga Komisioni Shtetëror i Maturës, që sipas vlerësimit të Avokatit të Popullit, i shkelë të drejtat dhe liritë e njeriut për faktin se është në kundërshtim me parimet bazë të funksionimit të shtetit demokratik, siç është parimi i ligjshmërisë, parimi kushtetues, i sundimit të ligjit dhe parimi i sigurisë juridike.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime Ex Officio nr. 412/2017, me ç'rast i ka rekomanduar MASHT-it që, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e legjislacionit përkatës në fuqi, ta shpallë të pavlefshëm Vendimin për pagesën e Provimit të Maturës Shtetërore, i datës 16.5.2017, me nr. 2-1843, i nxjerrë nga Komisioni Shtetëror i Maturës. MASHT-i, pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit, ka nxjerrë një vendim të ri, me të cilin nxënësit lirohen nga pagesa e Provimit të Maturës.

Një çështje tjetër, të cilën e ka trajtuar Avokati i Popullit ka të bëjë me një ankesë individuale lidhur me mosnjohjen e gradës Master, për kualifikimet e fituara, sipas sistemit të studimeve universitare pesëvjeçare, sipas sistemit të para Bolonjës. Pas trajtimit të ankesës, Avokati i Popullit ka vlerësuar se ekziston kufizim i interesave dhe i të drejtave të një numri të konsiderueshëm të personave të diplomuar në fushën teknike, sipas sistemit pesëvjeçar të studimeve, të aplikuar sipas sistemit të para Bolonjës. Së këndejmi, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime nr. 533/2017, ku në mes tjerash i rekomandohet MASHT-it që t'i ndërmarrë veprimet dhe hapat e

nevojshëm, me qëllim të plotësimit dhe riformulimit të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 11 për Krahasueshmërinë dhe Barasvlerën e Diplomave dhe të Programeve Studimore, para dhe sipas sistemit të Bolonjës, me qëllim të mundësimit të njohjes së titullit Master për të diplomuarit në sistemin pesëvjeçar të studimeve në fushën teknike, para sistemit të Bolonjës. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga MASHT-i, me të cilën konfirmohet se MASHT-i ka filluar trajtimin e çështjes dhe procedurat e nevojshme ligjore lidhur me plotësimin e normave ligjore për çështjen në fjalë.

Zbatimi i ligjeve në praktikë nga ana e zbatuesve të ligjit

Avokati i Popullit gjatë punës së tij ka hasur në raste ku një situatë faktike mbulohet nga dy a më shumë akte normative. Në këto situata, duhet vendosur se cilit akt normativ t'i jepet përparësi. Avokati i Popullit ka vërejtur se mënyra se si vendoset përparësia ndërmjet akteve normative, ka implikime të rëndësishme për të drejtat e njeriut. Kjo pashmangshmërisht reflektohet edhe gjatë punës së IAP-së në funksion të përmbushjes së misionit dhe mandatit që ka.

Avokati i Popullit ka pranuar informata se disa komuna nuk pranojnë që t'i lirojnë nga pagesa e tatimit në pronë personat e verbër, të cilët, sipas Ligjit nr. 04/L-192 për Personat e Verbër (neni 6) lirohen nga obligimi për të paguar tatimin në pronë, duke u bazuar vetëm në Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Avokati i Popullit, në mes tjerash, ka shprehur qëndrimin e tij lidhur me këtë në Raportin me Rekomandime Ex Officio nr. 441/2018 në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ku ka konstatuar se parimi *lex specialis* i jep përparësi dispozitës së Ligjit për Personat e Verbër kundrejt dispozitës së Ligjit për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Konkretisht, neni 6 i Ligjit për Personat e Verbër trajton vetëm një kategori të caktuar në aspektin tatimor, ndërsa Ligji për Tatimin në Pronën e Paluajtshme trajton të gjithë tatimpaguesit, duke përfshirë personat e verbër.

Së këndejmi, duke zbatuar parimin *lex specialis*, përjashtimi i përcaktuar në Ligjin për Personat e Verbër duhet të gëzojë përparësi kundrejt rregullit të përgjithshëm të përcaktuar në Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Menaxhimi dhe mirëmbajtja e varrezave nga ana e organeve komunale

Duke pasur parasysh se menaxhimi dhe mirëmbajtja e varrezave është veprimtari komunale e interesit të përgjithshëm, duke u bazuar në informatat e grumbulluara lidhur me gjendjen jo të mirë të mirëmbajtjes së varrezave, Avokati i Popullit ka iniciuar hetime me iniciativën e vet (*ex officio*) lidhur me vlerësimin e gjendjes së varrezave nëpër komunat e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit ka konstatuar se gjendja e varrezave nëpër disa komuna të Republikës së Kosovës, sa i përket menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave, përbën cenim të

dinjitetit të njeriut, të garantuar me nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, respektivisht dinjitetit të familjarëve të personave të vdekur. Mosmenaxhimi dhe mirëmbajtja joadekuate e varrezave paraqet edhe mos ushtrim të kompetencave nga autoritetet komunale, të parapara me Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe mosplotësim të obligimeve të parapara me Rregulloret Komunale të miratuara nga Asambletë Komunale, e që përcaktojnë qartë përgjegjësitë dhe obligimet e komunave në fushën e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime *Ex officio* nr. 401/2018, të cilin ua ka adresuar të gjitha komunave, duke kërkuar nga to përmbushjen e obligimeve ligjore përkatëse.

Ka pasur një përgjegjshmëri të lartë nga shumica e komunave, përveç komunave në pjesën veriore të vendit, të cilat janë zotuar se në buxhetet e tyre për vitin e ardhshëm do të parashohin shpenzimet për mirëmbajtjen dhe menaxhimin e varrezave, me qëllim të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Çështja e faturimit të energjisë elektrike të shpenzuar në veri

Një çështje që e ka përcjellë punën e Institucionit të Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2018 dhe që ka zgjuar interesimin e publikut dhe të mediave është çështja e faturimit të rrymës së shpenzuar në veri.

Avokati i Popullit, në vitin 2017, ka publikuar një raport me gjetjet se asnjë nga ligjet që e rregullon sektorin e energjisë elektrike nuk i jep Zyrës së Rregullatorit të Enërgjisë (ZRRë) të drejtë për t'ua faturuar qytetarëve në pjesë të tjera të vendit rrymën e shpenzuar në një pjesë të vendit. Duke marrë parasysh faktin se rekomandimet e Avokatit të Popullit nuk janë përfillur nga ZRRë-ja, Avokati i Popullit, më 15 gusht 2017, ka paraqitur padi pranë Gjykatës Themelore të Prishtinës, gjegjësisht në Departamentin për Çështje Administrative, me ç' rast ka kërkuar anulimin e Vendimit të ZRRë-së V_399_2012, i datës 6 shkurt 2012, dhe kompensimin e konsumatorëve të cilët faturohen për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore. Bashkë me padinë është kërkuar shtyrja e ekzekutimit të Vendimit të ZRRë-së V_399_2012. Gjykata Themelore në Prishtinë, më 11 shtator 2017, ka aprovuar kërkesën për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, deri në marrjen e aktgjykimit sipas kërkesëpadsisë.

Gjykata Themelore në Prishtinë akoma nuk ka vendosur lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit për çështjen kryesore, përkatësisht kompensimin e konsumatorëve, të cilët, deri në dhjetor të vitit 2017, ishin faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore.

Çështja e faturimit të ujit/ARrU

Avokati i Popullit në vitin 2017 kishte ngritur një shqetësim për faturimin paushall të shpenzimeve të ujit nga kompanitë e ujësjellësit. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit kishte rekomanduar që faturimi i ujit të bëhet në bazë të konsumit real në njehsorin e konsumatorit dhe shpenzimeve reale, ashtu sikur që parashihej me Ligjin nr. 04/L-121

për Mbrojtje të Konsumatorëve, si dhe ka kërkuar nga Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARrU) monitorimin e rregullt të Ofruesve të Shërbimeve. Nga përgjigja që Avokati i Popullit ka pranuar nga ARrU-ja, vërehet se çështja e faturimit dhe çështja e monitorimit të operatorëve të licencuar është mirë e normuar nga ARrU-ja me Rregulloren për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë. Po ashtu, nga një raport që Avokati i Popullit ka pranuar nga ARrU-ja, raportohet se ARrU-ja zhvillon inspektime të rregullta edhe në terren, si dhe ndërmerr masa në rastet e mungesës së përmbushjes së standardeve minimale për shërbimet e ujit. Avokati i Popullit ka hasur në bashkëpunim shumë konstruktiv të ARrU-së, e cila ka njoftuar Avokatin e Popullit se, aty ku ka qenë e mundur, i ka ndërmarrë të gjitha masat që uji të faturohet në pajtim me ligjin. ARrU-ja ka njoftuar se për këtë qëllim ka nxjerrë Rregulloren nr. 08/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores nr. 02/2016 për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë, me të cilën rregullohen çështjet që Avokati i Popullit i ka ngritur në Raportin me Rekomandime Ex officio 1/2017, i datës 11 janar 2017.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë

Sikur edhe në vitin paraprak, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil në Kosovë (KPMSHCK) ka vazhduar të anulojë të gjitha procedurat e rekrutimit në IAP, për të cilat është paraqitur ankesë në KPMSHCK, përveç ankesave që janë paraqitur pas afatit. Gjatë vitit raportues, KPMSHCK-ja ka anuluar katër procedura të rekrutimit, për çfarë Avokati i Popullit ka paraqitur padi për inicimin e konfliktit administrativ dhe njëkohësisht ka kërkuar shtyrjen ekzekutimit të vendimeve të KPMSHCK-së. Gjykata Themelore në Prishtinë (GjThP) ka aprovuar të gjitha kërkesat e Avokatit të Popullit, që janë gjithsej 4, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve të KPMSHCK-së, ndërsa në shqyrtim pranë GjThP-së janë gjithsej gjashtë padi të paraqitura nga IAP-ja.

Për më tepër, Avokati i Popullit vë në dijeni Kuvendin e Republikës së Kosovës se, më 26 tetor 2018, ka paraqitur kërkesë në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i cili e vesh KPMSHCK-në me kompetencat për të dhënë udhëzime dhe për të ndërhyrë jo vetëm në institucionet e Qeverisë, por edhe në institucionet e tjera, duke përfshirë Institucionin e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit, pa e paragjykuar rezultatin lidhur me paditë për konfliktin administrativ, të paraqitura në GjThP dhe pa e paragjykuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kërkon nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që me anë të ligjeve që rregullojnë administratën publike, përkatësisht shërbimin civil në Republikën e Kosovës, ta qartësojë pozicionin e institucioneve të pavarura, të përcaktuara me Kapitullin XII të Kushtetutës, në pajtim me rendin kushtetues në vend, si dhe në pajtim me frymën e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese KO73/2016, i datës 8 dhjetor 2016.

Përgjegjësia për mjedisin jetësor

Kushtetuta e vendit i garanton secilit të drejtën për mjedis të shëndetshëm jetësor, njëherësh duke garantuar mundësinë e informimit dhe pjesëmarrjes së çdo personi për të ndikuar në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin⁵².

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), bazuar në informatat e pranuar nga burime të ndryshme dhe nga ankesat individuale, gjatë vitit raportues, nuk ka vërejtur veprime konkrete institucionale, të cilat dukshëm do të ndikonin në respektimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Nuk është shënuar ndonjë përmirësim i gjendjes së ajrit, të ujërave dhe e tokës. Pothuajse në ritëm të njëjtë ka vazhduar degradimi i tokës bujqësore dhe shkatërrimi i sipërfaqeve pyjore. Përfshirja e publikut në vendimmarrje, si e drejtë kushtetuese, ka vazhduar të përcillet me paqartësi. Qasja në informata mjedisore vazhdon të mbetet sfiduese, e po ashtu nuk është vërejtur ndryshim në sistemin prokurorial dhe atë gjyqësor, që do të ndikonte në përshejtimin e shqyrtimit të lëndëve mjedisore.

Edhe pse qytetarët e vendit, vite me radhë, janë duke u ballafaquar me kufizim të së drejtës së privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë, nuk është arritur të miratohet ligji i ri, cili në mënyrë efektive do t'i mbronte qytetarët nga zhurma. Ndërsa, mosndërmarrja e asnjë veprimi në drejtim të menaxhimit të mbeturinave dhe të deponive, tanimë është bërë problem me ndikim serioz në të drejtat e njeriut me pasoja afatgjate. Zinxhirit të parregullsisë me ndikim në mjedis mund t'i shtohet edhe ndërtimi i rrugëve pa kritere të mbrojtjes së mjedisit. Asnjë përmirësim nuk është regjistruar në drejtim të respektimit të normave bazë të planifikimit hapësinor, i cili do të reflektonte në kualitetin e jetës.

Buxheti i ndarë për Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor vazhdon të ngelet i ulët, në krahasim me nevojat për ndërmarrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në vend, dhe duke pasur parasysh faktin që mjedisi ka filluar qartazi të ndikojë në shëndetin e qytetarëve. Kërkesa e rezolutës së Kuvendit të Kosovës, e datës 1 shkurt 2018, për vendosjen e mbrojtjes së mjedisit në prioritetet e Qeverisë sikur është anashkaluar. Ndërsa, edhe pse e përcaktuar me Ligjin për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve⁵³, taksë ekologjike vazhdon të mos shfrytëzohet për qëllime të mbrojtjes së mjedisit. Bashkëpunimi ndër-institucional për zgjidhjen efektive të problemeve mjedisore në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtje të mjedisit, nuk ka shënuar përmirësim.

Gjatë vitit raportues, të pakta kanë qenë aktivitetet e institucioneve kompetente, sidomos të MMPH-së, dhe për promovimin e së drejtës së qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Madje, përkundër rrezikut të ndikimit të gjendjes së mjedisit në shëndetin e

⁵² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52, par. 2, *Përgjegjësia për Mjedisin jetësor*, "Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton."

⁵³ Ligji nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, neni 1, par 2. Me këtë ligj gjithashtu rregullohet edhe vendosja e taksës ekologjike për automjetet regjistruara në Kosovë dhe për automjetet e huaja. Taksë ekologjike ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së ambientit.

qytetarëve, nuk janë vënë re aktivitete edukuese nga institucionet shëndetësore, nga profesionistët shëndetësorë etj., nëpërmjet të cilave qytetarët do të informoheshin lidhur me mundësitë për t'iu shmangur faktorëve të rrezikut dhe eliminimit të tyre, duke përdorur mjetet dhe metodat që mbrojnë shëndetin⁵⁴. Nuk janë vënë re as iniciativa të theksuara të shoqërisë civile dhe as të organizatave joqeveritare, të cilat do të ndikonin në proceset që lidhen me mbrojtjen dhe përmirësimin e gjendjes së mjedisit në vend, e as aktivitete të theksuara promovuese, që do të ndikonin në ndërgjegjësimin e publikut për të drejtën në mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Të zbehta ngelin fushatat informuese përmes mediave, të cilat do të ndikonin në vetëdijësimin dhe edukimin e qytetarëve për mbrojtjen e mjedisit.

Institucionet shtetërore ende nuk kanë filluar të ndërmarrin veprime serioze për t'iu bashkëngjitur iniciativës globale lidhur me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, si: qasja në ujë të pastër dhe kanalizim; sigurimi i qasjes në energji të përballueshme, të besueshme, të qëndrueshme dhe moderne për të gjithë; të bërit e qyteteve dhe vendbanimeve të jetuara nga njerëzit, gjithëpërfshirëse, të përshtatshme dhe të qëndrueshme; marrjen e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimet klimatike dhe ndikimet e saj; mbrojtjen e ujërave; mbrojtjen, rivendosjen, dhe promovimin e qëndrueshëm të ekosistemit tokësor, menaxhimin në mënyrë të qëndrueshme të pyjeve, luftimin e shkretëtirëzimit, ndalimin e degradimit të tokës dhe ndalimin e humbjes së biodiversitetit.

Avokati i Popullit në vitin raportues ka publikuar fletëpalosjen *“Përgjegjësia për mjedisin jetësor”*⁵⁵, një dokument i cili ka për qëllim edukimin e qytetarëve për të drejtën e tyre për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe informimin për institucionet përgjegjëse, të cilat sigurojnë respektimin e kësaj të drejte.

Më 21 mars 2018, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Botërore të Ujit/Ujërave, publikoi komunikatën për media, përmes së cilës kërkoi nga institucionet përgjegjëse, që t'i respektojnë dispozitat ligjore për përmirësimin e gjendjes së ujërave dhe të mundësojnë që të gjithë qytetarët të kenë qasje në ujë të pastër, të pijshëm, sipas standardeve ndërkombëtare.

Avokati i Popullit, në takimin e Asociacionit të Ombudsmanëve Mediteran – AOM “Ombudsmani si mbrojtës i të drejtave sociale, kulturore dhe mjedisore”, i mbajtur më 30 dhe 31 maj 2018 në Shkup të Maqedonisë, para të pranishmëve prezantoi gjendjen e përgjithshme të së drejtës në vend, dhe diskursin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Avokati i Popullit u zotua se IAP-ja do të vazhdojë të ushtrojë me përkushtim mandatin e tij, në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës të qytetarëve dhe mbrojtjes së mjedisit për gjeneratat e ardhshme, e në veçanti, të fuqizojë kapacitetet e

⁵⁴ Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, neni 27, “Promovimi i Shëndetit”.

⁵⁵ <https://www.oik-rks.org/2018/11/01/e-drejta-per-mjedis-te-sigurt-dhe-te-shendetshem/>

institucionit për mbrojtjen e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, në mënyrë që interpretimi i së drejtës të bëhet në harmoni me vendimet e GjEDNj-së.

Më 5 qershor 2018, me rastin e Ditës Botërore e Mjedisit, Avokati i Popullit, nëpërmjet komunikatës për media⁵⁶, duke sjellë në vëmendjen e të gjithëve gjendjen e mjedisit në vend, ftoi institucionet përgjegjëse, që të ndërmarrin hapa konkret për ndërprerjen e parregullsive me ndikim në mjedis, si dhe vendosjen e mjedisit në prioritet të Qverisë.

Më 22 nëntor 2018, IAP-ja, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Drejtësi, organizoi tryezën “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”. Qëllimi i organizimit të tryezës ishte diskutimi i arsyes së zvarritjes së lëndëve mjedisore në prokurori dhe në gjykatë. Në tryezë morën pjesë përfaqësuesit e institucioneve kompetente të nivelit lokal dhe qendror për mbrojtje të mjedisit, përfaqësuesit e organeve të drejtësisë, të Policisë së Kosovës, përfaqësues të organizatave Ndërkombëtare, ambasadave, shoqërisë civile dhe qytetarë.

Ajri

Në ndotjen e ajrit vazhdoi të ndikojnë KEK-u, si ndotësi më i madh në vend⁵⁷, duke u pasuar nga ndotja e karburanteve jocosilësore dhe nga veturat e vjetra⁵⁸, si dhe sistemi i ngrohjes me lëndë joekologjike. Projektligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja nuk u arrit të miratohet.

Obligimi i shtetit për vendosjen e masave të efikasitetit të energjisë ka mbetur në vullnet të individit, pa asnjë kontroll institucionale dhe pa ndonjë formë subvencionimi nga shteti. Nuk është vërejtur ndonjë ndryshim i dukshëm as në zgjerimin e rrjetit të kogjenerimit⁵⁹; në zgjerimin e hapësirave të gjelbra;⁶⁰ në ofrimin e lehtësirave që qytetarët t’i zëvendësojnë metodat e dëmshme për ngrohje me metoda të pastra alternative ekologjike;⁶¹ në përmirësimin e transportit publik;⁶² në kontroll teknike të automjeteve, e as në menaxhimin e mbeturinave urbane dhe industriale. Ndikim serioz në ndotjen e ajrit kanë pasur edhe ndërtimet e objekteve dhe të rrugëve pa kriteret e mbrojtjes së ndikimit në mjedis.

⁵⁶ <https://www.oik-rks.org/2018/06/05/deklarate-e-avokatit-te-popullit-me-rastin-e-dites-boterore-te-mjedisit/>

⁵⁷ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, AMMK, “Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017”, fq. 18.

⁵⁸ Ligji nr. 05/L-132 për Automjete, neni 44, “Në Kosovë nuk mund të importohen vetura më të vjetra se dhjetë (10) vjet”.

⁵⁹ Rezoluta, neni 7, “Të shtohen investimet kapitale për ngrohtoren “Termokos”, duke siguruar fonde shtesë për dyfishimin e kapacitetit të kogjenerimit, nga 140 megawat në 280 megawat energji termike, në mënyrë që të zgjerohet më shpejt rrjeti i ngrohtores në të gjitha lagjet e kryeqytetit, ku kjo është e mundur, përmes projektit të kogjenerimit. Po ashtu të krijohen mundësitë që edhe qytetet e tjera të lidhen me këtë projekt. Kjo të realizohet brenda afatit 2 vjeçar.”

⁶⁰ Po aty, neni, 8.

⁶¹ Po aty, neni 9.

⁶² Po aty, neni 13.

Komunat më të rrezikuara nga ndotja e ajrit janë komuna e Prishtinës, e Mitrovicës, e Obiliqit, e Hanit të Elezit dhe e Gjilanit⁶³. E drejta e jetës dhe e drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, në këto vende, ka vazhduar të cenohet nga tejkalimet mbi normat e lejuara me ndotësit PM10, PM2.5⁶⁴, me vlerën maksimale të lejuar (VML), të cilat ishin më të theksuara në muajt janar-mars, shkurt, tetor-nëntor dhe dhjetor.

Niveli i ndotjes së ajrit në komunën e Prishtinës në vitin 2018, në krahasim me vitin 2017, ka regjistruar përkeqësim nga tejkalimet e PM10 dhe PM 2,5⁶⁵. Tejkalimet e vlerave kufitare, të cilat arritën pragun e alarmit⁶⁶ dhe rrezikuan seriozisht shëndetin e qytetarëve⁶⁷, u përsëritën gjatë vitit raportues, në komunën e Prishtinës me rrethinë, në periudhën janar-shkurt-nëntor dhe dhjetor, pa asnjë masë preventive nga Qeveria, Ministria dhe Komuna⁶⁸. Edhe pse sipas Udhëzimit Administrativ 02/2011 për Normat e Cilësisë së Ajrit, janë të lejuara 35 ditë të tejkalimit të PM10 brenda një viti. Vetëm në janar 2018, në stacionin e monitorimit të Rilindja, janë regjistruar 21 ditë me tejkalime të PM10, ndërsa tejkalime të PM 2,5 janë regjistruar 30 ditë. Më 1 dhjetor 2018, në Stacionin-IHMK janë regjistruar tejkalime mbi normat e lejuara të PM10, dhe vlera më e lartë e mesatares ditore të regjistruar ishte 150.1µg/m3, edhe pse vlera kufitare ditore e lejuar për mbrojtjen e shëndetit të njeriut është vetëm 50µg/m3⁶⁹.

Gjetja e vendit pa asnjë masë shtesë mbrojtëse, në periudhën e dimrit, periudhë e përkeqësimit të cilësisë së ajrit, është tregues i dështimit të organeve kompetente për të respektuar përgjegjësinë kushtetuese për mbrojtjen e mjedisit dhe për t'i përmbushur obligimet e përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, të cilat do t'ua garantonin qytetarëve të drejtën për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër dhe të shëndetshëm.

⁶³ Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i Auditimit të Performancës “Mekanizmat Institucional për Rregullimin Ligjor, Monitorimin dhe Raportimin e Cilësisë së Ajrit”, fq.12.

⁶⁴ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, AMMK, “Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017”, fq. 8 dhe 9.

⁶⁵ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Analiza e cilësisë së ajrit në Prishtinë gjatë muajit janar 2018, “Janari i vitit 2018 ka pasur nivelin e ndotjes së ajrit më të lartë krahasuar me janarin e vitit 2017”.

⁶⁶ Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 24 “Masat për tejkalimin e pragut të alarmit dhe cilësinë e dobët të ajrit.

⁶⁷ Dokument pune i personelit të komisionit, Raport për Kosovën* 2018, në përcjellje të dokumentit, Komunikata nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian, si dhe Komitetin e Rajoneve Komunikata 2018 për Politikën e Zgjerimit të BE-së “Cilësia e ajrit, sidomos në zonat urbane, vazhdon të përbëjë kërcënim madhor ndaj shëndetit publik”.

⁶⁸ Ligji nr. 03/L-160 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 24, 2. Për parashikimin dhe paralajmërimin e gjendjes së smogut ose situatave me cilësi të dobët të ajrit, Qeveria me propozim të Ministrisë, me akt të veçantë përcakton masat për rregullimin e sistemit special paralajmërues. 3. Në raste emergjente, për të normalizuar gjendjen, masat e ndërmarra duhet të koordinohen nga Ministria, Qeveria dhe autoritetet lokale-komunat. 4. Ministria përcakton masat për rregullimin, ndaljen dhe kufizimin e shkarkimit në ajër nga burimet e ndotjes. 5. Autoritetet lokale në bashkëpunim me Ministrinë, duhet të ndërmarrin masa emergjente për të normalizuar gjendjen e cilësisë së ajrit. 6. Autoriteti lokal përcakton masat për rregullimin, ndaljen dhe kufizimin e burimeve të emisioneve të ndotësve në ajër.

⁶⁹ AMMK, Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, “Raporti mbi Cilësinë e Ajrit sipas Monitorimit nga Ihmk 2018.”

Avokati i Popullit, më 31 janar 2018, në takimin e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Kosovës, ku u diskutua lidhur me gjendjen alarmante të ajrit, në periudhën e dimrit 2017-2018, në komunën e Prishtinës me rrethinë, deklaroi se institucionet kompetente nuk janë duke e zbatuar Ligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, dhe se monitorimi dhe mbikëqyrja inspektive nuk është duke u bërë në përputhje me ligjin.

Rezoluta e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, më 1 shkurt 2018, pas seancës dyditore të mbajtur lidhur me ndotjen e ajrit, edhe pse e vlerësuar si hap i rëndësishëm, u tregua iniciativë dhe masë joefektive për përmirësimin e gjendjes, pasi që nuk u vërejt asnjë ndryshim në përmirësimin e gjendjes së ajrit në muajin nëntor dhe dhjetor 2018. Asnjëra nga tri objektivat e “Planit të aktiviteteve për përmirësimin e cilësisë së ajrit vjeshtë-dimër 2017-2018”, ajo për përmirësimin e cilësisë së ajrit, rritjes së nivelit të zbatimit të legjislacionit dhe të përgjegjësive institucionale, si dhe ngritjes së nivelit të edukimit dhe ndërgjegjësimin për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, nuk gjeti zbatim. Po ashtu, nuk u vërejt ndonjë efekt i punës së Task Forcës ndërminstrore për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Edhe pse i përcaktuar me ligj, nuk është shënuar ndonjë përmirësim i dukshëm në sistemim e informimit të publikut, i cili njëherësh do të ishte masë parandaluese e ndikimit të ndotjes së ajrit në shëndetin dhe jetën e njeriut. Edhe pse Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, parasheh obligimin e Ministrisë që ta informojë Qeverinë, autoritetet relevante lokale dhe publikun, kur pragu i alarmit tejkalohet dhe përcaktohet cilësi e dobët të ajrit, përkrah një gjendje mjaft të rëndë në periudhën nëntor - dhjetor 2018⁷⁰, është arritur të evidentohet vetëm një informatë e tillë, dhe atë jo përmes mjeteve shumë të qasshme⁷¹. Qytetarët kanë vazhduar të njoftohen përmes faqes zyrtare të ambasadës Amerikane në Kosovë.

Informimi i ofruar nga organet kompetente përmes mjeteve jo shumë të qasshme, mbështetet në informatat e pranuar nga stacionet e monitorimit dhe nga raportet e pranuar nga operatorët, saktësia e të cilave është vlerësuar të jetë indikative dhe joreale⁷². Dita e monitorimit, e cila zgjidhet nga vetë operatori, mundet të mos e paraqesë gjendjen reale të shkarkimeve nga operatori. Stacionet e monitorimit përcillen me probleme të ndryshme⁷³, dhe të dhënat që dalin nga këto stacione raportojnë gjendjen e përgjithshme të cilësisë së ajrit që është rezultat i të gjitha shkarkimeve në ajër, pa e identifikuar burimin e shkarkimeve (energjetika, transporti, amvisëria, ngrohja etj.).

⁷⁰ Faqja zyrtare e AMMK-së, në Facebook, raportimi i fundit për gjendjen e ajrit më 29 nëntor dhe 1 dhjetor 2018, më 2 dhjetor 2018. Lexo me shume: http://ammk-rks.net/.../Raportet_per_cilesin_e_ajrit_IHMK_RI..., sipas raportit më 29 nëntor dhe 1 dhjetor 2018, janë regjistruar tejkallime me PM10, PM2.5, në Drenas, Prishtinë (IHMK), Obiliq dhe Gjilan.

⁷¹ Informata e titulluar “Pragu i informimit për ndotje të ajrit”, në faqen zyrtare të AMMK-së, në rrjetin social Facebook, ka mbetur e vetmja, përkundër tejkallimeve të shënuara në muajt e dimrit 2018.

⁷²⁷² Zyra Kombëtare e Auditimit, “Mekanizmat Institucional për Rregullimin Ligjor, Monitorimin dhe Raportimin e Cilësisë së Ajrit”, fq.19

⁷³ Po aty, fq. 26. “Vetëm 17% e stacioneve kanë qenë funksionale gjatë pjesës dërrmuese të vitit ndërkohë që 33% e stacioneve kanë qenë jashtë funksionit për më shumë se 7 muaj gjatë vitit 2017’.

Raportet e operatorëve të cilat bëhen nëpërmjet mjeteve matëse të kompanive dhe kompanive të kontraktura nga operatori, nuk verifikohen nga inspektoratet, por vetëm rishikohen⁷⁴.

Fakti se një pjesë e këtyre parametrave mund të mos jenë funksionale për një periudhë të caktuar kohore, si rezultat i dëmtimeve, prishjeve apo thjesht mungesës së servisimit⁷⁵, vë në pikëpyetje relevancën e informatës lidhur me mos tejkalimin dhe ngritjet e lehta të VML të SO₂ (Dioskidi i sulfurit), CO (Monoksidi i karbonit), NO₂ (Dioksidi i azotit), O₃ (Ozoni)⁷⁶.

Avokati i Popullit, nëpërmjet Raportit me Rekomandime⁷⁷, i publikuar më 21 dhjetor 2018, ku shqyrtoi çështjen e ndotjes së ajrit në komunën e Obiliqit dhe hapësirat përreth, shprehu skepticizmin lidhur me relevancën dhe kualitetin e të dhënave lidhur me gjendjen e ajrit, dhe konstatoi se Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka arritur të sigurojë një sistem të sigurt për monitorimin e aktiviteteve të operatorit (KEK), e sidomos emisioneve, që mund të jenë elemente që paraqesin rrezik për jetën e banorëve.

Skepticizëm lidhur me relevancën dhe kualitetin e të dhënave lidhur me gjendjen e ajrit, në komunën e Hanit të Elezit, e paraqiti edhe kryetari i komunës së Hanit të Elezit⁷⁸.

Përkundër informacioneve të pranuar nga burime të ndryshme për ngritjen e numrit të të prekurve në vend nga sëmundjet e organeve respiratore, kardiovaskulare dhe malinje, sëmundjeve të lëkurës, Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik, edhe pse është kompetent për analizimin dhe vlerësimin e ndotjes së ajrit⁷⁹, nuk ka arritur të dalë ende me hulumtim, i cili do të ishte tregues për ndikimin e ndotjes së ajrit në shëndetin e qytetarëve.

Uji

Institucionet kompetente vazhduan të mos i përmbushin përgjegjësitë e tyre për mbrojtjen nga ndotja të resurseve ujore si pasuri e përgjithshme, tej shfrytëzimi dhe keqpërdorimi. Edhe gjatë vitit raportues nuk është arritur të sigurohet zhvillim dhe shfrytëzim i qëndrueshëm i resurseve ujore. Masat parandaluese, masat për minimizimin e përdorimit dhe pengimin e ndotjes së resurseve ujore, parimi *ndotësi paguan dhe shfrytëzuesi paguan* vazhduan të mbeten dispozita ligjore, të pazbatueshme. Edhe pse të ndaluar me ligj, ka vazhduar nxjerrja e rërës, zhavorrit, gurëve, deponimi i dheut, hedhja

⁷⁴ Po aty, fq.19.

⁷⁵ Po aty, fq.27.

⁷⁶ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/AMMK, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017, Ajri, fq.6.

⁷⁷ Raport me Rekomandime Ex officio 280/2016 në lidhje me cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës dhe të privatësisë, të drejtën për shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive, të drejtën e pronës, lirinë e lëvizjes së banorëve të komunës së Obiliqit dhe komunave të afërta që ndikohen nga problemi i njëjtë.

⁷⁸ Diskutimi i kryetarit të komunës së Hanit të Elezit z. Refki Suma, në tryezën e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Drejtësi, “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”, më 22 nëntor 2018.

⁷⁹ Ligji nr. 02/L-78 “Ligji për Shëndetësi Publike”, neni 4, par. 1.

e mbeturinave, materialeve të ngurta dhe shkarkimi i materieve të lëngëta në ujë rrjedha, liqene, akumulime dhe në brigjet e tyre.

Rreth 94% e popullatës së Kosovë realizon të drejtën për ujë të pijshëm nëpërmjet sistemeve publike të menaxhuara nga Kompanitë Rajonale të Ujit, kurse mbulimi me shërbime të ujërave të ndotura-kanalizim, arrin në nivelin prej 74%⁸⁰.

Resurset ujore të vendit vazhdojnë të shfrytëzohen si nga operatorë, po ashtu edhe nga industria. Shfrytëzuesit më të mëdhenj të ujërave vazhdojnë të janë KEK-u, Feronikeli dhe Sharrceci. Të njëjtat, po ashtu ndikojnë në ndotje të ujërave me metale të rënda si plumb dhe kadmium.⁸¹

E drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt, të shëndetshëm, e drejta e pronës, edhe këtë vit janë prekur nga përmbytjet, rezultat jo vetëm i të reshurave, por edhe ndërtimeve pa kriter në zona urbane, në dy dekadat e fundit, të cilat nuk kanë i respektuar parimet bazë të kodit të ndërtimit⁸², dhe duke mos lënë hapësira për drenim natyror.

Pothuajse në tërë vendin ka vazhduar mbi shfrytëzimi nga ndërhyrje arbitrare në inertet e lumenjve, jashtë çdo kriteri, me pasoja të pa riparueshme, si në ekosistem, duke tejkaluar kapacitetet e shtretërve të lumenjve. Ka vazhduar shtypja e substratit të lumenjve nga operimi i makinerive të rënda brenda shtretërve të lumenjve; gjurmimi i gropave të thella, ndonjëherë mbi 10 metra, si pranë lumenjve, po ashtu edhe në brendi; gjurmimi në vende të bashkërrjedhjes ku degët e vogla i bashkohen lumenjve kryesorë; ndërtimi i rrugëve në mes të lumenjve; çrregullimi dhe ndërtimi i rrjedhës natyrale të lumenjve; erozioni i tokës; zvogëlim të stabilitetit të substratit të lumit, sidomos në rastet e vërshimeve; si dhe ndryshim natyror të ekosistemit të lumit, florës dhe faunës. Lumenjtë më të degraduar dhe që ende vazhdojnë të degradohen janë: Drini i Bardhë, Lumëbardhi i Pejës, Ereniku, Desivojcë, Krivarekë dhe Ibri⁸³.

As komunat e as autoriteti, si organe kompetent, nuk arritën të gjejnë zgjidhje efektive për të vënë nën kontroll veprimtaritë ilegale, të cilat, pa asnjë kriter, kanë vazhduar ndërhyrjen në shtretërit e lumenjve. Nuk u vërejt ndonjë investim nga komunat dhe autoriteti për rregullimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës mbrojtëse në shtretërit e lumenjve⁸⁴. Ende nuk është arritur mbajtja dhe menaxhimi i prurjeve të pranueshme ekologjike.

Shkarkimi i ujërave të ndotura, pa trajtim në lumenj, llogaritet të jetë një ndër ndotësit kryesorë të ujërave sipërfaqësore. Alarmante vlerësohet të jetë rrjedhja e pakontrolluar e ujërave të deponisë së Mirashit dhe deponisë së hirit në Obiliq, dhe depërtimi në ujërat

⁸⁰ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës/AMMK, “Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017, fq. 58.

⁸¹ World Bank, June 2018, “Water Security Outlook for Kosovo”, fq. 49

⁸² World Bank, June 2018, “Water Security Outlook for Kosovo”

⁸³ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, “Gjendja e Ujërave në Kosovë 2015”, fq. 42.

⁸⁴ Ligji nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës, neni 46, par.3.

nëntokësorë⁸⁵. Numri i impianteve mbetet mjaft i kufizuar, ndërsa instalimi i tyre ende mbetet në fazën e planifikimit. Ujërat e zeza të pa trajtuara të Prishtinës, të Fushë Kosovës, të Prizrenit etj., kanë vazhduar shkarkimin në lumenj. Lumi Sitnica është lumi më i ndotur në Kosovë⁸⁶.

Operimi i hidrocentraleve të vogla në vend mbetet që të vlerësohet me kujdes, duke marrë parasysh kapacitetin e ulët të prodhimit të energjisë në raport me ndikimin në mjedis që mund të jetë i rëndë, pasi ato shkaktojnë ndërprerje në rrjedhat e ujit dhe përkeqësojnë habitatet⁸⁷.

Avokati i Popullit, në Raportin me Rekomandime *Ex officio* 280/2016, i publikuar më 21 dhjetor 2018, përveç çështjes së ndotjes të lumit Sitnicë nga shkarkimet e pa trajtuara nga KEK-u, ngriti edhe çështjen e shfrytëzimit të ujërave, në veçanti të lumit Llap, si dhe moszbatimit të parimit *ndotësi dhe shfrytëzuesi paguean*. Raporti po ashtu ngriti çështjen e mungesës së llogaridhënies së MMPH-së lidhur me masat e ndërmarra përkitazi me shkarkimet hidraulike nga Termocentralet “Kosova A” dhe “Kosova B” në lumin Sitnica, pa asnjë trajtim.

Toka

Degradimi i tokës ka vazhduar me hapa të njëjtë nga ndotja e shkaktuar për shkarkimeve të pakontrolluara të ujërave të ndotura, ndotja nga mbeturinat e amvisërive, ato industriale dhe të rrezikshme, shkarkimet bujqësore, transporti, ndërtimet etj. Degradimi dhe ndotja në hapësirat përreth industrive të rënda, si Obiliq, Mitrovicë, Drenas dhe Han të Elezit⁸⁸, edhe këtë vit nuk është arritur të vihet nën kontroll, e as të sanohet. Hapësirat përreth ish-objekteve industriale energjetike në lokacionin në afërsi të TC “Kosova A”, kanë vazhduar të kenë të depozituara mbetje toksike të prodhimit (mbetjeve fenolike), deponim të hirit të TC “Kosova A”, si dhe mbetje nga punimet e vjetra minerare nëntokësore. Shqetësuese vazhdon të mbetet ndërhyrja pa kriter e aktiviteteve minerare, sidomos nga operatorë ilegalë. Rrallë vërehet rehabilitimi apo rikultivimi i hapësirave ku janë kryer aktivitetet minerare.

Ka vazhduar trendi i ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore dhe të hapësirave të gjelbërta në tokë ndërtimore, pa kontroll dhe jashtë kriterëve të përcaktuara, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe komunat nuk kanë informata të sakta, edhe pse sipas informatave jozyrtare, në vit rreth 500 hektarë tokë bujqësore u ndërrohet destinimi⁸⁹. Nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës⁹⁰.

⁸⁵ Hydrogeochemical analyses of the ground water in the Mirash landfill area and problem analysis Control report, GIZ 2016, M. Sc. Eng. Evelina Rathje dhe emisioni “Teta në Kosovë”, 24 maj 2018.

⁸⁶ https://kallxo.com/gjnk/lumenjte-e-kanalizimit-te-kosoves/?fbclid=IwAR16LoY6JoIfjJnTkOOXuS5i10bpQS3MWM_nrikF-zaPOLiJcDwzWf-7kQI

⁸⁷ Water Security Outlook for Kosovo, fq.59.

⁸⁸ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017, Toka (Dheu), fq. 36.

⁸⁹ <https://ndertimi.info/tkurret-toka-bujqesore-ne-kosove-krijohen-zona-industriale-dhe-urbane/>

Serioze për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, edhe pse e ndaluar me ligj⁹¹, tanimë konsiderohet ndotja/dëmtimi/zënia e tokave bujqësore me mbeturina inerte, duke mos përjashtuar mbeturinat e rrezikshme në gjithë territorin e vendit⁹². Mbeturinat e të gjitha llojeve vazhdojnë të jenë të pranishme në mjedise urbane dhe në hapësira të gjelbëruara përgjatë rrugëve magjistrale. Nga hetimet e zhvilluara në rastin *Ex Officio* 12/2018,⁹³ lidhur me mosndërmarrjen e obligimeve pozitive nga organet kompetente për menaxhimin e mbeturinave të asbestit, u kuptua se ende asnjëra komunë, me përjashtim të Komunës së Mitrovicës, nuk ka bërë asnjë veprim në drejtim të menaxhimit të mbeturinave sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk i ka përcaktuar deponitë për deponimin e mbeturinave në fjalë, ato vazhdojnë të përhapen në mjedis pa trajtim dhe pa u penguar.

Neglizhenca e autoriteteve për zbatimin e parimit *ndotësi paguan*, parimit për rehabilitim dhe masa ndëshkuese të parapara në legjislacionin në fuqi, vetëm sa ka kontribuar në përkeqësimin e gjendjes.

Edhe pse trendin e ndërhyrjes pa kriter në sipërfaqe të pyllëzuara e ka ngadalësuar përfshirja e sipërfaqeve pyjore në kuadër të zonave të mbrojtura, dëmtimi i sipërfaqeve pyjore ka vazhduar edhe këtë vit, si: nga prerja e pyjeve, zjarret, ndërtimi ilegal dhe ndërtimi i rrugëve. Ripyllëzimi nuk arrihet të bëhet në proporcion të përafërt me degradimin e sipërfaqeve pyjore.

Në Raportin me rekomandime *Ex officio* 280/2016, i publikuar më 21 dhjetor 2018, Avokati i Popullit, në lidhje me cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës dhe të privatësisë, të drejtën për shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive, të drejtën e pronës, lirinë e lëvizjes së banorëve të komunës së Obiliqit dhe komunave të afërta që ndikohen nga problemi i njëjtë, theksoi çështjen e ndotjes së dheut në zonën e ish-objekteve industriale energjetike në lokacionin në afërsi të TC “Kosova A”, depozitimim e mbetjeve toksike të prodhimit (mbetjeve fenolike), deponimin e hirit të TC “Kosova A”, mbetjet nga punimet e vjetra minerare nëntokësore dhe ndotjen nga deponitë e egra.

Mbeturinat

E drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe e drejta për jetë e qytetarëve është duke u kufizuar seriozisht nga ndotja e vazhdueshme e hapësirave me mbeturina. Nuk është shënuar asnjë përmirësim në sistemin e menaxhimit të mbeturinave, në pengimin e hedhjes ilegale, dhe asnjë tentativë për ndarjen në burim dhe riciklimin e mbeturinave.

⁹⁰ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017, Toka (Dheu), fq. 71

⁹¹ Ligji nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore, neni 20, par. 20.3 “Ndalohet lëshuarja e lëndëve të dëmshme dhe të rrezikshme”.

⁹² Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017, “Mbeturinat” fq. 71. “Vetëm 60 % e mbeturinave deponohen në deponi”.

⁹³ <https://www.oik-rks.org/2018/11/07/ex-officio-nr-122018-raport-lidhur-me-mosnderrmarrjen-e-obligimeve-positve-nga-organet-kompetente-per-menaxhimin-e-mbeturinave-me-permbajtje-asbest/>

Fakti që vetëm 60%⁹⁴ e mbeturinave deponohet në deponi rajonale është tregues i mjaftueshëm që 40% e mbeturinave hidhen në tokë dhe lumenj. Sipas informatave, në territorin e vendit gjenden rreth 1572 të deponive ilegale⁹⁵.

Deponitë regionale të mbeturinave Mirash (Prishtinë), Dumnicë (Podujevë), Velekincë (Gjilan), dhe Landovicë (Prizren), përkundër obligimeve të dala nga Ligji nr. 02/L-30 për Mbeturina, për administrim të duhur të mbeturinave, duke krijuar kushte për zvogëlimin e rrezikshmërisë së mbeturinave, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit dhe të shëndetit të qytetarëve, vazhdojnë të operojnë me problemet si: mosfunksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë; kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara dhe mbulimi jo i mjaftueshëm i mbeturinave; shkarkimi i ujërave të pa trajtuara nga deponitë në tokë, në lumenj dhe depërtimi i tyre në ujëra nëntokësorë.

Serioze ka vazhduar të jetë gjendja e deponisë së Mirashit, duke pasur parasysh që mbeturinat e 7 komunave, komunës së Prishtinës, Drenasit, Podujevës, Gracanicës, Obiliqit dhe Fushë Kosovës shkarkohen në të. Kanë vazhduar problemet e njëjta, si: shpërndarja e papenguar e mbeturinave në ajër nga mosmbulimi i duhur; lirim i gazrave dhe kundërmim i vazhdueshëm nga mosmenaxhimi i duhur i mbeturinave, sidomos atyre organike; sistemi jofunksional i drenazhimit dhe i shkarkimit të gazrave. Mungesa e riciklimit të mbeturinave, përzjerja e mbeturinave inerte, të veçanta dhe të rrezikshme, medicinale, organike etj., kanë vazhduar edhe gjatë vitit raportues. Mosmenaxhimi i duhur i metanit dhe deponimi i thëngjillit në skajet e deponisë, paraqet rrezik të veçantë, të përhershëm për djege dhe rrezik për jetën dhe sigurinë e qytetarëve. Kullimi i ujërave të pa trajtuara nga deponia në lumin Sitnica dhe në ujërat nëntokësorë, nga mungesa e sistemit funksional të drenazhimit (sistemi i pompave është jashtë funksionit që nga viti 2007), përbën kërcënim serioz për ndotjen e ujërave në vend, sidomos duke pasur parasysh se 40% e mbeturinave të deponuara në deponi janë mbeturina organike, e po ashtu, deponohen mbeturinat e pa trajtuara medicinale dhe ato të rrezikshme⁹⁶.

Avokati i Popullit, në Raportin me Rekomandime *Ex officio* 280/2016⁹⁷, ngriti shqetësimin lidhur me gjendjen e deponisë së Mirashit dhe ndikimit në të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit konsideroi se gjendja e deponisë është duke e cenuar vazhdimisht të drejtën e jetës, të drejtën e privatësisë, të gëzimit të shtëpisë, dhe të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, dhe të drejtën për ujë të pijshëm për qytetarët. Në Raport është shqyrtuar edhe çështja e deponisë së hirit dhe ndikimit në të drejtat e njeriut.

⁹⁴ Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit, 2017, “Mbeturinat”, fq. 71.

⁹⁵ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës “Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë, Raport mbi gjendjen”, fq. 85.

⁹⁶ Hydrogeochemical analyses of the ground water in the Mirash landfill area and problem analysis Control report, GIZ 2016, M. Sc. Eng. Evelina Rathje dhe emisioni “Teta në Kosovë”, 24 maj 2018.

⁹⁷ Avokati i Popullit, më 21 dhjetor 2018, publikoi Raportin me rekomandime *Ex officio* 280/2016 në lidhje me cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës dhe të privatësisë, të drejtën për shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive, të drejtën e pronës, lirinë e lëvizjes së banorëve të komunës së Obiliqit dhe komunave të afërta që ndikohen nga problemi i njëjtë.

Shqetësuese vazhdon të jetë edhe mosarritja e organeve kompetente për të menaxhuar deponinë e Veleknicës në Gjilan, e cila, përveç problemeve të cekura më lart, ballafaqohet me mosarritjen e mbajtjes nën kontroll të deponisë nga hyrjet e personave të paautorizuar. Mosarritja e sigurimit të deponisë me rrethojë, e cila do ta pamundësonte hyrjen në deponi të personave të paautorizuar, ka rezultuar me kufizimin e së drejtës në jetë.

Shqetësim serioz me ndikim në të drejtën për jetë dhe në të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm është mosarritja e organeve kompetente për menaxhimin e materialeve me përmbajtje asbesti në vend. Avokati i Popullit, duke u bazuar në hetimet e iniciuara *EX Officio A. 12/2018*, ka konstatuar që organet kompetente nuk kanë arritur t'i përmbushin obligimet e tyre ligjore për menaxhimin e materialeve me përmbajtje asbesti brenda territorit të vendit. Përveç Komunës së Mitrovicës, asnjëra nga komunat nuk ka i caktuar lokacionet për deponimin e materialeve me përmbajtje asbesti, dhe as nuk ka ndërmarrë fushata vetëdijësuese me qytetarët lidhur me ndikimin e asbestit në jetën dhe shëndetin e qytetarëve⁹⁸. Avokati të Popullit ka konstatuar se, pavarësisht rrezikut që përbëjnë materialet me përmbajtje azbesti për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, si dhe ndikimi i tyre në mjedis, materiali në forma të ndryshme vazhdon të mbetet mjaft i pranishëm në hapësirat e hapura, i pa kontrolluar, i pa menaxhuar, pa masa parandaluese, që do ta evitonin ndikimin negativ në mjedis.

Projekti i filluar nga MMPH-ja për largimin e materialeve të asbestit në komunën e Hanit të Elezit, ka përfunduar duke e përkeqësuar gjendjen dhe duke e rritur mundësinë e ndikimit në mjedis dhe në shëndetin e qytetarëve, pasi që materialet të cilat ishin të vendosura në sipërfaqen e tokës, u nxorën mbi sipërfaqe, duke i lënë të hapura dhe pa asnjë masë mbrojtëse.⁹⁹

Po ashtu, nuk është filluar procesi i klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave, nuk janë caktuar lokacionet për deponimin e mbeturinave inerte dhe të rrezikshme. Deponitë e mbetjeve të N&D¹⁰⁰, të cilat përbëjnë 46% të 1572 deponive, vlerësohet se përbëjnë

⁹⁸ Raporti me Rekomandime Ex Officio 12/2018, lidhur me mosndërmarrjen e obligimeve pozitive nga organet kompetente për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti: “Avokati i Popullit gjen që sipas dokumentit të Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO), dhe të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), të publikuar në vitin 2007, që ka të bëjë me zhvillimin e programeve kombëtare për eliminimin e sëmundjeve të lidhura me asbest: “Ekspozimi ndaj asbestit shkakton asbestozë, pllaka pleurale, trashje dhe efusions, kancer të mushkërive, mesothelioma, laryngeal dhe ndoshta kanceret e tjera me periudha të ndryshme latente”. Ndërsa sipas dokumentit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, i publikuar në vitin 2014 “Eliminimi i sëmundjeve të lidhura me asbestin”, i cili shqyrton efektet negative të ekspozimit të asbestit në shëndet, vlerësohet se të paktën 107 mijë njerëz vdesin çdo vit nga kanceri në mushkëri, si rezultat i ekspozimit në asbestozë gjatë ushtrimit të profesionit”.

⁹⁹ Informatë e pranuar nga kryetari i komunës së Hanit të Elezit, 22 nëntor 2018, Tryeza “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”, tryezë e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Drejtësi “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”.

¹⁰⁰ Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës “Menaxhimi i Mbeturinave Komunale në Kosovë, Raport mbi gjendjen”, fq. 85, “Mbeturinat e N & D janë pjesa tjetër më e përfaqësuar e mbeturinave për të cilat mungon një sistem i ndarë për grumbullim. Në shumicën e rasteve ky lloj i mbeturinave përfundon i përzier me rrjedhën e mbeturinave komunale apo hidhet paligjshëm”.

kërcënim serioz për mjedisin. Këtë vit, aksioni “Ta pastrojmë Kosovën” ka ndihmuar pastrimin e pjesshëm të deponive ilegale.

Zhurma

Ligji i ri për mbrojtje nga zhurma, i cili do t’i garantonte qytetarëve mjedis të qetë, pa bezdi, nuk është arritur të miratohet as në vitin 2018. Ka vazhduar ndikimi i zhurmës në privatësinë dhe gëzimin e shtëpisë së qytetarëve, pa u arritur të vihet nën kontroll nga organet kompetente jo vetëm si rezultat i mosarritjes së zbatimit të ligjit, por edhe i mungesës së pajisjeve të zhurmës. Shqetësuese mbetet mungesa e vendosjes së paneleve për mbrojtje nga zhurma pranë vendbanimeve në autostrada. Në Raportin me Rekomandime 280/2016, Avokati i Popullit vlerësoi se mungesa e monitorimit kualitativ të zhurmës paraqet ndërhyrje në të drejtat e njeriut.

Zona e interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”

Një ndër problemet madhore të ndikimit të gjendjes së mjedisit në të drejtat e njeriut vlerësohet të jetë situata e banorëve të pa zhvendosur/shpronësuar të zonës me interes të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re”. Edhe pse gjendja e mjedisit është larg standardeve të dëshirueshme dhe normat e ndotjes, sipas raporteve ekzistuese, shpeshherë tejkalojnë kufijtë e lejuar të përcaktuar me legjislacionin vendor, përkundër obligimit pozitiv të shtetit, zhvendosja, shpronësimi apo lëvizja e një numri të konsiderueshëm të banorëve nga ato hapësira, si masë proporcionale dhe efektive për zgjidhjen e çështjes, që nga viti 2004, nuk është kryer. Vendimi për devijimin e vijës së mihjes duke tejkeluar pjesën e mbetur të fshatit Hade, ka lënë qytetarët në situatë *Limbo*, duke ua kufizuar të drejtën e tyre për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës, privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë/pronës dhe lirinë e lëvizjes. Po ashtu, dokumenti i quajtur Kontratë Administrative në mes të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Komunës së Obiliqit, me të cilin lokacioni “Hade e Re”, në fshatin Shkabaj, i jepet në menaxhim Komunës së Obiliqit, i vë në pozitë të pabarabartë banorët e pa zhvendosur të Hades me ata të cilët janë zhvendosur më herët, duke ua lënë të vetmen mundësi marrjen e truallit në fshatin Shkabaj.

Avokati i Popullit, në takimin e datës 4 korrik 2018, i mbajtur në Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjimore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione i Kuvendit të Kosovës, ngriti çështjen e të drejtave të njeriut për banorët e zonës së Shipitullës dhe Hades, duke vlerësuar se shteti duhet t’i balancojë interesat e zhvillimit ekonomik me respektimin e të drejtave të njeriut dhe, që çdo vendim për zgjidhjen e çështjes së zhvendosjes apo shpronësimit, duhet bazohet vetëm në ligj.

Avokati i Popullit, në Raportin me rekomandime 280/2016, lidhur me situatën e banorëve të zonës “Fusha e Mihjes së Re”, ka vlerësuar që shteti nuk ka arritur ta përmbushë obligimin e tij pozitiv të paraparë me Kushtetutë dhe ligje, karshi qytetarëve, për të respektuar të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën e jetës, privatësisë dhe gëzimit të shtëpisë/pronës etj., edhe lirinë e lëvizjes. Avokati i Popullit ka

konsideruar se banorët në fjalë janë vënë në pozitë të pabarabartë me qytetarët tjerë të Kosovës dhe që shteti, duke mos u përpjekur të gjejë zgjidhje konkrete për banorët, ka dështuar ta përmbushë obligimin pozitiv për të harmonizuar zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Të tjera

Qytetarët e vendit kanë vazhduar të ballafaqohen me mungesë të rregullimit të qëndrueshëm të hapësirës, që do t'u ofronte trajtim të barabartë, lëvizje të lirë, qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët, si dhe cilësi të lartë të jetesës. Planet rregulluese të hollësishme kanë vazhduar të mos i përfshijnë nevojat e të gjithë qytetarëve, nevojat e personave me aftësi të kufizuara, të të moshuarve, të fëmijëve, të rinjve¹⁰¹. Nuk është shënuar asnjë përmirësim i gjendjes së trotuareve/shtigjeve për këmbësorë, rrugëve, apo shtimit të shtigjeve për biçikleta.

Ka vazhduar ndërtimi i objekteve pa u respektuar parimet në vijim: lartësia e lejuar në raport me largësinë nga kufiri i parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike; përqindja e sipërfaqes së përgjithshme të shfrytëzueshme për shputën e ndërtesës në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale; përqindja e sipërfaqes së përgjithshme e gjelbërimit për absorbim të reshjeve atmosferike në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale; kërkesat minimale për vend parkingje; e drejta e ndriçimit natyror; kushtet e qasjes e adekuate në rrugë publike dhe infrastrukturë teknike; kufizimet e ndotjes mjedisore; dhe të zhurmës¹⁰², kushtet për mbrojtje nga zjarri, nga vërshimet, nga tërmetet etj. Nuk ka pasur asnjë përmirësim të mbikëqyrjes inspektive dhe inspektimit final.

Mosarritja e ndërtimit të objekteve sipas kritereve të parapara me Udhëzimin Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe mosndërmarrja e veprimeve për korrigjimin e gjendjes është tregues i dështimit të shtetit për respektimin e të drejtave të njeriut dhe të trajtimit të barabartë, pa diskriminim, të personave me aftësi të kufizuara¹⁰³.

Nuk është ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të përmirësimit të gjendjes së trotuareve, i cili do ta mundësonte lëvizjen e lirë dhe të papenguar të qytetarëve, në veçanti, të personave me aftësi të kufizuara, si dhe respektimin e së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Qytetarët kanë vazhduar të ballafaqohen me gjerësi të pamjaftueshme të trotuareve në krahasim me numrin e banorëve; lartësi jashtë normave të caktuara; mungesë të elementeve për qasje dhe të rampave, të cilat do ta mundësonin lidhjen pa ndërprerje në mes të niveleve të ndryshme të trotuareve; lidhjen me sipërfaqet publike pa pengesë si dhe qasjen në rrugët e qarkullimit kryesor; parregullsi në platformat ngritëse

¹⁰¹ Udhëzim Administrativ MMPH nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

¹⁰² Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, neni 21, “Kushtet e Ndërtimit”.

¹⁰³ Udhëzimi Administrativ nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.

vertikale etj. Të zbehta ngelin veprimet për zgjidhjen me kohë të rregullimin e gropave dhe të pusetave të dëmtuara. Nuk është arritur zgjidhja efektive e çështjes së zënies së trotuareve nga veturat, liritimit nga inventari hotelier, nga mallrat dhe materialit ndërtimor, të vendosura pa asnjë masë mbrojtëse apo shenjë paralajmërimi. Shqetësuese është mosndërmarrja e masave për përmirësimin e infrastrukturës pranë shkollave dhe kopshteve të fëmijëve, e cila do të garantonte të drejtën e jetës, shëndetit dhe sigurisë së fëmijëve.

Në veçanti, e drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe lëvizja e lirë e papenguar e qytetarëve të komunës së Prishtinës, ka vazhduar të kufizohet edhe gjatë vitit 2018, nga mosndërmarrja e veprimeve të organeve kompetente për përmirësimin e gjendjes në trotuare.

Me trend të njëjtë kanë vazhduar problemet e lidhjeve përmes nënkalimeve dhe mbikalimeve në vendbanime, duke penguar lëvizjen e lehtë, të sigurt, të shpejtë në rrugët magjistrale e rajonale. Në këtë situatë është duke ndikuar mospërfshirja e qytetarëve në dëgjime publike, si formë e vendimmarrjes në proceset e ndërtimit të rrugëve.

Avokati i Popullit, në Raportin me Rekomandime 280/2016, ngriti shqetësimin lidhur me kufizimin e lëvizjes së lirë të papenguar në pronë/shtëpi të familjes Morina, në fshatin Palaj të Obiliqit, prona e të cilëve gjendet brenda hapësirës së rrethuar nga KEK-u. Duke pasur parasysh që të gjithë anëtarëve të familjes, po ashtu edhe vizitorëve, qasja në pronë u kufizohet nga vendosja e laurës së kontrollës së sigurimit, 40-50 metra para shtëpisë së tyre, Avokati i Popullit konstatoi se, përveç kufizimit të lëvizjes së lirë të familjes në fjalë dhe vizitorëve të tyre nga kontrollat e bezdishme të përhershme në publik, u kufizohet edhe e drejta e privatësisë.

Problem serioz në sigurinë publike të pjesëmarrësve në komunikacion dhe ndotjen e mjedisit ka mbetur jo vetëm qarkullimi i papenguar i mjeteve të rënda motorike/mjeteve të punës, të cilat, si rezultat i mbingarkesës, bëjnë derdhjen e pakontrolluar të materialeve të ndërtimit, të dheut etj. në rrugë, e po ashtu edhe kyçja e tyre nga vend punishtet, pa asnjë masë preventive për të penguar përhapjen e baltës në rrugë magjistrale.¹⁰⁴ Përhapja e baltës apo papastërtisë në rrugë e cila ndikon në reduktimin e kushteve të fërkimit, duke shkaktuar humbje progresive të kontaktit në mes të gomës/ave dhe asfaltit, ndikon në rritjen e kohës së frenimit, gjithnjë duke ngritur mundësinë e rrezikut për aksidente.

Varrezat që hyjnë në kategorinë e infrastrukturës publike dhe sociale, vazhdojnë të mos i plotësojnë kriteret e përcaktuara.¹⁰⁵ Avokati i Popullit, më 25 tetor 2018, publikoi Raportin me Rekomandime në lidhje *Menaxhimi dhe mirëmbajtjen e varrezave në komunat e Republikës së Kosovës*. Raporti identifikon kriteret bazike që duhen plotësuar që varrezat të jenë të qasshme, të dinjitetshme dhe t'i plotësojnë kërkesat e qytetarëve,

¹⁰⁴ Ligji nr. 02/L-70 për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor “45.1. Shoferi i cili me mjet kyçet nga rruga e dheut në rrugë me shtresë bashkëkohore (asfalt) duhet ta ndal mjetin dhe ta heq baltin nga rrotat”.

¹⁰⁵ Udhëzim Administrativ MMPH nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, neni 1.6.

dhe të cilat është e nevojshme të adresohen nga autoritetet kompetente komunale në bazë të kompetencave të tyre ligjore, më qëllim të rregullimit dhe përmirësimit të gjendjes në menaxhimin e varrezave.

Tri parimet e Konventës Aarhus¹⁰⁶: pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje; qasja në informata mjedisore; dhe qasja në drejtësi, të cilat janë të integruara në legjislacionin mjedisor, vazhdojnë të jenë sfidë për qytetarët.

Pjesëmarrje e publikut në vendimmarrje, edhe pse e garantuar me Kushtetutë¹⁰⁷, ende vazhdon të bëhet me pengesa. Ka paqartësi me mënyrat e të ftuarit të publikut. Ftesa bëhet përmes mjeteve jo shumë të qasshme. Forma e aplikuar gjatë vitit 2018 për përfshirjen e publikut në vendimmarrje përmes pyetësorit elektronik lidhur me planin zhvillimor komunal vlerësohet si hap i suksesshëm në drejtim të integritimit të interesave nga vetë qytetarët. Debati lidhur me çështjen e ndërtimit të deponisë së mbeturinave të rrezikshme në fshatin Harilaq të Fushë Kosovës është përcjellë me mjaft paqartësi, mungesë informimi, duke nxitur pasiguri të banorët.

Edhe pse parimi i qasjes së publikut në informata mjedisore i garanton secilit person juridik ose fizik të drejtën për t'u informuar për gjendjen e mjedisit, informimi i publikut nuk ka shënuar asnjë përmirësim. MMPH-ja dhe komunat, në veçanti Komuna e Prishtinës, edhe pse të detyruara me ligj, përsëri kanë dështuar ta sigurojnë rregullisht, në çdo kohë, në mënyrë të plotë dhe objektive, informimin e qytetarëve për gjendjen e mjedisit, si dhe për masat paralajmëruese ose të shtrirjes së ndotjes që mund të paraqesin rrezik për mjedisin, shëndetin dhe jetën e njeriut. Mënyra e informimit të publikut nëpërmjet faqes zyrtare të AMMK-së lidhur me gjendjen e ajrit “Si mund të qaseni në të dhënat për cilësi të ajrit?”, konsiderohet joefektive dhe jo lehtë e qasshme¹⁰⁸. Raporti i fundit vjetor për gjendjen e mjedisit, i publikuar në faqen e AMMK-së është ai i vitit 2016.

Madje, MMPH-ja, po ashtu dhe komunat, edhe pse të obliguara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës që t'u përgjigjen kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'ia paraqesin atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara, rrallëherë ofrojnë informata të plota dhe kualitative lidhur me çështjet e ndryshme mjedisore. Përgjigjet e mangëta të institucioneve jo vetëm që pengojnë hetimet, japin bindjen përmes paqartësive se duan ta fshehin veprimin dhe mosveprimin e tyre lidhur me shkeljen. MMPH-ja, pa asnjë arsytim, nuk i ka ofruar Avokatit të Popullit informatat lidhur me raportin për hulumtimin e asbestit në të gjitha ndërtesat publike në komunën e Pejës dhe në komunën e Istogut, të OJQ “Pro Vitae”, dhe po ashtu nuk e ka bërë publike ashtu sikurse ka rekomanduar Avokati i Popullit përmes raportit me Rekomdime Ex Officio 12/2018.

¹⁰⁶ Konventa e Aarhus-it është miratuar në Konferencën e IV Ministrorë të mbajtur, më 23-25 qershor 1998, Kosova ende nuk është palë e Konventës, tri parimet e Konventës janë të integruara në gjithë legjislacionin mjedisor.

¹⁰⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 52.2, 2. “Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton”.

¹⁰⁸ Linku ‘<http://ihmk-rks.com/t/?page=1,5>’, në kohën e përpilimit të raportit ishte jashtë përdorimit.

Avokati i Popullit, në *Raportin me Rekomandime Ex Officio 280/2016*, ka vlerësuar që përmirësimi i qasjes në informata për fushën e mjedisit do të ndikonte në përmirësimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, duke rritur cilësinë dhe zbatimin e vendimeve, do të kontribuonte në ndërgjegjësimin e qytetarëve për çështjet e mjedisit dhe do t'u hapte qytetarëve mundësinë për t'i shprehur shqetësimet e tyre. Ligji për Qasje në Dokumente Publike, në nenin 12, përfshin informatat për mjedisin në mesin e arsyeve mbi bazën e të cilave mund të kufizohet e drejta e qasjes në dokumente publike.

Rastet mjedisore të iniciuara në prokurori dhe gjykata, si nga individë, po ashtu nga institucionet, vazhdojnë të trajtohen pa asnjë prioritet, në shumicën e rasteve duke u parashkuar dhe duke u hedhur poshtë. Sistemi i drejtësisë, përkundër gjendjes së rënduar mjedisore, nuk ka statistika lidhur me lëndët mjedisore, të cilat do të ishin tregues i numrit të tyre, dhe llojit të veprave. Mbeten të fuqizohen kapacitetet e prokurorëve dhe gjykatësve dhe Policisë së Kosovës me trajnime lidhur me trajtimin e lëndëve që dalin nga kapitulli XXVIII i Kodit Penal. Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës ende nuk kanë arritur ta ndërtojnë bazën e të dhënave lidhur me trajtimin e lëndëve kundër mjedisit. Me qëllim të diskutimit të arsyes së zvarritjes së lëndëve mjedisore në prokurori dhe gjykata, Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Institutin e Kosovës për Drejtësi, organizoi tryezën “Parandalimi dhe luftimi i problemeve të mjedisit”.

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShP), karshi ndotjes alarmante të ajrit¹⁰⁹, ujit dhe tokës¹¹⁰, përsëri nuk ka arritur ta përmbushë obligimin ligjor¹¹¹, për të dalë me një hulumtim mbi bazën e të dhënave relevante (Sistemi i Informimit shëndetësor-SISH ende nuk është funksionalizuar), i cili do të elaboronte ndikimin e ndotjes së mjedisit në jetën dhe shëndetin e qytetarëve dhe për sëmundjet si rezultat i ndotjes, dhe njëherësh do t'i propozonte masat parandaluese për eliminimin e mangësive.

Mosaplikimi i parimit *ndotësi paguan* dhe moszbatimi i dispozitave tjera të dala nga ligjet mjedisore ndaj shkaktarëve të dëmeve mjedisore sikur inkurajon individët, po ashtu edhe operatorët në veprime në drejtim të degradimit të mjedisit.

Edhe këtë vit nuk është vërejtur ndonjë përmirësim lidhur me bashkëpunimin e organeve kompetente në mbrojtje të mjedisit. Përkrah gjendjes alarmante në mjedis, nuk është shënuar hap i rëndësishëm në drejtim të koordinimit të veprimeve në mes të inspektorateve-Policisë së Kosovës - prokurorive dhe gjykatave. Ka vazhduar mosndërmarrja e veprimeve si nga institucionet e nivelit qendror, po ashtu edhe atij lokal në zgjidhjen e çështjeve sfiduese mjedisore, me arsyetimin për kompetencën negative.

¹⁰⁹ Po aty, neni 8, “IKShPK hulumton shkaqet dhe pasojat e aerndotjes që dëmtojnë shëndetin publik si dhe i propozon masat mbrojtëse”.

¹¹⁰ Po aty, neni 9, “IKShPK hulumton shkallën e kontaminimit të tokës, nga aspekti i kërcënimit të shëndetit publik në mënyrë direkte apo të tërthortë”.

¹¹¹ Ligji nr. 02/L-78, Ligji për Shëndetësi Publike, Kapitulli III Shëndeti Mjedisor dhe Banimi, neni 6.

E drejta e qasjes në dokumente publike

E drejta e qasjes në dokumente publike është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriu (DUDNj),¹¹² me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj),¹¹³ me Kushtetutën e Republikës së Kosovës¹¹⁴ dhe me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ndër parimet më të rëndësishme në botën demokratike njihen *transparenca* dhe *llogaridhënia*, që janë në funksion të qeverisjes së përgjegjshme dhe funksionale. Në funksion të transparencës, mjeti më i rëndësishëm është informimi dhe qasja në dokumente publike. Sipas standardeve ndërkombëtare, si dhe legjislacionit në fuqi, të gjitha informacionet që mbahen nga institucionet, si dhe dokumentet të cilat krijohen, grumbullohen, përpunohen, ruhen ose mbahen nga autoritetet publike, duhet të jenë publike dhe të qasshme për të gjithë, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Qasja në dokumente publike është e drejtë e garantuar, ndërkaq kufizimi duhet të jetë përjashtim.

E drejta e qasjes në dokumente publike nënkupton të drejtën që ka çdo person për të njohur përmbajtjen e dokumenteve që mbahen nga autoritetet publike, si dhe të drejtën e qasjes në informacione publike, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj. Kjo e drejtë përcakton dhe vendos rregulla për mirëfunksionimin dhe transparencën e administratës publike në raport me publikun, në lidhje me veprimtarinë e përditshme të saj.

Shumica e ankesave të pranuar në IAP-ja gjatë vitit raportues, lidhur me qasjen në dokumente publike, janë kryesisht kundër institucioneve publike në nivel qendror (figura 1).

¹¹² DUDNj, neni 19: “Gjithkush ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes; kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit pa ndërhyrje, si dhe lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë”.

¹¹³ Lirinë për të marrë dhe dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1, i KEDNj: “Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”.

¹¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 41.




Figura 1. Palët përgjegjëse në anekesat lidhur me QDP-në

Nga hetimet e zhvilluara për këto anekesa, vërehet mosklasifikimi i dokumenteve, mungesa e kapaciteteve të zyrtarëve përgjegjës në trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike, por edhe mungesa e vullnetit të institucioneve për zbatimin e ligjit, rezulton me shkeljen e së drejtës për qasje në dokumente publike. Për më tepër, vazhdon të mbetet problematike “shëtitja” e kërkuarve të dokumenteve nga një drejtori në tjetrën apo edhe premtimi se do t’u dorëzohet një dokument i kërkuar, i cili nuk u dorëzohet asnjëherë.

Megjithëse, përgjigjet e institucioneve për pranimin e kërkesës, shpeshherë, janë të shpejta dhe brenda afateve ligjore, vendimi për lejimin apo refuzimin e kërkesës, shumë shpesh nuk merret brenda afateve të parapara me ligj, përkundër rëndësisë së dhënies së shpejtë të informacioneve/dokumenteve. Gjithashtu, institucionet publike shpeshherë dështojnë të japin arsyetim të bazuar në ligj për moslejimin/kufizimin e qasjes.

Për më tepër, janë shqetësuese rastet kur Avokati i Popullit, në bazë të anekesave të pranuar, i drejtohet me rekomandime autoriteteve përgjegjëse¹¹⁵, por edhe pas pranimit të përgjigjes prej tyre, me të cilën shprehin gatishmëri për të vepruar sipas rekomandimit të Avokatit të Popullit, qasja në dokumentet e kërkuara nuk realizohet.¹¹⁶

Qarkullimi i lirë i informacionit është mjet i rëndësishëm që ndikon në ndërtimin e besimit mes institucioneve dhe qytetarëve në transparencë të veprimeve, në efikasitetin dhe efektivitetin e administratës publike. Ligji për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) parasheh një procedurë gjithëpërfshirëse të qasjes në dokumente publike dhe zbatimi i këtij ligji është i rëndësishëm në ndërgjegjësimin e administratës për detyrimin që ka në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, por edhe të qytetarëve për shërbimet që i pret nga administrata.

¹¹⁵ Anekesat nr. 823/2017 dhe nr. 58/2018 kundër Ministrisë së Infrastrukturës, Ankesa nr. 310/2018 kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme.

¹¹⁶ Deri në kohën e përpilimit të këtij raporti, përkundër rekomandimeve të AP-së, qasja e ankuesve në dokumentet e kërkuara nuk është realizuar.

Nga sa u tha më lart, zbatimi i LQDP-së në Kosovë, në praktikë përcillet me vështirësi të natyrave të ndryshme. Gjatë vitit 2018, në IAP janë paraqitur 61 ankesa që pretendojnë mohim të së drejtës për qasje në dokumente publike. Krahasuar me vitin paraprak, ka një rritje pothuajse të dyfishuar të ankesave që i referohen cenimit të nenit 41 të Kushtetutës së vendit. Përderisa në vitin 2017 ankesat lidhur me qasjen në dokumente publike përbënin 2% të të gjitha ankesave të trajtuara,¹¹⁷ ankesat e trajtuara në vitin 2018 përbëjnë 5% të tyre. Nga ankesat përkitazi me QDP, në periudhën 1.1.2018 deri 31.12.2018, prej gjithsej 61 ankesave të paraqitura, 56 janë hapur për hetim. Në 12 rastet kur edhe pas veprimeve të Avokatit të Popullit qasja nuk ka gjetur realizim, apo është e kufizuar, IAP-ja u është drejtuar me rekomandime autoriteteve përgjegjëse. Nga ankesat e pranuar, 11 ankesa janë nga OJQ-të, 6 ankesa janë nga gazetar/medie dhe të tjerat janë ankesa individuale. Prej 6 ankesave nga gazetarët/mediat, pas intervenimit të Avokatit të Popullit, 3 kanë siguruar qasje në dokumentin e kërkuar. Nga 11 ankesat e OJQ-ve, 6 kanë siguruar qasje pas intervenimit të IAP-së, 4 prej tyre jo, 1 ankesë është ende në proces. Nga numri i përgjithshëm i ankesave, në 7 ankesa nuk janë gjetur shkelje, d.m.th. është vepruar në pajtim me dispozitat ligjore.

Nga të gjeturat e IAP-së gjatë hetimit të ankesave të paraqitura për qasje në dokumente publike vërehet se vështirësi në realizim të qasjes në dokumente publike më së shumti ka në kontrata publike për projekte të mëdha. Organizatat joqeveritare dhe mediat janë ato që kanë pasur kërkesa të tilla, përderisa ankesat e qytetarëve kryesisht kanë qenë të lidhura me kërkesa përkitazi me procedura të rekrutimit.

Si e drejtë kushtetuese, e drejta për qasje në dokumente publike megjithatë nuk është e drejtë absolute. Ajo duhet të jetë e mbrojtur në mënyrë proporcionale dhe e balancuar me të drejtat tjera. Në hetimet e zhvilluara për ankesat e pranuar gjatë vitit 2018, përkitazi me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike, vërehet se gjendja vazhdon të jetë e njëjtë me vitin paraprak. Edhe më tutje vërehet se institucionet shtetërore, mbajtëse, hartuese apo pranuese të informacioneve, në shumicën e rasteve nuk i kanë klasifikuar me kohë dokumentet, ose nuk i kanë klasifikuar fare, ashtu sikurse e parasheh Ligji nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë dhe Ligji nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Mungesa e klasifikimit të dokumenteve, për pasojë ka shpeshherë vendime arbitrare mbi lejimin ose jo të dokumenteve të kërkuara. Për më tepër, kjo ndikon edhe në respektimin e afateve të parapara me ligj.¹¹⁸ Avokati i Popullit ua rikujton autoriteteve që, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, ta bëjnë klasifikimin e dokumenteve që në momentin kur prodhohet informacioni, sepse, vetëm kështu do të shmangej vendimi i atypëratyshëm kufizimi apo refuzimi eventual dhe gjithsesi do të lehtësohej procesi i trajtimit të kërkesave që drejtohen në institucione për qasje në dokumente publike.

¹¹⁷ Raporti vjetor 2017 nr.17 i Institucionit të Avokatit të Popullit, faqe 230, figura 7.

¹¹⁸ Ankesa nr. 86/2018 kundër MPMS; Ankesa 542/2018 kundër MASHT; Ankesa 554/2018 kundër MTI; Ankesa 569/2018 kundër MI; Ankesa 678/2018 kundër MPB; Ankesa 747/2018 kundër MIE.

Avokati i Popullit vëren se Projektligji për Qasjen në Dokumente Publike është miratuar në parim, më 23 korrik 2018, dhe pret të procedohet më tej, sipas procedurave të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Të drejtat e fëmijëve

Gjendja e të drejtave të fëmijëve

Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të fëmijëve vazhdon të mbetet sfidë në Kosovë. Në vitet e fundit janë ndërmarrë hapa të shumtë në avancimin e kornizës ligjore dhe politikave në mbrojtje të fëmijëve. Mirëpo, zbatimi në praktikë vazhdon të mbetet joadekuat dhe i ngadalshëm.

Fëmijët dhe mirëqenia e tyre do të duhej të jenë prioritet nga institucionet duke zbatuar legjislacionin dhe duke ndarë burime financiare për ta mundësuar këtë. Në veçanti, është e nevojshme dhënia e vazhdueshme e mbështetjes financiare qendrave të kujdesit ditor, në mënyrë që fëmijët me aftësi të kufizuara të marrin shërbimet e nevojshme për trajtim, rehabilitim dhe riintegrim. Po ashtu, mbeten të pa adresuara çështjet lidhur me fëmijët në situatë rruge, që jetojnë në kushte të rënda sociale, nuk shkojnë në shkollë dhe shpeshherë janë subjekt i formave të ndryshme të dhunës, abuzimit dhe shfrytëzimit.

Kosova ende nuk ofron shërbime përkatëse për fëmijët viktime të abuzimit me substanca narkotike dhe familjet e tyre. Institucionet shtetërore duhet të hartojnë programe parandaluese dhe të ofrojnë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe ndihmën e fëmijëve, përdorues të substancave narkotike, në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre. Këto programe duhet të hartohen pas konsultimeve me akterë kyç, duke inkuadruar edhe zërin e fëmijëve dhe duke pasur gjithmonë parasysh interesin më të mirë të fëmijës. Adresimi, bashkërendimi i punës dhe ndërmarrja e veprimeve përkatëse janë obligime ligjore të institucioneve kosovare për të siguruar që të drejtat e fëmijëve të respektohen, të mbrohen dhe të zbatohen.

Korniza ligjore dhe të drejtat e fëmijëve

Hapi i parë pozitiv ka qenë krijimi i kornizës së mirëfilltë ligjore si bazë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Në masë të madhe kjo kornizë është në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe mbështetet fuqishëm në Konventën për të Drejtat e Fëmijës (KDF), si instrumenti më i rëndësishëm ndërkombëtar dhe më gjithëpërfshirës në këtë fushë. Sidoqoftë, kjo fushë është e rregulluar me ligje, akte nënligjore dhe politika të ndryshme. Fragmentimi i ligjeve për këtë fushë kontribuon në paqartësi dhe pasiguri juridike. Për të adresuar këtë zbrastëri ligjore, në vitin 2013 filloi procesi i përpilimit të Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Deri më tani Projektligji ka kaluar përmes konsultimeve të hollësishme me institucionet vendore, ndërkombëtare dhe shoqërisë civile. Avokati i Popullit bashku me KOMF-in, UNICEF-in, si dhe me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, ia ka dërguar rekomandimet e tij Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione. Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP-ja, përveç se ishte pjesë e shqyrtimit të këtij Projektligji në disa takime, më 29 tetor 2018, mori pjesë në dëgjimin publik lidhur me të. Sidoqoftë, Projektligji vazhdon të mbetet në Kuvend në procedurë shqyrtimi dhe korniza ligjore është ende e paplotësuar. Mirëpo,

përveç hartimit dhe miratimit të ligjit, është më se e nevojshme zbatimi adekuat dhe i plotë. Kuvendi i Kosovës duhet t'i ndër marrë veprimet e nevojshme që Projektligji të miratohet pa vonesa të mëtejme. Ai duhet edhe ta ndaj buxhetin e duhur për implementimin dhe funksionalizimin e ligjit.

Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve

IAP-ja gjatë këtij viti raportues ka shqyrtuar 46 ankesa, 35 prej të cilave janë hapur si raste për hetim, ndërsa 11 janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bëjnë ato kanë qenë jashtë juridiksionit të IAP-së, nuk ka shkelje të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike, ndërsa Avokati i Popullit ka filluar hetimet në 18 raste sipas detyrës zyrtare.

E drejta e fëmijëve në arsim

Rastet pranë IAP-së lidhur me të drejtën në arsim të cilat janë hetuar, duke përfshirë edhe rastet e filluara sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: mungesën e kushteve elementare për mësim në shkollë;¹¹⁹ vështirësitë dhe pengesat për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor; sigurimin e transportit të vajzave dhe djemve për të vijuar procesin mësimor;¹²⁰ realizimin e së drejtës për arsimim universitar për personat e mitur dhe madhorë që janë në vuajtje të dënimit;¹²¹ vështirësitë në transferimin e nxënësve nga një shkollë në shkollën tjetër; kushtëzimi i dhënies së diplomës me të holla me pretendimin për riparimin e shkollës; detyrimin për nxënës të cilët i nënshtrohen Provimit të Maturës Shtetërore për të kryer pagesën e nevojshme për vazhdim të mësimi;¹²² mospërgjigje në ankesë;¹²³ sigurinë dhe përdorimin e dhunës ndaj fëmijëve;¹²⁴ edukimin e të rinjve në relacion me kërkesat dhe nevojat e tregut të punës; çështjet e fuzionimit dhe bartjes së nxënësve nga një shkollë në shkollën tjetër; dhe mosarritjen e regjistrimit të nxënësve në shkollë. Nga 29 raste të pranuar, 19 kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, prej tyre 11 janë zgjidhur sipas kërkesës së ankuesve, ndërsa të tjerat mbesin duke u hetuar. Katër raste të pranuar nga viti i kaluar, që kishin të bënin me nevojën për transport për të vijuar mësimet në shkollë, gjendje të rëndë ekonomike si dhe mbarëvajtjen në procesin mësimor në shkollë, janë përfunduar me sukses.

Një nga këto raste kishte të bënte me Provimin e Maturës Shtetërore. Komisioni Shtetëror i Maturës, duke u mbështetur në nenin 8 dhe 9 të Ligjit nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore (në tekstin e mëtejme *Ligji nr. 05/L-018*), më 16 maj 2017, nxori vendim ku përcaktonte si kriter shtesë dhe i obligonte të gjithë nxënësit që ta bëjnë pagesën prej 5 eurosh në bankë për t'iu nënshtuar Provimit të Maturës. Mospagesa e

¹¹⁹ IAP, rasti ex officio nr.127/2018 dhe nr. 315/2018.

¹²⁰ IAP, rasti ex officio nr.234/2018.

¹²¹ IAP, ankesa nr. 493/2018 dhe nr. 694/2018.

¹²² IAP, rasti ex officio nr.427/2017.

¹²³ IAP, ankesa nr.484/2017.

¹²⁴ IAP, rasti ex officio nr.279/2018.

provimit përkthehej në pamundësi për t'iu nënshtruar provimit. Rasti nr. 412/2017 është hapur më 21 qershor 2017, sipas detyrës zyrtare nga Avokati i Popullit, me qëllim të vlerësimit nëse ky Vendim është në pajtim me parimin e sundimit të ligjit dhe ligjshmërinë. Në rastin konkret, Avokati i Popullit vërejti se Ligji nr. 05/L-018, më saktësisht nenin 16, ka përcaktuar një listë shteruese, e cila nuk lë hapësirë për të shtuar kritere shtesë, siç është bërë me vendimin e lartcekur. Pas vlerësimit, Avokati i Popullit konstatoi se vendimi për pagesën e Provimit të Maturës i shkel të drejtat dhe liritë e njeriut. Vendimi ishte në kundërshtim me parimet bazë të funksionimit të shtetit demokratik: parimin e ligjshmërisë, parimin kushtetues të sundimit të ligjit dhe parimin e sigurisë juridike, sepse nuk ekziston bazë ligjore në Ligjin nr. 05/L-018, për nxjerrjen e një vendimi të tillë. Në bazë të analizës, vlerësimeve dhe konstatimeve, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MAShT) që, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e legjisllacionit përkatës në fuqi, ta shpallë të pavlefshëm Vendimin për pagesën e Provimit të Maturës Shtetërore, i datës 16 maj 2017, me nr. 2-1843, i nxjerrë nga Komisioni Shtetëror i Maturës. MAShT-i e ka respektuar rekomandimin e Avokatit të Popullit dhe, më 4 maj 2018, IAP-ja është informuar se është nxjerrë vendimi i ri për lirim nga pagesa.

Fëmijët në Kosovë ende përballen me mungesën e kushteve elementare në shkolla gjersa renovimi dhe mirëmbajtja e objekteve shkollore mbetet problematike. IAP-ja, sipas detyrës zyrtare, filloi hetimet në komunën e Deçanit bazuar në informatat e siguruar nga shkrimi i gazetës “Koha Ditore”, me titull: “*Shkolla e Maznikut prej 17 vjetësh pa asnjë investim*”. Përfaqësuesi i IAP-së vizitoi objektin e shkollës ku vërejti se shkolla në fjalë nuk ofronte kushte adekuate për zhvillimin e procesit mësimor, pikonte çatia në klasa kur binte shi dhe borë. Zhvillimi i mësimi në kushte të tilla, përveç cenimit të së drejtës për arsim, nxënësve ua rrezikonte edhe të drejtën për jetë, shëndet dhe mirëqenie sociale. IAP-ja i kishte rekomanduar Komunës së Deçanit që urgjentisht t’i ndër marrë veprimet përkatëse për renovimin e objektit të shkollës. IAP-ja ende nuk ka pranuar përgjigje përkitazi me këtë çështje.

Gjithashtu, lidhur me mungesën e kushteve elementare për mësim, IAP-ja, sipas detyrës zyrtare, zhvilloi hetimet duke u nisur nga informatat e siguruar nga shkrimi i gazetës “Koha Ditore”, me titull: “*Objekti i dëmtuar rrezikon nxënësit dhe personelin arsimor*”, në fshatin Bellopojë. Përfaqësuesi i IAP-së, në vizitën e realizuar lidhur me rastin, kishte vërejtur se objekti i shkollës nuk ofronte kushtet elementare për mësim, për shkak të rrëshqitjes së dheut dhe dëmtimit të mureve të klasave dhe tualeteve, gjë që përbënte rrezik për shëndetin dhe për jetën e fëmijëve. Pas ndërmjetësimit të IAP-së, Komuna e Podujevës bëri renovimin e shkollës. Gjithashtu, pas ndërmjetësimit të IAP-së, në një rast tjetër të hapur po ashtu sipas detyrës zyrtare, bazuar në informatat e siguruar nga portali “Kallxo.com”, me titull: “*Në shkollë me barka të vjetra*”, nxënësve të një shkolle në fshatin Orllan, autoritetet komunale në Podujevë ua kanë siguruar transportin për të udhëtuar nga shtëpia për në shkollë dhe anasjelltas.

Dhuna dhe gjendja e sigurisë në shkolla

Gjatë kësaj periudhe raportuese, IAP-ja ka zhvilluar hetime për katër raste, të hapura sipas detyrës zyrtare.¹²⁵ Njëri nga këto raste kishte të bënte me pohimet e nxënësve të një shkolle fillore për ngacmim seksual, dhunë fizike dhe ofendim. Pas përfundimit të hetimeve, IAP-ja u njoftua se autoritetet shkollore kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme për trajtimin e rastit, përkatësisht lidhur me pohimet e nxënësve për dhunë fizike dhe ofendim, disa mësimdhënës kanë marrë vërejtje me gojë dhe me shkrim, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, ndërsa sa i përket dyshimit për ngacmim seksual, rasti është proceduar në organet e hetuesisë. Edhe në një rast tjetër lidhur me pretendimet për ushtrim të dhunës fizike nga arsimtari ndaj nxënësit, pas hetimeve të kryera, rezultoi se autoritetet komunale dhe policore i kanë ndërmarrë veprimet e nevojshme dhe se rasti është duke u hetuar në Prokurorinë e Shtetit, ndërsa nxënësi i cili është përfshirë në këtë rast është kthyer në shkollë dhe është duke e vijuar mësimin me rregull.

Gjithashtu, një rast tjetër kishte të bënte me pretendimet e një nxënësi për trajtimin fyes dhe poshtërues të nxënësve nga një mësimdhënës dhe për mospërgjigje në ankesat e tyre nga Drejtoria Komunale e Arsimit si dhe nga Inspektorati i Arsimit.¹²⁶ IAP-ja konstatoi se institucionet përkatëse kishin ndërmarrë veprimet e nevojshme për trajtimin e rastit, përkatësisht mësimdhënësit i është ndërruar vendi i mbajtjes së orëve të mësimin, rasti është zgjidhur pozitivisht sipas kërkesës së ankuesit.

Në relacion me nevojën e respektimit dhe promovimit të të drejtave të fëmijëve, edhe të të drejtës për mbrojtje nga dhuna, IAP-ja, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, vazhdoi me fushatën informuese “*Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit*”. Ajo u zhvillua në 26 shkolla, në regjione të ndryshme të Kosovës, për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollave fillore dhe të mesme,¹²⁷ e cila kishte për qëllim vetëdijesimin e mësimdhënësve dhe nxënësve, përveç tjerash, edhe për domosdoshmërinë e parandalimit të ndëshkimit trupor nëpër shkolla.

Ndërsa sa i përket sigurisë në shkolla, IAP-ja, gjithashtu sipas detyrës zyrtare, zhvilloi hetimet duke u nisur nga informatat e siguruara nga shkrimi i gazetës “Koha Ditore”, me titull: “*Prindërit ankohen për pasiguri në komunikacion afër shkollave*”. Avokati i Popullit i dërgoi letër Komunës së Pejës, ku kërkoi informata lidhur me çështjen. IAP-ja është informuar se Komuna e Pejës është duke e vlerësuar çështjen dhe se deri në shtator të vitit 2018, do të vendosen policët e shtrirë afër tri lokacioneve, nga Shkolla Fillore “Xhemail Kada” e deri te Shkolla e Mesme Ekonomike. Pas komunikimeve të vazhdueshme me autoritetet komunale të Pejës, IAP-ja, më 29 tetor 2018, është njoftuar se është zgjedhë operatori ekonomik, i cili së shpejti do t’i vendosë policët e shtrirë në lokacionet në fjalë.

¹²⁵ IAP, rastet: ex officio nr. 128 /2018, 279/2018 dhe 762/2018.

¹²⁶ IAP, A. nr. 905/2017.

¹²⁷ Lidhur me fushatën shihni pjesën për aktivitetet e DMDF.

Duke u nisur nga informatat e siguruar në media dhe gjatë takimit me nxënës, rezulton se duhet edhe me shumë të punohet në parandalimin e dhunës nëpër shkolla. Në këtë drejtim institucionet shtetërore duhet të ndërmarrin masat përkatëse, përfshirë edhe hartimin e planeve konkrete, përveç tjerash, për ta parandaluar dhe adresuar dhunën në shkolla.

Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë vazhdojnë të përballen me vështirësi të shumta në të gjitha fushat e jetës. Këtë vit, lidhur me këtë çështje, IAP-ja ka hapur katër raste të reja, dy sipas detyrës zyrtare. Njëri rast i iniciuar sipas detyrës zyrtare ka të bëjë me vështirësitë e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, përkatësisht për mungesë të planeve individuale për mësim dhe mosdiagnostifikim përkatës të aftësisë së kufizuar, për shkak të mosdhënies së pëlqimit nga prindërit. Ndërsa rasti tjetër ka të bëjë me hetimin e informatave se nga përfaqësues të MASHT-it, MPMS-së dhe të Ministrisë së Drejtësisë është vendosur që të rrënohet Qendra për arsim dhe këshillim për nxënësit e verbër dhe gjysmë të verbër në Pejë, për ta ndërtuar në vend të saj objektin e gjykatës.

Në një rast tjetër, i iniciuar nga ankesat e parashtruara nga prindër/përfaqësuese e OJQ-së, IAP-ja ndërmjetësoi tek autoritetet komunale si dhe udhëzoi nënën për veprimet që duhej t'i ndërmerre në mënyrë që fëmija i saj të pranohej në institucionin parashkollor. Në një rast tjetër të vitit të kaluar, lidhur me mospësigurimin e asistentit personal për mësimnxënie në shkollë për një fëmijë, si dhe sigurimin e transportit, IAP-ja kishte vazhduar ndërmjetësimin me përfaqësues të Komunës së Prishtinës, të cilët kishin siguruar transportit. Ndërsa sa i përket angazhimit të asistentit personal për mësimnxënie, ata kanë pohuar se, fillimisht duhet të bëhet vlerësimi profesional i fëmijës për nevojat e veçanta arsimore-edukative, i cili bëhet me kërkesën apo bashkëpunimin dhe miratimin e prindërve, kur kërkesa bëhet nga institucioni. Sipas Ligjit nr.04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, procedura e vlerësimit nga ekipi profesional¹²⁸ mund të fillohet me kërkesën e ndonjë prindi apo institucioni arsimor a aftësues me pëlqimin e prindit. Pas vlerësimit të rrethanave dhe informatave të siguruar doli se vështirësitë për ofrimin e mbështetjes përkatëse fëmijëve për arsimim gjithëpërfshirës, mospërpilimi dhe moszbatimi adekuat i planeve individuale shkaktohen edhe për arsye të hezitimit të prindërve për të dhënë pëlqimin apo për të kërkuar vlerësimin profesional të fëmijëve të tyre, kur kjo bëhet nga institucioni. Natyrisht një gjë e tillë nuk i liron institucionet përkatëse nga detyrimet për veprim, që edhe për rastet e tilla të gjejnë mënyrat më të mira, për t'i bindur prindërit se vlerësimet që kërkohen të bëhen janë në interesin më të mirë të fëmijëve për arsim gjithëpërfshirës. Angazhimin dhe pagesën e profesionistëve/asistentëve për të ndihmuar fëmijët e tyre për mësimnxënie vazhdon të mbetet barrë ekonomike e familjeve. Mirëpo, jo të gjitha familjet e kanë këtë

¹²⁸ Nga informatat e siguruar nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe e Teknologjisë del se janë themeluar dhe funksionalizuar ekipet vlerësuese në 24 komuna.

mundësi, prandaj edhe shumë fëmijë mbesin pa ndihmën e nevojshme për mësim, gjë që zvogëlon mundësitë për mësim adekuat. Natyrisht një gjë e tillë ndikon dhe vështirëson mësimnxenien edhe për nxënësit e tjerë dhe për mësimdhënësit. Aq më tepër, në shumë shkolla nuk ka infrastrukturë adekuate shkollore, e cila do t'u mundësonte atyre qasje të lehtë dhe pa pengesa. Këto çështje mbeten shqetësuese dhe kërkojnë adresim dhe prioritet nga institucionet shtetërore, në pajtim me detyrimet ligjore. Sidoqoftë, IAP-ja i vlerëson pozitivisht deklaratat e përfaqësuesve të MAShT-it se për vitin 2019, në kuadër të grantit specifik, MAShT-i do të angazhojë 100 asistentë personalë për fëmijët me aftësi të kufizuara, gjë që do të ndihmojë përmirësimin e situatës për mësim gjithëpërfshirës.¹²⁹

Edhe në fushën e shëndetësisë fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me vështirësi sa i përket realizimit të së drejtës për shërbime shëndetësore cilësore dhe pa pagesë.¹³⁰ Jo gjithëherë institucionet shëndetësore sigurojnë barnat falas dhe pajisje të tjera që do t'u mundësonin përmirësimin e shëndetit dhe jetë me dinjitet. Përfshirja dhe sigurimi i shërbimeve sociale në komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara ka nevojë për mbështetje të vazhdueshme. Autoritetet përkatëse arsimore, shëndetësore dhe të mirëqenies sociale duhet t'i ndër marrin veprimet përkatëse, përfshirë edhe mbështetjen materiale, ndarjen e buxhetit adekuat për të përmirësuar gjendjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, për të siguruar gjithëpërfshirjen e tyre në procesin arsimor, sigurimin e rregullt të barnave, pajisjeve dhe materialeve si dhe dhënien e shërbimeve adekuate trajtuese, rehabilituese dhe riintegruese.

Fëmijët në situatë rruge

Fëmijët në situatë rruge përbëjnë grupin e fëmijëve më të cenusshëm, të cilët hasen edhe në rrugët e Kosovës. Këta fëmijë i shohim në rrugë vetëm apo në grupe duke pastruar xhamat e automjeteve, duke shitur gjësende të imëta, duke kërkuar nëpër kontejnerë apo lëmshë, përveç tjerash. Përfshirja e tyre në këto aktivitete ua dëmton shëndetin, zhvillimin dhe mirëqenien, i vë në rrezik të ekspozimit ndaj dhunës, eksploatimit dhe trafikimit, gjë që është shqetësuese dhe kërkon adresim adekuat nga institucionet shtetërore. Pavarësisht prezencës së tyre, në Kosovë nuk ka të dhëna të plota zyrtare lidhur me numrin e vajzave dhe djemve në situatë rruge. Kjo mungesë e të dhënave i bënë këta fëmijë të padukshëm, pa mundësi të gëzimit të të drejtave të garantuara me legjislacionin në fuqi dhe e vështirëson punën e institucioneve shtetërore në zhvillimin e politikave adekuate dhe frytdhënëse për mbrojtjen e tyre. Avokati i Popullit është duke zhvilluar hetimet lidhur me këtë çështje dhe është në proces të sigurimit të informatave të mëtutjeshme të nevojshme.

Të rinjtë/fëmijët viktima të abuzimit me substanca narkotike

Në Kosovë, deri vonë, nuk ka pasur studime gjithëpërfshirëse lidhur me përdorimin e drogave, ndonëse studime të pjesshme dhe shërbime të ndryshme parandaluese e

¹²⁹ Informatat e siguruar në konferencën e organizuar nga KOMF-i, më 18 tetor 2018, përveç tjerash.

¹³⁰ IAP, rasti Anr. 504/2018.

rehabilituese janë ofruar nga organizata të ndryshme joqeveritare. Duke u nisur nga informatat e siguruara se numri i përdoruesve të substancave narkotike po vjen duke u rritur, ndërsa është shtuar numri i përdoruesve të moshës më të re, IAP-ja ka filluar hetimet sipas detyrës zyrtare.¹³¹ Nga takimet e realizuara me disa nga përfaqësuesit e institucioneve dhe organizatave që punojnë në mbrojtjen e fëmijëve po edhe në dhënien e shërbimeve personave viktimë të abuzimit me substanca narkotike, rezultoi se duhet bërë shumë në këtë drejtim nga e tërë shoqëria për adresimin adekuat të çështjes. Në Kosovë ka mungesë të qendrave të specializuara për trajtimin e përdoruesve të substancave narkotike, e veçanërisht për të rinjtë. Shërbimet përkatëse të trajtimit, rehabilitimit dhe riintegritimit për fëmijët përdorues të substancave narkotike janë themelore në adresimin e këtij problemi. Po ashtu, duhet të krijohen programe të përshtatshme për vetëdijësimin e të rinjve. Problemi duhet të adresohet në thelb dhe jo vetëm simptomat e tij, është e domosdoshme që të konsultohen edhe vetë të rinjtë lidhur me situatën e krijuar dhe arsyet të cilat i shpijnë ata tek përdorimi i drogave.

Të drejtat e fëmijëve në procedurat pranë organeve gjyqësore dhe administrative

Edhe gjatë kësaj periudhe të raportimit, në IAP janë pranuar një numër i ankesave kundër gjykatave, që kanë të bëjnë me zvarritje të procedurës gjyqësore për të vendosur lidhur me besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim, mosrealizimin e kontakteve personale të fëmijës me prindin,¹³² kontestin administrativ për mbështetje materiale për familjen me fëmijë me aftësi të kufizuara. Lidhur me mosrealizimin e kontakteve apo pamundësinë e realizimit të kontakteve të rregullta me fëmijë, në IAP janë pranuar ankesa edhe kundër qendrave për punë sociale.¹³³ Në rastin e ankesave kundër gjykatave, IAP-ja u është drejtuar gjykatave nga të cilat ka kërkuar ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme, në mënyrë që fëmijët të mund t'i realizojnë të drejtat e tyre, të garantuara edhe me KDF. Gjykatat do të duhej t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që rastet që kanë të bëjnë me fëmijë apo prekin të drejtat e fëmijëve të vendosen pa vonesa, brenda afateve të përcaktuara ligjore, në mënyrë që të mos dëmtohet apo rrezikohet shëndeti i fëmijëve, mirëqenia apo edhe jeta e tyre. Ato gjithashtu do të duhej t'i ndërmarrin të gjitha veprimet që interesi më i mirë i fëmijëve të jetë parësor gjatë punës së tyre lidhur me fëmijët, përfshirë këtu edhe respektimin e së drejtës së fëmijëve për t'u dëgjuar, sipas nenit 3 dhe 12 të KDF-së. Ndërsa në rastin e ankesave kundër qendrave për punë sociale, IAP-ja, pas hetimit të tyre, ka konstatuar se qendrat për punë sociale i kanë ndërmarrë veprimet përkatëse .

¹³¹ IAP, rasti Ex officio nr.489/2018.

¹³² IAP, rastet: A.nr. 700/2018, A.nr. 810/2018, A.nr. 776/2018, A.nr. 457/2018.

¹³³ IAP, rastet: A.nr.834/2018, A.nr. 626/2018, A.nr.725/2018,A.nr. 96/2018.

Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve

IAP gjatë kësaj periudhe raportuese nga fusha e mbrojtjes sociale dhe shëndetësore ka filluar dhe hetuar 3 raste të reja, përfshirë edhe raste sipas detyrës zyrtare,¹³⁴ të cilat i referohen të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu ka hetuar dhe përfunduar edhe 9 raste të pranuar në vitin 2017. Rastet kishin të bënin, ndër të tjera, me: mosdhënie të ndihmës sociale;¹³⁵ gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale;¹³⁶ mospërkrahje financiare për trajtimin shëndetësor;¹³⁷ pamundësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara që të marrin shërbime sociale dhe familjare në disa nga qendrat e kujdesit ditor, për shkak të mbylljes së tyre;¹³⁸ dhe mos kompensim material shëndetësor. Një numër i tyre janë zgjedhur në të mirë të ankuesve, përfshirë këtu edhe 5 raste të pranuar në vitin 2017.

Një nga ankesat e hetuara sipas detyrës zyrtare në fushën sociale ka të bëjë me çështjen e ndarjes së ndihmës sociale familjeve që kanë fëmijë nën moshën pesëvjeçare.¹³⁹ Avokati i Popullit vëren se zbatimi i nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për skemën e ndihmës sociale në Kosovë, ka shkaktuar që shumë familje në gjendje të rëndë materiale, të mbesin edhe pa ndihmën sociale, të cilën e gëzonin deri në momentin kur fëmija mbush pesë vjet. Pavarësisht faktit që janë bërë ndryshime në nenin 4 të Ligjit nr. 2003/15, kjo në fakt nuk e ka përmirësuar gjendjen e familjeve të varfra për faktin e kufizimit të moshës së fëmijëve. Për më tepër, kushtet e përcaktuara për ndihmë sociale, me dispozitat ligjore në fuqi, kanë ndikuar në keqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familjeve, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në mirërritjen e fëmijëve dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi. Këto kushte në veçanti e vështirësojnë gjendjen tek familjet në rrethana të vështira socio-ekonomike, e kjo sidomos vlen për komunitetet e marginalizuara.

Avokati i Popullit vëren se neni 4 i Ligjit, përtej çdo dyshimi, shkel interesin më të mirë të fëmijës, madje mungesa e ndihmës sociale për fëmijë dhe familje në nevojë kushtëzon dhe ndikon në shëndetin fizik dhe mental të fëmijës, si dhe në edukimin e zhvillimin e mëtutjeshëm të tij. Avokati i Popullit, në pajtim me gjetjet e theksuara në raport, konstaton se neni 4 i Ligjit, është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me standardet ndërkombëtare, veçmas me KDF-në, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës.

Në bazë të analizës, të vlerësimeve dhe të konstatimeve, Avokati i Popullit i rekomandoi Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshimin e nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, në mënyrë që kufizimi i moshës pesëvjeçare i fëmijës, të ngrihet në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, në pajtim me nocionin e termit “fëmijë”

¹³⁴ IAP, Ex officio nr. 400/2018.

¹³⁵ IAP, Ankesa nr. 483/2017.

¹³⁶ IAP, Ex-officio nr. 272/2017.

¹³⁷ IAP, Ex-officio nr. 479/2017.

¹³⁸ IAP, Ex-officio nr. 43/2017.

¹³⁹ IAP, Ex-officio nr. 385/2016.

dhe në qëllim të përmbushjes së obligimeve kushtetuese. Në bazë të të dhënave të siguruara nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Republikës së Kosovës, kjo çështje është adresuar te ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, sipas të cilit në vitin 2019 do të bëhet plotësim-ndryshimi i reformës së skemave sociale, ku do të adresohet edhe çështja e rekomanduar nga Avokati i Popullit.

Avokati i Popullit, duke u nisur nga informatat e siguruara nga vizitat e realizuara në disa nga qendrat e kujdesit ditor, ka zhvilluar hetimet sipas detyrës zyrtare, lidhur me pamundësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara që të marrin shërbime sociale dhe familjare në këto qendra, për shkak të mbylljes së tyre. Në janar të vitit 2017, Avokati i Popullit i dërgoi letër me rekomandim ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, lidhur me pamundësinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara që të marrin shërbime sociale dhe familjare në këto qendra, për shkak të mbylljes së tyre. Më 19 mars 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga ministri i Punës dhe Mirëqenies me të dhëna të detajuara për veprimet e ndërmarra nga Ministria në fjalë, që qendrat e kujdesit ditor të mund të ofrojnë shërbime përkatëse për fëmijët me aftësi të kufizuara. Avokati i Popullit në përgjigjen e pranuar është informuar po ashtu se qendrat e kujdesit ditor janë duke zhvilluar aktivitetet e tyre në dhënien e shërbimeve sociale për fëmijët në nevojë sociale. Autoritetet përkatëse duhet të sigurojnë financim të qëndrueshëm dhe adekuat për shërbimet sociale dhe shëndetësore në Kosovë.

Drejtësia për të mitur

Kushtetuta e Republikës së Kosovës arsimimin e garanton si të drejtë të përgjithshme të njeriut që e gëzon çdo person, e cila, si e tillë, paraqet një parakusht të rëndësishëm për t'i gëzuar të drejtat e tjera të njeriut. Pra, edukimi është parë si faktor kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm të njeriut, përmes së cilit rritet përmirësimi i cilësisë së jetës në nivel individual, familjar, shoqëror dhe global.

Edhe fëmijët që janë subjekt i sistemit të drejtësisë, përkatësisht të miturit, të cilët kanë rënë ndesh me ligjin, duhet të kenë qasje dhe shërbime të duhura të kujdesit arsimor. Arsimimi i të miturve që janë të dënuar dhe që qëndrojnë në institucionet korrektuese është një nga detyrimet kryesore të institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës që buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, ligjet në fuqi dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare. Si i tillë, ky detyrim i institucioneve për të ofruar mundësi për arsimim për të rinjtë nuk mund të shmanget as për të miturit që qëndrojnë në institucionet korrektuese. IAP-ja i ka hetuar dy ankesa të dy të miturve në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Lipjan¹⁴⁰ lidhur me pamundësinë e tyre për vazhdimin e studimeve universitare. Avokati i Popullit rikujton se e drejta për arsimim e të miturve dhe madhorëve, të cilët janë të dënuar dhe që qëndrojnë në institucionet korrektuese duhet realizuar. Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se kjo e drejtë për të dënuarit duhet të

¹⁴⁰ IAP, ankesa nr. 493/2018 dhe 694/2018.

mundësohet në kuadër të Qendrës Korrektuese, ose edhe jashtë saj, përkatësisht në shkollat e rregullta publike.

Më 23 nëntor 2018, Avokati i Popullit u dërgoi raport me rekomandime MASht-it dhe Ministrisë së Drejtësisë, për nxjerrjen e aktit nënligjor në pajtim me Ligjin nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe me Ligjin nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili do të precizonte mënyrën e realizimit të së drejtës për arsimim parauniversitar të personave të mitur dhe madhorë që janë në vuajtje të dënimit, mirëpo deri në publikimin e këtij raporti, Avokati i Popullit nuk mori përgjigje.

Barazia para ligjit

Republika e Kosovës ka ndërtuar një kornizë ligjore për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, bazuar në standarde ndërkombëtare. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në kapituj të veçantë trajton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, duke afirmuar parime të përgjithshme, por dhe shumë lloje të drejtash, mes tyre, dy nene të veçanta i qasen barazisë para ligjit si dhe në vete ngërthen Instrumentet Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, të cilat zbatohen drejtpërdrejt dhe kanë prioritet me legjislacionin në fuqi.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuptimin normativ e paraqet bazën e rregullave ligjore të legjislacionit për mbrojtje nga diskriminimi në Kosovë. Termi “diskriminim” nënkupton dallimet që ekzistojnë në trajtimin e individëve ose mohimin e të drejtave të garantuara në të gjitha fushat e jetës, për shkak të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër.

Për më shumë, neni 9 i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokatin e Popullit e përcakton si Institucion të shtetit, i cili bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe i cili i trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.

Nga periudha 1 janar 2018 deri më 31 dhjetor 2018, Avokati i Popullit ka pranuar 189 ankesa me bazë diskriminimi, prej të cilave për hetim janë hapur 98, ndërsa 70 ankesa janë vlerësuar të pa pranueshme. Përveç ankesave të paraqitura nga qytetarët, Avokati i Popullit ka hapur 21 raste për hetim sipas detyrës zyrtare (*ex-officio*).

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Avokati i Popullit, me konstatime për diskriminim, ka publikuar 7 Raporte me rekomandime në cilësinë e Mikut të Gjykatës (*Amicus Curiae*) me Mendim Juridik, i është drejtuar gjyqësorit në 5 raste, dhe në 2 raste ka paraqitur Opinione.¹⁴¹

Avokati i Popullit, në përputhje me kompetencat që burojnë nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, ka hartuar doracakun për mbrojtje nga diskriminimi, i cili ka për qëllim të ofrojë përkufizim të qartë të diskriminimit në raport me sjelljet tjera të paligjshme, duke ofruar njohuritë themelore për njohjen dhe reagimin ndaj këtij fenomeni. Sipas legjislacionit vendor për mbrojtje nga diskriminimi, ky doracak në vete përmban përmbledhjen e të gjitha termave ligjorë, definicioneve dhe përgjigjeve në çështjet komplekse, të cilat kanë të bëjnë me diskriminimin dhe mbrojtjen ndaj tij. Gjithashtu, ky

¹⁴¹ Shih “Përmbledhja e Raporteve me Rekomandime për vitin 2018.

doracak për lexuesit ofron edhe një përmbledhje të legjislacionit ndërkombëtar për mbrojtje nga diskriminimi¹⁴².

Në përcjelljen e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, kanë zhvilluar takime me Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, përkitazi me zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Ligjit për Barazi Gjinore. Gjithashtu, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë qenë pjesëmarrës në prezantimin e draftit *Ex post* të Ligjit 05/L-020 për Barazi Gjinore, i cili ishte i organizuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore.

Gjithashtu, gjatë këtij viti raportues, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij janë prononcuar nëpër medie lidhur me çështje të diskriminimit. Kanë qenë pjesëmarrës dhe panelistë nëpër konferenca, debate, tryeza, punëtori, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Kosovës, në temat përkitazi me diskriminimin. Kanë zhvilluar takime me komunitetet rom, egjiptian, ashkali, dhe me OJQ të cilat i mbrojnë interesat e këtyre komuniteteve. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë realizuar takime të rregullta edhe me shoqërinë civile. Janë takuar me OJQ-të të cilat i mbrojnë interesat e komuniteteve LGBTI dhe janë paraqitur edhe si pjesë e paneleve në ngjarje të organizuara nga ky komunitet. Takime të rregullta Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë mbajtur edhe me Rrjetin e Grave, Forumin Kosovar të Aftësisë së Kufizuar, OJQ Hendikos, OJQ Sindrom Down Kosova, ECMI Kosova etj. Më 25 shtator 2018, në shkëmbim të përvojave të punës, DMD-ja ka zhvilluar takim me Komisionarin për Mbrojtje nga Diskriminimi i Republikës së Shqipërisë, ndërsa më 30 tetor 2018, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës dhe Komisionari për Mbrojtje nga Diskriminimi i Republikës së Shqipërisë kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi. Nga 19 deri më 23 nëntor 2018, në shkëmbim të përvojave, në DMD kanë qenë për vizitë studimore dy përfaqësues të Ombudsmanit nga Federate e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Personat me aftësi të kufizuar

Çdo person gëzon të drejtat universale që janë të njohura me Deklaratën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut. Të drejtat e të gjithë personave me aftësi të kufizuara janë të garantuara me legjislacionin vendor, si dhe me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara e Kombeve të Bashkuara¹⁴³.

¹⁴² Doracaku për Mbrojtje nga Diskriminimi, i publikuar në konferencën e organizuar nga IAP, më 18 dhjetor 2018.

¹⁴³ Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara është e inkomporuar edhe në Strategjinë Nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2013. shih http://www.kryeministris.net/repository/docs/STRATEGJIA_NACIONALE_PER_TE_DREJTAT_E_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE..._Shq+Ser+Ang.pdf.

Shteti ka detyrim ligjor që personave me aftësi të kufizuar t'u ofrojë garanci dhe mundësi që të kontribuojnë në zhvillimin e vendit, si dhe t'ua sigurojë përfshirjen dhe integrimin e tyre në proceset e ndryshme shoqërore, pa asnjë diskriminim.

Sipas vlerësimeve të bëra nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, konsiderohet se rreth 10 dhe 15 për qind e popullsisë në botë ka një aftësi të kufizuar. Gjithsesi, në Kosovë ende nuk ka statistika të sakta zyrtare rreth numrit të përgjithshëm të personave me aftësi të kufizuar. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konsideron se mungesa e një baze të dhënash për këtë kategori e pamundëson adresimin e duhur nga institucionet politike-hartuese.

Korniza ligjore¹⁴⁴ që merret me rregullimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës është mjaft e gjerë¹⁴⁵ dhe e shpërndarë në disa ligje. Që nga fillimi i vitit 2018, MPMS-ja ka deklaruar se ka filluar hartimin e një koncepti dokumenti, për një ligj gjithëpërfshirës në mbrojtje ligjore të personave me aftësi të kufizuar. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit konsideron se është e dukshme nevoja për plotësimin dhe ndryshimin e legjislacionit aktual përkitazi me personat me aftësi të kufizuar.

Personat me aftësi të kufizuara ende janë në margjinat e shoqërisë dhe programeve politike. Prandaj, përkundër ndryshimeve të shumta pozitive, Kosova vazhdon të mbetet prapa vendeve të zhvilluara, duke u përpjekur ta bëjë harmonizimin e legjislacionit vendor me legjislacionin dhe praktikën e Bashkimit Evropian, pa i krijuar paraprakisht parakushtet e domosdoshme brenda sistemit tonë.

Ashtu sikurse në vitet paraprake, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese, personat me aftësi të kufizuara vazhdojnë të përballen me të njëjtat probleme në të gjitha fushat e jetës¹⁴⁶. Vazhdon të mbetet e ulët shkalla e punësimit të kësaj kategori, ndonëse pikërisht ky është parakushti themelor që këta persona të gëzojnë trajtim të barabartë. Gjithashtu, mungesa e qasjes në hapësira publike, në institucione publike, në transport publik, problemet në

¹⁴⁴ Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, Ligji nr. 04/L-092 për personat e verbër, Ligji nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078, Ligji nr. 05/L-025 për shëndetin mental, Ligji nr. për përkrahje materiale familjeve të fëmijëve me aftësi të kufizuar të përhershme, Ligji nr. 04/L-131 për skemat e pensioneve të financuara nga shteti (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara), Ligji nr. 02 / L-17 për shërbimet sociale dhe familjare, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-081, Ligji nr. 02/L-52 për arsimin parashkollor, Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 04/L-037 për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës, Ligji nr. 05/L-018 për provimin shtetëror të maturës (Dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara), Ligji nr. 04/L-125 për shëndetësinë, Ligji nr. 04/L-249 për sigurimin shëndetësor (dispozitat përkatëse për personat me aftësi të kufizuara), Ligji nr. 04/L-110 për ndërtim/Udhëzimi administrativ nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasje të personave me aftësi të kufizuara.

¹⁴⁵ Raporti Vjetor për vitin 2017, në pjesën "Personat me nevoja të veçanta", për më shumë shih: <https://www.oik-rks.org/raportet/raportet-vjetore>.

¹⁴⁶ Raportet Vjetore të IAP për vitet 2016 dhe 2017- Pjesa aftësia e kufizuar, për më shumë shih: <https://www.oik-rks.org/raportet/raportet-vjetore/>

furnizimin me pajisje ortopedike, varfëria, realizimi i të drejtave në beneficione sipas legjislacionit etj., e vështirësojnë edhe më shumë jetën e tyre.

Përkundër faktit se Kosova para shumë vitesh ka vënë në fuqi një kornizë ligjore, e cila e parashikon ndërtimin e një infrastrukture¹⁴⁷ e cila është e qasshme për të gjithë, në realitet pak është bërë për t'u siguruar lëvizja e pavarur e qytetarëve me aftësi të kufizuara.

Problemet me të cilat përballen personat e verbër dhe personat me shikim të dobët në Kosovë janë të shumta. Mungesa e shtigjeve të prekshme, të cilat do t'u ndihmonin ta kalonin rrugën të sigurt, semaforët e zëshëm, mbishkrimet me alfabetin e Brajlit në institucione, janë vetëm disa nga barrierat. Anëtarët e Shoqatës së të Verbërve të Kosovës nuk janë të kënaqur, as me zbatimin e Ligjit për Personat e Verbër,¹⁴⁸ as me Ligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L -078,¹⁴⁹ gjë që ndikon në cilësinë e dobët të jetesës së tyre dhe e vështirëson integrimin shoqëror.

Lidhur me zbatimin e Ligjit për personat e verbër, Kuvendi i Kosovës ka dhënë rekomandime të qarta për institucionet e Kosovës, por ende nuk ka tregues se institucionet kanë ndërmarrë hapa për t'i zbatuar ato. Përveç neneve 6 dhe 7 të këtij Ligji,¹⁵⁰ nenet e tjera nuk zbatohen. Gjithashtu personat e verbër, për t'i realizuar të drejtat e tyre ligjore në beneficione, kushtëzohen të anëtarësohen në Shoqatën e të Verbërve të Kosovës, ngase me këtë Ligj, neni 21, parasheh: *“Për zbatimin e këtij ligji, dhe pa mohuar të drejtat e individëve ose grupeve të tjera, Shoqatës së të Verbërve të Kosovës i njihet e drejta e përfaqësimit të të verbërve dhe fitimit të shërbimeve të posaçme, në varësi të plotësimit të kushteve [...]”*

Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga persona të verbër, të cilët shprehin shqetësimin e tyre në keqinterpretimin e këtij neni nga institucionet ku të verbrit drejtohen për të kërkuar beneficione të garantuara me Ligjin për të Verbrit, ngase kërkojnë që përfaqësimet të bëhen nga Shoqata e të Verbërve të Kosovës apo të prezantohen librezat e verbërisë nga po e njëjta shoqatë, kurse në anën tjetër, shoqata në fjalë po i kushtëzon të verbrit me pagesa për anëtarësim, në rastet kur ata kërkojnë të pajisen me librezat të

¹⁴⁷ Ligji për ndërtim nr. 04/L-110, dhe Udhëzimi administrative për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

¹⁴⁸ Ligji nr. 04/L-092, Ligjit për personat e verbër, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2837>

¹⁴⁹ Ligjin nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2620>

¹⁵⁰ Ligji nr. 04/L-092, Ligjit për personat e verbër, neni 6 “Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë. Në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtari si persona juridikë, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas ligjeve në fuqi...” Neni 7, “Të ardhurat dhe beneficione, 1. Personat e verbër gëzojnë të gjitha të drejtat dhe beneficione sipas ligjeve në fuqi. 2. Personat e verbër të përcaktuar me këtë ligj, marrin nga buxheti shtetëror kompensimin në një shkallë të caktuar bazuar në pagën minimale në Kosovë, por jo më pak se njëqind (100) euro në muaj dhe përcaktohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria. (...)”

verbërisë, ose në të kundërtën i refuzojnë. Këto raste janë në procedura të hetimit në IAP.¹⁵¹

Gjatë periudhës raportuese, përkitazi me zbatimin e Ligjit për të Verbrit, si edhe problemet e personave me aftësi të tjera të kufizuara, në të gjitha sferat e jetës, përfshirë edhe çështjen e punësimit, ka raportuar edhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Zhdukur dhe Peticione i Kuvendit të Kosovës¹⁵², i cili konstatoi se punësimi i personave me aftësi të kufizuara nuk është i kënaqshëm jo vetëm në sektorin privat, por edhe në sektorin publik.

Gjatë vitit 2018, IAP-ja e ka shqyrtuar një rast, sipas ankesës individuale të ankuesit, në lidhje me pretendimin për diskriminim ndaj personave të verbër. Për këtë qëllim, duke i shfrytëzuar kompetencat¹⁵³ e tij ligjore, Avokati i Popullit i paraqiti Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Administrative, një mendim ligjor në cilësinë e tij si mik i gjykatës, për konkluzionet në lidhje me pretendimet e Shoqatës së të Verbërve në Gjakovë për shkeljen e të drejtave të personave të verbër për lirim e të njëjtëve nga tatimi në pronë.

Avokati i Popullit theksoi se Ligji nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme është ligj i përgjithshëm (*legi generalis*), qëllimi i të cilit është futja e tatimit në pronë të paluajtshme dhe përcaktimi i standardeve dhe procedurave që duhet t'i respektojnë komunat gjatë administrimit të taksave të pronës. Nga ana tjetër, Ligji nr. 04/L-092 për Personat e Verbër është një ligj i veçantë (*lex specialis*), qëllimi i të cilit është të rregullojë statusin ligjor të personave të verbër. Ky ligj gjithashtu përcakton të drejtat dhe përfitimet e tyre dhe shprehimisht thekson në nenin 6 se: “Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë.” Ligji nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme në asnjë nga dispozitat e tij nuk e ndalon përjashtimin e kategorive të tjera nga tatimi në pronë të paluajtshme. Neni 8 i këtij ligji liston disa nga kategoritë e përjashtuara, por as ky ligj, as ndonjë ligj tjetër nuk e ndalon ligjvënësin ta miratojë një ligj të posaçëm për lirim e grupeve të caktuara nga detyrimet financiare.

Në bazë të argumenteve të paraqitura më sipër, Avokati i Popullit konstatoi se parimi i *lex specialis derogat legi generali* është i zbatueshëm në sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, si pjesë e së drejtës për një proces të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe me nenin 6 të Konventës. Parimi i sundimit të ligjit shkelet rëndë në qoftë se një autoritet publik nuk e zbaton ligjin në fuqi dhe individët kanë pritje legjitime për efektin e ligjit.

¹⁵¹ Rasti A.56/2018 dhe rasti A.57/2018.

¹⁵² Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të zhdukur dhe Peticione, mbajti mbledhje më 2 maj 2018. https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/proc/proc__2018_05_02_10_7402_sr.pdf

¹⁵³ Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 9 paragrafi 2.13. “Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi”.

Sa i përket statistikave mbi punësimin e personave me aftësi të kufizuara në shërbimin civil, nuk ka statistika të ndara, por sipas disa informatave, në këtë shërbim janë të punësuar 103 punonjës me aftësi të kufizuara.

Një çështje tjetër, e cila është duke u trajtuar në IAP, ka të bëjë me shkeljen e së drejtës si dhe diskriminimin në beneficionet e personave me aftësi të kufizuara, përkitazi me lirimin nga pagesa e detyrimeve të importit për kategorinë e personave me nevoja të veçanta, përkatësisht personat e verbër dhe personat me paraplegji dhe tetraplegji¹⁵⁴. Personat me aftësi të kufizuara të drejtën në lirimet nga pagesa e detyrimeve të importit e kanë të garantuar me dispozitat e nenit 182 në lidhje me nenin 76-81 të Aneksit A të Kodit Doganor dhe akcizave në Kosovë nr. 03/L-109; me nenin 10 të Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik nr. 05/L-067, me nenin 6 të Ligjit nr. 04/Z-092 për Persona të Verbër; Pika 1.12 e nenit 30 të Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Avokati i Popullit konsideron se legjislacioni doganor në fuqi nuk e ka ofruar bazën ligjore, e cila do të konsiderohej e mjaftueshme, me anë të së cilës personat me aftësi të kufizuara dhe personat me paraplegji dhe tetraplegji, si dhe personat e verbër mund të përfitonin nga përjashtimi i pagesës së detyrimeve të importit për një mjet udhëtimi për nevojat e tyre.

Sipas informatave të marra nga Dogana e Kosovës lidhur me lirimin e automjeteve nga pagesa e detyrimeve të importit, e cila ndërlihet me Ligjin për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik, i cili me nenin 10 e ka paraparë që për përfituesit e këtij ligji, me qëllim të lirit nga detyrimet e importit, me rastin e importit vlejné dispozitat e legjislacionit në fuqi, në kuptim të Kodit Doganor, të cilit i referohet paragrafit 1 të nenit 10 të Ligjit nr. 05/L-067. Në lidhje me këtë privilegj, të lirit nga detyrimet doganore, ato vazhdojnë t'u njihen vetëm personave, të cilët paraprakisht janë pajisur me patentë shoferi dhe me kushtin që automjeti të jetë i dizajnuar apo i përshtatur për përdorim nga personat me aftësi të kufizuara. Ndërkaq, asnjë nga këto akte nuk e ka paraparë lirimin nga taksat e automjeteve doganore për personat e kësaj kategorie, të cilët, për arsye objektive, nuk kanë automjet të përshtatur për aftësinë e kufizuar të tyre dhe nuk kanë mundësi të kenë patentë shoferi për të ta vozitur automjetin. Një beneficion i tillë për lehtësira doganore në import të veturave, për kategorinë e personave me aftësi të kufizuara duke vënë kushte të tjera, të cila nuk mund të plotësohen nga të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, përbën pabarazi dhe njëherësh diskriminim në përfitime të beneficioneve edhe brenda aftësisë së kufizuara.

Në programin legjislativ për vitin 2018, të miratuar më 20 dhjetor 2017, në mbledhjen e 20-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës¹⁵⁵, është paraparë një projektligj për ndryshimin dhe plotësimin e Kodit Doganor dhe akcizave. Gjatë rishikimit të dispozitave të këtij Kodi, komisioni përgjegjës për hartimin e draftit origjinal ka planifikuar, ndër të

¹⁵⁴ A.822/2017 dhe A864/2018.

¹⁵⁵ http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/PROGRAMI_LEGJISLATIV_PER_VITIN_2018...pdf

tjera, edhe ndryshime dhe plotësime të dispozitave që kanë të bëjnë me privilegjet doganore për personat e të gjitha kategorive me nevoja të veçanta. Megjithatë kjo çështje deri më sot nuk është e rregulluar.

Gjithashtu, mungesa e rregullimit legjislativ, me të cilën do të bëhej klasifikimi dhe kategorizimi i plotë i të gjitha llojeve të personave me aftësi të kufizuara dhe përfshirjen e tyre të plotë në legjislacion dhe përcaktimin e tarifave dhe shërbimeve të përshtatshme për të gjithë, i vë në pozitë të pabarabartë personat me aftësi të kufizuara që i përkasin llojit që nuk është kategorizuar, si p.sh. personat që nuk e kanë kapacitetin të jetojnë në mënyrë të pavarur dhe e drejta në pensione për paftësi u rregullohet me Ligjin për Skemën Pensionale. Personat me aftësi të kufizuara, të cilët përfitojnë përkrahje monetare nga Ligji për Skemën Pensionale, nuk gëzojnë asnjë benificion ashtu si personat me aftësi të kufizuara, të cilëve të drejta dhe benificionet u rregullohen me ligje të veçanta.

Gjatë periudhës raportuese, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale e miratoi Udhëzimin Administrativ nr. 05/2018, për metodën dhe procedurat e vlerësimit të aftësisë për punë të personave me aftësi të kufizuara.¹⁵⁶ Ky Udhëzim rregullon metodën dhe procedurat e vlerësimit të zvogëlimit të kapacitetit të punës të personave me aftësi të kufizuara për përcaktimin e njohjes së të drejtave për aftësim, riaftësim dhe punësim.

Avokati i Popullit, gjatë periudhës raportuese, hapi një hetim për disa raste individuale, si dhe për rastet sipas detyrës zyrtare, duke iu referuar diskriminimit të personave me aftësi të kufizuara, shqyrtimi i të cilave është në vazhdim e sipër.¹⁵⁷

Diskriminimi në punë

Nocioni i së drejtës për punë nënkupton të drejtën e barabartë në kushte të barabarta për punë dinjitoze dhe respektim të dispozitave ligjore përkatëse, me çka përjashtohet çdo formë e diskriminimit.

Garancitë kushtetuese për të drejtën e punës dhe të drejtën për zgjedhjen e lirë të profesioneve, krijojnë detyrimin e shtetit për t'i mbrojtur këto të drejta në mënyrë të barabartë dhe për ta siguruar respektimin dhe zbatimin e plotë të legjislacionit përkatës.¹⁵⁸

Sipas dispozitave ligjore aktuale, ndalohet shkelja e parimit të trajtimit të barabartë, në punësim dhe profesion, në lidhje me procesin e rekrutimit, aftësimin profesional, promovimit, kushteve të punësimit ose çështjeve të tjera në fushën e punës, të rregulluara me ligjet në fuqi, në cilëndo veprimtari dhe në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale. Dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë të zbatueshme drejtpërdrejt, kur

¹⁵⁶ file:///C:/Users/drodic/Downloads/Udh%C3%ABzimi%20Administrativ%20(MPMS)%20nr.%2005-2018.pdf

¹⁵⁷ A.100/2018, A.610/2018A.864/2018, Ex officio br.340/2017 , Ex officio br.451/2018, Ex officio br.262/2018.

¹⁵⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, Barazia para ligjit, dhe neni 49, E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit.

bëhet fjalë për marrëdhëniet e punës ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, si në sektorin privat, ashtu edhe në atë publik.

Avokati i Popullit thekson se, sipas qasjeve të deritashme të përkufizimit të punës dinjitoze,¹⁵⁹ si një qëndrim i përbashkët, veçohet se puna dinjitoze, e parë përmes aspiratës së individit në realizimin e të drejtave të punës, përfaqëson mundësinë për punë produktive, një raport të rregullt dhe të drejtë të punëdhënësit ndaj të punësuarve, një vend pune të sigurt dhe të shëndetshëm, mbrojtjen e të drejtave sociale të punonjësve dhe anëtarëve të familjeve të tyre, si dhe kushte më të mira për prosperitetin personal të punonjësit dhe integrimin e tij social, lirinë e të punësuarve për t'i shprehur nevojat e veta, për t'u organizuar dhe për të marrë pjesë aktive në vendimet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me punën e tyre.

Njëherësh, Avokati i Popullit rikujton ekzistencën e problemeve që rezultojnë nga mosrespektimi i detyrimeve ligjore nga institucionet relevante të Sistemit në fushën e të drejtave të punës.

Institucionet kryesore, të cilave u është besuar zbatimi dhe mbikëqyrja e zbatimit të legjislacionit të punës, janë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, roli i së cilës është krijimi i politikave të punës dhe mbrojtjes sociale dhe krijimi dhe zbatimi i ligjeve në këtë fushë, vendosja e standardeve për sigurinë dhe shëndetin në vendim punës së të punësuarve dhe e mbikëqyr zbatimin e tyre; edhe Inspektorati i Punës, si një institucion me rëndësi të veçantë për mbrojtjen e të drejtave të punës në sferën e mbikëqyrjes inspektuese dhe më pas edhe institucionet e tjera relevante të sistemit.

Brenda kornizës institucionale, Inspektorati i Punës është i vetmi organ që e mbikëqyr zbatimin e dispozitave për punësim, siguri dhe shëndet në punë. Avokati i Popullit e sheh rolin vendimtar parandalues të Inspektoratit të Punës në zbatimin e Ligjit të Punës dhe sigurimin e punës dinjitoze, në kujdesin për sigurinë dhe shëndetin në punë, në parandalimin e abuzimit në punë, në zbatimin e akteve të përgjithshme dhe luftimin e parregullsive në sferën e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës, në themelimin dhe kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës dhe detyrimin e ekzistimit të një kontrate pune për secilin punëtor. Në të gjitha këto është me rëndësi të veçantë të theksohet roli i inspektimit jo vetëm si një trup këshillëdhënës dhe konsultativ, por edhe si organ kontrolli.

Gjatë vitit 2018, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë hapa për krijimin e legjislacionit me synim të reformës së administratës shtetërore. Megjithatë, marrëdhënia e punës gjatë periudhës raportuese, tek sektori publik, ka vazhduar të rregullohet me Ligjin për Shërbimin Civil.¹⁶⁰

¹⁵⁹ Programi i punës dinjitoze ose (Agjenda e punës dinjitoze – The Decent Work Agenda) është miratuar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës, në vitin 1999, me qëllim që në shtetet anëtare, por edhe atyre jo anëtare, të gjitha organizatat të promovojë punën dinjitoze si një komponent kyç të politikave zhvillimore dhe në të njëjtën kohë duke synuar politikën shtetërore të qeverive dhe partnerëve socialë.

¹⁶⁰ Ligji nr. 04/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është organ i pavarur, i cili i trajton ankesat e shërbyesve civilë përkitazi me shkeljen e së drejtës në punë. Baza ligjore për funksionimin e pavarur mbikëqyrës për shërbimin civil të Kosovës është Kushtetuta e Republikës së Kosovës¹⁶¹, Ligji për Këshillin e Pavarur të Kosovës¹⁶², Ligjin për Shërbimin Civil¹⁶³. Mirëpo gjatë këtij viti raportues, lidhur me funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë ligj të ri, i cili është miratuar dhe është në fuqi nga vitit 2018.¹⁶⁴

Sipas ankesave ndaj vendimeve të Inspektoratit të Punës dhe Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendos Gjykata Themelore, gjegjësisht Departamenti për Çështje Administrative. Mirëpo, Avokati i Popullit, edhe gjatë këtij viti raportues, ashtu si edhe në raporte për ankesa individuale, ka ngritur shqetësimin e tij për zvarritjet e procedurave gjyqësore në zgjidhjen e rasteve që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës, të cilat paraqesin gjithashtu një problem madhor në zbatimin e ligjeve. Procedurat që zgjasin shumë dhe mungesa e një gjykate të specializuar, e cila do të merrej vetëm me rastet e punësimit, janë ende pengesë për zbatimin e legjislacionit të punës¹⁶⁵. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se, edhe gjatë këtij viti raportues, nuk është vërejtur përkushtim i mekanizmave kompetentë të lartpërmendur që, duke iu referuar Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të kenë vendosur në rastet ku pretendohet se ka diskriminim.

Në Kosovë ende vazhdon të jetë sfidë shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë. Edhe sot nuk vërehet ndonjë përkushtim i Qeverisë për krijimin e vendeve të reja të punës. Për më tepër, Qeveria ka dështuar të ketë një analizë të mirëfilltë për kërkesat e tregut të e punës. Prandaj, me qëllim të ndikimit të drejtpërdrejtë në uljen e papunësisë në vend, Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta trajtojë me prioritet dhe të ndërmarë veprime në krijimin e politikave për orientimin e të rinjve në shkollim adekuat sipas kërkesave të tregut të punës.

Avokati i Popullit, edhe gjatë këtij viti raportues, shpreh shqetësimin e tij se për shkak të shkallës së lartë të papunësisë, rastet e diskriminimit në vendin e punës raportohen shumë rrallë, pasi të punësuarit frikësohen nga hakmarrjet e punëdhënësve të tyre. Shumë shpesh, siç edhe theksohet nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura, të punësuarit i zgjidhin çështjet e tyre të punës në mënyrë të brendshme dhe joformale me punëdhënësit e tyre. Nisur nga kjo, Avokati i Popullit e konsideron si të nevojshme krijimin e politikave në mbrojtjen e punëtorëve në rastet e raportimeve të diskriminimit në vendin e punës.

¹⁶¹ Neni 101, paragrafi 2, Kushtetuta e Republikës së Kosovës

¹⁶² Ligji nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

¹⁶³ Ligji nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës

¹⁶⁴ Ligji nr. 06/1 -048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, https://kpmshc.rks-gov.net/repository/docs/15_873621.pdf

¹⁶⁵ Shih pjesën Përmbledhja e Raportëve, Raporti Vjetor 2018.

Pamja e përgjithshme e tregut të punës në Republikën e Kosovës, sipas rezultateve të publikimeve të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në Anketën e fuqisë punëtore (AFP)¹⁶⁶ për tremujorin e tretë (K3) në vitin 2018, tregon që dy të tretat e popullsisë në Kosovë janë të aftë të punojnë. Në popullsinë e aftë për punë janë përfshirë personat e moshës 15-64 vjeç. Në kuadër të popullsisë së aftë për punë, shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është 42.0%. Shkalla e punësimit është 29.1%. Punësimi është më i lartë tek meshkujt (45.6%); ndërsa te gratë është 12.6%. Sa u përket punonjësve me kontrata pune, 28.4% e të punësuarve kanë një kontratë pune të përhershme, ndërsa 71.6% kanë një kontratë pune të përkohshme. Sipas rezultateve të AFP-së në K3 2018, shkalla e papunësisë ishte 30.7%.

Sektorët ekonomikë me shkallën më të lartë të punësimit ende janë: tregtia, ndërtimi dhe industria. Ndërsa shkalla e lartë e papunësisë në Republikën e Kosovës, e cila kap shkallën më të lartë të papunësisë në Evropë, mbetet shqetësim i vazhdueshëm.¹⁶⁷

Bazuar në ankesat e parashtruara në IAP, gjatë këtij viti raportues, Avokati i Popullit konsideron se nuk ka pasur përparim të dukshëm dhe përmirësim të situatës në lidhje me respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe kushteve të punës. Edhe më tutje vazhdon të jetë prezent shkelja e të drejtave të punëtorëve. Pozita e të punësuarve vazhdon të jetë veçanërisht e rëndë në sektorin privat, ku përgjithësisht nuk ka organizata sindikale që do t'i mbronin të drejtat e punëtorëve.

Diskriminimi i punëtorëve është më i theksuar në sektorin e ndërtimit, tregtisë, hotelerisë dhe industrisë. Ende është i theksuar problemi i punës joformale, pa kontratë pune, që sjell deri te përjashtimi i sigurisë juridike për personat që punojnë pa kontratë, pasi ata formalisht dhe ligjërisht nuk ekzistojnë te punëdhënësi i caktuar, dhe për ta e vetmja mundësi për ushtrimin e të drejtave të tyre të marrëdhënies së punës është inicimi i procedurave përkatëse gjyqësore.

Avokati i Popullit thekson në mënyrë të veçantë se, kur është fjala për ta dëshmuar punën joformale në procedurat përkatëse gjyqësore, përkatësisht se ky person ishte në një punë faktike te punëdhënësi në fjalë, i njëjti duhet të sigurojë shumë prova për ta dëshmuar ekzistencën reale të punës së tij. Dëshmitë dhe dokumentacioni që do të dëshmonin praninë e të punësuarit, shpesh shmangen ose nuk ekzistojnë, me qëllim që të mos lënë gjurmë për angazhimin faktik të të punësuarit te punëdhënësi dhe është shumë vështirë të dëshmohet, sepse, për shembull, për punë joformale nuk merret llogaritja e pagës mujore, për shkak se paga i jepet në dorë e jo përmes llogarisë bankare, për këtë lloj pune nuk mbahet evidenca zyrtare e prezencës në vendin e punës, po ashtu ka gjasa që ai të mos jetë në gjendje të ofrojë edhe dëshminë e kolegëve të tij, si mjet dëshmie, sepse ata kanë frikë nga pasojat që do të mund t'u shkaktonte dëshmia e tyre te punëdhënësi etj. Në situata të tilla, për të punësuarit pa kontratë punësimi është shumë vështirë dhe nganjëherë e pamundur të dëshmohet dhe të realizohen të drejtat nga marrëdhënia e

¹⁶⁶ <http://ask.rks-gov.net>

¹⁶⁷ <http://ask.rks-gov.net>

punës. Barra e provës dhe zvarritja e procedurave në gjykatat tona e komplikon edhe më shumë situatën e një punëtori tashmë ekzistues të rrezikuar.

Niveli i sigurisë në punë në sektorin privat mbetet edhe tej shqetësues, shpesh pa mbrojtje elementare dhe, për këtë arsye rezulton se, për shkak të mungesës dhe mosmarrjes së masave të duhura të sigurisë në punë, kemi një numër të madh të rasteve të vdekjeve të punëtorëve dhe rasteve të lëndimeve të rënda të punëtorëve në vendin e punës. Veçanërisht shqetësuese është pozita e grave në tregun e punës, për çka raportohet në detaje më të hollësishme në pjesën e këtij raporti vjetor që ka të bëjë me barazinë gjinore.

Duke e monitoruar fushën e zbatimit të legjislacionit të punës, Avokati i Popullit deri tani nuk e ka vënë re se autoritetet relevante të mbikëqyrjes, promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të punës kanë ndërmarrë ndonjë masë më efektive në luftimin strategjik të punës joformale, masa që janë të nevojshme për përmirësimin e standardeve në këtë fushë.

Nga aspekti social, ligji aktual i punës konsiderohet si një ligj që i garanton të drejtat minimale të punonjësve dhe në një masë të madhe i rregullon aspektet e përgjithshme të të drejtave sociale të të punësuarve. Që të arrihen qëllimet e caktuara në sferën e të drejtave sociale, Avokati i Popullit apelon që shteti t'i rrisë aktivitetet e tij në fushat si në vijim: përmirësimi i kushteve të punës; mbrojtja e të punësuarve në rast të ndërprerjes së marrëdhënies së punës; përmirësimin e ambientit të punës në fushën e shëndetit dhe sigurisë në punë; trajtimin e barabartë për burrat dhe gratë e punësuar; përfshirjen e personave, të cilët punësohen më me vështirësi etj.

Po ashtu, përkundër nenit 51 të Kushtetutës (Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale), me të cilin është paraparë sigurimi social themelor, që ka të bëjë me papunësinë, sëmundjen, aftësitë e kufizuara dhe moshën e shtyrë, sistemi i sigurimeve sociale në Kosovë ende nuk është plotësisht i rregulluar. Në mungesë të këtij sistemi mungon Fondi i sigurimeve sociale. Në Kosovë ky sistem aktualisht zbatohet vetëm për kontributet pensionale për punonjësit pas vitit 2002. Përveç kësaj, sigurimi shëndetësor ende nuk ka filluar të aplikohet, megjithëse Ligji¹⁶⁸ për sigurimin shëndetësor, i cili u miratua në prill të vitit 2014, tashmë është në fuqi.

Si rrjedhojë, Avokati i Popullit konsideron se problemet kryesore, të identifikuar si mangësi në fushën e legjislacionit të punës, duhet të rregullohen sa më shpejt që është e mundur, përmes procesit legjislativ dhe të vazhdohet me harmonizimin e tyre me legjislacionin relevant të Bashkësisë Evropiane, me qëllim të përsheptimit të procesit të përafritimit ligjor. Kjo nënkupton edhe rritjen e kapacitetit të institucioneve të mbikëqyrjes, forcimin e gjyqësorit dhe ndërmarrjen e masave të tjera të përshtatshme, të cilat do të kontribuojnë në mënyrë efektive në zbatimin e legjislacionit. Përndryshe, procesi i harmonizimit të brendshëm në fushën e legjislacionit të punës me legjislacionin përkatës të Bashkimit Evropian filloi në vitin 2013, por edhe pas një periudhe të gjatë kohore, ende nuk është përmbyllur.

¹⁶⁸ Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor

Në përputhje me kompetencat e veta dhe në bazë të dyshimit se ekziston diskriminim në sektorin publik, gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit i shqyrtoi rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin në punë në sektorin publik.

Avokati i Popullit, më 12 shkurt 2018, ua dërgoi Rektoratit të Universitetit të Prishtinës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, një Raport *Ex-officio* me rekomandime lidhur me kushtin diskriminues në konkursat për punësim në Universitetin e Prishtinës, i publikuar gjatë viti 2016 dhe 2017, më saktësisht me kushtin që “Në Universitetin e Prishtinës nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve që kanë marrëdhënie të ngushta pune, familjare brenda departamenteve/departamenteve ose programeve”. Për më tepër, përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit e thekson se në mënyrë specifike e kupton problemin e nepotizmit si një formë të veçantë të konfliktit të interesit, që është jashtëzakonisht i shpeshtë me rastin e punësimit në sektorin publik. Megjithatë, luftimi i nepotizmit nuk nënkupton përjashtimin e plotë të të afërmeve, por nënkupton ndalimin e keqpërdorimit të pozitës së nëpunësve civilë për të siguruar punë për anëtarët e familjes. Qëllimi nuk është që të pengohen anëtarët e familjes të punojnë së bashku, por ta parandalojnë mundësinë që një nëpunës civil të jetë i njëanshëm, duke favorizuar ose duke përdorur ndikimin dhe pozitën e tij për anëtarët e familjes në ushtrimin e kompetencave diskrecionale për të punësuar nëpunës të kualifikuar civilë.

Avokati i Popullit, pas një analize ligjore të kushtit të lartpërmendur kontestues në konkursat e UP-së, të shpallura gjatë vitit 2016 dhe 2017, i cili nuk e lejon paraqitjen në konkurs dhe rekrutimin e kandidatëve brenda të njëjtit departament sipas bazës së marrëdhënies të ngushta familjare, si dhe neni 7, paragrafi 11 të Rregullores së brendshme për procedurat e vlerësimit për angazhimin e bashkëpunëtorëve të Jashtëm në UP “Hasan Prishtina”, e datës 8 shtator 2017, në të cilën thuhet: “*Në Universitet të Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas)*”, konkludoi se, në kontekstin e parimit të barazisë, përbën kusht diskriminues dhe është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.¹⁶⁹

Me rastin e këtij raporti, më 16 mars 2018, Avokati i Popullit u dërgoi të njëjtave palë edhe Opinionin e tij mbi Parandalimin e nepotizmit në Universitetin e Prishtinës.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit gjithashtu shqyrtoi edhe ankesa individuale në lidhje me diskriminimin në procesin e punësimit.¹⁷⁰ Duke e përfunduar hetimin sipas ankesave individuale, Avokati i Popullit, më 16 prill 2018, ua dërgoi Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) një Raport me rekomandime në lidhje me kushtin diskriminues në konkursin për punësim në Shërbimin Korrektues të

¹⁶⁹ Për më tepër shih pjesën e raportit Vjetor 2018, Raporti nr. Ex officio 853/2016 dhe Opinioni nr. Ex officio 853/2016 Përmbledhja e Raporteve.

¹⁷⁰ Nga data baza e IAP-së, A. nr. 114/2018; A. nr. 122/2018 dhe A. nr. 182/2018.

Kosovës, me numrin e referencës MJ/KCS/132-09-02-2018, i datës 12 shkurt 2018 për 70 /shtatëdhjetë/ vende të lira për “Zyrtarë korrektues”. Në konkursin e lartpërmendur, në pjesën “Kualifikimet, shkathtësitë dhe karakteristikat personale”, si kriter theksohet” **“Moshë mesatare për meshkuj është deri 30 vjet, për gra deri 35 vjet.”** Esenca e këtij rasti qëndron në faktin se, në bazë të të gjitha fakteve dhe rrethanave, në përputhje me rregulloret imperative për ndalimin e diskriminimit, të shqyrtohet çështja se a janë shkelur mundësitë e barabarta për themelimin e marrëdhënieve të punës në ShKK me vendosjen e moshës në Konkurs, si kusht kufizues për punësim.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, për të përcaktuar nëse me përjashtimin e mundësisë së themelimit të marrëdhënies së punës për vendin e punës “Zyrtarë korrektues” është bërë diskriminim duke kufizuar moshën e kandidatëve/kandidateve potencialë/e, Avokati i Popullit nuk është lëshuar në analizën nëse në rastin konkret moshë deri në 30 vjet për meshkuj, gjegjësisht 35 vjet për femra, e paraqet kushtin real dhe vendimtar për kryerjen e kësaj pune, duke pasur parasysh natyrën dhe veçantinë e kësaj pune dhe nëse qëllimi që synohet të arrihet është i arsyeshëm, por ekskluzivisht e ka shqyrtuar dhe analizuar çështjen nëse vendosja e kushtit kufizues gjatë punësimit në Konkursin e ShKK-së bazohet në akt të veçantë përkatës juridik në pajtim me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe me standardet ndërkombëtare¹⁷¹.

Lidhur me çështjen në fjalë, Avokati i Popullit konstatoi se Kushtetuta dhe rregulloret relevante ligjore e ndalojnë dallimin arbitrar ose veprimet e pabarabarta gjatë përcaktimit të kushteve për punësim dhe përzgjedhjes së kandidatëve/kandidateve për kryerjen e një pune të caktuar në bazë të moshës së tyre. Kështu që, përjashtimet nga kjo rregull në mënyrë shumë restriktive duhet të interpretohen dhe të pranohen si të justifikuara vetëm me ekzistencën e rregulloreve të veçanta dhe në situata kur moshë paraqet faktor real dhe vendimtar për mundësinë, gjegjësisht për pamundësinë e kryerjes së një pune të caktuar, duke pasur parasysh natyrën dhe veçantinë e kësaj pune.

Avokati i Popullit konstatoi se me vendosjen e moshës si kusht kufizues për punësim në Konkursin e ShKK-së, pa ekzistencën e aktit të veçantë juridik, me të cilin do të përcaktoheshin këto kushte, ka ardhur deri tek shkelja e mundësive të barabarta me rastin e punësimit në raport me personat më të vjetër se 30/35 vjet, me çka është bërë diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të moshës në fushën e punës, i ndaluar me dispozitat relevante të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Një sjellje e tillë është kundërligjore dhe përbën një shkelje të rregullave imperative që e ndalojnë diskriminimin, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë personat juridikë.

¹⁷¹ Shih Raportin Vjetor 2018, pjesa e Përmbledhjes së Raporteve, lidhur me çështjen në fjalë, Avokati i Popullit ua dërgoi Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës rekomandimet përkatëse përmes Raportit A. nr. 114/2018; A. nr. 122/2018 dhe A. nr. 182/2018.

Duke i shfrytëzuar kompetencat e veta ligjore,¹⁷² me rastin e shqyrtimit të rasteve, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) u dërgoi gjykatave kompetente edhe disa mendime juridike, me qëllim që të njëjtat t'i informojë për gjetjet dhe konkludimet e tij lidhur me çështjet në shqyrtim¹⁷³.

Më 31 janar 2018, Avokati i Popullit ua dërgoi një mendim juridik Gjykatës Supreme, Gjykatës së Apelit dhe gjykatave themelore në Kosovë, si dhe Ministrisë së Administratës Publike, me qëllim të ofrimit të ndihmës juridike për të krijuar mundësinë e një interpretimi të drejtë të konceptit të “përvojës së punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit mendon se nuk ekziston dhe nuk mund të ekzistojë, një formulë e saktë që mund të zbatohet për gjithë shërbimin civil, që tregon se sa të përafërta janë detyrat e një vendi të punës me ato me të cilat kandidati kishte përvojë. Kjo është një çështje që duhet të lihet në diskrecionin e secilit institucion që shpall konkurs dhe të secilit komision vlerësues, jo vetëm për shkak se nuk ekziston formulë e saktë që mund të tregojë “përafrimin” e detyrave të punës, por edhe për shkak se institucioni dhe komisioni vlerësues mund të supozohet se janë ekspertë dhe profesionistë të fushës së cilës i përket vendi i punës që kërkon të plotësohet. Prandaj, ata që shpallin konkursin dhe anëtarët e komisionit janë ata që janë në pozitën më të mirë për ta vlerësuar, nëse përvoja e secilit kandidat është mjaftueshëm “e përafërt” me detyrën, për të cilën ka konkurruar kandidati.

Ndonëse nuk ekziston formulë e saktë për vlerësimin e përvojës së punës, e cila do të mund të zbatohet për gjithë shërbimin civil, Avokati i Popullit mendon se kjo nuk e pengon institucionin që në konkursin e shpallur të përfshijë kritere të detajuara në përputhje me praktikën evropiane¹⁷⁴.

Avokati i Popullit, në cilësi të mikut të gjykatës (*amicus curiae*) i dërgoi një Mendim Juridik, Gjykatës Themelore në Prishtinë, i cili është i përqendruar në sqarimin e procedurave ligjore përkitazi me kufizimin e moshës si kriter për punësimin e ankuesit, në pozitën e mësimdhënësit, në konkursin e shpallur nga Universiteti Publik i Prishtinës “Hasan Prishtina”, gjegjësisht nga Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Avokati i Popullit rikujton se në vitin 2010 kishte hapur një rast të ngjashëm *ex-officio* dhe ia kishte dërguar një Letër rekomandim Rektorit të UP-së, duke ia rekomanduar rishqyrtimin e Vendimit me nr. 1/499, i datës 25 maj 2010, të Senatit të UP-së, lidhur me veprimet e ndërmarra, si përgjigje ndaj këtij rekomandimi. Mirëpo, brenda afatit të caktuar, Avokati i Popullit nuk mori përgjigje në rekomandimet e dhëna. Për shkak të faktit që Avokati i Popullit nuk mori përgjigje në rekomandimet e dhëna për Rektoratit e

¹⁷² Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9 paragrafi 2.13. “Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimi”.

¹⁷³ Shih Raporti Vjetor 2018, pjesa e Përmbledhjes së Raporteve, A. nr. 903/2017.

UP-së, i njëjti, në bazë të neneve përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit për Kontestet Administrative dhe Ligjit për Avokatin e Popullit, i cili ishte në fuqi asokohe, në dhjetor të vitit 2010 i parashtrijoi kërkesë Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me ligjshmërinë e vendimit që të mos rekrutohen mësimdhënës, të cilët kanë arritur moshën mbi 50 vjeçare.

Në bazë të provave dhe pas shqyrtimit të kërkesës së Avokatit të Popullit lidhur me ligjshmërinë e Vendimit nr. 1/499 të Senatit të UP, të datës 25 maj 2010, që të mos rekrutojë mësimdhënës, të cilët e kanë arritur moshën mbi 50-vjeçare, Gjykata Themelore në Prishtinë e miratoi kërkesëpadinë e Avokatit të Popullit si të bazuar dhe sipas Aktgjykimit A.nr.1242/2010, i datës 9 dhjetor 2013, e kërkoi anulimin e vendimit të Senatit. Mbi bazën e ankesës së ankuesit A.nr.903/2017, Avokati i Popullit vëren se Rektorati i UP-së edhe më tej vazhdon të mos e zbatojë Aktgjykimin A.nr.1242/2010, i datës 9 dhjetor 2013, dhe një veprim i tillë përbën shkelje të nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit 03/L-199 për Gjykatat, sipas të cilit “Vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë personat fizikë dhe juridikë”.

Duke u bazuar në Ligjin e Punës, përkatësisht në nenin 7, par. 1, dhe në nenin 67, par.1.4, kufizimi i moshës në rastin konkret, i paraparë me Statutin e UP-së dhe Vendimin e Senatit të UP-së, përbën akt diskriminues dhe është në kundërshtim të plotë me normat ligjore të parapara me legjislacionin vendor dhe ndërkombëtar. Kjo praktikë e UP-së është në kundërshtim me parimin e ligjshmërisë si dhe me parimin e sigurisë juridike.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit regjistroi edhe raste të tjera sipas detyrës zyrtare dhe raste individuale, që kanë të bëjnë me diskriminimin në punë. Hetimet janë në vazhdim e sipër dhe shpjegimet e Avokatit të Popullit për këto raste priten në periudhën e ardhshme.

E drejta për pension

Jo të gjitha skemat pensionale ose skemat e kompensimit aktualisht¹⁷⁵ janë të rregulluara me një ligj të veçantë. Janë tetë ligje të ndryshme, të cilat i rregullojnë skemat pensionale dhe shpesh bien ndesh me njëri-tjetrin. Prandaj zbatimi i tyre përgjithësisht është i vështirë.

Gjatë periudhës raportuese, IAP-ja ka pranuar një numër të konsiderueshëm të ankesave, në të cilat pretendimet e ankuesve lidheshin përkitazi me përfitimet e së drejtës në pensione nga dy skema pensionale. Për më tepër, ankuesit në ankesat e tyre pretendonin se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, konkretisht Departamenti i Pensioneve, pa

¹⁷⁵ Mes tjerash, Ligji nr. 04/I-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, neni 2 “Skemën e Pensionit Bazik të Moshës, Skemën e Pensionit Kontributpagues të Moshës, Skemën e Pensionit të Aftësisë së Kufizuar dhe Skemën e Pensionit të Parakohshëm, (...) familjar dhe invalidor të punës, në rastet kur kontribuesit lëndohen në punë apo fitojnë sëmundje profesionale, <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=9517>, Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre dhe Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

paralajmërim i kanë përjashtuar nga njëra skemë pensionale, të drejtë të cilën ata e kishin fituar vite më parë. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit, më 27 shkurt 2018, ia ka përcjellë Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), Raportin me Rekomandime përkitazi me të drejtën në pension kontributpagues të moshës, si dhe të drejtën në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.¹⁷⁶

Qëllimi i Avokatit të Popullit ka qenë që organit relevant t'ia tërheqë vëmendjen që qytetarëve t'u sigurohet realizimi i së drejtës së garantuar me ligj për shfrytëzimin e pensioneve kontributpagues, siç është e definuar me Ligjin nr. 04/L-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, me të drejtën në ushtrimin e pensioneve në bazë të Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre dhe Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka konstatuar se, përkundër faktit që një person i plotëson kushtet e parashikuara me ligj për shfrytëzimin e të drejtës në pension kontributpagues të moshës, ose cilindo pension tjetër të financuar nga shteti, i njëjti nuk mund të privohet nga e drejta për t'i gëzuar pensionet e garantuara me ligj. Kjo rrjedh nga dispozitat ligjore (neni 8, paragrafi 3 i Ligjit për Skemat e Pensioneve të Financuara nga Shteti),¹⁷⁷ sepse korniza ligjore e lejon ushtrimin e së drejtës vetëm për një pension. Ajo që duhet të theksohet është se dispozitat ligjore nuk e sqarojnë se kush e zgjedh pensionin, të cilin ai do të vazhdojë ta gëzojë. Ligji për Vlerat e Luftës, në mënyrë të qartë ia jep këtë të drejtë personit që i plotëson kushtet për ushtrimin e së drejtës për një nga pensionet e parashikuara nga ky ligj. Mirëpo, kjo nuk pasqyrohet edhe në Ligjin për Skemat e Pensioneve.

Avokati i Popullit vlerësoi se një përkufizim i tillë i së drejtës për shfrytëzimin e pensionit kontributpagues të pleqërisë, ose cilindo pension tjetër të financuar nga shteti, përkundër faktit se plotësohen kushtet e përcaktuara me ligj, paraqet shkelje të së drejtës në pronë. Avokati i Popullit e vlerësoi se e drejta për ta gëzuar pensionin, veçanërisht pensionin kontributpagues të pleqërisë, dhe se kjo e drejtë e fituar (*acquired right*), që paraqet një doktrinë ligjore, sipas së cilës, një e drejtë e fituar në bazë të normave të caktuara ligjore nuk mund të kufizohet nga ligjet ose aktet e nxjerra më vonë. Doktrina për të drejtën e fituar është e lidhur ngushtë me parimin e sigurisë juridike. Prandaj, kufizimi i së drejtës për ta gëzuar pensionin kontributpagues në bazë të nenit 8 të Ligjit nr. 04/L-131 për Skemat e Pensioneve të Financuara nga Shteti e shkel parimin e sigurisë

¹⁷⁶ Raporti është bazuar në lëndën A. 890/2016 dhe mbështetet në pretendimet, faktet dhe dëshmitë, të cilat parashtruesi i ankesës i ka dorëzuar në IAP, lidhur me ndërprerjen e pensionit kontributpagues. Përveç ankesës në fjalë, Avokati i Popullit pranoi edhe ankesa të tjera të natyrës së njëjtë. Qëllimi i Raportit është që të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që t'ua ofrojë qytetarëve të drejtat e garantuara ligjore dhe kushtetuese në ushtrimin e së drejtës në pensionet kontributpagues, si e drejtë në pronë.

¹⁷⁷ "Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj."

juridike, sepse kjo e drejtë është fituar sipas ligjeve të mëparshme të pensionit dhe nuk mund të ndryshohet me ndonjë ligj tjetër.¹⁷⁸

Përveç rasteve të lartpërmendura, Avokati i Popullit, gjatë periudhës raportuese, hapi një rast të *ex officio* 235/2018, në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999, të cilët nuk ushtrojnë të drejtën për pensioni kontributpagues të moshës, për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 vjetëve, si pasojë e largimit diskriminues nga puna.

Në këtë raport është trajtuar e drejta në pensionin kontributpagues të moshës, konkretisht pamundësia e shfrytëzimit të kësaj të drejte nga kategoria e shtetasve që kanë punuar para vitit 1999, por për shkak të largimit nga vendi i punës gjatë kohës së imponimit të masave të dhunshme në Kosovë, ata nuk arritën t'i plotësojnë 15 vjet shërbim të pensionit, si kriter ligjor për shfrytëzimin e pensionit kontributpagues të moshës.

E drejta e qytetarëve që i përkasin kësaj kategorie për ta ushtruar të drejtën për një pension kontributpagues për periudhën para vitit 1999 (që nuk arritën t'i plotësojnë 15 vjet shërbim të pensionit) konsiston në një kolizion midis ligjit që e ka përcaktuar kriterin e përfitimit të këtij lloji të pensionit (15 vjet përvojë pune pensionale, siç thuhet në legjislacionin aktual) me parimet që lidhen me të drejtat themelore të njeriut (përkatësisht të drejtën e mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, së drejtës për të mos u diskriminuar) dhe obligimet pozitive të shtetit në raport me të drejtat e qytetarëve të vet.

Avokati i Popullit, pas analizës së legjislacionit që ka qenë në fuqi para viteve të 90-ta, në lidhje me të drejtën në pension kontributpagues, vëren se ligji (Ligji nr. 011-24/83 i KSAK në lidhje me Ligjin federativ) i asaj kohe, si kriter për të përfituar të drejtën në pension kontributpagues, përveç tjerash, ka përcaktuar arritjen e stazhit pensional prej së paku 15 vjetëve. I njëjti kriter është pranuar edhe me legjislacionin e pasluftës, përfshirë edhe LSPFSh që aktualisht është në fuqi.

Për këto arsye, dhe duke u bazuar në detyrimet kushtetuese dhe obligimet pozitive që i ka shteti në raport me qytetarët, Avokati i Popullit e konstaton domosdoshmërinë që Qeveria e Republikës së Kosovës të marrë masa që të gjithë qytetarët që kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuese të përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës. Për këtë qëllim është e nevojshme të ndryshohet LSPFSh, përkatësisht neni 8 i tij¹⁷⁹.

Lidhur me të drejtën për realizimin e pensioneve të moshës, më 17 maj 2018, Avokati i Popullit nisi një hetim sipas detyrës zyrtare¹⁸⁰ në bazë të informacioneve të marra nga qytetarët e përkatësisë etnike serbe të komunës së Graçanicës, të Prizrenit, të Mitrovicës dhe të Klllokotit, për vështirësitë në të cilat po hasin me rastin e aplikimit për pension të pleqërisë te organi kompetent i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe për

¹⁷⁸ Për më tepër, shih Raporti Vjetor 2018, pjesa përmbledhje të raporteve me rekomandime.

¹⁷⁹ Për më tepër shih Raportin Vjetor 2018, pjesa me përmbledhje të raporteve me rekomandime .

¹⁸⁰ Ex Officio 324/2018

dokumentacionin shitesë që kërkohet arbitrarisht prej tyre nga ana e disa zyrtarëve të zyrës përkatëse të administratës së pensioneve. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit është informuar se kjo problematikë nuk është unike nëpër të gjitha zyrat e administratës pensionale, por është evidente nëpër zyrat e lartpërmendura. IAP-ja është në zhvillim e sipër të hetimeve për këtë rast.

Në bazë të informacioneve që i ka Avokati i Popullit, Qeveria tashmë i ka ndërmarrë disa hapa në reformimin e sistemit të pensioneve dhe përfitimeve. Plani i Qeverisë është që ta hartojë një ligj unik pensional, i cili në një vend do të përfshijë dhe trajtojë të gjitha të drejtat për pensionet, si dhe krijimin e një Fondi të sigurimeve sociale, me të cilin ligj do të definohej struktura organizative, forma e qeverisjes, norma e kontributit dhe pensioni invalidor, me qëllim të përafrimit me praktikën evropiane. Qeveria e ka punuar Koncept Dokumentin për reforma të pensioneve,¹⁸¹ i cili, përveç krijimit të një sistemi të qëndrueshëm për gjeneratat e ardhshme, pritet të sigurojë edhe njohjen e përvojës së punës për punonjësit, të cilët janë përjashtuar nga vendet e tyre të punës gjatë periudhës 1990-1999. Megjithatë, deri në kohën kur po raportohet, situata e skemës pensionale vazhdon të mbetet e pandryshuar. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Kosovës duhet të shpejtojë hapat drejt reformës në sistemin pensional.

Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale

Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore vazhdon ende të jetë jashtë listës së instrumenteve ligjore në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë¹⁸². Avokati i Popullit edhe në raportet paraprake vjetore e ka ngritur këtë çështje, e cila ka një rëndësi të veçantë, sepse do ta kompletonte më tej listën e instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë dhe njëherësh do të ndikonte në avancimin e mbrojtjes së të drejtave ekonomiko-sociale në vend.

Bazuar në ankesat e pranuar në IAP si dhe nga vizitat e realizuara në terren, Avokati i Popullit konsideron se ndër faktorët kryesorë që janë duke ndikuar në jetën e rënduar ekonomike dhe sociale në Kosovë janë papunësia si faktor kyç, mungesa e legjislacionit për sigurime shëndetësore, e cila po e vështirëson marrjen e shërbimeve mjekësore adekuate nga qytetarët, si dhe legjislacioni i cili e rregullon çështjen e Skemës së Ndhmës Sociale në Kosovë. Bazuar në rastet e pranuar në IAP, edhe gjatë këtij viti raportues, gjendja ekonomiko-sociale në Kosovë mbetet sfidë dhe shqetësim për Avokatin Popullit.¹⁸³

¹⁸¹ <https://mpms.rks-gov.net/sr/recica-hap-konsultimet-publike-per-koncept-dokumentin-e-reformes-pensionale/lajme>

¹⁸² Shih <https://www.oik-rks.org/2017/03/31/raporti-vjetor-2016/>, Raportin Vjetor të Avokatit të Popullit, të vitit 2016, fq.64.

¹⁸³ Shih <https://www.oik-rks.org/2017/03/31/raporti-vjetor-Raportet-Vjetore-paraprake-të-Avokatit-të-Popullit>.

Gjatë këtij viti raportues, në IAP, nga kategoria Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale, janë pranuar gjithsej 374 ankesa, prej tyre 108 janë hapur për hetim. Duke pasur parasysh numrin e lartë të ankesave në këtë kategori, edhe gjatë këtij viti raportues, Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera në Kosovë duhet shtuar përpjekjet e tyre në ndërmarrjen e masave për përmirësimin dhe zhvillimin e disa sektorëve jetikë që mundësojnë zhvillimin social dhe ekonomik të vendit.

Për vite me radhë, Avokati i Popullit shprehu shqetësimin lidhur me kriterin e vendosur për përfitim të ndihmës sociale përkatësisht kufizimi për përfitim të ndihmës sociale për fëmijët nën moshën 5 vjeçare, e cila po vazhdon të thellonjë edhe më tepër gjendjen e rëndë, sepse këto familje, në mënyrë të planifikuar, çdo 5 vjet lindin edhe nga një fëmijë në mënyrë që të mos u ndërpritet ndihma sociale. Këtë shqetësim Avokati i Popullit e ka ngritur edhe në raportet vjetore paraprake. Megjithatë, ky Ligj vazhdon të jetë i zbatueshëm edhe më tej.

Sipas të dhënave statistikore të dërguara nga përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale në Institucionin e Avokatit të Popullit, vetëm për muajin dhjetor të vitit 2018, përfitues të ndihmës sociale janë gjithsej 25, 345 familje, me numrin e anëtarëve prej 103,437, prej tyre 19,602 familje me 82,586 anëtarë janë nga komuniteti shqiptar, 2,422 familje me numrin e anëtarëve prej 6,176 janë të komunitetit serb, 1,414 familje me numrin e anëtarëve prej 6,836 anëtarëve janë të komunitetit ashkali, 965 familje me numrin e anëtarëve prej 4,312 anëtarëve janë të komunitetit rom, 354 familje me numrin e anëtarëve prej 1,712 janë të komunitetit egjiptian, 262 familje me numrin e anëtarëve prej 856 janë të komunitetit boshnjak, 168 familje me numrin e anëtarëve prej 463 janë të komunitetit goran, 74 familje prej 213 anëtarëve janë të komunitetit turk, 16 familje prej 41 anëtarëve janë të komunitetit kroat, 4 familje prej 9 anëtarëve janë të komunitetit malazez dhe 64 familje prej 244 anëtarë janë të tjerë.¹⁸⁴

Më 13 korrik 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/I-96 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë . Raporti gjithashtu arsyeton domosdoshmërinë e ndryshimit të nenit 4 të Ligjit në raport me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, pasi me këtë kufizim po rëndohet edhe më shumë jeta dhe mirëqenia e qytetarëve, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Për më tepër, kushtet e përcaktuara për ndihmë sociale me dispozitat ligjore në fuqi kanë ndikuar në përkeqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familjeve, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në rritjen adekuate të fëmijëve dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi, veçmas qytetarët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Të dhënat e

¹⁸⁴ Këto informata janë marrë nga një zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, më datën 16 janar 2019.

tjera lidhur me këtë rast mund të gjenden në pjesën e raportit që i referohet të drejtave të fëmijëve.

Ligji për Sigurimin Shëndetësor¹⁸⁵, i cili ka për qëllim sigurimin e qasjes universale të qytetarëve dhe banorëve të Republikës së Kosovës ndaj shërbimeve kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, megjithëse u krijua në vitin 2004 dhe u miratua në vitin 2007, deri më sot nuk është zbatuar. Edhe pas zotimeve të shpeshta nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës që nga janari i vitit 2017 Fondi i Sigurimeve Shëndetësore do të jetë funksional dhe do të fillojë me mbledhjen e fondeve për të njëjtin, kjo ende nuk ka ndodhur. Shqetësimin e tij lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit e ka ngritur edhe në Raportet vjetore paraprake. Moszbatimi i këtij ligji po ndikon drejtpërdrejt tek qytetarët përkitazi me mungesat e kushteve të përshtatshme të shërbimeve mjekësore. Avokati i Popullit rekomandon që Qeveria e Kosovës me prioritet të ndërmarrë veprime, të cilat do të mundësonin zbatimin e këtij ligji.

Strehimi Social

E drejta në banim është një çështje mjaft e rëndësishme për stabilitetin social, shëndetin dhe zhvillimin kualitativ të mirëqenies njerëzore. Projektet e banimit social janë mjaft të rëndësishme për mirëqenien e qytetarëve me kushte të rënda ekonomike. E drejta në banim në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut është duke u vlerësuar si pjesë integrale e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore, në nivel të njëjtë me të drejtat civile dhe politike. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut siguron se të gjithë njerëzit kanë të drejtë në standard të jetesës që është i përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre. Ky është një standard me përmasa globale dhe është përfshirë në shumë instrumente ndërkombëtare. Ligji për Financimin e Programeve të Veçanta të Banimit në Kosovë obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe komunat në ofrimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme për banim për qytetarët.

Krahasuar me vitet e kaluara, në këtë vit raportues, në çështjen e zbatimit të projekteve për strehim social janë vërejtur lëvizje pozitive, por kërkesat e qytetarëve në nevojë vazhdojnë të jenë ende të larta.

Komuna e Prishtinës, gjatë muajit shkurt 2018, publikoi listën e 50 familjeve përfutuese të banesave për kategoritë e luftës, përfshirë familjet e dëshmorëve, të veteranëve dhe invalidëve të UÇK-së. Kategoritë e familjeve që kanë mundur të përfitojnë nga programi i veçantë i banimit, në pajtim edhe me Ligjin, ishin ato familje që komisioni i ka vlerësuar dhe verifikuar që nuk kanë banesë apo shtëpi në pronësi individuale; familjet që jetojnë në shtëpi apo banesë të rrezikshme dhe të papërshtatshme për banim; familjet që kanë mbetur pa banesë/shtëpi, si rezultat i dëmtimit të shtëpive gjatë luftës së fundit në Kosovë; dhe familjet që jetojnë në objekte të huaja me ose pa qira. Gjithashtu, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në bashkëpunim me Komunën e Podujevës, në këtë vit

¹⁸⁵ Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12880>.

kanë ndërtuar 70 shtëpi për familjet me gjendje të rëndë sociale¹⁸⁶. Në fshatin Stantërg të komunës së Mitrovicës, në këtë vit është përfunduar një objekt i banimit social për 17 familje me kushte e rënda sociale. Ky objekt u financua nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, kurse prona është dhënë nga Komuna e Mitrovicës. Komuna e Prizrenit, gjatë muajit nëntor 2018, në bashkëpunim me një organizatë joqeveritare, ndau 28 shtëpi për 28 familje me kushte të rënda sociale¹⁸⁷.

Megjithatë, bazuar në ankesat e parashtruara në IAP, edhe sot strehimi social mbetet sfidë, si për qytetarët me gjendje të rëndë ekonomike, ashtu edhe për institucionet, si në nivelin qendror, edhe në nivel lokal në Kosovë. Avokati i Popullit, gjatë kësaj periudhe raportuese, ka pranuar ankesa lidhur me mungesën e kushteve të përshtatshme për jetesë.¹⁸⁸ Lidhur me këto raste, Avokati i Popullit, në vitin 2017, i është drejtuar me Letër me rekomandime Komunës së Istogut dhe asaj të Podujevës. Megjithatë, këto rekomandime nuk janë zbatuar edhe sot nga këto dy komuna dhe se gjendja e këtyre familjeve vazhdon të mbetet e njëjtë.

Bazuar nga ankesat në IAP,¹⁸⁹ janë disa familje të cilat jetojnë në shtëpi të improvizuara që janë në pronësi publike në afërsi të hekurudhave të trenit, si në Podujevë, Istog, Fushë Kosovë, Graçanica etj., dhe janë në lista prioritare. Megjithatë, komunat nuk kanë arritur t'u sigurojnë strehim social. Në ndihmë për ndërtimin e shtëpive për këto familje u janë ofruar organizata të ndryshme donatore. Gjithsesi, mungesa e pronës ka qenë arsye e mos mbështetjes për këto familje. Për këto familje disa nga komunat kanë ofruar vetëm ndihma ushqimore, dru zjarri etj.

Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe, Avokati i Popullit ka pranuar ankesa nga komuniteti rom, të cilët jetojnë në komunën e Graçanicës, përkitazi me mungesë të kushteve të banimit. Për njërin nga rastet e hapura në IAP, Komuna e Graçanicës është duke e shqyrtuar mundësinë e ndërtimit të një shtëpie për strehim,¹⁹⁰ kurse rastit tjetër ia ka siguruar një banesë.¹⁹¹

Gjatë këtij viti raportues bazuar në informata nga mediat, Avokati i Popullit ka hetuar sipas detyrës zyrtare çështjen e mos nënshkrimit të Marrëveshjes së Mirëkuptimit në mes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komunës së Lipjanit lidhur me mbështetjen e projekteve për komunitetet joshumicë.¹⁹² Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje ishte pjesë e projektit kapital “Mbështetje për komunitetet joshumicë” për komunitetin turk, atë boshnjak, rom, ashkali, egjiptian, goran. Pas hetimit të këtij rasti, Avokati i Popullit ka gjetur se Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Komuna e Lipjanit

¹⁸⁶ <https://kk.rks-gov.net/podujeve/news/kryetari-veliu-dorezoi-celesat-e-shtepive-te-reja-per-20-familje-ne-lagjen-e-deshmoreve/>.

¹⁸⁷ <https://gazetaeprizrenit.net/28-banesa-do-te-ndahen-per-familjet-me-gjendje-sociale-ne-prizren-e-sharr/>

¹⁸⁸ Rastet e regjistruara në data bazën e IAP-së: A.nr.913/2018, A.nr.643/2018, 759/2018, A.nr.380/2018, A.nr.331/2018.

¹⁸⁹ Rastet e regjistruara në data bazën e IAP-së: A. 927/2016 OIK-Komuna e Graçanicës, A.nr.312/2017

¹⁹⁰ Rast i regjistruar në data bazë IAP: A.nr. 927/2016.

¹⁹¹ Rast i regjistruar në data bazë IAP A.nr.526/2016.

¹⁹² Rasti i regjistruar në data bazë IAP:A. .528/2018.

janë pajtuar në pikat kontestuese dhe kanë nënshkruan Marrëveshjen e Mirëkuptimit. Bazuar në informatat zyrtare të cilat i ka pranuar Avokati i Popullit, implementimi i kësaj marrëveshjeje nëpër komunat përfituese ka filluar me 19 nëntor 2018.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka hapur një rast tjetër sipas detyrës zyrtare lidhur me kthimin e disa familjeve rrome nga Maqedonia për në komunën e Obiliqit¹⁹³. Ky rast është ende në procedurë të hetimit dhe pas analizimit të situatës në fjalë, pritet të veprohet në përputhje me mandatin dhe kompetencat e IAP-së.

Komunitetet LGBTI

Komunitetet LGBTI, si pjesë e shoqërisë në Kosovë, konsiderohen të jenë kategori të marginalizuar edhe përkundër faktit se ekziston kornizë ligjore e cila i mbron të drejtat e tyre. Është evidente se qëndrimet homofobike ende janë të theksuara në shoqërinë kosovare. Personat LGBTI ende jetojnë me frikë për ta shprehur orientimin e tyre seksual, për shkak të qasjes dhe homofobisë së shoqërisë ndaj tyre, dhe kjo është arsyeja që ata janë të diskriminuar në jetën e përditshme.

Sa i përket legjislacionit i cili rregullon të drejtat e personave LGBT, është evidente që nuk mbetet asnjë zbrazësi në legjislacionin ekzistues, që kërkon plotësim lidhur me mbrojtjen e mëtejshme të të drejtave të njeriut në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor. Por, problemi qëndron në faktin se legjislacioni përkatës në këtë fushë nuk zbatohet në mënyrë adekuate. Avokati i Popullit rikujton se parimi i shtetit të së drejtës, si parim themelor i Kushtetutës dhe Konventës, obligon organet shtetërore ta respektojnë/zbatojnë legjislacionin e aprovuar nga legjislativi i vendit. Garancitë Kushtetuese për të drejtat e njeriut janë vlera themelore të shoqërisë demokratike që i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë, sepse këto vlera janë baza themelore për funksionimin e shtetit dhe së drejtës, si dhe janë parakusht i respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve.

Avokati i Popullit rikujton se Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi e themelon kornizën e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, duke i konkretizuar dispozitat kundër diskriminimit, të parapara me instrumentet ndërkombëtare dhe me Kushtetutë. Fushëveprimi i këtij ligji, në kuptim të nenit 1, e parasheh parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, përfshirë identitetin gjinor dhe orientimin seksual.

Ashtu siç e përcakton legjislacioni në fuqi, në regjistrat e gjendjes civile që me lindje shënohen të dhënat si emri, mbiemri, shënuesi i gjinisë etj. Udhëzimi Administrativ (MPB) nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, përcakton dhe rregullon kriteret dhe procedurat për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal për shtetasit e Republikës së Kosovës. Megjithatë, edhe sot nuk ka ndonjë bazë ligjore e cila do të mundësonte që qytetarët, mbi bazën e së drejtës në identitet gjinor të garantuar me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, të kenë mundësi të kërkojnë

¹⁹³ Rasti i regjistruar në data bazë IAP: A.nr.453/2018.

ndërrimin e shënjesit të gjinisë. Avokati i Popullit konstaton se mospërputhja e statusit ligjor me identitetin personal gjinor ka ndikim jashtëzakonisht të rëndë në një sërë situatash të shpeshta në jetën e përditshme. Prandaj rekomandon që Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë veprime konkrete që, përmes sistemit të vet ligjor, t’u ofrojë garanci shtesë individëve, që t’i gëzojnë të drejtat e tyre në mënyrë efektive kundër arbitraritetit¹⁹⁴.

Ligji për Familjen i Kosovës, në nenin 14, rregullon çështjen e martesës dhe e specifikon gjininë femër dhe mashkull si kusht për lidhje të martesës.¹⁹⁵ Avokati i Popullit tërheq vëmendjen në të drejtën e identitetit gjinor, i cili mbrohet me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi. Rrjedhimisht, konsideron që Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë veprime konkrete në harmonizimin e legjislacionit, sepse vetëm në këtë formë do të ofrohej një garanci shtesë për individin, që t’i gëzojë të drejtat e garantuara.

Megjithatë, edhe pse jokënaqshëm, mund të thuhet se në shoqërinë tonë kanë filluar hapat e parë për ndryshime pozitive sa i përket qasjes ndaj komuniteteve LGBTI. Në vitin 2018, në ditën ndërkombëtare kundër homofobisë, e organizuar nga OJQ të cilat i mbrojnë interesat e qytetarëve të komuniteteve LGBTI, është mbajtur Parada e krenarisë, me moton “Në emër të dashnisë”, pa incidente dhe me mbikëqyrjen e Policisë së Kosovës.

Krahas organizatorëve në paradë, pjesëmarrës ishin edhe përfaqësuesit e institucioneve publike, përfaqësuesit e Bashkimit Evropian, personalitete nga shoqëria civile si dhe qytetarë. Në këtë parade ishin prezentë edhe përfaqësuesit e Institucionit të Avokatit të Popullit.¹⁹⁶

Avokati i Popullit gjatë këtij viti raportues ka shqyrtuar një ankesë përkitazi me refuzimin e Zyrës së Gjendjes Civile për të ndryshuar gjininë në dokumentet e identitetit nga ‘femër’ në ‘mashkull’.

Ankesa ishte e drejtuar kundër Zyrës së Gjendjes Civile të Komunës së Gjakovës për ndërrimin e emrit dhe shënjesit të gjinisë. Zhvillimet lidhur me këtë rast kanë arritur në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Prandaj, përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), i është drejtuar gjykatës me një mendim juridik.

Qëllimi i paraqitjes së Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës në Gjykatën Kushtetuese, është që ta mbështesë kërkesën e ankuesit në mënyrë të kërimit të lirimit të

¹⁹⁴ Mendimi juridik i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës A.nr.252/2018.

¹⁹⁵ Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës, në nenin 14, rregullon çështjen e martesës e cila përcaktohet të jetë “bashkësi e regjistruar ligjërisht në mes të dy personave të sekseve të ndryshme, me anë të së cilës ata lirshëm vendosin që të jetojnë së bashku me qëllim të krijimit të familjes. Për më tepër, ky ligj përcakton se mashkulli dhe femra kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të formojnë familje pa ndonjë kufizim në bazë të racës, kombësisë apo religjionit, si dhe janë të barabartë gjatë lidhjes së martesës, vazhdimet të martesës dhe zgjidhjes së saj”, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12880>

¹⁹⁶ Parada e krenarisë, me moton “Në emër të dashnisë”, e mbajtur në sheshin e Prishtinës, 10 tetor 2018.

ankuesit nga detyrimi i shterjes së të gjitha mjeteve juridike, për shkak se rrethanat e rastit e bëjnë pritjen e procedimit të padisë nga gjykatat e rregullta mjet joefektiv dhe të papërshtatshëm.¹⁹⁷

Avokati i Popullit duke u bazuar në praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) ka vënë në pah se rregulli i shterimit të mjeteve juridike duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar, duke e sqaruar se rregulli i shterjes së mjeteve juridike nuk është absolut dhe nuk duhet të zbatohet në mënyrë automatike, por është më rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual.

Avokati Popullit po ashtu ka vënë në pah edhe praktiken e vetë Gjykatës Kushtetuese në rastet kur kjo gjykatë kishte konstatuar se parashtruesit nuk kishin qasje në mjete juridike efektive dhe e kishte lejuar shfrytëzimin e këtij juridiksioni pa i shterur mjetet juridike. Prandaj, këto konstatime përshtatshëmrisht do të mund të zbatoheshin edhe në rastin e ankuesit në fjalë.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë qenë të angazhuar në mbrojtjen e të drejtave të personave të komuniteteve LGBTI, edhe përmes pjesëmarrjes nëpër konferenca brenda dhe jashtë vendit, në emisione televizive, tryeza e debate si dhe në takimet e Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues në nivel nacional në Republikën e Kosovës për të drejtat e komunitetit LGBT, të organizuara nga Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të Zyrës për Barazi Gjinore.

Barazia gjinore

Barazia gjinore nënkupton mundësi të barabarta për të gjitha gratë, burrat dhe personat e identiteteve të ndryshme gjinore në shoqëri, që kontribuojnë në përparimin ekonomik, social, kulturor, politik, duke ofruar mundësi të barabarta për të shfrytëzuar të gjitha përfitimet e progresit të një shoqërie demokratike.

E garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, barazia midis gjinive nënkupton vlerën themelore në një shoqërie e cila për synim ka zhvillimin e demokracisë dhe mbrojtjen e të drejtave të barabarta të grave dhe të burrave. Institucioni i Avokatit të Popullit, me Ligjin për Barazi Gjinore, përcaktohet si institucion i barazisë, i cili i trajton rastet e diskriminimit gjinor në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Ligji për Barazinë Gjinore është korniza themelore institucionale dhe legislative për arritjen dhe promovimin e barazisë gjinore në Republikën e Kosovës.¹⁹⁸ Ky ligj mbron dhe promovon barazinë gjinore, baza e të cilit është Kushtetuta e Kosovës dhe normat e së drejtës ndërkombëtare, të cilat garantojnë të drejtën për barazi gjinore. Fokusi i ligjit

¹⁹⁷ Mendimi juridik i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës A.nr.252/2018.

¹⁹⁸ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>, Ligji për Barazi Gjinore nr.05/L-020.

është kryesisht definimi më i afërt i politikës së mundësive të barabarta në fusha të rëndësishme të të drejtave të njeriut (puna, punësimi, arsimit, kultura, familja, jeta politike), mbrojtja e të drejtave të barazisë gjinore dhe, në veçanti si instrumente të mbrojtjes, masat e ndërmarra për të eliminuar pabarazinë faktike.

Barazia gjinore, sipas këtij ligji, nënkupton pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e jetës publike dhe private dhe politikat e mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e barabartë të grave në të gjitha fazat e planifikimit, miratimit dhe zbatimit të vendimeve që ndikojnë në pozitën e grave dhe burrave. Politika e mundësive të barabarta kërkon që shteti të krijojë një mjedis shoqëror dhe politik në të cilin secili individ ka mundësi të njëjtë për t'i ushtruar të drejtat e tij.

Megjithatë, për periudhën për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit ka vënë re se nuk ka pasur ndonjë lëvizje domethënëse për barazinë gjinore në Republikën e Kosovës. Ligji për Barazi Gjinore nuk ka gjetur zbatim adekuat në praktikë. Prandaj mbetet që legjislativi, gjyqësori dhe ekzekutive të veprojnë në praktikë për zbatimin e ligjit dhe të sigurojnë që parimi i barazisë të mos mbetet vetëm vlerë e garantuar *de jure*, por edhe *de facto*. Për më tepër, Avokati i Popullit rikujton se parimi i shtetit të së drejtës, si parim themelor i Kushtetutës dhe Konventës, obligon organet shtetërore të respektojnë/zbatojnë legjisllacionin e aprovuar nga legjislativi i vendit.

Bazuar në ankesat e parashtruara në IAP, gratë janë në një pozitë më pak të favorshme se burrat në fushën e punësimit, zhvillimit të karrierës, veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara, gratë e moshuara, gratë rome, gratë të reja, gratë shtatzëna dhe nënat me fëmijë të mitur.

Barazia gjinore ndërlidhur me çështjen e së drejtës në punë

Niveli i lartë i papunësisë, rolet tradicionale gjinore dhe faktorët ekonomikë janë elementet kyçe që i vështirësojnë pozitën e grave në tregun e punës. Edhe në vitin 2018 është përsëritur përvoja shumëvjeçare, e cila tregon se një numër i konsiderueshëm i grave ankohet për problemet që lidhen me të drejtën në punë dhe çështjen ekonomike, mbrojtjen sociale dhe prindërore, apo lidhur me shkeljen e të drejtave gjatë shtatzënisë dhe pushimit të lindjes.

Nga ankesat e pranuar në IAP përkitazi me të drejtën e punës gjatë periudhës raportuese, është vënë re se ankueset jo gjithmonë arrijnë të bëjnë dallimin mes shkeljeve të të drejtave në bazë të gjinisë dhe diskriminimit nga shkelja e të drejtave të punës, ose të drejtave sociale, shëndetësore. Rrjedhimisht, për këtë shkak problemet në shoqëri, në përgjithësi, nuk perceptohen nga një perspektivë gjinore. Aspekte të tjera të diskriminimit në fushën e punës paraqesin edhe largimet e paligjshme të grave nga puna, mosdhënia e mundësive për aftësim profesional në punë dhe pengimet lidhur me avancimin në punë.

Përgjegjësia e vazhdueshme e grave për punën, kujdesi për anëtarët e familjes dhe mungesa e shërbimeve sociale, shkaktojnë në mënyrë të përsëritur pabarazinë në tregun e punës. Trajtimi i barabartë i grave dhe burrave në tregun e punës varet edhe në sigurimin

e mjaftueshëm të institucioneve dhe shërbimeve për kujdesin e fëmijëve dhe të anëtarëve të moshuar të familjes të varur prej tyre. Prandaj, Avokati i Popullit e konsideron më se të nevojshme ndërmarrjen e veprimeve konkrete nga niveli qendror dhe lokal, lidhur me shtimin e numrit të çerdheve për fëmijët, si dhe shtimin e numrit të personelit medicinal për kujdesin shtëpiak për të moshuarit.

Gjithashtu, Ligji për Barazi Gjinore ka paraparë përfaqësimin të barabartë gjinor, i cili duhet të jetë në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet drejtuese dhe vendimmarrëse. Megjithatë, edhe sot ky ligj vazhdon të mos zbatohet, konkretisht dispozita që kërkon përfaqësimin prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini nuk zbatohet, dhe si e tillë mbetet problem i vazhdueshëm që kërkon një qasje më serioze institucionale.¹⁹⁹

Në këtë periudhë të raportimit, mes tjerash, është pranuar një ankesë ku ankuesja pretendon se është diskriminuar në bazë të gjinisë, në procesin e konkursit të brendshëm për plotësimin e pozitave të lira të punës.²⁰⁰

Sipas pohimeve të ankueses, që nga viti 2008, ajo ka ushtruar detyrën udhëheqëse, por në procesin e rekrutimit të brendshëm, pas vlerësimit të komisionit rekrutues, ajo nuk është përzgjedhur. Ankuesja pretendon se është diskriminuar në bazë të gjinisë gjatë procesit të përzgjedhjes së kandidatit për këtë vend pune. Rasti i ankueses është ende në fazën e hetimit.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, në IAP është në procedurë të hetimeve edhe një rast ku ankuesja pretendon në shkeljen e së drejtës në punë dhe diskriminim, përkitazi me mos ngritjen e koeficientit të pagës²⁰¹.

Sipas pohimeve të ankueses, në bazë të Rregullores për përshkrimin e detyrave të punës, pozita e saj nuk është trajtuar njësoj sikurse edhe pozitat e punës me koeficient të njëjtë. Për më tepër, në këtë rast ankuesja pretendon se në bazë të kësaj rregulloreje, pozicionet ekuivalente për të gjithë stafin janë avancuar, ndërsa ajo është e vetmja që është diskriminuar dhe degraduar për një gradë. Avokati i Popullit i është drejtuar institucionit përgjegjës me letër për të kërkuar informata në pretendimet e ankueses.

E drejta e pronës dhe e trashëgimisë

E drejta në pronë është një e drejtë themelore e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si akti më i lartë juridik i vendit. Gjithashtu, e drejta në pronë rregullohet edhe

¹⁹⁹ Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L -019, neni 3 paragrafi 1.15. Përfaqësimi i pabarabartë - është atëherë kur pjesëmarrja apo përfaqësimi i njëres gjini është më i ulët se pesëdhjetë për qind (50%) në çdo organ dhe nivel vendimmarrës në jetën politike dhe publike; neni 6, paragrafi 8. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë për qind (50%) për secilën gjini, përfshirë edhe organet e tyre drejtuese dhe vendimmarrëse, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>.

²⁰⁰ Rasti i regjistruar në data bazë IAP:A.nr.637/2018

²⁰¹ Rasti i regjistruar në data bazë IAP: A.nr.399/2018.

nëpërmjet ligjeve të tjera në fuqi si: Ligji për Barazi Gjinore²⁰², Ligji për Familjen²⁰³, Ligji i Trashëgimisë²⁰⁴, Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore²⁰⁵ dhe Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi²⁰⁶, ku parashihet se të gjithë fëmijët e trashëgimlënësit, në kushte të njëjta, janë të barabartë në trashëgimi.

Në raportin vjetor të vitit paraprak, Avokati i Popullit ka theksuar se pas ndryshimit të Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve dhe zëvendësimin e tij me Udhëzimin Administrativ, është zgjatur periudha kohore e zbatimit të këtij udhëzimi, prej periudhës njëvjeçare në periudhën dyvjeçare²⁰⁷. Avokati i Popullit konsideron se Qeveria e Kosovës ka bërë një hap pozitiv me këtë masë afirmative për të nxitur bashkëshortët që të regjistrojnë pasurinë e përbashkët në regjistrin kadastral. Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve, i detyronte të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës, si edhe organet publike²⁰⁸ që të zbatojnë masa e posaçme të përkohshme me qëllim të rritjes së numrit të grave të regjistruara si pronare të përbashkëta. Prandaj, Avokati i Popullit rekomandon se do të duhej të vazhdohet zgjatja e periudhës kohore e zbatimit të këtij udhëzimi. Avokati i Popullit ngrit shqetësimin e tij përkitazi me taksat e transaksionit të pronës dhe njëherësh konsideron se taksa e transaksionit duhet të paguhet vetëm një herë për çdo transaksion, dhe jo për çdo blerës. Avokati i Popullit thekson se të gjitha rregulloret komunale për taksat dhe tarifatat duhet të harmonizohen në tërë Kosovën.

Gjithashtu, sipas legjislacionit në fuqi, gratë dhe burrat i përcakton të kenë të drejta të barabarta në trashëgimi. Megjithatë, duke u thirrur në shoqërinë tonë tradicionale, edhe sot vazhdon në praktikë mohimi i trashëgimisë së pronës tek gratë dhe përparësia e anëtarëve nga gjinia mashkullore për të trashëguar pronën.

Bazuar nga ankesat e parashtruara në IAP, kjo dukuri është e shprehur më së shumti në zonat rurale, por nuk ndryshon shumë situata edhe në zonat urbane. Në shumicën e rasteve vetëm burrat janë subjekt i së drejtës në trashëgimi, përderisa gratë në shumicën e rasteve heqin dorë nga kjo e drejtë. Arsyeja se përse gratë po heqin dorë nga trashëgimia janë të shumta dhe janë të llojllojshme, ku mes tjerash, vlen të theksohet tradita dhe e drejta zakonore me të cilën grave u ndalohet e drejta në trashëgimi. Në shumë raste ato

²⁰² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10923>, Ligji për Barazi Gjinore nr.05/L-020

²⁰³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2410>, Ligji nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës dhe Ligji nr. 06/L-077 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/32 për Familjen i Kosovës.

²⁰⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2407>, Ligji nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë si dhe Ligji 06/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2004/26 për Trashëgiminë në Kosovë.

²⁰⁵ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2643>, Ligji nr. 03/L-154 për Pronësinë dhe të Drejtat Sendore.

²⁰⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10924>, Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi.

²⁰⁷ Udhëzimi Administrativ nr. 03/2017 për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve dhe zëvendësimin e tij me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2017.

²⁰⁸ Udhëzimi Administrativ nr. 03/2017 për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve dhe zëvendësimin e tij me Udhëzimin Administrativ nr. 04/2017, neni 2 dhe neni 4.

heqin dorë nga trashëgimia, për shkak të dëshirës që t'i ruajnë lidhjet e tyre me familjet e origjinës.

Avokati i Popullit thekson se korniza aktuale legislative për trashëgimi është e pamjaftueshme që të përballët me praktikat tradicionale. Nisur nga kjo, ekziston nevoja për legjislacion dhe rregulla procedurale më të qarta dhe të përpikta në njërin anë, ndërsa në anën tjetër duhet të punohet edhe më shumë në ndërgjegjësimin e grave, ashtu edhe burrave, lidhur me të drejtat e tyre trashëgimore.

Dhuna në familje

Dhuna në familje është një realitet në shoqërinë kosovare, megjithatë, vetëm një numër i vogël i tyre raportohet tek autoritetet kompetente. Dhuna në familje paraqet shkelje të të drejtave të njeriut, është bazë e diskriminimit të grave dhe gjithashtu vazhdon të jetë problem i madh i të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Avokati i Popullit, edhe në raportet paraprake vjetore²⁰⁹, ka rekomanduar përfshirjen e Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit) në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky rekomandim është bërë në kuadër të Strategjisë për Zgjerim të Komisionit Evropian, megjithatë, edhe sot nuk është implementuar.

Pas hetimeve në terren, Avokati i Popullit ka pranuar statistikën e Policisë së Kosovës përkitazi me rastet dhunës në familje të raportuara në rajonin e Prishtinës, sipas së cilave janë 332 raste, në rajonin e Prizrenit janë 178 raste, në rajonin e Gjilanit janë 146 raste, Ferizajt 140 raste dhe në rajonin e Pejës 150 raste të tilla.

Avokati i Popullit ka vënë re se në rastet e raportuara, reagimet dhe veprimet e organeve kompetente (Policia, Prokuroria dhe Gjykata) vazhdojnë të mos jenë në nivelin e duhur. Këtë e dokumentojnë ankesat e pranuar në IAP përkitazi me zvarritjet e procedurave gjyqësore sa i përket rasteve të dhunës në familje.²¹⁰

Por gjithashtu ka edhe raste ku viktimat e dhunës në familje hezitojnë t'i raportojnë rastet për shkaqe të ndryshme, e në mesin e të cilave edhe për shkak të lidhjeve emocionale me personin i cili ushtron dhunën, apo edhe për arsye se shoqëria vazhdon ta konceptojë dhunën në familje si një çështje private, e cila nuk duhet të paraqitet jashtë rrethit familjar.

Gjithsesi, Avokati i Popullit e konsideron si hap pozitiv në luftën kundër dhunës në familje përfshirjen e këtij fenomeni në kuadër të Kodit Penal, në të cilin dhuna në familje trajtohet si vepër penale ashtu që kushdo që ushtron dhunë ose keqtrajtim fizik, psikologjik ose ekonomik me qëllim të cenimit të dinjitetit të personit tjetër, brenda një marrëdhënie familjare, të dënohet me gjobë dhe burgim deri në tri vjet.²¹¹

²⁰⁹ <https://www.oik-rks.org/raportet/raportet-vjetore/>.

²¹⁰ Rastet e regjistruara në IAP: A.nr459/2018, A. 665/2018, A.698/2018, A.748/2018

²¹¹ Kodi Penal i Kosovës, neni 248

Në Kosovë ekzistojnë tetë strehimore për viktimat e dhunës në familje, shtatë janë funksionale, ndërsa strehimorja e tetë në Novobërdë ende është në procedure të licencimit. Gjithashtu, janë edhe dy strehimore tjera ku njëra nga to është e dedikuar për fëmijët të cilët i nënshtrohen dhunës në familje si dhe keqtrajttimeve tjera, ndërsa strehimorja tjetër është në funksion të viktimave nga trafikimi me qenieve njerëzore. Strehimoret luajnë një rol të rëndësishëm për rehabilitim dhe riintegrim e viktimave të dhunës në familje. Megjithatë, shqetësuese për Avokatin e Popullit është çështja e funksionimit të tyre. Gjatë periudhës për të cilën raportohen, sfidat kryesore me të cilat përballen strehimoret janë: financimi i qëndrueshëm, licencim, trajnimi i stafit si dhe auditimi transparent i punës së tyre.

Mungesa e financimit të qëndrueshëm për strehimoret përbën sfidën kryesore të punës së tyre gjatë ofrimit të shërbimeve për viktimat të dhunës në familje. Edhe pse Departamenti i Mirëqenies Sociale në kuadër të MPMS-së është përgjegjës për to, ai financon vetëm gjysmën e buxhetit të nevojshëm, ndërsa fondet tjera sigurohen nga donatorët ndërkombëtarë. Avokati i Popullit thekson rëndësinë e ndarjes së financimit të fondeve për strehimoret me kohë për çdo vit, si dhe përlllogaritjen e kostos së saktë, të cilën shteti duhet ta ndajë për secilën viktimë të dhunës në familje.

Faktorë të ndryshëm socialë, ekonomikë dhe kulturorë kanë ndikuar që niveli i dhunës në Kosovë të mbetet i pandryshueshëm. Papunësia dhe varfëria nuk e arsyetojnë dhunën në familje. Megjithatë, bazuar në ankesat e ankueseve të paraqitura në IAP, një ndër problemet kryesore që e vështirëson pozitën e viktimave, del të jetë varësia ekonomike.

Edhe pse ekziston një bazë solide ligjore për mbrojtjen nga dhuna në familje, duhet theksuar se zbatimi i ligjit nuk është në nivelin e duhur. Vlen të theksohet se zvarritja e procedurave gjyqësore në rastet e trajtimit të rasteve që kanë të bëjnë me dhunën në familje është mjaft dekurajuese që raste e tilla të paraqiten. Në të shumtën e rasteve gratë mbeten viktimat jo vetëm të dhunës së ushtruar nga bashkëshortët, por edhe të mosveprimeve dhe neglizhencës së institucioneve që për mandat kanë ofrimin e mbrojtjes dhe ndihmës atyre. Me kërkesën e ankueseve, IAP-ja, në shumë raste, i ka monitoruar proceset gjyqësore për viktimat e dhunës në familje.

Ligji për mbikëqyrje të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës²¹² është në fuqi që nga data 1 korrik i vitit 2015, dhe ka për qëllim të rregullojë përdorimin e mbikëqyrjes elektronike në procesin e drejtësisë penale për të ngritur sigurinë publike dhe për të garantuar ekzekutim efektiv të vendimeve të gjykatës, edhe tek rastet e viktimave të dhunës në familje. Për zbatimin e këtij ligji në realizimin e mbikëqyrjes elektronike dhe raportim nga Policia e Kosovës të personave të cilëve iu kufizohet lëvizja, Ministria e Punëve të Brendshme ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ.²¹³ Megjithatë, ky ligj edhe sot nuk është i zbatueshëm. Avokati i Popullit gjatë periudhës raportuese ka hapur

²¹² Ligji nr. 05/L-003 për mbikëqyrje të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të gjykatës, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12880>

²¹³ MPB Udhëzimin Administrativ nr. 11/2016, <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=12880>

hetimet sipas detyrës zyrtare lidhur me moszbatimin e këtij ligji, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikonte në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sepse gjatë këtij viti raportues nga shkelësit e urdhër-mbrojtjes janë identifikuar raste të cilat kanë përfunduar edhe me fatalitet. Ky rast është në procedure të hetimeve në IAP.²¹⁴

Gjatë kësaj periudhe raportuese IAP ka pranuar edhe kërkesë për monitorimin e seancës në Gjykatën e Apelit të Kosovës, bazuar në ankesën e nënës së viktimës, sipas së cilës vajza e saj është privuar nga jeta, ndërsa i akuzuari, me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, është liruar nga akuza për veprën penale. IAP-ja e ka monitoruar seancën gjyqësore pas së cilës Gjykata e Apelit ka anuluar aktgjykimin e Gjykatës Themelore dhe lënda i është kthyer të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.²¹⁵

Gratë të mbijetuara të dhunës seksuale gjatë luftës

Aplikimi për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës ka filluar që nga data 2 shkurt 2018. Gjatë këtij viti raportues Avokati i Popullit ka pranuar ankesa ku ankuesit pretendojnë se nuk u është njohur e drejta e viktimës nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, gjatë vitit 2018, ka pranuar ankesë edhe përkitazi për formën e vendimit të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, përkatësisht për shkak të mungesës së pjesës së arsyetimit në Vendimin e Komisionit, me të cilin njihet apo refuzohet statusi i viktimës së dhunës seksuale.

Aktualisht, vendimi i Komisionit përbëhet nga diapozitivi, i cili në korniza të ruajtjes së konfidencialitetit, përmban vetëm njohjen apo refuzimin e statusit të viktimës së dhunës seksuale, dhe këshillën juridike, ku në rast refuzimi palët udhëzohen për të drejtën për paraqitje të kërkesës për rishqyrtim të vendimit. Ndërkaq, vendimet nuk përmbajnë pjesën e arsyetimit. Nga Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës, Avokati i Popullit ka pranuar informatë se kjo praktikë është implementuar për arsye të ruajtjes së konfidencialitetit të procedurës, identitetit të palëve në procedurë dhe të informatave. Në anën tjetër, palët pjesëmarrëse në procedurë kanë ngritur shqetësimin e tyre se mungesa e arsyetimit në vendim ua vështirëson procesin e ankimimit në shkallë të dytë dhe shfrytëzimin e ankesës, si mjet efektiv juridik, pasi që arsyetimi si pjesë integrale e vendimeve në procedurë administrative përmban bazën ligjore dhe përmbledhjen e fakteve dhe provave që kanë qenë vendimtare në njohjen apo refuzimin e ndonjë të drejte, të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë.

Sipas Rregullores nr. 22/2015 që përcakton procedurat për njohjen dhe verifikimin e statusit të viktimës së dhunës seksuale në Kosovë, pala, në rast të refuzimit, ka të drejtën e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim të vendimit tek komisioni i njëjtë. Në këtë drejtim,

²¹⁴ Rasti i regjistruar në IAP: Ex officio nr. 621/2018

²¹⁵ Rasti i regjistruar në IAP: A.nr. 619/2018

çështje tjetër e ngritur për shqyrtim konsiston në respektimin e procesit të dyshkallshmërisë në procedurë administrative, pasi në këtë rast i njëjti organ vepron edhe në shkallë të parë edhe në shkallë të dytë, sipas procedurës së ankesës.

Për Avokatin e Popullit është shqetësues fakti se ankesat e parashtruara nga ankuesit në Komisionin Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës trajtohen përsëri nga trupa e njëjtë e këtij komisioni, prandaj ngrit shqetësimin se në këto raste e drejta në ankesë nuk përbën mjet juridik efektiv. Ankesat e parashtruara në IAP lidhur me këto çështje vazhdojnë të jenë në procedurë të hetimit.²¹⁶

Komunitetet pakicë

Gjendja e të drejtave të pakicave etnike është tregues i vlerave demokratike të një shoqërie. Në vendet ku mosmarrëveshjet etnike dhe fërkimet çojnë deri te ndarja në shoqëri, respektimi i të drejtave të komuniteteve pakicë mund të kontribuojë në arritjen e stabilitetit politik e shoqëror dhe të paqes. Kjo kurrësi nuk do të thotë që qëllimi paraqet segregacion dhe ndarje, por integrim shoqëror, që të drejtat, të cilat u janë dhënë komuniteteve pakicë me Kushtetutë dhe me ligjet në Republikën e Kosovës²¹⁷ duhet të respektohen dhe të zbatohen, në qoftë se dëshirojmë ta ndërtojmë një shoqëri të begatë shumetnike.

Komunitetet e ndryshme etnike, fetare dhe gjuhësore që jetojnë në Kosovë duhet gjithashtu ta kuptojnë se zgjidhjet varen edhe nga ata vetë. Rrjedhimisht nevojiten përpjekje të përbashkëta për t'i kapërcyer sfidat. Është gjithashtu e nevojshme të ekzistojë vullneti politik për të arritur zgjidhje të drejta dhe të qëndrueshme në kuadër të të gjithë shoqërisë dhe brenda të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës.

Vullneti politik në respektimin e të drejtave dhe në respektimin e kontributeve të të gjithëve është i një rëndësie primare për krijimin dhe funksionimin e një shoqërie të prosperuar dhe gjithëpërfshirëse, me qëllim të vendimmarrjes së përbashkët dhe rrënimin e paragjykimeve dhe pengesave, pavarësisht sa janë të mëdha ato. Njëkohësisht, situatat specifike, shoqërore dhe politike ia imponojnë Kosovës një mori vështirësish në funksionimin dhe efektivitetin e duhur të mekanizmave që ka në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave, me çka qasja dhe realizimi i të drejtave të garantuara i nënshtrohen një provimi të madh.

²¹⁶ Mes tjerash, rasti i regjistruara në data bazën e IAP-së: A. 695/2018.

²¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës (Kapitulli III për të drejta e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre); neni 22 i Kushtetutës së Kosovës (Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare) definojnë se midis të tjerash zbatohet drejtpërdrejt edhe Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollin e saj, Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit etj.; Ligji nr. 03/L-47 për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre; Ligji nr.05/L-021 për mbrojtje nga diskriminimi, Ligji nr. 03/L-068 për arsimin në komunat e Republikës së Kosovës; Ligji nr. 02/L-037 për përdorimin e gjuhëve; Ligji nr. 03/L-040 vetëqeverisjen lokale; Ligji nr. 03/L-041 për kufijtë administrativ të komunave; Ligji nr. 02/L-088 për trashëgiminë kulturore dhe Ligji nr. 03/L-039 për zonat e veçanta të mbrojtura.

Ngjashëm me periudhat tjera raportuese, edhe këtë vit, Avokati i Popullit vë në dukje problemet, me të cilat qytetarët, pjesëtarë të komuniteteve pakicë, përballen në baza ditore, duke pasur për qëllim zgjidhjen e tyre sistematike dhe efikase në periudhën në vijim.

Në përgjithësi, problemet me të cilat janë ballafaquar komunitetet, si serb, rom, ashkali, egjiptian, boshnjak, turk, kroat, malazez dhe goran, gjatë vitit 2018, mbesin të përafërta me konstatimet e paraqitura në Raportin vjetor paraprak të IAP-së²¹⁸, me më pak ose me më shumë suksese në përmirësimin e gjendjes së tyre.

Kthimi dhe siguria

Duke pasur parasysh situatën kur bëhet fjalë për kthimin, është e domosdoshme që për kthimin e personave të zhvendosur të punohet më shumë për kushtet dhe qëndrueshmërinë e kthimit. Është e domosdoshme që të gjitha institucionet në Kosovë, por edhe shoqëria në tërësi, duhet të bëjnë më shumë përpjekje për ta ndërtuar besimin e ndërsjellë me qëllim të përmirësimit të rezultateve.

Numri më i madh i personave të zhvendosur dhe refugjatëve janë pjesëtarë të komunitetit serb, pastaj të komuniteteve rom, malazez, kroat, boshnjak dhe pjesëtarë të tjerë të komuniteteve pakicë. Gjithashtu, një numër janë pjesëtarë të komunitetit shqiptar nga veriu i Kosovës.

Në bazë të të dhënave të Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë (UNHCR), gjatë 19 vjetëve të fundit, në Kosovë janë kthyer gjithsej 28.111 persona (që është rreth 13% e numrit të përgjithshëm të personave të zhvendosur, të regjistruar nga UNHCR-ja)²¹⁹, prej të cilëve 26,830 të kthyer janë pjesëtarë të komuniteteve pakicë.²²⁰ Sipas të dhënave të mbledhura nga UNHCR-ja, në vitin 2015 u kthyen 726 persona të komuniteteve pakicë, në vitin 2016 u kthyen 356, në vitin 2017 u kthyen 417 persona, përderisa deri në fund të dhjetorit të vitit 2018 janë kthyer gjithsej 284 pjesëtarë të komuniteteve.²²¹

Sigurimi i banimit të përhershëm për personat që janë të akomoduar në qendra kolektive tash e 20 vjet, vazhdon të jetë problem i cili duhet të adresohet edhe në kuadër të resurseve dhe projekteve që ka Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK).

Në qendrat kolektive në tërë Kosovën janë të vendosur 423 persona, që rezulton se janë vetëm 41 persona më pak se në periudhën e kaluar raportuese, informatë nga e cila mund

²¹⁸ Shih Raportin Vjetor të IAP 2017.

²¹⁹ Në bazë të të dhënave statistikore të UNHCR-së, janë regjistruar 226 418 persona që e kanë braktisur Kosovën nga qershori i vitit 1999 dhe kanë shkuar në Serbi, Mal të Zi dhe Maqedoni. Të dhënat janë marrë nga ueb-faqja zyrtare e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim e Republikës së Kosovës. <http://mzp-rks.org>

²²⁰ Në bazë të të dhënave statistikore të UNHCR-së, të janarit të vitit 2018, thuhet se nga viti 2000 deri në fund të viti 2018 janë kthyer 11945 serbë, 7577 ashkalinj dhe egjiptianë, 1875 boshnjakë, 4 kroatë, 1464 goranë, 21 malazezë, 3925 romë si dhe 19 turq.

²²¹ Në bazë të të dhënave statistikore të UNHCR-së, nga janari deri në fund të dhjetorit të vitit 2018 janë kthyer 133 serbë, 96 ashkalinj dhe egjiptianë, 10 boshnjakë, 5 goranë, 35 romë, 4 malazezë dhe 1 kroat.

të konstatohet se për zgjidhjen e strehimit të tyre të përhershëm nuk është vepruar me kujdesin e duhur, sepse shumë prej tyre ende jetojnë në kushte shumë të vështira dhe çnjerëzore. Avokati i Popullit përsëri rikujton se numri më i madh i personave të vendosur në qendrat kolektive është ende në komunën e Shtërpcës (247 persona). Edhe pse kah fundi i dhjetorit të vitit 2017, IAP-ja mori një informacion pozitiv nga MKK-ja²²², që tregon se është planifikuar që deri nga mesi i vitit 2018 qendrat kolektive në komunën e Shtërpcës të mbyllen dhe çështja banimit të personave të akomoduar në këto qendra të zgjidhet në mënyrë të përhershme, kjo deri në fund të periudhës raportuese nuk ndodhi.

Njëjtë me periudhën e kaluar raportuese, sipas njoftimit të siguruar nga MKK-ja, edhe për vitin 2019 MKK-ja e ka planifikuar po njëjtë gjë, që të bëjë mbylljen e të gjitha qendrave kolektive. Sipas planifikimeve të MKK-së, është paraparë që në fazën e parë, e cila realizohet përmes projektit IPA, të bëhet mbyllja e qendrave kolektive në territorin e komunës së Shtërpcës, si dhe të përfundojë ndërtimi i 5 ndërtesave të banimit. Sipas informatave të marra nga MKK-ja, është planifikuar që këto ndërtesa, të cilat do të ofronin zgjidhje për banim të përhershëm për rreth 80 familje, të jenë të gatshme për banim deri në gjysmën e parë të vitit 2019, ndërsa për 4 familje janë ndërtuar shtëpi në parcelat, të cilat ata vetë i kanë siguruar. Në fazën e dytë të të njëjtit projekt është planifikuar mbyllja e 11 qendrave kolektive në komunën e Graçanicës, Leposaviqit dhe Zveçanit dhe realizimi i këtij projekti do të fillojë në shtator ose tetor të vitit 2019, kurse partner zbatues i projektit do të jetë Këshilli Danez për Refugjatët (DRC)²²³. Ndonëse informacionet e marra nga MKK-ja janë të njëjta me ato të periudhës së kaluar raportuese, për Avokatin e Popullit mbeten shqetësuese vonesat në realizimin e planifikimeve si dhe sigurimin e një zgjidhjeje të qëndrueshme për personat e rikthyer. IAP-ja do të vazhdojë që edhe gjatë vitit 2019 ta ndjekë angazhimin e MKK-së për këtë çështje.

Kur është fjala për Rregulloren e re të Qeverisë së Republikës së Kosovës për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhjet e qëndrueshme²²⁴, Rregullorja në fjalë u vlerësua pozitivisht si nga institucionet kompetente që merren me çështjen e kthimit, ashtu edhe nga vetë personat e kthyer, duke vlerësuar përmirësimin e qasjes në institucione dhe realizimit të të drejtave të të kthyerve. Përveç kësaj, me këtë Rregullore hapet mundësia e ndarjes së tokës nga ana e komunës për ndërtimin e shtëpive, si dhe kthimin në vendet që nuk ishin vendbanime të mëparshme të të kthyerve. Duke pasur parasysh se zbatimi i Rregullores së lartpërmendur ka filluar në vitin 2018, aktualisht nuk është e mundur të vlerësohet me siguri suksesi i zbatimit të saj në terren.

²²² Shih Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, pjesë për Komunitetet pakicë – Kthimi dhe siguria.

²²³ Informatat e marra nga MKK-ja, përmes e-mailit më 14 janar 2019.

²²⁴ Rregullorja e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, që u miratua në mbledhjen e Qeverisë me vendimin nr. 63/23 i datës 4 janar 2018 dhe Udhëzimi nr.2/2018 për zbatimin e kësaj rregulloreje, që u nxor në qershor të vitit 2018.

Sa i përket sigurisë së komuniteteve pakicë, mund të thuhet se nuk vërehet ndonjë dallim i madh nga periudhat e kaluara raportuese, duke pasur parasysh disa incidente, siç janë dëmtimi i monumentit në varrezat ortodokse në Lipjan, shkrimi i grafiteve në shkollën fillore në të cilën e vijnë mësimin nxënësit e komunitetit serb në Lipjan, djegia e shtëpisë së një të kthyeri në fshatin Bellopojë afër Pejës, vjedhja dhe shkatërrimi i materialeve ndërtimor gjatë ndërtimit të 6 shtëpive për të kthyerit në fshatin Lubozhdë në komunën e Istogut, gjuajtja më gurë e shtëpive të të kthyerve në rajonin e Pejës.

Në janar dhe gusht 2018, banorët lokalë protestuan ndaj paralajmërimeve për vizitat e pjesëtarëve të komunitetit serb në varreza dhe objektet e besimit në Gjakovë. Edhe pse vizitat nuk u realizuan, Avokati i Popullit rikujton detyrimet e shtetit që të ofrojë siguri, qoftë për protestuesit, qoftë për vizitorët, në mënyrë që të shmangen incidentet me motive etnike. Veçanërisht shqetësuese mbeten incidentet ndëretnike në veri të Kosovës.

Pas gjetjes së një mjeti shpërthyes në fshatin Osojan, MKK-ja ka financuar instalimin e 13 kamerave të survejimit në fshatin etnikisht të përzier, ndërsa për mirëmbajtjen e kamerave kompetente do të jetë Komuna e Istogut. Vendosja e kamerave ka për qëllim uljen e nivelit të krimit në rajonin e Pejës, i cili është veçanërisht i lartë ndaj familjeve të kthyerit.²²⁵ Nga sa u tha më sipër, mund të përfundohet se numri më i madh i incidenteve, si në vitet e mëparshme, ndodh në Kosovën perëndimore, në zonat e të kthyerve në komunën Pejës, të Klinës dhe të Istogut.

Numri i incidenteve të drejtuara ndaj të kthyerve dhe pasurisë së tyre ka shënuar rënie graduale. Në vitin e kaluar u regjistruan 65 incidente, ndërsa në këtë vit, deri në nëntor ishin 58 raste. Kur bëhet fjalë për incidentet, ato janë të natyrës juridike-pronësore, vjedhje, prerje ilegale dhe uzurpim i paligjshëm i pronës. Përveç kësaj, ka pasur kërcënime dhe sulme fizike ndaj të kthyerve.²²⁶ Sa u përket kallëzimeve për nxitje të urrejtjes, trazirave apo jotolerancës kombëtare, racore dhe fetare, në pajtim me nenin 147 të Kodit Penal të Kosovës,²²⁷ në periudhën nga 1 janari deri më 21 dhjetor 2018, në Policinë e Kosovës janë raportuar vetëm 10 raste.

Incidentet e drejtuara ndaj të kthyerve nga radhët e komunitetit pakicë dhe ndikimi e politizimi i shpeshtë i çështjeve nga faktorët e jashtëm, pamundësojnë integrimin e plotë të qytetarëve serbë në jetën publike dhe ekonomike të Kosovës dhe ngadalësojnë ndërtimin e besimit të ndërsjellë dhe sigurisë.

Gjithashtu, një problem evident tani sa kohë është me komunitetin shqiptar në veri, në komunat Leposaviq, Zveqan, Mitrovicë e Veriut dhe Zubin Potok, që për arsye krejtësisht politike nga autoritetet në veri, mund të pajisen me dokumente pronësore (regjistrat kadastral) vetëm me vulë të organeve paralele, të cilat më pas nuk njihen si dokumente

²²⁵ Informatat për incidente janë të marra nga MKK-ja, të cilat ata i kanë prezantuar në kuadër të “Procesit të Shkupit”

²²⁶ Po aty.

²²⁷ Kodi Penal i Kosovës nr. 04/L-129, neni 147.

pranë organeve të Republikës së Kosovës dhe qytetarët ndodhen në pamundësi të realizimit të të drejtave.

Avokati i Popullit vëren se MKK-ja gjatë vitit 2018, në pajtim me mandatin e vet, i ndërtoi 94 shtëpi për të kthyerit (për 592 persona), ndërsa 4 shtëpi janë rinovuar (për 24 persona). Përveç kësaj, janë realizuar 23 projekte infrastrukturore në komuna të ndryshme në tërë Kosovën.²²⁸ Këtu duhet përmendur gjithashtu se kah mesi i vitit 2018, MKK-ja ndërtoi 6 shtëpi për 13 të kthyerit që u kthyen me iniciativën e tyre në fshatin Lubizhdë në komunën e Istogut. Kështu që, për të gjithë të kthyerit spontanë në këtë fshat është zgjidhur aspekti i banimit deri nga mesi i vitit 2018.²²⁹

Edhe pse parimisht ka qenë i pranuar rekomandimi i Avokatit të Popullit në Raportin e mëparshëm Vjetor për nxjerrjen e Ligjit për personat e zhvendosur dhe refugjatë, i cili është dashur të nxirrej gjatë vitit 2018, deri në fund të kësaj periudhe raportuese kjo gjë nuk është bërë. Tema për të cilën në mënyrë të veçantë është bërë fjalë në periudhë paraprake raportuese është edhe Iniciativa ndërinstitucionale për personat e zhvendosur nga Kosova, e njohur si “Procesi i Shkupit”²³⁰, MKK-ja në fillim të vitit 2018, së bashku me Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB) dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal në kuadër të “Procesit të Shkupit” dhe zgjidhjeve të qëndrueshme, grupi punues për siguri, dialog dhe riintegrimin e personave të zhvendosur ka hartuar dhe u ka dërguar komunave Udhëzues për reagim ndaj incidenteve që ndikojnë te komunitetet.²³¹ Pas një numri trajnimesh përkatëse për zyrtarë komunalë në lidhje me udhëzuesit e mësipërm, janë vërejtë efektet pozitive të ndikimit të tyre, e cila është reflektuar nëpërmjet reagimeve publike ndaj incidenteve të sigurisë në Novo Bërd, Mitrovicë, Kamenicë, Ferizaj, Istog dhe Vushtrri.

Vlerësohen pozitivisht edhe aktivitetet e Grupit punues për dokumentacion personal, në kuadër të “Procesit të Shkupit”. Në të vërtetë, vendimi i MPB-së së Republikës së Kosovës nr. 296/2018, i datës 5 korrik 2018, që zbatohet nga 27 gushti 2018, ka të bëjë me çështjen e personave të zhvendosur për njohjen e një statusi civil të regjistruar në zyrat paralele dhe shërbimet komunale të Republikës së Serbisë në Kosovë dhe/ose në Republikën e Serbisë. Ndonëse MKK-ja ka publikuar se ky vendim i Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës është përkrahur nga fushatat përkatëse informative, me këtë rast, Avokati i Popullit e mirëpret rekomandimin e miratuar drejtuar MKK-së për transparencën dhe qasshmërinë në dokumentacionin lidhur me “Procesin e Shkupit”, që gjendet në faqen zyrtare të MKK-së. Tani në këtë faqe mund të gjenden informacione për konkluzione konkrete në lidhje me këtë iniciativë, me qëllim të informimit më të mirë të

²²⁸ Informata të marra nga MKK, përmes e-mailit, më 14 janar 2019.

²²⁹ Informata të cilën IAP në lidhje me të kthyerit në fshatin Lubizhdë, komuna e Istogut është konfirmuar nga MKK, më 14 janar 2019, përmes emailit.

²³⁰ Shih Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, pjesë për Komunitetet pakicë – Kthimi dhe siguria.

²³¹ <http://mzp-rks.org/sr-l/dokumenti/skopski-proces.html>

publikut dhe personave të zhvendosur.²³² Po ashtu, në bashkëpunim me Komisaratin për refugjatë dhe migracionin e Republikës së Serbisë, Këshillin Danez për Refugjatë (DRC) dhe UNHCR-in, MKK-ja e përpiloi dhe e publikoi një raport për “Profilizimin e personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës – Shqyrtimi i kahjes për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur brenda në Kosovë”,²³³ që është një dokument mjaft konciz dhe statistikisht shumë i dobishëm dhe i saktë, i cili në periudhën që është para nesh duhet të shërbejë si udhërrëfyes për ndërmarrjen e hapave të mëtejshëm, projekteve dhe planeve për kthimin e personave të zhvendosur.

Megjithatë, edhe me tej në faqen zyrtare të MKK-së mungojnë informatat dhe raportet lidhur me kthimin, mungon dokumentacioni për politikën e kësaj Ministrie dhe për projektet e iniciuara.²³⁴ Pjesa që ka të bëjë me ligjet relevante të MKK-së dhe kthimin nuk përmban ligje, por vetëm disa rregullore të brendshme, rregullore dhe udhëzime, të cilat duhet të korrigjohen dhe rregullohen, në përputhje me parimin e transparencës së punës të kësaj Ministrie.

Shtetësia dhe regjistrimi civil

Në pajtim me mandatin e vet kushtetues, parimet dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të gjithë qytetarëve në Republikën e Kosovës, Avokati i Popullit vazhdon të jetë konsistent në monitorimin e gjendjes që ka të bëjë me shtetësinë dhe regjistrimin civil, e cila hollësisht është e paraqitur në dy raportet vjetore paraprake.²³⁵ Bazuar në ankesat që Institucioni i Avokatit të Popullit i ka pranuar, kryesisht në veri të Kosovës, mund të thuhet se me këtë çështje ishin prekur kryesisht qytetarët nga radhët e komunitetit serb dhe komunitetit rom. Këta janë kryesisht persona që jetojnë në Kosovë, por edhe persona të zhvendosur, të cilët deri më tani ende nuk e kanë rregulluar statusin e tyre civil në Republikën e Kosovës.

Marrja e shtetësisë së Republikës së Kosovës është e rregulluar me Ligjin për shtetësinë²³⁶ dhe personat, të cilët plotësojnë një ose më shumë kritere ligjore mund ta marrin shtetësinë. Përveç kësaj, personat që kanë jetuar në Kosovë (qoftë me qëndrim të përhershëm ose të përkohshëm) deri më 1 janar 1998, kanë të drejtë ta marrin shtetësinë e Republikës së Kosovës,²³⁷ si dhe personat prindërit e të cilëve kanë shtetësi të Kosovës. Shikuar nga këndvështrimi i legjislacionit, ligji është relativisht i gjerë në aspektin e përcaktimit të përshtatshmërisë për dhënien e shtetësisë. Mirëpo, shikuar nga aspekti i zbatimit të ligjeve dhe rregulloreve dhe në bazë të ankesave të paraqitura dhe veprimeve

²³² <http://mzp-rks.org/>

²³³ <http://mzp-rks.org/sr-l/dokumenti/2015-12-01-19-13-00.html> që është postuar në web faqen e MKK, 10 shtator 2018.

²³⁴ <http://mzp-rks.org>

²³⁵ Shih Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, pjesë për Komunitetet pakicë – Kthimi dhe siguria.

²³⁶ Ligji nr. 04/L-215 për Shtetësinë e Republikës së Kosovës.

²³⁷ Udhëzimi Administrativ i MPB-së së Republikës së Kosovës nr. 05/2017 për kriteret që përmbajnë dëshmi për shtetësinë e ish-RSFJ më 01.01.1998, i nxjerrë në qershor 2017.

hetimore, të cilat i ka ndërmarrë IAP-ja, mund të konstatohet se korniza ligjore në këtë fushë nuk është aplikuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të saktë.

Si rezultat i kësaj, një numër i madh i qytetarëve të komuniteteve pakicë, veçanërisht serbëve dhe romëve, nuk kanë dokumente identifikimi të Kosovës, qoftë për shkak të vështirësive administrative dhe zbatimit të gabuar të akteve nënligjore, qoftë për shkak të ngurrimit të një numri të qytetarëve që të aplikojnë për marrjen e një dokumenti identifikimi të Kosovës, për shkak se posedojnë dokumente të Republikës së Serbisë. Mirëpo, problemi lind kur shtrohet pyetja rreth çështjes së statusit të këtyre qytetarëve, të drejtave dhe detyrimeve të tyre, pasi ata, shikuar ligjërisht, janë të padukshëm për sistemin. Gjithashtu, është i panjohur numri i saktë i personave që gjenden në këtë situatë, prej të cilëve numri më i madh gjendet në veri të Kosovës. Prandaj, Avokati i Popullit, qoftë duke u bazuar në ankesat e paraqitura, qoftë duke u bazuar në hulumtimet e veta, inicioi Ex officio një hetim për çështjen e shtetësisë dhe të regjistrimit civil, që ka të bëjë me pjesëtarët e komuniteteve pakicë në Kosovë, përkatësisht qytetarët që jetojnë në veri të Kosovës.²³⁸ Përveç lëndës e cila është duke u zhvilluar në Institucionin e Avokatit të Popullit, sipas detyrës zyrtare, Avokati i Popullit ka pranuar edhe ankesa individuale, prej të cilave një numër, pas ndërhyrjes së IAP-së, janë zgjidhur pozitivisht, ndërsa një numër i këtyre rasteve ende janë në proces e sipër.

Avokati i Popullit, në vitin 2018, ka pranuar numrin më të madh të ankesave kundër punës së zyrave për regjistrim dhe gjendje civile në Mitrovicën Jugore, si dhe zyrave në rajonin e Pejës, kundër të cilave ankohen kryesisht personat e zhvendosur.²³⁹ Një problem të veçantë paraqesin zyrat e zhvendosua të regjistrimit dhe gjendjes civile, të cilat edhe më tej gjenden për komunën e Zubin Potokut në fshatin Çabër, për Zveçanin në fshatin Lipë, kurse për Leposaviq në fshatin Banjë.²⁴⁰ Këto fshatra janë shumë të largëta nga zonat urbane dhe janë të pa qasshme për qytetarët. Këto zyra janë zhvendosur për shkak të mosfunksionimit të mëhershëm të komunave në veri të Kosovës, mirëpo, edhe pse komunat veriore gjatë dy vjetëve të fundit janë plotësisht funksionale, këto zyra kanë mbetur aty ku ishin, gjë që për qytetarët paraqet pengesë për ta rregulluar statusin e tyre qytetar, për ta bërë regjistrimin ose çfarëdo lloj të ndryshimit në përputhje me kornizën ligjore. Duke pasur parasysh të lartcekurat, Avokati i Popullit mendon se zyrat kryesore komunale për regjistrim dhe gjendje civile në veri të Kosovës duhet të kthehen në bërthamat e veta komunale, d.m.th. në Mitrovicën Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, kurse për qytetarët e fshatrave të largëta nga qyteti të formohen nën zyra për regjistrim dhe gjendje civile, sipas nevojës.

²³⁸ Ex officio nr.323/2018, në të cilin palë përgjegjëse janë zyrat për gjendjen civile në Mitrovicën Jugore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, lënda është hapur më 17 maj 2018 dhe ende është në zhvillim e sipër.

²³⁹ Ankesat nr. 285/2018, nr. 339/18, nr. 393/2018, nr. 417/2018, nr. 482/2018, nr. 509/2018 etj.

²⁴⁰ Shih Raportin vjetor të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2017, pjesë për Komunitetet pakicë – Shtetësia dhe regjistrimi civil.

Ende vazhdon të jetë e shprehur mos pajisja me dokumente personale e pjesëtareve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas. Te komunitetet në fjalë, problem paraqet mos azhurnimi dhe mungesa e informimit të mjaftueshëm se çdo lloj ndryshimi në gjendjen civile duhet të raportohet në zyrat kompetente. Në këtë drejtim, ata kanë mbështetjen e plotë të organizatave lokale të shoqërisë civile, të cilat në mënyrë të vazhdueshme ndihmojnë në regjistrimin e grupeve më të margjinalizuara të qytetarëve, lindja, vdekja dhe ndryshimi i gjendjes civile e të cilëve nuk është regjistruar në Regjistrin Qendror Civil.²⁴¹

Avokati i Popullit e vlerëson pozitivisht Vendimin afirmativ të MPB-së së Kosovës nr. 296/2018²⁴², me të cilin u lejohet të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës që kanë regjistruar, apo paraqitur faktet në lidhje me statusin civil në strukturat paralele të Republikës së Serbisë, në periudhën prej 10 qershorit të vitit 1999 deri më 14 shtator të vitit 2016, të paraqesin kërkesë për kopje dhe regjistrim në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile të Kosovës. Rregullorja është e vlefshme deri në fund të qershorit 2019. Me nxjerrjen dhe hyrjen në fuqi të Vendimit në fjalë të MBP do të lehtësohet shumë regjistrimi në Regjistrin Qendror dhe me këtë edhe marrja e dokumenteve personale për qytetarët, të cilët deri më tani kanë qenë në pamundësi që të njëjtin dokument ta rregullojnë. Kjo në veçanti vlen për pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët ende në përqindje të madhe janë në listën e qytetarëve pa dokumentacion personal. Mirëpo, me këtë rast duhet theksuar dështimin e Zyrave të Regjistrimit dhe Gjendjes Civile nëpër komuna, posaçërisht ato në të cilat jetojnë edhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë, se nuk ka pasur transparencë në zbatimin e këtij vendimi dhe se shumica e qytetarëve as nuk e dinë se ekziston ky vendim. Prandaj është e domosdoshme që zyrat kompetente në fjalë, së paku në komunat e veta amë, të vendosin njoftime në tabelat e shpalljeve të komunës, por gjithashtu është domosdoshme që komunat dhe MKK-ja në faqen e tyre zyrtare të publikojnë një njoftim për të gjithë qytetarët, të cilët janë të obligueshëm që ta rregullojnë statusin e tyre qytetar.²⁴³

Të gjitha këto probleme që kanë të bëjnë me çështjen e shtetësisë, regjistrimit civil dhe me dokumentet personale e krijojnë një situatë shumë të pasigurt për qytetarët që nuk janë zyrtarisht të regjistruar si shtetas të Kosovës, sepse janë në një situatë të paqëndrueshme. Një situatë e tillë nuk ka të bëjë vetëm me problemin e statusit civil, por shkakton pasoja negative në lirinë e lëvizjes, të drejtën për punë, shëndetin dhe mbrojtjen

²⁴¹ Me këtë problematikë është marrë posaçërisht OJQ-ja "Projekti për të Drejtat Civile Kosovë" nga Prishtina, e cila në vazhdimësi tashmë e disa vite u ndihmon pjesëtarëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian në marrjen e dokumenteve të tyre personale.

²⁴² Vendimi i MBP të Kosovës nr. 296/2018, që u mor më 5 korrik 2018, kurse zbatimi i të njëjtit ka filluar kah fundi i muajit gusht të vitit 2018.

²⁴³ Gjatë mbledhjes së informacioneve për raportin vjetor, nga shtatori deri në fund të dhjetorit janë rishikuar ueb-faqet zyrtare të MKK, të komunave, të cilat janë të populluara me pjesëtarë të komuniteteve pakicë në Kosovës, si dhe tabelat informuese të disa komunave të populluara me pjesëtarë të komuniteteve pakicë, por në asnjë ueb-faqe, por as tabela informuese nuk është postuar informimi për qytetarë lidhur me Vendimin nr. 296/2018, i datës 5 korrik 2018, për rregullimin e gjendjes civile të qytetarëve, të cilët të gjitha ndryshimet i kanë paraqitur në zyrat amë të shërbimeve në Republikën e Kosovës.

sociale, të drejtën për të zgjedhur dhe për të marrë pjesë në zgjedhje, por edhe në detyrimet që kanë në përputhje me gjendjen e tyre civile ndaj shtetit, në të cilën ata jetojnë.

Të drejtat pronësore

E drejta e pronës si e drejtë themelore e njeriut ka rëndësi dhe ndikim në të gjitha të drejtat e tjera dhe, si e tillë, kërkon vëmendje dhe angazhim të veçantë në rregullimin dhe sigurimin e gëzimit të kësaj të drejte pronarëve, qoftë sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi, qoftë në bazë të standardeve njerëzore e drejta në përgjithësi.²⁴⁴

Në të vërtetë, për problemin e uzurpimit dhe riuzurpimit të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Kosovës, Avokati i Popullit ka raportuar në të gjitha raportet e tij vjetore, por një vëmendje të veçantë kësaj çështjeje ia kushtoi në tri raportet e fundit vjetore, të cilat sipas ligjit në fuqi i janë dhënë për shqyrtim Kuvendit të Republikës së Kosovës.²⁴⁵ Përveç kësaj, Misioni i Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE) në Kosovë raportoi për të njëjtin problem në vitin 2015, në raportin e titulluar “Shqyrtimi i rasteve të ri-uzurpimit të paligjshëm të pronës në Kosovë”²⁴⁶, dhe që atëherë gjendja në këtë fushë është përmirësuar në raport me palët e dëmtuara, ose pronarët e pasurisë së uzurpuar.

Nuk mund të mohohet fakti se përmirësimet në aspektin e të drejtave pronësore të personave, të cilëve u është uzurpuar prona, ka treguar një lëvizje pozitive në zgjidhjen e këtij problemi, por ende ekzistojnë një sërë problemesh esenciale në aspektin e gëzimit paqësor dhe pasjes në dispozicion të pronës së paluajtshme private, me të cilat ballafaqohet një numër i madh i qytetarëve. Ende është shqetësues uzurpimi i vazhdueshëm kundërligjor i pronës private të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë, por edhe pjesëtarëve të komunitetit shqiptar në veri të Kosovës.

Përveç kësaj, duhet theksuar se ekziston një numër i ankesave të cilat IAP-ja i ka pranuar dhe regjistruar, që kanë të bëjnë me uzurpimin dhe/ose riuzurpimin e pronës së paluajtshme, të cilat janë në procedurë para organeve gjyqësore, qoftë si lëndë penale (lëndët penale për riuzurpimin e pronës së paluajtshme, kallëzime penale kundër

²⁴⁴ E drejta për pronë private përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës (neni 46), Ligjin nr.03/L-154 për pronësinë dhe të drejtat e tjera sendore, por përmenden gjithashtu edhe në shumë ligje të tjera, si Ligji nr. 04/L-077 për marrëdhëniet e detyrimeve, Ligjin nr. 2004/26 për trashëgiminë, Ligjin nr. 2008/3-L-007 për procedurën jokontestimore, Ligji nr. 2009/03-L-006 për Procedurën Civile (Ligjin nr.201 / 04-L-118 për Ndryshimin e Ligjit për Procedurën Civile) dhe Ligjin nr. 2002/5 për themelimin e Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme (Ligjin nr. 2011/04-L-009 për ndryshimet dhe ndryshimet në këtë Ligj). Ligji për pronësinë dhe të drejta e tjera sendore e definojnë pronësinë si të drejtë të tërësishme mbi pronën që autorizon pronarin ta përdorë lirshëm pasurinë, tjetërsojë dhe përjashtojë nga çfarëdo ndërhyrje lidhur me të (neni 18).

²⁴⁵ Shih Raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015, 2016 dhe 2017.

²⁴⁶ Misioni i OSBE në Kosovë, raporti “Pasqyra e rasteve të ri-uzurpimit të paligjshëm të pronave në Kosovë” <https://www.osce.org/sr/kosovo/141151?download=true>.

personave NN për uzurpimin e tokës etj.), qoftë si lëndë civile (p.sh. padi për anulimin e kontratave të falsifikuara të shitblerjes së pasurive të patundshme, pengim posedim, padi për largimin e personave dhe gjësendeve nga pasuria e patundshme, padi për konfirmimin e të drejtave pronësore në pronën e patundshme, përkundër faktit që organet e mëparshme kompetente ad-hoc, HPD dhe KPA, tashmë e ka bërë zgjidhjen e këtyre çështjeve, për të cilat kanë pasur juridiksion ekskluziv etj.), por të cilat deri më sot nuk janë zgjidhur brenda një kohe të arsyeshme, siç kërkohet me nenin 6 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj).²⁴⁷ Në përputhje me të lartcekurat dhe duke i analizuar ankesat e ndryshme të paraqitura në IAP, Avokati i Popullit e nisi një hetim Ex officio lidhur me këtë çështje, në të cilin si palë përgjegjëse janë gjykatat dhe prokuroritë themelore në gjithë territorin e Republikës së Kosovës dhe Gjykata e Apelit.²⁴⁸ Avokati i Popullit gjatë hetimit kërkoi nga gjykatat dhe prokuroritë themelore dhe nga Gjykata e Apelit, të dhëna statistikore lidhur me uzurpimin dhe/ose riuzurpimin e pasurisë së paluajtshme, përfshirë edhe paditë civile që kanë të bëjnë me anulimin e kontratave të falsifikuara të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme, pengim posedimin, largimin e personave dhe gjësendeve nga pronat e paluajtshme, konfirmimin e së drejtës në pronën e paluajtshme etj., të cilat mund të klasifikohen si lëndë që kanë të bëjnë me disponimin e paligjshëm të pronës së paluajtshme nga ana e palëve të treta. Pas grumbullimit të të dhënave nga të gjitha palët përgjegjëse në këtë rast dhe analizimit të tyre do të shihet mundësia e dhënies së rekomandimeve përkatëse.

Në lidhje me këtë duhet të vlerësohet pozitivisht qasja aktuale e prokurorisë, kur bëhet fjalë për ngritjen e aktakuzave në rastet e uzurpimit të pronës, të cilat megjithatë tani po e kërkojnë edhe dëbimin e uzurpatorëve nga prona e uzurpuar në mënyrë të paligjshme, gjë që në periudhat e mëparshme nuk ishte kështu.²⁴⁹

Gjithashtu, gjatë periudhës raportuese është arritur një progres në fushën e të drejtave pronësore, që ka të bëjë me lirimimin e pronarit nga tatimi në pronën e paluajtshme për periudhën gjatë së cilës prona ka qenë e uzurpuar nga palët e treta, në bazë të Ligjit mbi Tatimin në Pronë të Paluajtshme, i cili është plotësuar me këtë dispozitë kah mesi i muajit shkurt të vitit 2018.²⁵⁰ Me këtë rast, Zyra e Kryeministrit së bashku me MKK-në u dërgoi letra qarkore të gjitha ndërmarrjeve publike komunale, duke ua kujtuar atyre detyrimin

²⁴⁷ Neni 6 i KEDNj-së thotë: “Secili, kur merr vendime për të drejtat dhe detyrimet e tij civile ose me padi penale kundër tij, ka të drejtë në seancë të drejtë dhe publike brenda një kohe të arsyeshme përpara një gjykate të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj”.

²⁴⁸ Ex officio nr.322/2018, i hapur më 17 maj 2018, ende është në zhvillim e sipër.

²⁴⁹ Shih Raportet vjetore të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2015, 2016 dhe 2017, pjesë për Komunitetet pakicë – Të drejtat e pronës, si dhe raportin e OSBE-së “Pasqyra e rasteve të ri-uzurpimit të paligjshëm të pronave në Kosovë”.

²⁵⁰ Ligji nr. 06/L-005 për tatimin në pronë të paluajtshme, neni39.

ligjor për t'i shlyer borxhet e mbetura të shërbimeve komunale në emër të këtyre personave për periudhën në të cilën nuk e kishin në posedim pronën e tyre.²⁵¹

Arsimi

Në të gjitha periudhat paraprake raportuese, Avokati i Popullit raportoi për polarizimin e sistemit të arsimit të komuniteteve pakicë në Kosovë. Sa i përket polarizimit të përmendur, edhe më tej vazhdojnë të funksionojnë dy sisteme arsimore, njëri sipas planit dhe programit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë i Republikës së Kosovës (MASHT), dhe i dyti sipas planit dhe programit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Zhvillimit Teknologjik (MASHZhT) i Republikës së Serbisë.²⁵² Pjesëtarët e komuniteteve pakicë në Kosovë i ndjekin dy sisteme arsimore, varësish nga gjuha e tyre dhe zona gjeografike në të cilën jetojnë. Pjesëtarët e komunitetit ashkali, egjiptian dhe një pjesë të komunitetit rom e ndjekin arsimin në bazë të planit dhe programit të MASHT-it në gjuhën shqipe, ndërsa pjesëtarët e komunitetit turk²⁵³ dhe pjesa më e madhe e komunitetit boshnjak²⁵⁴ e ndjekin arsimin fillor dhe të mesëm sipas planit dhe programit të MASHT-it, por në gjuhën e tyre amtare. Nga ana tjetër, pjesëtarët e komunitetit serb, malazez, kroat,²⁵⁵ goran, një pjesë e vogël e komunitetit boshnjak²⁵⁶ dhe një pjesë e komunitetit rom i vijnë shkollat fillore dhe të mesme në gjuhën serbe dhe sipas programit të MASHZhT-it të Republikës së Serbisë. Në përputhje me sa u tha më sipër, situata lidhur me arsimin në esencë nuk ka ndryshuar në raport me situatën e përshkruar në raportin paraprak vjetor të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit gjatë gjithë viteve të fundit ka tërhequr vëmendjen për cilësinë e dobët të teksteve shkollore në gjuhën turke dhe boshnjake, por deri tani nuk ka pasur rezultate në kuptim të përmirësimit të këtij problemi. Ky problem është ende i pranishëm, si në arsimin fillor, të mesëm dhe atë universitar.²⁵⁷ Tekstet shkollore për klasat më të larta të arsimit primar nuk janë në dispozicion, por edhe ato që janë në dispozicion janë tekste të përkthyer me një kualitet të dobët nga gjuha shqipe në gjuhën turke²⁵⁸ dhe boshnjake. Kështu që nxënësit dhe mësimdhënësit janë të detyruar të përdorin libra të fotokopjuara, ose libra të cilat i marrin nga Turqia dhe Bosnja e Hercegovina. Librat që merren nga vendet e tjera për nevojat e nxënësve në Kosovë, megjithatë nuk janë adekuate, sepse nuk janë të përshtatura me planin dhe programin e MASHT-it. Pjesëtarët e komunitetit turk

²⁵¹ <http://mzp-rks.org>.

²⁵² Shih raportet paraprake vjetore të IAP.

²⁵³ Është mundësuar në pesë nga gjithsej gjashtë komuna ku është përfaqësuar popullata e komunitetit turk.

²⁵⁴ Është mundësuar në shtatë nga gjithsej nëntë komuna ku është përfaqësuar popullata e komunitetit boshnjak.

²⁵⁵ Në shkollën fillore në Janjevë mësimet i ndjekin 35 nxënës, në shkollën e mesme 13, ndërsa në Universitetin në Mitrovicën Veriore i ndjekin studimet 10 studentë, pjesëtarë të komunitetit kroat (rreth 200 kroatë jetojnë në vendin Janjevë, komunën e Lipjanit, dhe rreth 35 kryesisht persona në moshë të shtyrë jetojnë në fshatin Letnicë, komuna e Vitisë).

²⁵⁶ Në Mitrovicën Veriore, Leposaviq dhe Obiliq.

²⁵⁷ Shih Raportet paraprake vjetore të IAP.

²⁵⁸ Këtë problem e kanë theksuar pjesëtarët e komunitetit turk, në takimin me Avokatin e Popullit në Prizren kah mesi i dhjetorit të vitit 2018.

gjithashtu ankohen për cilësinë e dobët në lëndën e gjuhës shqipe, të cilën nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme e ndjekin në kuadër të planit dhe programit mësimor. Ankesat kanë të bëjnë me kualifikimet e dobëta të mësuesve që e zhvillojnë këtë lëndë, si dhe faktin që nxënësit gjatë shkollimit të tyre nuk i fitojnë as njohuritë elementare të gjuhës shqipe. Ata gjithashtu theksuan edhe problemin e mungesës së teksteve historike në turqisht, por edhe mungesën e testeve për dhënien e provimit të vozitjes dhe kërkesat për marrjen e licencave të ndryshme të punës.²⁵⁹

Pjesëtarët e komunitetit goran, në komunën e Dragashit, ku jeton numri më i madh i tyre, ende e theksojnë problemin se fëmijët e tyre i ndjekin mësimet në kushte shumë të këqija dhe joadekuate. Edhe në këtë komunitet është prezent polarizimi në përzgjedhjen e arsimit. Një pjesë fëmijëve të komunitetit goran e ndjek mësimin në shkollën fillore dhe të mesme sipas planit dhe programit të MASHZhT-it në gjuhën serbe, ndërsa pjesa e tjetër e ndjek mësimin sipas planit dhe programit të MASHT-it në gjuhën boshnjake. Problemet, me të cilat janë ballafaquar gjatë periudhës paraprake raportuese janë tejkaluar, e këto kishin të bënin me përdorimin e përbashkët të objekteve shkollore për të dyja sistemet arsimore dhe vështirësinë e qasjes në mjediset e shkollës gjatë festave zyrtare dhe shkollore, që i përcaktonte MASHT-i i Republikës së Kosovës, të cilat nuk përputheshin me festat zyrtare dhe shkollore dhe pushime vjetore të nxënësve që e ndjekin mësimin sipas planit dhe programit të MASHZhT-it të Republikës së Serbisë.

Është rritur përqindja e fëmijëve të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian që e ndjekin arsimimin e detyrueshëm. Kështu është vazhduar trendi që përputhet me të dhënat zyrtare të vitit 2014/15, sipas të cilave fëmijët e pjesëtarëve të komuniteteve në fjalë, në 85% të rasteve e ndjekin mësimin në shkollën fillore nga klasa e 1-rë deri në klasën e 5-të, ndërsa 65% të fëmijëve nga radhët e këtyre komuniteteve e ndjekin rregullisht shkollën nga klasa e 6-të deri në klasën e 9-të, sipas planit dhe programit të MASHT-it të Republikës së Kosovës.²⁶⁰ Është për t'u lavdëruar fakti se MASHT-i në bashkëpunim me OJQ "VoRAE" dhe Qendrën e Kosovës për Arsim (KEC), gjatë këtij viti shkollor ka ndarë 600 bursa për nxënësit e shkollave të mesme që u përkasin komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian, që është 100 bursa më shumë se vitin e kaluar. Në fakt, fondi i përgjithshëm për bursa ka qenë 180.000 euro, prej të cilave MASHT-i i ka ndarë nga burimet e veta 60,000 euro, kurse shumica prej 120,000 eurove janë mjete të marra nga donacionet ndërkombëtare.²⁶¹ Me ndihmën e organizatave lokale joqeveritare dhe donatorëve ndërkombëtarë në Kosovë janë hapur më shumë se 80 qendra për mësim dhe përkrahje, të cilat u ofrojnë ndihmë në mësim më shumë se 5000 fëmijëve.²⁶²

²⁵⁹ Po aty.

²⁶⁰ Informacini është marrë në takimin me drejtorin e OJQ "VoRAE", i mbajtur më 18 dhjetor 2018, në hapësirat e IAP-së në Graçanicë.

²⁶¹ Po aty.

²⁶² <https://masht.rks-gov.net/uploads/2018/12/ua-nr-19-masht-për-themelimin-dhe-funksionimin-e-qendrave-mesimore-x.pdf>, të dhënat për numrin e qendrave dhe numrin e nxënësve që janë përfutues të drejtpërdrejtë të këtyre qendrave, janë marrë nga OJQ "VoRAE".

Një nga problemet lidhur me arsimin, të cilin e thekson komuniteti serb dhe komunitetet që i ndjekin mësimet në gjuhën serbe, është ndalimi i marrjes së teksteve nga Republika e Serbisë që daton nga viti 2015. Sa i përket këtij ndalimi, kjo u përfshi si masë e reciprocitetit për Republikën e Serbisë, e cila nuk i lejoi tekstet e MASHT-it të dërgohen në tri komuna të Republikës së Serbisë, të cilat janë të banuara me një numër të madh të shqiptarëve etnikë në komunat Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc.

Përveç arsimit fillor dhe të mesëm, pjesëtarët e komunitetit turk dhe boshnjak mund të vijnë në arsimin universitar në gjuhët e tyre në Universitetin Shtetëror “Ukshin Hoti” në Prizren, në gjuhën boshnjake në Universitetin Shtetëror “Haxhi Zeka” në Pejë, si dhe në Institucionin e Arsimit të Lartë për Biznes dhe Administratë, në kuadër të të cilit ofrohet edhe programi bachelor, edhe programi master i studimeve. Edhe pse ekziston arsimi në gjuhën turke dhe boshnjake në shkollat e larta të studimeve profesionale, pas përfundimit të tyre, nuk ka shumë mundësi për punësimin e të rinjve që e përfundojnë studimin e tyre në universitetet e përmendura. Kur është fjala për universitetin shtetëror në Prishtinë, mësimi ende organizohet vetëm në gjuhën shqipe.²⁶³

Me këtë rast, përsëri duhet tërhequr vëmendjen për mosorganizimin e mësimin të gjuhës shqipe si gjuhë zyrtare për nxënësit që e ndjekin mësimin në gjuhën serbe, si dhe mësimin e gjuhës serbe si gjuhë e dytë zyrtare për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, të cilët e ndjekin mësimin në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhën turke.²⁶⁴ Duhet të theksohet gjithashtu se ende nuk ka iniciativa institucionale me qëllim të ndërveprimit ndërkulturor, ndërveprimeve të përgjithshme reciproke, si dhe mësimin e gjuhëve nga ana e fëmijëve, të cilët e ndjekin mësimin në këto dy sisteme të ndara arsimore. Deri tani, përveç disa organizatave nga sektori civil dhe disa organizatave ndërkombëtare, nuk ka pasur iniciativa për socializim, aktivitete të përbashkëta dhe bashkëpunim ndërmjet nxënësve, pjesëtarë të komunitetit shqiptar dhe serb. Për fat të keq, një situatë e tillë vetëm i thellon barrierat e mëtejshme gjuhësore dhe barrierat e tjera, të cilat si rezultat i stereotipeve dhe paragjytimeve të përditshme imponohen midis komunitetit shqiptar dhe atij serb. Për tejkalimin e këtij problemi duhet të punohet gjithnjë e më shumë dhe në mënyrë të vazhdueshme, nëse dëshirohet çfarëdo progresi në marrëdhëniet e ardhshme midis këtyre komuniteteve.

Kur është fjala për verifikimin e diplomave të fituara në universitetin që gjendet në Mitrovicën Veriore, pas miratimit të Rregullores së Qeverisë në vitin 2015,²⁶⁵ ky proces po zbatohet me sukses, për të tretin vit radhazi. Megjithatë kjo çështje në vetvete nuk ka

²⁶³ Shih Raportin vjetor të IAP-së për vitin 2017.

²⁶⁴ Shih raportin e hulumtimit të OJQ-së “Qendra për Iniciativa Sociale”, mbështetur nga Komisioneri për Gjuhët me titull “Komunikimi ndërmjet pjesëtarëve të komunitetit serb dhe shqiptar - çështja e gjuhës” nga dhjetori 2018, http://www.kosovo.iom.int/sites/default/files/SI%20Language%20Report_SRB.pdf i http://www.kosovo.iom.int/sites/default/files/SI%20Language%20Report_ALB.pdf

²⁶⁵ Rregullorja nr. 21/2015 e Qeverisë së Republikës së Kosovës për kriteret për lëshimin e certifikatave për qytetarët e Kosovës, të cilët kanë marrë diploma në Universitetin e Mitrovicës së Veriut me qëllim të aplikimit për vendet e lira të punës, marrjen e licencave për punë dhe marrjen e provimeve profesionale në institucionet publike.

qenë subjekt i Marrëveshjes së Brukselit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Serbisë. Mirëpo, temë e marrëveshjes në fjalë, fillimisht në vitin 2011, ishte njohja reciproke e diplomave universitare, e cila u zgjerua në vitin 2016 dhe përfshiu diplomat e shkollave fillore, të mesme dhe profesionale sipas planit dhe programit të MASHZhT të Republikës së Serbisë, si dhe diplomat e shkollave të profilit të lartë të studimeve profesionale të fituara në Republikën e Serbisë, si dhe në Universitetin në Mitrovicën Veriore. Me zbatimin e marrëveshjes së përmendur është dashur të fillohet në mars të vitit 2016, por deri më sot kjo nuk është bërë²⁶⁶, gjë që deri tani në një masë të madhe ka ndikuar negativisht në mundësitë e punësimit si dhe arsimimit të mëtejshëm të atyre qytetarëve, të cilët e kanë përfunduar arsimin e tyre fillor, të mesëm dhe të lartë në gjuhën serbe.

Sa i përket bashkëpunimit të vetëm ndërinstitucional midis këtyre dy sistemeve arsimore, duhet theksuar dhe duhet vlerësuar pozitivisht faktin se në periudhën e kaluar një numër çdoherë e më i madh i komunave ka filluar të ofrojë një lloj mbështetje në punën e shkollave që e zhvillojnë mësimin në gjuhën serbe. Ndihma që u ofrohet këtyre shkollave është në formën e riparimit të objekteve shkollore, blerjen e pajisjeve shkollore, pagesën e faturave të shërbimeve, furnizimin me lëndë djegëse për ngrohje gjatë dimrit dhe sigurimin e transportit falas për nxënësit që udhëtojnë nga vise të largëta për ardhur në shkollën ku i vijojnë mësimet, çka është pak, por megjithatë paraqet njëfarë fillimi në bashkëpunimin midis dy sistemeve arsimore në fjalë.

Përdorimi i gjuhës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve²⁶⁷ e përcaktojnë karakterin shumë gjuhësor të shoqërisë në Kosovë, ndërsa gjuha shqipe dhe serbe gëzojnë status të barabartë të gjuhëve zyrtare në të gjitha institucionet shtetërore.²⁶⁸ Megjithatë, përdorimi i gjuhës serbe në komunikimin e qytetarëve me organet shtetërore, si dhe vetë organeve ndaj publikut dhe brenda institucioneve, si një nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës mebetet sfidë që duhet adresuar vazhdimisht. Përveç dygjuhësisë së garantuar me Kushtetutë, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve më hollësisht e rregullon përdorimin zyrtar të gjuhës, qoftë në nivelin qendror, apo në atë komunal si dhe varësisht nga përqindja e popullsisë dhe gjuhët e tjera mund ta kenë statusin e gjuhës zyrtare.²⁶⁹

Gjatë monitorimit të zbatimit të të drejtave gjuhësore²⁷⁰, gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit është i mendimit se lidhur me këtë çështje situata nuk ka ndryshuar

²⁶⁶ Shih raportin e OSBE-së “Qasja në arsimin parauniversitar në Kosovë”, publikuar në dhjetor 2018.

²⁶⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 5, 57,58 i 59 dhe Ligji nr. 02/L-037 për përdorimin e gjuhëve

²⁶⁸ Neni 5, paragrafi 1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 2 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

²⁶⁹ Neni 2 i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.

²⁷⁰ Të dhënat e grumbulluara gjatë takimeve në fund të vitit 2018 me përfaqësues të Misionit të OSBE-së në Kosovë, OJQ "CSD", qytetarë, ankesa të parashtruara, leximi i ligjeve dhe akteve nënligjore etj.

ndjeshëm në krahasim me periudhat e mëparshme të raportimit.²⁷¹ Kështu që, pavarësisht nga korniza ligjore moderne, dygjuhësia nuk është zbatuar në përputhje me të dhe se shumica e problemeve të periudhës së mëparshme janë ende të pranishme. Procesi i respektimit të zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, pavarësisht disa ndryshimeve pozitive, po bëhet shumë ngadalë, gjë që vetvetiu e imponon konstatimin se mekanizmat ekzistues për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore nuk janë efikas në sigurimin e një përgjegjësie dhe konsistence të plotë në zbatimin e kornizës legjislative të lartpërmendur.

Njësoj si në periudhat e mëparshme të raportimit, Avokati i Popullit gjithashtu dëshiron ta tërheqë vëmendjen në shkeljen e së drejtës për përdorim të barabartë të gjuhës serbe në procedurat administrative të qytetarëve me organet shtetërore, mosrespektimin e gjuhëve zyrtare në ueb-faqet zyrtare të një numri të madh institucioneve, në të gjitha nivelet e qeverisjes, si dhe ekzistencën e devijimeve të mëdha kur përditësohet një ueb-faqe në gjuhën serbe, është evidente mospërputhja jo vetëm e informacioneve në të dy gjuhët, por vërehen vonesa të dukshme në informacionet e postuara, ndërsa cilësia e përkthimit është veçanërisht e diskutueshme. Gjithashtu, edhe më tej është i pranishëm përkthimi joadekuat apo i gabuar i emërtimeve në gjuhën serbe i toponimeve.

Përveç të lartcekurave, edhe më tutje mbetet aktual problemi lidhur me kualitetin e përkthimit të ligjeve në gjuhën serbe, çështje të cilën Avokati i Popullit e citon në raportet e veta vjetore vite me radhë. Mirëpo, pavarësisht kësaj, ende nuk është bërë shumë për rishikimin gjuhësor të teksteve të ligjeve në gjuhën serbe. Megjithatë, me këtë rast duhet të thuhet se cilësia e përkthimit të ligjeve të miratuara gjatë vitit 2018 është më e mirë se në vitet e mëparshme.²⁷² Gjithashtu, duhet rikujtuar se, pavarësisht se ekziston Udhëzimi për standardet e hartimit të akteve normative²⁷³, qëllimi i të cilit është përcaktimi dhe unifikimi i standardeve për hartimin e akteve normative, është evidente se nuk po zbatohet, sepse dallimet në mes të versioneve në gjuhën shqipe dhe serbe në aspektin e terminologjisë dhe esencës janë të mëdha, pavarësisht nga fakti se të dyja versionet janë njëloj autentike dhe kur është fjala për interpretimin asnjë nga këto versione nuk ka epërsi mbi tjetrin. Nisur nga kjo, ende nuk ekzistojnë udhëzuesit e përcaktuar për standardizimin e përkthimeve që ka të bëjë me terminologjinë juridike apo standardet e caktuara që do të siguronin saktësinë e përkthimit të ligjeve nga drafti deri në versionin final, për të cilin votohet në Kuvend.²⁷⁴

²⁷¹ Shih raportet vjetore të Avokatit të Popullit nga 2012 deri 2017, pjesa për përdorimin e gjuhëve.

²⁷² Po aty.

²⁷³ Udhëzimi Administrativ nr. 03 / 2013 për standardet për hartimin e akteve normative, i datës 17 qershor 2013.

²⁷⁴ Gjithashtu shih raportin e publikuar nga ERAC në tetor 2018 “Në takim me cilësinë e barabartë të legjislacionit në gjuhën shqipe dhe serbe - një hap në plotësimin e mangësive në zbatimin e ligjit për përdorimin e gjuhëve”, si dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë “Legjislacioni dygjuhësh në Kosovë”, shtator 2018.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e mirëpret miratimin e një projektligji për aktet ligjore,²⁷⁵ i cili e parashikon një qasje më të lehtë për korrigjimin e gabimeve në ligjet në fuqi. Mekanizmi korrektues do ta krijonte bazën ligjore për korrigjimin e një numri të madh të materialeve, si dhe të gabimeve leksikore dhe drejtshkrimore, kurse ligjet në gjuhën serbe do të plotësoheshin me fjalë dhe fjali që mungojnë në disa ligje. Avokati i Popullit me këtë rast rikujton se është e domosdoshme të miratohet ligji i lartpërmendur sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në raportin vjetor të vitit 2017, Avokati i Popullit e përshëndeti vendimin dhe iniciativën e Qeverisë për formimin e një grupi punues që do ta hartojë një koncept dokument për themelimin e Njësisë qendrore të përkthimit.²⁷⁶ Gjatë vitit 2018, grupi i lartpërmendur i punës i ka mbajtur tri mbledhje dhe mbetet që në periudhën në vazhdim të dalë me rekomandime për krijimin e një baze ligjore, gjatë vitit 2019, për themelimin e Njësisë qendrore të përkthimit pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Me këtë rast, Avokati i Popullit e mbështet iniciativën dhe e vlerëson atë si një lëvizje pozitive në zgjidhjen konkrete të problemit, kur është fjala për standardizimin e përkthimit të dokumenteve zyrtare, ligjeve dhe akteve nënligjore në gjuhën serbe.

Megjithatë, duhet theksuar këtu se, për cilësinë e përkthimeve të ligjeve në gjuhën serbe, kontribut në këtë drejtim mund të japin edhe deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, gjuha amtare e të cilëve është gjuha serbe. Kjo, në fakt është e rëndësishme, për shkak se vetë angazhimi dhe përkushtimi i tyre në zgjidhjen e këtij problemi është i një rëndësie të madhe, sepse kështu komuniteteve pakicë do t'u garantohet qasja e barabartë në ligjet në fuqi, përkatësisht në gjyqësor. Përveç kësaj, është i nevojshëm një angazhim më i madh i Zyrës së Komisionarit për Gjuhë (ZKGJ)²⁷⁷ gjatë procesit legjislativ në përputhje me mandatin e tij, gjë që deri tani nuk ka ndodhur.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit i pranoi disa ankesa lidhur me shkeljen e së drejtës për përdorimin e gjuhës. Ankuesit u këshilluan që paraprakisht t'i drejtohen me ankesë ZKGJ-së, si një mekanizëm qendror për mbrojtjen e të drejtave gjuhësore, ndërsa IAP-ja regjistroi dy ankesa që kanë të bëjnë me të drejtat gjuhësore. Një ankesë u zgjidh pozitivisht, ndërsa procedura sipas ankesës e dytë është ende në proces.²⁷⁸

²⁷⁵ Projektligji për aktet ligjore, i miratuar në seancën e Qeverisë së Republikës së Kosovës, në dhjetor 2017.

²⁷⁶ Shih Vendimin e Qeverisë nr. 05/12 i datës 3 nëntor 2017. <http://kryeministri-ks.net/sr/dokumenti/?kategoria=odluke-sa-sednice-vlade&viti=2017>

²⁷⁷ Rregullorja 07/2012 për Zyrën për komisionerit për gjuhë, mandat ZKGJ (neni 16).

²⁷⁸ Ankesa nr.111/2018 S.G. kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës, ankesa kishte të bënte me dorëzimin e dokumentacionit zyrtar të i dënuari vetëm në gjuhën shqipe, pas intervenimeve të IAP-së, dokumentacioni i kontestuar u përkthye në gjuhën serbe dhe iu dorëzua ankuesit; dhe Ankesa nr.699/2018 B.M. kundër Dhomës së Përmbauesve Privatë të Kosovës dhe Përmbauesit privat në Prizren, ankesa ka të bëjë me pagesën e shërbimit të përkthimit të dokumentacionit zyrtar nga shqipja në serbisht, që ka të bëjë me procedurën për ekzekutimin e aktgjykimit, rasti është ende në pritje në IAP.

Gjithashtu, Avokati i Popullit edhe kësaj radhe vë në dukje shkeljen e së drejtës për përdorim të gjuhës shqipe në institucionet shtetërore në veri të Kosovës, ku përjashtim bën vetëm Komuna e Mitrovicës Veriore, ndërsa në komunat e tjera përdorimi i gjuhës shqipe është në një nivel minimal. Mungesa e përkthyesve të kualifikuar mbetet një nga sfidat kryesore në aspektin e përkthimit të dobët ose joadekuat. Mungesa e një fakulteti ose e një trajnimit të organizuar profesional për përkthyesit rezulton në gjendjen aktuale.

Ne jemi të vetëdijshëm për shumë sfida që sjell shumë gjuhësia në legjislacionin e Kosovës, megjithëse duket kështu problemi nuk është i pakapërcyeshëm, sepse vetëm me një angazhim të vazhdueshëm dhe qasje serioze mund të tejkalohet.

Liritë fetare në Kosovë

Çështja më e rëndësishme në sferën e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive fetare në Kosovë është tash e sa vjet rregullativa joadekuate ligjore për rregullimin e pozitës ligjore të bashkësive fetare. Ligji ekzistues nuk e rregullon në mënyrë adekuate pozitën e bashkësive fetare. Se ekziston një nevojë e tillë për ta sjellë një ligj të ri përmes të cilit do të rregullohej kjo fushë e kanë bërë të ditur të gjitha bashkësitë fetare tani e sa vjet. Kuvendi i Kosovës në parim e ka miratuar projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-31 mbi Liritë Fetare në Kosovë, më 29 nëntor 2017, dhe me vendim të Kuvendit nr. 06-V 014, ligji u është proceduar komisioneve të Kuvendit për shqyrtim. Megjithatë, edhe pse në dukje të parë zgjidhja e kësaj çështjeje dhe miratimi i ligjit ishte afër, edhe gjatë 2018 ky ligj nuk është miratuar. Aktualisht, pas procedimit të projektligjit te komisionet e Kuvendit dhe shqyrtimit nga ana e komisioneve të caktuara ka ardhur deri te zvarritja në procedim të mëtejshëm të këtij ligji dhe zgjidhjes së kësaj çështjeje.

Miratimi i ligjit përmes të cilit do të rregullohej pozita ligjore e bashkësive fetare është e rëndësishme në aspektin e respektimit të të drejtave dhe lirive të bashkësive fetare të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me konventat ndërkombëtare. Miratimi i ligjit të ri paraqet sfidë për shtetin për gjetjen e masave në mes të lirisë së bashkësive fetare, që në mënyrën e vetë ta rregullojnë funksionimin e tyre dhe të ruajnë, në një anë, pavarësinë e garantuar dhe ta harmonizojnë rregullimin e tyre me normat ligjore të shoqërisë moderne. Përgjatë viteve të kaluara, të gjitha bashkësitë fetare kanë theksuar se me miratimin e ligjit të ri dhe rregullimin e kësaj fushe, do t'u bëhej i mundur tejkalimi i barrierave të ndryshme ekzistuese administrative. Specifikat të cilat ekzistojnë në rregullimin e çdo bashkësie fetare veç e veç dhe ndjeshmëria e bashkësive fetare në ndërhyrje të organizimit të tyre të brendshëm, përmes së cilave eventualisht do të mund të shkelen të drejtat dhe liritë e tyre të garantuara, imponon nevojën që kësaj çështjeje t'i çasemi me kujdesin dhe ndjeshmërinë më të madhe, me qëllim që të gjitha bashkësitë fetare që përfaqësojnë traditën e shoqërisë kosovare dhe që të jenë në pajtim me standardet ndërkombëtare lidhur me lirinë e besimit fetar. Miratimi i ligjit të ri do të mundësonte respektimin e autonomisë së bashkësive fetare dhe zgjidhjen e pozitës ligjore dhe tejkalimin e barrierave të ndryshme ligjore dhe administrative, me të cilat sot

përballen bashkësitë fetare, si dhe do të mundësonte respektimin dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive të garantuara.

Përveç respektimit të të drejtave tradicionale të komuniteteve fetare të cilat kanë traditë të gjatë dhe një numër të madh besimtarësh, një nga sfidat e shteteve moderne, kur është fjala për respektimin e të drejtave dhe lirive fetare, është të rregullojë statusin ligjor të bashkësive fetare të cilat kanë më pak besimtarë ose të atyre komuniteteve fetare të cilat në të ardhmen do të mund të shprehin dëshirën dhe intencën për t'u regjistruar dhe njohur ligjërisht. Me qëllim të shmangies në të ardhmen të diskriminimit të mundshëm të ndonjë bashkësie fetare, e cila nuk është e përfshirë në atë tradicionale, Projektligji për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 02 / L-31 për Liritë Fetare në Republikën e Kosovës, në parim ka paraparë një opsion shumë të pranueshëm duke vendosur kushtet për regjistrimin të një bashkësie fetare me vetëm 50 anëtarëve të shtetasve të Republikës së Kosovës. Me një zgjidhje të tillë ligjore krijohet mundësia që nëse në të ardhmen paraqitet një nevojë e tillë, këtyre bashkësive fetare dhe besimtarëve t'u mundësohet manifestimi dhe aplikimi i besimit dhe respektim i lirive dhe të drejtave fetare në përputhje me kornizën ligjore. Zgjidhja ligjore e tillë e kësaj çështjeje, pemës së cilës parashihet edhe kushtëzimi me një numër të vogël besimtarësh është rekomanduar gjithashtu në Mendimin nr. 743-2013 të Komisionit të Venedikut.²⁷⁹

Projektligji për Lirinë Fetare në parim është miratuar në nëntor të vitit 2017 dhe ka paraparë zgjidhje të cilat mund të kishin bërë përparim të madh në rregullimin e pozitës ligjore, por pas shqyrtimit të ligjit në komisionet e Kuvendit ka ardhur deri te zvarritja në miratimin e këtij ligji. Për këtë arsye, vazhdojnë të jenë aktuale ende problemet e shumta në rregullimin e çështjeve të varrezave për bashkësitë fetare, si dhe çështjet e stabilitetit financiar të bashkësive fetare, të cilave me projektligjin e ri u janë paraparë privilegje tatimore dhe doganore të caktuara, me çka do t'u lehtësohej pozicioni i tyre për arsye se shteti nuk financon komunitetet fetare.

Çështjet që kanë qenë aktuale për bashkësinë fetare islame në vitet e mëparshme vazhdojnë të jenë aktuale edhe sot. Një prej tyre është trajtimi dhe vënia e shamive fetare në shkolla, për të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit ka raportuar në raportet vjetore të mëparshme.

Kisha Ortodokse Serbe gjatë vitit 2018 ka shprehur shqetësimin që ka të bëjë me ndërtimin e rrugës magjistrale Pejë-Plavë, duke pretenduar që traseja e kësaj rruge kalon nëpër zona e mbrojtur të Manastirit të Deçanit dhe se do ta rrezikonte atë duke këmbëngulur që traseja e rrugës të mos ketë fare hyrje në zonën e mbrojtur. Sipas informacioneve nga Ministria e Infrastrukturës, punimet nuk janë duke u zhvilluar në këtë pjesë të kontestuar nga kisha.

Gjatë muajit maj të vitit 2018, një grup i banorëve të fshatit Poterq i Epërm në komunën e Klinës ka protestuar duke kundërshtuar vizitën e një grupi të qytetarëve të komunitetit

²⁷⁹ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2014\)012-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-AD(2014)012-e)

serb që kishin për qëllim kryerje e riteve fetare në kishën “Trinia e Shenjët” në këtë fshat. Me këtë rast, Policia e Kosovës e ka përcjellë këtë tubim dhe nuk është shënuar ndonjë incident.

Kisha Katolike në Kosovë ka pësuar ndryshime në statusin hierarkik. Gjegjësisht, deri më 5 shtator 2018, kisha katolike në Kosovë ka funksionuar dhe ka pasur statusin e Administratës Apostolike-Prizren, kur me dekret të Papës është ngritur në nivelin e Dioqezës së veçantë Prizren-Prishtinë²⁸⁰, nën administrimin e drejtpërdrejtë të Selisë së Shenjt/Vatikanit. Ky akt është i një rëndësie të veçantë për besimtarët katolikë në Kosovë.

Kisha Protestante në Kosovë, si problem më të madh, ka theksuar mosmiratimin e ligjit, me anë të të cilit do të rregullohej pozita e tyre ligjore.

Komuniteti hebraik në Kosovë është një bashkësi fetare me traditë historike, e cila nuk ka edhe numër të madh anëtarësh. Kërkesa e tyre drejtuar Komunës së Prishtinës për ndarjen e një parcele në të cilën do të mund të ndërtohej sinagoga, e në të cilën mund t'i realizonin lutjet pjesëtarët e këtij komuniteti, ende nuk është realizuar.

Me projektligjin e ri, i cili ende nuk është miratuar, Komuniteti i Tarikateve të Kosovës është një bashkësi fetare me një histori të gjatë e të pasur në Kosovë dhe, si i tillë, është i përfshirë në mesin e bashkësive fetare tradicionale në Kosovë. Në këtë mënyrë respektohen të drejtat e tyre për lirinë e fesë, ushtrimin dhe fuqizimin e fesë dhe traditës.

Aktivitetet e Departamentit për Mbrojtje nga Diskriminimi (DMD)

Departamenti për Mbrojtjen nga Diskriminimi (DMD) në kuadër të IAP-së, përveç se ka shqyrtuar ankesat e paraqitura në IAP, ka ndërmarrë edhe aktivitete të tjera në drejtim të promovimit të mandatit të Avokatit të Popullit bazuar në kompetencat e dhëna me Ligjin nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij, lidhur me çështje të mos diskriminimit, kanë realizuar takime të rregullta me OJQ-të, të cilat i përfaqësojnë interesat e personave të komunitetit LGBT (Lesbikë, Gei, Biseksual dhe Transgjender), kanë qenë pjesëmarrës në panele të organizuara në tryezat e rrumbullakëta, trajtimin e rasteve LGBTI nga sistemi i drejtësisë në Kosovë, të shëndetësisë etj., dhe gjithashtu janë pjesëmarrës në Grupin Këshillëdhënës dhe Koordinues në nivel Nacional në Republikën e Kosovës për të drejtat e komunitetit LGBT.

Takime të rregullta janë realizuar edhe me OJQ të cilat i mbrojnë interesat e personave me aftësi të kufizuara si dhe me OJQ të cilat i mbrojnë interesat e komuniteteve joshumicë në Kosovë, komunitetit serb, rom, egjiptian, ashkali, turk etj. Gjithashtu takime të rregullta lidhur me çështjen e barazisë gjinore janë mbajtur edhe me Rrjetin e Grave të Kosovës.

²⁸⁰ <http://press.vatican.va/content/salastampa/it/bollettino/pubblico/2018/09/05/0613/01317.html> , qasur me, 26.12.2018.

Më 26 janar 2018, DMD-ja i është përgjigjur pyetësorit të Qendrës për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD) në çështje të cilat lidhen me komunitetin LGBT.

Më 7 Shkurt 2018, në emër të Avokatit të Popullit, drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në cilësi të panelistit në konferencën e organizuar nga Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore (CSGD), ku në fokus ishin zhvillimet kryesore gjatë vitit 2017, si dhe rekomandimet dhe hapat që duhet t'i ndërmarrim në të ardhmen. Gjithashtu me këtë rast CSGD-ja kishte publikuar edhe raportin vjetor për vitin 2017 “Rishikim: Komuniteti LGBTI dhe të drejtat e tyre në Kosovë”.

Më 9 mars 2018, drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në takimin e Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues për të drejtat e komunitetit LGBT (Lesbique, Gei, Biseksual dhe Transgender), i mbajtur në Qeverinë e Kosovës.

Më 17 maj 2018, zëvendësja e Avokatit të Popullit nga sektori për Mbrojtje nga Diskriminimi ka marrë pjesë në Ekspozitën “Qe pse!”, e mbajtur në Sheshin “Nëna Terezë” në Prishtinë, e cila është organizuar nga CSGD-ja për Ditën Ndërkombëtare Kundër Homofobisë dhe Transfobisë, ku edhe janë shfaqur fotografi të komenteve homofobike që janë shkruar në mediat sociale gjatë Javës së Krenarisë që u mbajt në tetor 2017. Në po të njëjtën datë, drejtoresha e DMD-së ka qenë e pranishme në Talent Show – “Diversity – the new flavor” në Teatrin Oda në Prishtinë, ku organizatat LGBTI kanë mbajtur Talent Show për Ditën ndërkombëtare Kundër Homofobisë dhe Transfobisë, me qëllim të fuqizimit të personave LGBTI për të shprehur talentin e tyre përmes këndimit, kërcimit, poezisë dhe performances drag.

Më 28 maj 2018, drejtoresha e DMD-së ka qenë e pranishme në debatin televiziv të organizuar nga KTV-ja, emisioni “Rubikon”, ku temë e diskutimit ishin të drejtat e komunitetit LGBTI në Kosovë.

Më 1 shkurt 2018, Avokat i Popullit ka marrë pjesë në konferencën, e cila është mbajtur në kuadër të “Koalicionit të drejtat e barabarta për të gjithë” (ECMI Kosova), ku është prezantuar raporti “Njerëzit në mes: e ardhmja e qytetarëve dhe liria e lëvizjes së serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera pakicë”.

Më 2 shkurt 2018, drejtoresha e DMD-së ka dhënë intervistë në një kronikë të realizuar nga Radiotelevizioni i Kosovës lidhur me regjistrimin e pronave të përbashkëta në emër të të dy bashkëshortëve.

Më 15 shkurt 2018, në Institucionin e Avokatit të Popullit, drejtoresha e DMD-së, së bashku me këshilltaren e lartë juridike, janë takuar me përfaqësues të USAID-it për vlerësimin e performancës së Programit për të Drejtën Pronësore (PDP) të USAID-it në Kosovë, që nga viti 2014.

Më 20 shkurt 2018, këshilltarja e lartë juridik në DMD ka qenë e pranishme në tryezën e organizuar nga ana e Akademisë së Drejtësisë, ku tema ka qenë për barazinë gjinore në procedurë gjyqësore në përgjithësi dhe në rastet e dhunës në veçanti.

Më 16 mars 2018, Drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në konferencën për prezantimin e të gjeturave kyçe të Analizës së Situatës të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë, të organizuar nga *Save the Children*, në kuadër të projektit “Mbështetje për shërbime më të mira sociale për grupet më të cenueshme”, projekt i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i bashkëfinancuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (Sida).

Më 19 mars 2018, Avokati i Popullit, së bashku me dy zëvendëset e tij, si dhe bashkëpunëtorët tjerë, vizitoi Shoqatën Down Syndrome Kosova (DSK), me seli në Prishtinë.

Më datë 21 mars 2018, Avokati i Popullit, së bashku me zëvendësit e tij, si dhe me DMD-në, ishte pjesëmarrës në Marshin Ndërgjegjësues me qëllim të adresimit të kërkesave për realizimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, i organizuar nga OJQ “Down Syndrome Kosova”.

Këshilltari juridik i DMD-së ka qenë pjesëmarrës në Forumin për Sundim të së Drejtës, i mbajtur në Shkup, më 16 dhe 17 mars 2018, i organizuar nga organizata “Civil Rights Defenders”.

Më 8 dhe 9 mars 2018, këshilltarët juridikë të DMD-së kanë realizuar vizita në lagjet e banuara nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian (Fushë Kosovë, Obiliq dhe Gracanicë).

Më 14 mars 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka marrë pjesë në grupin punues për siguri, dialog dhe riintegrim, në kuadër të zbatimit të “Procesit të Shkupit” dhe me qëllim të sigurimit të komuniteteve dhe reagimit të mekanizmave lokale në incidente, të cilat kanë ndikim në komunitete, e organizuar nga OSBE-ja.

Më 22-23 mars 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka marrë pjesë në punëtorinë për hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore, e organizuar nga ana e Agjencisë për Barazi Gjinore.

Më 23 mars 2018, drejtoresha e DMD-së, së bashku me këshilltarët juridikë të DMD-së, si dhe me Departamentin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve kanë vizituar Shkollën Filllore “Qamil Batalli” në Prishtinë, në kuadër të fushatës “Njihuni me të Drejtat Tuaja”, e cila ka për qëllim promovimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, të drejtave të fëmijëve si dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

Më 30 mars 2018, zëvendësja e Avokatit të Popullit në sektorin për Mbrojtje nga Diskriminimi ka qenë pjesë e panelit në takim pune, me temën: “Fuqizimi dhe zbatimi i planit të veprimit kundër dhunës në familje”, i organizuar në Komunën e Gjakovës nga Mekanizimi Koordinues për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje (MKMDhF). Qëllimi i këtij takimi, sipas organizatores, ishte shpalosja e të arriturave të MKMDhF-së dhe mundësia për të diskutuar rreth sfidave, nevojave dhe bashkëpunimin në mes nivelit lokal dhe qendror, si dhe bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Më 30 mars 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka marrë pjesë në kampanjën informuese “Barazia Gjinore në Kodin Civil”, e organizuar nga Ministria e Drejtësisë, me mbështetjen e Zyrës së Bashkimit Evropian.

Më 10 prill 2018, Avokati i Popullit, i shoqëruar nga përfaqësuesit e DMD-së, ka vizituar Lagjen e Romëve në Graçanicë. Fillimisht ata takuan përfaqësues të OJQ-së Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE dhe më pas edhe me familje të komunitetit rom, ku u njoftuan me problemet e tyre. Gjithashtu vizita u realizua edhe tek disa familje tjera rome që, me ndihmën e IAP-së dhe të OJQ VoRAE, i kanë zgjidhur pozitivisht ankesat e tyre.

Më 19 prill 2018, zëvendësja e Avokatit të Popullit, së bashku me drejtoreshën e DMD-së, kanë qenë pjesëmarrëse në tryezën e organizuar nga UNHCR-ja, Zyra e Komisarariatit të KB-ve për Refugjatët, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Këshilli Danez për Refugjatët, e temën: “Personat e zhvendosur nga Kosova në regjion – Rivlerësimi i interesimit për kthim dhe profilizimi i personave të zhvendosur brenda në Kosovë”.

Më 23 prill 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka marrë pjesë në puntorinë lidhur me mbështetjen dhe zhvillimin e platformës për shoqërinë civile për monitorimin dhe raportimin për krimin e urrejtjes, e organizuar nga OSBE-ja.

Më 26 prill 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka marrë pjesë në takimin e radhës në grupin punues lidhur me të drejtat pronësore të grave, i organizuar nga USAID-i.

Më 30 prill 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka qenë pjesëmarrëse në prezantimin e draftit të vlerësimit të EX-posti të Ligjit 05/L-020 për Barazi Gjinore, i organizuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore.

Më 3 maj 2018, drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në tryezën me temën “Barazia Gjinore në Procedurë Gjyqësore”, e cila ishte e organizuar nga GIZ-i.

Më 2 maj 2018, me delegimin nga Avokati i Popullit, zëvendësja e Avokatit të Popullit dhe drejtoresha e DMD-së kanë marrë pjesë në mbledhjen Komisionit për të Drejtat e Njeriut.

Më 4 maj 2018, drejtoresha e DMD-së, së bashku me këshilltaren e lartë juridike, kanë marrë pjesë në Punëtorinë për përmirësimin e proceseve dhe praktikave të rregullimit të barazisë gjinore në projekte të IPA-së, e organizuar nga Ministria e Integritimit Evropian.

Më 4 maj 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka marrë pjesë në konferencën “Shumë gjuhësia: Vlera dhe/ose Detyrim”, e organizuar nga Komisionarit për gjuhët.

Më 7 maj 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka marrë pjesë në prezantimin e raportit rreth të drejtave pronësore të grave në Viti, në Kaçanik dhe në Shterpcë, i organizuar nga UNDP-ja.

Më 17 maj 2018, dy këshilltare të larta juridike në DMD kanë qenë pjesëmarrëse në “Punëtorinë për dhunë në familje”, e organizuar nga OSBE-ja.

Më 31 maj 2018, drejtoresha e DMD-së ka qenë pjesë e panelit në punëtorinë e organizuar për shtatëmbëdhjetë (17) asistentët ligjorë të projektit ERAC, me temën “Mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut përmes prizmit të bashkëpunimit të IAP-së me mediat (sesioni i parë) dhe funksionimi i zyrave rajonale të IAP-së, cilat janë mundësit/mënyrat për t’iu qasur këtyre zyrave (sesioni i dytë)”.

Më 31 maj 2018, këshilltarja e lartë juridike në DMD ka qenë pjesëmarrëse në prezantimin e draftit Ex-post të Ligjit 05/L-020 për Barazi Gjinore, i organizuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore.

Më 1 qershor 2018, në rastin e shënimit të 1 qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) organizoi aktivitete të ndryshme për fëmijët në Prishtinë, Graçanicë, Prizren dhe Gjilan me qëllim të përfitimit të njohurive themelore për të drejtat e njeriut. Gjatë këtyre aktiviteteve fëmijët, nëpërmes pikturave dhe vizatimeve, u njoftuan për të drejtat e fëmijëve. Pjesë e këtij aktiviteti ishte edhe DMD-ja.

Më 20 qershor 2018, dy këshilltare të larta juridike në DMD kanë qenë pjesëmarrëse në konferencën e organizuar nga Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), me temën: “Angazhimi institucional në lidhje me komunitetin LGBT”.

Më 25 qershor 2018, dy këshilltare të larta juridike në DMD kanë marrë pjesë në “Tryezën e rumbullakët për financimin e qëndrueshëm dhe çështjet organizative në lidhje me strehimoret e dhunës në familje në Kosovë”, e organizuar nga OSBE-ja.

Më 13 korrik 2018, drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në mbledhjen e grupit avokues, e organizuar nga Rrjeti i Grave, me temën: “Përmirësimi i kuadrit ligjor”.

Më 14 shtator 2018, drejtoresha e DMD-së është prononcuar për medie lidhur me funksionimin e DMD-së.

Më 25 shtator 2018, DMD-ja ka zhvilluar takim me Komisionarin për Mbrojtje nga Diskriminimi i Republikës së Shqipërisë, në shkëmbim të përvojave të punës.

Më 26 shtator 2018, DMD-ja u është përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga mediat elektronike “indexonline” përkritazi me të drejtën në punë.

Më 26 shtator 2018, zëvendësja e Avokatit të Popullit ka mbajtur ligjëratë për prokurorët e rinj lidhur me funksionimin e DMD-së.

Më 27 shtator 2018, këshilltarja e lartë juridike e DMD-së ka qenë e pranishëm në takimi me këshillin koordinues për komunitetin LGBTI.

Më 5 tetor 2018, Avokati i Popullit, zëvendësit e tij dhe drejtoresha e DMD-së kanë zhvilluar takim me Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, përkritazi me zbatimin e Ligjit për Barazi Gjinore.

Më 5 tetor 2018, DMD-ja ka qenë pjesëmarrës në aktivitetin lidhur me komunitetin LGBTI i organizuara nga OJQ-të, të cilat i përfaqësojnë interesat e personave të komunitetit LGBT.

Më 8 tetor 2018, Avokati i Popullit, zëvendësit dhe drejtoresha e DMD-së kanë zhvilluar takim me Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me rekomandimet në zbatimin e Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi.

Më 8 tetor 2018, Avokati i Popullit ka qenë pjesë e panelit në konferencën lidhur me përmirësimin e të drejtave të LGBTI-së.

Më 9 tetor 2018, këshilltarët juridikë të DMD-së kanë marrë pjesë në punëtorinë “Mobilizimi i të rinjve LGBT + Shembuj të praktikave të mira të ekipit të vullnetarëve nga *Da se zna*, e cila është mbajtur qendrën e konferencave Orion, në Prishtinë.

Më 13 tetor 2018, drejtoresha e DMD-së ishte pjesë e panelit në konferencën “Profesionistë Shëndetësorë, Pacienti dhe të Drejtat e Tyre”.

Më 4 tetor 2018, këshilltari juridik në DMD mori pjesë në tryezën “Përfshirja e vajzave dhe personave me aftësi të kufizuar nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në edukim dhe punësim në Kosovë”, organizuar nga OJQ Voice of Roma, Ashkali and Egyptians.

Më 17 tetor 2018, drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në debatin e hapur me temën: “Obligimi i institucioneve në ofrimin e shërbimeve në rastet e edukimit dhe arsimimit për personat e verbër dhe të drejtat e tjera që u takojnë sipas kornizës ligjore në fuqi në Kosovë”, i organizuar nga OJQ “Iniciativa e Pavarur e të Verbërve të Kosovës”, në kuadër të organizimeve të *Javës ndërkombëtare të njeriut me shkop të bardhë*.

Më 14 dhe 15 nëntor 2018, Avokati i Popullit ka qenë pjesëmarrës në Konferencën Regjonale, me temën: “Tolerant and Inclusive Societies in the Western Balkans”, në Malin e Zi.

Më 26 tetor 2018, drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në takimin e mbajtur nga Koordinatori Nacional për Mbrojtjen e Dhunës në Familje, përkitazi me konferencën rajonale: “Qasja në drejtësi e viktimave të dhunës në familje dhe në baza gjinore”.

Më 28-30 tetor 2018, këshilltarja e lartë juridike e DMD-së ka qenë pjesëmarrëse në punëtorinë dyditore: “Integrimin e Perspektivës Gjinore - Shërbime Sociale”, mbajtur në Shkodër të Shqipërisë.

Me 30 tetor 2018, drejtoresha e DMD-së ka qenë pjesëmarrëse në konferencën në të cilën është prezantuar raporti “Programet e trajnimit për çështje gjinore për administratën publike të Kosovës”, organizuar nga koalicioni “Të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC)”.

Më 7 dhe 8 nëntor 2018, këshilltari juridik i DMD-së mori pjesë në konferencën “Përfshirja e romëve pas përfundimit të dekadës së romëve”, e mbajtur në Shkup të Maqedonisë dhe e organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Maqedonisë.

Më 15 nëntor 2018, drejtoresha e DMD-së ka qenë pjesë e emisionit televiziv “Rubikon” , ku temë debati ka qenë “Viktimat e dhunës gjatë luftës, statusin, pensionet”.

Më 19-23 nëntor 2018, në shkëmbim të përvojave, në DMD kanë qenë në vizitë studimore dy përfaqësues të Ombudsmanit nga Bosnja.

Më 20 nëntor 2018, këshilltarja e lartë juridike e DMD-së ka marrë pjesë në punëtorinë me temën: “Të drejtat trashigimore të grave”, e organizuar nga Forumi i Gjyqtareve dhe Prokuroreve të Kosovës.

Më 21 nëntor 2018, drejtoresha e DMD-së ka marrë pjesë në diskutimin e hapur mbi draftin e dokumentit propozues për përfshirjen e specifikave/nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara në *Procedurat Standarde të Veprimit kundër Dhunës në Familje*, i organizuar nga OJQ Hendikos.

Më 26 nëntor 2018, drejtoresha e DMD-së ka qenë pjesëmarrëse në tryezën mbi çështjet e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, Plemetin/Obiliq, Mahalla e Romëve/Mitrovicë, Brekoc-Ali Ibra/Gjakovë, Dubravë/Ferizaj dhe Gjilan, e organizuar nga UNHCR-ja.

Më 2 dhjetor 2018, drejtoresha e DMD-së ka qenë në emisionin televiziv “Familja ime” , ku temë debati ka qenë “Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”.

Më 3 dhjetor 2018, drejtoresha e DMD-së ka qenë e pranishme në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, për nder të shënimit të “3 Dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara”,

Më 4 dhjetor 2018, zëvendësja e Avokatit të Popullit për sektorin e Mbrojtjes nga Diskriminimi, si dhe drejtoresha e DMD-së, kanë qenë të pranishme në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, lidhur me fushatën për aktivizimin kundër dhunës në baza gjinore.

Më 3 dhe 4 dhjetor 2018, këshilltari juridik në DMD mori pjesë në punëtorinë dyditore në Prishtinë, me temën: “Krimet e Urrejtjes”, e organizuar nga OSBE-ja - misioni në Kosovë.

Më 11 dhjetor 2018, këshilltari juridik në DMD mori pjesë në tryezën: “Krijimi i një databaze për OJQ që ka të bëjë me incidentet e krimeve të urrejtjes”, organizuar nga OSBE-ja - misioni në Kosovë.

Raportet e publikuara nga Avokati i Popullit që lidhen me bazë diskriminimi

Më 12 shkurt 2018, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime në rastin Ex officio nr. 853/2016, përkitazi me *Kriteret diskriminuese në konkurset për punësim të*

UP. Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vërejtjes për nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi si dhe trajtimi i barabartë në kriteret e vendosura për vendet e lira të punës të shpallura për rekrutimin e kandidatëve në Universitetin e Prishtinës “Hasana Prishtina” gjatë vitit 2016 dhe 2017.

Më 27 shkurt 2018, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime në rastin A. nr. 890/2016, përkitazi me të drejtën në pension kontributpagues të moshës si dhe e drejta në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë. Raporti është i bazuar në rastin A.890/2016 dhe mbështetet në pretendimet, faktet dhe dëshmitë e ankuesit të paraqitura në IAP, lidhur me ndërprerje të pensioneve kontributpaguese. Përveç ankesës në fjalë, Avokati i Popullit ka pranuar edhe ankesa të natyrës së njëjtë. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, që qytetarëve t’u ofrohet mundësia e garantuar ligjore dhe kushtetuese në shfrytëzim të pensioneve kontributpaguese si e drejtë në pronë.

Më 16 mars 2018, Avokati i Popullit ka publikuar Raport me Rekomandime në rastin A. nr. 355/2016, përkitazi me të drejtat civile të shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të zhvendosur në Republikën e Kosovës, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Kryeministrit të vendit, i cili ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve përgjegjëse shtetërore të Republikës së Kosovës lidhur me të drejtat civile për status dhe qëndrim ligjor dhe pajisjen me dokumentacion personal të shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të shpërngulur në Kosovë.

Më 6 prill 2018, Avokati i Popullit e ka publikuar Raportin me Rekomandime Ex 235/2018 për Qeverinë e Republikës së Kosovës dhe ministrinë përkatëse, me qëllim të tërheqjes së vëmendjes mbi nevojën e rregullimit pozitiv të pensionit kontributpagues për kategorinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 vjetëve, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna, në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë.

Më 10 prill 2018, Avokati i Popullit i ka publikuar Raportin me Rekomandime në rastin A.nr. 885/2016 Zlatibor Kostić kundër Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP), përkitazi me mosekzekutimin e vendimit KSIZ-HPCC/D/197/2005A&C, i datës 18.6.2005, i nxjerrë sipas lëndëve DS 000641 dhe DS004997.Ex 235/2018. Qëllimi i këtij raporti është shqyrtimi i çështjes së kohëzgjatjes së procedurës nga ana e AKKVP-së lidhur me mospagesën e kompensimit parashtruesit të kërkesës në bazë të vendimit përfundimtar si dhe pabarazisë para ligjit në kuptimin e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare për parashtruesit e kërkesave të kategorisë AC dhe gëzimit paqësor të së drejtës pronësore të konfirmuar me vendim.

Më 16 prill 2018, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime në rastet A. nr. 114/2018; A. nr. 122/2018 dhe A. nr. 182/2018, kundër Ministrisë së Drejtësisë – Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), përkitazi me kushtin diskriminues në konkursin për punësim në ShKK. Qëllimi i raportit është të tërheqë vëmendjen për

nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi si dhe trajtimit të barabartë në punësim në rastin e kriterit që është paraparë për vendet e lira të punës, i shpallur në konkursin për punësim të kandidatëve në ShKK. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka analizuar harmonizimin e kriterit të kontestuar, të cilin ShKK-ja e ka publikuar më 12 shkurt të vitit 2018, në konkursin me numrin e referencës MJ/KCS/132-09-02-2018, për 70 (shtatëdhjetë) vende të lira për *Zyrtarë korrektues*, me legjislacionin vendor dhe instrumentet ndërkombëtare që veçanërisht kanë të bëjnë me aspektin e mbrojtjes nga diskriminimi.

Më 17 korrik 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me Rekomandime në rastin e ankuesit z. Fran Marniku, përkitazi me zvarritjen e procedurës gjyqësore nga Gjykata e Apelit lidhur me një kontest prone.

Më 20 korrik 2018, Avokati i Popullit ia ka përcjellë Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, Rektoratit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Raportin A. nr. 533/2017, nëpërmjet të cilit rekomandohet plotësimi dhe riformulimi i nenit 5 i Udhëzimit Administrativ nr. 11 për Krahasueshmërinë dhe Barasvlerën e Diplomave dhe të Programeve Studimore para dhe sipas sistemit të Bolonjës, me qëllim të mundësimit të njohjes së titullit Master për të diplomuarit në sistemin pesëvjeçar të studimeve në fushën teknike para Sistemit të Bolonjës. Avokati i Popullit, pas analizës së detajuar të çështjes ka konstatuar që mospërputhja në mes Ligjit për Arsimin e Lartë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 11, i cili rregullon çështjen e Barasvlerësimit të Diplomave dhe Programeve Studimore Para Sistemit të Bolonjës dhe të Sistemit të Bolonjës, i cili nuk sqaron shprehimisht ekuivalencën e titujve në raport me ECTS kreditë e fituara gjatë programeve studimore të fushës teknike, me kohëzgjatje pesëvjeçare, ka rezultuar me efektin e trajtimit të pabarabartë në punësim dhe kompensim të pagës të një numri të konsiderueshëm të të diplomuarve në këtë sistem, të cilët janë të angazhuar në mësimdhënie, në krahasim me të tjerët.

Më 2 nëntor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raport me Rekomandime për rastin e ankuesit z. Arben Hajrullahu, përkitazi me pretendimet e tij për trajtim të pabarabartë të kandidatëve në konkursin publik të datës 24 nëntor 2016, të shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” për zgjedhjen e personelit akademik për mësimdhënës në Fakultetin Filozofik, duke i rekomanduar Rektoratit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Këshillit të Fakultetit Filozofik që të ndërmarrin veprime të menjëhershme bazuar në kompetencat ligjore, për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit për diskriminim, si dhe në përputhje me nenin 20, paragrafi 2 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të ofrojnë prova të mjaftueshme për të dëshmuar se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë në konkursin publik të datës 24 nëntor 2016, i shpallur nga Universiteti i Prishtinës, për zgjedhjen e personelit akademik; dhe Inspektoratit të Arsimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, që të ndërmarrë veprime të menjëhershme, bazuar në kompetencat ligjore, për t’iu përgjigjur ankuesit në ankesën e

tij me nr. prot. 213, e parashtruar më 13 prill 2017, me pretendime se Këshilli i Fakultetit Filozofik ndaj tij ka kryer veprime diskriminuese.

Amicus curiae dhe opinione

Më 1 shkurt 2018, Avokati i Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae), ia ka përcjellë Gjykatës Supreme të Kosovës, Gjykatës së Apelit, Gjykatave Themelore dhe Ministrisë së Administratës Publike, *Opinionin* në lidhje me çështjen e interpretimit të konceptit të “përvojës së punës”, në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike.

Më 21 shkurt 2018, Avokati i Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae), ia ka përcjellë Gjykatës Themelore në Prishtinë *Mendimin Juridik* lidhur me trajtimin e personave të sëmurë rëndë, që janë të privuar nga liria në rastin Driton Hajdari.

Më 16 mars 2018, Avokati i Popullit, në zbatim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, ia ka përcjellë Rektoratit të Universitetit të Prishtinës dhe Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe të Teknologjisë, *Opinionin* në lidhje me parandalimin e nepotizmit në Universitetin e Prishtinës. Qëllimi kryesor i këtij Opinioni është:

- 1) Të sqarojë se ky konstatim nuk e ndalon aspak Universitetin e Prishtinës që ta luftojë problemin e nepotizmit në bazë të procedurave të parashikuara me Statutin e Universitetit të Prishtinës;
- 2) të theksojë se luftimi i nepotizmit është i domosdoshëm për respektimin e plotë të drejtave të njeriut të të gjithë kandidatëve për punësim në Universitetin e Prishtinës; dhe
- 3) të propozojë disa masa për të përforcuar edhe më shumë parandalimin e nepotizmit, duke u bazuar në politikat e të dy universiteteve që njihen botërisht për standarde të larta akademike: Harvard University i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe University of Cambridge i Mbretërisë së Bashkuar.

Më 21 qershor 2018, Avokati i Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae), ia ka përcjellë Gjykatës Themelore në Prishtinë *Mendimin Juridik* në rastin Ankesa nr. 499/2017 Xhafer Kadrija, lidhur me cenimin e të drejtave të personave të verbër, respektivisht mosrespektimin e dispozitave ligjore për lirim nga tatimi në pronë, sipas ankesës së Shoqatës së të Verbërve në Gjakovë. Avokati i Popullit, gjatë trajtimit të rastit në fjalë, e ka vërejtur se Komuna e Gjakovës nuk po i zbaton dispozitat e Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, në bazë të të cilave personat e verbër lirohen nga tatimi për pronën e paluajtshme. Avokati i Popullit më tej vëren se, në disa komuna, personat e verbër lirohen nga tatimi në pronën e paluajtshme sipas dispozitave të Ligjit për Personat e Verbër.

Më 2 korrik 2018, Avokati i Popullit, në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae), ia ka përcjellë Gjykatës Themelore në Prishtinë *Mendimin Juridik* lidhur me rastin A.nr.903/2017 Mufail Salihaj, në lidhje me Padinë e ankuesit kundër Universitetit Publik

të Prishtinës “Hasan Prishtina”, i cili përqendrohet në sqarimin e procedurave ligjore përkitazi me kufizimin e moshës si kriter për punësimin e ankuesit në pozitën e mësimitdhënësit, në konkursin e shpallur nga UP-ja, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Më 23 gusht 2018, Avokati i Popullit, në zbatim të funksioneve të tij kushtetuese dhe ligjore, më 17 gusht 2018, në rastin e parashtruar nga Nita Shala, Ankesa nr. 421/2018, ka nxjerrë *Opinionin* përkitazi me kriterin për dorëzimin e vendimit të nostrifikimit për aplikim në konkursin për personel akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Më 26 shtator 2018, Avokati i Popullit i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese të Kosovës me *Mendim Juridik*, në cilësi të Mikut të Gjykatës, lidhur me rastin e Blert Morinës.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKPT)

Republika e Kosovës nuk është palë nënshkruese e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, meqenëse ende nuk është anëtare e Kombeve të Bashkuara. Megjithatë, neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare garantohen me këtë Kushtetutë. Këto marrëveshje dhe instrumentet ndërkombëtare zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Një ndër konventat e përfshira në këtë nen është edhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese, e cila u miratua më 10 dhjetor 1984 dhe hyri në fuqi më 26 qershor 1987.²⁸¹

Ndërsa, më 18 dhjetor 2002, Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në seancën e pesëdhjetë e shtatë (57) me rezolutën A/RES/57/199, miratoi Protokollin Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Ky protokoll hyri në fuqi më 22 qershor 2006.²⁸² Qëllimi kryesor i protokollit në fjalë është krijimi i një sistemi të vizitave të rregullta, të cilat ndërmerren nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe nacionale, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, me qëllim të parandalimit të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.²⁸³

Më tej, Protokollin Fakultativ përcakton obligimin e secilit shtet palë nënshkruese që të themelojë një ose më shumë organe vizituese për parandalim të torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese. Protokollin përcakton se këto organe vizituese emërtohen si Mekanizma Kombëtarë Parandalues.²⁸⁴

Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili hyri në fuqi më 26 qershor 2015, në nenin 17, paragrafi 1 përcakton se Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Ligji parasheh që në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit të krijohet një Mekanizëm i veçantë i cili do të kryejë të gjitha funksionet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm *MKPT*).²⁸⁵ Më tej, ky ligj përcakton se personeli i këtij mekanizmi, përveç juristëve, duhet të përfshijë profesionistë të fushave të ndryshme.

Vizitat e rregullta dhe pa paralajmërim, në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet

²⁸¹ Zyra e Komisionerit të Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cat.aspx>.

²⁸² Zyra e Komisionerit të Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opcat.aspx>.

²⁸³ Neni 1 i Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës.

²⁸⁴ Neni 3 i Protokollit Fakultativ të Konventës kundër Torturës.

²⁸⁵ Ligji nr. 05/L-019, neni 17, paragrafi 2.2.

shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, janë detyra të MKPT-së të përcaktuara me Ligj.²⁸⁶

Ligji për Avokatin e Popullit i jep MKPT-së të drejtën për t'i vizituar vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, për të bërë fotografime dhe incizime audio vizuale, i garanton mbrojtjen nga ndërhyrja e jashtme në punën e personelit të saj, si dhe të drejtën që personeli i MKPT-së të mos japin të dhëna, informata apo sqarime për gjetjet e tyre gjatë kryerjes së detyrave të tyre në këtë fushë.²⁸⁷ Gjatë kryerjes së funksionit si MKPT, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, me pajtimin e tyre, si dhe të dhënat personale të këtyre personave.²⁸⁸

MKPT-ja u themelua zyrtarisht me vendimin e Avokatit të Popullit z. Hilmi Jashari, më 16 janar 2016. Menjëherë pas këtij vendimi, Këshilli i Evropës filloi projektin për forcimin e kapaciteteve monitoruese të MKPT-së për monitorim të të gjitha vendeve ku mbahen personat e privuar nga lirie. Qëllimi i këtij projekti është fuqizimi i kapaciteteve monitoruese të MKPT-së. Projekti në fjalë do të zgjasë deri në prill të vitit 2019.

Metodologjia dhe organizimi i MKPT-së gjatë vitit 2018

Metodologjia e MKPT-së

MKPT-ja ka metodologjinë e vizitave e cila konsiston në: përgatitjen e vizitës, llojin e vizitës (vizitë e paralajmëruar apo e pa paralajmëruar), veprimet të cilat zbatohen me të arritur në institucionin i cili vizitohet, ndarja në grupe me të arritur, biseda me udhëheqësin e institucionit, ekipi monitorues bën një gjiro në të gjitha hapësirat e institucionit, intervistat me personat e privuar nga liria, kontaktet me zyrtarët korrektues, kontaktet me personelin shëndetësor, takimi ndërmjet ekipit monitorues para takimit final me drejtorin, biseda finale me drejtorin.

Faza e përgatitjes së vizitës nënkupton mbledhjen e informatave të rëndësishme për institucionin i cili vizitohet, objektivi i vizitës, përcaktimin e numrit të anëtarëve të MKPT-së, të cilët do të marrin pjesë në vizitë, ndarjen në nëngrupe dhe ndarjen konkrete të detyrave. Neni 17 i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton se MKPT-ja kryen vizita në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria pa paralajmërim.

Biseda fillestare me udhëheqësin e institucionit i cili vizitohet nënkupton prezantimin e mandatit të MKPT-së në mënyrë efektive dhe profesionale, prezantimi i anëtarëve të ekipit monitorues, objektivi i vizitës etj. Pas bisedës fillestare me drejtorin, ekipi monitorues bën një gjiro në të gjitha hapësirat e institucionit.

²⁸⁶Ligji nr. 05/L-019, neni 17, paragrafi 2.

²⁸⁷Ligji nr. 05/L-019, neni 17, paragrafi 3.

²⁸⁸Ligji nr. 05/L-019, neni 17, paragrafi 4.

Më pastaj fillojnë intervistat me personat e privuar nga liria dhe zyrtarët e institucionit, ekipi monitorues vendos se kë dhe ku do ta intervistojë. Ekipi monitorues e siguron të të intervistuarin se biseda do të jetë konfidenciale, pa prezencë të zyrtarëve të institucionit të intervistuar.

Po ashtu, ekipi monitorues viziton njësinë shëndetësore të çdo qendre korrektuese apo të paraburgimit, me qëllim të verifikimit nëse të burgosurve u bëhen kontrollet fillestare shëndetësore me rastin e pranimit, nëse zyrtarët korrektues janë prezentë gjatë ofrimit të shërbimeve mjekësore ndaj të të burgosurve, nëse në protokollet e njësisë shëndetësore mbahet evidencë e përpiktë për të gjitha aspektet relevante të ofrimit të shërbimeve mjekësore, sidomos rastet e lëndimeve trupore, tentim-vetëvrasjeve, vetë-lëndimeve etj.

Pas këtyre veprimeve, ekipi monitorues mban një takim ndërmjet anëtarëve të ekipit monitorues dhe bën vlerësimin e përkohshëm të të gjeturave të deritanishme, merr vendime për veprime të mëtejme nëse është e nevojshme, si dhe vendos se cilat çështje do të paraqiten para udhëheqësit të institucionit.

Biseda finale me udhëheqësin e institucionit fokusohet në shqetësimet më të rëndësishme, siç mund të jenë: marrëdhëniet ndërmjet personelit dhe të të burgosurve, incidentet ndërmjet të të burgosurve, kushtet e këqija të akomodimit, kujdesi jo adekuat shëndetësor, moszbatimi i garancive procedurale (qasja tek avokati, kontaktet me familjen etj.). Gjatë bisedës finale me drejtorin, ekipi monitorues përdor gjuhë konstruktive dhe respekton punën e zyrtarëve të institucionit. Ekipi monitorues kërkon dialog konstruktiv dhe jo konfrontim me zyrtarët e institucionit.

Përbërja e MKPT-së

Përbërja e tanishme e MKPT-së sa i përket personelit është kompletuar në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit dhe me Rregulloren 01/2016 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Institucionin e Avokatit të Popullit, ku bëjnë pjesë:

1. Zëvendësja e Avokatit të Popullit, përgjegjëse për MKPT-në
2. Drejtoresha e MKPT-së
3. Këshilltari i lartë ligjor për parandalim të torturës
4. Këshilltarë për parandalim të torturës
5. Këshilltare-mjeke
6. Këshilltare-psikologe
7. Këshilltare-punëtore sociale

Këshilli i Evropës, në kuadër të projektit për fuqizimin e MKPT-së, ka angazhuar një psikiatër në ekipin e MKPT-së, me qëllim të realizimit të vizitave monitoruese në institucionet e shëndetit mendor.

Gjatë vitit për të cilin po raportohet, MKPT-ja ka kryer vizita në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, si dhe institucionet tjera ku personat mund të privohen nga liria ose nuk mund të largohen nga këto institucione me vullnetin e tyre, për shkak të

ndonjë vendimi të organeve kompetente. MKPT-ja, gjatë vitit për të cilin po raportohet, ka vizituar një numër të madh të stacioneve policore, qendra të paraburgimit, qendra korrektuese, institucione të shëndetit mendor, qendrat e kujdesit social, Qendrën për Azilkërkues dhe Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.

Trajnimet e stafit të MKPT-së

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës, kanë vazhduar trajnimet për forcimin e kapaciteteve të MKPT-së. Gjatë kësaj periudhe u mbajt trajnimi i kombinuar teori dhe ushtrim praktik në Burgun e Sigurisë së Lartë, në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe në Qendrën Edukativo-Korrektuese në Lipjan. Në vazhdim u organizuan edhe trajnime të kombinuara me vizita praktike në stacione policore, në institucionet e shëndetit mendor dhe ato të kujdesit social. Përveç kësaj, personeli i MKPT-së mori pjesë në trajnimin katër ditor të organizuar nga Agjencia Kufitare e Bashkimit Evropian FRONTEX, i mbajtur në Beograd. Në gjitha trajnimet të cilat u organizuan në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës, ligjëruan dhe mbikëqyrën për së afërmi trajnimet praktike ekspertët e tanishëm dhe të mëhershëm të Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës.

Aktivitetet e MKPT-së

Në kuadër të projektit të KE-së, MKPT-ja në bashkëpunim me zyrën e KE në Prishtinë, organizoi disa aktivitete si: tryeza të rumbullakëta njëditore, me qëllim të ngritjes së ndërgjegjësimit për përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës (drejtësia, sistemi i burgjeve, prokurorët) dhe stafit të IAP-së, në lidhje me mandatin e MKPT-së; një konferencë njëditore në lidhje me rezultatet e arritura gjatë projektit dhe në lidhje me modalitetet e bashkëpunimit midis MKPT-së dhe institucioneve të tjera të Kosovës.

Gjithashtu u mbajt Forumi i Punës për Bashkëpunim Ndërinstitucional, me temë “Parandalimi i keqtrajtimit në Shërbimet e Shëndetit Mendor dhe të Kujdesit Social”. Qëllimi i Forumit ishte që të diskutohen të gjeturat e MKPT-së, problemet e identifikuara në terren dhe gjetja e mundësive për zgjidhjen e problemeve nga vetë pjesëmarrësit. Si rezultat i Forumit, pjesëmarrësit dhanë njëzet rekomandime të vlefshme, për të adresuar në mënyrë efektive boshllëqet dhe mangësitë e identifikuara bashkërisht. Ato rekomandime janë integruar në raportet me rekomandime të përpiluara nga MKPT-ja.

Për nder të shënimit të Ditës Botërore të Shëndetit Mendor (10 tetori), MKPT-ja në bashkëpunim me Zyrën e KE-së në Prishtinë, organizuan Konferencën rajonale njëditore në lidhje me sfidat e funksionimit të MKP-ve në Ballkanin Perëndimor. Konferenca synoi shkëmbimin e përvojave dhe diskutimin mbi sfidat me të cilat përballen mekanizmat kombëtarë për parandalim të torturës në vendet e rajonit, lidhur me monitorimin e trajtimit të personave me probleme mendore në institucionet korrektuese, spitalet psikiatrike dhe institucionet e kujdesit social. Konferenca përfundoi me një sërë rekomandimesh mbi mënyrën e forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit midis mekanizmave parandalues kombëtarë, organeve ndërkombëtare të monitorimit, shoqërisë

civile dhe autoriteteve përkatëse, për një mbrojtje më të mirë të të drejtave të personave me çrregullime mendore dhe aftësi të kufizuara intelektuale, në vendet e privimit të lirisë. Vlen të theksohet se bashkëpunimi konstruktiv i MKPT-së me institucionet tjera në vend si dhe OJQ-të ishte një shembull i mirë për vendet e rajonit.

MKPT-ja, përveç organizmit të aktiviteteve në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës, ka marrë pjesë edhe në aktivitete të ndryshme të organizuara nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve/Ministria e Shëndetësisë dhe Organizatat Joqeveritare.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vazhduar bashkëpunimin ndërkombëtar, duke marrë pjesë në takime të organizuara nga Rrjeti i MKPT-ve të Evropës-Juglindore, grupet punuese të Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI), siç janë Grupi Punues për Azil dhe Migrim dhe Grupi Punues për rolin e Avokatit të Popullit në situata post-konflikti. MKPT-ja, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës për forcim të kapaciteteve të MKPT-ve, mori pjesë në vizitën studimore katër ditore në Poloni. Në kuadër të kësaj vizite, MKPT-ja e Kosovës dhe ajo e Polonisë kryen së bashku disa vizita në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria në Poloni dhe vizituan disa institucione dhe organizata joqeveritare, siç është ODHIR, Komitetit Polak i Helsinkit etj. Gjatë këtij viti, FRONTEX dhe IOM-i organizuan trajnim për Policinë e Kosovës në Mal të Zi lidhur me kthimin me forcë të emigrantëve. Me këtë rast përfaqësuesi i MKPT-së ka mbajtur ligjëratë për mandatin e Avokatit të Popullit dhe të MKPT-së.

Po ashtu, MKPT-ja ka vazhduar bashkëpunimin me organizatat relevante ndërkombëtare, duke u përgjigjur në pyetësorët e dërguar lidhur me gjendjen e personave të privuar nga liria dhe çështjet që kanë të bëjnë me azilin dhe migracionin.

Përmbushja e mandatit të MKPT-së gjatë vitit 2018

Vizitat e realizuara

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka realizuar 60 vizita (të përgjithshme, ad-hoc dhe vizita përcjellëse) në institucione të ndryshme, si: Qendrën Korrektuese në Dubravë, Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, Qendrën për Azilkërkues, Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, Qendrën e Paraburgimit në Pejë, Qendrën e Paraburgimit në Prizren, Qendrën Edukuese Korrektuese në Lipjan, Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, Burgun e Sigurisë së Lartë, Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Prishtinë, Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, stacionet policore në Lipjan, Podujevë, Mitrovicë, Vushtri, Prizren, Suharekë, Dragash, Klinë, Istog, Deçan, Pejë, Viti, Kaçanik, Shtërpçë, Ferizaj, Gjilan, Novobërdë, Kamenicë, Graçanicë, Ranilluk, Shtime, Qendrën për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime, Klinikën e Psikiatrisë, Institutin e Psikiatrisë Forenzike, Shtëpinë e fëmijëve me aftësi të kufizuara mendore,

Institutin Special në Shtime, Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë.

Raportet me rekomandime të publikuara gjatë vitit 2018

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka publikuar raportin me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, Qendrën Korrektuese në Dubravë²⁸⁹, Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, Qendrën e Paraburgimit në Prizren, Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan, Qendrën e Paraburgimit në Pejë, Qendrën për Azilkërkues, Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll²⁹⁰.

MKPT-ja gjatë vitit 2018 ka publikuar raportin me rekomandime për vizitat në stacionet policore në Mitrovicë, Podujevë, Vushtri, Dragash, Prizren, Suharekë, Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë; raportin me rekomandime për vizitat në stacionet policore në Klinë, Istog, Deçan, Pejë; raportin me rekomandime për vizitat në stacionet policore në Viti, Gjilan, Graçanicë, Kaçanik, Ferizaj, Novobërdë, Kamenicë, Shtërpçë, Ranilluk, Shtime.

Përveç kësaj, MKPT-ja ka vizituar po ashtu institucionet e shëndetit mendor dhe të kujdesit social, si dhe ka publikuar raportin me rekomandime për vizitën në Klinikën e Psikiatrisë në Prishtinë, raportin me rekomandime për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, raportin për vizitën në Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime, raportin me rekomandime për vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

Gjatë këtij viti, MKPT-ja ka publikuar edhe raportin *ex officio* lidhur me arrestimin dhe largimin me forcë nga territori i Republikës së Kosovës i gjashtë shtetasve turq.²⁹¹ Qëllimi kryesor i këtij raporti është të tërheqë vëmendjen autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për respektimin e të drejtave të personave të arrestuar dhe personave subjekt i largimit me forcë apo ekstradimit nga territori i Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën, ligjet e aplikueshme si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Raporti i referohet arrestimit dhe largimit me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës, më 29 mars 2018, me pretendimin se përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare.

²⁸⁹ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, publikuar më 24 gusht 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/08/30/raport-me-rekomandime-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-avokati-i-popullit-lidhur-me-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-dubrave/>.

²⁹⁰ Raport me rekomandimet për vizitën në Qendrën e mbajtjes për të huajt në Vranidoll, publikuar më 2 maj 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/02/22/raport-me-rekomandime-vizite-ne-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/>

²⁹¹ Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/06/04/raport-me-rekomandime-i-avokatit-te-popullit-te-republikes-se-kosoves-ne-lidhje-me-arrestimin-dhe-largimin-me-force-te-gjashte-shtetasve-turq-nga-territori-i-republikes-se-kosoves-ex-officio-nr-2142/>

Po ashtu, MKPT-ja ka publikuar edhe Raportin me rekomandime lidhur me të drejtën për studime universitare për të miturit e privuar nga liria.²⁹²

Bashkëpunimi i institucioneve të vendit me MKPT-në

Gjatë vizitave të MKPT-së në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria, zyrtarët e institucioneve të vizituara në përgjithësi i kanë ofruar ekipit monitorues bashkëpunim të plotë dhe qasje të menjëhershme, përveç në një rast i cili ka të bëjë me Policinë e Kosovës. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e arrestuar, paraburgosur dhe të dënuar, pa prezencë të zyrtarëve korrektues, zyrtarëve policorë ose personelit tjetër. Përveç kësaj, ekipi i MKPT-së, në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit, u lejua të përdorë edhe pajisjet për fotografim si dhe pajisjet për matjen e hapësirave, temperaturës dhe lagështisë.

Megjithatë, ekipit të MKPT-së iu mohua qasja në hapësirat e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”, gjatë hetimit të rastit të largimit me forcë nga territori i Republikës së Kosovës të gjashtë shtetasve turq. Veprimet e tilla të autoriteteve publike janë në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Avokatin e Popullit.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit, përmes raportit *Ex Officio* 214/2018, në lidhje me arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës, ndër të tjera, i ka rekomanduar Ministrisë së Punëve të Brendshme që shprehimisht ta njoftojë personelin e kësaj Ministrie lidhur me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit sa i përket qasjes pa paralajmërim, në çdo vend dhe në çdo kohë ku mbahen personat e privuar nga liria.

Po ashtu, neni 25 i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton qartë obligimin e të gjitha autoriteteve publike për t’u përgjigjur kërkesave të Avokatit të Popullit, si dhe t’i ofrojnë ndihmën adekuate sipas kërkesës së tij. Ndërsa neni 25, paragrafi 3 të Ligjit për Avokatin e Popullit shprehimisht përcakton: “*Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtar.*”

Të gjeturat gjatë vizitave dhe rekomandimet e dërguara autoriteteve kompetente

Stacionet policore

Keqtrajtimi fizik

²⁹² <https://www.oik-rks.org/2018/11/23/raport-me-rekomandime-nr-4932018-esat-beqiri-kunder-ministrise-se-arsimit-shkences-dhe-te-teknologjise-dhe-sherbimit-korrektues-te-kosoves/>

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vizituar 22 stacione policore, ka publikuar 3 raporte me rekomandime. Në përgjithësi, MKPT-ja ua ka dërguar autoriteteve kompetente 13 rekomandime.

Gjatë vizitave, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga personat e arrestuar për keqtrajtim fizik, të cilët gjendeshin në ndalim policor, përveç gjatë vizitës në stacionin policor në Pejë, ku MKPT-ja ka intervistuar personat në ndalim, të cilët pohuan se janë keqtrajtuar fizikisht në momentin e arrestimit. MKPT-ja ka shqyrtuar dosjet e të arrestuarve, ku u evidentua se të arrestuarit janë vizituar nga mjeku dhe në raport mjekësor është shënuar matja e shenjave vitale dhe vetëm te një rast është udhëzuar terapi kundër dhimbjeve.

Nëpërmjet Raportit me rekomandime, i publikuar më 17 tetor 2018²⁹³, MKPT-ja ka rekomanduar se të gjithë zyrtarëve të Policisë së Kosovës duhet t'u bëhet e qartë se të gjitha format e keqtrajtimit fizik të personave të arrestuar janë të papranueshme dhe se do t'u nënshtrohen sanksioneve ligjore ata që kryejnë veprime të tilla.

Gjatë vizitave në qendra të paraburgimit dhe qendra korrektuese, MKPT-ja ka pranuar 4 ankesa për keqtrajtim fizik gjatë arrestimit, qëndrimit në ndalim policor dhe marrjes në pyetje nga zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës.

Gjatë vizitës së MKPT-së në Qendrën Korrektuese në Dubravë, MKPT-ja ka pranuar 2 ankesa nga dy të burgosur, me pretendimin se janë keqtrajtuar fizikisht nga zyrtarët e Policisë së Kosovës, në kohën kur u arrestuan dhe u dërguan në stacionet policore ku u intervistuan. Në rastin e ankuesit B. D., ankuesi pohoi se është keqtrajtuar fizikisht nga zyrtarët policorë gjatë intervistimit dhe transportimit në stacionin policor në Prizren, duke u goditur me grushte. Sipas pohimeve të ankuesit, lidhur me këtë ai e njoftoi gjyqtarin e procedurës paraprake, por nuk u ndërmor asgjë. Po ashtu, ankuesi pohoi se nuk ka ushtruar kurrë ankesë pranë Policisë së Kosovës apo Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK). I burgosuri u njoftua nga MKPT-ja se cilat janë organet kompetente të cilave ai mund t'u drejtohet me ankesë. Ndërkaq në rastin tjetër, ankuesi R. S. pohoi se ai u keqtrajtua fizikisht në stacionin policor në Ferizaj dhe se lidhur me këtë kishte ushtruar ankesë pranë Inspektoratit Policor të Kosovës, një muaj më parë. Lidhur me këtë pohim, MKPT-ja iu drejtua IPK-së përmes postës elektronike zyrtare dhe kërkoi të njoftohet për ankesën e ankuesit. IPK-ja e njoftoi MKPT-në se Inspektorati Policor i Kosovës, respektivisht Departamenti për menaxhimin e ankesave, më datë 13 shkurt 2018, ka pranuar ankesën e qytetarit Rinor Sejdiu nga Burgu i Dubravës. Pas analizimit të ankesës së tij, rasti është përcjellë në Departamentin e Hetimeve (IPK) për hetim penal.

MKPT-ja gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Pejë ka pranuar ankesë nga i paraburgosuri E. A.²⁹⁴, i cili pohoi se ishte keqtrajtuar fizikisht nga Policia e Kosovës në kohën e arrestimit. Sipas pohimeve të ankuesit, ai u arrestua më 13 shtator 2018 dhe u dërgua në stacionin policor në Prizren. Ankuesi pohoi se në stacion u lidh për radiatorit, u

²⁹³ Raport me rekomandime për vizitat në stacionet policore në Klinë, Istog, Deçan, Pejë. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>.

²⁹⁴ Rast i regjistruar në Institucionin e Avokatit të Popullit si A.nr. 770/2018.

grushtua dhe u shkelmua. MKPT-ja, më 14 nëntor 2018, pas analizimit preliminar të dokumentacionit mjekësor dhe pohimeve të ankuesit, përmes postës elektronike zyrtare e ka njoftuar Inspektoratin Policor (IPK) për këto pohime dhe ka kërkuar nga IPK-ja që të hetojë dhe ta njoftojë MKPT-në me rezultatin e hetimeve. MKPT-ja është në pritje të përfundimit të hetimeve nga IPK-ja.

Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (QPL), MKPT-ja ka pranuar ankesën e K. B., i cili u ankua se ishte keqtrajtuar fizikisht gjatë arrestimit nga Policia e Kosovës, më 7 tetor 2018. Sipas pohimeve të ankuesit, kjo ka ndodhur gjatë periudhës së arrestimit dhe fazës së intervistimit nga hetuesit policorë në stacionin policor “Qendër”. Lidhur me këto pohime, MKPT-ja ka vizituar Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, ku është kontrolluar dosja e ankuesit dhe raporti mjekësor. Përveç kësaj, Departamenti i Shëndetësisë në Burgje ia ka dërguar MKPT-së dosjen mjekësore të ankuesit, e cila hapet me rastin e çdo pranimi në qendër të paraburgimit apo qendër korrektuese. Pas analizimit të dokumentacionit relevant dhe pohimeve të ankuesit, MKPT-ja ka kërkuar nga IPK-ja që ta hetojë çështjen në pajtim me mandatin që ka dhe ta njoftojë MKPT-në me rezultatin e hetimeve.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, u pranuan 36 ankesa për keqtrajtim fizik nga zyrtarët e Policisë së Kosovës. Pas vlerësimit preliminar, 19 raste janë hapur për hetim, ndërsa 3 raste janë hapur për hetim *ex officio* (sipas detyrës zyrtare). Në disa raste MKPT-ja ka kërkuar nga organet relevante të Policisë së Kosovës dhe nga IPK-ja që të zhvillojnë hetime efektive lidhur me këto ankesa dhe ta njoftojnë MKPT-në me rezultatin e hetimeve në fjalë. MKPT-ja ka hasur bashkëpunim të plotë me IPK-në dhe organet tjera të Policisë së Kosovës gjatë hetimit të ankesave të lartpërmendura.

MKPT gjatë vizitave në stacione të ndryshme policore përgjatë këtij viti ka hasur në një praktikë të cilën e konsideron jo të duhur dhe se duhet të evitohet menjëherë. Koncretisht, gjatë vizitës në stacionet policore në Shtërpcë, në një dhomë intervistimi ka gjetur tri objekte të forta, të cilat, sipas zyrtarëve policorë, ishin objekte të konfiskuara nga personat e arrestuar në vend të ngjarjes dhe mbahen aty si dëshmi. Por, MKPT-ja ka vërejtur se në këto objekte nuk ka të shënuar numër të rastit.²⁹⁵ Pas dërgimit të raportit me rekomandime, MKPT-ja u njoftua se Policia e Kosovës ka krijuar një ekip të përbërë nga zyrtarë policorë, i cili do t’i vizitojë të gjitha stacionet policore dhe do të kërkojë që këto objekte të mbahen në vendin e duhur dhe jo në zyra të intervistimit.

Edhe gjatë vizitave në Stacionin Policor në Kaçanik dhe në atë të Kamenicës, MKPT-ja ka vërejtur se në dhomat e intervistimeve gjendeshin nga një shkop druri, por të cilët ishin të shënjuar me numrin e rastit. Sipas zyrtarëve policorë, këto mjete janë konfiskuar nga të arrestuarit dhe mbahen aty si dëshmi për rastet që janë në hetim e sipër. MKPT-ja

²⁹⁵Objektet e gjetura mund të përshkruhen si në vijim: tre shkopinj, dy nga këta shkopinj duket se janë kablllo elektrike të mbështjella me shirit izolues fund e krye dhe një shkop tjetër më i gjatë i mbështjellë vetëm në fillim për aq sa mund të kapet me dorë.

u ka rekomanduar zyrtarëve policorë se objektet e tilla duhet të hiqen menjëherë nga zyra ku intervistohen të arrestuarit.

Për më shumë, KPT-ja në raportin për vizitën në Spanjë, i publikuar në vitin 2011, thekson se delegacioni ka gjetur shkopinj druri dhe shkopinj bejsbolli në disa stacione policore, në dhoma të intervistimit, të cilët nuk ishin të shënjuara. KPT-ja më tej thotë në raport se një situatë e tillë, përveçse nxit spekulimet për sjellje jo të duhur të policisë, gjërat e tilla janë burim potencial i rrezikut për vetë zyrtarët policorë, por edhe për të dyshuarit për kryerje të veprave penale. Mjetet e tilla apo prona e konfiskuar gjatë hetimeve penale duhet të regjistrohet në një regjistër të veçantë, të shënjohet në mënyrën e duhur (që identifikon edhe rastin të cilit i referohet) dhe të ruhen në vendin e dedikuar për ruajtje të mjeteve të tilla. Përmes raportit në fjalë, KPT-ja u rekomandoi autoriteteve spanjolle që të gjitha mjetet e tilla të paautorizuara të largohen nga hapësirat ku personat mund të mbahen apo të merren në pyetje.²⁹⁶

MKPT-ja, bazuar në vizitat gjatë këtij viti dhe vizitat e mëhershme, shqyrtimin e ankesave të pranuar, si dhe hetimet sipas detyrës zyrtare, vlerëson se nuk ka keqtrajtim fizik sistematik apo keqtrajtim fizik të përhapur nga Policia e Kosovës.

Garancitë kundër keqtrajtimit

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm *KPT*), në raportin e 2-të të përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia, të cilat janë: e drejta për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën), e drejta për të pasur një avokat, e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor, nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).²⁹⁷

Këto të drejta duhet të zbatohen jo vetëm në rastin e personave të ndaluar, por edhe në rastet tjera kur qytetarët detyrohen të qëndrojnë në polici apo me policinë edhe për arsye tjera (për shembull: për qëllime identifikimi).

Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përshkruhet në kuadër të sistemit ligjor. Po ashtu, këto të drejta themelore parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.²⁹⁸

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton: “Çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton për të drejtën për ndihmë juridike

²⁹⁶ Raporti i KPT-së për vizitën në Spanjë, publikuar në vitin 2011, paragrafi 34, në: <https://rm.coe.int/16806cb01c>.

²⁹⁷ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

²⁹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës.

sipas dëshirës së tij, për të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin se është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.”²⁹⁹

Sa i përket njoftimit për arrestin, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë: ta njoftojë anëtarin e familjes apo personin tjetër, sipas përzgjedhjes së tij, për arrestin dhe vendin e ndalimit menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur.³⁰⁰

Sipas Ligjit për Policinë,³⁰¹ e drejta për të njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në “ndalim të përkohshëm” me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.

Gjatë vizitave, MKPT-ja është njoftuar nga zyrtarët policorë se gjatë intervistimit të personave të arrestuar nuk praktikohet audio dhe video incizimi i intervistave. MKPT-ja konsideron se audio dhe video incizimi i intervistimit të personave të arrestuar do të ishte një garanci shtesë kundër keqtrajtimit fizik. MKPT-ja vëren se edhe KPT-ja konsideron se regjistrimi elektronik (audio dhe/ose video) i intervistave policore përbën një garanci të rëndësishme shtesë kundër keqtrajtimit të të arrestuarve.³⁰² MKPT-ja vëren se mundësia për të bërë audio dhe video incizimin e intervistave të personave të arrestuar lihet e hapur edhe nga Kodi i Procedurës Penale.³⁰³

MKPT gjatë vizitave ka konstatuar se Policia e Kosovës respekton tri të drejtat themelore të personave të arrestuar. Policia e Kosovës ka formularë standardë përmes të cilëve të arrestuarit njoftohen për të drejtat e tyre dhe përmes nënshkrimit të tyre konfirmojnë se janë njoftuar me këto të drejta. MKPT-ja po ashtu ka vërejtur se Policia e Kosovës në përgjithësi mban evidencë dhe dokumentacion të bollshëm për çdo ngjarje lidhur me personat në ndalim policor. Këta formularë standardë janë të përpiluar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze.

Përveç kësaj, MKPT-ja ka vërejtur se në çdo qeli ku mbahen personat e arrestuar janë të vendosura informatat për të drejtat e tyre të përpiluara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Gjatë vizitave dhe intervistimit të personave të arrestuar, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa lidhur me respektimin e këtyre të drejtave.

Kushtet fizike të stacioneve policore të vizituara

MKPT-ja konsideron se, pavarësisht kohëzgjatjes së qëndrimit në ndalim policor, megjithatë kushtet në qeli duhet t'i plotësojnë disa kërkesa themelore sa i përket kushteve

²⁹⁹ Shih po ashtu nenet 29 dhe 30 të Kushtetutës.

³⁰⁰ Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 168, paragrafët 1, 2, 3, 4.

³⁰¹ Ligji për Policinë, neni 20.

³⁰² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, ekstrakt nga raporti i 12 i përgjithshëm, paragrafi 36. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/16806cd1ed>.

³⁰³ Kodi i Procedurës Penale, neni 205, paragrafi 5.

të akomodimit. KPT-ja në raportin e 2-të të përgjithshëm, i publikuar më 13 prill 1992 në Strasburg, ka përcaktuar standardin lidhur me kushtet në qelitë ku mbahen të arrestuarit: *“Të gjitha qelitë në stacione policore duhet të jenë të madhësisë së arsyeshme për numrin e personave të akomoduar, duhet të kenë ndriçim adekuat (shembull, dritë e mjaftueshme për të lexuar, me përjashtim të periudhave të fjetjes dhe ventilim dhe të jenë të pajisura me karrige të fiksuar ose tavolinë). Për më shumë, personat të cilët qëndrojnë në ndalim gjatë natës, duhet t’u sigurohen çarçafë dhe batanije të pastra.”*³⁰⁴

Sa i përket kushteve të akomodimit në vendet ku mbahen personat e arrestuar, MKPT-ja ka vërejtur se shumica e stacioneve policore të vizituara i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të arrestuar, përveç stacioneve policore në Deçan, Pejë, Ferizaj, Shtime.

Qendra Rajonale e Mbajtjes në Prishtinë³⁰⁵

Gjatë vizitës në këtë qendër, MKPT-ja ka vërejtur se qelitë ishin të pastra, hapësira për person në qeli është në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT-ja³⁰⁶, secila qeli kishte dyshek dhe çarçaf të pastër, por, qelitë kishin pak dritë natyrale dhe nuk ishin të pajisura me sistem të thirrjes. Brenda Qendrës funksiononte sistemi i ventilimit. Tualetet dhe dushet ishin në gjendje të mirë dhe kishte ujë të ngrohtë. Qendra është rinovuar gjatë vitit 2016.

Kushtet për punë të zyrarëve policorë, të cilët punonin në këtë Qendër, nuk janë të mira dhe nuk kanë pësuar asnjë ndryshim krahasuar me vizitat e mëhershme. Përmes raportit me rekomandime pas vizitës në këtë qendër, MKPT-ja i ka rekomanduar MPB-së që të ndërmerren hapat e nevojshëm për të siguruar më shumë dritë natyrale. MPB-ja, në përgjigjen e dërguar më 31 nëntor 2018, theksoi se nuk ka mundësi të ndryshimit të dimensioneve të dritareve në objektin ekzistues, nisur nga fakti se hapësirat e qendrave të mbajtjes gjenden në bodrum. Sipas tyre, në planifikimin e këtij viti është paraparë që dritareve ekzistuese t’u ndërrohen grillat dhe se projekti është në procedura të prokurimit.

Stacioni Policor në Prizren

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të arrestuarit janë në gjendje të keqe dhe duhet të gëlqerosen (lyhen), si dhe të furnizohen me çarçafë dhe batanije të pastra, meqenëse ato ekzistueset janë të vjetra dhe as për së afërmi nuk i plotësojnë kushtet për akomodim të të arrestuarve, në pajtim me standardet ndërkombëtare. Nëpërmjet raportit me rekomandime, i publikuar më 25 janar 2018, MKPT-ja u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që t’i ndërmarrin veprimet e nevojshme, në mënyrë që në këtë stacion të bëhen renovimet e nevojshme dhe furnizimet e duhura. Në përgjigjen e dërguar në këtë rekomandim, Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) e

³⁰⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 2-të i përgjithshëm, paragrafi 42. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/1680696a3f>.

³⁰⁵ Të gjitha raportet me rekomandime për vizitat në stacionet policore mund të gjenden në: <https://www.oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>.

³⁰⁶ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

njoftoi MKPT-në se “*gjatë këtij viti (2018) është bërë gjetimi dhe ngjyrosja komplet e qendrave të mbajtjes në Prizren. Po ashtu, në kuadër të projektit që është iniciuar për këtë vit është paraparë ndërrimi i dyshekëve.*”

Stacioni Policor në Pejë

MKPT-ja ka vërejtur se qelitë ishin në gjendje shumë të keqe, nuk ka dritë natyrale, edhe drita artificiale ishte e dobët. MKPT-ja ka vërejtur se ndërtesa mban lagështi dhe erë myku, higjiena nuk ishte në nivelin e duhur. Në qelitë ku mbahen personat e arrestuar ka mungesë të çarçafëve, jastëkëve, mjeteve higjienike. Ky stacion ka nevojë për renovime në hapësirat ku mbahen të arrestuarit dhe në hapësirat ku punojnë zyrtarët policorë. KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, lidhur me stacionin policor në Pejë, ka konstatuar se ndriçimi artificial në zonën e ndalimit në këtë stacion ishte jo i mjaftueshëm.³⁰⁷

Stacioni Policor në Deçan

MKPT-ja ka vërejtur se qelitë ku mbahen të arrestuarit janë në gjendje shumë të keqe dhe kanë nevojë për renovime të menjëhershme, nuk kanë dritë natyrale dhe as artificiale. Si pasojë e kësaj gjendjeje, MKPT-ja në errësirë të plotë e ka intervistuar një person të arrestuar. Ekipi monitorues, gjatë vizitës në qelitë ku mbahen të arrestuarit ka vërejtur edhe prezencë të insekteve. Një gjendje e tillë në stacionin policor në Deçan mund të krahasohet me trajtimin degradues, poshtërues dhe çnjerëzor. KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2007, publikuar në vitin 2009, shpreh shqetësim të veçantë lidhur me gjendjen në stacionin policor në Deçan sa i përket kushteve të akomodimit.³⁰⁸

Stacioni Policor në Ferizaj

Kushtet e akomodimit janë në gjendje jo të mirë, qelitë nuk kishin dritë natyrale të mjaftueshme, ndërsa drita artificiale ishte e dobët. Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se ndërtesa mban lagështi dhe erë myku, higjiena nuk ishte në nivelin e duhur. Në qelitë ku mbahen personat e arrestuar ka mungesë të çarçafëve, jastëkëve dhe mjeteve higjienike. Ndërkaq për dhomën e intervistimit të të miturve, MKPT-ja ka vërejtur se është dhomë komode. MKPT-ja konsideron se stacioni në fjalë ka nevojë për renovime në hapësirat ku mbahen të arrestuarit dhe në hapësirat ku punojnë zyrtarët policorë.

MKPT-ja ka vërejtur se kushtet fizike dhe të akomodimit në stacionet policore në Graçanicë, Gjilan, Ranillug, Viti, Klinë, Istog, Lipjan, Mitrovicë, Podujevë, Suharekë dhe në Dragash, në përgjithësi i plotësojnë standardet për akomodim të personave të arrestuar.

Sa i përket ushqimit, Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës përcakton obligimin që, nëse personi i privuar nga liria mbahet më shumë se 12 orë, duhet t'i

³⁰⁷ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë, paragrafi 25. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

³⁰⁸ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2007, publikuar në vitin 2009, paragrafi 35. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/168069727c>.

sigurohen tri racione ushqim në ditë.³⁰⁹ Personave të arrestuar, të cilët dërgohen në mbajtje, u ofrohen tri racione ushqim brenda 24 orëve. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga personat e ndaluar lidhur me këtë të drejtë.

Në të gjitha stacionet e vizituara, MKPT-ja ka vërejtur se të arrestuarit nuk furnizohen me mjete higjienike personale. MKPT-ja konsideron se autoritetet relevante duhet të ndërmarrin hapa konkret për të pajisur qendrat e mbajtjes me mjete higjienike. Asnjëra nga stacionet e vizituara nuk ka sistem të thirrjes. KPT-ja, në raportet për Kosovën për vizitën në vitin 2015, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente në Kosovë që qelitë në stacionet policore të pajisen me sistem të thirrjes, gjë që të arrestuarve do t'u mundësonte kontakt më të lehtë me zyrtarët policorë në rast nevojë.

Sa i përket regjimit, në raportin e 12-të të përgjithshëm të publikuar në vitin 2002, Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës thekson se personave të cilët mbahen në arrest në polici më shumë se 24 orë, duhet që brenda mundësive t'u ofrohet ajrosje ditore.³¹⁰

MKPT-ja ka vërejtur se shumica e stacioneve policore të vizituara nuk u ofrojnë të arrestuarve ajrosje (dalje jashtë, dalje në oborr), të cilët qëndrojnë më shumë se 24 orë në mbajtje, pasi që nuk posedojnë hapësira adekuate. Përgjatim është në rastin e Stacionit Policor në Viti, ku i ndaluarit lejohet që nën prezencë të zyrtarëve policorë, të kalojë pak kohë në ambient të hapur. Megjithatë, asnjë nga stacionet e vizituara nuk kanë hapësirë të veçantë për ajrosje.

Sa i përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të cilët arrestohen nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike, siç janë: Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga personat e intervistuar lidhur me këtë të drejtë. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet e tyre personale njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.

Sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë, lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, të arrestuarit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në stacionin policor ku mbahen, si dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës. Përveç kësaj, të arrestuarit mund t'i drejtojnë ankesë edhe Avokatit të Popullit. Për t'u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t'ua mundësuar të arrestuarve parashtrimin e ankesës në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka instaluar kuti të ankesave në stacionet policore ku ekzistojnë qelitë për mbajtje të të arrestuarve.

Avokati i Popullit ka zyrat regjionale në çdo qytet të Kosovës dhe zyrtarët regjionalë i vizitojnë stacionet policore, i hapin kutitë e ankesave dhe i trajtojnë ankesat individuale. Në rast se zyrtarët regjionalë pranojnë pohime për keqtrajtim, menjëherë e njoftojnë MKPT-në.

³⁰⁹Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, neni 170 paragrafi 3.

³¹⁰Raporti i 12-të i Përgjithshëm i KPT-së, paragrafi 47, në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed>.

Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se Inspektorati Policor i Kosovës ka vendosur një kuti të ankesave në hyrje të Stacionit Policor në Kaçanik. MKPT-ja konsideron se kjo është një praktikë e mirë, e cila u ofron qytetarëve që drejtpërdrejt t'i drejtohen organit kompetent me ankesë, lidhur me trajtimin që u bëhet nga zyrtarët policorë.

MKPT-ja, gjatë vizitës në Stacionin Policor në Kamenicë, ka vërejtur se stacioni ka një libër (regjistër) me të dhëna gjithëpërfshirëse të ankesave të qytetarëve, në të cilin regjistrohen të gjitha ankesat e qytetarëve, të cilat më pas procedohen tek organet kompetente, brenda Policisë së Kosovës ose Inspektoratit Policor të Kosovës. MKPT-ja konsideron se kjo është një praktikë shumë e mirë dhe në pajtim me kërkesat e standardeve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Rekomandimet e MKPT-së së Avokatit të Popullit drejtuar autoriteteve përgjegjëse për vizitat në stacionet policore gjatë vitit 2018:

- Të ndërmerren hapat e nevojshëm për të siguruar më shumë dritë natyrale në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë. (Në pritje për implementim)
- Të krijohen kushte më të mira për punë për zyrtarët policorë në Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë. (I implementuar)
- Të bëhen rinovime dhe furnizime në Qendrën e Mbajtjes në Prizren. (I implementuar)
- Në të gjitha qelitë e stacioneve policore ku ka dhoma të mbajtjes të instalohen sistemet e thirrjeve. (I pa implementuar)
- Të funksionalizohen kamerat e sigurisë në Stacionin Policor në Lipjan (I implementuar).
- Të bëhen renovimi i nevojshëm në Qendrën e Mbajtjes në Deçan, sa më shpejt që të jetë e mundur. (Në pritje për implementim)
- Të bëhen renovimet e nevojshme në Qendrën e Mbajtjes në Stacionin Policor në Pejë, si dhe të furnizohet stacioni me materiale të nevojshme (Në pritje për implementim)
- Të bëhen renovimet e nevojshëm në Qendrën e Mbajtjes në Stacionin Policor në Ferizaj. (Në pritje për implementim).
- Në të gjitha qendrat e mbajtjes të stacioneve policore të vizituara, tualetet e qelive ku mbahen të ndaluarit, duhet të pajisen me një ndarje e cila respekton privatësinë. (Në pritje për implementim).
- Të largohen mjetet e forta nga zyrat ku intervistohen apo mbahen personat e arrestuar ose ndaluar, në të gjitha stacionet policore, të cilat pretendohet se janë mjete të konfiskuara në cilësi të dëshmisë (Në pritje për implementim).
- Të informohet MKPT-ja për datën e funksionalizimit të Stacionit Policor në Shtime (Në pritje për implementim)
- Të furnizohen të ndaluarit me mjete personale higjienike (Në pritje për implementim).

Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja, së bashku me dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve) dhe kryeinspektorin e Ministrisë së Drejtësisë (në cilësi të vëzhguesit), ka vizituar Qendrën Korrektuese në Dubravë (në tekstin e mëtejme *QKD*). Objektivi i kësaj vizite ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të të burgosurve. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe MKPT-ja ka vizituar Burgun e Sigurisë së Lartë (në tekstin e mëtejme *BSL*), Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan, Qendrën Edukativo-Korrektuese në Lipjan, Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, Qendrën e Paraburgimit në Prizren, Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë dhe Qendrën e Paraburgimit në Pejë. Shumica e këtyre vizitave ishin të natyrës *ad-hoc* dhe përcjellëse.

Keqtrajtimi fizik

MKPT-ja gjatë vizitës në QKD nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të burgosurit për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. MKPT, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka pranuar dy ankesa nga dy të burgosur në vuajtje të dënimit në BSL, të cilët u ankuan se ishin keqtrajtuar fizikisht, njëri në BSL, ndërsa tjetri gjatë vuajtjes së dënimit në QKD. Lidhur me këto ankesa, MKPT-ja, përveç pohimeve të ankuesve, ka analizuar edhe dokumentacionin relevant mjekësor dhe ka kërkuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) t'i hetojë pohimet e ankuesve dhe ta njoftojë MKPT-në për rezultatin e hetimeve. ShKK-ja ka zhvilluar hetime të brendshme sipas kërkesës së MKPT-së dhe e ka njoftuar MKPT-së se nuk ka gjetur shkelje të procedurave dhe shkelje të të drejtave të të burgosurve nga zyrtarët e saj.

Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (QPL), MKPT-ja ka pranuar ankesën e të paraburgosurit S. H., kundër zyrtarëve korrektues të kësaj Qendre. Sipas ankuesit, ai është keqtrajtuar fizikisht nga zyrtarët korrektues në hapësirat e Gjykatës Themelore në Ferizaj, edhe gjatë transportimit në QPL. MKPT-ja, përveç pohimit të ankuesit, ka shqyrtuar edhe dokumentacionin relevant mjekësor dhe protokollat e lëndimeve trupore. Nga Drejtoria u pranua dokumentacioni relevant lidhur me hetimin e çështjes nga Komisioni i brendshëm i themeluar nga Drejtoria, për të hetuar këtë pohim. Komisioni i brendshëm hetues nuk kanë arritur të sigurojnë dëshmi të cilat mbështesin pohimin e ankuesit.

MKPT-ja ka kërkuar nga Drejtoria e përgjithshme e ShKK-së që ta themelojë një Komision hetues, i cili do të ishte i pavarur nga Drejtoria e QPL-së. ShKK-ja ka zbatuar këtë rekomandim të MKPT-së, e ka themeluar Komisionin hetues dhe e ka njoftuar MKPT-në se nuk ka gjetur dëshmi të cilat e mbështesin pohimin e ankuesit. Në përgjithësi, MKPT-ja ka pranuar pohime në favor të trajtimit të mirë dhe me dinjitet nga ana e zyrtarëve korrektues në qendrat e vizituara korrektuese dhe të paraburgimit. Po ashtu, në përgjithësi është vërejtur se ndërmjet zyrtarëve korrektues dhe të burgosurve ka komunikim korrekt.

Incidentet ndërmjet të burgosurve

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet nuk janë shënuar incidente serioze (përveç në BSL) ose në numër të madh të incidenteve ndërmjet të burgosurve. MKPT-ja gjatë vizitave ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës, si dhe në protokollat adekuate të njësive shëndetësore. Në përgjithësi, MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se raportet ndërmjet të burgosurve janë të mira dhe nuk ka klimë negative ndërmjet tyre, pothuajse në asnjë pavijon.

Megjithatë, në fund të vitit, janë shënuar dy incidente ndërmjet të burgosurve në Burgun e Sigurisë së Lartë, në të cilat të burgosurit pësuan edhe lëndime serioze trupore. MKPT-ja, edhe nëpërmjet këtij raporti, ua rikujton autoriteteve obligimin që ta parandalojnë dhunën ndërmjet të burgosurve, për të cilët ata janë përgjegjës. Kjo përgjegjësi përfshinë obligimin për t'u kujdesur dhe për të miratuar masa preventive për të reduktuar rrezikun e dhunës, si dhe për t'i mbrojtur të burgosurit më të cenueshëm.

Personeli i qendrave korrektuese dhe të paraburgimit

Sa i përket personelit, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka pranuar shqetësimet e Drejtorisë së QKD-së, për shkak të mungesës së personelit korrektues, punëtorëve socialë dhe psikologëve. Sipas Drejtorisë, afërsisht 100 zyrtarë korrektues i mungojnë QKD-së, momentalisht QKD-ja ka të angazhuar rreth 60 zyrtarë korrektues në ruajtjen e personave me sëmundje kronike, të cilët janë të shtrirë në ente shëndetësore dhe një numër i zyrtarëve korrektues shkollohen në Akademinë për Siguri Publike në Vushtrri. Po ashtu, Drejtoria ka shprehur shqetësimin lidhur me moshën mesatare të personelit korrektues, e cila është 49 vjeç. Sipas Drejtorisë, planifikohet shtimi i numrit të personelit korrektues për 50 zyrtarë.

MKPT-ja ka pranuar ankesa për mungesë të personelit korrektues, punëtorëve socialë, edhe në qendrat tjera korrektuese dhe të paraburgimit. Përmes raporteve me rekomandime, MKPT-ja u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që të angazhojnë personel shtesë korrektues, psikologë dhe punëtorë socialë, sipas nevojës. ShKK-ja është në proces të testimit dhe rekrutimit të 120 zyrtarëve të rinj korrektues, të cilët do të angazhohen në punë në QPGJ dhe BSL. Sipas njoftimit të fundit të drejtorit të QKD-së, ata kanë planifikuar punësimin e 5 punëtorëve socialë. MKPT-ja do ta përcjellë implementimin e këtyre rekomandimeve.

Kushtet e akomodimit në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë (20-22 mars 2018), MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit dallojnë nga pavijoni në pavijon. MKPT-ja në kohën e vizitës ka vërejtur se pavijoni 1 është rinovuar, tualetet dhe dushet ishin në gjendje të mirë, qelitë nuk kishin lagështi, ishin të gëlqerosura dhe të pastra. Qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim dhe ventilim të mjaftueshëm.

Gjatë vizitës, MKPT-ja i kushtoi vëmendje të veçantë të burgosurve të cilëve u ishte shqiptuar masa e vetmisë, për shkak të shkeljeve disiplinore dhe të cilët mbaheshin në

qeli të ndara. Në rastin e të burgosurit R. B., në qelinë ku ishte i vendosur i burgosuri, tualeti ishte i bllokuar, dysheku mbi krevatin ku flinte i burgosuri nuk kishte çarçaf fare, qelia kishte ndriçim të mjaftueshëm dhe nuk kishte lagështi. Të njëjtat kushte akomodimi u gjetën edhe në rastin e të burgosurit G. A., i cili po ashtu ishte i ndëshkuar me masën disiplinore të vetmisë.

MKPT konsideron se qelitë e tilla duhet t'i plotësojnë kriteret e parapara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili përcakton se dhoma për ekzekutimin e masës disiplinore të vetmisë duhet të ketë një hapësirë prej së paku dhjetë (10) metra kub, pajisje sanitare, dritë natyrore, ujë të pijshëm, shtrat me çarçaf, tavolinë, karrige dhe ngrohje.

Po ashtu, KPT-ja, lidhur me kushtet e akomodimit në qeli ku mbahet i burgosuri, të cilit i shqiptohet masa disiplinore e vetmisë, thekson se qelitë e tilla duhet t'i plotësojnë standardet e njëjta minimale, si ato të cilat zbatohen në rastet e akomodimit të të burgosurve të tjerë. Ato duhet të jenë të madhësisë adekuate, të kenë dritë natyrore, të kenë ngrohje adekuate dhe ventilim. KPT-ja më tej thekson se qelitë e tilla duhet të jenë së paku të pajisura me tavolinë, karrige adekuate, krevat adekuat dhe çarçaf.³¹¹

MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se në pavijonin 2 nevojiten renovime, pasi që kishte qeli dhe salla të ngrënies të cilat mbanin lagështi, dushet dhe tualetet po ashtu ishin në gjendje të keqe. Gjatë vizitës është vërejtur se të burgosurit përdorin pajisje elektrike të improvizuara për ngrohje të ujit, të cilat mund të rrezikojnë seriozisht jetën e tyre.

MKPT-ja ka vizituar pavijonin 8 në të cilin vendosen të sapo pranuarit dhe i nënshtrohen një regjimi themelor, i cili zgjat deri në 28 ditë. Gjatë vizitës u vërejt se kushtet e akomodimit në këtë pavijon janë shumë të këqija dhe lehtë mund të barazohen me trajtim degradues, poshtërues dhe çnjerëzor. MKPT-ja shpreh shqetësim serioz lidhur me faktin se një pjesë e pavijonit numër 8 shfrytëzohet si krah i spitalit dhe i cili nuk përmbush standardet minimale të akomodimit të parapara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Ligjin për Shëndetin Mendor, standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe Konventat tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Në Burgun e Sigurisë së Lartë (BSL) kushtet e akomodimit janë shumë të mira, të burgosurit janë të vendosur në qeli vetë, secila qeli ka TV, qelitë kanë dritë të mjaftueshme natyrore dhe artificiale, nuk kanë lagështi, janë të pajisura me krevat, çarçaf, tavolinë, karrige dhe sistem të thirrjes. MKPT-ja gjatë vizitave të periudhës për të cilën po raportohet ka vërejtur se dëmtimet e dysHEMEVE në pavijonet 1, 2 dhe në stacionarin e BSL-së nuk janë riparuar ende.³¹²

³¹¹Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga raporti i 21-të i Përgjithshëm, publikuar në vitin 2011, për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806cccc6>.

³¹²Raport me rekomandime për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë, publikuar më 19 qershor 2017. Për më shumë: https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2018/01/947_2017_Raport_me_rekomandime_i_MKPT_921071_2.pdf.

Gjatë vizitës në Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan, MKPT-ja ka konstatuar se kjo qendër i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të të miturve. MKPT-ja ka vërejtur se dhomat ku qëndronin të miturit janë të mëdha dhe kanë ndriçim të mjaftueshëm, posedojnë TV dhe dollap personal. Secila dhomë kishte tualete të cilat ishin në gjendje të rregullt, të përshtatshme dhe kishin ujë të ngrohtë pa ndërprerë. Po ashtu, dhomat dhe tualetet të cilat ishin të dedikuara për personat me nevoja të veçanta i plotësonin kushtet për akomodim.

Në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur, MKPT-ja gjatë vizitave *ad-hoc* ka vërejtur se në pjesën ku akomodohen të miturit nuk ka pasur renovime me qëllim të përmirësimit të kushteve të akomodimit. MKPT-ja u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që të ndërmarrin veprime për të përmirësuar kushtet e akomodimit në këtë qendër, në pjesën ku akomodohen të miturit.³¹³ Gjatë muajit dhjetor 2018, MKPT-ja ka pranuar përgjigje nga autoritetet kompetente lidhur me përmirësimin e kushteve në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan. Gjithashtu, gjatë vizitave *ad-hoc*, të realizuara gjatë muajit nëntor-dhjetor 2018, këto përmirësime i ka vërejtur ekipi i MKPT-së. Në pavijonin A dhe B e kanë rregulluar ujin solar, kanë bërë ngjyrosjen e dy pavijoneve.

MKPT-ja ka kryer një vizitë të përgjithshme (vlerësim i plotë) në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan (QPGj), kurse raporti me rekomandime lidhur me këtë vizitë u publikua më 27 mars 2018. Kapaciteti zyrtar i QPGj-së është për 300 persona, por për shkak të kushteve teknike, mungesës së inventarit dhe të personelit korrektues, kapaciteti momental operacional është për 80 persona. Në ditën e vizitës në QPGj ishin të akomoduar 49 të paraburgosur dhe 25 të dënuar.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se një pjesë e rrugës deri tek QPGj-ja, konkretisht rruga deri tek porta kryesore, është e pa asfaltuar dhe në kushte të këqija atmosferike dhe mund të paraqesë vështirësi serioze për zhvillim të aktiviteteve të përditshme të këtij institucioni. MKPT-ja ka vizituar një numër të qelive dhe ka verifikuar nëse hapësira e akomodimit është në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës.³¹⁴ Po ashtu, Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale parasheh që secili i burgosur duhet të ketë 4m² hapësirë në qeli të përbashkët.³¹⁵ Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se qelitë ku vendosen të paraburgosurit dhe të dënuarit, për sa i përket madhësisë, shkojnë përtej standardit minimal dhe janë në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës.

³¹³ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur, publikuar më 20 dhjetor 2016.

³¹⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih në: <https://rm.coe.int/16806cc449>.

³¹⁵ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë ndriçim të mjaftueshëm, nuk kanë lagështi dhe po ashtu kanë ngrohje adekuate dhe pastërti. Në qeli janë të vendosur nga një ose dy të burgosur. Secila qeli është e pajisur me TV.

MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, publikoi raportin me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren. Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për 92 persona, ndërsa gjatë vizitës së MKPT-së, aty ishin të vendosur 100 të burgosur, prej tyre 22 të dënuar. Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Prizren (QPP), ekipi monitorues u njoftua se planifikohet ndërtimi i një qendre të re të paraburgimit në Prizren, por procedurat kanë stagnuar dhe ende nuk është shënuar progres në këtë drejtim. Lidhur me këtë, MKPT-ja u njoftua zyrtarisht nga Ministria e Drejtësisë, më 27 shkurt 2018, se për ndërtimin e objektit të ri të QPP-së, përmes Kornizës së Investimeve të Ballkanit Perëndimor, në sektorin social, ka aplikuar për ndërtimin e qendrave të paraburgimit në Prizren dhe në Pejë. Sipas këtij njoftimi, Ministria e Drejtësisë do të vazhdojë të kërkojë mjete nga Qeveria apo nga donatorët për realizimin e këtij projekti.

MKPT-ja ka vizituar një numër të qelive për të verifikuar nëse hapësira e akomodimit është në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës³¹⁶ dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.³¹⁷ Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në disa qeli, për shkak të mungesës së hapësirës, disa të paraburgosur dhe të dënuar flinin në dysheme në dyshekë të vjetruar dhe pa mbulesa adekuate.

Me këtë rast, MKPT-ja ka konstatuar se QPP-ja përballej me mbipopullim, i cili duhet të evitohet sa më shpejt që të jetë e mundur dhe se mund të ofrojë hapësirë akomodimi në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe nga Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Lidhur me këtë gjendje, MKPT-ja i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të ndërmerren veprime që numri i të burgosurve të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP-së.

Ministria e Drejtësisë e njoftoi Avokatin e Popullit se Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) e ka pranuar objektin e ri të Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, i cili së shpejti do të fillojë së funksionuari dhe do të ndikojë në zvogëlimin e mbipopullimit dhe të burgosurve do t'u ofrojë hapësirë për akomodim në pajtim me standardet e theksuara më lart. Megjithatë, MKPT-ja vëren se deri tani Qendra e Paraburgimit në Prishtinë ende nuk është funksionalizuar.

Përveç kësaj, në dy qeli ku akomodoheshin të paraburgosurit në QPP, tualetet nuk kishin derë dhe në këtë mënyrë nuk respektohej aspak privatësia e të paraburgosurve.³¹⁸

³¹⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449>.

³¹⁷ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

³¹⁸ Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 18.1.

Rregulli 15 i Rregullave të Mandelës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 29 shtator 2015, përcakton: “*Instalimet sanitare duhet të jenë adekuate dhe të mundësojë që secili i burgosur të përmbush nevojat fiziologjike në mënyrë dinjitoze dhe të pastër*”. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka rekomanduar që të ndërmerren masat e duhura që të paraburgosurve t’u respektohet privatësia. Më 30 dhjetor 2018, Drejtoria e QPP-së e njoftoi MKPT-në se tanimë nuk ka mbipopullim dhe në ato dy qeli, të cilat janë përshkruar më lart, janë të dizajnuara vetëm për nga një person. Tani janë akomoduar vetëm nga një person në qelitë e lartpërmendura.

Ndërsa qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kishte lagështi, kurse dushet ishin në gjendje të mirë. Gjithashtu sallat ku ushqehen të burgosurit ishin të pastra, kishte dritë natyrale dhe ventilim. Megjithatë, MKPT-ja ka konstatuar se qelitë në përgjithësi kanë nevojë të gëlqerosen (lyhen). Drejtoria e QPP-së e njoftoi MKPT-në se ky rekomandim është implementuar dhe se gëlqerosja e qelive pothuajse ka përfunduar. MKPT-ja, përmes vizitave përcjellëse, do të verifikojë zbatimin e rekomandimeve. Gjatë vizitave në qendra korrektuese dhe të paraburgimit, MKPT-ja ka vërejtur se të paraburgosurve u mungon hapësira për vendosjen e gjësendeve të domosdoshme personale. MKPT-ja, përmes raporteve me rekomandime, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që ta përmirësojnë këtë mangësi dhe të burgosurve t’u sigurojnë hapësira adekuate për t’i vendosur gjërat e domosdoshme. Deri më tani, MKPT-ja nuk ka vërejtur përmirësime në këtë drejtim.

Në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, MKPT-ja ka vërejtur se është rinovuar plotësisht krahu B, ndërsa në pjesët tjera të Qendrës, sa i përket kushteve të akomodimit, gjendja mbetet e njëjtë ashtu siç u konstatua në raportin e MKPT-së për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, i publikuar më 21dhjetor 2016.³¹⁹ MKPT-ja konsideron se autoritetet kompetente pjesërisht e kanë implementuar rekomandimin sa i përket kushteve të akomodimit. Megjithatë, duhet theksuar se ka vite që pritet mbyllja e kësaj qendre dhe do të bëhet transferimi i të paraburgosurve në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë.

Sa i përket kushteve të akomodimit në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, MKPT-ja ka vizituar një numër të qelive dhe ka konstatuar se hapësira e akomodimit, ndriçimit dhe ventilimit nuk janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga KPT-ja dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. MKPT-ja ka vërejtur se në krahun B, banjat e përbashkëta janë të dëmtuara, muret kanë lagështi, mbajnë erë myku, pajisjet sanitare janë të dëmtuara. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në disa qeli, për shkak të mungesës së hapësirës, disa të paraburgosur dhe të dënuar flinin në dysheme në dyshekë të vjetruar dhe të mykur, pa mbulesa adekuate. QPP-ja u vizitua dy herë nga KPT-ja. Sa i përket kushteve të akomodimit, KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2007,

³¹⁹Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan, e realizuar më 11 nëntor 2016, për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2016/12/21/raporti-i-mkpt-te-iap-nga-vizita-qendres-korrektuese-ne-lipjan-2/>.

këto kushte i përshkruan si shumë të këqija dhe konstaton se madhësia e qelive nuk është në përputhje me standardet e përcaktuara nga ky komitet. Përveç kësaj, në raport thuhet se qelitë nuk kanë ventilim dhe ndriçim të duhur.³²⁰

Më tej, KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, konstatoi se nuk ishin përmirësuar kushtet e akomodimit dhe përgjithësisht mbeten ashtu siç u konstatua edhe në raportin për vizitën në vitin 2007. Për më shumë, gjatë kësaj vizite, KPT-ja u njoftua nga autoritetet relevante të Republikës së Kosovës se planifikohet mbyllja e kësaj qendre. KPT-ja, në raportin në fjalë, i inkurajoi autoritetet e Republikës së Kosovës që ta mbyllin Qendrën e Paraburgimit në Pejë, sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në raport KPT-ja thekson: *“Për sa kohë që kjo qendër është në përdorim, duhet bërë përpjekje për të siguruar që anekset sanitare të mbahen në gjendje të pranueshme sa i përket kushteve fizike dhe që të burgosurve t’u sigurohen 4m² hapësirë për person në qelitë ku akomodohen më shumë se një i paraburgosur”*.³²¹

Rregullat Evropiane të Burgjeve, në rregullin 181 dhe 18.2, përcaktojnë obligimin e autoriteteve për t’u siguruar të burgosurve kushte, të cilat respektojnë dinjitetin e njeriut, privatësinë dhe që përmbushin kërkesat shëndetësore dhe higjienike, t’u kushtohet vëmendje e duhur kushteve klimatike, madhësisë së qelive, ajrosjes, ndriçimit, ventilimit dhe ngrohjes.

Po ashtu, Rregulli numër 13 i Rregullave të Mandelës, të miratuara nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, përcakton: *“Hapësirat e akomodimit për të burgosurit duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat shëndetësore, vëmendje e veçantë duhet t’u kushtohet kushteve klimatike dhe veçanërisht ajrosjes, hapësirës minimale për banim, ndriçimit, ngrohjes dhe ventilimit.”*

Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë (QPM), përveçse shërben si qendër paraburgimi, njëkohësisht akomodon edhe të dënuarit me dënime afatgjate. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet është funksionalizuar ndërtesa e re, e cila në një pjesë mbulon nevojat për hapësirë me zyra, ndërsa në pjesën tjetër mbulon nevojat për aktivitete të lira, siç janë: shtypshkronja, punëtorja për zdrukthëtarë dhe për punëtorinë për përpunim të metaleve (axhustator), si dhe hapësira për vizita të lira. Shtypshkronja është e re dhe funksionale, ndërsa aty shtypen fanella dhe gjëra tjera.

Kushtet e akomodimit në QPM në përgjithësi janë të mira, objekti është rinovuar gjatë viteve të mëhershme, kështu që nuk ka mangësi të theksuara sa i përket kushteve të akomodimit. Pastrimi u lejohet të burgosurve në çdo të dytën ditë, ndërsa në situata të veçanta mund të pastrohen edhe më shpesh, furnizimi me ujë të ngrohtë është i rregullt, dhomat e të burgosurve posedojnë TV kabllore.

³²⁰ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2007, publikuar në vitin 2009, në: <https://rm.coe.int/168069727c>.

³²¹ Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2015, paragrafi 41. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

Ushqimi

Sa i përket kualitetit dhe sasisë së ushqimit, MKPT-ja ka pranuar ankesa nga të burgosurit në QKD. Ankesat lidhur me këtë çështje i referohen në të shumtën e rasteve kualitetit dhe sasisë së ushqimit, i cili u shërbehet të burgosurve në mëngjes dhe në darkë. Edhe gjatë vizitës në Qendrën Edukative Korrektuese në Lipjan, MKPT-ja ka pranuar ankesa nga të miturit sa i përket kualitetit dhe sasisë së ushqimit. Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve, të cilëve u është hequr liria, theksojnë se, çdo ambient paraburgimi duhet të garantojë që çdo i mitur të marrë ushqim të përgatitur në mënyrë të përshtatshme dhe të shërbyer në vakte normale të ushqimit, në cilësi dhe sasi që plotëson standardet e dietës, higjienës dhe shëndetit, për aq sa është e mundur. Po ashtu duhet të respektohen kërkesat fetare dhe kulturore. Çdo i mitur duhet të ketë ujë të pijshëm të pastër në çdo kohë.

MKPT-ja vëren se Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton se i dënuari ka të drejtë në ushqim të përshtatshëm për ruajtjen e mirë të shëndetit dhe fuqisë së tij, në tri shujta për çdo ditë, të cilat duhet të jenë të llojllojshme dhe ushqyese.

Ushqimi që i jepet personit të dënuar duhet t'i përshtatet moshës dhe gjendjes së tij shëndetësore, natyrës së punës, stinës, kushteve klimatike dhe për aq sa është e mundur, u përshtatet kërkesave të tij fetare dhe kulturore. Po ashtu, ky ligj përcakton obligimin që të dënuarit t'i sigurohet ushqimi i caktuar nga mjeku.³²² Gjatë vizitave në qendrat tjera korrektuese dhe të paraburgimit, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të burgosurit, lidhur me kualitetin dhe sasinë e ushqimit. MKPT-ja gjatë vizitave ka vërejtur se kohë pas kohe përballen me mungesa të ushqimit dietal, sipas përshkrimit të mjekut kompetent për të burgosur të caktuar.

Përmes raporteve me rekomandime, MKPT-ja ua rikujtoi autoriteteve kompetente obligimin për të siguruar pakot dietale për të dënuarit dhe të paraburgosurit, për të cilët një gjë e tillë është e domosdoshme për shkaqe shëndetësore.³²³ Në përgjigjen e tyre autoritetet kompetente kanë theksuar se kohë pas kohë përballen me mungesa të ushqimit adekuat, për shkak të procedurave të tenderimit dhe lidhjes së kontratës me operatorin ekonomik.

Regjimi

Sa i përket regjimit, MKPT-ja ka vërejtur se në QKD, sipas Drejtorisë, janë rreth 350 të dënuar të angazhuar në punë. Angazhimi në punë është më i madh gjatë stinës së verës. Zakonisht, të dënuarit angazhohen në punë në kuzhinë, pastrim dhe në ferma të Qendrës. Të dënuarit mund të lëvizin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur dhe kanë të drejtë 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit 2 orë në ditë.³²⁴ Po

³²²Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39, paragrafët 1 dhe 2.

³²³Rregullat e Mandelës, neni 22. Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 22.2. Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 39.1.

³²⁴Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë në së paku dy orë shëtitje.

ashtu, në kuadër të Qendrës Korrektuese funksionojnë 3 punëtori, që në fakt janë edhe qendra për trajnime profesionale, ku organizohen trajnime për saldim, ndërtimtari, axhustator, zdrukthëtari, mirëmbajtje teknike, instalim të ujit dhe rrymës. Në këto punëtori organizohen kurse me kohëzgjatje prej 3 muajve.

Në kuadër të QKD-së ekziston edhe salla e fitnesit, e basketbollit dhe fusha e futbollit. Salla e basketbollit tash për tash është jashtë përdorimit, meqenëse duhet të ndërrohen xhamat e dëmtuar dhe të vendosen rrjeta, të cilat do t'i parandalonin dëmtimet e xhamave, që shkaktohen si pasojë e goditjeve me top. Një pjesë e sallës, siç janë tualetet dhe dushet, ishin rinovuar dhe janë në gjendje shumë të mirë, kurse në pjesën tjetër punimet janë ndalur pasi që kryerësi i punëve nuk i ka respektuar kushtet teknike. Prandaj, gjendja në këto objekte mbetet e njëjtë si edhe gjatë vizitës në nëntor të vitit 2016.

Po ashtu, MKPT-ja konsideron se krijimi i njësisë ekonomike do t'i shtonte aktivitetet dhe angazhimet e një numri më të madh të të dënuarve. Krijimi i njësisë ekonomike parashihet edhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.³²⁵ Pavarësisht përpjekjeve të Drejtorisë së QKD-së, MKPT-ja mendon se, me qëllim të arritjes së risocializimit dhe rehabilitimit të duhur të të dënuarve, duhet të rriten aktivitetet e mirëfillta dhe të ketë sa më shumë programe rehabilitimi, të cilat do të ishin në dispozicion të një numri sa më të madh të të dënuarve.

Në BSL të dënuarit mund të lëvizin të lirë brenda pavijoneve ku janë të vendosur, brenda kohës së caktuar, p.sh. të burgosurve në regjim themelor dhe standard, dera u lihet hapur deri në orën 16:00 pasdite, të burgosurve në regjim të avancuar - deri në orën 18:00, ndërsa dëshmitarëve të mbrojtur - deri në orën 19:00. Të burgosurit gjithashtu dalin në shëtitje 2 orë në ditë. Për zhvillim të aktiviteteve sportive dhe shëtitjeve mbeten problem muret dhe terrenet për aktivitete sportive dhe shëtitje, të cilat janë të ndërtuara nga betoni me ngjyrë të bardhë dhe shkaktojnë një reflektim verbues të diellit, sidomos gjatë stinës së verës. Autoritetet kompetente kanë pohuar se një gjendje e tillë paraqet problem për zhvillim të aktiviteteve sportive dhe shëtitje, por ende nuk është gjetur zgjidhje. Sa i përket ushtrimeve fizike, MKPT-ja e ka vizituar objektin ku të burgosurit mund të bëjnë fitnes tri herë në javë. Objekti ofron kushte të mira dhe pajisje të mjaftueshme për ushtrime fizike. Pajisjet për fitnes gjenden edhe në çdo krah të pavijoneve.

Të burgosurit angazhohen në punë që ndërlidhen me mirëmbajtje të objekteve dhe punë në kuzhinë. Angazhimi në punë është më i madh gjatë stinës së verës. Gjatë vizitës së MKPT-së, në mars të vitit 2017, ishin të punësuar 80 të burgosur, kurse gjatë vizitës së MKPT-së, më 14 shkurt 2018, ishin të punësuar 68 të burgosur, 2 punëtori janë ende jofunksionale. Në këto punëtori do të mund të organizoheshin kurse dhe trajnime profesionale.

³²⁵Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 212-214.

Sa i përket regjimit për të paraburgosurit, mbetet i varfër pasi që aktivitetet e të paraburgosurve kushtëzohen me lejen nga gjykata kompetente. Edhe përmes këtij raporti, MKPT-ja inkurajon autoritet kompetente t'i rrisin aktivitetet jashtë qelisë në BSL për të paraburgosurit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur. KPT-ja, në raportet për vizitat në shtetet e ndryshme, konsideron se sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes në paraburgim, po aq duhet të jetë i zhvilluar edhe regjimi i cili u ofrohet.³²⁶

Gjatë vizitës në Qendrën Edukative Korrektuese për të Mitur në Lipjan (QEKL), MKPT-ja u njoftua nga të miturit se ata lëvizin lirshëm në hapësirat e objektit, u mundësohet shëtitja jo më pak se 3 orë, gjë që është në pajtim me nenin 139 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur.³²⁷ MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa sa i përket respektimit të kësaj të drejte.

QEKL-ja posedon kabinetin e informatikës të pajisur me kompjuterë, bibliotekën e cila është e pasuruar me tituj të ndryshëm, romane, kabinetin e shtypshkronjës, gjithashtu të pajisur me makineri adekuate për shtypjen e dizajnëve në bluza, gota; sallonin e rrobaqepësisë dhe të floktarisë, të cilat po ashtu janë të pajisura me mjete adekuate të punës. Të gjitha makineritë dhe pajisjet janë donacione nga donatorë të ndryshëm, si: Organizata gjermane HELP, UNICEF-i etj.

MKPT-ja u informua se kabineti i informatikës është në funksion. Është i angazhuar instruktori për aftësim profesional, i cili është i licencuar. Të miturit që e kryejnë kursin, pajisen me certifikata nga Qendra Kombëtare për Aftësim Profesional. Ekipi monitorues u njoftua nga përgjegjësit e QEKL-së se kurset kanë filluar në prill të vitit 2018, gjithsej janë 6 nivele-programe aplikative, ndërsa kursi zgjat 5 deri 6 muaj. Në dhjetor 2018, zëvendës drejtori i QEKL-së e njoftoi MKPT-në se ka filluar edhe kursi i floktarisë, ku e kanë angazhuar personin kompetent të mbajë kurs 1 herë në javë për të miturit.

QEKL-ja ka edhe sallën e sportit dhe sallën e fitnesit, e cila po ashtu është e pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme. MKPT-ja gjatë vizitës ka konstatuar se salla e sportit dhe e fitnesit shfrytëzohen nga të miturit, mirëpo nuk kanë të angazhuar trajner për këto aktivitete sportive. Gjithashtu, rrobaqepësia dhe kabineti i shtypshkronjës nuk janë në funksion, pasi që nuk kanë të angazhuar instruktorë për këto fusha. MKPT-ja inkurajon autoritetet që t'iu mundësojnë QEKL-së angazhimin e instruktorëve profesionalë dhe adekuatë për rrobaqepësi, shtypshkronjë, fitnes. MKPT-ja u njoftua se 12 të mitur vijnë në mësimin në shkollën e mesme në Qendrën Korrektuese në Lipjan (QKL).

³²⁶Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë, nga 15 deri më 22 prill 2015, raporti u publiku në shtator të vitit 2016, shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806a1efc>. Raporti i Komitetit Evropian për Vizitën në Gjeorgji në vitin 2014, i publikuar në vitin 2015 në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806961f8>.

³²⁷Neni 139, paragrafi 1 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, thekson se i mituri ka të drejtë të kalojë të paktën tri (3) orë gjatë ditës në ambient të hapur brenda institucionit.

Sipas njoftimit të punëtorëve socialë, shumica e të miturve në QEKL janë të angazhuar në punë me pagesë. Nga dokumentacioni i kontrolluar del se nga 20 të mitur të akomoduar në QEKL, 19 prej tyre janë të angazhuar në punë në pastrim dhe kuzhinë.

Në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan funksionon shkolla e mesme e ulët dhe shkolla e mesme e lartë, në kuadër të sistemit publik të arsimit. Në vitin 2016, MKPT-ja realizoi një vizitë të vlerësimit të plotë, ndërsa më 20 dhjetor 2016, publikoi raportin me rekomandime. Në të kaluarën, shkolla në këtë qendër u përball me vështirësi për të siguruar mbarëvajtjen e mësimin në mungesë të mësimitdhënësve. Përveç kësaj, pati vështirësi në sigurimin e certifikatave adekuate nga MASHT-i për mbarimin e shkollimit.

Lidhur me problemet e shkollimit të të miturve dhe mbarëvajtjen e mësimin në këtë Qendër, Avokati i Popullit publikoi raportin me rekomandime, përmes së cilit u theksua rëndësia e respektimit të të drejtës në arsimim, e cila mbrohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me konventat tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve. Gjatë vizitave të realizuara në vitin 2018, MKPT-ja u njoftua se shkollimi vijon normalisht dhe certifikatat për mbarim të shkollimit lëshohen rregullisht.

Lidhur me të drejtën për shkollim të personave të burgosur, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja publikoi raportin me rekomandime për të drejtën e personave të burgosur në arsimim universitar.³²⁸ Përmes raportit në fjalë, MKPT-ja u rekomandoi autoriteteve kompetente që të nxjerrin aktin nënligjor në pajtim me Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili do të precizonte mënyrën e realizimit të së drejtës për arsimim universitar për personat e mitur dhe madhorë që janë në vuajtje të dënimit. Të gjitha kategoritë e të dënuarve dhe të paraburgosurve në këtë Qendër gëzojnë të drejtën për shëtitje dy herë në ditë nga një orë dhe tri herë në ditë gjatë ditës në rastin e të miturve.

Në këtë qendër ofrohen trajnime profesionale për hidro-instalues, elektro-instalues dhe ndërtime. Nga statistikat e dërguara nga drejtoria, vërehet se organizohen programe, kurse dhe trajnime të ndryshme siç është programi EQUIP, aktivitete sportive dhe kulturore. Ndërsa, në rastin e femrave të akomoduar, MKPT ka vërejtur se në përgjithësi janë të angazhuara në kuzhinë dhe pastrim.

Angazhimi i të miturve në punë mund të bëhet vetëm me leje të gjykatës kompetente, prandaj aktivitetet për të miturit e paraburgosur mbeten të mangëta. MKPT-ja, si edhe në raportet e mëhershme, inkurajon autoritetet që t'i shtojnë angazhimet jashtë qelisë edhe për personat e paraburgosur, për aq sa kjo është e mundur. Për më shumë, sa më e gjatë që të jetë kohëzgjatja e paraburgimit, aq më i pasur duhet të jetë edhe regjimi i cili u ofrohet. Gjatë këtij viti, në këtë Qendër u organizua teatër terapia, pikturimi në bashkëpunim me CARITAS Kosova, të cilat aktivitete organizohen një herë në javë. Në

³²⁸Raport me rekomandime, A.nr. 493/2018 E.B kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës, publikuar më 23 nëntor 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/raporte-mkpt-1/>.

QKL, CARITAS Kosova ka organizuar edhe trajnime profesionale për rrobaqepësi dhe floktari, ku edhe i ka pajisur me certifikata.

Në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se të paraburgosurit mund të dalin në ajrosje (shëtitje) dy herë në ditë në kohëzgjatje prej 1 ore.³²⁹ Të dënuarit mund të dalin në ajrosje gjatë gjithë kohës. Sipas Drejtorisë, 4 të paraburgosur janë të angazhuar në punë. Të paraburgosurit pjesën tjetër të ditës, përveç ajrosjes, e kalojnë në qelitë e tyre, të cilat janë të pajisura me TV. Mungon salla dhe pajisjet për aktivitete sportive dhe fitnes. Mundësitë e të burgosurve për të lëvizur janë të vogla, meqenëse hapësira në QPP këtë nuk e ofron. Po ashtu, në kuadër të QPP-së funksionon edhe biblioteka, e cila ka nevojë për më shumë libra me tituj shkencorë dhe romane.

Gjatë vizitës në fjalë, MKPT-ja ka vërejtur se regjimi për të paraburgosurit mbetet i varfër, pavarësisht përpjekjeve të Drejtorisë për të ofruar më shumë aktivitete për të paraburgosurit. MKPT-ja konsideron se, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes në paraburgim, po aq duhet të jetë i zhvilluar edhe regjimi i cili u ofrohet.

Në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan (QPGj), MKPT-ja u njoftua se, në momentin vizitës, ishin të angazhuar në punë rreth 16 të burgosur. Të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të dalin në ajrosje (shëtitje) dy herë në ditë, në kohëzgjatje prej 1 ore. Përgjithësisht të burgosurit angazhohen në punë pastrimi, kuzhinë, lavanteri dhe kryejnë detyra të caktuara të përkohshme. Përndryshe, për MKPT-në është shqetësues fakti se në QPGj nuk ka asnjë aktivitet rekreativ, kulturor, sportiv, apo program për rehabilitim dhe risocializim të të burgosurve. MKPT-ja, ka vërejtur po ashtu se terrenet sportive nuk janë të pajisura me pajisje të domosdoshme për zhvillim të aktiviteteve sportive dhe rekreative. Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe aktet tjera ndërkombëtare, relevante për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve përcaktojnë obligimet e autoriteteve për të siguruar aktivitete të mirëfillta dhe programe rehabilitimi për të burgosurit.³³⁰

QPGj posedon edhe një bibliotekë, e cila posedon libra të ndryshme në gjuhën shqipe dhe serbe, por sipas Drejtorisë, nuk ka pasur rifreskim me tituj të rinj dhe këto që janë në dispozicion, janë të periudhës së paraluftës.

³²⁹Rregullat e Mandelës, neni 23. Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 27.1. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 48, publikuar në vitin 2015. Sipas nenit 37 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të dënuarit kanë të drejtë në së paku dy orë shëtitje.

³³⁰Neni 88.1 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale: “*Aktivitetet kulturore, rekreative dhe sportive, si dhe aktivitetet tjera që synojnë zhvillimin e personalitetit të personit të dënuar organizohen brenda institucioneve korrektuese me ndihmën e subjekteve publike dhe private të interesuara për ri-integrimin e personave të dënuar në shoqëri*”. Rregullat e Mandelës, Rregulli 104. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 11-të i Përgjithshëm, paragrafi 32-të, publikuar në vitin 2000: “*Aktivitetet të cilat u sigurohen të burgosurve duhet të jenë sa më të llojlojshme që të jetë e mundur (edukim, sport, punë të vlerës trajnuese)*. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, pjesë nga Raporti i 3-të i Përgjithshëm, paragrafi 43 [CPT/Inf (93) 12].

Rregullat Evropiane të Burgjeve, 25.1: “*Regjimi i ofruar për të gjithë të burgosurit duhet të ofrojë një program të balancuar të aktiviteteve rehabilituese*”.

Në Qendrën e Paraburgimit në Lipjan (QPL), të paraburgosurit angazhohen në punë pastrimi për mirëmbajtje të objektit dhe në kuzhinë. Atyre u ofrohet shëtitje 1 orë para dite dhe 1 orë pasdite gjatë stinës së verës, ndërsa, gjatë stinës së dimrit ky orar reduktohet në 45 minuta. Gjatë kësaj periudhe, të paraburgosurit dhe të dënuarit mund të merren me sport, siç është basketbolli, futbollli dhe vrapimi, kurse, salla e fitnesit aktivizohet vetëm gjatë stinës së dimrit. Megjithatë, angazhimi i të paraburgosurve në punë të tjera mund të varet edhe nga leja e gjykatës kompetente. Neni 199 i Kodit të Procedurës Penale përcakton: *“I paraburgosuri mund të kryejë punë të nevojshme për mbajtjen e rendit dhe pastërtisë në ambientin e tyre. Të paraburgosurit mund t’i lejohet të punojë në aktivitete që i përgjigjen aftësive fizike dhe mendore brenda mundësive dhe kushteve me të cilat disponon institucioni dhe me kusht që të mos e dëmtojë procedurën penale. Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendos për këtë në marrëveshje me drejtorinë e institucionit.”*

Drejtoria e QPL-së e njoftoi MKPT-në se tash për tash ka angazhuar në punë 10 të dënuar dhe 5 të paraburgosur.

Sa i përket aktiviteteve dhe angazhimit në punë të të paraburgosurve në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, MKPT-ja, gjatë vizitës së përgjithshme të realizuar më 4 tetor 2018, ka vërejtur se në këtë Qendër tash për tash janë të angazhuar në punë rreth 8 të paraburgosur dhe 3 të dënuar. Të paraburgosurit mund të dalin në ajrosje (shëtitje) dy herë në ditë, në kohëzgjatje prej 1 orë. Qendra e Paraburgimit në Pejë ka një shëtitore mjaft të vogël, në të cilën gjendet vetëm një tabelë e pingpongut. QPP-ja nuk ka mundësi që të paraburgosurve dhe të dënuarve t’u ofrojë aktivitete të tjera, përveç shëtitjes dhe shikimit të TV-së në qeli. Kështu që, të paraburgosurit dhe të dënuarit shumicën e kohës e kalojnë të mbyllur në qelitë e tyre. Për më shumë, në rastin e të paraburgosurve shpesh nevojitet leja nga gjykata kompetente, në mënyrë që ata të angazhohen në punë ose në ndonjë aktivitet specifik.

Sa i përket regjimit në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë (QPM), të burgosurit angazhohen në punë në kuzhinë dhe pastrim të rrobave. Sa i përket aktiviteteve, në dispozicion të të burgosurve është salla e fitnesit, ndërsa në oborr janë të vendosura mjetet për fitnes dhe aksesoret për të luajtur futboll. Gjatë kësaj periudhe, në QPM u zhvillua aktiviteti i përkrahjes së psikologut të jashtëm, i udhëhequr nga Këshilli i Evropës. Megjithatë, gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, në QPM nuk pati kurse apo ndonjë trajnim.

Kontaktet me botën e jashtme

Legjisllacioni në fuqi³³¹, në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar të korrespondencës (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe në

³³¹Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.

Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese³³² përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Sipas këtij Udhëzimi, biseda telefonike e personit të dënuar dhe të paraburgosur nuk mund të jetë më e gjatë se 15 (pesëmbëdhjetë minuta). Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me këtë të drejtë.

Në rastin e të paraburgosurve, neni 200 i Kodit të Procedurës Penale të Kosovës përcakton se të paraburgosurit mund të pranojnë vizita “*brenda kufijve të rregullave të qendrës së paraburgimit*”, bazuar në lejen e gjyqtarit të procedurës paraprake dhe nën mbikëqyrjen e tij. Më tej, Kodi përcakton se korrespondenca dhe vizitat tjera i nënshtrohen vendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake.

Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta, pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit.

Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike apo me zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai.³³³ MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, nuk ka pranuar ankesa lidhur me të drejtën për kontakte me botën e jashtme nga të dënuarit dhe të paraburgosurit.

Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Shërbimet shëndetësore në qendra korrektuese dhe të paraburgimit ofrohen nga Ministria e Shëndetësisë, respektivisht nga Departamenti i Shëndetësisë në Burgje (DShB). Që nga viti 2013, ky shërbim u nda nga Ministria e Drejtësisë (MD), duke plotësuar kështu një standard të rëndësishëm ndërkombëtar për të drejtat e të burgosurve, i cili kërkon që shërbimet shëndetësore në burgje të jenë pjesë e shërbimeve publike shëndetësore. Përveç kësaj, DShB-ja, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertët e Këshillit të Evropës, ka hartuar Praktikën Standarde të Veprimit, e cila u miratua nga Ministria e Shëndetësisë. Ky dokument është udhëzues konkret për personelin shëndetësor që nga momenti i pranimit të të burgosurit.

Shërbimet shëndetësore në burgje dhe qendra të paraburgimit mbeten në nivel të mirë dhe i plotësojnë standardet minimale ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve. Disa njësi

³³²Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

³³³Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33 paragrafi 1.

shëndetësore të DShB-së hasin në vështirësi, për arsye të mungesës së kushteve adekuatë të punës, për shkak të infrastrukturës në disa qendra korrektuese dhe të paraburgimit.

Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, MKPT-ja ka vërejtur se hapësira e cila shfrytëzohet për kujdesin shëndetësor është e pamjaftueshme dhe nuk i plotëson as nevojat minimale. Në shfrytëzim është një dhomë, e cila përdoret për të gjitha nevojat e kujdesit parësor nga mjeku i burgut, infermierët, nga psikologu kur ka raste për të trajtuar, si dhe është hapësirë e përhershme e qëndrimit të personelit shëndetësor.

Mungesa e hapësirës së veçantë për psikologun, i cili ofron shërbime psikologjike për rastet me probleme të ndryshme, si: rastet me tentim të vetëvrasjes, vetëlëndimeve, probleme emocionale, me përdorues të duhanit, alkoolit, drogave, e vështirëson punën e psikologut si dhe nuk ofron rehati për të burgosurit që kanë nevojë për shërbime psikologjike.

Në Qendrën Korrektuese në Dubravë funksionon spitali i burgut, i cili ofron shërbime mjekësore për të burgosurit. MKPT-ja, në raportin e fundit për QKD-në³³⁴, i publikuar më 26 janar 2017, i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) që të angazhojë edhe një psikolog, pasi që është e pamundur të mbulohet tërë qendra me një psikolog, të angazhojë një stomatolog dhe një psikiatër të rregullt. Gjatë vizitës së fundit përcjellëse u konstatua se QKD-ja ka të angazhuar vetëm një psikolog me orar të plotë. Rekomandimet lidhur me angazhimin e një psikiatri të rregullt dhe stomatologut është implementuar dhe, gjatë muajit dhjetor 2018, stomatologu dhe psikiatri kanë filluar punën e rregullt me orar të plotë në QKD.

MKPT-ja shpreh shqetësim serioz lidhur me faktin se në Qendrën Korrektuese në Dubravë, një pjesë e pavijonit numër 8 shfrytëzohet si krah i spitalit. MKPT-ja konstaton se pavijoni 8 nuk i përmbushë standardet minimale të akomodimit të parapara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me Ligjin për Shëndetin Mendor, me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe me Konventat tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria.

Edhe gjatë kësaj vizite, MKPT-ja ka vërejtur se spitali edhe më tej nuk ka ashensor, përmes të cilit të dënuarve me aftësi të kufizuara do t'u mundësohej qasja në katin e dytë. MKPT-ja ka vërejtur se higjiena në dhomat e spitalit, në pjesën ku mbahen pacientët për trajtim psikiatrik, nuk ishte në nivelin e duhur. Po ashtu, shtretërit në dhomat e spitalit dhe mbulesat janë të vjetërsuara dhe të pa pastra. Më 29 maj 2018, Drejtoria e Shëndetësisë në Burgje e njoftoi MKPT-së se tani janë pajisur me një autoambulancë të re.

Edhe pse spitali i burgut u rinovua më herët, megjithatë, MKPT-ja ka vërejtur se infrastruktura është dëmtuar dukshëm (pllakat e dyshemesë dhe inventari në korridorin e sallës ku ushqehen pacientët), ndërsa pjesa e ndarë si kuzhinë për përdorim të pacientëve

³³⁴ http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/27012017,Raport_me_rekomandime_i_MKPT_-_Dubrav%C3%AB_101537_457637.pdf

të shtrirë nuk përdoret. MKPT-ja konsideron se janë të domosdoshme rinovimet në spitalin e burgut.

Spitali ka pajisje moderne dhe mund të ofrojë shërbime adekuate mjekësore për të burgosurit. Në përgjithësi, MKPT-ja konstaton se përbërja e personelit dhe pajisjet në dispozicion të spitalit të burgut i plotësojnë standardet për ofrim të shërbimeve adekuate mjekësore, por ambienti ku akomodohen personat me probleme mendore si dhe ata me sëmundje organike, nuk është i përshtatshëm.

Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan, MKPT-ja ka konstatuar se hapësirat e vizituara ku ofrohen shërbimet mjekësore, në përgjithësi, janë të një standardi të mirë. Personeli shëndetësor në dispozicion është në nivel të mjaftueshëm. MKPT-ja gjatë vizitës nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të burgosurit lidhur me trajtimin shëndetësor në këtë qendër të paraburgimit.

Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit lidhur me kujdesin shëndetësor. MKPT-ja ka vërejtur se shërbimet mjekësore në Qendrën e Paraburgimit në Pejë jepen në pajtim me kërkesat dhe nevojat e të paraburgosurve. Megjithatë, infrastruktura ku realizohen shërbimet mjekësore nuk i plotëson as kushtet minimale, mungon drita natyrale, nuk ka dhomë të veçantë për vizitë të pacientëve apo aplikim të terapisë. Higjiena mbahej nga vetë infermierët. Transporti i të burgosurve për të marrë shërbime mjekësore në institucionet tjera shëndetësore jashtë QPP-së bëhet me automjet të Shërbimit Korrektues.

Sa i përket shërbimeve mjekësore në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, gjatë 24 orëve, në dispozicion të të burgosurve janë dy infermierë, ndërsa mjekët e përgjithshëm, psikiatri dhe psikologu janë në shërbim dy herë gjatë javës dhe janë në gjendje gatishmërie, sipas thirrjes. QPM-ja përballet me probleme kur bëhet fjalë për hospitalizim të të burgosurve. Në situata të tilla, të burgosurit e nacionalitetit serb dhe ata jo shqiptarë nuk e mirëpresin hospitalizimin në QKUK dhe hospitalizohen në Qendrën Klinikën Mitrovica-Veri. Në raste të tilla ekziston problemi konstant sa i përket pjesës formale të akomodimit të tyre lidhur me sigurimin shëndetësor, pagesën e shpenzimeve etj. Deri më tani problemi u tejkalua, pasi që spitali në Mitrovicën - Veri tregoi mirëkuptim në interes të mbrojtjes së shëndetit të të burgosurve. Deri më tani ky spital nuk e ka refuzuar hospitalizimin e të burgosurve dhe ofrimin e trajtimit.

Rëndësia e kontroleve mjekësore me rastin e pranimit të të burgosurit

Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore, sidomos në rastet e të burgosurve apo të paraburgosurve të sapo pranuar jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit, i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës, përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.

I burgosuri i sapo pranuar, në pajtim me Praktikën Standarde të Veprimit të Departamentit të Shëndetësisë në Burgje, fillimisht kontrollohet nga infermieri pastaj

edhe nga mjeku i qendrës korrektuese apo i qendrës së paraburgimit, brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit. Po ashtu, Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton obligimin që të burgosurit të sapo pranuar t'i bëhet një kontroll mjekësor brenda afatit prej 24 orëve nga momenti i pranimit.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

Në përgjithësi, MKPT-ja ka vërejtur se shërbimet shëndetësore në qendra korrektuese dhe të paraburgimit ofrohen pa prezencë të zyrtarëve korrektues, përveç në raste kur mjeku vlerëson se prezenca e zyrtarëve korrektues është e domosdoshme. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës vazhdimisht thekson rëndësinë e mosprezencës së zyrtarëve të sigurisë gjatë marrjes së shërbimeve mjekësore nga të burgosurit, pasi që një gjë e tillë do të minonte raportin mjek-pacient.³³⁵ Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet edhe me nenin 25 të Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese dhe Praktikën Standarde të Veprimit.

Shëndeti mendor në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, ekipi i MKPT-së ka hasur në disa të burgosur me çrregullime kronike psikiatrike. MKPT-ja ka intervistuar disa të burgosur në QKD, në pavijonin 8, ku dy prej tyre ishin me çrregullime kronike psikiatrike dhe njëri prej tyre që gati tri vjet qëndronte vetëm në një qeli. Kjo gjendje është në kundërshtim me nenin 6, paragrafi 1.10 të Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor³³⁶.

Neni 43, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04 L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale thekson se *“Personi i dënuar të cilit nuk mund t'i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues dërgohet në spitalin e burgut, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.”*

Neni 174, paragrafi 1 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *“Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në institucionin shëndetësor, ose në institucionin tjetër të posaçëm që ndodhet në vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e të pandehurit, ose nëse institucioni i tillë nuk ndodhet në atë vend, në institucionin më të përafërt me vendin ku i pandehuri ka vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin, ose në vendin ku është zbatuar procedura penale.”*

Neni 175, paragrafi 1 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, thekson: *“Nëse personi ndodhet në paraburgim, personeli i Shërbimit Korrektues të Kosovës e përcjell në institucionin e kujdesit shëndetësor”*, ndërsa paragrafi 3 i po këtij neni, thekson se personi ndaj të cilit ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik ka të drejta dhe

³³⁵ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në shtator 2016, paragrafi 65. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

³³⁶ Neni 6, paragrafi 1.10 i Ligjit nr. 05/L-025 Për Shëndetin Mendorë, përcakton *“të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë”*.

detyrime të njëjta sikurse personi i cili mban dënimin me burgim, nëse nevojat e trajtimit nuk kërkojnë ndryshe.³³⁷

Po ashtu, neni 509, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale përcakton: “Nëse i pandehuri ndodhet në paraburgim dhe më pas konstatohet se ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore në kohën e kryerjes së veprës penale, gjykata urdhëron që i pandehuri të mbajë paraburgimin në institucionin e kujdesit shëndetësor nëse ai aktualisht ndodhet në gjendje të çrregullimit mendor.”

Në bazë të Ligjit për Shëndetin Mendor, Instituti i Psikiatrisë Forenzike është njësi organizative e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Sipas ligjit në fuqi, ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (i vetmi në Kosovë)³³⁸. Në IPFK akomodohen personat të cilët kanë kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrimit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik³³⁹, si dhe personat të cilët janë subjekt i urdhrimit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor.³⁴⁰ MKPT-ja konstaton se numri i shtretërve në IPFK nuk mjafton për tërë vendin, gjithashtu edhe reparti C me kapacitetin prej 12 shtretërve është i pa mjaftueshëm për trajtimin e të burgosurve, ku këtë shqetësim e kanë shprehur edhe drejtori i DShB-së dhe IPFK-së.

Gjatë vizitave në Qendrën Korrektuese për Femra dhe të Mitur, MKPT-ja gjithashtu ka hasur në raste me çrregullime mendore, ku sipas personelit mjekësor, shpesh është problem menaxhimi i rasteve në fazën akute. Kjo paraqet problem, pasi që nuk ka vend se ku të trajtohen të miturit me çrregullime mendore. IPFK-ja nuk ka hapësira të veçanta për trajtimin e të miturve dhe femrave.

KPT-ja thekson se një i burgosur i sëmurë mendor duhet të mbahet dhe përkujdeset në një mjedis spitalor që është i pajisur përshtatshëm dhe që ka personelin e trajnuar siç duhet. Ai mjedis mund të jetë një spital psikiatrik civil ose një mjedis psikiatrik i pajisur posaçërisht brenda sistemit të burgut³⁴¹.

Sipas drejtorit të DShB-së, duhet të funksionalizohen dhoma të sigurta në Klinikën e Psikiatrisë për trajtimin e rasteve me çrregullime mendore dhe, sipas tyre, janë duke punuar në këtë drejtim. MKPT-ja, gjatë vizitës në Klinikën Psikiatrike³⁴², ka konstatuar se nuk ka repart të veçantë për trajtim të të moshuarve, fëmijëve dhe adoleshentëve. Megjithatë, vendosja e të miturve dhe e të moshuarve është praktikë gati e përhershme dhe në njëfarë mënyre e detyruar, për shkak se të miturit nuk i pranojnë në repart të pediatriisë dhe po ashtu edhe të moshuarit nuk kanë hapësira tjera hospitalizimi. Në Rregulloren nr.127/2015, e datës 21.12.2015, për pranimin dhe trajtimin e personave me

³³⁷ Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, neni 175, paragrafi 1 dhe 3.

³³⁸ Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, neni 13 paragrafi 1.2

³³⁹ Kodi Penal i Kosovës, neni 89.

³⁴⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 508, paragrafi 4.

³⁴¹ Normat e KPT, Pjesë nga Raportii 3-të i Përgjithshëm. [CPT/Inf (93) 12], paragrafi 43.

³⁴² <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-psikiatrike-ne-qkuk/>

çrregullime mendore në ShSKUK (neni 11) lejohet që një person që nga mosha 16 vjeçare të hospitalizohet.

Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor hyri në fuqi në dhjetor të vitit 2015 dhe ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Ky ligj përcakton obligimin e ministrive kompetente për të nxjerrë aktet nënligjore relevante. Sipas nenit 28, paragrafi 4 të Ligjit për Shëndetin Mendor: *“Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë i propozojnë Qeverisë për miratim aktin nënligjor ku i përcaktojnë rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimeve të shëndetit mendor në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”*. Mungesa e akteve nënligjore paraqet problem edhe në trajtimin e rasteve. MKPT-ja e Avokatit të Popullit, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, u rekomandoi autoriteteve kompetente të nxjerrin aktet nënligjore ashtu siç parashihet me Ligjin e Shëndetit Mendor.

Procedura e parashtrimit të ankesave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtit në burgje dhe në qendra të paraburgimit. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda burgut apo brenda qendrës së paraburgimit ku akomodohen dhe që në mënyrë konfidenciale t’u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

Neni 91 i Ligjit nr. 04/L- 149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton në hollësi procedurën sipas së cilës të paraburgosurit dhe të dënuarit mund t’i drejtohen me ankesë apo lutje drejtorit të një institucioni të caktuar të ShKK-së. Procedura përfshin edhe afatet për përgjigje nga drejtori dhe mundësinë që ankesa t’i drejtohet një autoriteti më të lartë, që në rastin e tanishëm është Drejtoria e Përgjithshme e ShKK-së dhe ministri i Drejtësisë.³⁴³

MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të burgosurve janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kutitë e vendosura nga Departamenti Shëndetësor i Burgjeve. Gjithashtu, në çdo institucion janë të vendosura edhe kutitë e ankesave të Institucionit të Avokatit të Popullit, ku mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Këshilli i Evropës dhe ShKK-ja kanë mbajtur punëtori të përbashkëta, me qëllim të hartimit të procedurave dhe formularëve për parashtrim të ankesës, të cilët do të hartohen nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të ekspertëve të Këshillit të Evropës.

³⁴³Neni 91, paragrafi 4 i Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: Në ankimin e paraqitur drejtori i institucionit korrektues do të përgjigjet në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ndërsa Zyra Qendrore e Shërbimit Korrektues në afat prej tridhjetë (30) ditësh. Në ankimin me shkrim do të jepet përgjigja në formën me shkrim.

MKPT-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, ka pranuar ankesa nga të burgosurit në QKD, me pretendimin se Drejtoria nuk përgjigjet në ankesat dhe kërkesat e tyre. Këto pretendime janë hedhur poshtë nga Drejtoria. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit në qendrat tjera korrektuese dhe të paraburgimit lidhur me çështjen e parashtrimit të ankesave apo vonesa për të shqyrtuar ankesat e tyre brenda afatit ligjor. Përmes raportit me rekomandime për vizitën në QKD dhe kontakteve të drejtpërdrejta, MKPT-ja ua ka rikujtuar autoriteteve kompetente obligimin e tyre që të përgjigjen në kërkesat dhe ankesat e të burgosurve, pavarësisht natyrës së kërkesës, është e rëndësishme që të burgosurve t'u kthehen përgjigje në kërkesat e parashtruara. Ky obligim i autoriteteve përcaktohet me Ligjin nr. 04/L-149.

Rekomandimet e dërguara autoriteteve kompetente pas vizitave në qendra korrektuese dhe të paraburgimit

Rekomandimet për Qendrën Korrektuese në Dubravë drejtuar Ministrisë së Drejtësisë:

- Ta njoftojë MKPT-në e Avokatit të Popullit nëse është miratuar legjislacioni sekondar për luftimin e korrupsionit (I pa implementuar).
- Të përmirësohet cilësia dhe sasia e ushqimit (I implementuar).
- Të burgosurve t'u sigurohet ushqimi dietal sipas rekomandimit të mjekut kompetent (I implementuar).
- Të gjitha qelitë ku vendosen të burgosurit, të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e vetmisë, të jenë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe me rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës. (I implementuar).
- Të bëhen renovimet e nevojshme bazuar në konstatimet në këtë raport, veçanërisht pavijoni 8 (I implementuar).
- Të furnizohet kuzhina me pajisje adekuate, sipas vlerësimit konkret (I implementuar).
- Të ndërmerren hapa konkret, në mënyrë që të ndërpritet praktika e përdorimit të pajisjeve të improvizuara elektrike (Në pritje për implementim).
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të burgosurit të furnizohen me dollapë për vendosjen e gjësendeve të tyre (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017) (Në pritje për implementim).
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të funksionalizohet salla e sportit. (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017) (Në pritje për implementim).
- Të funksionalizohet njësi ekonomike (Në pritje për implementim).
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që në spitalin e burgut të instalohet ashensori i cili do t'u mundësonte të burgosurve me aftësi të kufizuara qasjen në katin e dytë të spitalit (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017) (I pa implementuar).
- Të bëhen renovimet e nevojshme në spital (shih paragrafin 40 të këtij raporti) (Në pritje për implementim).

- Të angazhohet personeli i nevojshëm korrektues sipas vlerësimit të nevojave (Në pritje për implementim).
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të vendosen kamerat e sigurisë aty ku mungojnë, si dhe mundësinë teknike të ruajtjes së të dhënave për një kohë më të gjatë (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017) (Në pritje për implementim).
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që të bëhet plotësim/ndryshimi i LESP-së dhe Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, ku parashihet që të kërkohet mendimi me shkrim i mjekut, para se një personi t'i shqiptohet masa disiplinore (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017) (Në pritje për implementim).
- Të shtohet numri i punëtorëve socialë bazuar në numrin e të burgosurve në QKD (Në pritje për implementim).
- Të furnizohet QKD-ja me të gjitha pajisjet dhe materialet e nevojshme për punë të përditshme (Në pritje për implementim).
- Të adresohen nevojat e zyrtarëve korrektues sa i përket kushteve të punës dhe pajisjeve për punë (Në pritje për implementim).
- Të njoftohet MKPT-ja lidhur me çështjen e përdorimit të *peperspray* dhe afatit të skaduar të të njëjtit (shih paragrafin 67 të këtij raporti) (I implementuar).

Rekomandimet për Qendrën Korrektuese në Dubravë drejtuar Ministrisë së e Shëndetësisë:

- MKPT ripërsërit rekomandimin që Ministria e Shëndetësisë të angazhojë një stomatolog të rregullt (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017). (I implementuar).
- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin që Ministria e Shëndetësisë të angazhojë një psikiatër të rregullt (shih raportin me rekomandime, 26 janar 2017). (I implementuar).

Rekomandimet për Qendrën Edukuese-Korrektuese në Lipjan drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Korrektues të Kosovës:

- Ushqimi për të miturit të jetë i bollshëm dhe i përshtatshëm sipas kalorive të kërkuara për rritjen dhe zhvillimin e të miturve (Në pritje për implementim).
- Të bëhen renovimet e duhura në kuzhinë, si dhe të pajiset kuzhina me makineritë e domosdoshme (Në pritje për implementim).
- Të shtohen aktivitetet për të miturit dhe të funksionalizohen kabinetet ekzistuese dhe të angazhohen instruktorët adekuatë (Pjesërisht i implementuar).

Rekomandimet për Qendrën e Paraburgimit në Prizren drejtuar Ministrisë së Drejtësisë:

- Ministria e Drejtësisë ta njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me planifikimet për ndërtimin e Qendrës së re të Paraburgimit në Prizren (I implementuar).
- Të krijohen kushte adekuate të punës për personelin mjekësor (Në pritje për implementim).

- Numri i të parburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP-së dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejt që të jetë e mundur (I implementuar).
- Të ndërmerren masat e duhura në mënyrë që të parburgosurve t'u respektohet privatësia (I implementuar).
- Të gëlqerosen qelitë sipas nevojës (I implementuar).
- Të përmirësohen kushtet e punës së zyrtarëve korrektues (Pjesërisht i implementuar).

Rekomandimet për Qendrën e Paraburgimit në Gjilan drejtuar Ministrisë së Drejtësisë:

- Ministria e Drejtësisë ta njoftojë MKPT-në e Avokatit të Popullit lidhur me planifikimet për shfrytëzimin e hapësirës së pa banuar në QPGj (Në pritje për implementim).
- Të njoftohet Avokati i Popullit lidhur me ngecjet në krijimin e hapësirës për montim të karriges stomatologjike (Në pritje për implementim).
- Të sigurohen aktivitete kulturore, sportive dhe programe për rehabilitim dhe risocializim të të burgosurve (Në pritje për implementim).
- Të asfaltohet pjesa e rrugës së paasfaltaruar, e cila mund të paraqesë vështirësi serioze gjatë stinës së dimrit dhe në kushte të reshjeve atmosferike, për kryerjen e punës së QPGj-së në pajtim me LESP-në (Në pritje për implementim).
- Të furnizohet QPGj-ja me materiale të nevojshme për punë (Në pritje për implementim).
- Të instalohen kamerat e sigurisë të cilat mbulojnë pjesën e jashtë të pavijoneve dhe oborrin e QPGj-së (Në pritje për implementim).
- Të funksionalizohet ashensori në pjesën ku ofrohen shërbimet mjekësore. (Në pritje për implementim).

Rekomandimet për Qendrën e Paraburgimit në Pejë, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë:

- Ministria e Drejtësisë ta njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me pretendimet e punonjësve të QPP-së se kjo Qendër do të mbyllet.³⁴⁴ (Në pritje për implementim).
- Të krijohen kushte dhe hapësirë adekuate të punës për personelin mjekësor (I pa implementuar).
- Numri i të parburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP-së dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejt që të jetë e mundur (Në pritje për implementim).
- Kushtet e akomodimit, përderisa kjo Qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet minimale të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve

³⁴⁴Më 3 tetor 2018, Avokati i Popullit ka pranuar ankesë nga personeli i Qendrës së Paraburgimit në Pejë, duke pretenduar se kjo Qendër do të mbyllet dhe personeli do të transferohet në Qendrën Korrektuese në Dubravë.

Penale; me standardet e KPT-së dhe me standardet tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve (Në pritje për implementim).

Qendra për Azilkërkues dhe Qendra e Mbajtjes për të Huajt

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vizituar Qendrën për Azilkërkues dhe Qendrën e Mbajtjes për të Huajt dhe ka publikuar raportet me rekomandime. Gjatë vizitave në këto qendra, MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo sjellje të zyrtarëve të qendrave, përfshirë ata të sigurisë, që do të ishte në kundërshtim me respektimin e dinjitetit të azilkërkuesve dhe të të huajve në mbajtje.

Garancitë kundër keqtrajtimit

Neni 5 i Rregullores për Funkcionimin e Qendrës për Azilkërkues³⁴⁵ (në tekstin e mëtejshëm *Rregullorja*) shprehimisht përcakton: “Zyrtarëve të Qendrës iu ndalohe të diskriminojnë dhe të fyejnë dinjitetin e azilkërkuesve, për shkak të racës, besimit fetar, gjinisë, kombësisë, përkatësisë në një grup shoqëror ose bindjeve politike.”

Po ashtu neni 5, paragrafi 2 i Rregullores përcakton: “Asnjë azilkërkues nuk do t’i nënshtrohet torturës, trajtimit jo njerëzor dhe përvulës.” Neni 6.3 i Rregullores përcakton obligimin e zyrtarit të Qendrës që azilkërkuesin ta njoftojë për të drejtat dhe obligimet e tij, si dhe për procedurën e azilit, duke përfshirë mundësinë e përfitimit të ndihmës juridike pa pagesë dhe mundësinë e kontaktimit me përfaqësuesit e UNHCR-së, ose organizatat tjera, të cilat merren me mbrojtjen e të drejtave të refugjatëve, në gjuhën e tij ose në një gjuhën të cilën ai e kupton.

MKPT-ja ka vërejtur se azilkërkuesit njoftohen për të drejtat e tyre në gjuhë të ndryshme, përmes afisheve dhe broshurave. Po ashtu, në dispozicion të Qendrës është edhe lista e përkthyesve e MPB-së. Ndihma juridike falas, e në raste të shumta edhe përkthimi u ofrohet nga organizata joqeveritare CRPK (Civil Rights Program Kosovo). MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë lidhur me mosrespektimin e të drejtave të lartpërmendura. Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se në të gjitha korridoret e Qendrës operojnë kamerat e sigurisë, gjë që përbën një garanci shtesë kundër keqtrajtimit.

Ndërsa në rastin e të paraburgosurve të huaj, të cilët vendosen në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (QMH), MKPT-ja vëren se standardet e përcaktuara nga KPT-ja përcaktojnë se të gjithë të huajt e paraburgosur si emigrantë të parregullt, që nga momenti i privimit nga liria, duhet të gëzojnë tri të drejta themelore, në të njëjtën mënyrë siç i gëzojnë edhe kategoritë tjera të personave të privuar nga liria. Këto të drejta janë: të kenë qasje tek avokati mbrojtës; të kenë qasje tek një mjek dhe të kenë mundësinë t’i njoftojnë të afërmit e tyre apo palën e tretë, sipas përzgjedhjes së tyre, për faktin se janë

³⁴⁵ Rregullore (MPB) nr. 03/2018 për Funkcionimin e Qendrës për Azil, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Shin në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18328>.

paraburgosur.³⁴⁶ Bazuar në dispozitat e Ligjit 04/L-219 për të Huajt i Republikës së Kosovës, i huaji i cili vendoset në QMH njoftohet në formë të shkruar, në njërin nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në QMH, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën të sigurojë mbrojtjen ligjore të tij, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet”.³⁴⁷

Sipas Rregullores dhe Ligjit për të Huajt, i huaji i vendosur në QMH ka të drejtat si në vijim: informimi lidhur me të drejtën e ankimit për ndalimin në QMH; të drejtën lidhur me ndihmën juridike falas; të drejtën për përkthyesin në gjuhën e tij ose në një gjuhën të cilën ai/ajo e kupton; të drejtën për të komunikuar me organet dhe organizatat relevante vendore apo ndërkombëtare, si dhe me organizatat joqeveritare.³⁴⁸ MKPT-ja ka vërejtur se në të gjitha korridorët e QMH-së operojnë kamerat e sigurisë, të cilat janë vazhdimisht funksionale. Sipas njoftimit të zyrtarëve, imazhet e kamerave të sigurisë ruhen deri në dy muaj. Në raportin për vizitën në Irlandë në vitin 2010, KPT-ja e konsideroi ekzistimin e kamerave të sigurisë si një nga garancitë kundër keqtrajtimit fizik në qendrat ku mbahen personat e privuar nga liria.³⁴⁹

Sa i përket së drejtës për t’u informuar në gjuhën e tyre apo në gjuhën të cilën të huajt e paraburgosur e kuptojnë dhe së drejtës për të pasur shërbime të një përkthyesi, MKPT-ja është njoftuar nga QMH-ja se MPB-ja, përveç shërbimeve në gjuhën angleze, e ka listën e përkthyesve, të cilët ofrojnë shërbime përkthimi edhe në gjuhët tjera të të huajve. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se të huajt në QMH informohen për të drejtat e tyre përmes broshurave të shkruara në gjuhët më të shpeshta, por QMH-ja nuk ka një dokument në të cilin këto të drejta janë të shkruara dhe në të cilin të huajt e paraburgosur vërtetojnë se ata janë njoftuar me të drejtat e tyre në gjuhën të cilën ata e kuptojnë.

Sa i përket ndihmës juridike falas, UNHCR-ja dhe OJQ CRPK u ofrojnë ndihmë juridike falas vetëm të huajve në mbajtje, të cilët janë azilkërkues potencialë, por jo edhe të tjerëve. Sipas Ligjit për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas, Agjencia mund t’u ofrojë ndihmë juridike falas të huajve të cilën kanë leje qëndrimi të përkohshëm në Republikën e Kosovës, por deri më tani nuk kanë pasur raste të ofrimit të ndihmës juridike për të paraburgosurit e huaj. MKPT-ja vëren se neni 9, paragrafi 1.2 i Rregullores parasheh të drejtën për ndihmë juridike falas për të huajt, të cilët gjenden në mbajtje në QMH. Në rastin e azilkërkuesve, ndihma juridike falas, e në raste të shumta edhe përkthimi, u ofrohet nga organizata joqeveritare CRPK (Civil Rights Program Kosovo). MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga ankuesit lidhur me mosrespektimin e të drejtave të lartpërmendura.

³⁴⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 19-të i Përgjithshëm i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, paragrafi 81, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-standards-inf-2009-27-part-en-3%22%5D%7D>.

³⁴⁷ Ligji 04/L-219 për të Huajt, neni 108.

³⁴⁸ Neni 9 i Rregullores (MPB) nr. 03/2014 për Funkcionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve. Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

³⁴⁹ Raporti i KPT-së për vizitën në Irlandë në vitin 2010, paragrafi 18, publikuar në vitin 2011, në: <https://rm.coe.int/1680696c98>.

Kushtet e akomodimit

Në të dy qendrat kushtet e akomodimit janë shumë të mira dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues, MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha dhomat ofronin akomodim të mirë, ngrohje, pastërti dhe ndriçim të mjaftueshëm natyral. Qendra ofron banja të përshtatshme dhe ujë të ngrohtë pandërprerë, ku azilkërkuesit e akomoduar mund të pastrohen sa herë që dëshirojnë. Po ashtu, në oborrin e Qendrës ishte edhe këndi i lojërave për fëmijë. Në përgjithësi, MKPT-ja konsideron se Qendra i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të azilkërkuesve.

Gjatë vizitës në QMH, MKPT-ja ka vizituar dy objektet ku mbahen të huajt, përfshirë të gjitha hapësirat, siç janë dhomat e intervistimit, dhomat e izolimit, dhomat e fjetjes, dhomat familjare, dhomat e aktiviteteve për të rritur, të cilat ishin të pajisura me TV, letra për lojë, tabelë shahu, si dhe në një kënd ishte biblioteka me një numër të vogël të librave. Po ashtu QMH-ja ka dhoma e aktiviteteve për fëmijë, të cilat janë të pajisura me lodra dhe të dizajnuar sipas standardeve, dhomën ku u mundësohet kryerja e aktiviteteve fetare, kuzhinën, e cila ishte e kompletuar me orëndi, si dhe një lavanteri të pajisur mjaftueshëm për kapacitetin e Qendrës. Të gjitha dhomat ofronin akomodim të mirë, ngrohje dhe ndriçim të mjaftueshëm natyral. MKPT-ja konsideron se Qendra i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të personave të huaj.

Neni 24, paragrafi 1 i Rregullores përcakton se çdo i huaj i ndaluar në Qendër ka të drejtë për ajrosje (kalim i kohës jashtë hapësirës së mbyllur), së paku dy (2) orë në ditë, në mjediset e jashtme të Qendrës. Për arsye shëndetësore, udhëheqësi i Qendrës mund të zgjasë kohën e ajrimit. Më tej neni 24, paragrafi 3 përcakton se gjatë kohës së ajrimit mund të zhvillohen aktivitete kulturore dhe sportive. MKPT-ja ka vërejtur se Qendra ka një fushë të vogël sportive, e cila nuk është e pajisur me elementet përcjellëse ku të huajt do të mund të merreshin me aktivitete konkrete sportive. MKPT-ja, ashtu sikurse edhe në raportin me rekomandime, i publikuar pas vizitës në QMH, në vitin 2017³⁵⁰, inkurajon autoritet relevante që t'i shtojnë përpjekjet e tyre për të ofruar mundësitë për aktivitete konkrete sportive dhe aktivitete të tjera për të huajt në këtë Qendër.

KPT-ja, në standardet e përcaktuara në mars të vitit 2017, për paraburgimin e të huajve për shkak të imigracionit, thekson rëndësinë e një regjimi, i cili përmban sa më shumë aktivitete. Sipas KPT-së, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes së të huajve, po aq duhet të zhvillohen aktivitetet, të cilat u ofrohen atyre.³⁵¹ Gjatë takimit me drejtorin e DShAM-së, MKPT-ja u njoftua se janë hapur procedura tenderuese për furnizim me pajisje përcjellëse, në mënyrë që të huajve të paraburgosur në QMH t'u ofrohen më shumë aktivitete. MKPT-ja gjatë vizitave të radhës do të kërkojë informata të përditësuara lidhur me këto plane.

³⁵⁰ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt, publikuar më 13 shkurt 2017. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/01/31/raport-i-mkpt-per-qendren-e-mbajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/>.

³⁵¹ Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

Sa i përket personelit të QMH-së, MKPT-ja u informua se personeli i sigurimit është i trajnuar për të kryer detyra të mbrojtjes fizike të objektit dhe pronës, por nuk janë të trajnuar për të punuar me persona të huaj të privuar nga liria, të cilët, sipas Ligjit për të Huajt, janë subjekt i kthimit me forcë. Lidhur me këtë, MKPT-ja, më 23 mars 2018, zhvilloi takim zyrtar me drejtorin e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion, me ç’ rast u njoftua se personeli i sigurisë nuk ka kryer trajnime adekuate për të punuar me këtë kategori. MKPT-ja i ka rekomanduar Ministrisë së Punëve të Brendshme që personeli i sigurisë në QMH duhet t’i nënshtrohet trajnimeve adekuate për të punuar me këtë kategori.

Kujdesi shëndetësor

Shërbimet mjekësore ndaj të huajve në të dy qendrat ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra Klinike Universitare e Kosovës. Përmes raportit me rekomandime, i publikuar gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja u ka rekomanduar autoriteteve kompetente se QMH-ja duhet të ketë në dispozicion së paku një infermiere/infermier, e cila do t’i kryente kontrollet mjekësore të të sapo pranuarve, shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH; dhe një psikolog siç parashihet në Rregullore.

Sa i përket rëndësisë së kontrolleve mjekësore, KPT-ja³⁵² thekson se çdo i huaj i sapo pranuar në qendra paraburgimi për të huajt duhet të përfitojë nga një mundësi e ekzaminimit gjithëpërfshirës mjekësorë (duke përfshirë sëmundjet transmetuese) nga një mjek ose një infermier të kualifikuar, që i raporton një mjeku të kualifikuar sa më shpejt që është e mundur, pas pranimit të personave të huaj. Për më shumë, KPT-ja në raportet për vizita në shtetet anëtare dhe raportet e përgjithshme, vazhdimisht ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore, sidomos në rastet e të paraburgosurve të sapo pranuar jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit, i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.³⁵³

MKPT-ja, gjatë vizitës së fundit më 7 mars 2018, u njoftua se të huajve të sapo pranuar në këtë Qendër nuk u bëhen ekzaminime të përgjithshme mjekësore, përveç nëse ata e kërkojnë një gjë të tillë, edhe pse kjo shprehimisht parashihet në nenin 10 të Rregullores. Në rastet kur personit të huaj i caktohet terapi me medikamente, terapia i jepet nga zyrtarët jokompetent (personeli i sigurisë dhe zyrtarët tjerë), pasi që nuk ka personel mjekësor të Qendrës.

MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha të dhënat lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore ndaj të huajit mbahen në dosjen e tij/saj personale. Në dosjen e tij/saj personale kanë qasje

³⁵² KPT, Të ndaluarit për shkak të Migracionit [CPT/Inf(2017)3], paragrafi 9, në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

³⁵³ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në vitin 2016, paragrafi 62, në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>. Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti i 26-të i përgjithshëm, paragrafi 72, në: <https://rm.coe.int/168070d0c8>.

zyrtarët e Qendrës. KPT-ja³⁵⁴ thekson se konfidencialiteti mjekësor duhet të respektohet në të njëjtën mënyrë si në komunitet, në veçanti, dosjet mjekësore nuk duhet të jenë të qasshme për personelin jo mjekësor, por duhet të mbahen të mbyllura nga infermierja ose mjeku.

Prandaj, MKPT-ja konsideron se QMH-ja duhet të ketë së paku një infermiere të kualifikuar, e cila do ta kryejë shqyrtimin fillestar mjekësor të të sapo pranuarve, t'i pranojë kërkesat e nevojshme për vizitë nga mjeku, ta shpërndajë terapinë, t'i mbikëqyrë dosjet mjekësore dhe t'i mbikëqyrë kushtet e përgjithshme të higjienës. Personave të huaj të paraburgosur gjithashtu duhet t'u ofrohet asistencë psikologjike dhe kujdes psikiatrik në rast nevoje.

Lidhur me masat disiplinore, sipas Rregullores, masat disiplinore të cilat mund t'i shqiptohen të huajit janë: vërejtja me gojë apo me shkrim; detyrimi për mirëmbajtjen dhe pastrimin e Qendrës; heqja e së drejtës për aktivitete të lira, rekreacion, TV, internet; heqja e së drejtës për aktivitete kulturore dhe sportive në kohëzgjatje deri në 5 ditë; dhe izolimi deri në 48 orë.

MKPT-ja vëren se Rregullorja nuk përmban dispozita, të cilat e obligojnë QMH-së që të huajit në mbajtje t'ia dorëzojë kopjen e vendimit për masë disiplinore të izolimit, por vetëm parasheh se vendimi duhet t'i bashkëngjitet dosjes së të huajit. MKPT-ja, në pajtim me rekomandimet e KPT-së për vizitën në Ukrainë, Bullgari dhe Francë³⁵⁵, u ka rekomanduar autoriteteve kompetente që Rregullorja për Funksonimin e QMH-së të përmbajë një dispozitë të veçantë, e cila parasheh se të huajit të cilit i shqiptohet masa disiplinore, t'i dorëzohet një kopje e vendimit në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton. Ky rekomandim i MKPT-së u zbatua me ndryshimin e Rregullores që hyri në fuqi më 28 dhjetor 2018.

Procedura e parashtrimit të ankesave

Sistemi efektiv i parashtrimit të ankesave është garancia themelore kundër keqtrajtimit në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Personat e vendosur në këto qendra duhet të kenë mundësi për të parashtruar ankesë brenda Qendrave dhe që në mënyrë konfidenciale t'u mundësohet qasja tek autoriteti i duhur.

Të huajt në të dy qendrat kanë të drejtë ankese tek udhëheqësi i Qendrës lidhur me kushtet e pranimit në Qendër dhe sjelljet e personelit. Ankesa dërgohet në Departamentin

³⁵⁴ KPT, Të Ndaluarit për shkak të Migracionit [CPT/Inf(2017)3], shih [linkun](http://hudoc.cpt.coe.int/eng?i=p-standards-inf-2009-27-part-en-5) <http://hudoc.cpt.coe.int/eng?i=p-standards-inf-2009-27-part-en-5>, (13.3.2018)

³⁵⁵ Për më shumë, shih Raportin e 19-të të përgjithshëm të KPT, paragrafi 88, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-standards-inf-2009-27-part-en-4%22%5D%7D>}, Raportin e KPT për vizitën në Ukrainë në vitin 2009, paragrafi 71, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-ukr-20090909-en-17%22%5D%7D>}, Raportin e KPT për vizitën në Bullgari, në vitin 2008, paragrafi 44, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-bgr-20081215-en-12%22%5D%7D>}, Raportin e KPT për vizitën në Francë në vitin 2006, paragrafi 76, në: <http://hudoc.cpt.coe.int/eng#%7B%22CPTSectionID%22:%5B%22p-fra-20060927-fr-14%22%5D%7D>}.

për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DShAM), brenda 7 ditësh. Më tej, Rregullorja përcakton se në Qendër vendoset kutia e ankesave, e cila administrohet nga Qendra. Një kuti e ankesave vendoset dhe administrohet nga Institucioni i Avokatit të Popullit.³⁵⁶ MKPT-ja ka vërejtur se në dispozicion të të huajve në dy qendrat është nga një kuti e ankesave e vendosur nga Qendra për Azil dhe Qendra për të Huajt.

Kontakti me botën e jashtme

KPT-ja konsideron se të ndaluarit e huaj duhet të kenë çdo mundësi për të qenë në kontakt të mirëfilltë me botën e jashtme (përfshirë mundësitë për të bërë telefonata dhe për të pranuar vizita) dhe liria e tyre e lëvizjes brenda qendrës së mbajtjes duhet të kufizohet sa më pak që kjo të jetë e mundur.³⁵⁷ Rregullorja për Funkcionimin e QMH-së përcakton se i huaji në këtë qendër ka të drejtë të mbajë korrespondencë, të pranojë pako dhe sende të tjera.

Po ashtu, Rregullorja përcakton se i huaji ka të drejtë të bëjë telefonata sipas nevojës, në kohëzgjatje prej 5 minutash, duke filluar nga ora 09:00 deri në orën 16:00. Sipas Rregullores, të huajve u mundësohet pranimi i thirrjeve prej jashtë vendit. Të huajve të vendosur në qendër u lejohen edhe vizitat. Gjatë vizitës, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa sa i përket së drejtës për kontakte me botën e jashtme.

Regjimi

KPT-ja, në standardet e përcaktuara në mars të vitit 2017, për paraburgimin e të huajve për shkak të imigracionit, thekson rëndësinë e një regjimi, i cili përmban sa më shumë aktivitete. Sipas KPT-së, sa më e gjatë që është periudha e mbajtjes së të huajve, po aq duhet të zhvillohen aktivitetet të cilat u ofrohen atyre.³⁵⁸

Gjatë vizitës në Qendrën për Azilkërkues, MKPT-ja ka pranuar ankesa nga një azilkërkues lidhur me ngecjen në mbajtjen e kursit të gjuhës shqipe, si pjesë e integritimit në shoqërinë kosovare.

Rekomandimet për Qendrën për Azilkërkues drejtuar Ministris së Punëve të Brendshme:

- Të përshtatet orari i ushqimit sipas nevojave të azilkërkuesve, sidomos koha kur shërbehet darka. (I implementuar).
- Të njoftohet MKPT-ja e Avokatit të Popullit për gjendjen sa i përket dhënies së ndihmës sociale, në pajtim me Ligjin për Azil. (I implementuar).
- Të njoftohet MKPT-ja e Avokatit të Popullit për mbarëvajtjen e kursit të gjuhës shqipe dhe aspekteve tjera të integritimit në shoqëri në Republikën e Kosovës. (I implementuar).

Rekomandimet për Qendrën e Mbajtjes për të Huajt drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme:

³⁵⁶ Neni 19, paragrafët 2 dhe 3 të Rregullores për Qendrën e Mbajtjes për të Huajt.

³⁵⁷ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

³⁵⁸ Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806fbf12>.

- QMH-ja duhet të ketë në dispozicion së paku një infermiere, e cila do t'i kryente kontrollet mjekësore të sapo pranuarve, do të shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në QMH; dhe një psikolog siç parashihet në Rregullore. (Në pritje për implementim).
- Qendra duhet të mbajë protokollat si në vijim: Protokolle për vetminë, për lëndime trupore, vetëlëndime, tentim vetëvrasjes, abuzim seksual dhe të vdekjeve. (Në pritje për implementim).
- Personeli i sigurisë duhet t'u nënshtrohet trajnimeve adekuate për të punuar me këtë kategori. (Në pritje për implementim).
- Për të gjitha të drejtat dhe obligimet e tyre, të huajt të njoftohen përmes një dokumenti të veçantë, në gjuhën të cilën e kuptojnë dhe në të cilin ata vërtetojnë se i kanë kuptuar të drejtat dhe obligimet e tyre. (I implementuar).
- Rregullorja të përmbajë një dispozitë të veçantë, e cila parasheh se të huajt, të cilit i shqiptohet masa disiplinore, t'i dorëzohet një kopje e vendimit në gjuhën të cilin ai/ajo e kupton. (I implementuar).
- Të huajve të paraburgosur t'u ofrohet ndihma juridike falas në pajtim me Rregulloren. (I implementuar).

Institucionet e shëndetit mendor

Gjatë vizitave në institucionet e shëndetit mendor, MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë dhe nuk ka hasur në indikacione për keqtrajtim të pacientëve nga personeli i institucioneve në fjalë. Në të gjitha institucionet e vizituara, atmosfera e përgjithshme ishte e relaksuar, ndërsa raportet ndërmjet personelit dhe pacientëve ishin të mira.

Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës

Baza ligjore relevante gjendet në Kodin Penal³⁵⁹ të Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale³⁶⁰, në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale³⁶¹ dhe në Ligjin për Shëndetin Mendor. Më 21 dhjetor 2015, u miratua Rregullorja për Pranimin dhe Trajtimin e Personave me Çrregullime Mendore në Institucionet Publike Shëndetësore, përfshirë Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Për personelin e IPFK-së, problem shqetësues duket të jetë mosdefinimi i statusit ligjor të IPFK-së.

Në IPFK akomodohen personat të cilët kanë kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrat të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik³⁶², si dhe personat të cilët janë subjekt i urdhrat të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor.³⁶³ Në repartin C të IPFK-së janë të vendosur pacientët që sillen nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, të cilët janë ose të paraburgosur, kur gjykata kërkon

³⁵⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 18 dhe nenet 87-90.

³⁶⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nenet 506-508.

³⁶¹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 174-180.

³⁶² Kodi Penal i Kosovës, neni 89.

³⁶³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 508, paragrafi 4.

vlerësimin e gjendjes mendore (ekspertizë psikiatrike), ose të dënuar që sillen nga burgjet për trajtim.

Kushtet e akomodimit të pacientëve në IPFK në përgjithësi janë shumë të mira. Dhomat janë me nga dy shtretër, pacientët kanë qasje në dritë natyrale, ventilim, dhomat posedojnë alarm, tavolina të vogla, shtretër me dyshekë, mjetet higjienike dhe pajisje përcjellëse. Dhomat e pacientëve kanë edhe ormanë, por janë të dëmtuar dhe nuk mund të mbyllen.

Në mure të dhomave ka foto të pacientëve ose shkrime. Po ashtu ka hapësirë për qëndrimin ditor të pajisur me karrige, televizion, lojëra (shahu) si dhe hapësirë të përshtatshme për kuzhinë. MKPT-ja ka vërejtur se banjat janë të vendosura në dhoma, por nuk kanë perde, gjë që do t'u sigurote pacientëve privatësi. MKPT-ja konsideron se në një situatë të tillë shkelet privatësia e pacientit dhe se IPFK-ja duhet t'i marrë në konsideratë çështjet e privatësisë së pacientëve.

Në IPFK, përveç vlerësimit, ofrohet edhe trajtimi me medikamente dhe trajtimi psiko-social. Furnizimi me barëra nuk është i mirë, familjarët shpesh detyrohen t'i blejnë ato. Dosjet e pacientëve janë të vendosura në një hapësirë të hapur, ku është edhe qëndrimi ditor. Historitë e pacientëve janë të plotësuara, por jo edhe aq të detajuara në shënimet përcjellëse shëndetësore. Po ashtu ekziston libri i terapisë, libri i lëndimeve/incidenteve, forma e monitorimit të izolimit dhe formulari për rishikimin e incidenteve.

Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitetet si lojëra, shikim televizioni, vizatime, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitore të IPFK-së), seanca individuale me psikologun etj. Orari i aktiviteteve ditore është i vendosur në vende të dukshme, por ky orar është uniform dhe nuk ka plane individuale të aktiviteteve të listuara për pacientët.

Për vikendet terapeutike merret vendimi nga komisioni multidisiplinor. Dalja ditore (në shëtitore) brenda institucionit, për pacientët e repartit B, është e mundur tërë ditën, kurse për pacientët e repartit D – dy herë në ditë, në mëngjes dhe mbrëmje.

MKPT-ja, përkundër konstatimit të ekzistimit të disa aktiviteteve psiko-sociale, shpreh brengosjen se ato janë të zbehta dhe rutinore. Siç theksohet edhe në raportin e KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2015, në IPFK nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit me përfshirje të pacientit, nuk ka një përfshirje në një rang më optimal të aktiviteteve terapeutike, rehabilituese dhe rekreative.³⁶⁴

IPFK-ja nuk ka ndonjë plan parandalues specifik lidhur me vetëvrasjet. MKPT-ja konsideron se, pavarësisht faktit se nuk kanë pasur raste të vetëvrasjeve, është e nevojshme të hartohet një udhërrëfyes i qartë, i cili efektivisht do të ndihmojë në identifikimin e rasteve me tendenca suicidale dhe hartimin e një skeme observimi të veçantë, me mbështetjen imediate psikologjike/psikiatrike.

³⁶⁴ Raporti i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në shtator 2016. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

Përmes raportit me rekomandime,³⁶⁵ pas vizitës në IPFK, MKPT-ja ka shprehur shqetësimin për shkak se personeli i sigurisë (përfshirë edhe personelin e sigurisë të ShKK), nuk kanë kryer trajnime adekuate për punë me këtë kategori të pacientëve. Një gjë e tillë u konstatua gjatë intervistave me zyrtarë të sigurimit privat dhe të ShKK-së. MKPT-ja vëren se KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, autoriteteve kompetente u ka rekomanduar si në vijim:

"Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës konsideron se është e rëndësishme cruciale që personeli i cili caktohet në detyra të ndërlidhura me sigurinë në institucione psikiatrike të përzgjidhet me kujdes dhe që para se të caktohen në detyra të tilla, ata t'ju nënshtrohen trajnimeve të duhura. Për më shumë, gjatë kryerjes së detyrës, ata duhet të mbikëqyren për së afërmi dhe të jenë nën autoritetin e personelit mjekësor të kualifikuar." MKPT-ja konsideron se IPFK-ja duhet të veprojë në pajtim me rekomandimin e lartpërmendur.

Përveç kësaj, kryerja e detyrave të sigurimit, si p.sh. bastisja e trupit dhe e dhomave, vazhdojnë të bëhen nga ana e stafit të infermierëve, ndonëse nuk janë trajnuar specifikisht për këtë. Kjo cenon mbajtjen e raportit ndërmjet pacientëve dhe personelit mjekësor. MKPT-ja konsideron se IPFK-ja duhet t'i japë fund një praktike të tillë, pasi që personeli mjekësor, përveç tjerash, nuk janë të trajnuar për të kryer detyra të tilla. Një rekomandim i tillë u dha edhe nga KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë.³⁶⁶

Kontakti me botën e jashtme

Pacientët në repartin B kanë kontakt përmes telefonit me familjarët e tyre, po ashtu, ata mund të kenë vizitat nga familjarët 1-2 herë në javë, nga 30 minuta.

Sa i përket së drejtës për të parashtruar ankesë, MKPT-ja ka vërejtur se në IPFK është instaluar një kuti e ankesave, të cilën e hap një autoritet i caktuar brenda Ministrisë së Shëndetësisë. Megjithatë, MKPT-ja konsideron se pacientëve duhet t'u mundësohet parashtrimi i anekses pranë menaxhmentit të IPFK-së, në mënyrë konfidenciale, duke instaluar një kuti të ankesave, të cilën do të mund ta hapte vetëm personeli i caktuar. Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë personat e akomoduar në IPFK dhe të korrespondojnë me ta pa paralajmërim paraprak. Po ashtu, pacientët mund t'i drejtohen MKPT-së edhe përmes telefonit. Përveç kësaj, Avokati i Popullit në IPFK ka vendosur një kuti të ankesave, të cilën e hap vetëm personeli i caktuar i Avokatit të Popullit.

Mjetet e kufizimit

Në repartin e trajtimit të detyrueshëm (B) janë dy dhoma të izolimit, të cilat janë me mure të forta dhe kanë vetëm një dyshek. Stafi ka qasje direkte vizive tek pacientët. Në repart e

³⁶⁵ Raporti me Rekomandime për vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike, publikuar më 28 gusht 2018, shih në: <https://www.oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>.

³⁶⁶ Për më shumë shih Raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës në Kosovë në vitin 2015 në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

kanë një këmishë për fiksion mekanik, por nuk është përdorur asnjëherë. Nga dokumentacioni, MKPT-ja konstatoi se një pacient ka qëndruar 3 ditë në izolim, kurse një pacient tjetër në intervistë pohoi se ka qëndruar 6 ditë në izolim. Sipas pohimeve të pacientit dhe të personelit, arsyeja e qëndrimit gjashtë ditorë në izolim ishte gjendja e përkeqësuar shëndetësore, si dhe kërcënimet ndaj personelit. IPFK-ja ka formularin e monitorimit të izolimit, ku stafi, pas monitorimit, çdo 15 – 30 minuta e nënshkruan formularin në fjalë.

MKPT-ja ka vërejtur se përdorimi i dhomave të izolimit është i tepruar dhe me kohëzgjatje që nuk mund të arsyetohet. Standardet e KPT-së precaktojnë se nuk lejohet përdorimi i izolimit si ndëshkim³⁶⁷. Përdorimi i izolimit duhet të jetë sa më i shkurtër dhe sa më i arsyeshëm. MKPT-ja, gjatë kontrollit të dokumentacionit, ka vërejtur se vendimi dhe arsyetimi për vendosje në dhomë të izolimit nuk ishte shënuar nga mjeku në dosjen e pacientit, por vetëm në librin dhe formularin e izolimit.

Më tej, KPT-ja rekomandon se çdo element i çdo lloji të kufizimit duhet të shënohet qartë në regjistrin specifik, por edhe në dosjen e pacientit. Shënimet e tilla përfshijnë kohën e fillimit dhe përfundimit të kufizimit, rrethanat, arsyet, emrin e mjekut, lëndimin e pësuar etj.

MKPT-ja ka vërejtur se IPFK-ja ka një udhërrëfyes bazik për vendosjen në dhoma të izolimit (Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të punës në repartin B). Ky dokument është shumë i thjeshtë dhe përmban vetëm një paragraf. Nuk ka udhërrëfyes për metodat e tjera të kufizimit. MKPT-ja vëren se KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, në pjesën për vizitën në IPFK, ka dhënë rekomandime konkrete se çka duhet të përmbajë ky udhërrëfyes.³⁶⁸

Rishikimi i vendimeve nga gjykatat kompetente

MKPT-ja vëren se neni 89, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës, shprehimisht përcakton se gjykata do ta pushojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, pasi të ketë vërtetuar se ka pushuar nevoja për trajtim në institucionin e kujdesit shëndetësor.

Ndërsa neni 176 i Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, përcakton se së paku një herë në gjashtë muaj, çdo pranim i pavullnetshëm duhet të rishikohet nga gjykata, bazuar në raportin e përpiluar nga menaxhmenti i institucionit shëndetësor dhe mendimit të një eksperti të pavarur, i cili nuk është i punësuar në institucionin shëndetësor.

Nga analizimi i dokumentacionit relevant, MKPT-ja ka konstatuar se IPFK-ja, në baza të rregullta dhe në pajtim me dispozitat e legjislationit të lartpërmendur, ka dërguar raporte relevante mjekësore, në të cilat është vlerësuar gjendja shëndetësore e pacientit të

³⁶⁷ Standardet e KPT-së, publikuar më 21 mars 2017, shih në: <https://rm.coe.int/16807001c3>.

³⁶⁸ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, pjesa C, paragrafët 96-98, për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

pranuar, bazuar në kërkesat e gjykatave kompetente. Sipas pohimeve të menaxhmentit të IPFK-së, ka probleme me vendosjen jo të vullnetshme të pacientëve me urdhër gjykate, për shkak të çrregullimit mendor, pasi që, përkundër faktit se bëhet rishikimi i gjendjes shëndetësore të pacientit nga personeli mjekësor dhe gjykata njoftohet me shkrim se gjendja mendore e pacientëve është përmirësuar dhe se duhet ndryshuar masa përshtatshmërisht, në disa raste gjykatat nuk janë azhure dhe nuk kthejnë përgjigje.

Sa i përket së drejtës për trajtim është evidente se në të shumtën e rasteve pacientët informohen, por pa u dhënë mundësia e dhënies së pëlqimit me shkrim apo së drejtës për refuzim të trajtimit. E njëjta situatë është konstatuar edhe në raportin e KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2015.³⁶⁹

Në raportin në fjalë, KPT-ja thekson se pranimi i personit të caktuar në një institucion psikiatrik pa vullnetin e tij/saj, përfshirë edhe pranimin bazuar në urdhrin e gjykatës për “*trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim*”, nuk duhet të përjashtojë kërkimin e pëlqimit të informuar për trajtim. Çdo pacient duhet të informohet për çdo trajtim apo intervenim mjekësor që synohet t’i jepet. Çdo derogim nga ky parim themelor duhet të bazohet në ligj dhe t’u referohet rrethanave të jashtëzakonshme dhe të definuara në mënyrë të qartë dhe të prerë.

Po ashtu, nuk ka evidenca se është ofruar shpjegimi me shkrim për arsyet e trajtimit të pavullnetshëm, ashtu siç parashihet në nenin 21, paragrafi 1.4 të Ligjit për Shëndetin Mendor, i cili shprehimisht përcakton se pacientit të trajtuar pa vullnetin e tij/saj, ndër të tjera, duhet t’i shpjegohen me shkrim, brenda 48 orëve, arsyet e trajtimit të pavullnetshëm. MKPT-ja rekomandon që kjo situatë duhet të rregullohet në mënyrë urgjente nga ana e institucionit.

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore

MKPT-ja, gjatë vizitës, ka vërejtur se shërbimet mjekësore pacientëve në IPFK u jepen pa prezencë të zyrtarëve të sigurimit, përveç nëse personeli mjekësor, në raste të caktuara, shprehimisht e kërkon një gjë të tillë.

Rekomandimi lidhur me vizitën në IPFK drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë:

- Të njoftohet MKPT-ja e Avokatit të Popullit lidhur me çështjen e statusit ligjor të IPFK-së (Në pritje për implementim).

Rekomandimet lidhur me vizitën në IPFK drejtuar Shërbimi Spitalor Klinik Universitar të Kosovës:

- Të furnizohet IPFK-ja rregullisht me barëra dhe gjëra tjera të nevojshme për kryerjen e punës. (Në pritje për implementim).

³⁶⁹Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, i publikuar në vitin 2016, paragrafi 101. Për më shumë: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

- Të zbatohen rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, sa i përket përbajtjes së Udhërrëfyesit për përdorim të mjeteve të kufizimit. (Në pritje për implementim).
- Të shtohen aktivitetet psiko-sociale. (Në pritje për implementim).
- Të instalohet në IPFK sistemi (një kuti ankesash), i cili ua mundëson pacientëve që menaxhmentit t'ia drejtojnë ankesat e tyre në mënyrë konfidenciale dhe në kuti të ankesave të ketë qasje vetëm personeli i caktuar. (Në pritje për implementim).
- Personeli mjekësor të mos kryejë detyra të sigurisë (shih paragrafin 45 të këtij raporti) (Në pritje për implementim).
- Personeli i sigurisë në IPFK të përzgjidhen me kujdes dhe t'u nënshtrohet trajnimeve adekuate para se të marrin përsipër detyrat e tilla të sigurisë (Në pritje për implementim).

Klinika Psikiatrike

Në bazë të Ligjit për Shëndetësinë, nenit 13 të Ligjit për Shëndetin Mendor të Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Statutit të ShSKUK-së, Klinika Psikiatrike është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas ligjit në fuqi, ajo ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë), por është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regjionin e Prishtinës, në mungesë të një spitali të përgjithshëm. Të gjitha repartet (përveç repartit të urgjencës dhe kujdesit intensiv psikiatrik) janë të hapura dhe bëjnë trajtimin me vullnetin e pacientëve dhe në raste të caktuara edhe pa vullnetin e tyre, bazuar në vendimin e gjykatës kompetente.

MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se dhomat e pacientëve në përgjithësi janë të mëdha, me nga dy dhe tre shtretër, kanë dritë të mjaftueshme, ndërsa dritaret mund të hapen dhe janë të thyeshme. Orenditë (dollapët për rroba) ishin të gjitha pothuajse të dëmtuara, muret e lyera, por tashmë të vjetërsuara, ka 6 vjet që nuk ka pasur renovime, ndërsa ujë të ngrohtë ka kohë pas kohe. MKPT-ja ka vërejtur se nuk ka piktura në mure, nuk ka komodina për gjërat personale, tualeti nuk ka derë që mbyllet.

MKPT-ja konsideron se duhet të ndërmerren masa për krijimin e një mjedisi sa më familjar dhe terapeutik. Lyerja, rregullimi i orendive të dëmtuara, dekorimi, vendosja e komodinave personale duhet të bëhet me prioritet. MKPT-ja vëren se Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), gjatë vizitës në Kosovë në vitin 2010, e ka vizituar edhe Klinikën Psikiatrike. Përkitazi me kushtet e jetesës së pacientëve, KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë, kushtet e jetesës së pacientëve në këtë Klinikë i përshkruan si të këqija dhe të rënda, në të cilat nuk mund të pritët krijimi i një mjedisi terapeutik.³⁷⁰ Prandaj, MKPT-ja konsideron se në Klinikën Psikiatrike duhet të bëhen renovime sa më shpejt që është e mundur.

Reparti i urgjencës dhe i kujdesit intensiv psikiatrik

³⁷⁰ Raporti i Komitetit Evropian për vizitën në Kosovë, 2010, paragrafi 79, në: <https://rm.coe.int/16806972c7>.

Reparti i urgjencës dhe i kujdesit intensiv psikiatrik (në tekstin e mëtejshëm *UKIP*) është njësi e mbyllur dhe funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike. Në këtë repart trajtohen rastet e çrregullimeve të ndryshme psikotike, të çrregullimeve bipolare dhe çrregullimeve të personalitetit, që nuk mund të trajtohen në repartet tjera. Ky repart është i vetmi në tërë territorin e Kosovës. Në spitalet tjera regjionale, repartet psikiatrike nuk i kanë funksionale dhomat e veçanta ku trajtohen rastet urgjente. Rastet e tilla, nga tërë Kosova, sillen në repartin UKIP të Klinikës Psikiatrike në Prishtinë.

MKPT-ja konsideron se repartet psikiatrike në spitalet tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente. Një konkludim i tillë doli edhe nga konferenca e organizuar nga Avokati i Popullit dhe Këshilli i Evropës, lidhur me trajtimin e pavullnetshëm të rasteve në institucionet e shëndetit mendor, e cila u mbajt në Budva (Mali i Zi) më 19 shtator 2018. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga pacientët e intervistuar për keqtrajtim fizik apo ushtrim të dhunës, si dhe sjellje të cilat do të përbënin fyerje të dinjitetit të pacientëve nga personeli i këtij reparti. Gjatë intervistave, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa apo njoftime nga pacientët për dhunë ndërmjet pacientëve të akomoduar në këtë repart.

MKPT-ja u njoftua se pacientët në përgjithësi sillen këtu nga familjarët ose policia dhe janë pacientë të cilët akomodohen pa vullnetin e tyre. Ka edhe raste kur sillen pacientë me vendim të gjykatës. Sipas Drejtorisë, pas pranimi të pacientit, të nesërmen bëhet vlerësimi i gjendjes së tij/saj shëndetësore nga komisioni përkatës mjekësor.

MKPT-ja ka vërejtur se gjykata kompetente nuk njoftohet për pranimin e pacientit për trajtim të pavullnetshëm. MKPT-ja vëren se nenet 22-23 të Ligjit për Shëndetin Mendor e rregullojnë çështjen e pranimi të pavullnetshëm të pacientëve, pa vendim të gjykatës kompetente. Neni 22, paragrafi 4 përcakton: *“Mjeku në shërbimin e shëndetit mendor të specializuar me shtretër, që vendos për trajtimin e pavullnetshëm, përshkruan në mënyrë të hollësishme në kartelën mjekësore të gjitha procedurat e ndjekura dhe siguron njoftimin e shefit të shërbimit për shtrimin e pavullnetshëm, brenda njëzet e katër (24) orëve.”*

MKPT-ja vëren se kjo kërkesë ligjore respektohet nga shefi i repartit UKIP dhe dërgohet informacioni relevant tek drejtori i klinikës. Sipas Drejtorisë, njoftimi për pranimin e pacientit për trajtim të pavullnetshëm më pas i dërgohet zyrës ligjore të ShSKUK-së, por nuk i dërgohet gjykatës kompetente, ashtu siç parashihet me Ligjin për Shëndetin Mendor. Sipas Drejtorisë, kjo ndodh për shkak të mungesës së komunikimit ndër-institucional, respektivisht komunikimit ndërmjet ShSKUK-së dhe gjykatës kompetente.

Megjithatë, MKPT-ja vëren se neni 23, paragrafi 4 i Ligjit të Shëndetit Mendor përcakton: *“Në rast pas rivlerësimit, shefi i shërbimit konstaton se ekzistojnë shkaqet që personi të mbahet në kushte trajtimi të pavullnetshëm, personi vazhdon të marrë trajtimin e pavullnetshëm në këtë shërbim. Pas këtij vendimi, brenda dyzet e tetë (48) orëve, udhëheqësi i institucionit, ku ofrohet shërbimi i shëndetit mendor të specializuar me*

shtretër, referuar nga shefi i shërbimit, i drejtohet gjykatës themelore për të vlerësuar procedurën e kryer. Një kopje e kërkesës i vihet në dispozicion pacientit, një familjari të afërt dhe/ose përfaqësuesit ligjor të tij.” MKPT-ja vëren se kjo dispozitë qartazi e obligon institucionin shëndetësor që, në raste të pranimin të pacientit për trajtim të pavullnetshëm, ta njoftojë gjykatën kompetente për procedime të mëtejme.

Lidhur me çështjen e trajtimit të pavullnetshëm dhe aspektet të tjera në lidhje me këtë, MKPT-ja e Avokatit të Popullit dhe Këshilli i Evropës, në punëtorinë e organizuar në Budva të Malit të Zi, i ftuan të gjithë akterët relevantë nga gjykatat kompetente, prokuroritë dhe institucionit të shëndetit mendor. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se duhet të rritet niveli i komunikimit ndërinstitucional, në mënyrë që të arrihet zbatimi efektiv i ligjeve në fuqi dhe të respektohen të drejtat e njeriut të kësaj kategorie, të garantuara me legjislacionin vendor dhe konventat ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Kushtet e jetesës në repartin UKIP

MKPT-ja vlerëson se kushtet e banimit në përgjithësi janë të mira. Është një ndërtesë e re, e ngrohtë dhe me dritë natyrale. Dhomat janë me nga dy shtretër, me hapësirë të përshtatshme dhe ajrosje. MKPT-ja ka vërejtur se muret ka kohë që nuk janë lyer, disa xhama të dritareve janë të krisura, dritaret kanë grila hekuri, banjat kanë lagështi. Tavolinat e vogla janë hequr, sepse janë thyer nga pacientët, po ashtu çelësat e dollapëve të rrobave janë hequr, për arsye se janë dëmtuar nga pacientët. Hapësirat e dhomave nuk kanë dekorime, disa piktura janë të vendosura në mure të dhomës së ditës dhe në sallën e ushqimit.

Trajtimi dhe aktivitetet në repartin UKIP

Trajtimi psiko-farmakologjik është trajtimi kryesor në këtë repart. Furnizimi me barëra herë pas here nuk është i mirë, ka periudha kur nuk ka gjilpëra dhe shiringa, të cilat detyrohen familjarët t'i blejnë. Por ka edhe periudha kur furnizimet janë të rregullta dhe në nivel të kënaqshëm. MKPT-ja konsideron se është obligim i autoriteteve kompetente ta furnizojnë pa ndërprerë këtë repart me barëra të nevojshme për trajtim të pacientëve.

MKPT-ja ka vërejtur se aktivitetet psiko-sociale nuk janë të mjaftueshme. Po ashtu, mungon ekipi multidisiplinor si: psikologu, punëtori social, terapist okupacional, mungon plani individual i trajtimit. MKPT-ja konsideron se autoritetet dhe institucionet duhet të sigurojnë llojshmërinë e nevojshme të profesionistëve psiko-socialë, si parakusht për një trajtim adekuat të pacientëve. Sa i përket personelit të sigurimit në këtë repart, duhet të kenë trajnime adekuate për punë me këtë kategori të pacientëve.

Regjimi në repart

Pacientët në repart gjatë ditës i nënshtrohen një rutine ditore, e cila konsiston aktivitetet, siç janë: ajrosja (dy orë në ditë, por pacientët mund të qëndrojnë edhe më gjatë), shikimi i TV-së, ushqimi, dalja në kopsht.

Kontakti me boten e jashtme

Vizitat familjare kryhen në hyrje të repartit, ku është vendosur një tavolinë dhe disa karrige. Kanë të drejtë të pranojnë vizita çdo ditë nga ora 12:00 deri në orën 15:00. Kohëzgjatja e vizitës është 30 minuta, e cila realizohet me lejen e mjekut. Nuk u lejohet komunikimi përmes telefonit. Kurse familjarët nga jashtë mund ta thërresin mjekun e repartit, por jo pacientin.

Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, lidhur me trajtimin e pavullnetshëm, theksojnë se kontakti i pacientit me botën e jashtme është esencial jo vetëm në kuptim të parandalimit të keqtrajtimit, por edhe nga pikëpamja terapeutike. Pacientët duhet ta kenë mundësinë të dërgojnë dhe të pranojnë korrespondencë, të kenë qasje në telefon dhe të pranojnë vizita nga familja dhe miqtë e tyre.³⁷¹

Mjetet e kufizimit

Në repart nuk përdoret kufizimi mekanik, por vetëm ai farmakologjik. Reparti UKIP posedon katër dhoma të izolimit, në të cilat është i vendosur nga një dyshek dhe një batanije, nuk kanë tualete, kanë hapësirë të mjaftueshme, dhomat janë të zymta, ndërsa në njëërën nga to ekipi monitorues ka vërejtur lagështi. MKPT-ja ka vërejtur se këto dhoma gjenden larg personelit shëndetësor, ndërsa zilja për ta ftuar personelin mjekësorë është jashtë funksionit.

MKPT-ja konsideron se, përderisa repartit e përdorë masën e izolimit, ky mjet kufizimi duhet të jetë subjekt i një politike të detajuar për pacientët, të cilët vendosen në dhoma izolimi, e cila duhet të përmbajë informatat për situatat kur mund të përdoret izolimi, objektivat e synuara, kohëzgjatjen dhe nevojën për shqyrtim të rregullt të vendimit për izolim, ekzistimi i kontakteve të mirëfillta njerëzore, nevojën që personeli të jetë në mënyrë të veçantë vigjilentë.

Çdo rast i përdorimit të kufizimit fizik të pacientit (kontrolli manual, përdorimi i instrumenteve të kufizimit fizik, izolimi) duhet të regjistrohet në regjistër specifik të krijuar për këtë qëllim (po ashtu edhe në dosjen e pacientit). Të dhënat duhet të përmbajnë kohën kur masa ka filluar dhe ka mbaruar, rrethanat e rastit, arsyet e zbatimit të kësaj mase, emrin e mjekut i cili e aprovon masën e tillë, si dhe të dhënat për çfarëdo lëndimi të shkaktuar ndaj pacientit apo personelit. MKPT-ja ka vërejtur se repartit nuk ka regjistër të veçantë për personat të cilët vendosen në izolim.

Procedura e ankesave

MKPT-ja konsideron se, si në çdo vend tjetër të privimit nga liria, një procedurë efektive e parashtrimit të ankesave është garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik në institucionet psikiatrike. Prandaj, duhet të bëhen aranzhime specifike për t'ua mundësuar pacientëve të parashtrajnë ankesa tek organi kompetent i themeluar për këtë dhe që të

³⁷¹Shih në: <https://rm.coe.int/16806cd43e>.

komunikojnë në mënyrë konfidenciale me autoritetin e duhur jashtë institucionit psikiatrik.

Në repart ekziston kutia e ankesave e Klinikës Psikiatrike, e cila, sipas Drejtorisë, hapet nga një zyre përgjegjëse në kuadër të QKUK-së. Megjithatë, për MKPT-në mbeti e paqartë procedura e parashtrimit të ankesës së pacientit. Prandaj, përmes raportit me rekomandime u kërkua nga ShSKUK-ja njoftimi me shkrim lidhur me këtë çështje.

Rekomandimet për Klinikën Psikiatrike drejtuar Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK):

- Të bëhen renovimet e duhura në Klinikën Psikiatrike (Në pritje për implementim).
- Të rritet numri i aktiviteteve të mirëfillta psiko-sociale (Në pritje për implementim).
- Të funksionalizohet ekipi multidisciplinar në repartet e Klinikës Psikiatrike (Në pritje për implementim).
- Të bëhet furnizimi i pandërprerë i Klinikës Psikiatrike me barëra (Në pritje për implementim).
- Të përpilohet Udhërrëfyesi për parandalim të vetëvrasjeve (Në pritje për implementim).
- Të ofrohen trajnime adekuate për personelin (Në pritje për implementim).
- Të shtohet numri i personelit sipas vlerësimit dhe nevojës (Në pritje për implementim).
- Nga pacienti të merret miratimi i informuar për trajtim në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor (Në pritje për implementim).
- Të njoftohen pacientët për të drejtat e tyre në formë të shkruar (Në pritje për implementim).
- Të përpilohet dhe të përdoret regjistër i veçantë për pacientët, të cilëve u shqiptohet masa e izolimit (Në pritje për implementim).
- Repartet psikiatrike në spitalet tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente psikiatrike (Në pritje për implementim).

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë në Shtime

Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronikë Psikiatrikë në Shtime (QIRSKP) funksionon në kuadër të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) dhe ofron shërbime 24 orë në ditë. QIRSKP-ja është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë Qendër janë kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, si *Schizophreniae*. Gjatë vizitës së MKPT-së, në këtë institucion ndodheshin 61 rezidentë, prej tyre 32 të gjinisë mashkullore, 29 të gjinisë femërore, moshë mesatare sillej rreth 54 vjeç. Kapaciteti zyrtar i institucionit është për 65 persona.

Kushtet e akomodimit

MKPT-ja vlerëson se kushtet e banimit në QIRSKP janë mesatare. Megjithatë, janë të nevojshme renovime, si: lysterje, rregullim i elementeve të tualeteve, vendosja e pikturave në mure dhe komodinat personale. MKPT-ja konsideron se ka mungesë të privatësisë tek tualetet që nuk kanë fare perde dhe kjo çështje duhet të zgjidhet urgjentisht.

Kuzhina u rinovua dhe u lëshua në përdorim në korrik të vitit 2018 dhe është e pajisur me të gjitha pajisjet moderne. Përmes raportit me rekomandime, i publikuar më 6 mars 2017, MKPT-ja e Avokatit të Popullit rekomandoi ndërmarrjen e masave për renovimin e kuzhinës. Përmes këtij raporti, MKPT-ja e Avokatit të Popullit përshëndet zbatimin e këtij rekomandimi.

Kujdesi shëndetësor

MKPT-ja u njoftua se në QIRSKP ofrohen shërbime të rregullta psikiatrike, ku këto shërbime i kryen drejtori i Qendrës, pasi që me profesion është psikiatër, ndërsa në rast nevojë, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, Spitali Rajonal në Ferizaj dhe Qendra Klinike Universitare në Prishtinë.

Përdorimi i medikamenteve antipsikotike, antidepressive dhe anksiolitike nga ekzaminimi i disa dosjeve mjekësore, duket se është i arsyeshëm dhe i bazuar në evidenca. Sipas personelit, përdorimi i barërave është reduktuar shumë dhe janë më racional në përshkrimin e tyre. Zakonisht i kanë preparatet nga lista esenciale, si: haloperidol, moditen, risperidon, olanzapineetj (10 pacientë ishin duke u trajtuar me haloperidol depo, kurse 15 me moditen depo). Sipas informatave të marra, ka raste kur QIRSKP-i ballafaqohet me mungesë të barnave. MKPT-ja konsideron se është përgjegjësi e autoriteteve kompetente që ta furnizojnë këtë institucion rregullisht me barnat e nevojshme.

Trajtimi dhe aktivitetet

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur një qasje të afërt dhe miqësore nga ana e stafit ndaj pacientëve, pra kryesisht vërehej një klimë pozitive brenda institucionit. Pacientët duken mirë për nga veshja dhe higjiena. MKPT-ja nuk ka hasur në shenja të lëndimeve. Nga intervistat me pacientë nuk u pranua ndonjë ankesë për ndonjë formë të keqtrajtit apo sjellje të personelit të cilat cenojnë dinjitetin e rezidentëve.

Aktivitetet psiko-sociale, që zakonisht kryhen, janë: piktura, muzika, ekskursionet. Institucioni ka një tavolinë për aktivitete, TV nuk punonte në repartin A2, nuk ka lojëra as libra, pasi që janë dëmtuar. Vizitat e familjarëve janë të lejuara kurdo që duan. KPT-ja thekson se mbajtja e kontakteve me botën e jashtme është thelbësore jo vetëm për parandalimin e keqtrajtit, por edhe nga një pikë vështrim terapeutik.³⁷² MKPT-ja vëren se plani i aktiviteteve nuk është i shkruar, as planet individuale nuk ekzistojnë, ndërsa

³⁷² Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti i 8-të i Përgjithshëm, paragrafi 54.

buxheti për aktivitete psiko-sociale është i vogël. Vikendet terapeutike janë shumë të rralla, për shkak se familjet nuk shprehin interesim.

MKPT-ja shpreh brengosjen për faktin se numri dhe cilësia e aktiviteteve psiko-sociale dhe rekreative është shumë i mangët. Po ashtu, nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit me përfshirje të pacientit. MKPT-ja, në raportin me rekomandime të publikuar më 26 tetor 2018³⁷³, ka rekomanduar fokusimin në planifikimin e ndërtimit të një njësie vokacionale, por kjo nuk është bërë deri më tani. Institucioni duhet të angazhohet me përparësi në shtimin e aktiviteteve psiko-sociale dhe përfshirjen e të gjithë pacientëve në mënyrë optimale në këto aktivitete.

Sipas KPT-së, trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një qasje të individualizuar, gjë që nënkupton hartimin e një plani trajtimi për çdo pacient, i cili plan duhet të përfshijë aktivitete rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë psikoterapi individuale, terapi në grup, art, teatër, muzikë dhe sport. Pacientët duhet të kenë qasje të rregullt në dhoma argëtimi të pajisura përshtatshëm dhe të kenë mundësi të dalin në ambient të hapur.³⁷⁴

MKPT-ja evidentoi 4 raste të cilave gjykata ua ka caktuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në QIRSKP, përkundër faktit se institucioni nuk ka kushte për t'i menaxhuar. MKPT-ja konsideron se QIRSKP-i nuk ka as bazë ligjore dhe as kapacitete për të vazhduar trajtimin e rasteve të tilla. MKPT-ja inkurajon stafin e QIRSKP-it, që rregullisht t'i njoftojnë gjykatat për gjendjen shëndetësore të këtyre pacientëve.

Lidhur me çështjen e shqyrtimit efektiv të rasteve të tilla, rasteve të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe trajtimeve të tjera në institucionet e shëndetit mendor, nga gjykatat kompetente dhe institucionet tjera, të cilat në një fazë të caktuar mund të përballen me persona me çrregullime mendore, Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, më 18 shtator 2018, kanë mbajtur punëtorinë, ku janë ftuar të gjithë përfaqësuesit e institucioneve relevante, përfshirë psikiatër, gjyqtarë, prokurorë, me qëllim të diskutimit dhe përmirësimit të gjendjes në këtë aspekt.

Gjatë kësaj punëtorie u arrit në përfundimin se Ministria e Shëndetësisë duhet të përpilojë listën e institucioneve të shëndetit mendor, ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Trajtimi i rasteve që nuk janë në kapacitetet e një institucioni, përbën parakusht për keqtrajtim ose neglizhencë.

Parandalimi i vetëvrasjeve

³⁷³ Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmurve Kronikë Psikiatrikë në Shtime, publikuar më 26 tetor 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/10/26/-1raport-me-rekomandime-i-mkpt-lidhur-me-viziten-ne-shtime/>.

³⁷⁴ Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12].

Sipas Drejtorisë, kanë ndodhur dy vetëvrasje pas luftës, ndërsa tentim-vetëvrasjet janë të shpeshta. Gjatë vitit 2018, në këtë institucion kanë ndodhur dy raste të vdekjeve. QIRSKP nuk ka ndonjë plan parandalues specifik lidhur me vetëvrasjet. MKPT-ja konsideron se është e nevojshme të hartohet një udhërrëfyes i qartë, i cili efektivisht do të ndihmojë në identifikimin e rasteve me tendenca suicidale, hartimin e një skeme të veçantë observimi, me mbështetjen imediate psikologjike/psikiatrike.

Personeli i QIRSKP

Personeli i QIRSKP-it ka 39 të punësuar, 1 psikiatër, i cili është edhe drejtori i institucionit, 9 infermierë, 16 ndihmës mjekësorë, 7 punëtorë administrativë dhe 7 punëtorë të shërbimeve teknike. MKPT-ja konsideron se numri i stafit nuk është adekuat. Po ashtu, mungojnë profesionistët si p.sh. psikolog, terapistët okupacionalë etj. MKPT-ja, në raportin me rekomandime të publikuar më 6 mars 2017, ka rekomanduar punësimin e një psikologu klinik dhe një punëtor social shtesë. Gjatë vizitave ad-hoc, MKPT-ja u njoftua se institucioni ka filluar procedurat e rekrutimit të psikologut klinik dhe punëtorit social. MKPT-ja, gjatë vizitave përcjellëse, do të monitorojë implementimin e rekomandimeve.

Mjetet e kufizimit

Sa i përket mjeteve të kufizimit, neni 27 i Ligjit nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, përcakton se kufizimi fizik i personave me çrregullime mendore zbatohet në institucionet e shëndetit mendor të specializuar me shtretër dhe përfshin, sipas protokollit përkatës, elementet e mëposhtme: mbajtja me forcë e personit, përdorimi i detyruar i medikamenteve, imobilizimin, izolimin.

Bazuar në pohimet e Drejtorisë së QIRSKP-it dhe dosjeve të rezidentëve, në këtë institucion nuk përdoren mjetet mekanike të kufizimit fizik, por vetëm ato kimike, psiko-terapia, intervenimet farmako-terapeutike, nuk përdoren masat izoluese, sepse nuk ka kushte për të zbatuar masë të tillë.

Sa i përket pëlqimit për trajtim dhe qëndrim, pëlqimi jepet nga familjari ose kujdestari ligjor i rezidentit, në rastet kur me vendim të organit kompetent rezidentit i është hequr zotësia e veprimit.

Në repart nuk është e vendosur karta e të drejtave të pacientëve dhe as fletushka për këtë qëllim, vetëm në ambulantë është e vendosur karta e të drejtave. MKPT-ja konsideron që informacioni lidhur me të drejtat e pacientëve duhet të jetë i vendosur përshtatshëm, në vende të dukshme, të mbështetet me fletushka, si dhe t'u shpjegohet sa më përshtatshëm pacientëve. Vizitat e familjarëve janë të lejuara në çdo kohë. Sipas personelit të QIRSKP-it, ka edhe raste kur kujdestari ligjor, i caktuar me vendim të organit kompetent, nuk i përmbush detyrat e tij ndaj rezidentit.

QIRSKP-i dhe institucionet tjera të përkujdesjes sociale (MPMS, qendrat për punë sociale) duhet t'i shqyrtojnë dhe t'i shfrytëzojnë të gjithë mekanizmat dhe mundësitë ligjore për ta përmirësuar këtë çështje, ashtu siç e përcakton neni 16, paragrafi 3 të Ligjit

për Shëndetin Mendor. Ndërsa Ministria e Shëndetësisë duhet t'i nxjerrë aktet nënligjore, ashtu siç parashihet në nenin 9, paragrafi 4 të Ligjit për Shëndetin Mendor.

Në QIRSKP, Institucioni i Avokatit të Popullit ka vendosur kutitë e ankesave, të cilat mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për ankuesit ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. MKPT-ja nuk ka pranuar asnjëherë ankesë nga rezidentët apo familjarët e tyre. MKPT-ja inkurajon stafin që t'i informojë më shumë familjarët e rezidentëve për mundësinë e parashtrimit të ankesave përmes kutisë së ankesave të vendosur në QIRSKP.

De-institucionalizimi, që është një nga preokupimet dhe detyrat e parashikuar për QIRSKP, ka ngecur. Për aq sa personeli është në dijeni, vetëm 3 raste janë kthyer në komunitet. MKPT-ja vlerëson se Ministria e Shëndetësisë duhet ta hartojë një politikë të qartë të de-institucionalizimit, duke ndërtuar shërbime efektive në komunitet. MPMS-ja dhe qendrat për punë sociale duhet të përfshihen në ofrimin e burimeve të nevojshme efektive në mbështetjen e një politike të tillë.

Rekomandimet për QIRSKP-in drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë:

- MKPT-ja e Avokatit të Popullit ripërsërit rekomandimin për nxjerrjen e akteve nënligjore në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor (Në pritje për implementim).
- Ministria e Shëndetësisë të marrë një vendim njoftues, që i liston institucionet e shëndetit mendor, ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik (Në pritje për implementim).

Rekomandimet për QIRSKP-in drejtuar Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK):

- MKPT-ja ripërsërit rekomandimin për ndërtimin e njësisë vokacionale në kuadër të QIRSKP-it (Në pritje për implementim).
- Të sigurohet numri adekuat i personelit mjekësor, si psikiatër, infermierë, psikologë klinikë, terapist okupacional, si parakusht për një trajtim adekuat (I implementuar)
- Të ofrohen trajnime adekuate për personelin (I implementuar)
- Të furnizohet rregullisht QIRSKP-i me barnat e nevojshme (I implementuar)
- Të funksionalizohet sistemi kompjuterik i evidentimit (baza e të dhënave) (I pa implementuar).
- Të përpilohet Udhërrëfyesi (Strategjia) për parandalim të vetëvrasjeve (Në pritje për implementim).

Institucionet e kujdesit social

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja ka vizituar institucionet e kujdesit social si në vijim: Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare³⁷⁵, Institutin Special në Shtime³⁷⁶ dhe Shtëpinë e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore.

Shtëpia për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF)

ShPMPF-ja është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për 110 persona. Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi ishte 63 rezidentë, prej tyre 27 meshkuj dhe 36 femra, ku 3 persona ishin nën moshën 65 vjeç.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka intervistuar një numër të rezidentëve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo abuzime verbale, si dhe sjellje të cilat do të shkelnin dinjitetin njerëzor të rezidentëve në ShPMPF. Sa i përket kushteve të akomodimit, gjatë vizitës MKPT-ja ka vërejtur se ndërtesa ka nevojë për investime serioze, sidomos në pjesën ku është i vendosur shërbimi mjekësor ku depërtimi i ujit shpesh shkakton dëmtime serioze të inventarit.

Lidhur me këtë gjendje, MKPT-ja, përmes raportit me rekomandime për vizitën në ShPMPF, i ka rekomanduar MPMS-së që urgjentisht të bëhen investime sipas vlerësimit të nevojave, në ndërtesën e vjetër dhe hapësirat ku funksionon shërbimi mjekësor dhe shërbimi i stomatologjisë. Sipas njoftimit të fundit nga MPMS-ja, janë bërë investime në ndërtesë, është izoluar objekti, gjithashtu edhe shërbimet stomatologjike nuk janë më në katin përdhese. MKPT-ja përmes vizitave përcjellëse dhe ad-hoc do të verifikojë zbatimin e rekomandimit në fjalë.

Rekomandimet për ShPMPF-në drejtuar MPMS-së:

- Urgjentisht të bëhen investime sipas vlerësimit të nevojave, në ndërtesën e vjetër dhe hapësirat ku funksionon shërbimi mjekësor dhe shërbimi i stomatologjisë (I implementuar).
- Rezidentët të furnizohen me inventar adekuat në dhomat e tyre (I implementuar).
- Të furnizohet institucioni me një autoambulancë (Në pritje për implementim).
- Shërbimi mjekësor të aplikojë protokolle për vetëlëndime, lëndime trupore, grevë urie, abuzime seksuale, vetëvrasje, si dhe vdekjeve në institucion (I implementuar).
- Të organizohen trajnime specifike për personelin, në pajtim me nevojat për trajtim të rezidentëve (I implementuar).

³⁷⁵ Raporti me rekomandime për vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare, publikuar në: <https://www.oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>.

³⁷⁶ Raporti për vizitën në Institutin Special në Shtime, në: <https://www.oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>.

- Të rritet numri i personelit sipas vlerësimit të nevojave nga shërbimi shëndetësor (I implementuar).

Instituti Special në Shtime (ISSh)

MKPT-ja, gjatë muajit gusht 2018, ka realizuar vizitë të përgjithshme në ISSh, bashkë me ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve). Ky Institucion menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) dhe është institucion i tipit të hapur, i cili ofron shërbime 24 orësh, si: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës edukative dhe aftësuese dhe trajtim social.

Kapaciteti zyrtar i institucionit është 65 shtretër. Gjatë vizitës është konstatuar se janë të vendosur 67 rezidentë (43 meshkuj dhe 24 femra) të moshës mbi 18 vjeç, moshë mestare është rreth 46.5 vjet. Kategorizimi i rezidentëve bëhet sipas gjinisë dhe gjendjes shëndetësore. Të gjithë personat e vendosur janë me diagnozën Paaftësi në Mësim (Prapambetje mendore).

Në bazë të UA nr. 11/2014 për Punën dhe Vendosjen e Rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore - ngecje në zhvillimin mendor në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, parashihet trajtimi i personave që u është marrë zotësia e veprimit nga gjykata themelore. Gjatë vizitave *ad-hoc* në ISSh, MKPT-ja u njoftua se në 98% të rasteve u është hequr zotësia e veprimit dhe u është përcaktuar kujdestari ligjor.

Gjatë vizitës së MKPT-së vërehej një qasje e afërt e stafit ndaj rezidentëve. Rezidentët dukeshin mirë për nga veshja dhe higjiena, raporti me stafin ishte miqësor. MKPT-ja nuk ka hasur në rezidentë me shenja të lëndimeve trupore.

Kushtet e banimit

Kushtet e banimit në përgjithësi janë shumë të mira. Rezidentët janë zhvendosur në ndërtesa më të reja dhe ishin vendosur në konvikte më të vogla. Hapësirat e banimit kanë ndriçim natyral të mjaftueshëm, ngrohje, ajrim si dhe pastërtia është në nivel të kënaqshëm. Dhomat ku akomodohen rezidentët, kryesisht janë me nga dy-tre shtretër në një dhomë, ka komodina për vendosjen e rrobave dhe gjërave personale, gjithashtu ka edhe dekorime për stimulim pamor, p.sh. piktura të ndryshme, të cilat janë punuar nga disa rezidentë në bashkëpunim me instruktorët. Gjatë vizitës në ISSh, ekipi i MKPT-së ka vizituar edhe kuzhinën, ku përgatitet dhe shërbehet ushqimi. Kuzhina kishte ndriçim dhe ventilim të duhur, pastërtia është në nivel, si dhe ushqimi ishte adekuat.

Trajtimi shëndetësor dhe aktivitetet

ISSh-ja, në kohën e vizitës së MKPT-së, nuk kishte mjek të përgjithshëm. Shërbimet stomatologjike merren nga Shtëpia për të Moshuar në Prishtinë. Në rast nevoje, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike rezidentëve u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, Spitali Rajonal në Ferizaj dhe Qendra Klinike Universitare në Prishtinë. Ambulanca ku qëndronte personeli shëndetësor nuk i plotëson kushtet, për

shkak të hapësirave të vogla dhe të papërshtatshme, nuk ka ndriçim të mjaftueshëm. Kjo situatë u theksua edhe në raportin me rekomandime nga vizita në këtë institucion në vitin 2016.³⁷⁷

Shërbimi psikiatrik ofrohet nga një psikiatër me kontratë, i cili i viziton rastet një herë në javë, nga katër orë dhe sipas thirrjes, kështu që, ndonjëherë detyrohet ta përshkruajë terapinë pa e vizituar pacientin. MKPT-ja ka vërejtur se rastet që vuajnë nga epilepsia nuk kishin kontrolla të rregullta neurologjike dhe, në të shumtën e rasteve, psikiatri e menaxhonte terapinë neurologjike. Përdorimi i medikamenteve antipsikotike, antidepressive dhe anksiolitike, nga ekzaminimi i disa dosjeve mjekësore, duket se është i arsyeshëm dhe i bazuar në evidenca. Barnat sigurohen nga MPMS-ja dhe nuk kishte vërejtje për furnizim me kohë. MKPT-ja ka vërejtur se tek rezidentët që përdornin Clozapinën nuk ka dëshmi se është bërë matja e qelizave të bardha të gjakut, sipas rekomandimeve të bazuara në evidenca.

Aktivitetet psiko-sociale, që zakonisht kryhen, janë të ndryshme. Institucioni ka tri dhoma të terapisë së punës: punëtorja e artit, zdrukthëtarisë dhe e punëdores. Në to përfshihen të gjithë personat që janë të aftë për këto aktivitete. Po ashtu, ekziston edhe salla e aktiviteteve tjera rekreativo-sportive (ping-pong, shah, domina, letra etj.). Si aktivitete tjera janë angazhimi në punë në serrë dhe aktivitetet jashtë institucionit (kamping në natyrë, përgatitje e ushqimit, lojra të ndryshme). Por nuk janë të rralla edhe shëtitjet në qytete të ndryshme me grupe të vogla si dhe daljet në lokalet e qytezës në Shtime.

Plani i aktiviteteve nuk është i shkruar, as planet individuale nuk ekzistojnë. Rezidentët lejohen në vikende familjare 3-5 ditë, kur familjet shprehin interesim për t'i marrë. MKPT-ja konsideron se numri dhe cilësia e aktiviteteve psiko-sociale dhe rekreative është solide, por nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit sipas nevojave dhe aftësive të rezidentëve.

Mjetet e kufizimit

Sipas Drejtorisë, në ISSh nuk ka dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit fizik, përveç në një rast ku një rezident është i fiksuar vazhdimisht (24 orë), i lidhur duartë nga mbrapa me një lidhëse, lirshëm, sa për të mos lejuar vetëlëndimin. Stafit ka shprehur keqardhje për menaxhimin e këtij rasti në këtë mënyrë, megjithatë, sipas pohimeve të personelit, ata kanë provuar të gjitha format e mundshme për ta menaxhuar këtë rast pa përdorur mjetet e kufizimit, por pa sukses.

MKPT-ja konsideron se stafi drejtues, psikiatrik dhe mjekësor duhet ta adresojë këtë rast në institucione tjera të specializuara psikiatrike (Klinika e Psikiatrisë etj.) për të gjetur mënyra dhe qasje të trajtimit sa më të përshtatshme dhe dinjitoz, duke krijuar një komision të jashtëm vlerësues.

³⁷⁷ Më gjerësisht shih në: <https://www.oik-rks.org/mekanizmi-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-mkpt/raporte-mkpt/>.

Shtëpia e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara Mendore

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKPT-ja bashkë me ekspertët e KE (në cilësinë e vëzhguesve), gjatë muajit gusht 2018, kanë realizuar vizitë të përgjithshme në Shtëpinë e Fëmijëve në Shtime. Ky institucion menaxhohet nga MPMS-ja dhe është i vetmi institucion i tipit të hapur, i cili akomodon fëmijët me nevoja të veçanta (paaftësi në mësim-prapambetje mendore) dhe ofron shërbime 24 orësh, si në vijim: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës edukative dhe aftësuese, trajtim social.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në këtë institucion janë të vendosur 10 persona të moshave të ndryshme (aq sa është kapaciteti i institucionit): katër prej tyre janë nën moshën 18 vjeçare, dy sapo i kanë mbushur 18 vjet, dy janë rreth të njëzetave dhe dy rreth të tridhjetave.

Bazuar në faktin se ky institucion është përcaktuar si Shtëpi e Fëmijëve, është e papranueshme që të vazhdojë qëndrimi në shtëpi i banorëve të rritur. Ata duhet të vendosen në hapësirat ekzistuese për të rritur që ekzistojnë në vendin tonë.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur një qasje të afërt, të ngrohtë e miqësore nga ana e stafit ndaj rezidentëve. MKPT-ja nuk ka rastisur në persona me shenja të lëndimeve dhe nuk ka pranuar ankesa nga rezidentët e këtij institucioni për keqtrajtim fizik apo sjellje të personelit të cilat do ta cenonin dinjitetin e tyre.

Kushtet e banimit

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se kushtet materiale për banorët në përgjithësi ishin shumë të dobëta. Dhomat e banorëve kishin hapësirë të mjaftueshme dhe nuk ishin të mbipopulluara, por ishin të dëmtuara. Përveç kësaj, institucioni përballet me mungesa të veshmbathjes dhe mbulesave të përshtatshme. MKPT-ja gjatë vizitës ka konstatuar se nevojitet rinovimi urgjent brenda dhe jashtë shtëpisë. Gjatë kësaj vizite, MKPT-ja u njoftua nga udhëheqësi i shtëpisë se i tërë objekti do t'i nënshtrohet një rinovimi të rëndësishëm që do të përfshijë rreth 90% të shtëpisë. MKPT-ja, menjëherë pas vizitës së realizuar në gusht të vitit 2018, ka takuar përfaqësues nga MPMS-ja ku ka shprehur shqetësimet lidhur me gjetjet.

Gjatë vizitës përcjellëse në janar 2019, MKPT-ja konstatoi se objekti në fjalë u rinovua në masë të madhe dhe se gjendja sa i përket kushteve të akomodimit ka ndryshuar dukshëm në drejtim pozitiv.

Shërbimet shëndetësore

Shërbimi shëndetësor dhe psikiatrik është i përbashkët me Institutin Special në Shtime. Psikiatri vjen njëherë në javë, rastet ndonjëherë dërgohen edhe në ambulancën e Institutit Special në Shtime. Në rast nevoje, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, Spitali Rajonal në Ferizaj dhe

Qendra Klinike Universitare në Prishtinë. Analizat laboratorike u bëhen në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Shtime çdo 6 muaj në mënyrë të rregullt.

Personeli shëndetësor ka një aparat për matje të TA, por nuk kanë aparat për oksigjen. Dhoma e fizioterapisë është e dëmtuar.

Furnizimi me barna bëhet nga MPMS-ja dhe është i rregullt. MKPT-ja ka vërejtur se tek rezidentët që përdornin Clozapinën nuk ka dëshmi se është bërë matja e qelizave të bardha të gjakut sipas rekomandimeve të bazuara në evidenca. MKPT-ja thekson se është përgjegjësi e institucionit dhënia e medikamenteve të caktuara sipas evidencave të njohura, por edhe aplikimi i monitorimit të efekteve anësore të tyre të mundshme sipas praktikave të pranuar klinike (analizat përcjellëse tek aplikimi i Clozapinës).

Sa i përket mjeteve të kufizimit, në Shtëpinë e Fëmijëve nuk ka dhoma të izolimit dhe nuk përdoren forma të kufizimit. MKPT-ja ka vërejtur se kishte regjistër për përdorimin e mjeteve të kufizimit.

Sa i përketë aktiviteteve psiko-sociale, MKPT-ja u njoftua se banorët zakonisht dëgjojnë muzikë si dhe dalin jashtë në natyrë, bëjnë disa dalje në qytet, ndonëse të rralla. Ndërsa tetë nga banorët vijojnë mësimin në shkollë speciale. MKPT-ja konstaton se numri dhe cilësia e aktiviteteve psiko-sociale dhe rekreative është shumë i varfër dhe nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit sipas nevojave dhe aftësive të rezidentëve.

Stafi përbëhet nga nëntë punëtorë dhe udhëheqësi i Shtëpisë (4 infermierë dhe 5 ndihmës mjekësorë). Shërbimet janë 24 orësh. Nivelet e stafit të Shtëpisë ishin të pamjaftueshme për të siguruar kujdesin e kërkuar multidisiplinor. Stafi ndihet tepër i ngarkuar, i stresuar nga specifikat e punës dhe i pashpërblyer në mënyrë adekuate për natyrën e punës. Ju mungojnë trajnimet adekuate për personelin e Shtëpisë. *MKPT e vlerëson si shumë të rëndësishme ofrimin e trajnimeve profesionale për stafin brenda dhe jashtë institucionit si dhe shpërblimin adekuat bazuar në specifikat e punës.*

Përmbledhja e raporteve me rekomandime

Bazuar në autorizimet e dhëna Avokatit të Popullit me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 16 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit gjatë vitit 2018 ka publikuar raporte, opinione, i është drejtuar gjykatës në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) dhe ka parashtruar kërkesë për aplikim të masës së përkohshme, të përmbledhura si më poshtë:

Raporte sipas detyrës zyrtare (*Ex officio*)

Raport për rastin *Ex officio* nr. 731/2017 lidhur me vendimin e Inspektoratit Policor të Kosovës, i datës 29 dhjetor 2017, për anulimin e procesit të rekrutimit për Inspektor/Hetues, i shpallur më 24 korrik 2017

Më 29 janar 2018, Avokati i Popullit kishte publikuar raportin *Ex officio* nr. 731/2017, i cili kishte për qëllim ta vlerësonte vendimin e ministrit të Punëve të Brendshme, z. Flamur Sefaj, i datës 6 nëntor 2017, për pezullimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm në konkursin e Inspektoratit Policor të Kosovës për Inspektor/Hetues, me numër të referencës IPK/DO/01, i shpallur më 24 korrik 2017; ta vlerësonte vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, i datës 29 dhjetor 2017, për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitat Inspektor/Hetues; ta vlerësonte nëse vendimi i ministrit të Punëve të Brendshme, për pezullimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm dhe kërkesa për anulimin e tërësishëm të procedurës së rekrutimit, përbën cenim të lirive dhe të drejtave të njeriut; si dhe t'i rekomandonte Inspektoratit Policor të Kosovës rregullimin e kësaj çështjeje bazuar në argumentet e përmendura në këtë raport.

Raporti është rezultat i hetimeve me vetiniciativë (*ex officio*) të Avokatit të Popullit, bazuar në komunikatën për media të MPB-së nr. 97/2017, e datës 6 nëntor 2017, me titull “*Ministri Sefaj pezullon nënshkrimin e kontratave në konkursin e IPK Inspektor/Hetues*”.

Inspektorati Policor i Kosovës, më 24 korrik 2017, kishte publikuar shpalljen e rekrutimit për plotësimin e vendeve të lira të punës për shtatëmbëdhjetë (17) pozita me titull *Inspektor/Hetues* dhe të gjitha procedurat e konkursit janë zhvilluar në bazë të dispozitave të *Udhëzimit Administrativ 1/2017 për procedurat lidhur me kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e IPK*. Kandidatët që i kanë plotësuar kriteret e kërkuara në konkurs i janë nënshtruar procedurave në testim me shkrim, në testim fizik, në intervistim me gojë dhe në kontrollin shëndetësor dhe më atë psikologjik, të përcaktuara sipas dispozitave të UA nr.1/2017.

Më 20 tetor 2017, IPK-ja kishte publikuar listën e rezultateve të testimit dhe intervistimit të kandidatëve, me ç’ rast ishin njoftuar kandidatët të cilët i vazhdojnë procedurat e rekrutimit, ndërsa kandidatët e pakënaqur me rezultatin e publikuar ishin njoftuar për mundësinë e paraqitjes së ankesës brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita e publikimit të rezultateve. Më 3 nëntor 2017, IPK-ja kishte publikuar listën përfundimtare të kandidatëve të përzgjedhur, të cilët, më 6 nëntor 2017, në orën 10:00, ishin ftuar t’i

nënshkruajnë kontratat e punës me punëdhënësin. Në të njëjtën ditë, MPB-ja kishte lëshuar komunikatë për media nr. 97/2017, përmes së cilës ishte njoftuar se ministri i MPB-së kishte marrë vendim që të mos nënshkrueshin kontratat me kandidatët e përzgjedhur në konkursin e shpallur më 24 korrik 2017 për pozitat Inspektor/Hetues. Ndërsa, më 29 dhjetor 2017, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, sipas kërkesës së ministrit të MPB-së, kishte nxjerrë Vendimin nr. pro. 01/112/2754/1, me të cilin kishte anuluar procedurën e rekrutimit, e shpallur më 24 korrik 2017 për plotësimin e vendeve të lira të punës për pozitën Inspektor/Hetues.

Në kërkesën e Avokatit të Popullit që të informohej në lidhje me rastin, më 19 dhjetor 2017, ministri i MPB-së kishte kthyer përgjigje duke e njoftuar se vendimin për pezullimin e nënshkrimit të kontratave e kishte marrë për shkak se ai dhe Kryeministri kishin pranuar ankesa të shumta nga kandidatët, të cilët nuk ishin përzgjedhur në konkursin në fjalë. Më tej ministri ka njoftuar se vendimi ishte bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm, në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, si dhe në nenin 16 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive. Ministri i MPB-së nuk kishte dhënë ndonjë sqarim lidhur me zbatimin apo moszbatimin e UA nr.1/2017 për procedurat lidhur me kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e IPK-së, në bazë të të cilit është shpallur konkursi.

Avokati i Popullit, duke analizuar arsyetimin të cilin e kishte dhënë ministri i MPB-së, kishte vlerësuar se ky arsyetim ishte jorelevant me rastin konkret. Sipas arsyetimit, vendimi për pezullimin e nënshkrimit të kontratave mbështetej në nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-128 për Auditim të Brendshëm, nën ky që përcakton themelimin dhe funksionimin e njësisive për auditim të brendshëm, ndërsa njësitë e auditimit nuk duket se kanë ndonjë rol në këtë mes. Po ashtu, mbështetja e këtij vendimi në nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, si dhe në nenin 16 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, dispozita këto krejtësisht jorelevante me procesin e rekrutimit, sepse neni 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 përcakton rolin e ministrave në sigurimin e shërbimeve të besueshme, transparente, të përgjegjshme dhe jodiskriminuese; ndërsa paragrafi 1.5 përcakton rolin e ministrave në krijimin dhe zbatimin e masave kundër mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe nxitjen e vetëdijesimit kundër mashtrimit. Gjithashtu, neni 16 i kësaj Rregulloreje, të cilit i ishte referuar ministri, flet për funksionet e Zyrës së Kryeministrit, që po ashtu ishte jorelevant me procesin e rekrutimit.

Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kishin zhvilluar dy takime të ndara me ministrin e MPB-së dhe përfaqësuesit e MPB-së, për t'i shprehur shqetësimet lidhur me veprimet e ministrit, të cilat do të mund të binin ndesh me ligjin dhe do të mund t'i cenonin të drejtat e njeriut.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për IPK-në, vlerëson se IPK-ja është institucion ekzekutiv në kuadër të MPB-së, i pavarur nga Policia që funksionon nën

autoritetin e ministrit dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së. Ligji për IPK-në ka bërë ndarjen e qartë në mes të kompetencave të ministrit dhe Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së dhe se ky i fundit është përgjegjës për organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të IPK-së (neni 12, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2). Rrjedhimisht, Kryeshefi Ekzekutiv është subjekti përgjegjës, i cili duhet ta bëjë organizimin e punësimit të personelit. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit vëren se, deri me nxjerrjen e vendimit për anulimin e procedurës së rekrutimit, Kryeshefi Ekzekutiv i ka ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin dhe UA nr. 1/2017, që si rezultat ka pasur shpalljen e listës përfundimtare të kandidatëve të suksesshëm, të cilët janë ftuar që, më 6 nëntor 2017, t'i nënshkruajnë kontratat e punës.

Avokati i Popullit vlerëson se kërkesa e ministrit për anulimin e procedurës së finalizuar përbën tejkallim të kompetencave të tij ligjore. Po ashtu, vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv për anulimin e procedurës, sipas kërkesës së ministrit, përbën tejkallim të kompetencave ligjore edhe nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv. Ndërmarrja e veprimeve të tilla në fazën përfundimtare të një procesi, në këtë rast procedurës së rekrutimit, dhe atë pas njoftimit të kandidatëve të suksesshëm, përveç që ka të bëjë me tejkallim të kompetencave, ngrit edhe një sërë çështjesh kushtetuese dhe ligjore, çështje këto mjaft shqetësuese nga pikëpamja e të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit. Vendimi për anulimin e procedurës së rekrutimit është një vendim i pajustificuar dhe i paarsyetuar. E drejta në një vendim të arsyetuar është e rrënjësor si parim i përgjithshëm në KEDNJ, që mbron individët nga arbitrariteti. Vendimi duhet të përmbajë arsyetim të mjaftueshëm, në mënyrë që t'i përgjigjet argumenteve procedurale dhe materiale të palëve (Ruiz Torija v. Spain, §§29-30). Vendimi për anulim të procedurës, edhe nëse është nxjerrë për të adresuar ankesat e kandidatëve të pakënaqur, ai nuk merret fare me aspektet procedurale dhe materiale të ankesave të ngritura nga kandidatët e pakënaqur.

Veprime të tilla të pajustificueshme dhe arbitrare, shmangia nga normat që rregullojnë procedura të caktuara krijojnë pasiguri juridike. Pasiguria juridike nënkupton një situatë kur te individi krijohet përshtypja se e drejta e tij/saj do të mund të varet nga çfarëdo veprimi tjetër, por jo nga ligji.

Avokati i Popullit vlerëson se vendimi i ministrit të MPB-së për anulimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm dhe kërkesa e ministrit të MPB-së për nxjerrjen e vendimit nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së për anulimin e procesit të rekrutimit, i datës 29 dhjetor 2017, përbëjnë veprime që cenojnë të drejtën e kandidatëve në punë dhe në ushtrimin e profesionit; cenojnë të drejtën në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe cenojnë të drejtën në mjete efektive juridike. Bazuar në këto konstatime, Avokati i Popullit i rekomandoi ministrit të Punëve të Brendshme që ta tërheqë kërkesën me të cilën ka kërkuar nga Kryeshefi Ekzekutiv anulimin e procesit të rekrutimit në IPK; i rekomandoi Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, që në pajtim me përgjegjësitë e tij të përcaktuara me Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe në

pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, të ndërmarrë veprime për anulimin e Vendimit nr.pro. 01/112/2754/1, i datës 29 dhjetor 2017; i rekomandoi ministrit të Punëve të Brendshme që të përmbahet nga ndërhyrjet në organizimin dhe punësimin e personelit dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të IPK-së.

Raport për rastin *Ex officio nr. 853/2016* lidhur me kriteret diskriminuese të vendosura nga Universiteti i Prishtinës

Sipas informacioneve të marra nga burime të ndryshme, por edhe nga disa takime të mbajtura me përfaqësuesin e UP-së, u bë e njohur se Senati i Universitetit, më 30 shtator 2016, ka shpallur konkurs publik për angazhimin me honorar të personelit në bazë të nevojave të njësive akademike. Megjithatë, një nga kushtet për angazhimin e personelit, që është përcaktuar më saktësisht në nenin 5, parashihet që: *“Në Universitetin e Prishtinës nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve që kanë marrëdhënie të ngushta pune, familjare brenda departamenteve ose programeve”*.

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vërejtjes për nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi dhe trajtimi i barabartë në kriteret e vendosura për vendet e lira të punës të shpallura për rekrutimin e kandidatëve në Universitetin e Prishtinës “Hasana Prishtina” (në tekstin e mëtejshëm *UP*) gjatë vitit 2016 dhe 2017. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit analizon përputhshmërinë e Rregullores nr. 2/475 për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP (në tekstin e mëtejshëm *Rregullorja*), e datës 8 shtator 2017, me legjislacionin vendor dhe me instrumentet ndërkombëtare në aspekt të veçantë të mbrojtjes nga diskriminimi.

Në takimet me përfaqësuesin e UP-së gjatë vitit 2016, Avokati i Popullit është informuar se kriteri kontestues është përfshirë në konkurs me qëllim të pengimit të *marrëdhënieve të ngushta të punës dhe familjare*, përkatësisht nepotizmit me rastin e punësimit brenda të njëjtit departament/degë apo program në UP. Në kohën e shpalljes së konkursit, UP-ja nuk kishte ndonjë rregullore të brendshme që e rregullonte këtë çështje në bazë të ligjeve në fuqi, por u tha se UP-ja është duke e hartuar Rregulloren për procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP “Hasan Prishtina”, e cila do ta përfshijë rregullimin e çështjeve të raporteve të ngushta familjare dhe se i gjithë procesi në lidhje me nxjerrjen e rregullores së lartpërmendur, do të përfundojë në kohën sa më të shkurtë të mundshme dhe UP do ta informojë Institucionin e Avokatit të Popullit.

Më 8 shtator 2017, UP-ja e miratoi *“Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP”*. Gjithashtu, është thënë se më 19 shtator 2017, UP-ja ka shpallur konkurs të ri për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve në bazë të nevojave të njësive akademike dhe se i njëjti kusht, si në konkurset e përmendura paraprakisht, është paraparë edhe në këtë konkurs, duke u thirrur në *Rregulloren e brendshme të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP “Hasan Prishtina”*, në të cilin është paraparë i njëjti kusht në bazë të nenit 7, paragrafit 11, i cili

thotë: *“Në Universitetin e Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas).”*

Avokati i Popullit thekson se, sipas vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ): *“E drejta për të mos u diskriminuar shkelet, kur shtetet i trajtojnë njerëzit në mënyrë të pabarabartë [...] duke mos dhënë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Në mënyrë që një justifikim i tillë të jetë “objektiv dhe i arsyeshëm”, duhet t’i kalojë dy hapa: Së pari, duhet të ekzistojë “qëllimi legjitim” për pabarazinë në fjalë; dhe së dyti, duhet të ekzistojë një “raport i arsyeshëm i proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe objektivit që synohet të arrihet.”*

Avokati i Popullit thekson se diskriminimi në fushën e punësimit është i ndaluar edhe me Ligjin e Punës, kurse me Ligjin ombrellë për mbrojtje nga diskriminimi është krijuar një kornizë gjithëpërfshirëse për mbrojtjen nga diskriminimi, me të cilin ndalohet diskriminimi i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë në punësim në çfarëdo baze, për të gjithë akterët që i kanë shkelur, i shkelin ose mund t’i shkelin të drejtat e secilit person, në veçanti kur kanë të bëjnë me kushtet për qasje në punësim, duke përfshirë kushtet e punësimit dhe kriteret e përzgjedhjes.

Avokati i Popullit thekson se, me nocionin e së drejtës për punë dhe zgjedhjes së lirë të profesionit, nënkuptohen të drejtat e barabarta në kushte të barabarta, që do të thotë se për secilin në kushte të barabarta është i qasshëm çdo vend i punës, me çka përjashtohet çdo formë e diskriminimit. Ndalimi i punësimit mbi bazën e raporteve të ngushta familjare në sektorin publik është në kundërshtim me të drejtën për punë dhe paraqet diskriminim. Avokati i Popullit në mënyrë specifike e kupton problemin e nepotizmit si një formë e veçantë e konfliktit të interesit, që është jashtëzakonisht i shpeshtë me rastin e punësimit në sektorin publik. Megjithatë, shtypja e nepotizmit nuk e nënkupton përjashtimin e plotë të të afërmve, por e nënkupton ndalimin e keqpërdorimit të pozitës së nëpunësve civilë për të siguruar punë për anëtarët e familjes. Qëllimi nuk është t’i pengojë anëtarët e familjes të punojnë së bashku, por ta parandalojë mundësinë që një nëpunës civil të jetë i njëanshëm, ta favorizojë ose ta shfrytëzojë ndikimin dhe pozitën e tij për anëtarët e familjes në ushtrimin e kompetencave diskrete për të punësuar nëpunës civilë të kualifikuar.

Avokati i Popullit konsideron se qëllimi i konkursit publik reflektohet në parimin e qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve që, nën kushte të njëjta, të aplikojnë në mënyrë të barabartë për çdo vend pune në sektorin publik. Barazia në punësim është kusht bazë i barazisë para ligjit. Prandaj një person, për shkak të disa prej karakteristikave të tij personale, ose në rastin konkret raporteve të ngushta familjare si dhe raporteve të punës që kanë brenda departamentit ose programit të UP-së, nuk mund të privohet nga e drejta për punësim, e cila për të tjerët është e qasshme dhe u njihet në masë të plotë, sepse me

këtë ky person vihet në pozitë e pafavorshme krahasuar me kandidatët e tjerë dhe të njëjtit nuk i lejohet në kushte të barabarta të konkursit të marrë pjesë në garë gjatë procedurës së rekrutimit, por është e rëndësishme të theksohet se, në raste të tilla, procedura e rekrutimit kërkon transparencë të plotë. Prandaj, punësimi dhe avancimi në UP duhet të bëhet në kushte të barabarta për të gjithë, duke e respektuar plotësisht parimin kushtetues të barazisë dhe të qasjes së barabartë në shërbime publike.

Avokati i Popullit konsideron se, si kusht i vetëm për punësim në konkurse, duhen caktuar kualifikimet më të mira dhe më të përshtatshme, aftësitë e punës të kandidatit që aplikon për punë, ndërsa në asnjë mënyrë kandidati i cili është në marrëdhënie familjare, martesore ose të ngjashme me ndonjë nga punonjësit e UP-së dhe njësive përbërëse të tij, nuk guxon të ketë trajtim preferencial, por as nuk guxon të vihet në pozitë më të pafavorshme me rastin e punësimit ose avancimit. Avokati i Popullit në asnjë mënyrë nuk i mbështet punësimet e familjarëve të ngushtë në UP, por ky lloj punësimi as nuk duhet të kufizohet, duhet të lejohet përmes procedurave transparente, duke i përmbushur kriteret ligjore të konkursit dhe me kufizime të ndërlidhura me atë se cilët anëtarë të bashkësive akademike mund të nxjerrin ose marrin pjesë në marrjen e vendimeve për pranimin e kandidatëve në marrëdhënie pune dhe vendimet e tilla duhet të jenë në përputhje me interesin publik dhe me integritetin e institucionit.

Nëse ekziston dyshimi për konflikt interesit mbi bazën e raporteve të ngushta familjare me rastin e punësimit, në secilin rast individual në UP, duhet të jetë në dispozicion një mekanizëm ligjor i bazuar në *Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik*.

Avokati i Popullit, pas një analize ligjore të kushtit kontestues të sipërpërmendur në konkursin e UP-së, i shpallur në vitin 2016 dhe 2017, i cili nuk ua lejon paraqitjen në konkurs dhe rekrutimin e kandidatëve brenda të njëjtit departament mbi bazën e raporteve të ngushta familjare, si dhe bazuar në nenin 7, paragrafit 11 të *Rregullores së brendshme të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP "Hasan Prishtina"*, e datës 8 shtator 2017, në të cilin thuhet: "*Në Universitetin e Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas), nxjerr përfundimin se në kontekstin e parimit të barazisë, paraqet kusht diskriminues dhe është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

Avokati i Popullit konstaton se mbrojtja e të drejtave të plota të punësimit nënkupton zbatimin e plotë të parimit të kapacitetit profesional dhe ofrimin e së drejtës së pjesëmarrjes në një konkurrencë të hapur në procesin e rekrutimit të të gjithë kandidatëve të interesuar, duke mos e shkelur procedurën e përgjithshme dhe as kushtet e përgjithshme për punësim në institucionet publike, në mënyrën në të cilën të gjithë

kandidatëve, pa përjashtim, në kushte të barabarta u bëhen të qasshme të gjitha vendet e punës në UP.

Duke u bazuar në këto gjetje dhe në përputhje me nenin 135, paragrafin 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafin 4 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, rekomandon: UP-ja në konkurset për punësim, në të ardhmen, të mos e përsërisë kushtin kontestues, i cili nuk e lejon paraqitjen në konkurs dhe rekrutimin e kandidatëve brenda departamentit të njëjtë mbi bazën e marrëdhënieve të ngushta familjare; UP-ja ta fshijë nenin 7, paragrafin 11 të *Rregullores së brendshme të procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në UP "Hasan Prishtina"*, nr. 2/475, e datës 8 shtator 2017; UP-ja, në përputhje me rregulloret ligjore në fuqi, me rregullore të veçantë, t'i rregullojë më saktësisht praktikatat e papranueshme të punësimit, si dhe çështjet e tjera që ndërliken me parandalimin e nepotizmit në UP.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 129/2018 në lidhje me zgjidhjen efektive të zvarritjeve të procedurës gjyqësore - shkelja e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

Më 6 mars 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandim në lidhje me zgjidhjen efektive të zvarritjeve të procedurës gjyqësore - shkelja e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Qëllimi kryesor i këtij Raporti është kërkesa e Avokatit të Popullit ndaj autoriteteve përkatëse për krijimin e një mekanizmi, i cili do t'u ofrojë qytetarëve të Republikës së Kosovës mbrojtje gjyqësore të së drejtës në gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Duke u nisur nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në harmoni me të cilën interpretohet KEDNj-ja, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ky Raport do ta analizojë mundësinë e kompensimit e dëmit për viktimat, të cilëve u shkelet e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe hapësirën që lë legjislacioni vendor, në mënyrë që dispozitat e KEDNj-së dhe praktika e GjEDNj-së të gjejnë zbatim më të mirë në Republikën e Kosovës.

Numri i ankesave që paraqiten në Institucionin e Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm *IAP*) lidhur me zvarritjet në procedurat gjyqësore është i lartë. Vetëm gjatë vitit 2017, rreth 26% të ankesave të paraqitura në IAP kanë të bëjnë me pretendimet për zvarritje të procedurave gjyqësore. Arsyet kryesore për ngritjen e kësaj çështjeje nga Avokati i Popullit është mungesa e mekanizmave ligjor për parandalimin e shkeljes të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor apo kompensimin e qytetarëve, të cilët mund të jenë viktimat të kësaj shkeljeje. Prandaj, ky Raport ka për qëllim ta analizojë nocionin e "zgjidhjeve efektive", në pajtim me praktikën e GjEDNj-së.

E drejta për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm garantohet me Kushtetutë. Në nenin 31, paragrafi 2 të Kushtetutës thuhet: "Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik (...) lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm" (theks i shtuar). Po ashtu, neni 6, paragrafi 1 i KEDNj-së përcakton: "Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet (...) brenda

një afati të arsyeshëm (...) për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij” (theks i shtuar). Në mënyrë të ngjashme, neni 14, paragrafi 3, nënparagrafi c i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike, përcakton: “Secili person i akuzuar për një vepër penale ka të drejtë plotësisht (...) [t]ë gjykohet *pa vonesë të tepruar*” (theks i shtuar). E drejta e përcaktuar me këto dispozita, njësoj si në të gjitha të drejtat e parashikuara në KEDNj apo Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike, “garantohe[t] me këtë Kushtetutë” (Kushtetuta, neni 22).

Për përcaktimin e kërkesave kushtetuese të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duke përfshirë edhe mundësinë e zgjidhjes efektive të shkeljeve të kësaj të drejte, duhet marrë parasysh nenin 53 të Kushtetutës, i cili udhëzon: “[t]ë drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Që nga shpallja e aktgjykimit në rastin *Kudla v. Poland* (Aplikacioni Nr. 30210/96, 26 tetor 2000), GjEDNj, bashkë me Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës, i cili e ka kompetencën për të mbikëqyrur ekzekutimin e aktgjyqimeve të GjEDNj-së (*shih* KEDNj, neni 46, par. 2), ka vendosur standarde të rrepta, të cilat kërkojnë prej çdo shteti themelimin e mekanizmave për zgjidhjen efektive për rastet e zvarritjeve dhe dëmet e shkaktuara si pasojë e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Këto standarde bazohen në nenin 13 të KEDNj-së, i cili përcakton: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar” (*shih gjithashtu* Kushtetutën, neni 54 (“Çdokush gëzon (...) të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë [e garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj] është shkelur”).

Mirëpo, në mënyrë që t’i analizojmë kërkesat specifike të GjEDNj-së lidhur me zgjidhjen efektive me rastin e shkeljes të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të marrim parasysh llojet e ndryshme të shkeljeve të kësaj të drejte. Në përgjithësi, janë dy mënyra kryesore se si mund të shkelet e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të cilat ndërlidhen me fazat përkatëse të një rasti gjyqësor. Së pari, kjo e drejtë mund të shkelet për shkak të *zvarritjes së procedurës gjyqësore deri në marrjen e vendimit përfundimtar në një rast të caktuar*; së dyti, mund të shkelet për shkak të *zvarritjes së ekzekutimit të vendimit përfundimtar, pas marrjes së një vendimi të tillë*. Kërkesat e GjEDNj-së lidhur me zgjidhjen efektive të këtyre dy llojeve të shkeljeve, edhe pse janë të ngjashme, nuk janë plotësisht identike.

Zgjidhjet efektive të zvarritjes së procedurës gjyqësore deri në marrjen e vendimit përfundimtar në një rast të caktuar

Në rastet e zvarritjes së procedurës gjyqësore, GjEDNj-ja ka konstatuar fillimisht se, në mënyrë që të jetë “efektive”, ashtu siç kërkohet me nenin 13 të KEDNj-së, një zgjidhje efektive duhet “ose të *parandalojë* shkeljen e pretenduar [të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm] apo vazhdimin e saj, ose të parashikojë një *kompensim* për çdo

shkelje që ka ndodhur” (*Kudla*, GjEDNj, op. cit., par. 158).

Standardet e përgjithshme për zgjidhjen efektive të zvarritjes së procedurës gjyqësore deri në marrjen e vendimit përfundimtar në një rast të caktuar

Komiteti i Ministrave i ka sqaruar më hollësisht standardet për zgjidhjen efektive të zvarritjes së procedurës, duke iu referuar edhe praktikave më të mira të shteteve të ndryshme të Këshillit të Evropës. Afërsisht katër vjet pas aktgjykimit për rastin *Kudla*, Komiteti i Ministrave, në seancën e tij të 114-të, më 12 maj 2004, shpalli Rekomandimin Rec (2004)6, mbi “përmirësimin e zgjidhjeve në nivelin kombëtar”. Si pjesë të këtij Rekomandimi, Komiteti citoi disa zgjidhje të mundshme të zvarritjes së procedurës, të cilat ishin zbatuar nga shtetet e ndryshme anëtare të Këshillit të Evropës. Në këtë drejtim u theksuan tri lloje të zgjidhjeve.

Së pari, në ligjet e disa shteteve anëtare parashikohet një kohëzgjatje maksimale për çdo fazë të procedurave penale, civile dhe administrative (shih po aty, par. 21).

Së dyti, nëse këto afate të kohëzgjatjes maksimale nuk respektohen, sidomos në rastet penale, apo nëse kohëzgjatja e procedurës në ndonjë rast konsiderohet jo e arsyeshme, ligjet kombëtare të shumë shteteve anëtare parashikojnë se individ i prekur mund të parashtrijë kërkesë për përshpejtimin e procedurës. Me miratimin e kërkesës përcaktohet një datë deri në të cilën gjykata ose prokurori kompetent duhet ta kryejë një hap të procedurës, ose deri në të cilën duhet ta kryejë procedurën në tërësi (shih po aty, par. 22).

Së treti, në shumicën e shteteve anëtare ekzistojnë mekanizma për dhënien e kompensimit për zvarritjen jo të arsyeshme të procedurës, edhe në ato raste në të cilat procedura nuk ka përfunduar ende. Ky kompensim shpeshherë është kompensim financiar; ose, nëse autoriteti kompetent nuk nxjerr vendim lidhur me një kërkesë deri në afatin përfundimtar, kërkesa konsiderohet e miratuar me automatizëm. Në rastet penale, zvarritja e procedurës mund të rezultojë edhe në reduktimin e dënimit (po aty, par. 23).

Gjashtë vjet më vonë, Komiteti i Ministrave nxori edhe një rekomandim tjetër lidhur me zgjidhjet efektive për zvarritjen jo të arsyeshme të procedurës (*shih* Rekomandimin CM/Rec (2010)3, i miratuar më 24 shkurt 2010 në mbledhjen e 1077-të të zëvendësministrave). Ky dokument përfshin rekomandime edhe më konkrete dhe specifike sesa në vitin 2004 lidhur me këtë temë.

Në mes tjerash, Komiteti ka rekomanduar që qeveria e çdo shteti anëtar të sigurojë mekanizma për *identifikimin* e procedurave që rrezikojnë të zvarriten më shumë se ç’ duhet dhe për identifikimin e shkaqeve të zvarritjeve të tilla, me qëllim që në të ardhmen të shmangen shkeljet e kësaj natyre (po aty, Rekomandimi Nr. 2), si dhe të sigurojë *përshpejtimin* e rasteve të identifikuar (po aty, Rekomandimi Nr. 4).

Po ashtu, Komiteti i Ministrave ka rekomanduar që çdo shtet të zbulojë nëse problemi i zvarritjes procedurale është rezultat i një problemi *sistematik*, d.m.th. jo vetëm i rastësishëm dhe, nëse është në të vërtetë problem sistematik, t’i marrë masat për zgjidhjen e këtij problemi (po aty, Rekomandimi Nr. 3).

Komiteti rekomandon që shtetet anëtare t'i ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar që autoritetet kombëtare vendosin mekanizma, të cilët mund t'i adresojnë në mënyrë efektive pretendimet e palëve që u është shkelur e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (po aty, Rekomandimi Nr. 5), në lidhje me çdo hap të procedurës në rastet që kanë të bëjnë me përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile dhe me akuza penale (po aty, Rekomandimi Nr. 6).

Në ato raste specifike në të cilat, për shkak të zvarritjes, paraqitet shkelje e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, Komiteti i Ministrave rekomandon: (a) që procedura të përshpejtohet; ose (b) që kompensim t'u jepet viktimave për çdo disavantazh që mund të kishin vuajtur; ose (c) që të ndërmerren të dyja këto zgjidhje. Theksohet se opsioni i fundit është ai më i preferuari (po aty, Rekomandimi Nr. 7).

Po ashtu, shteteve anëtare u rekomandohet që kërkesat për përshpejtim ose kompensim të adresohen edhe vetë në mënyrë të shpejtë dhe që këto zgjidhje të jenë efektive, adekuate dhe të qasshme (po aty, Rekomandimi Nr. 8).

Në ato rastet ku jepet kompensim, shtetet anëtare duhet të sigurojnë që sasia/vlera e kompensimit të jetë e arsyeshme dhe të njohin se, në këtë kontekst, ka një supozim të fuqishëm, ndonëse edhe të kundërshtueshëm, se procedurat që zvarriten më shumë se që duhet, do të shkaktonin dëme jomateriale (po aty, Rekomandimi Nr. 9) dhe, duke marrë parasysh këtë fakt, të shqyrtojnë mundësinë e dhënies së mënyrave të caktuara të kompensimit jomaterial, si p.sh.: reduktimi i sanksioneve ose anulimi i procedurës në raste penale apo administrative (po aty, Rekomandimi Nr. 10).

Meqenëse kanë kaluar më shumë se 17 vjet prej se GjEDNJ-ja ka nxjerrë aktgjykim në rastin *Kudla*, ekziston një fond i pasur vendimesh i kësaj gjykate, në të cilat, mekanizma të ndryshëm për zgjidhjen e zvarritjes së procedurës janë gjykuar si efektivë ose joefektivë. Këta shembuj mund të shërbejnë, bashkërisht, si njëfarë udhërrëfyesi për zbatimin dhe respektimin e standardeve të përgjithshme të cekura në paragrafët e mësipërm.

Përveç rasteve të zvarritjes së procedurës gjyqësore *përpara* se të merret vendimi përfundimtar në një rast të caktuar, GjEDNJ-ja ka konstatuar se zvarritja e ekzekutimit të një vendimi të tillë *pasi* të merret, mundet gjithashtu të paraqet shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Për shembull, GjEDNJ-ja ka konstatuar: “*E drejta për gjykim të garantuar me nenin 6 do të ishte iluzore, nëse sistemit ligjor kombëtar i një Shteti Kontraktues do të lejonte që një vendim gjyqësor përfundimtar dhe i plotfuqishëm të mbetet i paefektshëm, në dëm të një pale*” dhe se “*qasja efektive në gjykatë përfshin të drejtën që një vendim gjyqësor të ekzekutohet pa vonesë të paarsyeshme*” (shih *Yuriy Nikolayevich Ivanov v. Ukraine*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 40450/04, 15 tetor 2009, par. 51, duke cituar *Hornsby v. Greece*, GJEDNJ, Aplikimi Nr. 18357/91, 19 mars 1997, par. 40 dhe *Immobiliare Saffi v. Italy*, Aplikimi Nr. 22774/93, par. 66).

Standardet e përgjithshme për zgjidhjen efektive të zvarritjes së ekzekutimit të vendimit përfundimtar

Siç u cek më lart, parimet kushtetuese për zgjidhjen efektive të zvarritjes se pajustificueshme në zbatimin e vendimeve gjyqësore, janë të ngjashme, por jo identike, me parimet për zgjidhjen efektive të zvarritjes përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konstaton se e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor obligon shtetin që në mënyrë primare të mbrojë këtë të drejtë përmes sistemit të tij ligjor duke vendosur garanci për qytetarët në ushtrimin e të drejtave në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor nuk do të jetë efektive nëse nuk ekziston mundësia e paraqitjes së ankesave pranë ndonjë autoriteti shtetëror për shkeljet e mundshme të së drejtës në gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Avokati i Popullit, në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmes raporteve mbi rastet, raporteve *ex officio*, si dhe raporteve vjetore ka ngritur tek autoritetet kompetente çështjen e shkeljes të së drejtës në gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor. Megjithatë, për çfarëdo ankesë lidhur me zvarritjen e procedurave gjyqësore, e cila ka ndikuar në shkeljen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor nuk ka ekzistuar ndonjë mjet efektiv juridik karshi këtyre ankesave që si rezultat do të mund ta kishin pasur ndonjë lehtësim në formë të parandalimit të shkeljes apo në të formë kompensimit.

Në këtë rast Avokati i Popullit rekomandoi ndërmarrjen e nismës legjislative për propozimin e ligjit për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, me të cilin do të përcaktoheshin mjetet efektive juridike për rastet që kanë të bëjnë me zvarritjen e procedurave gjyqësore, në pajtim me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 355/2016 në lidhje me të drejtat civile të qytetarëve shqiptarë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të zhvendosur në Republikën e Kosovës

Më 16 mars 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me të drejtat civile të shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të zhvendosur në Republikën e Kosovës. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve përgjegjëse shtetërore të Republikës së Kosovës lidhur me të drejtat civile për status dhe qëndrim ligjor dhe pajisje me dokumentacion personal të shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të shpërngulur në Kosovë.

Bazuar në informatat e pranuar nga Lëvizja Qytetare “Vatra”, pasuar me informata plotësuese nga artikujt e gazetave ditore: Koha Ditore, datë 10 janar 2017, me titull: “*Të zhvendosurit nga Lugina e Preshevës, në pritje të regjistrimit zyrtar*”; Gazeta Zëri, datë 28 janar 2017: “*Serbia mban peng të diplomuarit në Kosovë*”; dhe e njëjta më datë 19 janar 2017, me titull: “*Serbia si pranon, Kosova ua mohon shtetësinë*”. Avokati i Popullit ka hapur hetime sipas detyrës zyrtare.

Nga viti 2001, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve shqiptarë nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, për arsye të ndryshme, janë shpërngulur në territorin e Republikës së Kosovës, me përqendrim kryesisht në qytetin e Gjilanit, të Fushë Kosovës dhe të Prishtinës, përderisa numër i vogël i tyre janë shpërndarë nëpër qytete të tjera nëpër Kosovë. Në vitin 2011, Qeveria e Serbisë miratoi Ligjin për Qëndrim të Përhershëm dhe të Përkohshëm në Serbi, i publikuar në Gazetën Zyrtare të RS Nr.87/2011, i cili ka hyrë në fuqi më 29.11.2011. Me këtë ligj rregullohet regjistrimi dhe çregjistrimi i qëndrimit të përhershëm dhe regjistrimi dhe çregjistrimi i qëndrimit të përkohshëm jashtë vendit, juridiksionin dhe mënyrën e mbajtjes së shënimeve të duhura.³⁷⁸ Në kuptim të këtij ligji, të drejtën për banim të përhershëm në Republikën e Serbisë, e kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Serbisë që jetojnë në mënyrë të përhershme në territorin e Republikës së Serbisë.³⁷⁹ Hyrja në fuqi e këtij ligji ndikoi negativisht dhe krijoi komplikime ndaj qytetarëve shqiptarë të këtyre anëve lidhur me të drejtën e tyre për njohjen e identitetit para ligjit, përkatësisht pajisjen me dokumente personale, si kartat e identitetit dhe pasaportat, të lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë. Rrjedhimisht, ky ligj i kushtëzon qytetarët me lëshimin e dokumenteve personale, duke u kërkuar prova dhe duke bërë inspektime sipas nenit 18, nëse ata vazhdojnë të jetojnë në vendbanimin apo adresën e regjistruar.

Kjo çështje ka ringjallur problemet më komplekse në Republikën e Serbisë. Raporti i Komisionit Evropian për Serbinë, i vitit 2015³⁸⁰, i referohet çështjes rreth shifrave të pasakta të numrit të popullsisë, që kanë rezultuar nga bojkotimi i regjistrimit të shqiptarëve në vitin 2011. Pra, bëhet fjalë për një numër të madh të qytetarëve të komunave Preshevë, Medvegjë dhe Bujanoc, ndaj të cilave është ndërmarrë apo pritet të ndërmerret sanksioni i shlyerjes nga evidenca, përmes një aksioni të gjerë nga policia serbe, për të cilët, sipas tyre, vërtetohet se vazhdojnë të mos jetojnë në adresat e paraqitura, edhe pse bëhet fjalë për personat të cilët posedojnë nënshtetësinë e Republikës së Serbisë, kanë patundshmëri në ato komuna dhe janë tatimpagues në këtë shtet. Personave, të cilët janë shlyer nga evidenca për arsyet e cekura më lart, u refuzohet e drejta për pajisje me dokumentacion personal, me ç’ rast ata privohen në realizimin e të drejtave të tyre elementare.

Sipas deklaratave të qytetarëve të prekur nga ky ligj, përkatësisht shqiptarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, dispozita ligjore e nenit 18 të Ligjit për Qëndrim të Përhershëm dhe të Përkohshëm në Serbi, e cila rregullon procedurat për regjistrimin dhe çregjistrimin e përhershëm dhe të përkohshëm të vendbanimit, është duke u zbatuar

³⁷⁸ Ligji për Qëndrim të Përhershëm dhe të Përkohshëm në Serbi, (titulli origjinal: *O Prebivalistu i Boravistu Gradana*), Nr. 87/2011, neni 1,

http://www.paragraf.rs/propisi/zakon_o_prebivalistu_i_boravistu_gradjana.html

³⁷⁹ Po aty, neni 2.

³⁸⁰ European Commission, “*Commission Staff Working Document, Serbia 2015 Report*”, Faqe 58, gjendet në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_serbia.pdf.

vetëm ndaj popullatës shqiptare, që aktualisht jeton në Kosovë. Shqiptarët e Preshevës, të Medvegjës dhe të Bujanocit e konsiderojnë këtë veprim të Republikës së Serbisë si veprim qartazi diskriminues. Një numër i madh i qytetarëve të komunave në fjalë, të cilët janë shpërngulur në Kosovë, për arsye të sigurisë apo aspekteve sociale dhe ekonomike, në mungesë të dokumenteve personale, për një kohë të gjatë po përballën me çështje të mbetjes pa status dhe qëndrim ligjor, pa shtetësi efektive dhe dokumente personale identifikimi brenda territorit të Republikës së Kosovës.

Bazuar në informatat që i ka Avokati i Popullit, ende nuk ka statistika zyrtare apo ndonjë formë regjistrimi rreth numrit të saktë të shqiptarëve të shpërngulur nga Serbia në Kosovë, ndërsa, nëse i referohemi informatave jozyrtare, është pohuar se janë diku rreth 3500 persona që nuk kanë asnjë dokument të Republikës së Kosovës. Sipas informatave nga Lëvizja Qytetare “Vatra” drejtuar Avokatit të Popullit, këta pjesëtarë që 17 vjet nuk kanë arritur të pajisen me dokumentacion identifikimi të Republikës së Kosovës dhe nuk kanë arritur ta fitojnë të drejtën e shtetësisë, për shkak të mungesës së dokumentacioneve përkatëse të shtetit prej nga vijnë.

Rrjedhimisht, meqë një numër i tyre nuk kanë dokumente personale të vlefshme, për arsyet e cekura më lart, të njëjtëve u është pamundësuar t’i ndjekin procedurat për fitimin e shtetësisë së Republikës së Kosovës, pavarësisht qëndrimit mbi 15 vjet. Kushtimisht, këta qytetarë po përballen me mungesën e statusit të qëndrimit ligjor, pa shtetësi, qoftë të Serbisë apo edhe të Kosovës, të dy shtete këto të cilat ligjërisht e njohin shtetësinë e dyfishtë.

Më 6 qershor 2013, Kuvendi i Republikës së Kosovës miratoi Rezolutën Nr. 04-R-011, lidhur me të drejtat e shqiptarëve, përmes së cilës kërkon nga Qeveria e Republikës së Kosovës të ketë më shumë përkujdesje dhe trajtim më të mirë për qytetarët shqiptarë të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, të cilët janë zhvendosur në Kosovë, duke u garantuar të drejta të plota dhe të barabarta. Përveç tjerash, pika 4 e kësaj rezolute shprehimisht përcakton krijimin e lehtësirave për këtë komunitet: *“Të krijohen lehtësi të qarkullimit, shkollimit, afirmimit kulturor, pajisjeve me dokumente përkatëse si dhe lehtësi tjera, duke përfshirë suspendimin e taksës diskriminuese.”*

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në rastin *Kurić dhe të Tjerë kundër Sllovenisë*, gjeti shkelje të së drejtës për respektimin e “jetës private ose familjare” ose të dyjave (neni 8 i Konventës), të drejtën për zgjidhje efektive (neni 13) dhe ndalimin e diskriminimit (neni 14, i lexuar bashkë me nenin 8) në lidhje me fshirjen nga regjistri i banorëve të përhershëm nga autoritetet sllovene, me ç’ rast rezultoi me humbjen e statusit ligjor të kërkuesve z. Kurić, znj. Mezga, z. Ristanović, z. Berisha, z. Ademi dhe z. Minić. Për pasojë, jo vetëm kërkuesit në këtë çështje, por gjithashtu edhe një numër i madh personash të tjerë ishin prekur dhe ende vazhdonin të prekeshin nga ajo masë. GjEDNj-ja gjeti që shkelja në thelb kishte filluar me dështimin e zgjatur të autoriteteve sllovene që ta rregullonin statusin e qëndrimit të kërkuesve pas “fshirjes” së tyre të paligjshme nga regjistri i banorëve të përhershëm dhe për t’u ofruar atyre një zgjidhje të përshtatshme.

Gjykata gjithashtu thotë se kërkuesit mund të pretendojnë se janë “viktima”, sipas nenit 34 të Konventës, për shkeljet e përmendura të të drejtave të tyre që rrjedhin nga Konventa.³⁸¹

Fryma për zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut është se këto nuk i gëzojnë vetëm një pjesë e kufizuar e qytetarëve të një shteti. Ato janë të vlefshme për çdo individ, pavarësisht nga kombësia apo shtetësia, si azilkërkuesit, refugjatët, punëtorët emigrantët dhe personat e tjerë, që ndodhen në territorin e një shteti tjetër ose janë nën juridiksionin e tij.

Në bazë të këtyre konstatimeve, Avokati i Popullit i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëhet profilizimi i numrit të saktë të qytetarëve nga Presheva, Medvegja dhe Bujanoci, të cilët po qëndrojnë pa status të definuar juridik në territorin e Republikës së Kosovës, si dhe të ndërmerren masat e nevojshme për rregullimin e kuadrit ligjor, që u mundëson këtyre qytetarëve t’i gëzojnë të drejtat themelore dhe elementare të njeriut.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 412/2017 në lidhje me vendimin për pagesën e provimit të maturës shtetërore, i datës 16.5.2017 me nr. 2-1843

Më 5 prill 2018, Avokati i Popullit publikoi raportin *Ex officio* nr. 412/2017 në lidhje me Vendimin për pagesën e Provimit të Maturës Shtetërore, i datës 16.5.2017, me nr. 2-1843. Raporti ka për qëllim vlerësimin e Vendimit për pagesën e Provimit të Maturës, i datës 16.05.2017, me nr. 2-1843 dhe nëse ky Vendim është në pajtim me parimin e sundimit të ligjit dhe ligjshmërinë.

Në dhjetor të vitit 2008 është nxjerrë *Ligji nr. 03/L-018 për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore* (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Prishtinë: viti III / nr. 44/22 dhjetor 2008) (në tekstin e mëtejme *LPPMSh*). Në bazë të këtij ligji është mbajtur provimi i maturës shtetërore nga viti 2008 deri në janar të vitit 2016. Në janar të vitit 2016 është shfuqizuar ky ligj nga *Ligji nr. 05/L-018 për Provimin e Maturës Shtetërore* (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.2/8 janar 2016, Prishtinë) (në tekstin e mëtejme *LPMSH*). Në qershor të vitit 2017 është mbajtur provimi i maturës shtetërore duke u bazuar në *LPMSH* dhe Vendimin e Komisionit Shtetëror të Maturës për pagesën e provimit të Maturës Shtetërore.

Pavarësisht faktit që kërkesa për pagesë nuk ekziston më sipas ligjit të ri tek neni 16, paragrafi 3 i *LPMSH*-së, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (*MAShT*), përkatësisht Komisioni Shtetëror i Maturës, ka nxjerrë vendim ku në pikën 1 dhe 2 ka përcaktuar: “1. Të gjithë nxënësit të cilët kanë shkollën e mesme të lartë dhe i nënshtrohen Provimit të Maturës duhet të sjellin dëshmi nga banka për kryerjen të pagesës në vlerë prej 5 euro. 2. Fletëpagesa përdoret si dëshmi për pjesëmarrje në Provimin e Maturës Shtetërore. (...).”

³⁸¹ GjEDNj, Vendim, Kurić dhe të Tjerë kundër Sllovenisë, (lënda nr. 26828/06), Stranbourg, 12.3.2014.

Avokati i Popullit vëren se ligji i ri i 8 janarit 2016 për Provimin e Maturës Shtetërore qëndron i heshtur sa i përket çështjes së pagesës. Ndryshe nga neni 17, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 i ligjit të mëparshëm për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, i datës 22 dhjetor 2008, i cili përmend në mënyrë eksplicite se, së bashkë me fletëparaqitjen, kandidati paraqet edhe **dëshminë për kryerjen e pagesës në bankë**. Është e qartë se hartuesit e ligjit dhe ndryshimet që janë bërë kanë zgjedhur që ta fshijnë paragrafin 3.3 me qëllim që të shmangë detyrimin për pagesën e provimit nga sistemi i paraparë nga neni 17, paragrafi 3, nënparagrafi 3.3 i ligjit të mëparshëm për provimin përfundimtar dhe provimin e maturës shtetërore, i datës 22 dhjetor 2008.

Megjithatë, përkundër kritereve të parapara në ligj, MASHT-i, përkatësisht Komisionit Shtetëror i Maturës, nxjerr vendim ku e përcakton si kriter shtesë dhe i obligon të gjithë nxënësit që të kryejnë pagesë në bankë për t'iu nënshtruar provimit të maturës duke u bazuar në nenin 8 dhe 9 të LPMSH-së.

Avokati i Popullit vëren se MASHT-i, përkatësisht Komisioni Shtetëror i Maturës, duke u bazuar në dispozitat e lartcekura, anashkalon bazën ligjore për përcaktimin e këtij kriteri shtesë të pagesës për të hyrë në provimin e maturës shtetërore, i cili kriter fare nuk përmendet në LPMSH dhe fare nuk i jep kompetenca MASHT-it, përkatësisht Komisionit Shtetëror të Maturës, që të përcaktojë kritere shtesë.

Kriteret për t'iu nënshtruar provimit të maturës janë përcaktuar në nenin 16 të LPMSH-së dhe është një listë shteruese, e cila nuk lë hapësirë për të shtuar kritere shtesë siç ka bërë MASHT-i, përkatësisht Komisioni Shtetëror i Maturës, duke nxjerrë vendim ku e përcakton si kriter shtesë dhe i obligon të gjithë nxënësit që të paguajnë për t'iu nënshtruar provimit të maturës.

Për këto arsye, në pajtim me gjetjet e lartcekura, Avokati i Popullit konstaton se Vendimi për pagesën e Provimit të Maturës, i datës 16.5.2017, me nr. 2-1843, i nxjerrë nga MASHT-i, përkatësisht nga Komisioni Shtetëror i Maturës, i shkel të drejtat dhe liritë e njeriut, për faktin se është në kundërshtim me parimet bazë të funksionimit të shtetit demokratik, siç është parimi i ligjshmërisë, parimi kushtetues i sundimit të ligjit dhe parimi i sigurisë juridike, sepse nuk ka bazë ligjore në LPMSH për nxjerrjen e një vendimi të tillë.

Për këtë arsye i rekomandoi MASHT-it që, në pajtim me kompetencat dhe përgjegjësitë e legjislacionit përkatës në fuqi, ta shpallë të pavlefshëm Vendimin për pagesën e Provimit të Maturës Shtetërore, i datës 16.05.2017, me nr. 2-1843, i nxjerrë nga Komisioni Shtetëror i Maturës.

Raport për rastin *Ex officio nr. 235/2018* në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës, për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 vjetëve, si pasojë e largimit diskriminues nga puna

Më 6 prill 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me kategorinë e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk përfitojnë nga pensioni kontributpagues i moshës, për shkak se nuk e plotësojnë kriterin e stazhit pensional prej 15 vjetëve, si pasojë e largimit diskriminues nga puna. Qëllimi i këtij raporti parashtrohet nevojën e rregullimit të pensionit kontributpagues për kategorinë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 vjetëve, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme të vendosura në Kosovë. Raporti tërheq vëmendjen mbi nevojën e rregullimit ligjor të çështjes së përfitimit të pensionit kontributpagues për qytetarët e Republikës së Kosovës që kanë punuar para vitit 1999, por që nuk e kanë arritur kriterin e stazhit pensional prej 15 vjetëve, për shkak të largimit nga puna në baza diskriminuese në vitet e 90-ta; ta prezantojë gjendjen faktike në lidhje me rrethanat apo arsyet e largimit nga puna për një pjesë të qytetarëve në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, si shkak i mosplotësimit të kriterit për stazh pensional prej 15 vjetëve; ta analizojë legjislacionin që ka qenë në fuqi para vitit 1999, duke bërë një interpretim qëllimor të dispozitës që ka përcaktuar kriterin e stazhit pensional prej 15 vjetëve. Gjithashtu do të analizohet edhe legjislacioni aktual i Republikës së Kosovës për këtë qëllim; t'i theksojë parimet themelore të të drejtave të njeriut, sidomos në lidhje me mosdiskriminimin dhe obligimet pozitive që shteti duhet t'i ketë në raport me qytetarët, që burojnë edhe nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe nga standardet ndërkombëtare. Në fund, duke vënë në pah këto detyrime, Avokati i Popullit synon të japë edhe rekomandime konkrete në bazë të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore të tij.

Në lidhje me të drejtat dhe trajtimin e pensionistëve në Kosovë, Avokati i Popullit rithekson se kategoria e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 vjetëve, për shkak të largimit nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, paraqesin sfidën kryesore për trajtim nga shteti i Kosovës.

E drejta e përfitimit të pensionit kontributpagues për këtë kategori të qytetarëve të Kosovës është një çështje e veçantë (*sui generis*) dhe komplekse. Kjo ka të bëjë me faktin se me ligjin e asaj kohe (para vitit 1999), si kriter për përfitimin e këtij lloji të pensionit është përcaktuar stazhi pensional prej 15 vjetëve, por për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme, përkatësisht vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë, një pjesë e qytetarëve të Kosovës nuk e kanë arritur këtë kriter, pa fajin e tyre, për shkak të largimit diskriminues nga puna. Në anën tjetër, kompleksiteti i kësaj çështjeje shprehet me nevojën e ndryshimit të legjislacionit në mënyrë afirmative, për shkak të rrethanave të reja dhe të jashtëzakonshme që kanë ndodhur, përkundër kriterit të përcaktuar me ligjin

që ka qenë në fuqi në kohën kur këta qytetarë kanë themeluar marrëdhënien e punës. Në anën tjetër, edhe legjislacioni aktual i Kosovës, të drejtën e përfitimit të pensionit kontributpagues të moshës e ka rregulluar duke u bazuar në të njëjtin kriter që kanë përcaktuar ligjet e asaj kohe, që të drejtë të përfitimit kanë vetëm punëtorët të cilët e kanë arritur stazhin pensional prej 15 vjetëve.

Avokati i Popullit rikujton gjithashtu se, përveç anës ligjore, kjo çështje për shtetin e Kosovës mund të paraqitet si sfiduese edhe në raport me mundësitë buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për dhënien e pensioneve për kategorinë në fjalë. Kjo problematikë është trashëguar nga periudha e paraluftës dhe nga rrethanat të cilat janë paraqitur në Kosovë. Siç dihet edhe nga aspekti i legjislacionit, Kosova ka trashëguar ligjet e ish-Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KSAK) dhe ligjet federative të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (ish-RSFJ), përfshirë edhe fushën e pensioneve. E drejta për pension kontributpagues para vitit 1999 është rregulluar me Ligjin nr. 011-24/83 për Sigurimin Pensional Invalidor, publikuar në Gazetën Zyrtare të KSAK-së nr. 26/83 (në tekstin e mëtejshëm *Ligji Nr. 011-24/83 i KSAK*) dhe Ligjin Federativ të ish-RSFJ-së, ku është përcaktuar kriteri i lartpërmendur prej 15 vjetëve i stazhit pensional për të fituar të drejtën e pensionit kontributpagues. Si të tilla, këto ligje nuk janë konsideruar se kanë karakter diskriminues dhe sigurisht për kohën kur janë miratuar nuk ka pasur një përmbajtje të tillë.

Megjithatë, Avokati i Popullit rithekson se për një kategori të qytetarëve të Kosovës largimi diskriminues nga puna në kohën e masave të dhunshme ka qenë shkak kryesor pse nuk e kanë arritur kohën e stazhit pensional prej 15 vjetëve. Andaj ky fakt përbën rrethanë të re dhe të jashtëzakonshme përtej dispozitës së ligjit, i cili ka qenë në fuqi dhe i ka përcaktuar kriteret e përfitimit të së drejtës për pension kontributpagues. Mbi këtë bazë, Avokati i Popullit vlerëson se e drejta për pensionin kontributpagues për qytetarët e kësaj kategorie duhet të përcaktohet jo vetëm në lidhje me kriterin që ka përcaktuar ligji i asaj kohe (stazhin pensional prej 15 vjetëve), por edhe duke vlerësuar faktin se largimi nga puna është bërë në mënyrë diskriminuese në kohën e masave të dhunshme.

Avokati i Popullit konsideron se mund të identifikohen tri kategori të personave që kanë punuar para vitit 1999 dhe nuk e kanë arritur kriterin për stazh pensional prej 15 vjetëve:

- Të punësuarit para vitit 1989, të cilët janë larguar nga puna në kohën e vendosjes së masave të dhunshme;
- Të punësuarit para vitit 1989 dhe që kanë vazhduar të punojnë deri në vitin 1999; dhe
- Të punësuarit pas vitit 1989, pas vendosjes së masave të dhunshme në Kosovë.

Ky klasifikim bëhet me qëllim që edhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës, ta marrë në konsideratë gjatë kategorizimit të personave, të cilët mund të përfitojnë nga skema e pensionit kontributpagues të moshës për punën e kryer para vitit 1999.

Në bazë të analizës së bazës ligjore, faktike dhe konstatimeve të arritura, Avokati i Popullit u rekomandoi institucioneve të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin masat e

nevojshme me qëllim të garantimit të së drejtës për pension kontributpagues të moshës për qytetarët, të cilët kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuëse; Qeverisë së Republikës së Kosovës i rekomandoi që në kuadër të kompetencave të veta kushtetuese dhe ligjore, t'i ndërmarrë masat e nevojshme që në afat sa më të shpejtë të fillohet ndryshimi i bazës ligjore dhe ta propozojë në Kuvendin e Republikës së Kosovës draft-ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti, në mënyrë që kategoria e qytetarëve që kanë punuar para vitit 1999 dhe janë larguar nga puna mbi baza diskriminuëse, të përfitojnë nga pensioni kontributpagues. Për këtë qëllim është e nevojshme që të përcaktohen detyrat përkatëse edhe për ministrinë e linjës, në lidhje me përgatitjen e ndryshimeve ligjore dhe planifikimet buxhetore, dhe sipas nevojës, të themelohet edhe një grup punues ndërministror, ndërsa MPMS-së që ta përgatisë draftin dhe të iniciojë ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (LSPFSh), përkatësisht nenin 8 të tij, në mënyrë që edhe personat që kanë punuar para vitit 1999 dhe që nuk e kanë arritur stazhin pensional prej 15 vjetëve, për shkak të largimit diskriminues nga puna, t'u njihet e drejta për të përfituar nga pensioni kontributpagues; që të bëjë identifikimin dhe klasifikimin e kësaj kategorie të qytetarëve të Kosovës në bazë të dëshmimeve relevante; që pas ndryshimit të ligjit të ndryshojë edhe Udhëzimin Administrativ nr. 09/2015 për kategorizimin e shfrytëzuesve të pensionit kontributpagues sipas strukturës kualifikuese dhe kohëzgjatjes së pagesës së kontributeve-stazhit pensional. Ministrisë së Financave i rekomandoi që t'i ndërmarrë masat e duhura që, përveç mjeteve nga fondi pensional, sipas nevojës, të parashikojë mjete financiare shtesë në planin e Buxhetit Shtetëror, me qëllim të dhënies së pensioneve për këtë kategori të qytetarëve. Në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve ligjore, në afat sa më të shpejtë, ta propozojë kategorizimin e këtyre pensionistëve në pajtim me kapacitetet që ka buxheti i Republikës së Kosovës.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 214/2018 në lidhje me arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës

Më 27 prill 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës. Qëllimi kryesor i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për respektimin e të drejtave të personave të arrestuar dhe personave subjekt i largimit me forcë apo ekstradimit nga territori i Republikës së Kosovës, në pajtim me Kushtetutën, me ligjet e aplikueshme si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Hetimet e Avokatit të Popullit filluan pas informacioneve të publikuara nga mjetet e informimit publik RTK, RTV 21 dhe media tjera, më 29 mars 2018, për arrestimin dhe largimin me forcë nga Republika e Kosovës të gjashtë shtetasve turq.

Të dëbuarit z. Mustafa Erdem, Drejtorja për Shtetësi Azil dhe Migrim (në tekstin e mëtejshëm *DShAM*), më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 91, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe në

nenin 26 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Erdem ishte valid deri më 23 shkurt 2021. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L219 dhe të nenit 8, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Erdem, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Të dëbuarit z. Hasan Huseyin Demir, DShAM-ja, më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 66, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe në nenin 48, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, të nenit 23 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Demir ishte valid deri më 21 qershor 2018. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L219 dhe të nenit 8, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të z. Demir, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Të dëbuarit z. Yusuf Karabina, DShAM-ja, më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 91, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, paragrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe në nenin 26 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Karabina ishte valid deri më 3 gusht 2022. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L219 dhe të nenit 8, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të z. Karabina, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Të dëbuarit z. Cihan Özkan, DShAM-ja, më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin bazuar në nenin 66, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe në nenin 48, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe në nenin 23 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Cihan ishte valid deri më 21 shtator 2018. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 i Ligjit nr. 04/L219 dhe të nenit 8, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të z. Özkan, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Të dëbuarit z. Kahraman Demirez, DShAM-ja, më 23 mars 2018, ia revokoi leje qëndrimin e tij bazuar në nenin 91, paragrafi 1, nënparagrafi 2, 3 dhe 4 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt dhe në nenin 26 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 01/2014 për

Procedurën e Lëshimit të Lejes së Qëndrimit për të Huajt dhe Vërtetimit të Lejes së Punës. Leje qëndrimi në rastin e z. Demirez ishte valid deri më 23 shkurt 2021. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në Policinë e Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L219 dhe të nenit 8, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të z. Demirez, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Të dëbuarit z. Osman Karakaya, sipas DShAM-së, leje qëndrimi i kishte skaduar dy muaj më herët dhe kërkesa për vazhdim nuk u aprovua, për shkak të vlerësimit nga organi kompetent se përbën rrezik për sigurinë kombëtare. Më 29 mars 2018, Drejtoria për Migrim dhe të Huaj e Policisë së Kosovës, në bazë të nenit 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 të Ligjit nr. 04/L219 dhe të nenit 8, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës, lëshoi Urdhër për Largim me Forcë të Z. Karakaya, i cili u zbatua në të njëjtën ditë.

Po në të njëjtën ditë mediat publikuan një komunikatë nga DShAM-ja e MPB-së, në të cilën theksohej: *“... ne si organ kompetent, gjatë administrimit të provave kemi konstatuar se për personat në fjalë, ka bazë të mjaftueshme ligjore që të merren masat për revokimin e leje qëndrimit të tyre në territorin e Republikës së Kosovës për arsye të përcaktuara me ligjin për të huaj, konkretisht nenit 6 të ligjit ku flet për refuzimin apo revokimin e lejes së qëndrimit për rrethanat e sigurisë shtetërore”*. Më 30 mars 2018, Departamenti për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar në Çështje Penale i Ministrisë së Drejtësisë e njoftoi Avokatin e Popullit se pranë këtij departamenti nuk janë zhvilluar procedura për ekstradim për personat e arrestuar dhe të larguar me forcë nga territori i Republikës së Kosovës.

Më 29 mars 2018, Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm *MKPT*) i Avokatit të Popullit kërkoi nga Qendra e Mbajtjes për të Huajt (në tekstin e mëtejshëm *QMH*) që ta njoftojë nëse të huajt e arrestuar gjenden në këtë qendër. Zyrtari kompetent i QMH-së e njoftoi MKPT-së se personat në fjalë nuk janë dërguar fare në QMH.

Më 29 mars 2018, Avokati i Popullit, përmes postës elektronike zyrtare, kërkoi nga Policia e Kosovës dhe DShAM-ja ta njoftojnë lidhur me rastin në fjalë. Në të njëjtën ditë, MKPT-ja e vizitoi Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë (QRM) ku u njoftua se të arrestuarit në fjalë nuk gjenden në këtë qendër.

Më 29 mars 2018, mediat në Kosovë e publikuan një lajm i cili i referohej gazetës turke “Hurriyet” në të cilin thuhej se Agjencia Kosovare e Inteligjencës në bashkëpunim me Agjencinë Turke të Inteligjencës e realizuan këtë operacion të suksesshëm të arrestimit, duke iu referuar personave të arrestuar dhe të dëbuar nga territori i Republikës së Kosovës. I njëjti medium publikoi edhe fotografitë e personave të arrestuar.

Më 30 mars 2018, MKPT-ja e vizitoi Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë (QRM), me ç' rast ekipi monitorues zhvilloi një inspektim të hollësishëm për të verifikuar nëse personat në fjalë mbahen apo ishin mbajtur ditë më parë në këtë qendër. Ekipi monitorues po ashtu kontrolloi të gjithë regjistrat zyrtarë në Qendrën Rajonale të Mbajtjes dhe konstatoi se të arrestuarit nuk gjendeshin në këtë qendër dhe nuk ishin dërguar fare aty.

Më 30 mars 2018, MKPT-ja e zhvilloi një takim zyrtar me drejtorin e DShAM-së dhe nga ky departament iu dorëzuan kopjet e vendimeve të DShAM-së për revokimin e lejeve të qëndrimit në Republikën e Kosovës për personat në fjalë. Me këtë rast, MKPT-ja kërkoi që DShAM-ja t'ia dorëzojë MKPT-së kopjet e dosjeve të secilit person të arrestuar.

Më 30 mars 2018, MKPT-ja, përmes postës elektronike zyrtare, kërkoi nga Drejtoria për Migrim dhe të Huaj në kuadër të Policisë së Kosovës që t'ia dërgojë dokumentet relevante lidhur me arrestimin dhe largimin me forcë të gjashtë shtetasve turq nga territori i Republikës së Kosovës.

Po në të njëjtën ditë, paradite, MKPT-ja kërkoi takim me zyrtarët kompetentë nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës për të marrë dokumentacion relevant dhe për t'u njoftuar me procedurat e zbatuara në rastin e arrestimit, të largimit me forcë dhe vendndodhjen e këtyre personave. Takimi nuk u realizua, mirëpo nga MKPT-ja u kërkua që takimi të caktohet përmes kërkesës me shkrim.

Më 30 mars 2018, në orën 14:00, Drejtoria për Migrim dhe të Huajt, përmes postës elektronike zyrtare, ia dërgoi MKPT-së "Urdhrat për Largim me Forcë" nga territori i Republikës së Kosovës për gjashtë shtetasit turq. Me këtë rast, MKPT-ja po ashtu u njoftua se personat në fjalë nga kjo Drejtori janë përcjellë menjëherë dhe në të njëjtën ditë janë dëbuar në shtetin e tyre të origjinës.

Më 30 mars 2018, Avokati i Popullit publikoi Deklaratë në të cilën ndër të tjera theksohet: *"Avokati i Popullit është jashtëzakonisht i shqetësuar me situatën e krijuar, që nga marrja e informatës për arrestimin e gjashtë shtetasve turq, me leje qëndrimi në vendin tonë. Janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të siguruar informacion zyrtar për vendndodhjen dhe gjendjen e tyre, mënyrën e arrestimit dhe aktin e deportimit drejt shtetit të Turqisë, por kjo ka qenë e pamundur gjatë ditës së djeshme dhe paraditen e sotme. Pas insistimit të pandërprerë të Avokatit të Popullit, Policia e Kosovës (PK), respektivisht Drejtoria për Migrim dhe të Huaj (DMH), sot, më 30 mars 2018, në ora 14:00, ka njoftuar se, nga ana e DMH-së së PK-së, më datë 29 mars 2018, janë nxjerrë gjashtë Urdhra për largim me forcë të shtetasve në fjalë, nga territori i Republikës së Kosovës, për në Turqi. Lëshimi i këtyre Urdhër largimeve me forcë, është aplikuar duke u bazuar në Vendimet e Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion (DSHAM) të MPB-së, që mbajnë datën 23 mars 2018, të përcjella tek DMH, më 28 mars 2018. Sipas njoftimit të PK-së, shtetasit në fjalë janë ndaluar më 29 mars 2018 dhe janë përcjellë të njëjtën ditë, në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, nga ku ka ndodhur dëbimi për në shtetin e tyre të origjinës. Gjatë ditës së djeshme, Avokati i Popullit, po ashtu, ka kontaktuar DSHAM-në në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe ka kërkuar të dijë nëse*

personat në fjalë po mbahen në Qendrën e mbajtjes për të huajt, por është njoftuar se ata nuk janë dërguar aty. Ndërkaq, gjatë ditës së sotme, po nga i njëjti Departament, është pranuar njoftimi se ka pasur Vendime për revokimin e leje qëndrimit të personave veç e veç dhe na janë përcjellë kopjet e këtyre Vendimeve. Duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe kompleksitetin e rastit dhe konfuzionin e autoriteteve mbi linjën e përgjegjësisë, Avokati i Popullit ka vendosur të hap rast Ex Officio, për të hetuar në detaje veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike. Sidoqoftë, në këtë fazë, Avokati i Popullit pohon që veprimet e ndërmarra nga autoritetet publike janë në kundërshtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut, të zbatueshme në sistemin e brendshëm juridik të Republikës së Kosovës. Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, saktëson qartë garancitë procedurale në lidhje me dëbimin e të huajve. Në kuptim të nenit 3, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 13 të KEDNJ-së, ashtu si edhe Parimit themelor të mos-kthimit (non-refoulement) sipas Konventës për Refugjatët të vitit 1951, përgjegjësia bie tek autoritetet shtetërore kompetente lidhur me situatën e krijuar. Mbi të gjitha, garancitë e nenit 3 (ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës) dhe nenit 6 (e drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të KEDNJ-së, në shoqëritë demokratike, nuk mund të shfuqizohen (dërgohen), as në rrethanat e jashtëzakonshme.

Më 30 mars 2018, Avokati i Popullit, përmes postës elektronike zyrtare, kërkoi nga Agjencia e Kosovës për Inteligjencë (AKI) që t'i dërgohet raporti i vlerësimit dhe i rekomandimeve të kësaj agjencie lidhur me personat në fjalë. Pas takimit me përfaqësuesin e AKI-së, Avokati i Popullit u njoftua se informacioni i kërkuar cilësohet i klasifikuar, i përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1.3.1 të Ligjit nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Sipas nenit 22, paragrafi 2 të këtij ligji: “Vetëm Presidenti i Republikës së Kosovës, Kryetari i Kuvendit të Kosovës dhe Kryeministri janë të autorizuar të kenë qasje në informacionet e klasifikuara.”

Më 30 mars 2018, pas kërkesës se avokatit mbrojtës dhe dyshimit të familjareve se ata ende po mbahen në hapësirat e aeroportit, ekipi monitorues i MKPT-së realizoi një vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës me qëllim të verifikimit nëse personat e arrestuar po mbaheshin ende aty. Përkundër insistimit të ekipit monitorues që të ketë qasje në hapësira dhe dokumentacion, ekipit nuk iu lejua qasja, duke ia pamundësuar kështu kryerjen e detyrës zyrtare në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Avokatin e Popullit.

Më 31 mars 2018, Gazeta Express publikoi një artikull që i referohet deklaratës së prokurorit Reshat Millaku nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, i cili deklaroi se rreth kësaj çështjeje para disa ditësh kanë marrë kërkesë për ekstradim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës. Më tej në këtë artikull prokurori në fjalë deklaroi: “Ne për këtë çështje nuk kemi nisur hetime. Por ka pasur kërkesë për ekstradim por nuk kemi vepru. Kërkesa ka shku përmes Ministrisë së Drejtësisë së Turqisë, drejtuar

Ministrisë së Drejtësisë sonë. Ne nuk kemi vepru se nuk e kemi pa të arsyeshme të veprimet.”

Më 3 prill 2018, avokati mbrojtës i personave të arrestuar dhe të larguar me forcë nga territori i Republikës së Kosovës e njoftoi Avokatin e Popullit se Urdhri për Largim me Forcë i Policisë së Kosovës dhe Vendimi për Revokim të Lejeve të Qëndrimit i DShAM-së nuk u është dorëzuar as klientëve të tyre dhe as avokatëve mbrojtës.

Më 6 prill 2018, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, së bashku me zyrtarët e Zyrës së Komisionarit të Lartë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, u takuan me familjarët e shtetasve turq të larguar me forcë nga territori i Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit, nga dokumentet e pranuar, vëren se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, më 29 mars 2018, ka lëshuar Urdhër për Largim me Forcë bazuar në nenin 6, 97 dhe 99, paragrafi 2 të Ligjit për të Huajt nr. 04/L-2019 dhe në nenin 8, paragrafi 1 i Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 09/2014 për Kthimin e të Huajve me Qëndrim të Paligjshëm në Republikën e Kosovës. Në arsyetimin për secilin Urdhër për Largim me Forcë qëndrojnë arsyet e njëjta. Në secilin vendim theksohet: ... [qëndrimi i tij i mëtejshëm në Republikën e Kosovës mund të paraqet kërcënim që lidhet me sigurinë shtetërore dhe rendin publik...]. Në të njëjtat vendime theksohet se ky akt mund të kundërshtohet me ankesë në Komisionin për Shqyrtim të Ankesave për të huajt brenda 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimit të tij. Ankesa dorëzohet personalisht apo nëpërmjet të autorizuarit juridik. Po ashtu në vendim shprehimisht theksohet se ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Avokati i Popullit vëren se në rastin e tanishëm autoritet kompetente ndërmorën veprime për të larguar me forcë të huajt në fjalë pa koordinime në mes të institucioneve në bazë të mandateve të cilat i kanë, si dhe me mungesë transparence, e cila është parimi kryesor i mirëqeverisjes në një vend. Nga informatat e grumbulluara deri më tani është e qartë se personat në fjalë u larguan me forcë nga territori i Republikës së Kosovës për t'u dorëzuar tek autoritetet policore turke, të cilat menjëherë i arrestuan dhe i akuzuan për kryerjen e veprës penale të terrorizmit.

Sipas nenit 3.1.26 të Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt, largimi me forcë definohet si *“ekzekutim i obligimit për t'u kthyer, përkatësisht transportim fizik jashtë Republikës së Kosovës”*. Po ashtu, nga takimi i përfaqësuesve të Avokatit të Popullit me Kryeprokurorin e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës del se Prokuroria Speciale ka pranuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dy kërkesa të Ministrisë së Drejtësisë së Turqisë për ekstradimin e dy personave, të cilët u ekstraduan së bashku me të tjerët, të cilat janë përcjellë nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës me një shkresë përcjellëse, më datë 26 shkurt 2018.

Më tej, sipas Kryeprokurorit, Ministria e Drejtësisë së Turqisë, nëpërmjet Ambasadës së saj në Prishtinë, ia ka përcjellë Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës kërkesën për

ekstradimin e dy shtesave turq (z. Kahraman Demirez dhe z. Yusuf Karabina) me qëndrim në Kosovë, lidhur me dyshimet për kryerjen e veprës penale për terrorizëm.

Avokati i Popullit vlerëson se në raste të tilla është dashur të zbatohen procedurat e ekstradimit të parapara me Ligjin nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik në Çështje Penale. Në këtë ligj precizohen qartë procedurat, obligimet dhe veprimet, të cilat mund dhe duhet t'i ndërmarrin organet kompetente deri në vendimin për të ekstraduar një person bazuar në kërkesën e parashtruar nga shteti tjetër. Në këtë mënyrë, të dëbuarve ua mohuan të drejtat për t'u dëgjuar dhe gjykuar nga organi kompetent publik. Kjo e drejtë po ashtu garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, me Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore, me Protokollet e saj shtesë, me Paktin për të Drejtat Civile dhe Politike, si dhe me vetë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së. Të gjitha këto instrumente ndërkombëtare janë pjesë e sistemit kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës dhe kanë epërsi ndaj dispozitave dhe ligjeve vendore në rast konflikti.

Në ditën e arrestimit, Policia e Kosovës, si organ kompetent i mandatuar për t'i privuar personat nga liria, nuk ishte në gjendje apo nuk dëshironte të jepte informacione konkrete se ku ndodheshin personat për të cilët mediat e shkruara dhe elektronike raportuan se janë arrestuar. Madje, një informatë e tillë iu mohua edhe Avokatit të Popullit, mandati i të cilit është mbrojtja e të drejtave dhe lirive themelore, sidomos e personave të arrestuar, të cilët konsiderohen kategori e cenueshme, meqenëse me rastin e arrestimit ata janë plotësisht nën kontroll të autoriteteve.

Në ditën e arrestimit, personave të dëbuar ua mohuan plotësisht të drejtat themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Policinë, si dhe të gjitha standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të arrestuar. Këto të drejta janë: e drejta për të pasur një avokat, e drejta për të pasur një mjek, si dhe e drejta për të njoftuar familjen apo personin, sipas dëshirës, për faktin se janë privuar nga liria. Këto të drejta konsiderohen garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik.

Mohimi i plotë i këtyre të drejtave e vë personin e arrestuar në rrezik nga ushtrimi i torturës apo keqtrajtimit fizik. Në ditën e arrestimit, as avokatët mbrojtës dhe as familjarët e të arrestuarve nuk u njoftuan për vendndodhjen e personave të arrestuar.

Vendimet për largimin me forcë nga territori i Republikës së Kosovës dhe revokim të lejeve të qëndrimit nuk ua dorëzuan personave të larguar me forcë dhe avokatëve mbrojtës të tyre. Avokati i Popullit rithekson, si edhe në rastet tjera, se mohimi i së drejtës në ushtrim të mjeteve juridike është shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut, e cila garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet në fuqi dhe me të gjitha standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

GjEDNj-ja shprehimisht dhe qartë ka theksuar se shtetet në asnjë rrethanë nuk mund të dëbojnë një të huajë në territorin e një shteti ku ai mund t'i ekspozohet rrezikut për t'u torturuar dhe keqtrajtuar fizikisht. Gjykata theksoi se kjo ndalesë në nenin 3 të Konventës

është e karakterit absolut dhe zbatohet edhe *“në kohë lufte apo emergjencash tjera publike të cilat kërcënojnë kombin”*.

Në rastin *Chahal v. Mbretërisë së Bashkuar*, në të cilin shteti deportues pretendonte se i deportuari përbënte rrezik për sigurinë kombëtare dhe se duhej deportuar në Indi, GjEDNj-ja vlerësoi se interesat e sigurisë së shtetit nuk mund të merren në konsideratë në përcaktimin nëse shteti palë nënshkruese e ka shkelur Konventën. Gjykata me këtë rast konstatoi se ndalesa në nenin 3 kundër torturës, trajtimit çnjerëzor dhe poshtëruës apo ndëshkimit, për dallim nga nenet tjera, është e karakterit absolut. Për më shumë, ndalesa në nenin 3, sipas GjEDNj-së, zbatohet edhe *“në kohë lufte apo emergjencash tjera publike të cilat kërcënojnë kombin”*.

Avokati i Popullit vlerëson se autoritet e Republikës së Kosovës duke i dëbuar qytetarët turq, ata i ekspozuan në rrezik real për t’iu nënshtruar torturës, keqtrajtimit fizik dhe rrezikut real për shkelje serioze të të drejtave tjera të garantuara me instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Si rezultat, në rastin e tanishëm, Avokati i Popullit konstaton se autoritetet kompetente në rastin e tanishëm kanë shkelur: nenin 29, paragrafi 2, 3 dhe 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [E drejta e lirisë dhe sigurisë], nenin 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], nenin 32 [E drejta për mjete juridike], nenin 14, paragrafi 1, nenin 15, neni 16, paragrafi 1 dhe 2, nenin 17, paragrafi 2 dhe 6 të Ligjit nr. 04/L-213 për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik në Çështje Penale, nenin 8 dhe 10 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, nenin 9, paragrafi 1 dhe 2, nenin 13 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, nenin 5, 6 dhe 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, nenin 1, paragrafi 1 të Protokollit nr. 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut, nenin 3, paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve a Dënimeve të Tjera Mizore Çnjerëzore ose Poshtëruese.

Në bazë të këtyre konstatimeve, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë që me rastin e vlerësimit të statusit të të huajve në vendin tonë, të zbatohen me kujdes të gjitha garancitë dhe procedurat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat ndërkombëtare, qoftë për dhënien e lejes së qëndrimit, të largimit apo të ekstradimit; Ministria e Punëve të Brendshme të njoftojë shprehimisht personeli e saj lidhur me kompetencat kushtetuese dhe ligjore të Avokatit të Popullit sa i përket qasjes pa paralajmërim, në çdo vend dhe çdo kohë në vendet ku mbahen apo mund të mbahen personat e privuar nga liria; Qeveria e Republikës së Kosovës të akordojë kompensim të përshtatshëm jomaterial si shprehje e vullnetit të mirë dhe njohje për shkeljet e të drejtave të njeriut në frymën e nenit 41 të KEDNj-së.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 385/2016 në lidhje ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë

Më 13 korrik 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë.

Qëllimi i këtij raporti është t'i rekomandojë Kuvendit të Republikës së Kosovës ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës/ nr. 15 / 13 qershor 2012, Prishtinë (në tekstin e mëtejme *Ligji nr. 04/L-096*), i cili kushtëzon ndarjen e ndihmës sociale familjeve që kanë fëmijë nën moshën pesë (5) vjeçare. Ky raport arsyeton domosdoshmërinë e ndryshimit të Ligjit nr. 04/L-096 në raport me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, me fokus të veçantë në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, pasi me këtë kufizim po rëndohet edhe më shumë jeta dhe mirëqenia e qytetarëve, të cilët janë në gjendje të rëndë ekonomike.

Raporti jep rekomandime specifike dhe konkrete lidhur me ndryshimin dhe plotësimin e nenit 4, përkatësisht paragrafit 4.5 të Ligjit nr. 04/L-096, në mënyrë që mosha e kushtëzuar pesë (5) vjeçare e fëmijës të ngrihet në 18, në pajtim me nocionin e termit “fëmijë” dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve Kushtetuese.

Në gusht të vitit 2007 është nxjerrë Ligji nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, publikuar në Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë/ Prishtinë: viti II / nr. 15/01 gusht 2007 (në tekstin e mëtejme *Ligji nr. 2003/15*). Në bazë të Ligjit nr. 2003/15 rregullohet skema e ndihmës sociale me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes të familjeve të rrezikuara në aspektin social.

Në janar të vitit 2016 është nxjerrë Ligji nr. 04/L-096 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës / nr. 15 / 13 qershor 2012, Prishtinë. Në bazë të këtij ligji rregullohet skema e ndihmës sociale në Kosovë, me qëllim të mbështetjes dhe ofrimit të ndihmës së përkohshme financiare për familjet në kushte të rënda ekonomike.

Me këtë dispozitë kufizuese, në veçanti janë prekur qytetarët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Sipas rasteve të paraqitura në IAP dhe pohimeve të vetë familjeve të prekura me këtë kufizim, ka vlerësime se një kufizim i tillë thëllon edhe më tepër gjendjen e rëndë, sepse këto familje në mënyrë të planifikuar çdo 5 vjet lindin edhe nga një fëmijë tjetër, në mënyrë që të mos u ndërpritet ndihma sociale.

Pavarësisht faktit që janë bërë ndryshime të nenit 4 të Ligjit nr. 2003/15, kjo në fakt nuk e ka përmirësuar gjendjen e familjeve të varfra për faktin e kufizimit të moshës së fëmijëve. Për më shumë, paragrafi 4.6 i nenit 4 të Ligjit nr. 04/L-096 ka paraparë që dispozitat e nenit 4.5 të modifikohen me kohë, në mënyrë që kufiri i moshës së fëmijës

gradualisht të ngrihet më qëllim që ky kriter të ndryshohet, i cili do të varet nga fondet e nevojshme buxhetore të vëna në dispozicion dhe do të jetë subjekt i kufizimeve fiskale.

Në lidhje me këtë, më 16.6.2016, është publikuar një artikull në gazetën ditore ‘Kosova Sot’, ku janë përmendur disa familje nga Gjakova me rrethinë, që janë ankuar në gjendje ende më të rëndë financiare tani që kanë mbetur pa ndihmë sociale. Duke marrë parasysh gjendjen jo të mirë ekonomike në Kosovë dhe vështirësitë në lidhje me punësimin, shumë familje varen nga ndihma sociale. Kushtet e përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi për ndihmë sociale kanë ndikuar në keqësimin e gjendjes ekonomike të shumë familjeve, duke shkaktuar edhe pengesa dhe vështirësi në mirërritjen dhe mirëqenien e familjeve në përgjithësi.

Duke pasur parasysh atë që u tha më lart, Ligji nr. 04/L-096, konkretisht neni 4, paragrafi 4.5, pika a), përtej çdo dyshimi shkel interesin më të mirë të fëmijës: *“Fëmijët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes dhe të kujdesit të domosdoshëm për mirëqenien e tyre”*. Njëherësh, dispozitat Kushtetuese janë plotësisht në pajtim me standardet ndërkombëtare të parapara brenda Konventës për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Edhe pse neni i njëjtë i Kushtetutës i referohet obligimit të organeve shtetërore të veprojnë në pajtim me interesin më të mirë të fëmijës, e njëjta është neglizhuar përmes Ligjit nr. 04/L-09. Në qoftë se fëmija definohet si qenie nën moshën 18 vjeçare, atëherë nuk mund t’i ndërpritet ndihma sociale për të cilën ka nevojë në kohën kur mbush 5 vjeç. Ligjvënësi në Ligjin nr. 04/L-096 ka implikuar pranimin e shkeljeve kushtetuese dhe interesin më të mirë të fëmijës, duke paraparë në nenin 4, paragrafin 4.6 që një kusht i tillë do të modifikohet me kohë, në mënyrë që kufiri i moshës të rritet gradualisht, që do të varet nga fondet buxhetore, e që në fakt do të jetë subjekt i kufizimeve fiskale. Nga kjo rrjedh që krijimi i një dispozite të tillë ka qenë rezultat i mungesës së buxhetit, që potencialisht do të definohej nën kapitullin e qëllimit legjitim, për të cilin na flet praktika e GjEDNj-së.

Neni 26 i kësaj Konvente për të Drejtat e Fëmijëve, që i referohet ndihmës sociale, shprehimisht thotë: *“Fëmijët – përmes kujdestarëve të tyre ligjorë apo në mënyrë direkte – gëzojnë të drejtën e ndihmës nga qeveria në qoftë se janë të varfër apo kanë nevojë për ndihmë të tillë”*. Në lidhje me këtë është edhe neni pasues, që i referohet standardit adekuat të jetesës së fëmijës. Ndërsa neni 27 thekson që fëmijëve u duhet njohur e drejta për një standard të jetesës që është i mjaftueshëm për t’i përmbushur nevojat e tyre fizike dhe mentale dhe se qeveritë duhet t’i ndihmojnë familjet dhe kujdestarët që nuk mund t’i përmbushin këto nevoja, në veçanti në lidhje me ushqimin, veshjen dhe banimin. Theksi patjetër duhet të jetë te fëmijët dhe faktit që nocioni i njëjtë u referohet të gjithë atyre që nuk kanë arritur moshën 18 vjeç. Kushtet e parapara në Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në lidhje me arritjen e standardit adekuat të jetesës, vlejnë edhe për fëmijë mbi moshën 5 vjeç, në këtë rast të arritur përmes ndarjes së ndihmës për prindërve të tyre apo kujdestarëve ligjorë.

Mungesa e ndihmës sociale për fëmijë dhe familje në nevojë kushtëzon dhe ndikon në shëndetin fizik dhe mental të fëmijës, si dhe në edukimin e zhvillimin e mëtutjeshëm të

tij. Në lidhje me këtë, dhe nëse merret parasysh fakti që fëmijës i ndërpritet ndihma për të cilën ka nevojë të rritet në pajtim me standardin adekuat, për të cilin plotëson kushtet në bazë të moshës deri në kohën kur mbush 18 vjet, shtrohet pyetja a mund të konsiderohet ndihma sociale, konkretisht tërheqja prapa e së njëjtës, pasi fëmija t'i mbushë 5 vjet, shkelje e së drejtës në pronë, sidomos duke marrë parasysh që praktika e GjEDNj-së nuk njeh të drejtën në pronën që mund të fitohet në të ardhmen.

Të drejtat pensionale dhe benefitet tjera sociale janë paraparë me praktikën e GjEDNj-së si pjesë e pronës apo segmente që mbërthehen me nenin 1 të Protokollit Nr.1 të KEDNj-së. Ashtu siç shihet nga Müller v Austria , e drejta pronësore të pranohet benefiti nga skema sociale e obligueshme apo vullnetare mund të ekzistojë, në qoftë se kërkuesi plotëson kushtet që parashihen me paragrafin e dytë të nenit 1 të Protokollit Nr.1. Sidoqoftë, kjo e drejtë nuk i jep kërkuesit të drejtë të kërkojë shumë të caktuar të pensionit. Paragrafi i dytë, të cilit i është referuar këtu, thërret në pengesën e së drejtës në pronë në rast të interesit publik dhe në pajtim me kushtet e parapara me ligj apo parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare publike.

Në lidhje me atë që u tha më lart, interferimi me të drejtën e pronës nuk duhet vetëm të ketë objektiv legjitim. Duhet po ashtu të jetë proporcional. Në Sporrang and Lönnroth v Sweden, GjEDNj-ja ka ardhur deri tek përfundimi në lidhje me arsyetimin e interferencës: Gjykata duhet të determinojë ekzistencën e balancës së drejtë ndërmjet interesit të përgjithshëm të bashkësisë dhe kërkesave për mbrojtje të të drejtave fundamentale të individit. Prandaj, është më se e rëndësishme të përcaktohet balancimi ndërmjet kufizimit të së drejtës me kërkesat e interesit të përgjithshëm. Balancimi i drejtë nuk mund të ekzistojë atëherë kur mbajtësi i pronës duhet të durojë “barrë individuale të tepërt”.

Rrjedhimisht, kushtëzimi i ndihmës sociale të dhënë nga shteti për familjet të cilat atë duhet ta gëzojnë me qëllim të rritjes së fëmijëve të tyre, e që është në pajtim të plotë me interesin më të mirë të fëmijës, (personit që ka mbushur pesë (5) vjet, por që në bazë të Konventës për mbrojtjen më të mirë të fëmijës dhe ligjeve vendore është ende fëmijë, pasi që nuk i ka mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet). Kjo ndihmë mund të konsiderohet pronë, pasi që familja në këtë rast, gëzon çdo të drejtë dhe nuk llogarit në diçka që mund t'i përkasë në të ardhmen, nuk mund të mos konsiderohet shkelje e së drejtës në pronë, në bazë të praktikës së GjEDNj-së. Duke thënë këtë, duhet t'i referohemi interesit të përgjithshëm legjitim që mund të ketë shteti tek kufizimi i të drejtave elementare. Mbajtja e familjeve në skamje të thellë, nga e cila kufizohet fëmija që të gëzojë gjëra elementare për rritje sa më të mirë, për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore, nuk mund të konsiderohet qëllim legjitim. Po ashtu, pa marrë parasysh që dispozitat e Ligjit janë të qarta në këtë drejtim, ato janë arbitrare, në kundërshtim të plotë me standardet ndërkombëtare dhe njëkohësisht me Kushtetutën, si aktin më të lartë juridik në vend.

Për këto arsye, Avokati i Popullit, në pajtim me gjetjet e lartcekura, konstaton: Neni 4 i Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale në Kosovë është në kundërshtim më

Konventën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, e cila është drejtpërdrejt e zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe rekomandoi ndryshimin e nenit 4, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/1-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndhmës Sociale në Kosovë, në mënyrë që kufizimi i moshës pesë (5) vjeçare të fëmijës të ngrihet në moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeçare, në pajtim me nocionin e termit “fëmijë” dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve Kushtetuese.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 687/2017 në lidhje me organizmin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale

Më 30 gusht 2018, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me rekomandime në lidhje me organizmin e votimit jashtë vendit për zgjedhjet parlamentare dhe lokale. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e autoriteteve përgjegjëse për mënyrën e votimit të qytetarëve që gjenden jashtë vendit dhe të atyre që përkohësisht jetojnë jashtë vendit, në mënyrë që ky votim të organizohet në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe të mbrohet e drejta e votës.

Hetimet e Avokatit të Popullit u iniciuan duke marrë shkas një shkrim të gazetës “Zëri”, i datës 19 tetor 2017. Raporti bazohet në analizën e legjislacionit vendor lidhur me organizimin dhe mbarëvajtjen e proceseve zgjedhore parlamentare dhe lokale, me fokus në organizimin e votimit jashtë vendit dhe trajton tri çështje me interes për organizimin e votimit jashtë vendit.

Çështja e parë ka të bëjë me publikimin e rezultateve përfundimtare të votave jashtë vendit. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit konstaton se korniza ligjore e Republikës së Kosovës parasheh ushtrimin e së drejtës së votës jashtë vendit. Nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) kur shteti i mundëson zgjedhjet jashtë vendit dhe e garanton atë me kornizën ligjore në fuqi, është detyrim i shtetit t’i organizojë zgjedhjet në mënyrë të mirëfilltë dhe transparente. Megjithatë, Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk parasheh publikim të rezultateve përfundimtare të votave nga jashtë. Së këndejmi, Avokati i Popullit ka rekomanduar Ndryshim/Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, në nenin 106, paragrafi 4, ku do përfshihet edhe publikimi i rezultateve përfundimtare të votave nga jashtë vendit.

Çështja e dytë ka të bëjë me rregullën zgjedhore të KQZ-së për votim jashtë vendit, e cila parasheh mënyrën e votimit përmes kutive postare të vendosura nga KQZ-ja, por nuk jep sqarim në lidhje me vendndodhjen e këtyre kutive postare. Duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, votimi përmes postës për votimin jashtë vendit konsiderohet si metodë e pasigurt, e brishtë dhe jo transparente. Prandaj, Avokati i Popullit ka rekomanduar Ndryshimin/Plotësimin e Rregullës Zgjedhore 03/2013, neni 4, i cili do të duhej ta përfshijë përcaktimin e vendndodhjes së kutive zgjedhore dhe rolin e zyrave konsullore/ambasadave në procesin zgjedhor.

Në frymën e çështjes së dytë, Avokati i Popullit ka rekomanduar edhe Ndryshim/Plotësimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, neni 96, i cili do të

mundësonte, përveç votimit me postë, edhe votimin fizik nëpërmjet zyrave konsullore apo ambasadave ku do të vendoseshin kutitë e votimit.

Raport për rastin *Ex officio nr. 441/2018* në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut

Më 28 shtator 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin në lidhje me tri parimet e përgjithshme për interpretimin e akteve normative dhe zbatimin e këtyre parimeve në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Avokati i Popullit, në kuadër të ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësive të tij ligjore, në mes tjerash, shqyrton dhe analizon zbatimin e legjislacionit. Gjatë punës së Institucionit të Avokatit të Popullit janë hasur disa raste ku një situatë faktike mbulohet nga dy a më shumë akte normative. Avokati i Popullit ka vërejtur se mënyra se si vendoset përparësia ndërmjet akteve normative ka implikime të rëndësishme në të drejtat e njeriut.

Raporti i Avokatit të Popullit ka për qëllim që t'i paraqesë tri parime të përgjithshme: akti normativ special e derogon aktin normativ të përgjithshëm; akti normativ i mëvonshëm e derogon aktin normativ të mëparshëm, dhe akti më i lartë normativ e derogon aktin normativ më të ulët (lex specialis derogat legi generalis, lex posterior derogat legi priori dhe lex superior derogat legi inferiori). Raporti po ashtu ka për qëllim që të udhëzojë se cilave akte normative duhet t'u jepet përparësi në një situatë faktike që mbulohet prej dy a më shumë akteve të tilla dhe që ta shpjegojë rëndësinë e këtyre parimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, për sundimin e ligjit dhe të demokracisë, duke paraqitur shembuj konkret nga përvoja e Avokatit të Popullit dhe për të shpjeguar se si këto tri parime interpretuese i zgjidhin këto raste.

Me këtë rast, Avokati i Popullit ka rekomanduar: Gjykata Supreme, në bazë të Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat, neni 22, par. 1, nënpar. 3 ("Gjykata Supreme (...) përcakton qëndrimet parimore dhe mendimet juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës") të shpallë një mendim juridik duke udhëzuar që të gjitha gjykatat e rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë akte normative në përputhje me tri parimet interpretuese (lex specialis derogat legi generalis, lex posterior derogat legi priori dhe lex superior derogat legi inferiori) dhe t'i zbatojnë rregullat e propozuara në këtë Raport për raste të konfliktit ndërmjet këtyre parimeve; Kryeministri, në bazë të Kushtetutës, neni 94, par. 3 ("Kryeministri (...) siguron zbatimin e ligjeve"), të nxjerrë një akt administrativ duke udhëzuar të gjitha institucionet dhe agjencitë qeveritare që t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë akte normative në përputhje me tri parimet e lartpërmendura dhe t'i zbatojnë rregullat e propozuara në këtë Raport për raste të konfliktit ndërmjet këtyre parimeve; Institucionet dhe agjencitë e pavarura t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë akte normative në përputhje me tri parimet e lartpërmendura dhe t'i zbatojnë rregullat e propozuara në këtë Raport për raste të konfliktit ndërmjet këtyre parimeve.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 376/2018 në lidhje me kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete

Më 5 tetor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me kushtëzimin e regjistrimit të automjetit dhe ndërrimit të pronarit me shlyerjen e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor, sipas Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete.

Raporti ka tri qëllime kryesore: për të shpjeguar hollësisht nenin 46, par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“E drejta e pronës është e garantuar”) dhe mënyrën se si duhet zbatuar kjo dispozitë në sistemin juridik të Republikës së Kosovës; për të analizuar, në bazë të këtij shpjegimi, nëse neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete paraqet shkelje të së drejtës së pronës; për t’u dërguar institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete për ndryshimin e Ligjit për Automjete për të qenë në përputhje të plotë me të drejtën kushtetuese të pronës.

Gjatë trajtimit të çështjes në fjalë, Avokati i Popullit ka konstatuar se Ligji nr. 05/L-132 për Automjete, neni 43, par. 2, i cili parashikon: “Pronari i mjetit nuk mund ta bëjë regjistrimin apo vazhdimin e regjistrimit të mjetit me veprim motorik, as ndërrimin e pronarit, pa e bërë shlyerjen e gjobave për kundërvajtje në trafikun rrugor”, paraqet shkelje të së drejtës së pronës, të garantuar me nenin 46, par. 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Së këndejmi, Avokati i Popullit ka rekomanduar që Kuvendi, në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës: ta ndryshojë Ligjin nr. 05/L-132 për Automjete, përkatësisht, ta fshijë nenin 43, par. 2 të tij; ta analizojë nëse Ligji nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, neni 30, par. 4 (“Nëse kryesi pjesërisht ose në tërësi nuk e paguan gjobën në afatin e përcaktuar, do të zbatohet përmbartimi i detyrueshëm në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përmbartim. Urdhri kundërvajtës përmes të cilit shqiptohet gjoba do të cilësohet dokument përmbartues në përputhje me dispozitat e Ligjit për procedurën përmbartimore”), po funksionon në atë mënyrë që po sigurohet, në nivel të mjaftueshëm, shlyerja e gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor; dhe nëse neni 30, par. 4 i Ligjit për Kundërvajtje nuk është i mjaftueshëm, ta shqyrtojë nëse ka një masë tjetër më pak të ashpër sesa neni 43, par. 2 i Ligjit për Automjete, me të cilën mund të arrihet qëllimi i shlyerjes së gjobave të papaguara për kundërvajtje në trafikun rrugor.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 401/2018 në lidhje me menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave

Më 25 tetor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me mungesën e menaxhimit dhe të mirëmbajtjes adekuate të varrezave në komunat e ndryshme të Kosovës. Duke pasur parasysh se menaxhimi dhe mirëmbajtja e varrezave është veprimtari komunale e interesit të përgjithshëm dhe duke u bazuar në informatat e grumbulluara lidhur me gjendjen jo të mirë të mirëmbajtjes së varrezave, Avokati i Popullit, në bazë Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka iniciuar hetime me

vetiniciativë (*ex officio*) për ta vlerësuar gjendjen e varrezave nëpër komunat e Republikës së Kosovës.

Raporti ka për qëllim që të ofrojë një përshkrim objektiv të gjendjes së varrezave, duke pasur parasysh kriteret më bazike që duhen plotësuar që varrezat të jenë të qasshme, të dinjitetshme dhe t'i plotësojnë kërkesat e qytetarëve. Raporti identifikon çështje të cilat janë të nevojshme të adresohen nga autoritetet kompetente komunale në bazë të kompetencave të tyre ligjore, më qëllim të rregullimit dhe përmirësimit të gjendjes në menaxhimin e varrezave.

Mungesa e veprimeve adekuate të autoriteteve lokale në fushën e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së varrezave dhe gjendja aktuale jo e rregullt e varrezave ndikon drejtpërdrejt në cenimin e dinjitetit të të gjithë personave, të cilët i vizitojnë varrezat e të afërmeve të tyre, sidomos duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe gjendjen e tyre emocionale gjatë realizimit të këtyre vizitave.

Në pothuajse në të gjitha Rregulloret e komunave për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e varrezave, ndër tjera, përcaktohen qartë përgjegjësitë e komunave në mirëmbajtjen dhe menaxhimin e varrezave, sidomos duke pasur parasysh: rrethojat e varrezave dhe mirëmbajtjen e tyre, mirëmbajtja e hyrje-daljeve, mirëmbajtja e shtigjeve të këmbësorëve, mirëmbajtja e gjelbërimit në varreza, mbajtja e pastërtisë dhe e rendit në varreza, lokacioni i përshtatshëm, mirëmbajtja e infrastrukturës, e parkingjeve për automjete etj.

Sipas praktikave ndërkombëtare, varësisht nga lokacionet individuale të varrezave, mirëmbajtja e varrezave, ndër të tjera, kryesisht përfshin: kujdesin dhe pastrimin e rrugëve për qasjen e këmbësorëve dhe të mjeteve të transportit, mirëmbajtjen e kufijve të varrezave, të portave dhe mureve të brendshme, largimin e mbeturinave, mirëmbajtjen e shenjave dhe njoftimeve, nivelimin e terrenit sipas nevojës, mirëmbajtjen e gjelbërimit, mbjelljen dhe ruajtjen e hapësirave me lule, shkurtimin dhe kujdesin ndaj pemëve dhe shkurreve, mirëmbajtjen e objekteve përcjellëse nëpër varreza etj.

Sa i përket aspektit legjislativ, disa shtete këtë çështje e kanë të rregulluar me ligj të veçantë, si për shembull, në Republikën e Kroacisë, çështja e varrezave është e rregulluar me ligj të veçantë. Ligji për varreza i Kroacisë rregullon çështjen e ndërtimit, përdorimit dhe administrimit të varrezave, të cilat, sipas këtij ligji, janë objekte komunale të zotëruara nga njësi e vetëqeverisjes lokale, në territorin e së cilës ndodhen. Në këtë ligj gjithashtu përcaktohen obligimet e njësive të vetëqeverisjes lokale që të përkujdesen për administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave duke u bazuar në plotësimin e kriterëve dhe të rregullave të përcaktuara me ligj, si dhe përcaktohen afatet brenda të cilave duhet të nxirren aktet nënligjore lidhur me administrimin dhe mirëmbajtjen e varrezave.

Nëpërmjet këtij Raporti, Avokati i Popullit u rekomandoi autoriteteve përgjegjëse në lidhje me masat që duhen ndërmarrë, në mënyrë që kjo gjendje të përmirësohet në komunat përkatëse në të cilat gjendja e varrezave lë për të dëshiruar.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 12/2018 në lidhje me mosndërmarrjen e obligimeve pozitive nga organet kompetente për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti

Më 7 nëntor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime lidhur me mosarritjen e organeve kompetente për të përmbushur obligimet për menaxhimin e materialeve me përmbajtje asbesti brenda territorit të vendit.

Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve kompetente, gjegjësisht të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunave, për nevojën e ndërmarjes së masave të menjëhershme parandaluese, në mënyrë që të reduktohen efektet negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Sipas Dokumentit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) dhe të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), i publikuar në vitin 2007, që ka të bëjë me zhvillimin e programeve kombëtare për eliminimin e sëmundjeve të lidhura me asbest: “*Ekspozimi ndaj asbestit shkakton asbestozë, pllaka pleurale, trashje dhe effusions, kancer të mushkërive, Mesothelioma, laryngeal dhe ndoshta kanceret e tjera me periudha të ndryshme latente*”. Ndërsa sipas dokumentit të WHO, i publikuar në vitin 2014 “*Eliminimi i sëmundjeve të lidhura me asbestin*”, i cili shqyrton efektet negative të ekspozimit të asbestit në shëndet, vlerësohet se të paktën 107 mijë njerëz vdesin çdo vit nga kanceri në mushkëri, si rezultat i ekspozimit në asbestozë gjatë ushtrimit të profesionit.

Avokati i Popullit, pas analizës së çështjes, edhe pse nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka pranuar asnjë përgjigje, duke u bazuar në informacionet e pranuar nga Komuna e Prishtinës, e Ferizajt, e Mitrovicës, e Gjilanit, e Gjakovës, e Pejës dhe e Prizrenit, konsideron se, pavarësisht bazës së mjaftueshme ligjore që ofron Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Udhëzimi Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe komunat, me përjashtim të Komunës së Mitrovicës, edhe pse janë të veshura me funksione për zbatimin e së drejtës dhe janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit jetësor, të natyrës dhe të biodiversitetit, nuk kanë ndërmarrë veprime me të cilat do të siguronin një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm për qytetarët e Kosovës, si obligim pozitiv që del nga neni 25 [E drejta për jetën] dhe nga neni 52 [Përgjegjësia për mjedisin jetësor] të Kushtetutës.

Avokati i Popullit në Raport ka konstatuar se mosndërmarrja e asnjë aktiviteti sensibilizimi për vetëdijesimin dhe informimin e publikut për rrezikun që kanë materialet me përmbajtje asbesti, tregon dështimin dhe neglizhencën e autoriteteve kompetente për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së njeriut, dhe njëherësh kufizim të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe të së drejtës për jetën.

Ndërsa, mosndërmarrjen e veprimeve nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me trajtimin e materialeve me asbest brenda territorit të Republikës së

Kosovës, ashtu sikurse parashihet në Ligj dhe Udhëzim Administrativ, Avokati i Popullit e konsideron si dështim për zbatimin e obligimeve të dala nga neni 92 i Kushtetutës për ushtrimin e pushtetit ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën e ligjin dhe për zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Bazuar në hetimet e bëra, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe me nenin 18, paragrafin 1.5 dhe 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit, rekomandoi: Qeveria të ndërmarrë masa të shpejta për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti, ashtu siç parashihet në Ligjin nr. 04/L-060 për Mbeturina; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të ndërmarrë masa shtesë për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti; Komunat, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të ndërmarrin masa me hapa të përsheptuar për zbatimin e obligimeve të dala nga Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Udhëzimi Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë Azbest; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të fillojë informimin dhe ndërjegjësimin përmes formave të ndryshme për ndikim të asbestit në shëndetin e njeriut dhe në mjedis, si dhe mënyrat e menaxhimit; Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ta bëjë publike raportin për hulumtimin e asbestit në të gjitha ndërtesat publike në Komunën e Pejës dhe të Istogut, të OJQ “Pro Vitae”, në përjashtim të informatave të kufizuara me ligj; Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës të kërkojë përgjegjësi nga ministri i MMPH-së për mosndërmarrjen e masave të parapara në Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, si dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë Azbest.

Raport për rastin *Ex officio* nr. 280/2016 në lidhje me cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm në Komunën e Obiliqit dhe të komunave të afërta që ndikohen nga problemi i njëjtë

Më 21 dhjetor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin *Ex officio* nr. 280/2016, që ka të bëjë me cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës së jetës dhe të privatësisë, të së drejtës për shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive, të së drejtës së pronës, lirisë së lëvizjes së banorëve të komunës së Obiliqit dhe të komunave të afërta që ndikohen nga problemi i njëjtë.

Raporti është iniciuar sipas detyrës zyrtare, për shkak të cenimin e vazhdueshëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, të së drejtës për jetën dhe të privatësinë, të së drejtës për shfrytëzimin e mjeteve juridike efektive, të pronës, të lirisë së lëvizjes së banorëve të komunës së Obiliqit dhe të komunave përreth. Edhe pse hetimet lidhur me rastin kanë përfunduar në muajin nëntor të vitit 2016, Avokati i Popullit gjatë periudhës dyvjeçare të monitorimit të çështjeve të evidentuara në raport nuk ka vërejtur asnjë ndryshim me synim përmirësimi.

Problemet e evidentuara në Raport janë: Ndotja e ujit, e ajrit dhe e tokës, mungesa e monitorimit cilësor mjedisor, mungesa e qasjes në informata mjedisore dhe shëndetësore, ngritja e numrit të sëmurëve nga organet respiratore, të sëmundjeve kardiovaskulare dhe malinje, mungesa e statistikave shëndetësore, mungesa e hulumtimeve lidhur me ndikimin e ndotjes në shëndetin e qytetarëve, keqmenaxhimi i deponisë së mbeturinave në Mirash dhe deponive të tjera, deponia e hirit, kufizimi i të drejtave të familjes së vendosur brenda pjesës së rrethuar nga KEK-u në fshatin Palaj, ndikimi në të drejtat e qytetarëve i mihjes sipërfaqësore, problemet me shpronësim të banorëve në zonën e interesit, ndërtimi i shtëpive/objekteve me qëllim të përfitimit nga shpronësimi, mosbashkëpunimi i organeve kompetente për të gjetur zgjidhje efektive për problemet mjedisore, si dhe vonesat e rasteve të iniciuara në gjykatë.

Raporti ka për qëllim që të tërheqë vëmendjen e institucioneve shtetërore, e Kuvendit të Republikës së Kosovës, e Komisionit Parlamentar për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, e Ministrisë së Shëndetësisë, e Policisë së Kosovës, e Agjencionit për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës, e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, e Komunës së Obiliqit dhe e Komunës së Prishtinës, për shkeljet e vazhdueshme të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ndotja e mjedisit dhe ndikimet në mjedis të faktorëve të ndryshëm në hapësirat e komunës së Obiliqit dhe të qyteteve tjera përreth, të ndikuara nga problemet e lartpërmendura.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura në këtë raport, nxjerr përfundimin se të drejtat dhe liritë e qytetarëve, të cilët banojnë në territorin afër KEK-ut dhe në qytetet përreth, janë cenuar vazhdimisht nga mosarritja e përmbushjes së obligimit pozitiv të shtetit për balancim të drejtë në mes të zhvillimit ekonomik dhe të mirëqenies sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Avokati i Popullit me këtë Raport konstaton se qytetarëve u është mohuar e drejta për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, dinjiteti i njeriut, e drejta për jetën, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, liria e lëvizjes, e drejta e privatësisë, e drejta për qasje në dokumente publike dhe e drejta e pronës; dhe u rekomandon organeve kompetente ndërmarrjen e veprimeve për përmbushjen e obligimeve. Për këtë arsye, Avokati i Popullit rekomandoi: MMPH/Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës, me hapa të përshpejtuar, ta përmirësojë procesin e monitorimit të ajrit; MMPH-ja të ndërmarrë aktivitete edukuese, në mënyrë që qytetarët të vetëdijësohen për ndikimin negativ të ajrit të ndotur në shëndet, si dhe mënyrën e ndërmarrjes së masave preventive; MMPH/Agjencioni për Mbrojtje të Mjedisit të Kosovës të fillojë me informim të përditësuar për kualitetin e ajrit; MMPH-ja ta përmirësoi sistemin e monitorimit të ujërave, të gjendet zgjidhje për trajtimin e ujërave dhe të investohet në impiante; MMPH-ja të ndajë fonde shtesë për rehabilitimin e sipërfaqeve me norma të tejkaluara të ndotjes dhe të bëjë vlerësimin për zhvendosje të

banorëve nga zonat ku ka tejkalime enorme me mundësi të ndikimit në shëndetin e njeriut; MMPH-ja të vazhdojë ndërmarrjen e masave për zhvendosjen e deponive ilegale dhe trajtimin e mbeturinave sikurse parashihet me legjislacionin në fuqi; MMPH-ja të ndërmarrë veprime në drejtim të hartimit të politikave për klasifikimin e mbeturinave sipas përmbajtjes së tyre; KEK-u të ndërmarrë veprime në drejtim të rehabilitimit dhe gjelbërimit të hapësirës së degraduar me qëllim të minimizimit të përhapjes së pluhurit në ajër; si dhe Inspektorati komunal i Komunës së Obiliqit dhe inspektorati i MMPH-së ta monitorojnë vazhdimisht gjendjen në këto hapësira; Komuna e Obiliqit të kërkojë nga KEK-u që ta zgjidhë çështjen e familjes Morina (të kërkojë nga KEK-u të ndalojë kontrollin e paautorizuar të familjes, apo zhvendosjen apo shpronësimin e pronës së familjes Morina); Këshilli Prokurorial i Kosovës - prokurorët pa vonesa t'i procedojnë të gjitha parashtrirat e qytetarëve dhe institucioneve për veprat penale për ndotje mjedisore nga individët, kompanitë publike dhe private; Këshilli Gjyqësor i Kosovës – gjykatat t'i shqyrtojnë të gjitha lëndët lidhur me ndotjen e mjedisit, t'i trajtojnë në afate ligjore, pa zvarritje dhe ashtu që të mos të vijë deri të parashkrimi i tyre; Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës të dalë me hulumtim lidhur me ndikimin e ndotjes së ajrit në shëndetin e popullsisë jo vetëm në komunën e Obiliqit, por edhe më gjerë.

Raporte bazuar në ankesa

Raport për rastin A.nr. 890/2016 në lidhje me të drejtën në pension kontributpagues të moshës si dhe e drejta në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë

Më 27 shkurt 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me të drejtën në pension kontributpagues të moshës si dhe të drejtën në shfrytëzimin e pensioneve të tjera të aplikueshme në Kosovë. Raporti është i bazuar në rastin A. nr. 890/2016 dhe mbështetet në pretendimet, faktet dhe dëshmitë e ankuesit të paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit, lidhur me ndërprerje të pensioneve kontributpaguese. Përveç ankesës në fjalë, Avokati i Popullit ka pranuar edhe ankesa tjera të së njëjtës natyrë. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), që qytetarëve t'u ofrohet mundësia e garantuar ligjore dhe kushtetuese në shfrytëzim të pensioneve kontributpaguese si e drejtë në pronë.

Raporti analizon kornizën ligjore në aspektin e ushtrimit të së drejtës në pension kontributpagues të moshës në raport me të drejtën në ushtrimin e pensioneve tjera në bazë të Ligjit nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre dhe të Ligjit nr.04/L-261 për Veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Po ashtu, ky Raport argumenton se ushtrimi i së drejtës në pensionin kontributpagues të moshës paraqet ushtrim të së drejtës në pronë, në bazë të nenit 1, Protokollit Nr.1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm *KEDNJ*), në raport me kushtëzimin e ushtrimit të së drejtës në këtë pension, në bazë të nenit 8 të Ligjit nr .04/L-

131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti (në tekstin e mëtejshëm *Ligji për Skemat Pensionale*).

Me krijimin e skemave tjera të veçanta pensionale, shumë nga ankuesit kanë aplikuar dhe kanë fituar edhe të drejta dhe benefite nga këto skema dhe për një kohë të gjatë kanë qenë përfitues nga dy skema pensionale, si në pensione kontributpaguese ashtu dhe në pensione tjera të përcaktuara me ligje të veçanta.

Nga viti 2016, me vendime nga MPMS-ja, pa paralajmërim apo konsultë për heqje dorë vullnetarisht nga njëri pension, ankuesve u janë shfuqizuar dhe u janë ndërprerë pensionet kontributpaguese të moshës. Ankuesit pretendojnë se kishin parashtruar ankesë në Komisionin për Ankesa në MPMS, por nuk kishin pranuar përgjigje.

Avokati i Popullit, nëpërmjet shkresave, disa herë i është drejtuar MPMS-së për të kërkuar informata lidhur me bazën ligjore të ndërprerjes së pensionit kontributpagues dhe arsyet për mos përgjigje në ankesat e qytetarëve drejtuar Komisionit të Ankesave në MPMS. Mirëpo as Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje në asnjërën nga shkresat e dërguara. Në takimin me përfaqësuesit e MPMS-së, i realizuar më 6 shkurt 2018, ndër të tjera u diskutua edhe lidhur me çështjet e ngritura nga Avokati i Popullit në shkresat e lartshënuara. Në këtë takim përfaqësuesit e Avokatit të Popullit u njoftuan se MPMS-ja i kishte ndërprerë pensionet duke u bazuar në nenin 16 të Ligjit për Skemat Pensionale.

Avokati i Popullit vë në dukje se e drejta në pension kontributpagues të moshës rregullohet me Ligjin për Skemat Pensionale, ndërsa e drejta në pensione dhe benefite për kategoritë e dala nga lufta rregullohet me Ligjin për Vlerat e Luftës dhe me Ligjin për Veteranët e UÇK-së. Mirëpo, përkundër faktit që personi i plotëson kushtet e përcaktuara me ligj për shfrytëzimin e së drejtës në pensionin kontributpagues të moshës ose të ndonjë pension tjetër të financuar nga shteti, ai mund të privohet nga e drejta për gëzimin të pensioneve të garantuara me ligj. Kjo rrjedh nga dispozitat ligjore, sipas të cilave: *“personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj”* (Neni 8, par 3 i Ligjit për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti).

Në këtë drejtim mund të konstatohet se shfrytëzimi i një pensioni përjashton të drejtën në ushtrimin e pensionit tjetër. Një gjë e tillë nënkupton që veterani i UÇK-së nuk do të mund të ushtrojë të drejtën në pensionin i cili i përket në bazë të kontributit të dhënë gjatë luftës, të përcaktuar me Ligjin për Vlerat e Luftës, në qoftë se i njëjti ushtron të drejtën në pensionin kontributpagues të moshës. Individidi në këtë rast do duhej të zgjedhë në mes të shfrytëzimit të pensionit ku ka kontribuar ashtu siç ka paraparë ligji në fuqi dhe shfrytëzimit të pensionit që i takon po ashtu në bazë të ligjit dhe kontributit që ka dhënë në luftën e UÇK-së.

Në këtë rast fokusi duhet të vihet të pensioni kontributpagues i moshës për dy arsye:

E para: në bazë të Ligjit për Skemat Pensionale, ky pension i takon personit që ofron dëshmi të vlefshme mbi pagesën e kontributeve sipas dispozitave të Ligjit për Sigurimin

Pensional dhe Invalidor nr. 011-24/83 (Gazeta Zyrtare e KSAK nr.26/83) para datës 01.01.1999; dhe e dyta: që kontributet e paguara në bazë të pikës 1 konsiderohen e drejtë në pronë në bazë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Rrjedhimisht, kushtëzimi në bazë të ligjit në ushtrimin e së drejtës mbi pensionin kontributpagues të moshës me ushtrimin mbi një pension tjetër shkakton shkelje të nenit 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së. Avokati i Popullit vlerëson se kufizimi i tillë i së drejtës në shfrytëzimin e pensionit kontributpagues të moshës ose ndonjë pensioni tjetër nga shteti, përkundër faktit se plotësohen kushtet e përcaktuara sipas ligjit, paraqet shkelje të **së drejtës së pronës**. GjEDNJ-ja ka gjetur që përmes pagimit të kontributeve në fondin pensional, personi në fjalë krijon të drejtën e pronës. Përmes analogjisë, e njëjta aplikohet edhe në rast të pagimit të kontributeve të natyrës vullnetare. Në dobi të asaj që është thënë deri tani flet edhe lënda *Gaygusuz v Austria*³⁸², ku është bërë lidhja në mes kontributeve dhe pensionit, andaj personit që ka paguar kontribute pensionale nuk mund t'i mohohet e drejta në ushtrimin e atij pensioni. Po ashtu, në bazë të lëndës *Van Raalte v Netherlands*³⁸³, neni 1 i Protokollit nr.1 aplikohet atëherë kur flitet për pagesën e kontributeve pensionale, sidomos për faktin që obligimi i tillë i pagesës së kontributeve dhe taksave imponohet nga shteti.

Avokati i Popullit vë në dukje se mangësitë në ligje ndikojnë në sundimin e ligjit, përkatësisht në sigurinë juridike. Me sigurinë juridike kërkohet që rregullat ligjore të jenë të qarta dhe precize, me të cilat synohet parashikimi i situatave, mosmiratimi nga Kuvendi i ligjeve të dykuptimta dhe veprimet ose premtimet e dhëna individëve nga shteti (*pritet legjitime*) duhet të respektohen. Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji të zbatohet në praktikë dhe që ligji të jetë i zbatueshëm.³⁸⁴

Së këndejmi, Avokati i Popullit i rekomandon MPMS-së që, në pajtim me kompetencat dhe autorizimet e saj, t'i propozojë Qeverisë së Republikës së Kosovës ndryshimin e Ligjit nr. 04/1-131 për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti, përkatësisht fshirjen e: a) paragrafit 3 të nenit 8 të këtij ligji, i cili përcakton: *“Personat të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret për pension kontributpagues të moshës, nuk mund të jenë edhe shfrytëzues të ndonjë skeme tjetër pensionale të përcaktuar me këtë ligj”*; dhe b) nenit 16

³⁸² *Gaygusuz v Austria*, Vendimi i datës 16 shtator 1996, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng/{"fulltext":\["gaygusuz v austria"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-58060"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng/{) Në vendimin mbi lëndën *Azinas v Cyprus* të datës 20 qershor 2002, GJEDNJ ka konfirmuar që, përderisa e drejta në pension nuk është si e tillë e përfshirë në KEDNJ, bazuar në praktikën e GJEDNJ-së, e drejta në pension që është e bazuar në punësim mund të konsiderohet “e drejtë në pronë”. Kjo aplikohet në rast të pagesës së kontributeve, ku në bazë të praktikës së GJEDNJ-së: “një gjë e tillë ndodh për shkak të faktit që punëdhënësi paguan contribute pensionale, që mund të merret që bien nën kushtet e kontratës së punës”.

³⁸³ *Van Raalte v Netherlands*, vendimi I datës 21 shkurt 1997, gjetur në: [http://hudoc.echr.coe.int/eng/{"fulltext":\["van raalte v the netherlands"\],"documentcollectionid2":\["GRANDCHAMBER","CHAMBER"\],"itemid":\["001-58031"\]}](http://hudoc.echr.coe.int/eng/{)

³⁸⁴ EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) REPORT ON THE RULE OF LAW Adopted by the Venice Commission at its 86th plenary session (Venice, 25-26 March 2011) (44-51)

të këtij ligji, i cili përcakton: *“Personat të cilët janë përfitues të të cilit do pension të Skemave pensionale të përcaktuara me këtë ligj, nën asnjë rrethanë, nuk mund të jenë përfitues të ndonjë pensioni nga skemat e veçanta pensionale të cilat menaxhohen dhe administrohen nga Ministria”*. Po ashtu është rekomanduar që të ndryshohet edhe Ligjit nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të Tyre, përkatësisht fshirjen e paragrafit 1.4 të nenit 5 të ligjit, i cili përcakton: *“Përfituesit e pensioneve sipas paragrafit 1.1 dhe 1.2 dhe 1.3 të këtij neni, nuk mund të jenë shfrytëzues të asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të aplikueshme në Kosovë, përveç nëse ndryshe është përcaktuar me ligj”*; si dhe Ligjit nr. 04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare Kosovës, përkatësisht fshirjen e paragrafit 2 të ligjit, i cili përcakton: *“Veterani Luftëtar i UÇK-së nuk mund të jetë shfrytëzues i asnjë pensioni nga skemat e tjera pensionale të financuara nga shteti. Nëse Veterani luftëtar është shfrytëzues i ndonjë skeme pensionale të financuar nga shteti në Republikën e Kosovës duhet të përcaktohet se cilin pension do të marrë.”*

Raport për rastin A.nr. 245/2016 në lidhje me detyrimet pozitive për hetime efektive dhe të drejtën në jetë

Më 21 mars 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me detyrimet pozitive për hetime efektive dhe të drejtën në jetë, që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës, si dhe nga neni 2 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut. Raporti ka për qëllim që të hedhë dritë mbi zhvillimin e veprimeve hetimore efektive nga Policia e Kosovës në rastin e zhdukjes së familjarit të ankuesve I. K. (*shtetas i Malit të Zi me përkatësi etnike boshnjake, i cili është zhdukur më 21 janar 2016*).

Ankuesit deklarojnë se më 21 janar 2016, rreth orës 01:00, I. K. ishte duke shëtitur në lagjen Bresje, bashkë me tezakun e tij E. M. nga Fushë Kosova (tek i cili kishte ardhur në vizitë) dhe kanë ndaluar në një rën nga dyqanet e lagjes, me ç’ rast I. K. ka qëndruar jashtë, ndërsa E. M. ka hyrë në dyqan për të blerë diçka dhe kur ka dalë (pas 2-3 minutave) nuk e ka gjetur më I. K. Sipas tyre, më vonë kanë kuptuar se patrulla policore e Fushë Kosovës e kishte arrestuar I. K. dhe e kishte dërguar në Stacionin Policor në Fushë Kosovë, të cilin e kishin legjitimuar e pastaj e kanë liruar duke e përcjellë me veturë policore deri në afërsi rreth 1 kilometër nga shtëpia e kushëririt të tij E. I. dhe prej momentit kur kishte zbritur nga vetura policore I. K. është larguar në drejtim të panjohur duke u zhdukur pa gjurmë.

Më 22 shkurt 2016, E. M. e kishte raportuar në Stacionin Policor të Fushë Kosovës rastin e zhdukjes së tezakut të tij, me ç’ rast nga ky stacion ishte iniciuar rasti *“Person i Zhdukur” me nr. 2016/AE0093*.

Nisur nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane, fenomeni i zhdukjes së personave ka ngritur një çështje interesante për diskutim në lidhje me shkeljet e mundshme të nenit 3. Sipas kësaj praktike, zhdukja e personit haset kur një person dërgohet në një vend

ndalimi nga persona që veprojnë në emër të autoriteteve duke theksuar se nga vendet e ndalimit shpesh rezultojnë në pohime për vdekjen e personit të zhdukur, ose në heshtje totale mbi fatin e personit të zhdukur, duke i bërë të afërmit dhe miqtë të besojnë se personi ka vdekur. Kjo lloj situatë ngre dy pyetje: *sa preket në këtë rast dinjiteti i personit ndaj të cilit ushtrohet ndalimi; dhe cili është impakti i familjes dhe të afërmeve mbi personin e zhdukur?* Gjykata Evropiane zgjodhi që të mos i drejtohet fenomenit të zhdukjes në vetvete si *trajtim çnjerëzor ose poshtëruar*, por ta konsiderojë atë sipas nenit 5 (*Heqja e lirisë së individit*). Gjykata Evropiane njeh faktin se në disa raste ka fakte ku personat janë keqtrajtuar përpara “zhdukjes”. Gjykata ka njohur faktin se ekziston një detyrim për të shqyrtuar impaktin e zhdukjes tek të afërmit e personit të zhdukur.

Gjykata Evropiane gjatë shqyrtimit të çështjes *Tas kundër Turqisë*, duke pasur parasysh indiferencën dhe pandjeshmërinë e autoriteteve ndaj shqetësimeve të kërkuarit dhe ankthit e rëndë dhe pasigurinë që përjetoi ai, konstatoi se kërkuari ishte viktimë e sjelljes së autoriteteve deri në shkallën që çon në cenim të nenit 3 të Konventës, ndërsa gjatë shqyrtimit të çështjes *Timurtas dhe Cicek* konstatoi se kërkuarit ishin prindërit e të zhdukurit që kishin vuajtur nga indiferenca dhe pandjeshmëria e autoriteteve. Prandaj gjykata gjeti se thelbi i shkeljeve të tilla nuk mbështetet aq shumë në faktin e “zhdukjes” së anëtarit të familjes sesa në shqetësimet e shkaktuara nga reagimet e autoriteteve dhe qëndrimet e tyre ndaj situatës kur i parashtrahet atyre për shqyrtim. Veçanërisht, në bazë të kësaj të fundit, një i afërm mund të ngrejë pretendimin drejtpërdrejt se është viktimë e sjelljes së autoriteteve sikur te rasti *Cakici kundër Turqisë*, gjykimi i 8 korrikut 1999.

Avokati i Popullit, në bazë të të gjitha dëshmive të paraqitura dhe fakteve të mbledhura, si dhe ligjeve relevante, të cilat e përcaktojnë të drejtën për jetë, konstaton se ankesa e ankuesve është e arsyeshme dhe e ligjshme. Në rastin konkret, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave dhe lirisë themelore të njeriut, meqë zyrtarët policorë, me vetë faktin që personin, tani të zhdukur, e kanë dërguar në stacion policor pa ndonjë arsye të justifikueshme, nuk i kanë njoftuar të afërmit e tij lidhur me ndalimin e tij dhe nuk e kanë dërguar sërish tek të afërmit e tij duke e kuptuar se I. K. e kishte humbur rrugën, kanë vepruar në kundërshtim me parimet kushtetuese dhe legjisllacionin në fuqi, duke i tejkaluar autorizimet policore dhe kanë ndërmarrë veprime që janë në kundërshtim me Kushtetutën, me Konventën Evropiane, me Ligjin për Policinë, si dhe me Kodin e Etikës Policore. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Policisë së Kosovës që në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, si dhe në bashkëpunim me të gjitha agjencitë e tjera të sigurisë, të vazhdojë të ndërmarrë masa për gjetjen e personit të zhdukur, si dhe t’i ngritë kapacitetet profesionale të Policisë së Kosovës lidhur me të drejtën në jetë dhe aspektet procedurale për hetime efektive të rasteve të kësaj natyre.

Raport për rastin A.nr. 885/2016 lidhur me mosekzekutimin e vendimit KSIZ-HPCC/D/197/2005A&C, i datës 18/06/2005, i nxjerrë sipas lëndëve DS 000641 dhe DS004997

Më 10 prill 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 885/2016 lidhur me mosekzekutimin e vendimit KSIZ- HPCC/D/197/2005A&C, i datës 18/06/2005, i nxjerrë sipas lëndëve DS 000641 dhe DS004997. Qëllimi i këtij Raporti është shqyrtimi i çështjes së kohëzgjatjes së procedurës nga ana e AKKVP-së lidhur me mospagesën e kompensimit ndaj parashtruesit të kërkesës në bazë të vendimit përfundimtar si dhe pabarazisë para ligjit, në kuptimin e ekzekutimit të vendimeve përfundimtare për parashtruesit e kërkesave të kategorisë AC dhe gëzimit paqësor të së drejtës pronësore të konfirmuar me vendim.

Ky raport bazohet në ankesën individuale dhe mbështetet në faktet dhe dëshmitë e mbledhura nga ankuesi dhe shkresat e paraqitura në Institucionin e Avokatit të Popullit si dhe faktet e mbledhura gjatë hetimit nga ana e palës përgjegjëse lidhur me çështjet e shqyrtuara.

Sipas pretendimeve të ankuesit, pas luftës në vitin 1999, ai e kishte braktisur Kosovën dhe kishte marrë qëndrim të përkohshëm në Republikën e Serbisë, më pas prona e tij banesore në Prishtinë, në adresën Ulpiana E-32, banesa 21, e paraqitur në Drejtorinë për Çështje Banesore dhe Pronësore (në tekstin e mëtejshme *DÇBP*) në kërkesën e regjistruar si DS 000641, është uzurpuar nga pala e tretë. Me kërkesën në fjalë, ankuesi ka kërkuar nga DÇBP-ja të drejtën e posedimit të banesës kontestuese. Në një datë të paspecifikuar, pala e tretë paraqiti kërkesën DS 000641 DÇPB, me të cilën gjithashtu kërkoi konfirmimin e së drejtës së banimit në banesën kontestuese, e cila i ishte shfuqizuar për shkak të diskriminimit gjatë periudhës prej 23 mars 1989 deri më 24 mars 1999. DÇPB-ja të dyja kërkesat në fjalë i ka udhëzuar në Komisionin për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (KKPB) për zgjidhjen e mëtejshme të kësaj çështjeje.

Më 18 qershor 2005, KKPB-ja mori një vendim grupor HPCC/D/197/2005/A & C, me të cilin përfshiu edhe këto dy kërkesa të lartpërmendura (DS 000641 dhe DS 000641). Në vendimin e vet KKPB-ja ia ka pranuar paditësit DS 000641 (përkatësisht palës së tretë) të drejtën e posedimit të banesës, me ç' rast ai i ka fituar të gjitha të drejtat si paditës i kategorisë A, në bazë të nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Me të njëjtin vendim, ankuesit në kërkesën DS 000641 i është mohuar e drejta e posedimit për banesën kontestuese dhe, si rrjedhojë, atij i është pohuar e drejta në kompensim me pagesën e çmimit të tregut për pronën e kontestuar, si parashtrues i kërkesës së kategorisë C, sipas nenit 4.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2000/60.

Më 28 shkurt 2018, përfaqësues të Avokatit të Popullit u takuan me u.d. të drejtoreshës ekzekutive të AKKVP-së. Me këtë rast, ata u informuan se AKKVP-ja, si pasardhëse ligjore e DÇPB-së, ka 143 raste, ku bën pjesë edhe vendimi i ankuesit. Për kompensim sipas këtyre vendimeve është e nevojshme shuma totale prej 3.200.000 euro. Edhe pse

AKKVP-ja çdo vit kërkon nga Qeveria e Kosovës shumën totale për kompensimin e personave të kësaj kategorie, Qeveria e Kosovës deri më tani ka dhënë vetëm shumën prej 300.000 eurosh për vitin 2017 dhe po aq për 2018, që përbejnë gjithsej shumën prej 600.000 eurosh.

Avokati i Popullit thekson se vonesa dhe joefikasiteti i procedurës së ekzekutimit të vendimeve përfundimtare të autoriteteve kompetente çojnë në situata të cilat janë në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit dhe gjithashtu çojnë në krijimin e pasigurisë ligjore dhe dyshimit për personat e prekur nga moszbatimi i të drejtave. E drejta në pronë është e karakterit absolut dhe mund të kufizohet vetëm me ligj, në kuptimin e nenit 46 të Kushtetutës dhe nenit 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës.

Duke i zbatuar parimet e të drejtës pronësore në kontekstin e kthimit të pronës, tendenca e GjEDNj-së është t'i japë secilit shtet një diskrecion të gjerë ("wide margin of appreciation") për të përcaktuar kriteret dhe kushtet për fitimin e së drejtës për kthim. Shih për shembull, *Gratzinger and Gratzingerova v. The Czech Republic (Aplikacioni nr. 39794/98, GjEDNj, 10 korrik 2002), paragrafi 68/77.*

Megjithatë, GjEDNj-ja mbështet gjithashtu një parim tjetër: çdo shtet, pas përcaktimit të kriterëve ligjore për fitimin e së drejtës për kthimin e pronës, është i detyruar t'i zbatojë këto kriterë deri në fund. Në kontekst të këtij Raporti, kjo mund të interpretohet se shteti është i obliguar që të ndërmarrë masa të domosdoshme për të mbrojtur të drejtën e pronës dhe të sigurojë një arsenal të adekuat dhe të mjaftueshëm për ta siguruar përmbushjen e detyrimeve pozitive për mbrojtjen e të drejtave pronësore deri në ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të autoritetit kompetent të nxjerra pas vendosjes së kriterëve ligjore.

Në bazë të fakteve të paraqitura në këtë rast, Avokati i Popullit mendon se AKKVP-ja, si pasardhëse ligjore e DÇPB-së, në kuptim të të drejtave dhe obligimeve të marra, është organ kompetent për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të KKPB-së, bashkë me Qeverinë e Kosovës, e cila është e obliguar që në shumën e plotë të njëhershme të sigurojë mjetet për pagesën e kërkesave totale pronësore nga skema e kompensimit për parashtruesit e kërkesave të kategorisë AC.

Avokati i Popullit konstaton se dështimi i organeve kompetente të Republikës së Kosovës për ta siguruar ekzekutimin e vendimit përfundimtar të KKPB-së HPCC/D/197/2005A & C, i datës 18.6.2005, si dhe të gjitha vendimeve të tjera për parashtruesit e kërkesave të kategorisë AC, përbën shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të Konventës.

Për shkak të moszekutimit të vendimit të lartpërmendur dhe të gjitha vendimeve të tjera përfundimtare për parashtruesit e kërkesave të kategorisë C, ankuesit dhe personave të tjerë nga këto vendime u është shkelur dhe padrejtësisht u është mohuar e drejta pronësore dhe gëzim në paqe i pronës, në kuptim të nenit 46 të Kushtetutës dhe të nenit 1 të Protokollit 1 të KEDNj-së.

Avokati i Popullit vë në dukje se është obligim pozitiv i shtetit që ta sigurojë një sistem efikas për zbatimin e vendimeve përfundimtare të organeve kompetente brenda një kohe të arsyeshme pa vonesa të panevojshme ose të pajustificuara dhe për këtë qëllim rekomandon që Qeveria e Kosovës, pa vonesa të mëtutjeshme, nga buxheti i Republikës së Kosovës të sigurojë dhe ndajë në fondin përkatës të AKKVP-së shumën e plotë të mbetur, që nevojitet për pagesën e kërkesave të trashëguara sipas vendimeve përfundimtare të KKP-së për parashtruesit e kërkesave të kategorisë C; AKKVP-ja, në një afat sa më të shkurtër, të nxjerrë akte nënligjore lidhur me procedurat për ekzekutimin e kërkesave pronësore të trashëguara sipas vendimeve përfundimtare të KKP-së për parashtruesit e kërkesave të kategorisë AC.

Raport për rastin A.nr. 114/2018; A.nr. 122/2018 dhe A.nr. 182/2018, në lidhje me kushtin diskriminues në konkursin për punësim në Shërbimin Korrektues

Më 16 prill 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime në lidhje me kushtin diskriminues në konkursin për punësim në Shërbimin Korrektues të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *ShKK*), duke u bazuar në tri ankesa individuale: më 22.2.2018, A. nr. 114/2018 nga z. Remzi Hoxha, më 27.2.2018, A. nr. 122/2018 nga Qendra e Kosovës për Transparencë, Përgjegjësi dhe Luftimin e Korrupsionit (në tekstin e mëtejshëm KUND) dhe më 16.3.2018 nga z. Fisnik Bllaca dhe të tjerët (15), në lidhje me kushtin diskriminues të paraparë dhe të shpallur në konkursin për punësim, ShKK, i datës 12.2.2018, me numër të referencës MJ/KCS/132-09-02-2018.

Qëllimi i raportit është që të tërheqë vëmendjen për nevojën e mbrojtjes nga diskriminimi si dhe trajtimit të barabartë në punësim, në rastin e kriterit që është paraparë për vendet e lira të punës, i shpallur në konkursin për punësim të kandidatëve në ShKK. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit do të analizojë harmonizimin e kriterit të kontestuar, të cilin ShKK-ja e ka publikuar më 12.2.2018 në konkursin me numrin e referencës MJ/KCS/132-09-02-2018, për 70 vende të lira për Zyrtarë korrektues (në tekstin e mëtejshëm *Konkurs*), me legjislacionin vendor dhe instrumentet ndërkombëtare, që veçanërisht kanë të bëjnë me aspektin e mbrojtjes nga diskriminimi.

Në Konkursin e ShKK-së, me numër të referencës MJ/KCS/132-09-02-2018, i shpallur për 70 vende të punës për pozitën “Zyrtarë korrektues”, në pjesën “Kualifikimet, shkathtësitë dhe karakteristikat personale” si kriter për praninë theksohet “*Mosha mesatare për meshkuj është deri 30 vjet, për gra deri 35 vjet*”.

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi për të përcaktuar nëse me përjashtimin e mundësisë së themelimit të marrëdhënies së punës për vendin e punës Zyrtarë korrektues është bërë diskriminim duke e kufizuar moshën e kandidatëve/kandidateve potencialë/e, Avokati i Popullit nuk do të lëshohet në analizën nëse në rastin konkret mosha deri në 30 vjet për meshkuj, gjegjësisht 35 vjet për femra, paraqet kushtin real dhe vendimtar për ushtrimin e kësaj detyre, duke pasur parasysh natyrën dhe veçantinë e kësaj pune dhe nëse qëllimi që synohet të arrihet është i arsyeshëm, por ekskluzivisht shqyrton dhe analizon çështjen nëse vendosja e kushtit

kufizues gjatë punësimit në Konkursin e ShKK-së bazohet në akt të veçantë juridik të duhur në pajtim me Ligjin për mbrojtje nga diskriminimi dhe me standardet ndërkombëtare.

Avokati i Popullit konsideron që qëllimi i konkursit publik pasqyrohet në parimin e qasjes së barabartë për të gjithë qytetarët që, nën kushte të njëjta, në bazë të ligjit, në mënyrë të barabartë të konkurrojnë për çdo vend pune në sektorin publik. Barazia në punësim është kushti themelor i barazisë para ligjit. Andaj një personi, për shkak të karakteristikave të tij/saj personale, gjegjësisht në rastin konkret, moshës, pa justifikim objektiv dhe të arsyeshëm me ekzistencën e qëllimit legjitim, nuk mundet që në mënyrë të paarsyeshme t'i mohohet e drejta në punësim, e drejtë që për të tjerët është e qasshme dhe u pranohet në kuptim të plotë.

Avokati i Popullit sipas udhëzimeve të Këshillit të Evropës dhe Direktivës për ndalimin e diskriminimit në bazë të moshës³⁸⁵, tërheq vërejtjen që ndalimi i diskriminimi të bazë të moshës paraqet pjesë të rëndësishme të përmbushjes së qëllimeve të përcaktuara në udhëzimet për punësim, si dhe stimulim për diversitetin e fuqisë punëtore. Sipas këtyre udhëzimeve është evidente që për çdo kusht me rastin e punësimit, i cili ka karakter eliminues, që do të mund të trajtohej “si veprim i arsyetuar ndryshe”, është e nevojshme të ekzistojë një rregullore e veçantë.

Avokati i Popullit thekson që qëllimi i ekzistencës së këtij akti të veçantë juridik, me të cilin do të përcaktohen vendet e punës në bazë të moshës së të punësuarit/punësuarës, si cilësi personale, paraqet kusht të veçantë për kryerjen e punës, nëse për këtë ekziston nevoja e arsyeshme, duke respektuar me këtë rast rregullat imperative ligjore, domosdoshmërinë, sepse paraqet bazë relevante ligjore dhe ofron mundësinë e vendosjes së kushtit kufizues në fjalë. Prandaj, sipas udhëzimeve të Këshillit të Evropës dhe Direktivës për ndalimin e diskriminimit në bazë të moshës, është e rëndësishme të bëhet dallimi ndërmjet trajtimit të ndryshëm të justifikueshëm, në veçanti atij që bazohet në objektivat e justifikuara të politikës së punësimit, tregut të punës dhe qëllimeve të trajnimit, nga diskriminimi i cili duhet të ndalohet.

Në lidhje me këto, Avokati i Popullit konstaton që Kushtetuta dhe rregulloret relevante ligjore ndalojnë dallimin arbitrar dhe veprimet e pabarabarta gjatë përcaktimit të kushteve për punësim dhe përzgjedhjes së kandidatëve/kandidateve për kryerjen e një pune të caktuar në bazë të moshës së tyre. Kështu që, përjashtimet nga kjo rregulle në mënyrë shumë restriktive duhet të interpretohen dhe të pranohen si të justifikuara vetëm me ekzistencën e rregulloreve të veçanta dhe në situata kur mosha paraqet faktor real dhe vendimtar për mundësinë, gjegjësisht për pamundësinë e kryerjes së një pune të caktuar, duke pasur parasysh natyrën dhe veçantinë e kësaj pune. Nisur nga këto që u thanë, Avokati i Popullit rekomandon: Ministria e Drejtësisë (MD) – Shërbimi Korrektues i

³⁸⁵ Shih Direktivën e Këshillit Evropian 2000/78/EC, nga 27.11. 2000 për vendosjen e kornizës së përgjithshme për trajtim të barabartë gjatë punësimit dhe kryerjen e profesionit, pika 25.

Kosovës (ShKK), pa vonesë, ta ndërpresë procedurën e rekrutimit dhe ta anulojë konkursin MJ/KCS/132-09-02-2018, i datës 12.2.2018, për shkak të mungesës së rregullore ligjore relevante dhe si pasojë e vendosjes së pajustificuar të kushtit kufizues në aspektin e moshës; MD – ShKK, pa vonesë, me akt të përgjithshëm për sistematizim të vendeve të punës, për të cilat moshë, si cilësi personale, paraqet kusht të veçantë për kryerjen e punës, nëse për këtë ekziston nevoja e arsyeshme, duke respektuar me këtë rregullat imperative ligjore, sipas të cilave moshë, si dhe çdo cilësi tjetër personale, duhet të paraqesë kusht real dhe vendimtar për kryerjen e punës në kuadër të vendit të punës, duke pasur parasysh natyrën dhe veçantinë e punës dhe kushtet në të cilat kryhet ajo punë; MD – SHKK me rastin e shpalljes së vendeve të lira të punës, në konkurset për punësim t’i vendosë vetëm ato kushte për kryerjen e punëve, që janë të përcaktuara me akt të veçantë të përgjithshëm për sistematizimin e vendeve të punës; MD-SHKK t’i ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme, me qëllim që me rastin shpalljes së vendeve të punës dhe përzgjedhjes së kandidatit/kandidates të parandalohet shkelja e mundësive të barabarta me rastin e themelimit të vendit të punës, përkatësisht të mos vijë deri te bërja e dallimeve të pajustificuara.

Raport për rastin A.nr. 185/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 29/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandim në lidhje me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 29/2015. Qëllimi i këtij Raporti është t’i tërhiqet vëmendja Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.29/2015, pa vonesa të mëtutjeshme. Raporti është i bazuar në ankesën individuale të z. Musa Musliut, (në tekstin e mëtejshëm *ankuesi*) dhe mbështetet në faktet dhe provat që ankuesi i ka ofruar, si dhe në shkresat e lëndës, të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP).

Më 27 janar 2011, Gjykata Komunale në Gjilan (tani Gjykata Themelore në Gjilan), duke vendosur lidhur me çështjen, ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.191/2007, sipas të cilit aprovohet kërkesëpadia e paditësit. Më 8 maj 2012, Gjykata e Qarkut në Gjilan, duke vendosur sipas ankesës, ka nxjerrë Aktvendimin Ac.nr.95/11, sipas të cilit prishet Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë (C.nr.191/2007) dhe lënda kthehet në rigjykim. Më 5 nëntor 2014, Gjykata Themelore në Gjilan vendosi lidhur me çështjen dhe nxori Aktgjykimin C.nr.385/2012, sipas të cilit përsëri aprovohet kërkesëpadia e paditësit. Më 2 dhjetor 2014, pala e paditur ka ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit dhe lënda, sipas ankesës, për të dytën herë është në Gjykatën e Apelit (Ac.nr. 29/2015). Lënda është iniciuar më 6 prill 2007 në Gjykatën Komunale në Gjilan (tani Gjykata Themelore në Gjilan) me padi për kompensimin e dëmit, në të cilën ankuesi është në cilësinë e paditësit, ndërsa e paditur është Komuna e Gjilanit - Shkolla e Mesme Teknike “Mehmet Isai” në Gjilan. Pra, ankuesi për 11 vjet është në pritje për t’u vendosur përfundimisht lidhur me çështjen e tij.

Avokati i Popullit rikujton që praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih në mes tjerash, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) e deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).

Neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për një individ, që e bën të mundur që ai/ajo t'i gëzojë të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih Aktgjykimin *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv në një autoritet vendor, për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme. Pasi që rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankesë të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, të ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosje në lëndën AC. nr. 29/2015.

Raport për rastin A.nr. 716/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1995/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime A.nr. 716/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1995/2015. Qëllimi i këtij Raporti është t'i tërhiqet vëmendja Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.1995/2015, pa vonesa të mëtejshme. Ky Raport është i bazuar në ankesën individuale të znj. Nazlije Thaqi (në tekstin e mëtejme *ankuesja*) dhe mbështetet në faktet dhe provat që ankuesja i ka ofruar, si dhe në shkresat e lëndës të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP).

Më 21 janar 2011, ankuesja ka parashtruar padi për kompensim të dëmit material dhe jomaterial në Gjykatën Komunale në Prizren. Më 25 shkurt 2015, Gjykata Themelore ka nxjerrë Aktgjykim C.nr.49/11, në favor të ankueses. Më 15 prill 2015, pala kundërshtare, e pakënaqur me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.49/11, paraqet ankesë në Gjykatën e Apelit, për të cilën gjykata akoma nuk ka vendosur. Më 31 tetor 2017, ankuesja paraqiti ankesë në IAP lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore për shqyrtimin e lëndës C.nr.49/11. Më 16 nëntor 2017, Avokati i Popullit i dërgoi letër kryetarit të Gjykatës së Apelit, për të kërkuar informata lidhur me veprimet që gjykata i ka ndërmarrë dhe që planifikon t'i ndërmerr për shqyrtimin e çështjes së parashtruar nga ankuesja. Më 29 nëntor 2017, IAP-ja, përmes postës elektronike, ka pranuar përgjigje nga kryetari i Gjykatës së Apelit, ku thuhet: "*Kjo lëndë ka ardhur në gjykatë më 28 maj 2015. Është ndarë në punë dhe pret në radhë për vendosje.*"

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së.

Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. GjEDNj-ja ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih, në mes tjerash, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga 21 janar 2011, kur paditësi ka paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Prizren. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rrikujton se GjEDNj-a disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999 dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih, Aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.

Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 1995/2015.

Raport për rastin A.nr. 462/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 4643/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 462/2017, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 4643/2015. Qëllimi i këtij Raporti është që t'i tërhiqet vëmendja Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.4643/2015, sipas Aktgjykimit C.nr.133/2011, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit në këtë rast tërheq vëmendjen tek praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë

Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-a ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton që praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-a ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga viti 2011, kur ankuesja ka paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Prizren. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti, nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtim dhe vendosje të lëndës AC. nr. 4643/2015.

Raport për rastin A.nr. 796/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3703/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandim për rastin A.nr. 796/2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 3703/2015. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr.3703/2015, sipas Aktgjykimit C. Nr. 518/13, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë

themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së.

Në raste të shumta, GjEDNj-a ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Avokati i Popullit rikujton që praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

GjEDNj-a ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983). Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet që nga viti 2013, kur paditësi ka paraqitur padinë në Gjykatën Themelore në Prizren. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej që ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).

Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr.3703/2015.

Raport për rastin A.nr. 794/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 3200/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 794/2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 3200/2015. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.3200/2015, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë

themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së.

Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. GjEDNj-ja ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet që nga 12 shkurt 2013, kur paditësja ka paraqitur padinë në Gjykatën Themelore në Prizren. Deri në ditën e publikimit të këtij Raporti nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Njëkohësisht, mungesa e mjeteve efektive në shkeljen e të së drejtës për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përbën shkelje të nenit 13 të Konventës. Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë, në rastet kur palët në procedurë nuk kanë mjete efektive për ankim në rastet e zvarritjes së procedurave gjyqësore përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit ligjor vendor (shih Aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe Aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej që të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Nisur nga kjo, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtim dhe vendosje të lëndës AC. nr. 3200/2015.

Raport për rastin A.nr. 463/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1763/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për A.nr. 463/2017, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1763/2015. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen në lëndën AC. nr. 1763/2015, sipas Aktgjykimit C. nr. 481/13, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton që praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

GjEDNj-ja ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet që nga 13 janar 2009, kur paditësi ka paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Prizren. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).

Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të

gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr.1763/2015.

Raport për rastin A.nr. 206/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 863/2014

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 206/2017, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 863/2014. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen në lëndën AC. nr. 863/2014, sipas Aktgjykimit C. nr. 19/13, pa vonesa të mëtutjeshme.

Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar, (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

GjEDNj-ja, në rastin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme. (Aktgjykimi *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga janari i vitit 2013, kur paditësi ka paraqitur padinë në Gjykatën Themelore në Prizren. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).

Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse

ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC. nr. 863/2014, pa vonesa të mëtutjeshme.

Raport për rastin A.nr. 429/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr.3109/12

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 429/2017, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr.3109/12. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr. 3109/12, pa vonesa të mëtejme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së.

Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja, në rastin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme. (Aktgjykimi *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është që të kërkojë që një dispozitë e një mjeti ligjor vendor të merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimin në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000). Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes së cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të

parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi GjThP-së që, pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.Nr. 3109/12.

Raport për rastin A.nr. 388/2014 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 239/2013

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 388/2014, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 239/2013. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC. nr. 239/2013, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së.

GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset më afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja, në rastin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre brenda një kohe të arsyeshme (Aktgjykimi *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje të parandalojnë shkeljen e pohuar ose vazhdimin e saj, ose për të ofruar përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e përmendur *Kudla kundër Polonisë*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC. nr. 239/2013.

Raport për rastin A.nr. 362/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 430/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandim për rastin A.nr. 362/2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 430/2015. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.430/2015, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Avokati i Popullit në këtë rast i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosje në lëndën AC. nr. 430/2015.

Raport për rastin A.nr. 561/2015 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamentin për Çështje Ekonomike, në lëndën C.nr. 649/2014

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 561/2015, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamentin për Çështje Ekonomike, në lëndën C. nr. 649/2014. Raportit ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamentit për Çështje Ekonomike, lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C. nr. 649/2014, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet

gjqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Avokati i Popullit në këtë rast i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C. Nr. 649/2014.

Raport për rastin A.nr. 648/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën CA nr. 374/2014

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 648/2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën CA nr. 374/2014. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës së Apelit lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën CA 374/2014, pa vonesa të mëtutjeshme.

Lënda fillimisht është iniciuar me padinë e dorëzuar më 10 qershor 2001 në Gjykatën Komunale në Prishtinë (tani Gjykata Themelore në Prishtinë), duke i kaluar të gjitha instancat gjyqësore dhe për t’u kthyer sërish në rigjykim. Pra, ankuesi për 16 vjet është në pritje të vendimit, lënda e të cilit ende nuk është vendosur përfundimisht.

Praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka vërtetuar se kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Në rastin e ankuesit procedura gjyqësore është iniciuar më 10 qershor 2001. GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Po ashtu, Avokati i Populli vëren se, sipas të drejtës precedentale të GjEDNj-së, “arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave duhet të vlerësohet duke iu referuar

kritereve, si: kompleksiteti i rastit, sjelljes së ankuesit dhe sjelljes së autoriteteve përkatëse dhe se çfarë ishte në rrezik për aplikuesin në çështjen në fjalë” (GjEDNj [Dhoma e Madhe], *Frydlander v. France*, Aplikimi Nr. 30979/96 (2000), par. 43, duke cituar GjEDNj [Dhoma e Madhe], *Comingersoll S.A. v. Portugal*, Aplikimi Nr. 35382/97, par. 19 (2000), par. 19).

Në rastin konkret, Avokati i Popullit vëren se çështja e ankuesit mund të cilësohet si çështje komplekse, duke pasur parasysh se padia fillestare për anulim kontrate mbi blerjen e banesës është iniciuar në Gjykatën Komunale në Prishtinë, më 10 qershor 2001, por, meqë në atë kohë kërkesat pronësore dhe banesore për periudhën 23 mars 1989 deri më 24 mars 1999, ishin kompetencë ekskluzive e Drejtorisë për Çështje Pronësore Banesore (Rregullorja e UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60), ankuesi, më 28 qershor 2001, kishte parashtruar kërkesë edhe në Drejtorinë për Çështje Pronësore Banesore (DÇPB)³⁸⁶. Më 12 dhjetor 2003, Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore Banesore kishte nxjerrë vendim³⁸⁷ me të cilin i refuzohej kërkesa ankuesit. Edhe pas rishqyrtimit, Komisioni për Shqyrtimin e Kërkesave Pronësore Banesore, më 31 mars 2006, kishte refuzuar kërkesën e ankuesit dhe e kishte udhëzuar atë t’i drejtohej gjykatës kompetente³⁸⁸. Kështu, ankuesi, më 11 maj 2007, ka dorëzuar parashtrësë për zgjerimin e kërkesëpadisë në Gjykatën Komunale në Prishtinë.

Prandaj, duke u nisur nga praktika gjyqësore e GjEDNj-së, Avokati i Popullit vëren se zvarritja procedurale për periudhën që nga inicimi i padisë, më 10 qershor 2001 e deri më 11 maj 2007, mund të justifikohet për shkak të rrethanave. Megjithatë, periudha që nga 11 maji 2007, kur ankuesi ka paraqitur zgjerimin e padisë, e deri më tani, 11 vjet më pas, paraqet shkelje të nenit 6 të KEDNj-së. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën CA nr.374/2014

Raport për rastin A.nr. 721/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën CA. nr. 4667/2014

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 721/2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën CA. nr. 4667/2014. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtim dhe vendosje në lëndën CA. nr. 4667/2014, pa vonesë të mëtejshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që

³⁸⁶ Në bazë Rregullores së UNMIK-ut 1999/23 dhe 2000/60, kërkesat pronësore ishin kompetencë ekskluzive e DÇPB, për të pranuar dhe zgjidhur ato, për periudhën 23 mars 1989-24 mars 1999.

³⁸⁷ Vendimi HPCC/D102/2003/A&C, i datës 12 dhjetor 2003.

³⁸⁸ Vendimi HPCC/REC/60/2006, i datës 31 mars 2006.

çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton që praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën CA. nr.4667/2014.

Raport për rastin A.nr. 357/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr. 2210/07

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 357/2017, lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr. 2210/07. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen në lëndën C.nr.2210/07, për anulimin e kontratës për shitblerje të pasurisë së patundshme dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në një numër rastesh, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret fillon të llogaritet nga data 16 tetor 2007, kur paditësi ka paraqitur padinë në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjete ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të

kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej ankohet për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit.

Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që, pa vonesa të mëtejshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.2210/07.

Raport për rastin A.nr. 57/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3297/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 57/2017, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 3297/2015/. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 3297/2015, pa vonesa të mëtejshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, në mes tjerash, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi

në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. Nr. 3297/2015.

Raport për rastin A.nr. 705/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3181/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandim për rastin A.nr. 705/2016, që ka të bëjë lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3181/2015. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 3181/2015, sipas aktgjykimit C. nr. 56/13, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, *në mes tjerash*, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 3181/2015.

Raport për rastin A.nr. 55/ 2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3488/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 55/ 2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr. 3488/2015. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr. 3488/2015.

Rasti i ankuesit ka filluar të procedohet në gjykata që nga viti 1992 dhe deri më sot. Pra, ankuesi, për 26 vjet është në pritje të vendimit, lënda e të cilit ende nuk është vendosur

përfundimisht me vendim meritor. Për këtë rast, që nga viti 1992 deri me sot, në ish-Gjykatën Komunale në Vushtri, në ish-Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë dhe në Gjykatën Supreme të Kosovës janë zhvilluar afërsisht 82 seanca gjyqësore (53 para vitit 1999 dhe 29 pas vitit 1999 deri më sot). Disa herë rasti është kthyer në rigjykim nga ish-Gjykata e Qarkut, dy herë ka qenë në revizion. Momentalisht lënda gjendet në Gjykatën e Apelit në Prishtinë dhe raporti në fjalë e vë në fokus kohën prej kur është riaktivizuar lënda në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Vushtri (atëherë Gjykata Komunale në Vushtri).

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor, paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, *në mes tjerash*, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtejme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr. 3488/ 2015.

Raport për rastin A.nr. 864/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC nr.292/2016

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 864/2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC

nr.292/2016. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Gjykatës së Apelit në Prishtinë lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC nr.292/2016, pa vonesë të mëtejshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se kohëzgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih, *në mes tjerash*, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC 292/2016.

Raport për rastin A.nr. 375/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1865/2014

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 375/2016, lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. nr. 1865/2014. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. nr. 1865/2014, sipas Aktgjykimit C. nr. 638/13, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, *në mes tjerash*,

Aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe Aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Avokati i Popullit në këtë rast i rekomandoi Gjykatës së Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC. Nr.1865/2014.

Raport për rastin A.nr. 910/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën A.nr. 2263/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 910/2016, lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën A.nr. 2263/2015. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën A.nr. 2263/2015, pa vonesë të mëtejshme.

Ankuesi ka parashtruar ankesë për zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamentin për Konteste Administrative dhe pretendon se kjo gjykatë nuk ka ndërmarrë veprime procedurale në afat të arsyeshëm dhe se kjo mund të përbëjë shkelje të së drejtës së tij në gjykim të drejtë dhe në afat të arsyeshëm kohor, sikurse është garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNj-së.

Në shumë raste, GjEDNj-ja ka theksuar që pala ka të drejtë që lënda e tij të zgjidhet në afat të arsyeshëm kohor, gjë që paraqet element kyç të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka vërtetuar se kohëzgjatja e procedurës llogaritet normalisht nga dita e inicimit të procedurës (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë* të datës 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë* të datës 30 shtator 2003) deri në kohën kur është përfunduar lënda dhe/apo është ekzekutuar aktgjykimi (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës* të

datës 8 nëntor 2005). Megjithatë, Avokati i Popullit rikujton se neni 6 i Konventës nuk parasheh kurrfarë afati përfundimtar absolut për përcaktimin e kohëzgjatjes së arsyeshme të procedurës, por se vendimi i tij varet nga rrethanat e caktuara të rastit.

Gjithashtu, Avokati i Popullit vëren se “arsyeshmëria” e kohëzgjatjes së procedurës sipas praktikës gjyqësore të GjEDNj-së duhet të vlerësohet duke u thirrur në kriteret në vijim: kompleksiteti i lëndës; sjellja e parashtruesit të kërkesës dhe organeve kompetente; dhe me çfarë është rrezikuar ankuesi në lëndën e përmendur “(GjEDNj [Dhoma e madhe], *Frydlender kundër Francës*, parashtresa numër 30 979/ 6 (2000), paragrafi 43, duke u thirrur në GjEDNj [Dhoma e madhe], *Comingersoll S.A. kundër Portugalisë*, parashtresa nr. 35382/97, paragrafi 19 (2000), paragrafi 19). Avokati i Popullit vëren se lënda e ankuesit nuk ishte komplekse dhe ka të bëjë me aspekte procedurale të përmirësimit të emrit tek regjistrimi i të drejtave absolute në pronë dhe se sjellja e ankuesit nuk i ka kontribuar zvarritjes procedurale.

Sa i përket zbatimit të nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë ka theksuar se vonesa e tepërt në ushtrimin e drejtësisë për sa kohë pala nuk ka kurrfarë mjeti juridik, përbën kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit të brendshëm juridik (shih psh. *Bottazzi kundër Italisë* aktgjykimi i datës 28 korrik 1999 dhe *Di Mauro kundër Italisë* aktgjykimi i datës 28 korrik 1999).

Sa i përket dispozitave të nenit 13 të KEDNj-së, Avokati i Popullit rikujton që efekti i këtij neni është të kërkojë dispozitën e mjetit juridik për trajtimin e materies së “ankesës së kontestueshme” sipas Konventës dhe të ndajë kompensim të përshtatshëm material (*Kaya kundër Turqisë*, Aktgjykimi i datës 19 shkurt 1998). Secili mjet i tillë juridik duhet të jetë efektiv në praktikë dhe në ligj (*Ilhan kundër Turqisë*, Aktgjykimi i datës 27 qershor 2000).

Sa i përket ankesës në kohëzgjatjen e procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjeti efektiv juridik” në pikëpamje të nenit 13 të Konventës, do të duhej të jetë në gjendje të parandalojë shkeljen e pretenduar apo vazhdimin e të njëjtit apo sigurimin e kompensimit adekuat për çfarëdo shkelje që ka ndodhur (shih më herët është përmendur aktgjykimi i *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se nuk ekziston kurrfarë qasje ligjore me të cilin ankuesi në lëndën në fjalë do të mund të ankohet në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës me mundësi të realizimit të ndihmës preventive apo të kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që, pa zvarritje të mëtejshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet relevante për shqyrtimin dhe vendosjen në lidhje me lëndën A.nr.2263/2015.

Raport për rastin A.nr. 473/2016 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr.1874/11

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 473/2016, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së

veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C.nr.1874/11, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, *në mes tjerash*, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose Aktgjykimi është ekzekutuar (shih Aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Avokati i Popullit vëren se në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Avokati i Popullit në këtë rast i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.1874/11.

Raport për rastin A.nr. 410/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.Nr. 3451/2015

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 410/2017 që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC. Nr. 3451. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën AC.nr.3451/2015, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet

gjqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, *në mes tjerash*, aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me kërkesat e nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih Aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes të cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatën e Apelit që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtim dhe vendosje të lëndës AC. nr. 3451/2015.

Raport për rastin A.nr. 722/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr. 3077/13

Më 29 maj 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 722/2017, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë në lëndën C.nr.3077/13. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C.Nr.3077/13, pa vonesa të mëtutjeshme.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit, të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të GjEDNj-së. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Avokati i Popullit rikujton se praktika e GjEDNj-së ka vërtetuar se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, *në mes tjerash*,

aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005).

Lidhur me ankesën për zvarritje të procedurës, Avokati i Popullit rikujton se “mjetet efektive” në kuptim të nenit 13 do të duhej të ishin në gjendje ta parandalojnë shkeljen e pohuar apo vazhdimin e saj, ose të ofrojnë përmirësimin adekuat për çfarëdo shkelje që tashmë kishte ndodhur (shih aktgjykimi i lartpërmendur *Kudla*). Në sistemin tonë të brendshëm nuk ekziston një mekanizëm ligjor përmes së cilit ankuesi do të mund të ankohej për zvarritje të procedurës për të arritur çfarëdo lehtësimi në formë të parandalimit apo kompensimit. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që, pa vonesa të mëtutjeshme, t’i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën C.nr.3077/13.

Raport për rastin A.nr. 235/2017 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr.724/2014

Më 17 korrik 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr.235/2017, lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr.724/2014. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC.nr.724/2014, pa vonesa të mëtutjeshme.

Lënda fillimisht është iniciuar nga ankuesi me padinë e dorëzuar më 13 korrik 2011, në Gjykatën Themelore në Pejë. Më pas, pala e paditur, më 3 shkurt 2014, ka parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë (GjA). Ankuesi që 7 vjet është në pritje të vendimit nga gjykata për lëndën që ende nuk është vendosur përfundimisht.

Avokati i Popullit rikujton se praktika gjyqësore e GjEDNj-së ka vërtetuar se kohëzgjatja e procedurës llogaritet nga koha e inicimit të procedurës gjyqësore (shih aktgjykimin *Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë*, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). Në rastin e ankuesit, procedura gjyqësore është iniciuar më 13 korrik 2011, në Gjykatën Themelore në Pejë. Në raste të shumta, GjEDNj-ja ka theksuar se e drejta e palës që çështja e tij të vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

Sipas praktikës së GjEDNj-së (shih *Poiss v. Austria*, § 50; *Bock v. Germany*, §35), llogaritja e kohës për trajtim të një rasti gjyqësor fillon nga momenti i paraqitjes së padisë pranë gjykatës kompetente, e që në rastin konkret, nisur nga rrethanat e rastit, mund të konsiderohet data 13 korrik 2011, kur ankuesi ka paraqitur padi në Gjykatën Themelore në Pejë. Më 3 shkurt 2014, pala e paditur ka parashtruar ankesë në GjA. Pra, ankuesi që 7

vjet është në pritje të vendimit nga gjykata dhe deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk është marrë ndonjë vendim përfundimtar lidhur me çështjen e ankuesit.

Avokati i Popullit vëren se neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që, fillimisht dhe në mënyrë primare, të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë për të siguruar që individit gëzon të drejtat në mënyrë efektive. Nëse shikohet nga kjo perspektivë, e drejta e një individit për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efektive nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrojë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 përkrahin ato të nenit 6 (shih aktgjykimin *Kudla vs Polland*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimi efektiv pranë një autoriteti vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6 për ta shqyrtuar një rast brenda një kohe të arsyeshme.

Sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GjEDNj-ja disa herë e ka theksuar se vonesat e mëdha në administrimin e drejtësisë lidhur me palët kontestuese, të cilat nuk kanë mjete, përbëjnë kërcënim për sundimin e ligjit brenda rendit vendor ligjor (shih aktgjykimin në rastin *Bottazi kundër Italisë*, më 28 korrik 1999, dhe aktgjykimin në rastin *Di Mauro kundër Italisë*, më 28 korrik 1999). Në rastin e ankuesit, lënda është në pritje për vendosje në Gjykatën e Apelit, që nga 3 shkurti 2014 dhe nuk është zhvilluar asnjë seancë. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Gjykatës së Apelit që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet përkatëse ligjore për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës AC.nr.724/2014, pa vonesa të mëtutjeshme.

Raport për rastin A.nr. 533/2017 lidhur me mosnjohjen e gradës Master për kualifikimet e fituara sipas sistemit të studimeve universitare pesëvjeçare sipas sistemit të para Bolonjës

Më 19 korrik 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A. nr. 533/2017, lidhur me mosnjohjen e gradës Master për kualifikimet e fituara sipas sistemit të studimeve universitare pesëvjeçare, sipas sistemit të para Bolonjës. Ky Raport me rekomandime bazohet në ankesën e pranuar nga z. Ahmet Murati parashtuar kundër Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë (MAShT) dhe Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) dhe ka të bëjë me mosnjohjen e së drejtës për gradë Master, për të diplomuarit në sistemin pesëvjeçar të shkollimit universitar në fushën teknike, sipas sistemit të para Bolonjës; dhe ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes për nevojën e ndërmarrjes së veprimeve për harmonizimin e legjislacionit primar dhe sekondar, që rregullon krahasueshmërinë dhe barasvlerësimin e diplomave dhe të programeve studimore, para sistemit të Bolonjës dhe të sistemit të Bolonjës.

Rasti ka të bëjë me ankesën e z. Ahmet Muratit parashtuar kundër MAShT-it, që lidhet me nenin 5 të Udhëzimit Administrativ (MAShT) nr. 11 Krahasueshmëria dhe Barazvlera e Diplomave dhe e Programeve Studimore Para Sistemit të Bolonjës dhe të Sistemit të Bolonjës, përkitazi me mosnjohjen e gradës Master. Z. Murati, po ashtu është ankuar kundër UP-së, për arsye të moslëshimit të diplomës për barasvlerësimin e kualifikimeve

të fituara në sistemin e studimeve pesëvjeçare, sipas sistemit të studimeve të aplikueshme para sistemit të Bolonjës me gradën Master.

Sipas informatave të pranuar nga ankuesi, kuptohet që z. Murati, në vitin 1988, kishte përfunduar studimet universitare në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Dega Elektronikë, në UP dhe kishte marrë kualifikimin Inxhinier i Diplomuar i Elektroteknikës. Nga shtojca e diplomës, e datës 20 shtator 2013, të lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike i UP-së, vërehet se z. Murati kishte përfunduar studimet themelore universitare sipas sistemit të para Bolonjës, në kohëzgjatje prej 5 vjetëve dhe 10 semestrave. Bazuar në kohëzgjatjen e studimeve, ankuesi kishte grumbulluar gjithsej 300 ECTS kredi. Sipas pikës 5.1 të shtojcës së diplomës, 300 ECTS kredi i kishin dhënë të drejtën e aplikimit në studimet Master dhe/ose të Doktoraturës.

Duke marrë parasysh që ankuesit dhe të tjerëve, të diplomuar në sistemin e para Bolonjës, sipas Udhëzimit Administrativ nr. 11/2015 Krahasueshmëria dhe Barasvlera e Diplomave dhe e Programeve Studimore para Sistemit të Bolonjës nuk u njihet titulli Master, edhe pse studimet që i kanë ndjekur barasvlerësohen me 300 ECTS kredi, mund të konsiderohet se mosnjohja e gradës së kualifikimit Master përmban elemente të trajtimit të pabarabartë dhe diskriminuese ndaj tij dhe të tjerëve, të diplomuar në të njëjtin sistem dhe të punësuar në institucione arsimore. Trajtimi i pabarabartë reflekton në kushtet e punësimit dhe të diferencës në lartësinë e kompensimit të pagës sipas gradës Master.

Duke marrë parasysh çështjen e analizës, pozitën e pabarabartë të të diplomuarve në sistemin pesëvjeçar të para Bolonjës, në krahasim me të diplomuarit sipas sistemit të Bolonjës, si në aspektin e kushteve të punësimit, e po ashtu në nivelin e kompensimit të pagës, Avokati i Popullit sjell në vëmendje nenin 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili saktëson: *“Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji.”*

Avokati i Popullit, pas analizës së rastit, vëren se, edhe pse Ligji nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës përcakton saktësisht kreditë për marrjen e diplomës Master, neni 5 i Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 11 Krahasueshmëria dhe Barasvlera e Diplomave dhe e Programeve Studimore para Sistemit të Bolonjës dhe të Sistemit të Bolonjës, i cili parasheh: *“Diplomat e studimeve universitare 4.5 (katër vite e gjysmë) dhe 5 (pesëvjeçare) që kanë përfunduar me mbrojtje publike të temës në fushat teknike të sistemit të para Bolonjës barsvlerësohen me 300 ECTS”*, lë zbrazëti ligjore, duke mos arritur që ta sqarojë qartë ekuivalencën e kredive të fituara gjatë studimeve me gradën përkatëse të kualifikimit.

Avokati i Popullit konsideron se neni i lartpërmendur, duke mos arritur të jetë i kuptueshëm dhe i parashikueshëm, bie ndesh me parimin e sigurisë juridike, si element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës. Zbrazëtia ka shkaktuar kufizimin e të drejtave dhe pritshmërive ligjore, që është dashur ta prodhojë dispozita në fjalë.

Për më tepër, neni i lartpërmendur vë në pozitë të pabarabartë ankuesin dhe të tjerët, të cilët i kanë përfunduar studimet themelore universitare në fushat teknike sipas sistemit të para Bolonjës, në kohëzgjatje prej 5 vjetëve, 10 semestrave dhe kanë grumbulluar gjithsej 300 ECTS, me të diplomuarit sipas sistemit të Bolonjës. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi MASHT-it që t'i ndërmarrë veprimet dhe hapat e nevojshëm, me qëllim të plotësimit dhe riformulimit të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 11 për Krahasueshmërinë dhe Barasvlerën e Diplomave dhe të Programeve Studimore para dhe sipas sistemit të Bolonjës, me qëllim të mundësimit të njohjes së titullit Master për të diplomuarit në sistemin pesëvjeçar të studimeve në fushën teknike para Sistemit të Bolonjës; ndërsa UP-së i rekomandoi që pas miratimit të udhëzimit administrativ, t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme përgatitore, me qëllim të lëshimit të diplomave për njohje të kualifikimit Master.

Raport për rastin A.nr. 186/2017 përkitazi me pretendimet e ankuesit për trajtim të pabarabartë të kandidatëve në konkursin publik, i datës 24 nëntor 2016, i shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për zgjedhjen e personelit akademik për mësimdhënës në Fakultetin Filozofik

Më 2 nëntor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A. nr. 186/2017, që ka të bëjë me pretendimet e ankuesit për trajtim të pabarabartë të kandidatëve në konkursin publik të datës 24 nëntor 2016, i shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për zgjedhjen e personelit akademik për mësimdhënës në Fakultetin Filozofik. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Rektoratit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (UP) dhe të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), përkatësisht Inspektoratit të Arsimit në këtë Ministri, lidhur me shkeljet dhe veprimet diskriminuese të pretenduara nga ankuesi në konkursin publik të shpallur nga UP-ja, më 24 nëntor 2016, për zgjedhjen e personelit akademik. Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 15, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 16 mars 2017, ka pranuar ankesën e z. Arben Hajrullahu (ankuesi) kundër Fakultetit Filozofik dhe Rektoratit të UP-së lidhur me çështje të punësimit.

Sipas pohimeve të ankuesit, më 24 nëntor 2016, UP-ja ka shpallur konkurs publik për zgjedhjen e personelit akademik. Në këtë konkurs kishte aplikuar për rizgjedhje edhe ankuesi, përkatësisht për avancim në pozitën në të cilën ishte zgjedhur nga Senati i UP-së, së pari si Profesor asistent, në vitin 2006, dhe më pas në pozitën Profesor i asocuar, në vitin 2011. Sipas tij, në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit Filozofik, më 9 shkurt 2017, është diskutuar edhe çështja e aplikimit të ankuesit. Kryetari i Komisionit Vlerësues dhe një anëtar i këtij komisioni e kanë nënshkruar “Raportin e Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik”, duke propozuar zgjedhjen e tij në thirrjen e Profesorit të rregullt, ndërsa anëtar i caktuar nga dekani i Fakultetit Filozofik ka përfaqësuar mendim të ndarë. Ankuesi pohon se, bazuar në procesverbalin e kësaj mbledhjeje, dekani i këtij Fakulteti kishte pohuar se në dosjen e aplikimit të ankuesit në këtë konkurs

mungon diploma e studimeve themelore (BA) dhe njohja – barasvlera e diplomës Master (MA) nga MASHT-i. Më pas, Këshilli i Fakultetit Filozofik votoi pro përsëritjes së konkursit, pasi që asnjëri nga kandidatët nuk e ka dosjen e aplikimit të kompletuar, siç kërkohet me konkurs. Rekomandimi i këtij Këshilli ishte që pozita në fjalë të rishpallet. Ky propozim u miratua me vetëm një votë kundër dhe tri abstenime.

Sipas ankuesit, në procesverbalin e sipërpërmendur, pozitat e tjera në konkurs si mësimdhënës, përfshirë edhe pozitën numër 5 dhe pozitën numër 6, për kandidatët Z. H. dhe H. I., propozohen nga Këshilli për Profesor të rregullt, respektivisht për Profesor të asocuar. Përkritazi me këtë çështje, ankuesi pohon se i është bërë diskriminim nga Këshilli në fjalë, sepse, në rastin e tij u kërkua rishpallja e konkursit, kurse në konkursin e njëjtë për dy kandidatët tjerë (Z. H. dhe H. I.) nuk rekomandohet rishpallja e konkursit, edhe pse, që të dy, me rastin e aplikimit, sipas ankuesit, nuk kishin thirrje MA të nostrifikuara nga MASHT-i.

Nisur nga pohimet e ankuesit dhe dokumentacioni i dorëzuar në IAP, Avokati i Popullit i vlerëson si shqetësuese pohimet e njërit nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, A. H., i cili, sipas procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Filozofik, i datës 30 mars 2017, kishte pohuar se ai ishte anëtar i Komisionit Vlerësues edhe tek kandidati tjetër Z. H. dhe se ky kandidat kishte sjellë nostrifikimin e diplomës pas mbylljes së konkursit. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se një situatë e tillë përbën trajtim të pabarabartë. Prandaj, në përputhje me nenin 20, paragrafi 2 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Rektorati i UP-së dhe Fakulteti Filozofik ***duhet të dëshmojnë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.***

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen që Fakulteti Filozofik do të duhej t'i përgjigjej ankuesit dhe t'ia ofronte procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Filozofik, e mbajtur më 9 shkurt 2017, në përputhje me Ligjin për Qasje në Dokumente publike. Avokati i Popullit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura i rekomandon Rektoratit të UP-së dhe Këshillit të Fakultetit Filozofik që të ndërmarrin veprime të menjëhershme bazuar në kompetencat ligjore për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit për diskriminim, si dhe në përputhje me nenin 20, paragrafi 2 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të ofrojnë prova të mjaftueshme për të dëshmuar se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë në konkursin publik të datës 24 nëntor 2016, të shpallur nga Universiteti i Prishtinës, për zgjedhjen e personelit akademik. Ndërsa, Inspektoratit të Arsimit në MASHT i rekomandoi që të ndërmarrë veprime të menjëhershme, bazuar në kompetencat ligjore, për t'iu përgjigjur ankuesit në ankesën e tij me nr. prot. 213, të parashtruar më 13 prill 2017, me pretendime se Këshilli i Fakultetit Filozofik ndaj tij ka kryer veprime diskriminuese.

Raport për rastin A.nr. 432/2018 lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike

Më 20 nëntor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 432/2018, që ka të bëjë me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.

Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Komunës së Ferizajt për qasje në dokumente publike, analizimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), si dhe detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike.

Nga dëshmitë dhe informatat të cilat i ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), të ofruara nga ankuesja dhe të evidentuara nga hetimi i bërë lidhur me rastin, vërehet se, më 4 qershor 2018, drejtoresha ekzekutive e OJQ “Iniciativa për Progres - INPO”, i është drejtuar me kërkesë zyrës së kryetarit të Komunës së Ferizajt, që t’i ofrojë qasje lidhur me listën e lejeve të ndërtimit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017, si dhe 1 janar - 31 maj 2018.

Meqë lidhur me kërkesën e parashtruar nuk mori përgjigje, më 26 qershor 2018, ankuesja i është drejtuar me parashtrësë Avokatit të Popullit, duke kërkuar që në kuadër të përgjegjësisë ligjore, ta mbrojë të drejtën për qasje në dokumente publike të kësaj OJQ-je, për shkak se, edhe pse kishte kaluar gati 1 muaj, ajo nuk kishte marrë kurrfarë përgjigje lidhur me të.

Më 26 korrik 2018, Avokati i Popullit i dërgoi letër drejtorit të Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mjedis (DUM) të Komunës së Ferizajt, përmes së cilës kërkoi të informohet për arsyen e kufizimit të qasjes në dokumente publike për OJQ “Iniciativa për Progres – INPO”, ndërsa më 9 gusht 2018, pranoi përgjigje nga drejtori i DUM-it në Komunën e Ferizajt sipas së cilës “..... informatat të cilat janë kërkuar janë transparente dhe publike në web faqen zyrtare të Komunës së Ferizajt”.

Më 31 gusht 2018, ankuesja e njoftoi përfaqësuesin e Avokatit të Popullit se Komuna e Ferizajt nuk është përgjigjur fare në kërkesën e datës 4 qershor 2018. Për më tepër, Komuna e Ferizajt, më 3 gusht 2018, në ueb-faqen e saj ka publikuar vetëm raportin e lejeve të ndërtimit për periudhën janar - korrik 2018. Pra plot tre muaj pas parashtrimit të kërkesës së INPO-s, si dhe nuk është publikuar lista e lejeve të ndërtimit për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2017, të cilën e ka kërkuar INPO-ja.

Avokati i Popullit vëren se, lidhur me kërkesën e parashtruar të palës, Komuna nuk ka nxjerrë vendim sipas kërkesave të ligjit. LQDP-ja në nenin 7, paragrafi 8 parasheh shprehimisht: *“Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes së plotë, apo të pjesërishme. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se “vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për personat juridikë dhe fizikë”, si dhe duke u bazuar në faktet e ofruara, konstaton se mospërgjigjja e Komunës së Ferizajt përkitazi me kërkesën e OJQ “Iniciativa për Progres – INPO”, bie në kundërshtim të plotë me dispozitat e LQDP-së nr. 03/L-215. Po ashtu konsideron se përgjigjja e drejtorit të DUM-it të Komunës së Ferizajt, e datës 9 gusht 2018, se: “.... informatat e kërkuara janë transparente në web-faqen e komunës”, nuk përkon me kërkesën e ankueses për të pasur qasje në listën e lejeve të ndërtimit për periudhën prej 1 janar 2017 - 31 dhjetor 2017.*

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e GjEDNj-së, që sipas nenit 53 të Kushtetutës paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut të garantuara me Kushtetutë. GjEDNj-ja thekson se vonesat në dhënien e informatës mund t'i heqin në mënyrë të vazhdueshme të gjithë vlerën e informatës dhe interesimin lidhur me të, sepse një lajm përbën një shërbim që ikën shpejt dhe vonimi i botimit të tij, edhe për një periudhë të shkurtër kohore, mund t'ia mohojë këtij lajmi tërë vlerën dhe interesin (shih rasti *The SundayTimes v. The United Kingdom*³⁸⁹).

Prandaj, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Ferizajt që ta shqyrtojë kërkesën e znj. Albulena Nrecaj nga OJQ “Iniciativa për Progres - INPO”, e datës 4 qershor 2018, për qasje në dokumente publike dhe të përgjigjet në përputhje me ligjin; si dhe të ndërmarrë hapa për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë lidhur me zbatimin Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Raport për rastin A.nr. 445/2018 lidhur me regjistrimin me numër të ri të lëndëve të cilat kthehen në rigjykim nga gjykata më e lartë

Më 29 nëntor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin me rekomandime për rastin A.nr. 445/2018, që ka të bëjë me regjistrimin me numër të ri të lëndëve, të cilat kthehen në rigjykim nga gjykata më e lartë. Raporti ka për qëllim ta njoftojë Këshillin Gjyqësor të Kosovës me shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut në rastet e regjistrimit me numër të ri të lëndëve, të cilat kthehen në rigjykim dhe t'u dërgohen institucioneve kompetente rekomandime specifike dhe konkrete që nëpërmjet legjislacionit të specifikojë afate për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore.

Avokatit i Popullit vëren se në gjykatat të cilat gjykojnë çështjet në shkallë të parë, ekziston një praktikë në bazë të së cilës lëndët të cilat kthehen në rigjykim dhe rivendosje regjistrohesh me numër të ri. Një praktikë e tillë bartet edhe në gjykatat e instancave më të larta, duke mos marrë parasysh faktin se rasti gjyqësor mund të jetë shumë më i vjetër nga data e paraqitjes së tij në gjykatë, si në rastet e përcjelljes së rastit në gjykatën e shkallës së dytë, ashtu edhe në situatat kur rasti kthehet në rigjykim.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 31, si dhe KEDNj-ja, neni 6, përcaktojnë të Drejtën për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm, ku një ndër komponentët e kësaj të drejte është e drejta për një proces gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm kohor. Ngjashëm sikur legjislacioni vendor, as KEDNj-ja nuk përcakton se cili është afati i arsyeshëm kohor, brenda të cilit duhet të përfundojë një rast gjyqësor. Mirëpo, ekziston praktika e etabluar e GjEDNj-së, përmes të cilës janë interpretuar çështjet rreth garancive kohore, brenda të cilave duhet të zgjidhet një çështje që është në shqyrtim gjyqësor.

³⁸⁹ *Case Of The Sunday Times V. The United Kingdom*, (Application no. 6538/74 , 26 April 1979)

Lidhur me këtë: “Duke kërkuar respektimin e “afatit të arsyeshëm”, KEDNJ nënvizon rëndësinë se drejtësia nuk duhet dhënë me vonesa që cenojnë efikasitetin dhe besueshmërinë (*H. kundër Francës*, § 58 ; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, § 61). Neni 6 § 1 i detyron Shtetet kontraktuese të organizojnë gjykatat në mënyrë që t’i përgjigjen kërkesave të kësaj dispozite.” GjEDNJ-ja tutje ka vendosur një standard, sipas të cilit: “*Kur flasim për pikënisjen e afatit, bëhet fjalë në parim për datën e paraqitjes së çështjes në gjykatën kompetente (Poiss kundër Austrisë, § 50 ; Bock kundër Gjermanisë § 35), me përjashtim kur paraqitja para një autoriteti administrativ përbën një kusht paraprak për paraqitjen në gjykatë, rast në të cilin afati mund të përfshijë edhe kohëzgjatjen e procedurës administrative paraprake të detyrueshme (König kundër Gjermanisë § 98 ; X kundër Francës, § 31 ; Kress kundër Francës [GC], § 90)”.*

Sa i përket termit “afat”, ky në parim mbulon të gjithë procesin, duke përfshirë këtu organet administrative (*König kundër Gjermanisë, § 98*). Ai shtrihet deri në vendimin që e ka zgjidhur përfundimisht çështjen (*Poiss kundër Austrisë, § 50*). Kështu, kërkesa për respektimin e afatit të arsyeshëm shtrihet në të gjitha fazat e procedurës gjyqësore që synon zgjidhjen e çështjes, pa përjashtuar fazat që pasojnë vendimet meritore (*Robins kundër Mbretërisë së Bashkuar §28*).

GjEDNJ-ja, gjithashtu thekson: “Është detyrë e shteteve kontraktuese të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në mënyrë që gjykatat të mund t’i garantojnë gjithkujt të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar për çështjet që lidhen me të drejtat dhe detyrimet të natyrës civile në një afat të arsyeshëm (*ibidem; Scordino kundër Italisë, [GC], § 183*).” Në fakt, përderisa shtetet anëtare duhet të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor në mënyrë të tillë që të garantojë të drejtën për një vendim gjyqësor në një afat të arsyeshëm, mbingarkesa e punës nuk mund të merret parasysh (*Vocaturò kundër Italisë, § 17; Cappello kundër Italisë, § 17*). Kështu, fakti që situatat e mbingarkesës janë bërë të zakonshme, nuk mund të justifikojë tej zgjatjen e një procesi (*Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, § 40*).”

Së pari, duhet theksuar se regjistrimi me numër të ri rendor nuk parashihet me ligjet në fuqi. Është e arsyeshme që ligjdhënësi nuk ka parashikuar diçka të tillë, sepse, në të kundërtën do të krijoheshin ex-lege një bazë për zhvendosje të lëndës nga renditja fillestare, në rend me padi të iniciuara shumë më vonë. Dhe së dyti, regjistrimi me numër të ri rendor nuk mund të krahasohet me asnjërin nga kriteret objektive të përlllogaritjes së vonesave procedura, sepse vetë regjistrimi me numër të ri krijon përshtypjen se lënda është iniciuar shumë më vonë, ndërsa vlerësimi i shkresave të lëndës e shfaq pastaj datën reale të inicimit të rastit.

Sipas praktikës së GjEDNJ-së, afati fillon të rrjedhë në momentin e inicimit të padisë në gjykatën kompetente, ndërsa për raste administrative edhe më herët. Është fakt notor se procedurat gjyqësore, që në shkallë të parë fillojnë të trajtohen disa vjet pasi padia është dorëzuar në gjykatë. Është e vërtetë që gjyqësori është i ngarkuar me lëndë, por sipas GjEDNJ-së, ky nuk përbën justifikim. Është detyrë e shtetit që të organizojë një sistem

gjqësor, i cili i trajton me efikasitet lëndët. Gjithashtu, inicimi i procedurave me qëllim reformimi të sistemit gjyqësor, reformim i cili do të përshejtonte trajtimin e lëndëve, po ashtu nuk përbën justifikim.

Avokati i Popullit konstaton se regjistrimi i lëndëve sipas vitit të paraqitjes së padisë dhe mosndryshimi i tyre kur lënda kalon nga njëra shkallë në tjetrën është në interes të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, brenda një afati të arsyeshëm kohor dhe për këtë qëllim i rekomandoi Këshillit Gjyqësor të Kosovës që ta adresojë këtë çështje në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në mënyrë që Kuvendi, nëpërmjet legjislacionit, të specifikojë afate për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore, duke specifikuar afatin maksimal që tolerohet nga inicimi i padisë e deri te vendimi i shkallës së parë, por edhe afatet e shqyrtimit në instancat tjera; deri në nxjerrjen e një akti nga Kuvendi i Kosovës, KGjK-ja ta nxjerrë një akt të brendshëm, i cili do t'i rregullonte afatet për kohëzgjatjen e një procedure gjyqësore, duke e specifikuar afatin maksimal që tolerohet nga inicimi i padisë e deri te vendimi i shkallës së parë, por edhe afatet e shqyrtimit në instancat e tjera; në aktin e brendshëm gjithashtu të përcaktohet se rastet që kthehen në rigjykim duhet të trajtohen me prioritet në krahasim me paditë e reja.

Raport për rastin A.nr. 493/2018 lidhur me të drejtën e të dënuarave në arsim universitar

Më 23 nëntor 2018, Avokati i Popullit publikoi Raportin për rastin A.nr. 493/2018, që ka të bëjë me të drejtën e të dënuarave në arsim universitar. Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës për respektimin e të drejtave të personave të dënuar për arsimim dhe edukim, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, si dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Rasti është iniciuar në Institucionin e Avokatit të Popullit bazuar në ankesën e z. E. B. kundër Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK), i cili ankohet në emër të të birit të tij V. B., që është duke vuajtur dënimin me burgim në Qendrën Korrektuese në Lipjan (në tekstin e mëtejme *QKL*), për shkak të pamundësisë për t'i vazhduar studimet universitare.

Me rastin e hetimit të ankesës, Avokati i Popullit është njoftuar përmes postës zyrtare elektronike nga Drejtoria e QKL-së se: *“I mituri V.B. gjendet në QK. Lipjan që nga data 07/12/2016, ku edhe e ka mbaruar arsimin e mesëm të lartë. Sa i përket arsimin universitar sipas nenit 83 dhe 84 të LESP, MASHT dhe MD kanë nxjerr udhëzimin administrativ për arsimin e mesëm por jo edhe për arsimin Universitar.”*

Më 19 korrik 2018, Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejme *MKPT*) e vizitoi QKL-në dhe ankesën në fjalë e diskutoi me Drejtorinë e këtij institucioni. Për më shumë, MKPT-ja e analizoi dosjen administrative të të dënuarit në fjalë. MKPT-ja u njoftua nga Drejtoria e QKL-së se Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë (në tekstin e mëtejme *MASHT*), ende nuk e ka miratuar ndonjë udhëzim administrativ me të cilin do të precizohej çështja e arsimimit universitar për të dënuarit.

Avokati i Popullit rikujton se arsimimi i të miturve dhe madhorëve, të cilët janë të dënuar dhe qëndrojnë në institucionet korrektuese, është një nga detyrimet e institucioneve kompetente të Republikës së Kosovës që buron nga Kushtetuta, nga ligjet në fuqi dhe instrumentet ligjore ndërkombëtare. Si i tillë, ky detyrim i institucioneve për të realizuar një nga të drejtat themelore të njeriut, siç është ofrimi i mundësisë për arsimim për të rinjtë, nuk mund të shmanget as për të miturit që qëndrojnë në qendrat korrektuese, si në rastin konkret QKL-ja. Për më tepër, Avokati i Popullit tërheq vërejtjen se kjo e drejtë për të dënuarit duhet të mundësohet në kuadër të QKL-së, ose edhe jashtë institucionit, përkatësisht në shkollat e rregullta publike.

Aktet ndërkombëtare në nivel të OKB-së dhe ato në nivel evropian, që rregullojnë të drejtat për personat e dënuar, krijimin e mundësisë për arsimim e përcaktojnë si obligim i shtetit dhe, në mënyrë të veçantë për të rinjtë që janë të privuar nga liria. E drejta e të gjithë njerëzve për arsimim është mishëruar në nenin 26, paragrafi 1 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut³⁹⁰: “Gjithkush gëzon të drejtën e shkollimit...”. Kurse në paragrafin 2 të kësaj deklarate përcaktohet se: “Arsimi duhet të drejtohet nga zhvillimi i plotë i personalitetit të njeriut dhe nga forcimi i respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Ai duhet të nxisë kuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjithë popujve, grupeve të racave dhe besimeve, si dhe veprimtarinë e Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes”.

Në këtë drejtim, “Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria”, të miratuara në vitin 1990 (Rregullat),³⁹¹ përcaktojnë: “Çdo i mitur i moshës së detyrueshme për shkollim ka të drejtë për arsim të përshtatshëm për nevojat dhe aftësitë dhe të përcaktuara për përgatitjen e tij apo të saj për kthim në shoqëri. Kurdo që është e mundur, arsimi i tillë duhet të sigurohet jashtë objekteve të privimit nga liria, në shkollat e bashkësisë dhe, në çdo rast, me arsimtarë të kualifikuar përmes programeve të integruara në sistemin arsimor të vendit ashtu që pas lirim, të miturit të mundën që pa pengesë të vazhdojnë arsimin e tyre...”(neni 38).

Në të njëjtën frymë janë edhe “Rregullat Evropiane të Burgut”, që janë miratuar nga Komiteti i Ministrave të KE-së, në vitin 2006 (RrEB), të cilat i kushtojnë një vëmendje të posaçme së drejtës në arsimim, duke përcaktuar: “Çdo burg duhet t’u japë të gjithë të burgosurve të drejtën për të marrë pjesë në programe edukative, të cilat janë të kuptueshme dhe plotësojnë nevojat individuale duke marrë parasysh aspiratat e tyre.” (28.1); si dhe përcaktimi se: “Pjesë kyçe e regjimeve të të burgosurve të dënuar është një program sistematik arsimi, duke përfshirë dhe aftësitë trajnuese, me objektivin e përmirësimit të nivelit të përgjithshëm të arsimimit si dhe qëllimin e të pasurit të një jete të përgjegjshme dhe pa krime.”

³⁹⁰Deklarata e Përgjithshme për të Drejtat e Njeriut në : https://www.ohchr.org/EN/UDHR/Documents/UDHR_Translations/aln.pdf, (15.8.2018)

³⁹¹ Shih <http://www.un.org/documents/ga/res/45/a45r113.htm>.

GjEDNj-ja ka konstatuar se të burgosurit e ndaluar ligjërisht vazhdojnë t'i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Konventa, me përjashtim të së drejtës për liri. Kështu ata kanë të drejtën e arsimimit të garantuar me nenin 2 të Protokollit nr. 1. Refuzimi për të regjistruar një të burgosur në një shkollë të burgjeve përbën shkelje të kësaj dispozite (*Velyo Veleve kundër Bullgarisë, 27 maj 2014*). Sigurisht, e drejta për arsimim nuk nënkupton detyrimin e shtetit që të organizohen orë mësimi *ad-hoc* vetëm për shkak të kërkesave individuale, dhe pamundësia e plotësimit të këtyre kërkesave nuk përbën shkelje të nenit 2 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së (*Epistatu kundër Rumanisë, 24 shtator 2013*).

Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën e të dënuarit për arsimim universitar obligon që të dënuarit t'i mundësohet realizimi i kësaj të drejte. Në këtë rast, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Ministrisë së Drejtësisë që ta nxjerrin aktin nënligjor në pajtim me Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, i cili do të precizonte mënyrën e realizimit të së drejtës për arsimim universitar për personat e mitur dhe madhorë që janë në vuajtje të dënimit.

Raportet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm *MKPT*) i Avokatit të Popullit, më 31 tetor 2017, ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Prizren (në tekstin e mëtejshëm *QPP*). Grupi monitorues përbëhej nga dy juristë, një mjeke dhe një psikologe.

Ndërtesa e QPP-së është ndërtuar në vitin 1964, fillimisht ka funksionuar nën administrimin e UNMIK-ut deri në shkurt të vitit 2005, ku kompetencat e plota të menaxhimit i ka marrë stafi vendor. QPP-ja është e dedikuar për të paraburgosurit e regjioneve të afërta me Prizrenin, si dhe pranon personat për vuajtje të dënimit të shqiptuar nga gjykata themelore deri në tre muaj. Ky institucion ka kapacitetin për 92 të burgosur, ka gjithsej katër krahë, në tre krahë janë të vendosur të paraburgosurit dhe në një krah janë të vendosur të dënuarit me dënime të shkurtra.³⁹²

Të burgosurit janë të vendosur në krahët A, B, C, D. Kapaciteti i përgjithshëm është për 92 persona. Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi këtë qendër ishin të vendosur 100 të burgosur, prej tyre 22 të dënuar. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës e ka vizituar QPP-në në vitin 2010.³⁹³

³⁹² Të dhëna nga ueb-faqja e Shërbimit Korrektues të Kosovës, në: <http://shkk.rks-gov.net> (31.10.2017)

³⁹³ Shih: <https://rm.coe.int/16806972c7> (14.11.2017)

Gjatë vizitës në QPP, ekipi monitorues u njoftua se planifikohet ndërtimi i një qendre të re të paraburgimit në Prizren, por procedurat kanë stagnuar dhe ende nuk është shënuar progres në këtë drejtim. Personeli i Shërbimit Korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e QPP-së. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

MKPT-ja gjatë vizitave në QPP ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve dhe të dënuarve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues.

Kapaciteti zyrtar i QPP-së është për 92 persona. Gjatë vizitës në qelitë e QPP-së, MKPT-ja ka vërejtur se aktualisht numri i të burgosurve kishte arritur në 100 persona. MKPT-ja ka vizituar një numër të qelive dhe ka verifikuar nëse hapësira e akomodimit nuk është në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës.³⁹⁴ Bazuar në këtë standard, hapësira për të paraburgosurit apo për të dënuarit në qeli duhet të jetë së paku 4m² për person në një hapësirë ku akomodohen më shumë se një person, pa përfshirë aneksin e tualeteve.

Po ashtu, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale parasheh që secili i burgosur duhet të ketë 4m² hapësirë në qeli të përbashkët.³⁹⁵ Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në disa qeli, për shkak të mungesës së hapësirës, disa të paraburgosur dhe të dënuar flinin në dysheme në dyshek të vjetruar dhe pa mbulesa adekuate. Prandaj, MKPT-ja konstaton:

- QPP-ja përballet me mbipopullim e cila duhet të evitohet sa më shpjet që të jetë e mundur dhe nuk mund të ofrojë hapësirë akomodimi në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Gjatë vizitës në disa qeli, MKPT-ja ka vërejtur se të paraburgosurve u mungon hapësira për vendosjen e gjësendeve të domosdoshme personale. Përveç kësaj, në dy qeli ku akomodoheshin të paraburgosurit, tualetet nuk ishin të pajisura me dyer dhe në këtë mënyrë të paraburgosurve nuk u respektohej privatësia.³⁹⁶ Rregulli 15 i Rregullave të Mandelës, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, më 29 shtator 2015, përcakton: *“Instalimet sanitare duhet të jenë adekuate dhe të mundësojë që secili i burgosur të përmbush nevojat fiziologjike në mënyrë dinjitoze dhe të pastër.”*
- Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kishte lagështi (me përjashtim të qelisë

³⁹⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449> (14.11.2017)

³⁹⁵ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

³⁹⁶ Rregullat Evropiane të Burgjeve, neni 18.1.

- A3 ku vërehej pak lagështi), ndërsa dushet ishin në gjendje të mirë. Gjithashtu sallat ku ushqehen të burgosurit, ishin të pastra, kishte dritë natyrale dhe ventilim. MKPT-ja ka konstatuar se qelitë në përgjithësi kanë nevojë të gëlqerosen (lyhen).
- Sa i përket furnizimit, MKPT-ja u njoftua se kishte mungesa të letrave higjienike, mungesa të çarçafëve, batanijeve, ku sipas Drejtorisë, ka kohë të gjatë që nuk janë furnizuar. Zakonisht të burgosurve u lejohet që çarçafët t'i sjellin nga familjarët. Gjatë bisedës me të burgosurit, MKPT-ja ka pranuar ankesa për mungesë të mjeteve higjienike, ndërsa sa i përket ujit, ky problem ishte evituar. Autoritetet duhet t'u sigurojnë të paraburgosurve produkte higjienike që ua mundësojnë atyre pastrimin e qelive dhe të mbajnë higjienën në mënyrë adekuate.³⁹⁷
 - MKPT u njoftua se të paraburgosurit mund të bëjnë dushe dy herë në javë, gjë që është në pajtim me Rregullat Evropiane të Burgjeve.³⁹⁸ MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit sa i përket kësaj të drejte.

Në bazë të të gjeturat dhe konstatimet e arritura gjatë vizitës, i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që ta njoftojë Avokatin e Popullit: lidhur me planifikimet për ndërtimin e Qendrës së re të Paraburgimit në Prizren; të krijohen kushte adekuate të punës për personelin mjekësor; numri i të paraburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP-së dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejt që të jetë e mundur; të ndërmerren masat e duhura në mënyrë që të paraburgosurve t'u respektohet privatësia (shih paragrafin 9 të këtij raporti); të gëlqerosen qelitë sipas nevojës (shih paragrafin 10); të përmirësohen kushtet e punës për zyrtarët korrektues.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 2 dhe 30 nëntor 2017, ka vizituar Shtëpinë për Personat e Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (ShPMPF). Grupi monitorues përbëhej nga një jurist, një mjekë dhe një psikologe. Gjatë vizitës së MKPT-së në ShPMPF, personeli i institucionit i ofroi ekipit monitorues bashkëpunim të plotë, qasje në dokumentacionin relevant, si dhe ia mundësoi bisedat me rezidentët pa prezencë të zyrtarëve të institucionit.

ShPMPF-ja është institucion me karakter social dhe vepron në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Kapaciteti zyrtar i këtij institucioni është për 110 persona. Numri i rezidentëve në momentin e vizitës ishte 63, prej tyre 27 meshkuj dhe 36 femra. Nga ky numër, 3 persona janë nën moshën 65 vjet. Me Rregulloren nr. 09/2008

³⁹⁷ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 38.2 përcakton: “Me qëllim të sigurimit të higjienës së personave të dënuar dhe higjienës së lokaleve, personave të dënuar iu sigurohet sasi e mjaftueshme e ujit të ftohtë dhe të nxehtë si dhe artikuj adekuat për pastrim dhe tualet. Pajisjet dhe mjetet për higjienë personale sigurojnë privatësinë e mjaftueshme dhe ata mirëmbahen dhe pastrohen me rregull”.

³⁹⁸ Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 19.4.

mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare (në tekstin e mëtejshëm *Rregullorja*) rregullohet çështja e kriterëve të pranimit të rezidentëve, organizimi i jetës dhe punës me rezidentët, rregullat shtëpiake dhe aktivitetet. Po ashtu, kriteret e vendosjes në këtë institucion më hollësisht rregullohen me Udhëzimit Administrativ nr. 07/2011 për Punën dhe Kriteret e Vendosjes së Rezidentëve në Shtëpinë e Personave të Moshuar pa Përkujdesje Familjare dhe në Shtëpitë me Bazë në Komunitet.

Legjislacioni i Republikës së Kosovës nuk përcakton vendosje të pavullnetshme në institucionet e kujdesit social. Të gjithë rezidentët e vendosur në këtë institucion janë të vendosur bazuar në kontratën e nënshkruar me institucionin në fjalë. Prandaj, konsiderohet se të gjithë rezidentët janë vendosur këtu mbi bazën e vullnetit të tyre.

Në ShPMPF vendosen kategoritë e rezidentëve si në vijim: personat e varur të cilët nuk mund t'i përmbushin nevojat e tyre ditore në mënyrë të pavarur, por duhet të asistohen gjithmonë nga të tjerët. Po ashtu, ata pranojnë kujdes të veçantë mjekësor; kategoria e rezidentëve gjysmë të varur janë rezidentët gjendja shëndetësore e të cilëve ka shënuar rënie dhe pranojnë kujdes të veçantë; kategoria tjetër janë rezidentët të cilët janë të pavarur dhe të cilët, edhe pse janë të moshuar, i plotësojnë nevojat e tyre ditore pa ndihmën e të tjerëve.³⁹⁹ Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se 13 rezidentë janë të varur dhe 5 gjysmë të varur, ndërsa 4 rezidentë vuajnë nga demenca.

Neni 7 i Udhëzimit Administrativ 07/2011 përcakton kriteret themelore për vendosjen e rezidentit në ShPMPF. Sipas këtij neni, duhet të plotësohen kriteret në vazhdim: personi të jetë banor i përhershëm i Republikës së Kosovës, të jetë në moshën mbi 65 vjeç, të mos ketë pasardhës-fëmijë biologjik apo të birësuar, të jetë në gjendje të mirë psikike dhe të mos ketë sëmundje infektive. Megjithatë, gjatë vizitës dhe kontrollit të dokumenteve relevante, MKPT-ja ka vërejtur se në këtë institucion janë të akomoduar edhe persona me diagnoza të ndryshme psikiatrike, personat me aftësi të kufizuara mendore apo ngecje në zhvillim mendor. Sipas njoftimit të punëtorit social, 7 prej rezidentëve u është marrë zotësia e veprimit dhe, kujdestarët ligjorë nga Qendrat për Punë Sociale të Komunave nga kanë ardhur rezidentët, nuk interesohen për rastet e tyre, me përjashtim të QPS-së së Gjilanit, e cila përmes zyrtarit të caktuar si kujdestar ligjor, u përgjigjet obligimeve ligjore.

MKPT-ja ka vërejtur se në këtë institucion janë të akomoduar edhe 3 persona të cilët janë nën moshën 65 vjeç. Akomodimi i tyre në këtë institucion është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ 07/2011 dhe Rregulloren mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka intervistuar një numër të rezidentëve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo abuzime verbale, si dhe sjellje të cilat do të shkelnin

³⁹⁹ Neni 10 i Rregullores nr. 09/2008 mbi Organizimin e Brendshëm të Punës për Shtëpinë e Personave të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare.

dinjitetin njerëzor të rezidentëve në ShPMPF. MKPT-ja çmon lart angazhimin e personelit në kujdesin ndaj të moshuarve, sidomos ndaj të moshuarve të palëvizshëm. MKPT-ja fitoi përshtypjen se marrëdhëniet e personelit me rezidentët janë të mira dhe miqësore.

MKPT-ja ka vërejtur se hapësirat e jashtme të institucionit janë të mbuluara me kamera të sigurisë, të cilat mbulojnë hapësirat e jashtme të ShPMPF-së.

Ndërtesa e institucionit daton që nga viti 1960. MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se oborri dhe trotualet e institucionit ishin rregulluar dhe qasja për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara ishte dukshëm më e lehtë. Po ashtu, ata kanë qasje ditore në kopshtin e institucionit, i cili posedon gjelbërim të mjaftueshëm. Sipas Drejtorisë, ashensori është funksional por është shumë i vjetër dhe shpesh pëson defekte. Nuk ka probleme me furnizim me ujë, edhe pse bojlerët janë të vjetër dhe të dëmtuar. Shqetësim kryesor për Drejtorinë janë bojlerët e vjetruar dhe lavatriçet ekzistuese, të cilat janë të vogla dhe nuk mjaftojnë për t'i pastruar rrobat e rezidentëve, çarçafët dhe gjërat tjera, gjë që e vështirëson punën e ndihmësve mjekësorë. MKPT-ja ka vërejtur se ndërtesa ka nevojë për investime serioze, sidomos në pjesën ku është i vendosur shërbimi mjekësor, ku depërtimi i ujit shpesh shkakton dëmtime serioze të inventarit.

Gjatë vizitës, Drejtoria ia prezantoi MKPT-së kërkesat të cilat i ka adresuar në MPMS lidhur me nevojat për investime për të cilat pretendon se nuk ka marrë përgjigje.

Dhomat ku vendosen rezidentët kanë ndriçim të mjaftueshëm, në përgjithësi nuk kanë lagështi, por inventari është tepër i vjetërsuar dhe i dëmtuar. Rezidentët janë të vendosur në dhoma nga 3, 2 dhe 1 person. Sipas Drejtorisë, ngrohja qendrore aktivizohet në periudha të caktuara dhe jo 24 orë, në mungesë të karburantit për ngrohje. Disa rezidentë u ankuan se gjatë natës është ftohtë, disa e njoftuan ekipin monitorues se përdorin ngrohëse elektrike gjatë mungesës së ngrohjes qendrore.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, i është rekomanduar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që urgjentisht të bëhen investime sipas vlerësimit të nevojave, në ndërtesën e vjetër dhe hapësirat ku funksionon shërbimi mjekësor dhe shërbimi i stomatologjisë; rezidentët të furnizohen me inventar adekuat në dhomat e tyre; të furnizohet institucioni me një autoambulancë; shërbimi mjekësor të aplikojë protokolle për vetëlëndime, lëndime trupore, grevë urie, abuzime seksuale, vetëvrasje, si dhe vdekjeve në institucion; të organizohen trajnime specifike për personelin në pajtim me nevojat për trajtim të rezidentëve; të rritet numri i personelit sipas vlerësimit të nevojave nga shërbimi shëndetësor.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës për vizitat në stacionet policore

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit ka vizituar stacionet policore si në

vijim: Qendrën Rajonale të Mbajtjes në Prishtinë, Stacioni Qendër, 30 tetor 2017; Stacionin Policor në Lipjan, 9 tetor 2017; Stacionin Policor në Podujevë, 18 tetor 2017; Stacionin Policor në Mitrovicë, 19 tetor 2017; Stacionin Policor në Vushtrri, 19 tetor 2017; Stacionin Policor në Prizren, 27 tetor 2017; Stacionin Policor në Suharekë, 27 tetor 2017; Stacionin Policor në Dragash, 27 tetor 2017. Grupi monitorues përbëhej nga një jurist, një psikologe dhe një mjeke.

Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi i personave të arrestuar pa prezencë të zyrtarëve policorë.

Sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, personat e dyshuar për kryerje të veprës penale mund të mbahen nga policia deri në 48 orë para se të dërgohen para gjyqtarit të procedurës paraprake. Policia mund të mbajë dhe të mbledhë informata nga personat të cilët gjenden në vendin ku është kryer vepra penale, të cilët mund të sigurojnë informata relevante (periudha maksimale kohore është gjashtë orë)⁴⁰⁰.

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), në raportin e 2-të të përgjithshëm të publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia: për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin e tij (anëtarin e familjes, mikun, konsullatën); e drejta për të pasur një avokat; e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).⁴⁰¹

Këto të drejta duhet të zbatohen jo vetëm në rastin e personave të ndaluar, por edhe në rastet tjera kur qytetarët detyrohen të qëndrojnë në polici apo me policinë edhe për arsye tjera (për shembull, për qëllime identifikimi). Sipas KPT-së, këto të drejta janë garanci themelore kundër keqtrajtimit fizik dhe duhet të zbatohen që nga momenti i parë i privimit nga liria, pa marrë parasysh se si përshkruhet në kuadër të sistemi ligjor. Po ashtu, këto të drejta themelore parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale dhe me Ligjin për Policinë.⁴⁰²

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për të njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër, për faktin se është arrestuar, dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.²⁴³ Sa i përket njoftimit për arrestin, neni 168 i Kodit të Procedurës Penale më tej përcakton se personi i arrestuar ka të drejtë ta njoftojë anëtarin e familjes

⁴⁰⁰ Nenet 162, 163, 164 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

⁴⁰¹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f> (15.11.2017).

⁴⁰² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, ²⁴³ Shih po ashtu nenet 29 dhe 30 të Kushtetutës.

apo personin tjetër sipas përzgjedhjes së tij për arrestin dhe vendin e ndalimit, menjëherë pas arrestimit; njoftimi i familjarit apo personit tjetër lidhur me arrestimin mund të vonohet më së shumti deri në 24 orë kur prokurori i shtetit çmon se kjo kushtëzohet me nevoja të jashtëzakonshme për hetim të rastit. Kjo vonesë nuk aplikohet në rastin e personave të mitur. Sipas Ligjit për Policinë⁴⁰³, e drejta për të njoftuar familjen apo personin tjetër për arrestimin gjithashtu vlen edhe për personat të cilët janë në ndalim të përkohshëm, me qëllim të identifikimit ose për shkak të mbrojtjes së tyre dhe mbrojtjes së të tjerëve.

Gjatë vizitave, MKPT-ja është njoftuar nga zyrtarët policorë se gjatë intervistimit të personave të arrestuar nuk praktikohet audio-video incizimi i intervistave. KPT konsideron:

*“Regjistrimi elektronik (audio dhe/ose video) i intervistave policore përbën një garanci të rëndësishëm shtesë kundër keqtrajtimit të të arrestuarve. KPT ka kënaqësinë të vërejtë se vënia në përdorim e sistemeve të tilla po shqyrtohet nga një numër i vendeve. Një sistem i tillë mund të sigurojë një proces të intervistimit të kompletuar dhe autentik dhe në këtë mënyrë lehtëson shumë hetimin e çdo pohimi për keqtrajtim. Kjo është në interes të dy palëve, respektivisht të personave të cilët janë keqtrajtuar nga policia dhe në interes të zyrtarëve policor të cilët përballën me pohime të pabazuara se janë përfshirë në keqtrajtim fizik dhe presion psikologjik. Po ashtu, regjistrimi elektronik e zvogëlon mundësinë e të pandehurve që më vonë rrejshëm të mohojnë se ata kanë bërë pohime të caktuara.”*⁴⁰⁴

Në raportin për vizitën në Irlandë në vitin 2006, KPT thekson:

“Të gjeturat gjatë vizitës në vitin 2006, sugjerojnë se audio-video incizimet në dhomat e intervistimit në stacionet e Garda, mund të kenë qenë faktor domethënës që ka kontribuar në zvogëlimin e pohimeve për keqtrajtim fizik të personave të arrestuar.”

MKPT-ja e Avokatit të Popullit inkurajon Policinë e Kosovës që ta shqyrtojë mundësinë e zbatimit të një sistemi të tillë të audio dhe video incizimeve në pajtim me konstatimet e KPT-së dhe për këtë ta njoftojë Avokatin e Popullit.

MKPT-ja ka vërejtur se në stacionet policore të vizituara, kamerat e sigurisë janë funksionale në hapësirat e stacioneve dhe në qelitë ku mbahen të arrestuarit, përveç në Stacionin Policor në Lipjan.

MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga personat e arrestuar të cilët gjendeshin në Qendrën Rajonale të Mbrojtjes në Prishtinë lidhur me këto të drejta. Po ashtu, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar vërehet se Policia e Kosovës, në të gjitha stacionet e vizituara, i ka respektuar këto të drejta. Gjatë vizitave, MKPT-ja ka vërejtur se në secilën qeli ndodheshin informata të shkruara në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze, lidhur me të

⁴⁰³ Ligji për Policinë, neni 20.

⁴⁰⁴ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, ekstrakt nga Raporti i 12-të i përgjithshëm, paragrafi 36. Për më shumë shih: <https://rm.coe.int/16806cd1ed> (24.11.2017).

drejtat e personave të arrestuar. Gjatë vizitave, MKPT-ja nuk ka hasur në të mitur të arrestuar.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës u është rekomanduar stacioneve policore që: të ndërmerren hapat e nevojshëm për të siguruar më shumë dritë natyrale në Qendrën Rajonale të Mbjajtjes në Prishtinë; të krijohen kushte më të mira për punë për zyrtarët policorë në Qendrën Rajonale të Mbjajtjes në Prishtinë; të bëhen rinovime dhe furnizime në Qendrën e Mbjajtjes në Prizren, siç është specifikuar në paragrafin 20 të këtij Raporti; në të gjitha qelitë e stacioneve policore, ku ka dhoma të mbajtjes, të instalohen sistemet e thirrjeve; të funksionalizohen kamerat e sigurisë në Stacionin Policor në Lipjan.

Raporti i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 31 tetor 2017, ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Gjilan (QPGj). Grupi monitorues përbëhej prej dy juristëve (njëra prej tyre zëvendëse e Avokatit të Popullit), një mjek dhe një psikologe.

Gjatë vizitës së MKPT-së në QPGj, personeli i Shërbimit Korrektues dhe personeli i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e dënuar dhe të paraburgosur, pa prezencë të zyrtarëve korrektues ose personelit tjetër.

Ndërtesa e QPGj-së është hapur për përdorim në vitin 2016. Kapaciteti zyrtar i QPGj-së është për 300 persona, por për shkak të kushteve teknike, mungesës së inventarit dhe personelit korrektues, kapaciteti momental operacional është për 80 persona. Në këtë qendër akomodohen të dënuarit dhe të paraburgosurit. Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se një pjesë e rrugës deri tek QPGj-ja, konkretisht rruga deri tek porta kryesore, është e paasfaltuar dhe në kushte të këqija atmosferike, e cila mund të paraqesë vështirësi serioze për zhvillim të aktiviteteve të përditshme të këtij institucioni.

Në kohën kur MKPT-ja e vizitoi këtë qendër, ishin të vendosur 49 të paraburgosur dhe 25 të dënuar. MKPT-ja ka vërejtur se të dënuarit dhe të paraburgosurit janë të ndarë me pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁴⁰⁵

MKPT-ja gjatë vizitës në QPGj ka intervistuar një numër të konsiderueshëm të të paraburgosurve dhe të dënuarve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues.

⁴⁰⁵ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33 paragrafi 7. Rregullat e Mandelës, Rregulli numër 11, pika b). Rregullat Evropiane të Burgjeve, Rregulli 18.8. Pakti për të Drejtat Civile dhe Politike, neni 10.2, pika b).

MKPT-ja ka vizituar një numër të qelive dhe ka verifikuar se hapësirat e akomodimit janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës.⁴⁰⁶ Bazuar në këto standarde, hapësira për të paraburgosurit apo të dënuarit në qeli duhet të jetë së paku 4m² për person në një hapësirë të përbashkët, pa përfshirë aneksin e tualeteve, dhe 6m² në qeli të vetme (qeli për vetëm një të burgosur).

Po ashtu, Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale parasheh që secili i burgosur duhet të ketë 4m² hapësirë në qeli të përbashkët.⁴⁰⁷

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se qelitë ku akomodoheshin të burgosurit kanë ndriçim të mjaftueshëm, nuk kanë lagështi, kanë ngrohje adekuate dhe pastërti. QPGj-ja nuk përballet fare me mbipopullim. QPGj-ja ka një hapësirë të madhe të pashfrytëzuar. MKPT-ja ka konsideruar se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin hapa konkret për të funksionalizuar këtë hapësirë. Përndryshe, për MKPT-në ishte shqetësues fakti vetëm se në QPGj nuk kishte asnjë aktivitet kulturor, sportiv apo program për rehabilitim dhe risocializim të të burgosurve.

Ndërsa sa i përket kuzhinës dhe sallës ku ushqeheshin të paraburgosurit, MKPT-ja ka vërejtur se në përgjithësi ishin në gjendje të mirë. Po ashtu dushet ishin në gjendje të mire dhe të burgosurit kishin të drejtë dy herë në javë të bënin dush, gjë që është në pajtim me Rregullat Evropiane të Burgjeve⁴⁰⁸.

MKPT-ja ka vizituar Shërbimin Shëndetësor në QPGj dhe ka vërejtur se hapësira ku ofrohen shërbimet mjekësore në përgjithësi janë të një standardi të mirë. Personeli në këtë qendër ishte në nivel të mjaftueshëm. Po ashtu, MKPT-ja gjatë vizitës nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të burgosurit lidhur me trajtimin shëndetësor në QPGj.

Mirëpo, MKPT-ja, lidhur me personat me aftësi të kufizuar në hapësirat e QPGj-së, ka vërejtur se në pjesën e QPGj-së ku ofrohen shërbimet mjekësore, tash për tash nuk funksionon ashensori.

MKPT-ja gjatë vizitës u njoftua se personeli i QPGj-së përbehet nga 16 veta personel civilë dhe 68 zyrtarë korrektues. Kushtet e punës së personelit të ShKK ishin në nivel të kënaqshëm. Mirëpo, MKPT-ja u informua se tash për tash Qendra ballafaqohet me mungesa të ndryshme në zyrë.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, i është rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë që: ta njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me planifikimet për shfrytëzimin e hapësirës së pabanuar në QPGj; të sigurohen aktivitete kulturore, sportive dhe programe për rehabilitim dhe risocializim të të burgosurve; të asfaltohet pjesa e rrugës së paasfaltuar, e cila mund të paraqesë vështirësi serioze gjatë stinës së dimrit dhe

⁴⁰⁶ Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih në: <https://rm.coe.int/16806cc449>

⁴⁰⁷ Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

⁴⁰⁸ Rregullat Evropiane për Burgjet, paragrafi 19.4.

në kushte të reshjeve atmosferike për kryerjen e punës së QPGJ në pajtim me LESP-në; të funksionalizohet ashensori në pjesën ku ofrohen shërbimet mjekësore.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 7 mars 2018, ka vizituar Qendrën e Mbajtjes për të Huajt (QHM) në Vranidoll. Grupi monitorues përbëhej nga një jurist, një mjek dhe një psikologe.

QHM-ja funksionin në kuadër të Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migrim (DShAM) e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Sipas nenit 2 të Rregullores (MPB) nr. 03/2014 për Funksionimin e Qendrës për Mbajtjen e të Huajve (në tekstin e mëtejme *Rregullorja*), në këtë Qendër vendosen të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë, si dhe të huajt për të cilët konsiderohet se e cenojnë sigurinë publike, me qëllim të vërtetimit të identitetit të tyre dhe për arsye tjera. Qendra ka filluar punën në vitin 2010. Kapaciteti i kësaj Qendre është për 76 persona.

Gjatë vizitës në QHM-së, personeli i Qendrës i përbëhet nga udhëheqës, dy zyrtare për pranim dhe regjistrim të të huajve dhe personeli i sigurimit, i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipit monitorues pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën.

Bazuar në dispozitat e Ligjit 04/L-219 për të Huajt i Republikës së Kosovës, i huaji i cili vendoset në Qendër njoftohet në formë të shkruar, në njërën nga gjuhët zyrtare dhe në gjuhën angleze, për ndalimin në Qendrën e Mbajtjes, i cili përmban arsyen e ndalimit, afatet e ndalimit, të drejtën të sigurojë mbrojtjen ligjore të tij, si dhe të kontaktojë me të afërmit e vet. Po ashtu të drejtën e të huajit për të njoftuar përfaqësuesin diplomatik apo konsullor lidhur me ndalimin e tij.⁴⁰⁹

Gjatë vizitës në QMH, ishin prezentë 5 persona të huaj të ndaluar. MKPT-ja ka kontrolluar dosjet e tyre si dhe realizoi intervista në dhomat ku ishin të akomoduar, pa prezencë të zyrtarëve të QMH-së dhe personelit të sigurimit. MKPT-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo sjellje nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH-së. Sa i përket kushteve materiale, MKPT-ja konsideron se Qendra i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të personave të huaj.

MKPT-ja gjate vizitës është informuar se UNHCR-ja u ofron ndihmë juridike falas të huajve në mbajtje, të cilët janë azilkërkues potencialë, por jo edhe të tjerëve. Po ashtu, MKPT-ja kontaktoi me Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) për të verifikuar nëse kjo agjenci është e involvuar në ofrimin e ndihmës juridike për të huajt e paraburgosur, të cilët janë subjekt i kthimit me forcë dhe u informuar se ANJE-ja mund

⁴⁰⁹ Ligji 04/L-219 për të Huajt.

t'u ofrojë ndihmë juridike falas të huajve të cilën kanë leje qëndrim të përkohshëm në Republikën e Kosovës, por deri më tani nuk kanë pasur raste të ofrimit të ndihmës juridike për të paraburgosurit e huaj.

Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua se shërbimet mjekësore të huajve në këtë qendër u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Prishtinë dhe Qendra Klinike Universitare. Mirëpo, në rastet kur personit të huaj i caktohet terapi me medikamente, terapia i jepet nga zyrtarët jokompetentë (personeli i sigurisë dhe zyrtarët tjerë) pasi që nuk ka staf mjekësor brenda Qendrës. MKPT-ja konsideron se QMH-ja duhet të ketë së paku një infermiere të kualifikuar.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën për Azilkërkues

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 12 mars 2018, ka vizituar Qendrën për Azilkërkues në fshatin Magurë të Komunës së Lipjanit (në tekstin e mëtejme *Qendra*). Grupi monitorues përbëhej nga zëvendësja e Avokatit të Popullit, një jurist dhe një mjeke.

Qendra u inaugurua në vitin 2012 dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB). Me Rregulloren (MPB) nr. 02/2014 për Funksionimin e Qendrës për Azilkërkues (në tekstin e mëtejme *Rregullorja*), rregullohet çështja e funksionimit dhe menaxhimit të Qendrës, përfshirë procedurën e pranimit, regjistrimit dhe lëvizjes së azilkërkuesve, brenda dhe jashtë Qendrës.⁴¹⁰ Kjo Rregullore, po ashtu rregullon edhe kushtet sanitare, higjienike, ushqimin, ndihmën mjekësore, mirëmbajtjen e rendit dhe disiplinës, si dhe çështje tjera të rëndësishme, lidhur me punën e saj.⁴¹¹

Gjatë vizitës, personeli i Qendrës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë, kështu që ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën, si dhe mundësia për t'i intervistuar azilkërkuesit, pa prezencë të zyrtarëve të Qendrës.

Neni 26 i Ligjit nr. 06/L-026 për Azil ka përcaktuar të drejtat e azilkërkuesve: të qëndrojnë në Republikën e Kosovës; të ketë kushtet themelore të jetesës; kujdesin shëndetësor; ndihmën sociale themelore; ndihmën ligjore pa pagesë; të drejtën e arsimimit për azilkërkuesit fëmijë; të drejtën në lirinë e mendimit dhe besimit fetar; të drejtën për punësim; dhe të drejtën në trajnime profesionale.

Gjatë vizitës se realizuar, MKPT-ja ka evidentuar se në këtë qendër ishin të akomoduar 21 persona, ndërsa 11 të tjerë ishin me banim privat në Lipjan. MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa për keqtrajtim në këtë Qendër. Ka pranuar një ankesë nga një familje, e cila ishte e akomoduar në këtë Qendër, ankesa e së cilës kishte të bënte me ndihmën sociale.

⁴¹⁰ Rregullorja (MPB) nr. 02/2014 për Funksionim e Qendrës për Azilkërkues, neni 1.

⁴¹¹ Rregullorja (MPB) nr. 02/2014 për Funksionim e Qendrës për Azilkërkues, neni 1 paragrafi 2.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vizituar hapësirat në të cilat ishin të akomoduar azilkërkuesit. MKPT-ja konsideron se Qendra plotëson të gjitha kushtet e akomodimit për azilkërkues. Ndërsa sa i përket ushqimit, MKPT-ja u njoftua se në këtë qendër ofrohen tri shujta ushqim. Mirëpo ekipi monitorues pranoi disa ankesa nga azilkërkuesit në lidhje me shërbimin e ushqimit.

MKPT-ja gjate vizitës u njoftua se shërbimi shëndetësor të huajve në këtë Qendër u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare dhe Qendra e Klinike Universitare.

MKPT-ja nga të gjeturat dhe konstatimet në këtë Qendër, i ka rekomanduar Ministrisë së Punëve të Brendshme: Të përshtatet orari i ushqimit sipas nevojave të azilkërkuesve, sidomos koha kur shërbehet darka; të njoftohet MKPT-ja për gjendjen sa i përket dhënies së ndihmës sociale në pajtim me Ligjin për Azil; të njoftohet MKPT-ja për mbarëvajtjen e kursit të gjuhës shqipe dhe të aspekteve tjera të integritimit në shoqëri në Republikën e Kosovës.

Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Institutin e Psikiatrisë Forenzike

Në pajtim me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit ka vizituar Institutin e Psikiatrisë Forenzike (IPFK). Grupi monitorues përbëhet nga zëvendësja e Avokatit të Popullit (mbikëqyrëse e MKPT-së), udhëheqësja e MKPT-së, një këshilltar ligjor, një këshilltare mjeke, një këshilltare psikologe, një këshilltar psikiatër (ekspert i angazhuar nga Këshilli i Evropës) dhe dy eksperte të Këshillit të Evropës në cilësinë e vëzhguesve.

Gjate vizitës së MKPT-së, personeli i IPFK-së dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë.

IPFK-ja është hapur në gusht të vitit 2014. Aktualisht është nën menaxhimin e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Në IPFK akomodohen personat të cilët kanë kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrimit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik⁴¹², si dhe personat të cilët janë subjekt i urdhrimit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor.⁴¹³ IPFK-ja përbëhet nga reparti A (Pranimi/Pacientët jo të shtrirë), reparti B (Trajtimet e Detyrueshme Psikiatrike), reparti C (Ekspertizat Psikiatrike), dhe reparti D i risocializimit. Kapaciteti i këtij institucioni është 36 shtretër (nga 12 shtretër në secilin repart).

IPFK-ja funksionon mbi bazën ligjore relevante që gjendet në Kodin Penal⁴¹⁴ të Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale⁴¹⁵, në Ligjin për Ekzekutimin e

⁴¹² Kodi Penal i Kosovës, neni 89.

⁴¹³ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, neni 508 paragrafi 4.

⁴¹⁴ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 18 dhe nenet 87-90.

⁴¹⁵ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nenet 506-508.

Sanksioneve Penale⁴¹⁶ dhe në Ligjin për Shëndetin Mendor. Ndërsa, më 21 dhjetor 2015, u miratua Rregullorja për Pranimin dhe Trajtimin e Personave me Çrregullime Mendore në Institucionet Publike Shëndetësore, përfshirë Institutin e Psikiatrisë Forenzike.

Ndërsa sa i përket kushteve të akomodimit të pacienteve në IPFK-së, MKPT-ja konsideron se kushtet në përgjithësi janë të mira. Po ashtu MKPT-ja ka vërejtur një raport pozitiv dhe qasje të afërt nga ana e stafit ndaj pacientëve. MKPT-ja ka intervistuar një numër të pacientëve dhe nuk ka pranuar ndonjë ankesë për ndonjë formë të keqtrajtitimit.

MKPT-ja gjatë vizitës është informuar për trajnimet dhe aktivitetet për pacientët, ku IPFK-ja, përveç vlerësimit, ofrohet trajnim medikamentoz dhe psikosocial. Sa i përket furnizimit me barëra në IPFK, nuk është i mire, familjarët shpesh detyrohen që t'i blejnë ato. Ndërsa trajtimi psiko-social konsiston në aktivitetet si lojëra, shikim televizori, vizatimet, daljet ditore brenda institucionit, seanca individuale me psikologun etj.

MKPT-ja u njoftua nga menaxhmentit se pengesa kryesore në funksionalizimin e IPFK-së është statusi ligjor i institucionit, sepse ky institucion më së paku i takon ShSKUK-së. Për këtë arsye, IPFK-ja nuk ka mundësi menaxhimi me buxhetin dhe planifikimet varen vetëm nga menaxhmenti i ShSKUK-së.

Personeli në IPFK është i përberë prej 43 të punësuarve, përveç drejtorit (neuropsikiatër), janë edhe 4 psikiatër të përgjithshëm, 2 psikiatër forenzikë, 1 punëtor social, 2 psikologë dhe 23 infermierë (prej tyre 15 femra dhe 8 meshkuj) si dhe 3 persona si staf administrativ, 2 kuzhinierë, 1 punëtor në depo. Sipas menaxhmentit, ky staf është i mangët sidomos edhe për 1-2 psikiatër.

Gjatë vizitës, MKPT-ja është informuar se personeli i sigurisë (përfshirë edhe personelin e sigurisë së ShKK) në IPFK nuk kanë të kryer trajnime adekuate për punë me këtë kategori të pacientëve.

Duhet cekur se IPFK-ja në vitin 2015 është vizituar nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, me ç' rast në raportin e saj ka dhënë rekomandime konkrete në lidhje me funksionimin e IPFK-së⁴¹⁷

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve, MKPT-ja i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë: Të njoftohet MKPT-ja lidhur me çështjen e statusit ligjor të IPFK-së dhe të ShSKUK-së; të furnizohet IPFK-ja rregullisht me barëra dhe gjëra tjera të nevojshme për kryerjen e punës; të zbatohen rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës; të shtohen aktivitetet psiko-sociale; të instalohet në IPFK sistemi (një kuti ankesash); personeli mjekësor të mos kryejë detyra të sigurisë; personeli i sigurisë në IPFK të përzgjidhet me kujdes dhe t'i nënshtrohet trajnimeve adekuate para se të marrin përsipër detyrat e tilla të sigurisë.

⁴¹⁶ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 174-180.

⁴¹⁷ Për më shumë shih Raportin e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës në Kosovë në vitin 2015 në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>.

Raport i Mekanizimit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën Edukuese - Korrektuese në Lipjan

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 5 korrik 2018, e ka vizituar Qendrën Edukuese-Korrektuese në Lipjan (QEKL).

QEKL-ja u hap në maj të viti 2017 dhe funksionon ashtu siç theksohet në Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve.⁴¹⁸ QEKL-ja funksionon mbi bazën ligjore relevante që gjendet në Kodin Penal⁴¹⁹ të Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale⁴²⁰, në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale⁴²¹ dhe në Kodin për të Mitur.⁴²² Kapaciteti i QEKL-së është 36 shtretër. Gjatë vizitës së MKPT-së ishin të vendosur 20 të mitur me masë edukuese.

Gjatë vizitës së MKPT-së në QEKL, personeli i Shërbimit Korrektues dhe personalia i Departamentit Shëndetësor të Burgjeve i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë.

MKPT-ja ka intervistuar një numër të të miturve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë nga të miturit për keqtrajtim fizik apo përdorim të forcës së tepruar.

Sa i përket kushteve materiale të akomodimit, në përgjithësi, MKPT-ja konsideron se QEKL-ja i plotëson të gjitha kushtet për akomodim të të miturve. MKPT-ja ka pranuar disa ankesa lidhur me sasinë dhe kualitetin e ushqimit.

MKPT-ja gjatë vizitës ka vërejtur se kuzhina ku ushqehen të miturit është në gjendje të keqe sa i përket makinerisë për pastrim të enëve dhe kushteve higjienike. Këtë shqetësim e shprehën edhe personeli dhe Drejtoria e QEKL-së, të cilët pohuan se planifikohet renovimi i kuzhinës.

Gjate vizitës, MKPT-ja u njoftua se sa i përket regjimit dhe aktiviteteve, QEKL-ja ua mundëson të miturve ajrosje në kohëzgjatje jo më pak se tri orë në ditë, gjë që është në pajtim me Kodin e Drejtësisë për të Miturit, gjithashtu posedon sallën e sportit dhe sallën e fitnesit. Mirëpo, mangësi në këtë Qendër është se nuk ka trajner të angazhuar për këto aktivitete sportive.

Sa i përket kujdesit shëndetësor, në përgjithësi, MKPT-ja konstaton se njësia shëndetësore në QEKL i plotëson standardet e kërkuara dhe ofron shërbimet e duhura mjekësore për të miturit e akomoduar aty.

MKPT-ja gjatë vizitës ka konstatuar se Qendra Edukative Korrektuese në Lipjan ofron mundësinë adekuate për parashtrim të ankesave dhe kërkesave, i shqyrton ato dhe u dërgon përgjigje të miturve brenda afatit ligjor.

⁴¹⁸ Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të cilëve u është hequr liria.

⁴¹⁹ Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 18 dhe nenet 87-90.

⁴²⁰ Kodi i Procedurës Penale i Kosovës, nenet 506-508.

⁴²¹ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 174-180.

⁴²² Kodi i Drejtësisë për të mitur nr. 03/L-193

Nga të gjeturat, MKPT-ja u ka dërguar autoriteteve kompetente rekomandimet si në vijim: Ushqimi për të miturit të jetë i bollshëm dhe i përshtatshëm sipas kalorive të kërkuara për rritjen dhe zhvillimin e të miturve; të bëhen renovimet e duhura në kuzhinë, si dhe të pajiset kuzhina me makineritë e domosdoshme; të shtohen aktivitetet për të miturit; të funksionalizohen kabinetet ekzistuese dhe të angazhohen instruktorët.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Mekanizmi Kombëtarë për Parandalim të Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 17 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 20 deri 22 mars 2018, vizitoi Qendrën Korrektuese në Dubravë (QKD).

Gjatë vizitës, personeli i QKD-së i siguroi ekipit të MKPT-së bashkëpunim të plotë, kështu që ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat e Qendrës.

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka intervistuar një numër të të burgosurve. Mirëpo, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesave për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës nga zyrtarët korrektues. Ekipi monitorues ka pranuar një numër të konsiderueshëm të pohimeve nga të burgosurit për korrupsion dhe favorizime jo vetëm për personelin korrektues, por edhe për personelin shëndetësor. MKPT-ja konsideron se Drejtoria e QKD-së dhe organet kompetente të Shërbimit Korrektues të Kosovës (ShKK) duhet të zhvillojnë hetime gjithëpërfshirëse dhe të pavarura sa herë që ka pohime për korrupsion dhe favorizime në QKD.

Sa i përket kushteve të akomodimit, MKPT-ja ka vërejte se kushtet e akomodimit dallojnë nga pavijoni në pavijon. MKPT-ja ka vërejtur se disa qeli nuk i plotësojnë standardet minimale të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës lidhur me madhësinë e qelisë dhe numrin e të burgosurve të akomoduar. Mirëpo, MKPT-ja konstaton se qelitë në përgjithësi ishin të ngrohta, kishin ndriçim të mjaftueshëm dhe ventilim. MKPT-ja i kushtoi rendësi të veçanta të burgosurve të cilëve u ishte shqiptuar masa e vetmisë, për shkak të shkeljeve disiplinore dhe të cilët mbaheshin në qeli të ndara. MKPT-ja konsideron se qelitë e tilla duhet t'i plotësojnë kriteret e parapara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.⁴²³

Sa i përket ushqimit, MKPT-ja ka pranuar një numër të madh të ankesave lidhur me cilësinë dhe sasinë e ushqimit, i cili u shërbehet të burgosurve. Të burgosurit pohuan se cilësia dhe sasia e ushqimit që u shërbehet për mëngjes dhe darkë është shumë e varfër.

Në kuadër të QKD-së ekziston edhe salla e fitnesit, e basketbollit dhe fusha e futbollit. Mirëpo, përveç këtyre, MKPT-ja konsideron se krijimi i njësisë ekonomike do t'i shtonte aktivitetet dhe angazhimet e një numri më të madh të të dënuarve. Krijimi i njësisë ekonomike parashihet edhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

⁴²³ Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale

Sa i përket kujdesit shëndetësor, në QKD funksionon spitali i burgut, i cili ofron shërbime mjekësore për të burgosurit, ku janë angazhuar 6 mjekë të rregullt (një mjek është në dispozicion gjatë 24 orëve), 26 infermierë, të cilët punojnë në ndërrime nga 12 orë. Ndërsa si konsultantë të jashtëm, të cilët punojnë një herë në javë, janë të angazhuar: psikiatri, kardiologu, ortopedi, neurologu, radiologu dhe tekniku i radiologjisë, fiziatri, oftamologu, otorinolaringologu.

Ndërsa sa i përket personelit të QKD-së, është përberë prej 60 zyrtarëve korrektues. MKPT-ja gjatë vizitës ka pranuar shumë ankesa nga personeli korrektues lidhur me numrin e vogël të zyrtarëve korrektues në raport me të burgosurit dhe kushtet e tjera të punës.

Përmes raportit, MKPT-ja u ka rekomanduar institucioneve kompetente si në vijim: Të njoftohet MKPT-ja nëse është miratuar legjislacioni sekondar për luftimin e korrupsionit; të përmirësohet cilësia dhe sasia e ushqimit; të gjitha qelitë ku vendosen të burgosurit, të cilëve u shqiptohet masa disiplinore e vetmisë, të jenë në pajtim me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe rekomandimet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës; të bëhen renovimet e nevojshme në pavijonet e caktuar; të funksionalizohet njësi ekonomike; të angazhohet personeli i nevojshëm korrektues sipas vlerësimit të nevojave.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitat në Stacionet Policore

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit ka vizituar stacionet policore si në vijim: Stacioni Policor në Klinë, 11 korrik 2018; Stacionin Policor në Istog, 11 korrik 2018; Stacionin Policor në Deçan, 12 korrik 2018; Stacionin Policor në Pejë, 12 korrik 2018.

Grupi monitorues përbëhej nga një këshilltar ligjor për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjeke-këshilltare, dy pjesëtarë të organizatës Qendra Kosovare për Rehabilitimin e Torturës (QKRMT), dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve).

Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për të kryer detyrën dhe qasja në të gjitha dokumentet e kërkuara, si dhe iu mundësua intervistimi i personave të arrestuar, pa prezencë të zyrtarëve policorë.

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), në raportin e 2-të të përgjithshëm, të publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia: e drejta për t'u njoftuar me të drejtat e tij; për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin e tij (anëtarin e familjes, mikun,

konsullatën e shtetit nga vjen nëse është shtetas i huaj); e drejta për të pasur një avokat; e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritet policore). Këto të drejta themelore parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në Ligjin për Policinë.⁴²⁴

Sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës, personat e dyshuar për kryerje të veprës penale mund të mbahen nga policia deri në 48 orë para se të dërgohen para gjyqtarit të procedurës paraprake. Policia mund t'i mbajë dhe të mbledhë informata nga personat të cilët gjenden në vendin ku është kryer vepra penale, të cilët mund të sigurojnë informata relevante (periudha maksimale kohore është gjashtë orë)⁴²⁵.

MKPT-ja gjatë vizitës në stacionin policor të Klinës dhe në atë të Istogut nuk ka hasur në persona të arrestuar. MKPT-ja ka hasur në persona të arrestuar në stacionin policor në Deçan dhe në Pejë, të cilët i ka intervistuar dhe nuk ka pranuar ankesa lidhur me këto të drejta. Po ashtu, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar del se Policia e Kosovës ka respektuar këto të drejta. Gjatë vizitave, MKPT-ja ka vërejtur se në secilën qeli të stacioneve të lartpërmendura, ndodheshin informata të shkruara lidhur me të drejtat e personave të arrestuar. Gjatë vizitave, MKPT-ja nuk ka hasur në të mitur të arrestuar.

MKPT-ja gjatë vizitës në stacionin policor në Pejë ka hasur në 5 persona të arrestuar, ku dy prej tyre ishin në procesin e intervistimit nga hetuesia dhe tre të tjerët janë intervistuar nga ekipi i MKPT-së. Gjatë intervistimit kishte pohime për keqtrajtim fizik nga zyrtarët policorë në momentin e arrestimit. MKPT-ja ka shqyrtuar dosjet e të arrestuarve ku u evidentua se të arrestuarit janë vizituar nga mjeku dhe në fletë-kontrollin mjekësor është shënuar matja e shenjave vitale dhe vetëm te një rast është udhëzuar terapi kundër dhimbjeve.

Në këtë drejtim, Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës përcakton: *“Zyrtari policor është i autorizuar ta përdorë forcën, vetëm atëherë kur është e domosdoshme dhe vetëm deri në atë nivel që kërkohet për t'i arritur objektivat legjitime të policisë.”*

Sa i përket kushteve të akomodimit, stacioni policor i Istogut dhe ai i Klinës, në përgjithësi i plotësojnë standardet minimale për akomodim të personave të arrestua, qelitë janë në pajtim me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. Ndërsa në stacionin policor në Pejë dhe në Deçan, MKPT-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit ishin në gjendje shumë të keqe, nuk ka dritë natyrale, edhe drita artificiale ishte e dobët, qelitë në këto dy stacione nuk i plotësojnë standardet minimale të akomodimit për personat e arrestuar.

Sa i përket kujdesit shëndetësor, MKPT-ja u njoftua se të arrestuarve shërbimet mjekësore u ofrohen nga institucionet publike, siç janë Qendrat e Mjekësisë Familjare më të afërta dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim.

⁴²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës,

⁴²⁵ Nenet 162, 163, 164 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës, MKPT-ja i rekomandon Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës: Të bëhet renovimi i nevojshëm në Qendrën e Mbajtjes në Deçan, sa më shpejt që të jetë e mundur; të bëhen renovimet e nevojshme në Qendrën e Mbajtjes në Stacionin Policor në Pejë, si dhe të furnizohet stacioni me materiale të nevojshme (shih paragrafin 23 të Raportit); në të gjitha qelitë e stacioneve policore ku ka dhoma të mbajtjes të instalohen sistemet e thirrjeve.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 17 maj 2018, ka vizituar Klinikën Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (në tekstin e mëtejme *Klinika Psikiatrike*). Grupi monitorues përbëhej nga një jurist, një mjek, një psikiatër dhe dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve).

Gjatë vizitës së MKPT-së, personeli i Klinikës Psikiatrike i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues.

Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë është e vendosur brenda hapësirës së ShSKUK-së, ka një sipërfaqe prej 3860 m². Kapaciteti i saj përbëhet prej 68 shtretërve dhe sipas autoriteteve shfrytëzimi i tyre është 60% brenda një viti. Klinika Psikiatrike përbëhet prej 4 reparteve.

Në bazë të Ligjit për Shëndetësinë, të nenit 13 të Ligjit për Shëndetin Mendor i Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 të Statutit të ShSKUK-së, Klinika Psikiatrike është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas ligjit në fuqi, ajo ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë).

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur se në përgjithësi atmosfera e në institucion është relaksuese dhe raportet ndërmjet personelit dhe pacientëve janë pozitive. MKPT-ja nuk ka pranuar nga pacientët asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo sjellje të personelit, e cila do të fyente dinjitetin e pacientit.

Sa i përket kushteve të akomodimit në ShSKUK, MKPT-ja vërejti se kushtet e akomodimit në përgjithësi janë të këqija dhe se duhet të ndërmerren masa të menjëhershme për renovim. Po ashtu, përkitazi me kushtet e jetesës së pacientëve, KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë, kushtet e jetesës së pacientëve në këtë klinikë i përshkruan si të këqija dhe të rënda, në të cilat nuk mund të pritët krijimi i një mjedisi terapeutik.⁴²⁶

⁴²⁶ Raporti i Komitetit Evropian për vizitën në Kosovë, 2010, paragrafi 79, në: <https://rm.coe.int/16806972c7>, (8.8.2018).

Sa i përket ushqimit në RSV, edhe pse shërbehen tri racione të përcaktuara dhe janë të bollshme për nga sasia, MKPT-ja ka pranuar ankesa lidhur me kualitetin e ushqimit ashtu që pacientët detyrohen të ushqehen jashtë Klinikës nga buxheti personal.

Në lidhje me aktivitetet piko-sociale, MKPT-ja shpreh brengosjen se janë të zbehta dhe rutinë, përkundër konstatimit të ekzistimit të disa aktiviteteve. Mirëpo nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit me përfshirje të pacientit dhe nuk ka një përfshirje në një rang më optimal të aktiviteteve terapeutike, rehabilitues dhe rekreacioneve. Ndërsa sa i përket informimit të pacientëve me të drejtat e tyre, MKPT-ja ka vërejtur se Karta e të Drejtave të Pacientëve ishte e vendosur në kuzhinë. Broshurat informuese janë harxhuar, zakonisht pacientët i njoftojnë gojarisht me të drejtat e tyre.

Ndërsa sa i përket furnizimit me barëra, shpesh ndodh që pacientët vetë t'i sigurojnë barërat, për shkak se ka mungesë të furnizimit me barëra.

Personeli i Klinikës Psikiatrike përbëhet prej 20 psikiatërve, 40 infermierëve, 5 psikologëve, 2 pedagogëve. Drejtoria thekson se numri i infermierëve është i vogël.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4 të Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon ShSKUK-së: Të bëhen renovimet e duhura në Klinikën Psikiatrike; të rritet numri i aktiviteteve të mirëfillta piko-sociale; të funksionalizohet ekipi multi-disiplinar në repartet e Klinikës Psikiatrike; të bëhet furnizimi i pandërprerë i Klinikës Psikiatrike me barëra; të përpilohet Udhërrëfyesi për parandalim të vetëvrasjeve; të ofrohen trajnime adekuate për personelin; të shtohet numri i personelit sipas vlerësimit dhe nevojës; nga pacienti të merret miratimi i informuar për trajtim në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor (shih paragrafin 32, 33 të këtij Raporti); të njoftohen pacientët për të drejtat e tyre në formë të shkruar; të përpilohet dhe përdoret regjistër i veçantë për pacientët, të cilëve u shqiptohet masa e izolimit; repartet psikiatrike në spitalet tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente psikiatrike.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës për vizitën në Qendrën për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 16 maj 2018, ka vizituar Qendrën për Integrim dhe Rehabilitim të të Sëmurëve Kronik Psikiatrik në Shtime (QIRSKP). Grupi monitorues përbëhej nga zëvendësja e Avokatit të Popullit, një jurist, një mjeke, një psikologe dhe dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve).

Gjatë vizitës së MKPT-së, personeli i QIRSKP-së i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues.

QIRSKP-ja funksionon në kuadër të ShSKUK-së dhe ofron shërbime 24 orë në ditë. QIRSKP-ja është institucion i tipit të hapur, rezidentët në këtë Qendër janë kryesisht të diagnostikuar me çrregullime psikotike, si Schizophreniae.

Sipas neni 12 të Ligjit për Shëndetin Mendor, QIRSKP-ja është njësi organizative e ShSKUK-së dhe ofron shërbime të nivelit sekondar. Ligji për Shëndetin Mendor ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore.⁴²⁷

Gjatë vizitës, MKPT-ja ka vërejtur një qasje të afërt dhe miqësore nga ana e stafit ndaj pacientëve, pra kryesisht vërehej një klimë pozitive brenda institucionit. Pacientët duken mirë për nga veshja dhe higjiena. Nuk kemi rastisur në shenja të lëndimeve. Nga intervistat me pacientët nuk kishte ndonjë ankesë për ndonjë formë të keqtrajtimit.

Lidhur me kushtet e banimit në Qendër, MKPT-ja vlerëson se janë mesatare. Megjithatë, janë të nevojshme renovime, si lysterja, rregullim i elementeve të tualeteve, vendosja e pikturave në mure dhe komodinat personale. MKPT-ja konsideron se ka mungesë të privatësisë tek tualetet që nuk kanë fare perde dhe kjo çështje duhet të zgjidhet urgjentisht.

MKPT-ja u njoftua se në QIRSKP ofrohen shërbime të rregullta psikiatrike, ku këto shërbime i kryen drejtori i Qendrës, pasi që me profesion është psikiatër, ndërsa në rast nevojë, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, nga Spitali Rajonal në Ferizaj dhe nga Qendra Klinike Universitare në Prishtinë.

Sa i përket regjimit dhe aktiviteteve, MKPT-ja shpreh brengosjen për faktin se numri dhe cilësia e aktiviteteve psiko-sociale dhe rekreative është shumë i mangët. Po ashtu nuk ka një plan të individualizuar të trajtimit me përfshirje të pacientit. Institucioni duhet të angazhohet me përparësi në shtimin e aktiviteteve psiko-sociale dhe përfshirjen e të gjithë pacientëve në mënyrë optimale në këto aktivitete.

Ndërsa sa i përket të drejtave të pacienteve, në repart nuk është e vendosur Karta e të Drejtave të Pacientëve dhe as fletushka për këtë qëllim, vetëm në ambulantë është e vendosur kjo Kartë. MKPT-ja konsideron që informacioni lidhur me të drejtat e pacientëve duhet të jetë i vendosur përshtatshëm, në vende të dukshme, të mbështetet me fletushka si dhe t'u shpjegohet sa më përshtatshëm pacientëve.

MKPT-ja u njoftua se personeli i QIRSKP-së ka 39 të punësuar, 1 psikiatër, i cili është edhe drejtori i institucionit, 9 infermierë, 16 ndihmës mjekësorë, 7 punëtorë administrativë dhe 7 punëtorë të shërbimeve teknike. MKPT-ja konsideron se numri i stafit nuk është adekuat. Po ashtu, mungojnë profesionistët, si p.sh psikolog, trapistët okupacional etj.

⁴²⁷ Ligji nr.05/L-025 për Shëndetin Mendor

Andaj, në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, përmes këtij Raporti, MKPT-ja u ka dërguar autoriteteve kompetente rekomandimet si në vijim: Të sigurohet numri adekuat i personelit mjekësor, si psikiatër, infermierë, psikologë klinikë, terapistë okupacionalë, si parakusht për një trajtim adekuat; të ofrohen trajnime adekuate për personelin; të përpilohet Udhërrëfyesi (Strategjia) për parandalim të vetëvrasjeve; Ministria e Shëndetësisë të marrë një vendim njoftues që i liston institucionet e shëndetit mendor ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik; të furnizohet rregullisht QIRSKP-ja me barërat e nevojshme; të funksionalizohet sistemi kompjuterik i evidentimit (baza e të dhënave). Gjithashtu MKPT-ja e ripërsërit rekomandimet si: nxjerrja e akteve nënligjore në pajtim me Ligjin për Shëndetin Mendor dhe ndërtimin e njësive vokacionale në kuadër të QIRSKP-së.

Raporti i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës lidhur me vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit, më 4 tetor 2018, ka vizituar Qendrën e Paraburgimit në Pejë (QPP). Grupi monitorues përbëhej nga dy juristë, një mjeke dhe një psikologe.

Ndërtesa e QPP-së është ndërtuar ndërmjet viteve 1960-1961. Fillimisht ka funksionuar nën administrimin e UNMIK-ut dhe të KFOR-it, deri në shkurt të vitit 2005, ku kompetencat e plota të menaxhimit i ka marrë stafi vendor. Ky Institucion ka kapacitetin zyrtar prej 86 të burgosurish. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës e ka vizituar QPP-në në vitin 2007 dhe 2015.⁴²⁸

Gjatë vizitës, MKPT-ja u njoftua nga drejtorja se janë njoftuar me gojë se duhet të fillojnë përgatitjet për mbylljen e QPP-së, pasi që është rekomandimi i Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës që kjo Qendër të mbyllet, për shkak të mospërmbushjes së standardeve për kushtet e akomodimit.

Gjatë vizitës nëpër qelitë e QPP-së, MKPT-ja ka vërejtur se aktualisht numri i të burgosurve kishte arritur në 89 persona. MKPT-ja ka vizituar një numër të qelive dhe ka verifikuar se hapësira e akomodimit, e ndriçimit dhe e ventilimit nuk është në pajtim me standardet e përcaktuara nga Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT) dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

MKPT-ja, gjatë vizitave në QPP, ka intervistuar një numër të madh të të paraburgosurve dhe të dënuarve dhe nuk ka pranuar asnjë ankesë për keqtrajtim fizik apo përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues.

Po ashtu, MKPT-ja vlerëson se kuzhina nuk i plotëson as kushtet elementare, pasi që hapësirat e saj janë shumë të vogla, pa dritë natyrore, mjetet për të punuar janë të

⁴²⁸ Shih: <https://rm.coe.int/16806972c7> (14.11.2017), Raporti i KPT-së për vizitën në Kosovë në vitin 2007, publikuar në vitin 2009. Për më shumë shih në: <https://rm.coe.int/168069727c> (15.10.2018).

vjetërsuara, të dëmtuara dhe të improvizuara nga vetë punëtorët. Ushqimi ishte i vendosur në një dhomë të posaçme me afat të gjatë të përdorimit

Sa i përket kujdesit shëndetësor, MKPT-ja nuk ka pranuar ankesa nga të paraburgosurit dhe të dënuarit. MKPT-ja ka vërejtur se shërbimet mjekësore në QPP jepen në pajtim me kërkesat dhe nevojat e të paraburgosurve.

MKPT-ja ka vërejtur se në QPP janë kutitë e ankesave të vendosura nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe kutitë e ankesave të vendosura nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 4 të Ligjit 05/L019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Drejtësisë: Ta njoftojë Avokatin e Popullit lidhur me pretendimet e punonjësve të QPP-së se kjo Qendër do të mbyllet; të krijohen kushte dhe hapësirë adekuate të punës për personelin mjekësor; numri i të paraburgosurve të akomoduar të jetë në pajtim me kapacitetin zyrtar të QPP-së dhe të zgjidhet çështja e mbipopullimit sa më shpejt që të jetë e mundur; kushtet e akomodimit, përderisa kjo Qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet minimale të përcaktuara me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me standardet e KPT-së dhe me standardet tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

Raport i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës për vizitat në Stacionet Policore

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 17 të Ligjit 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit ka vizituar stacionet policore si në vijim: Stacionin Policor në Shtime, më 30 tetor 2018; Stacionin Policor në Ferizaj, më 30 tetor 2018; Stacionin Policor në Graçanicë, më 30 tetor 2018; Stacionin Policor në Kaçanik, më 30 tetor 2018; Stacionin Policor në Shtërpçë, më 30 tetor 2018; Stacionin Policor në Gjilan, më 31 tetor 2018; Stacionin Policor në Ranillug, më 31 tetor 2018; Stacionin Policor në Kamenicë, më 31 tetor 2018; Stacionin Policor në Novobërdë, më 31 tetor 2018.

Grupi monitorues përbëhej nga udhëheqësja e MKPT-së, dy këshilltarë ligjorë për parandalim të torturës, një psikologe-këshilltare, një mjeke-këshilltare, një këshilltar-punëtor social, dy ekspertë të Këshillit të Evropës (në cilësi të vëzhguesve).

Gjatë vizitës në stacionet e lartpërmendura, Policia e Kosovës i ofroi MKPT-së bashkëpunim të plotë. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat.

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), në raportin e 2-të të Përgjithshëm, i publikuar në vitin 1992, ka theksuar rëndësinë e tri të drejtave themelore të personave të arrestuar nga policia: E drejta për t'u njoftuar me të drejtat e tij; e drejta për të njoftuar personin e tretë sipas përzgjedhjes së tij/saj për arrestimin e tij (anëtarin e familjes,

mikun, konsullatën e shtetit nga vjen nëse është shtetas i huaj); e drejta për të pasur një avokat; e drejta për t'u ekzaminuar nga mjeku sipas dëshirës së tij (përveç ekzaminimit mjekësor nga një mjek i thirrur nga autoritetet policore).⁴²⁹

Po ashtu, këto të drejta themelore parashihen edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Kodin e Procedurës Penale dhe me Ligjin për Policinë.⁴³⁰

MKPT-ja gjatë vizitës në stacionet policore në Shtime, Ferizaj, Graçanicë, Ranillug, Kaçanik, Shtërpçë, Novobërdë dhe Kamenicë nuk ka hasur në persona të arrestuar. MKPT-ja ka hasur në persona të arrestuar në stacionin policor në Gjilan dhe në Viti, të cilët i ka intervistuar dhe nuk ka pranuar ankesa lidhur me këto të drejta. Po ashtu, bazuar në dokumentacionin e shqyrtuar del se Policia e Kosovës i ka respektuar këto të drejta.

Sa i përket kushteve të akomodimit në stacionet policore Graçanicë, Gjilan, Ranillug, Viti, Shtërpçe, Novobërde, Kamenicë, në përgjithësi kushtet janë të mira dhe plotësojnë standardet minimale për akomodim të personave të arrestuar. Gjithashtu, madhësia e qelive është në pajtim me standardet e KPT-së⁴³¹.

Ndërsa në stacionet policore Ferizaj dhe Shtime kushtet e akomodimit vlerësohen si të këqija. MKPT-ja konsideron se Stacioni Policor në Ferizaj ka nevojë për renovime në hapësirat ku mbahen të arrestuarit dhe në hapësirat ku punojnë zyrtarët policorë. Sa i përket Stacionit Policor në Shtime, MKPT-ja u njoftua se është ndërtuar një objekt për këtë stacion, që pritet të funksionalizohet në dhjetor të këtij viti ose në janar të vitit të ardhshëm.

Megjithatë është shqetësues fakti se gjatë vizitës së ekipit të MKPT-së në këtë stacion, në një dhomë intervistimi ka gjetur tri objekte të forta, të cilat, sipas zyrtarëve policorë, ishin objekte të konfiskuara nga personat e arrestuar në vend të ngjarjes dhe mbahen aty si dëshmi.⁴³² MKPT-ja u ka rekomanduar zyrtarëve policorë se objektet e tilla duhet të hiqen menjëherë nga zyra ku intervistohen të arrestuarit.

Po ashtu, MKPT-ja ka vërejtur se të gjitha stacionet policore që i kanë vizituar posedojnë dokumentin standard (dosjen e të arrestuarit), në të cilin regjistrohen të gjitha të dhënat lidhur me të arrestuarin, në pajtim me nenin 172 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Sa i përkatës shërbimit shëndetësor, MKPT-ja u njoftua se shërbimet mjekësore të të arrestuarve, në të gjitha stacionet e vizituara, u jepen në qendrat më të afërta të mjekësisë familjare dhe në institucione të tjera publike sipas nevojës. MKPT-ja ka vërejtur se të

⁴²⁹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f> (2.11.2015).

⁴³⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 29 dhe 30. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, neni 13. Ligji nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës,

⁴³¹ Shih: <https://rm.coe.int/16806cea2f>.

⁴³² Objektet e gjetura mund të përshkruhen si në vijim: tre shkopin, dy nga këta shkopin duket se janë kablo elektrike të mbështjella me shirit izolues fund e krye dhe një shkop tjetër më i gjatë i mbështjellë vetëm në fillim për aq sa mund të kapet me dorë.

gjitha të dhënat lidhur me shërbimet e ofruara mjekësore ndaj të arrestuarve mbahen në dosjen e tij/saj personale.

Ndërsa lidhur me ankesat e të arrestuarve, MKPT-ja u njoftua se të arrestuarit kanë të drejtë të parashetrojnë ankesë në stacionin policor ku mbahet dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës. Përveç kësaj, të arrestuarit mund t'i drejtojnë ankesë edhe Avokatit të Popullit.

Prandaj, bazuar në të gjeturat gjatë vizitës, MKPT-ja i rekomandon Policisë së Kosovës: Të bëhen renovimet e nevojshëm në Qendrën e Mbajtjes në Stacionin Policor në Ferizaj; në të gjitha qendrat e mbajtjes të stacioneve policore të vizituara, tualetet e qelive ku mbahen të ndaluarit, duhet të pajisen me një ndarje e cila respekton privatësinë; të largohen mjetet e forta nga zyrat ku intervistohen apo mbahen personat e arrestuar ose ndaluar, në të gjitha stacionet policore, të cilat pretendohet se janë mjete të konfiskuara në cilësi të dëshmisë; të informohet MKPT-ja për datën e funksionalizimit të Stacionit Policor në Shtime; të furnizohen të ndaluarit me mjete personale higjienike.

Letër rekomandimet

Letër rekomandim – Ex officio nr. 23/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.4 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 17 janar 2018, ka iniciuar hetimet *ex officio*, lidhur me shkrimin e datës 12 janar 2018, me titull: “Gjykata konstaton se MZHE ka shkelur Kushtetutën dhe ligjin në procesin e privatizimit të KEDS dhe tenderin për “Kosova e re”, i publikuar në portalin “Telegrafi.

Nga hetimet e zhvilluara del se Instituti për Studime të Avancuara GAP, më 23 mars 2013, i është drejtuar MZHE-së me kërkesë për qasje në dokumente publike në dokumentet lidhur me procesin e privatizimit të KEDS dhe të ofertimit të projektit “Kosova e Re”. MZHE-ja i është përgjigjur kërkesës duke ia lejuar qasje, por vetëm për t’u parë. Atyre nuk u janë dhënë kopjet e dokumenteve të kërkuara me arsyetimin se “janë në formën e draftit final”. Me kërkesë të njëjtë, më 26 prill 2013, GAP i është drejtuar KEK-ut, por i është refuzuar qasja.

Nga shkrimi i lartpërmendur kuptohet se GAP, në emër të Konsorciumit Kosovar të Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm (KOSID), më 3 qershor 2013, ka parashtruar padi kundër MZHE-së për moslejim të qasjes në dokumente publike. Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, më 12 dhjetor 2017, ka nxjerrë aktgjykim (A.nr.750/13) me të cilin e detyron MZHE-në që, brenda 30 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit, GAP-it t’i lejohet qasja në dokumentet e kërkuara. Sipas informatave ka IAP-ja, lënda sipas ankesës ka kaluar në Gjykatën e Apelit.

Neni 4, paragrafi 1 i Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike (LQDP) specifikon: “Çdo kërkuar i dokumentit, ka të drejtë në qasje të dokumenteve të institucioneve publike, duke iu përmbajtur parimeve, kushteve dhe kufizimeve të përcaktuara me ligj”, ndërsa paragrafi 4 saktëson se: “Dokumentet publike të pranuar nga kërkuar nuk mund të përdoren për qëllime denigrimi, propagandistike dhe komerciale.”

Neni 7, paragrafi 8 i LQDP-së thekson: “Institucioni publik obligohet që brenda shtatë (7) ditëve, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerr vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose të japë përgjigje me shkrim për të arsyetuar refuzimin e plotë apo të pjesërishtëm dhe informon kërkuar për të drejtën që ai ka për parashtrimin e një kërkesë për rishqyrtim. Refuzimi i kërkesës bëhet me aktvendim me shkrim për refuzim të saj.”

Po ashtu, Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke trajtuar parimin e administratës së hapur në nenin 9, paragrafi 1, parasheh: “Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”

E drejta për t’u informuar është e drejtë e garantuar me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila secilit i garanton “Lirinë e kërkimit, marrjes dhe përhapjes së informacionit dhe ideve me çfarëdo mjetesh, pa marrë parasysh kufijtë” (neni 19 i DUDNj).

Lirinë për të marrë dhe dhënë informacion e parasheh edhe neni 10, paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) “Liria e Shprehjes”: *“Çdokush ka të drejtën e lirisë së shprehjes. Kjo e drejtë përfshin lirinë e mendimit dhe lirinë për të marrë ose për të dhënë informacione dhe ide pa ndërhyrjen e autoriteteve publike dhe pa marrë parasysh kufijtë...”*.

Rëndësia e mediave dhe e shoqërisë civile, si dhe raporti i masave të ndërmarra nga shteti në raport me shoqërinë civile është vlerësuar nga GjEDNJ-ja në rastin *Österreichische vs. Austria*. GjEDNJ-ja në këtë rast vlerëson: *“Mediat dhe shoqëria civile karakterizohen si “mbikëqyrëse” të shoqërisë, dhe që autoritetet kombëtare, lidhur me këtë duhet pasur kujdes në marrjen e masave, pasi që mund të dëmtojnë potencialisht pjesëmarrjen e tyre në debatet publike lidhur me çështjet e interesit të ligjshëm publik”*.

Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se “vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik”, si dhe duke u bazuar në faktet e ofruara si më lart, konstaton se përgjigja jo e plotë në kërkesën e GAP-it dhe refuzimi i kërkesës nga KEK-u, janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike.

Për më tepër, Avokati i Popullit, duke mos e paragjykuar trajtimin e çështjes nga gjykata, e vlerëson se qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar te qytetarët një kulturë administrative të harmonizuar dhe të fokusuar, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët dhe shoqëria civile.

Prandaj, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetues dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe të llogaridhënien, Avokati i Popullit rekomandoi që Institutit për Studime të Avancuara GAP t’i lejohet qasja e plotë në dokumentet e kërkuara.

Letër rekomandim – Ex officio nr. 127/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 4 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 5 mars 2018, ka hapur hetimet *ex officio*, në bazë të shkrimit të gazetës “Koha Ditore”, i datës 22 shkurt 2018, me titull: “Shkolla e Maznikut prej 17 vjetësh pa asnjë investim”. Drejtori i kësaj shkolle pohon se kanë probleme me çatinë, që vazhdimisht pikon brenda në shkollë, sa herë që bie shi dhe borë. Gjithashtu, sipas gazetës, drejtori i kësaj shkolle pohon se komuna ka qenë vazhdimisht në dijeni për problemet që kjo shkollë ka me çatinë, mirëpo ende nuk ka intervenuar në evitimin e tyre.

Më 8 tetor 2018, duke u nisur nga informatat e siguruar, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit vizitoi objektin e shkollës “Esad Mekuli”, në fshatin Maznik. Ai kishte vërejtur me këtë rast se shkolla në fjalë nuk ofronte kushte adekuate për zhvillimin e procesit

mësimor, se përveç cenimit të drejtës për arsim, nxënësve u rrezikohet edhe e drejta për jetë, shëndet dhe mirëqenie sociale.

Ligji për Arsimin Parauniversitar (LAP) në Republikën e Kosovës (publikuar në Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës/Nr.17/16 shtator 2011, Prishtinë), në nenin 3, paragrafi 3 përcakton: *“Është obligim i përgjithshëm i Ministrisë, komunave, institucioneve arsimore dhe të gjitha organeve të tjera, të përfshira në ofrimin e arsimit parauniversitar, siç është rregulluar përmes këtij ligji dhe ligjeve të tjera në fuqi, që të planifikojnë dhe ofrojnë shërbime efikase, efektive, fleksibile, gjithëpërfshirëse dhe profesionale, të dizajnuara për t’u ofruar të gjithë fëmijëve të drejtat e barabarta për shkollim, në pajtim me aftësitë dhe nevojat e tyre specifike, si dhe për të avancuar zhvillimin e tyre arsimor e social.”*

Po ashtu, neni 3, paragrafi 8 i LAP përcakton: *“Ministria, komuna, institucionet arsimore dhe aftësuese dhe komuniteti duhet ta bëjnë institucionin tërheqës dhe të sigurt për nxënësin, mësimdhënësin dhe prindërit, përmes përgjegjësive të tyre përkatëse për kurrikulum, standardet e ndërtimit dhe mirëmbajtjes së ndërtesave shkollore, shëndetësisë dhe sigurisë, ruajtjes së ambientit si dhe adresimit të çështjeve disiplinore dhe sjelljeve.”*

Ndërsa, neni 7, paragrafi 3 i LAP-së (Kompetencat e Komunës) përcakton përgjegjësitë shtesë të komunave si në vijim: *“3.1. ndërtimin e objekteve arsimore dhe aftësuese; 3.2. mirëmbajtjen dhe riparimin e ndërtesave dhe pajisjeve të institucioneve arsimore.”*

Nisur nga kjo, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit për Avokatin e Popullit, i rekomandoi Komunës së Deçanit që të ndërmarrë urgjentisht veprimet përkatëse për renovimin e objektit të shkollës “Esad Mekuli”, në fshatin Maznik.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 784/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 17 tetor 2018 ka pranuar ankesë nga z. Imer Abdyli, pronar i ndërmarrjes Fam Gas LLC, parashtruar kundër ATK-së.

Sipas informatave të pranuar nga z. Abdyli kuptohet që ATK-ja nuk ia ka pranuar atij TVSh-në e zbritshme nga Deklarata Unike Doganore (DUD). Lidhur me këtë çështje ai njofton se ndërmarrja që ai drejton ka lidhur marrëveshje (të vërtetuar tek noteri) me ndërmarrjen Mazrek Comerc NTP dhe janë pajtuar që DUD-i nr. 14464, i datës 11 shtator 2013 dhe DUD-i nr. 14451, i datës 16 shtator 2013, të evidencohet si kosto e blerjes tek Fam Gas LLC dhe të kreditohet TVSh-ja pasi që Fam Gas LLC paraprakisht ka bërë shitje dhe nuk ka kredituar TVSh-në në blerje me procedurë të zhdoganimit të mallit IM 7 në IM4. Ankuesi pretendon se ATK-ja po ia shkel të drejtat e tij me veprime të tilla, sepse po ia mohon marrëveshjen e vërtetuar para noterit, me të cilën ai ka marrë në pronësi DUD-in e theksuar më sipër.

Në letërkëmbimin e Avokati i Popullit me ATK-në njoftohet se ata janë bazuar në nenin 37, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1 të Ligjit nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në rrethanat e rastit, konstaton se lidhja e kontratës sipas të cilës e drejta pronësore mbi DUD-in është bartur tek Fam Gas LLC, është e plotfuqishme për faktin se kjo kontratë është lidhur në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe Ligjit për Noterinë dhe është vërtetuar pranë noterit. Prandaj e njëjta duhet të merret parasysh nga ana e ATK-së. Ky konstatim përforcohet edhe më shumë kur merret parasysh fakti se nga procedurat e kontrollit ka rezultuar se në rastin konkret nuk ka shmangie tatimore dhe doganore.

Avokati i Popullit vlerëson se mospranimi i kontratës së tillë nga ana e ATK-së përbën mosrespektim të së drejtës së pronës, e cila garantohet me Kushtetutë dhe me KEDNj, e po ashtu nuk është në harmoni me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve si dhe Ligjit për Noterinë dhe për këtë i rekomandon Administratën Tatimore të Kosovës që ta shqyrtojë kërkesën e Ndërmarrjes Fam Gas LLC dhe të vendosë lidhur me këtë çështje në pajtim me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me KEDNj-në, me Ligjin nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, me Ligjin nr. 03/L-010 për Noterinë dhe me Ligjin nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 747/2018

Avokati i Popullit bazuar në nenin 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe bazuar në nenin 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), më 6 gusht 2018, ka pranuar ankesën e Organizatës Joqeveritare “Iniciativa për Progres - INPO” parashtruar kundër Ministrisë së Integritimit Evropian, për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

Në bazë të informatave që ka Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), INPO-ja, më 27 gusht 2018, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar Ministrisë së Integritimit Evropian (MIE) duke kërkuar qasje në kontratën publike “Shërbime të Konsulencës Ndërkombëtare për nevoja të MIE”. Më 12 shtator 2018, INPO-ja, nëpërmjet postës elektronike, ka pranuar përgjigje nga MIE-ja, përmes së cilës i refuzohet qasja në dokumentin e kërkuar. Më 19 shtator 2018, INPO-ja ka parashtruar kërkesën për rishqyrtim në MIE, mirëpo deri në paraqitjen e ankesës në IAP, nuk kishte pranuar përgjigje.

Më 6 nëntor 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit është takuar me u. d. Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun, me ç’ rast është njoftuar se MIE-ja është duke punuar në përpunimin e të dhënave në kontratën në fjalë dhe me përfundimin e këtij procesi do ta njoftojnë ankuesen. Më 20 nëntor 2018, IAP-ja është njoftuar se përfaqësuesit e INPO-s mund të shkojnë në zyrat e MIE-së për ta realizuar qasjen në dokumentin e kërkuar. Më 22 nëntor 2018, INPO-ja e ka njoftuar IAP-në se qasja në dokumentin e kërkuar ishte e kufizuar.

Avokati i Popullit vëren se më shumë se 50 për qind e përmbajtjes së kontratës ishte e hijezuar, me arsyetimin se ato informata janë konfidenciale, por pa e arsyetuar ligjërisht kufizimin e tillë.

Më 3 dhjetor 2018, përfaqësuesja e IAP-së është takuar me u. d. Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun, me ç’ rast i është prezantuar dokumenti në fjalë në formën e njëjtë si edhe INPO-s, ndërsa kërkesa për kopjen e dokumentin në fjalë nuk i është dhënë nën arsyetimin se, për një gjë të tillë, duhet të bisedojë me zyrën ligjore në MIE. Përfaqësuesja e IAP-së e ka njoftuar atë me përmbajtjen e nenit 18, paragrafi 6 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit ka qasje në dosje dhe në dokumente të çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, mund t’i shqyrtojë ato lidhur me rastet që i ka në shqyrtim, mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve, sipas kërkesës së Avokatit të Popullit.

Qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët dhe shoqëria civile. Me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollimin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, Avokati i Popullit i rekomandoi në këtë rast Ministrisë së Integritimit Evropian që ta trajtojë kërkesën e OJQ-së “Iniciativa për Progres - INPO” dhe t’i përgjigjet në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi; dhe t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 115 / 2018

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 21 shkurt 2018, ka pranuar ankesën nga OJQ BIRN, kundër Telekomit të Kosovës (TK), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

OJQ BIRN kishte parashtruar kërkesë më 4 shtator 2017 dhe më 2 shkurt 2018, për qasje në dokumente publike, përkatësisht qasje në të gjitha kontratat që TK-ja i ka lidhur me biznese/media dhe subjekte të tjera, për qëllime të reklamimit/marketingut, duke përfshirë edhe vendosjen e panove dhe bilbordëve mirëpo TK-ja nuk ka kthyer përgjigje.

Në kërkesën e Avokatit të Popullit lidhur me këtë çështje Telekomit i Kosovës njoftoi se kërkesën e ankuesit nuk kanë arritur ta gjejnë në TK. Më tej TK-ja ka njoftuar se ankuesi sërish mund t’i drejtohet TK-së më kërkesën e njëjtë dhe se do t’i kthehet përgjigje në afatin optimal.

Ankuesi është njoftuar me përgjigjen e TK-së dhe në këtë rast ai ka kontaktuar zyrtarin përgjegjës në TK, me kërkesën e BIRN-it, lidhur me qasje në dokumente publike. Pas kontaktimit të përfaqësuesit të BIRN-it dhe atij të TK-së, përfaqësuesi i AP-së, më 29 gusht 2018, ka dërguar e-mail tek zyrtari përgjegjës në TK, të cilin e ka përsëritur më 4, 10, 14 dhe 28 shtator të vitit 2018, për të kërkuar informacione rreth veprimeve të TK-së përkitazi me kërkesën e BIRN-it, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje.

Megjithëse, ankuesi e ka përsëritur kërkesën e njëjtë për qasje në dokumente publike, si dhe përkundër që me nenin 7, paragrafin 8 dhe nenin 8, paragrafin 1, të Ligjit Nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (në tekstin e mëtejme *LQDP*), janë të përcaktuara afatet brenda të cilave duhet të kthehet përgjigje, ai nuk ka pranuar asnjëherë përgjigje.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme *Kushtetuta*), në nenin 41, paragrafi 1 parasheh të Drejtën për Qasje në Dokumente Publike, sipas të cilit: *“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike”*. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”*.

Fryma e nenit 41 të Kushtetutës është përcjellë edhe në nenin 1 të LQDP-së, sipas të cilit: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike”*.

Avokati i Popullit konstaton se mos përgjigja e TK-së në kërkesën për qasje në dokumente publike ia mohon të drejtën e BIRN-it për qasje në dokumente publike, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë dhe me ligj dhe në mënyrë që të rivendoset kjo e drejtë e shkelur i rekomandohet Telekomit të Kosovës të shqyrtojë kërkesën e BIRN-it për qasje në dokumente publike në afat sa më të shkurtër dhe t'i kthejë përgjigje në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 484/2017

Më 8 qershor 2016, ankuesi kishte parashtruar ankesë në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) në Prizren, kundër drejtorit të Shkollës “Loyla Gimnazium”, për abuzim psikik dhe ofendime ndaj vajzës së tij (nxënëse e kësaj shkolle) dhe bashkëshortes së tij (mësimdhënëse në këtë shkollë). Sektori i Inspektiveve të Arsimit (SIA) në Komunën e Prizrenit, më 20 korrik 2016 (shkresa Ref.10/1-4, Nr.prot.274), e vlerësoi ankesën e ankuesit si të pabazuar, mirëpo lënda e ankuesit ishte kthyer në rishqyrtim nga Inspektorati i Arsimit në kuadër të MASHT-it. Më 7 shtator 2016, SIA në Prizren (Vendimi Ref.10/1-4 nr. prot. 337) e vlerësoi çështjen e ankuesit sërish si të pabazuar. Më 23 dhjetor 2016, (Ankesa nr. prot.725) ankuesi iu drejtua me ankesë Departamentit të Inspektoratit në MASHT, i cili, përmes Vendimit nr.10/19, i datës 18 janar 2017, ia ka

refuzuar ankesën. Më 1 shkurt 2017, ankuesi iu drejtuar me ankesë (Nr. prot. 500) Sekretarit të Përgjithshëm në MASHT, por asnjëherë nuk kishte pranuar përgjigje.

Më 18 tetor 2017, Avokati i Popullit, nëpërmjet një shkrese, kërkoi nga Sekretari i Përgjithshëm i MASHT-it që ta informojë për veprimet që janë ndërmarrë apo që priten të ndërmerren, që rasti të procedohet brenda afatit të arsyeshëm kohor, në pajtim me ligjin.

Më 2 nëntor 2017, Sekretari e informoi Avokatin e Popullit se: *“Rastin konkret e ka kthyer në rishqyrtim te organi i shkallës së parë për faktin se inspektorati i arsimit, me rastin e shqyrtimit të lëndës, nuk është bazuar në Rregulloren QRK-NR.21/2013 për Protokollin për parandalimin dhe referimin e dhunës në institucionet e arsimit parauniversitar.”*

Më 1 dhjetor 2017, përfaqësuesi i IAP-së bisedoi me Sekretarin dhe kërkoi ta informojë, ndër të tjera, se kur është kthyer rasti në rishqyrtim dhe se a është informuar ankuesi. Sekretari pohoi se: *“.. lënda është kthyer me vonesë në rishqyrtim më 1 nëntor 2017 dhe nuk është çështje e imja që të vendosi dhe të merrem me këtë çështje. Ndërsa sa i përket informimit të ankuesit lidhur me ankesën e tij, ne nuk e kemi informuar ankuesin për faktin se pala nuk ka adresë, por e kemi informuar drejtorin e kësaj shkolle”*. Përfaqësuesi i IAP-së kërkoi dëshmi me të cilën mund të dëshmohej se është bërë përpjekje për ta informuar ankuesin, por për këtë Sekretari pohoi: *“Nuk kemi dëshmi dhe ky rast për neve është i vogël që të merrem me të dhe me nis me u marr unë me secilin nxënës apo arsimtar e t'i kthej përgjigje, mbetem pa i kryer punët tjera të cilat janë më me prioritet.”*

Ligji nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, në nenin 11 shprehimisht e përcakton obligimin për vendimmarrje: *“Organet e administratës publike, brenda kompetencave të tyre, detyrohen të vendosin për çdo kërkesë të dorëzuar nga personat fizik dhe juridik.”* Po ashtu, neni 38 i këtij ligji, në mënyrë të qartë parasheh obligimin e organit administrativ për veprim pas pranimit të kërkesave të palëve dhe për njoftimin e tyre me shkrim lidhur me vendimin e organit. Në rastin konkret, organi nuk ka vepruar në pajtim me nenin 38 të Ligjit të Procedurës Administrative, pasi që pala nuk ka marrë përgjigje me shkrim.

Ndërsa, neni 90, paragrafi 1 i po këtij ligji, rregullon shprehimisht mënyrën e dërgimit të akteve administrative: *“Aktet administrative individuale dhe kolektive iu dërgohen palëve të interesuara në afat prej 30 ditësh.”* Në rastin e ankuesit vërejmë se, edhe pse kanë kaluar disa muaj, ai nuk ka marrë kurrfarë përgjigje për kërkesën e tij.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në provat dhe shkresat e ofruara nga ankuesi, konstaton se MASHT-i ka dështuar në zbatimin e ligjit, pasi që ankuesi në parashtrësën e tij, më 1 shkurt 2017, nuk ka marrë përgjigje nga MASHT-i, përkundër detyrimit ligjor për të shqyrtuar parashtrësën e ankuesit sipas ligjit në fuqi; dhe për këtë rekomandoi që

MAShT-i të vendosë urgjentisht lidhur me parashtresën e ankuesit, e datës 1 shkurt 2017, duke e trajtuar atë në pajtim me dispozitat ligjore.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 290/2017

Avokati i Popullit, në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, ka pranuar ankesën e z. Florent Spahija, përfaqësues i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI) kundër Komisionit Qendror Zgjedhjeve (KQZ), lidhur me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike. KDI-ja, më 13 janar 2017, nëpërmjet postës elektronike,⁴³³ i është drejtuar Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike dhe Çertifikim të KQZ-së me kërkesë “*për qasje në raportet financiare dhe raportet e shpenzimeve të disa partive politike për vitin 2015, si në vijim: Partisë Demokratike të Kosovës PDK; Lidhjes Demokratike të Kosovës LDK; Lëvizjes Vetëvendosje LVV; Lista Srbska; Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës AAK; dhe Nismës për Kosovën NISMA.*”

Megjithëse, më 24 janar 2017, ankuesi ka ripërsëritur kërkesën e njëjtë për qasje në dokumente publike, por nuk kishte pranuar përgjigje.

Më 17 maj 2017, zyrtarë të Avokatit të Popullit kërkuan nga KQZ-ja që t’i njoftojnë në lidhje me mospërgjigje në kërkesën e KDI-së dhe arsyen e kufizimit të së drejtës për qasje në dokumente publike. Mirëpo asnjëherë nuk pranuan përgjigje.

Fryma e nenit 41 të Kushtetutës, sipas të cilit: “*Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike*”, është përcjellë edhe në nenin 1 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), sipas të cilit: “*Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike.*”

Avokati i Popullit kupton se LQDP-ja, neni 12, paragrafi 1 parasheh arsyet e përjashtimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton: “*Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1. të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin.*”

Sidoqoftë, Avokati i Popullit vëren se, përveç moskthimit të përgjigjes brenda afateve të përcaktuara me ligj (shih nenin 7, paragrafin 8 dhe nenit 8 paragrafin 1 të LQPD-së), KQZ-ja ka dështuar që së paku të ofrojë ndonjë informatë nëse të dhënat e kërkuara janë të kufizuara me ligj dhe se zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi t’i dëmtojë interesat e përcaktuara me paragrafin 1 të nenit 12 të LQPD-së.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) që, sipas neni 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Në rastin *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, GjEDNj-a

⁴³³ E-maili i z. Artan Canhasi drejtuar KQZ-së, më 13 janar 2017

ka vlerësuar: *“T’i mohosh publikut informacione mbi funksionimin e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.”*⁴³⁴

Rëndësia e mediave dhe shoqërisë civile, si dhe raporti i masave të ndërmarra nga shteti në raport me shoqërinë civile, është vlerësuar nga GjEDNj-ja në rastin *Österreichische (...)V. Austria*. GjEDNj-ja me këtë rast vlerëson: *“Mediat dhe shoqëria civile karakterizohen si “mbikëqyrëse” të shoqërisë, dhe që autoritetet kombëtare, lidhur me këtë duhet pasur kujdes në marrjen e masave, pasi që mund të dëmtojnë potencialisht pjesëmarrjen e tyre në debatet publike lidhur me çështjet e interesit të ligjshëm publik.”*⁴³⁵

Avokati i Popullit sjell në vëmendje edhe praktikën gjyqësore të sistemit gjyqësor të Kosovës, e cila arsyeton interesin e publikut për t’u njoftuar për shpenzimet e parasë publike. Lidhur me qasjen në dokumente publike, ngjashëm me rastin e KDI-së, Gjykata Themelore në Prishtinë me Aktgjykimin e saj A.nr.1335/12, i datës 26.05.2015, në kontestin administrativ të paditësit “Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese – BIRN” kundër të paditurës Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, ka vendosur pozitivisht duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, me të cilin gjykata ka detyruar të paditurën Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, që në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh të merr aktvendim me të cilin do t’i lejohet paditësit qasja në të gjitha dokumentet dhe informatat e kërkuara në lidhje me shpenzimet e bëra nga ish-kryeministri dhe ish-zëvendëskryeministrat, në periudhën kohore nga data 15.2.2011 e deri më datën 31.8.2012. Njëri nga konstatimet e gjykatës përcakton: *“... shpenzimet që i bëjnë zyrtarët publik, veçanërisht zyrtarët e lart të shtetit, janë para të mbledhura nga taksat dhe tatimet që paguajnë qytetarët e Republikës së Kosovës, dhe nga ky aspekt, ata kanë drejtpërsëdrejti interes të arsyeshëm të informohen për çdo cent, se ku i shpenzojnë zyrtarët publikë të cilëve u janë besuar autorizime Publike, dhe nga ky fakt ata duhet të mbahen përgjegjës për ato shpenzime.”*⁴³⁶

Avokati i Popullit konsideron se vëmendje e posaçme duhet t’i kushtohet Raportit të vitit 2016 për Kosovën të Komisionit Evropian, i cili qysh atëherë kishte vlerësuar: *“Komisioni Qendror i Zgjedhjeve po ashtu nuk ka siguruar publikimin në kohë të raporteve mbi financat e partive politike. Transparenca dhe llogaridhënia e financimit të partive politike dhe financimit të fushatës mbetet për t’u siguruar.”*⁴³⁷

Përkundër rëndësisë së rolit të shoqërisë civile në mirëfunksionimin e shtetit, duke pasur parasysh që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë mund të kufizohen

⁴³⁴Case of Observer And Guardian V. The United Kingdom, (Application no. 13585/88, 26 November 1991)

⁴³⁵Case of Österreichische Vereinigung zur Erhaltung, Stärkung und Schaffung eines wirtschaftlich gesunden land- und forstwirtschaftlichen Grundbesitzes v. Austria, (Application no. 39534/07), §33.

⁴³⁶Aktgjykimi A. nr. 1335/2012, më 26 maj 2015, i Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes të cilit u vendos që zyra e Kryeministrit t’i lejojë qasje paditësit Rrjetit Ballkanik të Gazetarisë Hulumtuese “Birn”, në të gjitha dokumentet dhe informatat në lidhje me shpenzimet e bëra nga ish-kryeministri dhe ish-zëvendëskryeministrat... në periudhën kohore 15.2.2011 deri më 31.8.2012.

⁴³⁷http://www.mei-ks.net/repository/docs/raporti_i_progresit_2016_shqip.pdf

vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme, që në një shoqëri të hapur dhe demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, në rastin konkret kjo e drejtë është kufizuar pa ndonjë bazë të arsyeshme, të lejuar me ligj.

Së këndejmi, Avokati i Popullit, duke vlerësuar përkushtimin dhe angazhimin e shoqërisë civile në ndërtimin e një shoqërie të hapur dhe demokratike, dhe duke e konsideruar çështjen e financimit të partive politike si çështje me interes të lartë publik, i rekomandoi KQZ-së që, në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, t'i ofrojë KDI-së qasje në raportet financiare dhe në raportet e shpenzimeve të partive politike.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 28/2018

Avokati i Popullit, në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 18 janar 2018, ka pranuar ankesën e z. Enis Veliu, zëvendëskryeredaktor i gazetës së përditshme “Zëri” parashtruar kundër Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (MZhE), përkitazi me mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Sipas informatave të pranuar nga ankuesi, kuptohet që z. Veliu, më 21 dhjetor 2017, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në MZhE, me kërkesë për qasje në kontratën për ndërtimin e termocentralit “Kosova e re”.

Megjithëse ankuesi, më 15 janar 2018, ka përsëritur kërkesën e njëjtë për qasje në dokumente publike, edhe pse me nenin 7, paragrafi 8 dhe me nenin 8, paragrafin 1 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), janë të përcaktuara afatet brenda të cilave duhet të kthehet përgjigje, por ai nuk kishte pranuar përgjigje.

Më 19 janar 2018, MZhE-ja ka bërë publike kontratën për ndërtimin e termocentralit “Kosova e re” dhe ka dhënë arsyen për vonesën e publikimit të saj. Sidoqoftë, Avokati i Popullit vëren se MZhE-ja nuk ka ofruar përgjigje në kërkesën e z. Veliut në afatin e paraparë me LQDP. Në anën tjetër, Avokati i Popullit vëren se kontrata e publikuar është vetëm në gjuhën angleze dhe se lidhur me këtë ka pasur edhe reagime nga ana e qytetarëve të interesuar.

Avokati i Popullit me këtë rast tërheq vëmendjen tek neni 5, paragrafi 1 të Kushtetutës, sipas të cilit: “Gjuhë zyrtare në Republikën e Kosovës janë Gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe”. Po ashtu Ligji nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, në nenin 2, paragrafi 2.1, përcakton: “Gjuha shqipe dhe gjuha serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë...”

Me gjithë faktin se MZhE-ja, edhe pse me vonesë është publikuar kontrata për ndërtimin e termocentralit “Kosova e re”, konsiderojmë se qasja e plotë në këtë kontratë ka mbetur e kufizuar për një pjesë të madhe të publikut, për shkak se mungon përkthimi i saj në cilëndo, apo në të dy gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

Duke pasur parasysh rolin e mediave dhe publikut në një shoqëri demokratike dhe duke pasur parasysh që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë mund të

kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme, që në një shoqëri të hapur dhe demokratike të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, Avokati i Popullit konsideron se në këtë rast kjo e drejtë është kufizuar pa ndonjë bazë të arsyeshme të lejuar me ligj. Kjo për shkak se, fillimisht publikimi i kontratës për ndërtimin e termocentralit “Kosova e re” është bërë me vonesë; dhe së dyti, për shkak se mungon përkthimi i kontratës në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Prandaj, Avokati i Popullit i rekomandon MZHE-së që kontrata për ndërtimin e termocentralit “Kosova e re” të publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 120/2017

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 8 shkurt 2017, ka pranuar ankesën e z. Kushtrim Latifaj parashtruar kundër Komunës së Prishtinës, për shkak të moszbatimit të vendimit nr. 41/16, i Autoriteti Kosovar të Konkurrencës (AKK), i datës 6 dhjetor 2016. Në ankesën e tij, z. Latifaj ka theksuar se ai merret me shërbime të pagesave dhe është pronar i kompanisë “Pro Paid” Sh.P.K. Veprimtarinë e tij e ka zhvilluar për një kohë të gjatë në objektet e Komunës së Prishtinës, mirëpo, më 3 prill 2015, Komuna e Prishtinës dhe Posta e Kosovës (Posta) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me të cilën parashihet vendosja e filialeve të Postës brenda objektit të Komunës së Prishtinës duke i eliminuar kështu operatorët e tjerë ekonomikë.

Më 6 dhjetor 2016, sipas detyrës zyrtare dhe bazuar në ankesën e kompanisë “Pro Paid” Sh.P.K., AKK-ja mori Vendim dhe konstatoi se *“marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet komunës së Prishtinës dhe Postës, me nr. protokollit 01-031-75225 e nënshkruar me datën 3 prill 2015”*, është e kundërligjshme dhe se prania e Postës nëpër institucione dëmton konkurrencën dhe bie ndesh me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencë dhe kërkoi nga Komuna e Prishtinës që ta shfuqizojë marrëveshjen e lartshënuar. Po ashtu, në këtë Vendim, AKK rekomandoi për Komunën e Prishtinës që të ofrojë kushte të barabarta për të gjithë operatorët ekonomikë, duke i vendosur ata në gjendje të favorshme konkurruese, nëpërmjet mekanizmave ligjor, në respektim të ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, të përcaktuar me nenin 119, paragrafi 1 dhe 3 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me nenin 1 dhe 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Bazuar në Ligjin nr. 03/L-229 për Mbrojtjen e Konkurrencës, parashihet që përmes AKK-së të përcaktohen rregullat dhe masat për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Më 29 korrik 2015, ndër të tjera, ankuesi ka parashtruar një kërkesë për marrjen me qira të një hapësire prej 20 m², brenda objekteve të Komunës së Prishtinës, mirëpo asnjëherë nuk ka pranuar përgjigje. Duke u bazuar në Vendimin nr. 41/16, i datës 6 dhjetor 2016, si dhe konstatimin e AKK-së se prania e Postës nëpër institucione dëmton konkurrencën që përcaktohet me Ligjin për Mbrojtjen e Konkurrencës, Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Prishtinës është dashur brenda afatit ligjor ta zbatojë Vendimin e lartpërmendur të AKK-së.

Prandaj, Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Prishtinës që në pajtim me nenin 119, paragrafi 1 dhe 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 1 dhe 4 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sa më parë ta zbatojë Vendimin e AKK-së nr. 41/16, i datës 6 dhjetor 2016, në mënyrë që të gjithë operatorët ekonomikë, qofshin ato kompani private apo ndërmarrje shtetërore, të jenë në pozitë të barabartë dhe të favorshme konkurruese, nëpërmjet mekanizmave ligjor në respektim të ekonomisë së tregut dhe konkurrencës së lirë.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 171/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike, më 19 mars 2018, ka pranuar ankesën e personit juridik Commando sh.p.k (më tutje *ankuesi*) parashtruar kundër Autoritetit Rregullator të Hekurudhave (ARrH), për shkak të refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente publike.

Në bazë të pohimeve të ankuesit dhe dokumenteve të pranuar, vërehet se, më 13 shkurt 2018, nëpërmjet postës elektronike, i është drejtuar ARrH-së me kërkesë për qasje në dokumentin publik, përkatësisht qasje në kontratën “Sigurimi fizik në ARrH”, e lidhur në muajin mars të vitit 2015 (nr. i prokurimit: 31400-15-001-221) me operatorin ekonomik N.T.Sh. “SFK”, si dhe certifikatën e biznesit dhe referencën e lëshuar për punën e kryer. Sipas pohimeve të ankuesit, kontrata në fjalë ka skaduar para dy vjetëve dhe vlera e saj ka qenë publike në ueb-faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të Kosovës (KRPP).

Më 16 mars 2018, ankuesi nëpërmjet postës elektronike, ka pranuar përgjigje me të cilën i refuzohet kërkesa për qasje. Megjithatë, ARrH-ja, përveç përgjigjes me të cilën e njofton ankuesin për refuzimin e kërkesës për qasje, nuk ka dhënë arsyetim, por as nuk ka nxjerrë Aktvendim, në pajtim me nenin 7, paragrafi 8 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi i kërkesës së ankuesit nga ARrH-ja, përveç që është në kundërshtim me LQDP-në, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, të përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1, sipas të cilit: “Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.” Për më tepër, mungesa e një vendimi, në formën e përcaktuar me ligj, tërheq më vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, në nenin 10 [Mjetet për Promovimin e Transparencës], në paragrafin 2, përcakton: “Shënimet për secilin aktivitet të prokurimit duhet të përmbajnë se paku: (i) të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me një aktivitet të prokurimit ose që janë zhvilluar apo pranuar gjatë, ose që janë mbledhur ose shfrytëzuar për të filluar ose përmbyllur një aktivitet të prokurimit, pa marrë parasysh nëse aktiviteti i tillë rezulton në një kontratë ose në dhënien e konkursit të projektimit; (ii) nëse aktiviteti i

prokurimit ka rezultuar në dhënien e një kontrate ose konkursi të projektimit, atëherë të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me dhënien e tillë; dhe (iii) nëse aktiviteti i prokurimit ka rezultuar në ekzekutimin e një kontratë publike, atëherë një kopje të kontratës publike dhe të të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me kontratën dhe/ose ekzekutimin e saj (...).

Ndërsa paragrafi 3 përcakton qasjen në të dhëna, si në paragrafin 2, ndërkaq me paragrafin 5 përcaktohet: “Autoriteti kontraktues, me kërkesë të një pale të interesuar, do të bëjë dhe do t’i sigurojë palës së tillë të interesuar një kopje të çfarëdo materiali në të cilin pala e tillë e interesuar ka të drejtën e qasjes sipas paragrafit 3 të këtij neni.”

Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët dhe shoqëria civile. Prandaj, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, Avokati i Popullit i rekomandon Autoritetin Rregullator të Hekurudhave që t’i trajtojë kërkesën e ankuesit në pajtim me LQDP-në dhe legjislacionin përkatës në fuqi.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 499/2017

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 11 korrik 2017, ka pranuar ankesën e z. Xhafer Kadrija, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së të Verbërve në Gjakovë, kundër Komunës së Gjakovës, përkitazi me pretendimet për cenimin e të drejtave të personave të verbër në Komunën e Gjakovës, respektivisht mosrespektimin e dispozitave ligjore për lirim nga tatimi në pronë.

Shoqata e të Verbërve në Gjakovë, më 19 janar 2017, kishte parashtruar ankesë për faturimin e tatimit në pronën e paluajtshme për personat e verbër dhe kishte kërkuar nga autoritetet komunale ta respektojnë nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, duke prezantuar dëshmi se ky ligj po zbatohet në Komunën e Prishtinës, e cila tanimë kishte miratuar Rregulloren për Tatim në Pronën e Paluajtshme 01 nr. 110-246609, e datës 3 tetor 2016, e cila në nenin 7 (7.2) përcakton: “*Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme për të verbërit, do të bëhet konform dispozitave të nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-092, për Personat e Verbër dhe fillon te zbatohet nga data 1 Janar 2017.*”

Më 5 korrik 2017, Shoqata e të Verbërve në Gjakovë kishte marrë përgjigje nga Bordi Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Gjakovës, duke e njoftuar Shoqatën e të Verbërve në Gjakovë se refuzohet ankesa si e pabazuar, me arsyetimin: “*Sipas shkresës zyrtare 09/58011, datë 14 mars 2017 nga Naim*

Baftiu-Sekretar i Përgjithshëm në MF drejtuar z. Teki Shala Drejtor për Buxhet dhe Financa në Komunën e Gjakovës i cili ka japur sqarime ligjore citoj "Ministria e Financave dhe Komunitet e Republikës së Kosovës janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme Nr.03/L-204, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-100."

Ligji nr. 04/L-092 për Personat e Verbër, në nenin 1 përcakton: *"Me këtë ligj rregullohet statusi ligjor i personave të verbër në Republikën e Kosovës"*, ndërsa neni 2 përcakton: *"Ky ligj rregullon të drejtat dhe përfitimet si dhe përcakton kriteret për kategorizimin e personave të verbërve"*, ndërsa neni 6 i Ligjit nr. 04/L-092 për Personat e Verbër përcakton: *"Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë. Në rast vetëpunësimi ata lirohen nga çdo detyrim fiskal, ndërsa në rast se zhvillojnë veprimtari si persona juridikë, ata gëzojnë lehtësira tatimore të cilat i realizojnë sipas ligjeve në fuqi."*

Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër. Në çështjen e ankuesit vërehet hapur se ankesat kanë filluar nga personat e verbër, të cilët nuk kanë kërkuar asgjë më shumë se zbatimin e të drejtave e të tyre ligjore, respektivisht ligjit, i cili i rregullon të drejtat dhe përfitimet e personave të verbër, ndërsa përgjigja e Bordit Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Tatimin në Pronën e Paluajtshme bie ndesh me Ligjin për Personat e Verbër, si dhe me parimin juridik: *"Lex specialis lex generalis derogat"* (Ligji special e derogon ligjin e përgjithshëm), sepse mohimi i shfrytëzimit të kësaj të drejte bazuar në ligje të përgjithshme mund të konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut, respektivisht i të drejtave ligjore të personave të verbër dhe shkelet parimi i sigurisë juridike, si një parim i përgjithshëm i së drejtës për të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit insiston në atë se ligji vlen për të gjithë dhe se askush nuk është i përjashtuar nga ligji apo nuk është mbi ligjin.

Avokati i Popullit, bazuar në atë që u tha më sipër, i rekomandon ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që në pajtim me kompetencat dhe autorizimet që burojnë nga ligji, të nxjerrë qarkore me të cilën kërkohet nga të gjitha komunat e Republikës së Kosovës lirim nga tatimi në pronën e paluajtshme për personat e verbër, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të Ligjit nr.04/L-092 për Personat e Verbër, pa asnjë dallim.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 683/2016

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L019 për Avokatin e Popullit, më 7 nëntor 2016, ka pranuar një ankesë nga Milka dhe Marko Petković parashtruar kundër Zyrës për Gjendje Civile në Ferizaj. Ankesa e parashtruar ka të bëjë me pamundësinë e marrjes së ekstraktit të certifikatës së lindjes në të cilën është e

shënuar shtetësia e Republikës së Kosovës në emër të të dy ankuesve. Parashtruesit e ankesës pohojnë se në muajin korrik të 2016, ata paraqitën kërkesë në Zyrën për Gjendjen Civile dhe Regjistrim në Ferizaj për lëshimin e ekstrakteve të lindjeve në emër të Malinka Petković, mbiemri i vajzërisë Marković dhe në emrin e Marko Petković. Më 20 korrik 2016, shërbimi në fjalë për gjendjen civile ua ka lëshuar certifikatat nga libri amzë i të lindurve, duke mos e shënuar shtetësinë e Republikës së Kosovës dhe numrin personal të qytetarit. Mirëpo, në certifikatën e lindjes të Marko Petković, në rubrikën për emrin e nënës dhe shtetësinë e saj është shënuar Malinka Petković dhe shtetësia *Kosovare*, kurse në certifikatën e ankuesit, shtetësisë i është vënë një vijë sipër. Ankuesit, ndër të tjera, në ankesën e tyre theksojnë se në zyrën e lartpërmendur ua kanë sqaruar se nëse dëshirojnë ta marrin ekstraktin e certifikatës së lindjes dhe shtetësinë, është e domosdoshme ta kenë vendbanimin e regjistruar në territorin e Republikës së Kosovës, pa marrë parasysh që ankuesit janë persona të zhvendosur dhe pa marrë parasysh se të dy ankuesit janë të lindur në Kosovë dhe se vendqëndrimi i tyre deri në qershor të vitit 1999 ishte në Ferizaj. Me atë rast, palës përgjegjëse i janë paraqitur provat që dëshmojnë për vendbanimin e tyre në Ferizaj deri në qershor të vitit 1999, mirëpo ankuesit më pas janë udhëzuar në procedurën për paraqitjen e kërkesës për shtetësi të Republikës së Kosovës, që ka të bëjë me të huajt.

Pas miratimit të Udhëzimit të ri Administrativ të MPB-së së Republikës së Kosovës, për kriteret që përmbajnë dëshmi të shtetësisë së ish-RFJ-së, në datën 1 janar 1998, nr. 05/2017, këshilltari ligjor i IAP-së u takua disa herë me zyrtarët e Zyrës për Gjendjen Civile dhe Regjistrimin në Ferizaj, por mori përgjigjen që ankuesit duhet të aplikojnë për marrjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës në MPB të Republikës së Kosovës, gjegjësisht në Departamentin për Shtetësi, Azil dhe Migracion, pa marrë parasysh Ligjin për Shtetësi, i cili është në fuqi, si dhe UA nr. 05/2017, që përcakton kriteret për njohjen e shtetësisë dhe rregullimin e statusit civil për të gjithë qytetarët.

Në bazë të asaj që u tha më sipër, Avokati i Popullit rikujton detyrimet ligjore të Zyrës për Gjendjen Civile dhe Regjistrim në Ferizaj, lidhur me paraqitjen e kërkesës për njohjen e shtetësisë dhe lëshimin e ekstrakteve të lindjeve dhe shtetësisë, të parashikuara në nenet 5 dhe 32 të Ligjit mbi Shtetësinë e Republikës së Kosovës, si dhe në UA nr. 05/2017 të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe i rekomandon Zyrës e Gjendjes Civile dhe Regjistrim në Komunën e Ferizajt që të veprojë sipas kërkesës së ankuesit, në përputhje me dispozitat ligjore.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 499/2015 dhe nr. 759/2017

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 22 shtator 2015, ka pranuar ankesën e znj. Ismete Kurtalani, përfaqësuese ligjore e babait të saj Maliq Sahiti, dhe më 14 nëntor 2017, ka pranuar ankesën e znj. Fatmire Arifi, përfaqësuese ligjore e babait të saj Hysen Ali Ademi, të cilat ankohen kundër Ministrisë së Drejtësisë - Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë (më tej *Komisioni Qeveritar*), për shkak të

zvarritjes së shqyrtimit të aplikacioneve të dorëzuara në Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë.

Sipas pohimeve të ankueseve, prindërit e tyre ishin të burgosur politikë të cilët tanimë kanë ndërruar jetë, po ashtu jetë kanë ndërruar edhe bashkëshortet e tyre, përkatësisht nënat e ankueseve. Prandaj, ankueset, në emër të prindërve të tyre, si ish të burgosur politikë, kanë aplikuar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe të ish përndjekurve politikë në Shoqatën e ish të Burgosurve Politikë në Gjiilan, por aplikacionet e tyre ende nuk janë shqyrtuar nga Komisioni Qeveritar.

Përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, më 28 janar 2016, është takuar me z. Shefik Sadiku, Sekretar i Komisionit Qeveritar, i cili ka pohuar se kategoria së cilës i takon ankuesja është kategori ku aplikanti dhe bashkëshortja e tij kanë vdekur dhe se këto aplikacione shqyrtohen më vonë. Më 17 janar 2017, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit, nëpërmjet adresës elektronike, kërkoi të informohet z. Sadiku lidhur me shqyrtimin e aplikacionit të ankueses.

Më 18 janar 2017, përfaqësuesi i IAP-së pranoi përgjigjen sipas të cilës: *“Aplikacionet e ish të Dënuarve të Vdekur me Bashkëshorte të vdekura Komisioni i shqyrton pasi të bëhet Kompensimi i (ish të Dënuarve) aplikuesve që janë të gjallë gjegjësisht (ish të Dënuarve) aplikuesve që janë të vdekur me Bashkëshorte gjallë.”* Gjithashtu, më 23 janar 2018, përfaqësuesi i IAP-së u njoftua se: *“Komisionin e shkallës së dytë (Komisioni i Ankesave), Qeveria e ka themeluar, por nuk funksionon! Komisioni i Ankesave kur të filloj punën, ndër rastet e para ka për me shqyrtuar aplikacionin e Maliq Sahitit gjegjësisht ankesën e z. Kurtalani!”*

Edhe pse Ligji nr. 03/L-95 për të Drejtat e ish të Dënuarve dhe të Përndjekurve Politikë, parasheh që Qeveria, përkatësisht ministritë përkatëse, kanë pasur obligim që komisionet e parapara sipas nenit 19, të formohen në afat prej (6) gjashtë muajsh nga nxjerrja e ligjit, Ministria e Drejtësisë ka dështuar ta zbatojë nenin 10 të Rregullores nr. 07/2013 për Procedurat dhe Kriteret e Kompensimit të ish të Dënuarve Politikë. Mospublikimi i regjistrave të përfituesve të statusit të ish të dënuarve politikë apo të ish të përndjekurve politikë ndikon në të drejtën e paraqitjes së ankesës nga qytetarët lidhur me personat që janë në regjistër (përfitues).

Nisu nga kjo që u tha, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që t'i publikojë regjistrat e përfituesve të statusit të ish të dënuarve politikë dhe të ish të përndjekurve politikë, ndërsa Komisionit Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe të ish të Përndjekurve Politikë që, pa zvarritje të mëtutjeshme, t'i shqyrtojë aplikacionet e znj. Kurtalani dhe të znj. Arifi.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 275/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 24 prill 2018, ka pranuar ankesën e z. Zlatko Nekić, i cili ka parashtruar ankesë në emër të babait të tij z. Živorad Nekić, për zvarritje të procedurës lidhur me

kallëzimin penal për shkak të uzurpimit të pasurisë së paluajtshme, si dhe për shkak të mosinformimit nga Prokuroria Themelore në Prizren, lidhur me veprimet e ndërmarra, të cilat kanë të bëjnë me kallëzimin e lartcekur penal KTN/II nr.2954/15.

Parashtruesi i ankesës pohoi se kallëzimin penal e ka paraqitur në Prokurorinë Themelore në Prizren, më 29 tetor 2015, kundër personit NN, për shkak të uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme dhe asgjësim apo dëmtim i pasurisë (nenet 332 dhe 333 të KPK-së) në fshatin Lubizhdë, komuna e Prizrenit. Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumentacionit të dorëzuar lidhur me ankesën e tij të parashtruar Institucionit të Avokatit të Popullit, rezultoi se përfaqësuesja e tij ligjore disa herë i është drejtuar Prokurorisë Themelore në Prizren për të marrë informacion lidhur me kallëzimin penal në fjalë dhe veprimet e ndërmarra nga kjo Prokurori, por pa sukses.

Në letërkëmbimin e Avokatit të Popullit me Prokurorinë Themelore në Prizren kuptohet se i vetmi veprim i ndërmarrë është kërkesa të cilën Prokuroria kompetente ia ka dërguar Zyrës Kadastrale në Komunën e Prizrenit dhe nga e cila ka pranuar përgjigje se parcela është në emër të ankuesit/të dëmtuarit, i cili edhe e ka paraqitur kallëzimin penal. Më tutje në përgjigje theksohet se lidhur me këtë çështje penale, Prokuroria Themelore në Prizren nuk mund të veprojë më tutje, duke mos dhënë sqarim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete procedurale.

Avokati i Popullit, në bazë të dokumentacionit të parashtruar nga ankuesi dhe përgjigjes së prokurorit të çështjes, vjen në përfundim se Prokuroria Themelore në Prizren, që prej 29 tetor 2015, kur edhe është paraqitur kallëzimi penal për uzurpim të pronës së paluajtshme ose dëmtimit të pasurisë, ka ndërmarrë vetëm një veprim hetues. Bazuar në dispozitat ligjore, prokurori i shtetit është i obliguar që pa vonesë të veprojë në përputhje këtyre dispozitave ligjore, prandaj iu rekomandua Prokurorisë Themelore në Prizren që të zbatojë dispozitat përkatëse të Kodit nr. 04/L-123 të Procedurës Penale lidhur me çështjen në fjalë.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 479/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), më 16 korrik 2018, ka pranuar ankesën e znj. Vera Remshkar, Drejtoreshë Ekzekutive e Fondacionit Together Kosova, parashtruar kundër Ministrisë së Shëndetësisë (MSh), për shkak të pamundësisë të qasjes në dokumente publike.

Ankuesja pretendon se, më 2 korrik 2018, i është drejtuar me ankesë Komisionit të Ankesave për financimin publik të OJQ-ve në MSh, për shkak të mosndarjes së fondit. Krahas kësaj ankese, ankuesja kishte parashtruar kërkesë për qasje në dokumente publike. Më 13 korrik 2018, ankuesja ka pranuar vendimin nga Komisioni i Ankesave, me të cilin ankesa e saj refuzohet si e pabazë, ndërsa nuk ka pranuar përgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ankuesja më tej pohon se, më 6 dhe 17 gusht 2018, zyrtarët e Fondacionit Together Kosova janë takuar me përfaqësues të MSh-së, me

ç' rast atyre u është lejuar qasja e pjesshme në fletat e vlerësimit për projektin e këtij Fondacioni.

Avokati i Popullit, më 13 gusht 2018, i është drejtuar me shkresë Sekretarit të Përgjithshëm duke kërkuar informata lidhur me veprimet që janë ndërmarrë ose që planifikohen të ndërmerren përkitazi me kërkesën për qasje në dokumentin e kërkuar dhe, më 17 dhe 28 gusht 2018, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga MSh-ja, me të cilën është njoftuar për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë, e ndër të tjera, edhe njoftimin se kërkesit e dokumentit i është dhënë qasje edhe në listën e OJQ-ve fituese dhe në vlerat financiare të mbështetura për projektet e tyre, si dhe në aplikacionin me vlerësimet e 5 anëtarëve të Komisionit për propozimin e Together Kosova, por me emra të mbuluar/fshehur të anëtarëve të këtij Komisioni. Megjithatë, përfaqësuesit e Fondacionit Together Kosova pohojnë se u është dhënë qasja vetëm në listën e OJQ-ve fituese, por jo edhe në vlerat financiare për projektet. Në përgjigjen e MSh, e datës 17 gusht 2018, të pranuar nëpërmjet postës elektronike, ndër të tjera, është kërkuar edhe opinion/asistencë nga Institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me përmbushjen e detyrimeve ligjore të MSh-së në raport me kërkesën e ankueses për qasje në dokumente publike.

Përkitazi me lejimin e pjesshëm të qasjes në aplikacionin me vlerësimet e 5 anëtarëve të Komisionit për propozimin e Fondacionit Together Kosova, me ç' rast janë mbuluar/fshehur emrat e anëtarëve të këtij Komisioni, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se kjo çështje është rregulluar me nenin 8, paragrafi 5 të Rregullores nr.04/2017 të MF mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik të OJQ-ve, që përcakton: “[...]... Komisioni vlerësues themelohet gjatë kohës sa thirrja publike është e hapur dhe emrat e anëtarëve të Komisionit Vlerësues bëhen publik brenda shtatë (7) ditëve pas themelimit të Komisionit....[...]”.

Ndërsa, lidhur me qasjen në dosjet e aplikimit të OJQ-ve fituese dhe në pikët e vlerësimit të tyre nga Komisioni, duhet të veprohet në përputhje me parimet e përpunimit të të dhënave, ashtu siç përcaktohet me nenin 3, paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku thuhet se të dhënat personale përpunohen në mënyrë të ligjshme, pa e cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave dhe se të dhënat personale duhet të jenë adekuate, relevante dhe të mos e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë grumbulluar ose përpunuar më tutje.

Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar në bashkëveprim me qytetarët dhe shoqërinë civile. Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Shëndetësisë që ta trajtojë kërkesën e Fondacionit Together Kosova dhe të përgjigjet, në pajtim me Ligjin për Qasje në Dokumente Publike dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 666/2017

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafit 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 9 tetor 2017, ka pranuar ankesën e z. Murat Limani, përmes të autorizuarit të tij z. Hamdi Jashari, parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), për mospërmbarimin e Aktvendimit E.nr.812/09, i datës 4.6.2015.

Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumentacionit që ai ka paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit, vërehet se ankuesi në vitin 2001, në Gjykatën Komunale në Prishtinë, ka iniciuar padi për vërtetimin e pronësisë, për të cilën kjo gjykatë ka vendosur me Aktgjykim (C.nr.178/2001, datë 5.6.2007). Po ashtu, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Aktgjykimin AC.nr.405/08, i datës 5.2.2009, ka vërtetuar Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë. Ndërsa Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Rev.nr. 226/2009, i datës 16.7.2012, ka refuzuar revizionin e të paditurit/debitorit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.

Ankuesi, tani në cilësinë e kreditorit, më 30 shtator 2009, në Gjykatën Komunale në Prishtinë ka parashtruar propozim për përmbarim të dhunshëm. GjThP-ja vendosë për çështjen me Aktvendimin E.nr.812/09, i datës 4.6.2015, dhe e lejon përmbarimin e propozuar. Prapësimin e debitorit, GjThP-ja e ka refuzuar me Aktvendimin nr. E.nr.812/09, i datës 21.1.2016. Gjykata e Apelit nxjerr Aktvendimin Ac.nr.2071/2016, i datë 11.5.2017, me të cilin e vërteton Aktvendimin e GjThP E.nr.812/09, i datës 21.1.2016.

Më 15 nëntor 2017, Avokati i Popullit iu drejtua me shkresë kryetares së GjThP-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar ta njoftojë për veprimet që janë ndërmarrë apo që planifikohen të ndërmerren, në mënyrë që ky rast të procedohet në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj.

Më 29 nëntor 2017, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga GjThP-ja, nëpërmjet së cilës është njoftuar se gjykata planifikon që në javën e parë të dhjetorit t'i njoftojë palët në procedurë për ditën e zbatimit të përmbarimit. Më 5 shkurt 2018, ankuesi/kreditori ka njoftuar IAP-në se gjykata ka dalë në vendngjarje, më 18 dhjetor 2017, me qëllim të zbatimit të përmbarimit, por që gjykata e ka shtyrë përmbarimin me konstatimin se mungonte fuqia punëtore dhe mjetet përcjellëse dhe se djali i debitorit ka deklaruar se ata nuk kanë pranuar konkluzionin e datës 4 dhjetor 2017. Më 6 shkurt 2018, ankuesi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka dorëzuar në gjykatë kërkesën për azhurnim të lëndës dhe, sipas pohimeve të tij, nuk është ndërmarrë ndonjë veprim në drejtim të përmbarimit të vendimit të plotfuqishëm.

Më 25 maj 2018, Avokati i Popullit i është drejtuar përsëri me shkresë kryetares së GjThP-së, nëpërmjet së cilës ka kërkuar që ta njoftojë për veprimet që do të ndërmerren në çështjen e ankuesit. Megjithatë, Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje në këtë

shkresë. Sipas pohimeve të ankuesit, GjThP-ja, që nga 18 dhjetori 2017, nuk ka ndërmarrë më asnjë veprim në drejtim të përmbarimit E.nr.812/09.

Avokati i Popullit vëren se GjEDNj-ja ka theksuar se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983).

Po ashtu, në Aktgjykimin për rastin *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, i datës 19 mars 1999, paragrafi 40, GjEDNj-ja thekson se përmbarimi i vendimeve të plotfuqishme gjyqësore është pjesë përbërëse e procedurës së gjyimit dhe se zbatimi i vendimeve garanton sundimin e ligjit. Në rastin në fjalë, Avokati i Popullit rithekson se periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon nga viti 2001, kur paditësi ka paraqitur padinë në Gjykatën Komunale në Prishtinë për vërtetimin e pronësisë, ndërsa procedura përmbarimore është iniciuar më 30 shtator 2009, e Aktvendimi E.nr.812/09, i datës 4.6.2015, ka marrë formën e prerë më 11.05.2017. Nga kjo që u tha më lartë, vërehet se tanimë kanë kaluar më shumë se 16 vjet qëkur z. Limani ka iniciuar procedurën gjyqësore, dhe deri më sot Aktvendimi E.nr.812/09, i datës 4.6.2015, nuk është përmbaruar.

Neni 13 i KEDNj-së pasqyron në mënyrë të drejtpërdrejtë obligimin e shtetit që fillimisht të mbrojë të drejtat e njeriut përmes sistemit të tij ligjor, duke vendosur me këtë rast një garanci shtesë, për një individ, që e bën të mundur që ai/ajo t'i gëzojë të drejtat në mënyrë efektive. E drejta e një individi për proces të rregullt brenda një kohe të arsyeshme do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston mundësia që së pari ta parashtrijë këtë ankesë pranë një autoriteti vendor. Kërkesat e nenit 13 mbështesin kërkesat e nenit 6 (shih aktgjykimi *Kudla kundër Polonisë*). Kështu, neni 13 garanton një mjet ankimimi efektiv pranë një autoriteti vendor për një shkelje të pohuar të kërkesave të nenit 6, për ta shqyrtuar një rast gjyqësor brenda një kohe të arsyeshme.

Pasi që rasti në fjalë ka të bëjë me ankesën lidhur me kohëzgjatjen e procedurës në zbatimin e aktvendimit të formës së prerë, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm. Prandaj, efekti i këtij neni është ekzistenca e një mjeti ligjor vendor që merret me substancën e “një ankese të kontestueshme” sipas Konventës dhe të lejojë lehtësimin përkatës (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Kaya kundër Turqisë*, më 19 shkurt 1998). Çfarëdo mjeti i tillë duhet të jetë efektiv si në praktikë ashtu edhe në ligj (shih p.sh. Aktgjykimi në rastin *Ilhan kundër Turqisë*, më 27 qershor 2000). Në rastin në fjalë, ankuesi vazhdimisht i është drejtuar gjykatës me parashtrësia ashtu siç parashihet me dispozita ligjore, megjithatë Aktvendimi E.nr.812/09 nuk është përmbaruar.

Duke u bazuar nga sa u tha më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, i rekomandoi Gjykatës Themelore në Prishtinë që t'i ndërmarrë veprimet ligjore për përmbarimin e Aktvendimit E.nr.812/09, i datës 4.6.2015.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 310/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), më 14 maj 2018, ka pranuar ankesën e z. Zekirja Shabanit (redaktor në “Infokusi”), parashtruar kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme (MPJ), për shkak të pamundësisë të qasjes në dokumente publike.

Në bazë të informatave që ka në dispozicion Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), z. Shabani, më 27 mars 2018, përmes postës elektronike, i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm në MPJ, me kërkesë për qasje në të gjitha shpenzimet e zyrës së ministrit, zëvendësministrit, këshilltarëve të ministrit dhe zëvendësministrave dhe stafit përcjellës, për periudhën 1 tetor 2017 deri më 26 mars 2018. Meqenëse ankuesi nuk kishte pranuar përgjigje brenda afatit të paraparë me LQDP, më 6 prill 2018, ai ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim, por nuk ka pranuar përgjigje.

Avokati i Popullit, më 12 korrik dhe 12 shtator 2018, i është drejtuar me shkresa Sekretarit të Përgjithshëm në MPJ, duke kërkuar ta njoftojë për veprimet që kjo Ministri ka ndërmarrë apo që planifikon t’i ndërmerr në mënyrë që t’i përgjigjet ankuesit në kërkesën për qasje në dokumente publike. Megjithatë, Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje në këto shkresa.

Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 41, paragrafi 1 përcakton të Drejtën për Qasje në Dokumente Publike, sipas të cilit: *“Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike”*. Ndërsa, paragrafi 2 i po të njëjtit nen përcakton: *“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përjashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë.”*

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi i kërkesës së ankuesit nga MPJ-ja, përveçse është në kundërshtim me LQDP-në, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, të përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1, sipas të cilit: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”*

Avokati i Popullit rikujton se praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), sipas neni 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Në rastin *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, GjEDNj-ja ka vlerësuar: *“T’i mohosh publikut informacione mbi funksiononim e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.”*

Avokati i Popullit vëren se në rastin e ankuesit, MPJ-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin e qasjes në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e cila e drejtë është e sanksionuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë, si mjet të fuqishëm për kontrollin e punës së organeve të pushtetit, e që do të ndikonte në përmirësimin e punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Jashtme që ta trajtoi kërkesën e ankuesit dhe t'i përgjigjet atij, në pajtim me LQDP-në dhe me legjislacionin përkatës në fuqi.

Letër rekomandim – Ankesa nr.58/2018

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), më 7 shkurt 2018, ka pranuar ankesën e z. Armend Gollubovcit parashtruar kundër Ministrisë së Infrastrukturës (MI), për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike.

Në bazë të pohimeve të ankuesit dhe dokumenteve të pranuara, vërehet se ankuesi, më 19 tetor 2017, ka parashtruar kërkesë (nr. i prot. 8031) në MI për qasje në projektin e ndërtimit të rrugës së re Kroi i Mbretit-Drenas-Skenderaj-Kroi i Mbretit, por nuk ka pranuar përgjigje.

Avokati i Popullit, më 7 mars dhe më 17 prill 2018, i është drejtuar me shkresa ministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm në MI, me të cilat ka kërkuar informata lidhur me veprimet që kjo Ministri ka ndërmarrë përkitazi me çështjen e z. Armend Gollubovcit. Më 26 qershor 2018, përfaqësuesja e IAP-së është takuar me Sekretarin e Përgjithshëm në MI, mirëpo edhe përkundër pohimit të tij që do t'i përgjigjen ankuesit dhe Avokatit të Popullit në shkresat e dërguara, Avokati i Popullit nuk pranoi asnjëherë përgjigje.

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi i kërkesës së ankuesit nga MI-ja, përveç që është në kundërshtim me LQDP-në, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, të përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1, sipas të cilit: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”*

Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq me vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit konstaton se MI-ja, përveçse ka dështuar t'i përmbushë obligimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës (neni 41) dhe nga LQDP-ja, kjo Ministri po ashtu ka dështuar t'i përmbushë obligimet që burojnë nga Kushtetuta (neni 132, paragrafi 3), si dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit (neni 25), në bazë të të cilit, të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.

Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët dhe shoqëria civile. Avokati i Popullit i rekomandoi Ministrisë së Infrastrukturës që ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t'i përgjigjet atij, në pajtim me LQDP-në dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, si dhe t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 823/2017

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, si dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-125 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP), më 29 nëntor 2017, ka pranuar ankesën e z. Naim Sallahut parashtruar kundër Ministrisë së Infrastrukturës (MI), për shkak të lejimit të pjesshëm të qasjes në dokumente publike.

Në bazë të informatave që ka Avokati i Popullit, ankuesi, më 23 nëntor 2017, ka parashtruar kërkesë në MI për qasje në dokumentin publik, përkatësisht qasje në dosjet e tetë (8) operatorëve ekonomikë të rekomanduar për kontratë (nr. i prokurimit 205/17/2586/5-1-1 dhe me numër të brendshëm MI/17/046/511). Në po të njëjtën ditë, z. Sallahu ka pranuar përgjigje me të cilën njoftohet se i miratohet kërkesa për qasje në dokumente publike dhe ftohet në zyrat e MI-së, më 24 nëntor 2017, në orën 14:00. Megjithatë, z. Sallahu pohon se të gjithë operatorëve tjerë MI-ja u kishte lejuar qasje nga 23 nëntor deri më 24 nëntor 2018, ndërsa atij i ishin lënë vetëm 2 orë në dispozicion. Si rrjedhojë, z. Sallahu, nëpërmjet e-mailit, kishte kërkuar vazhdimin e kohës për qasje, por, edhe pse gojarisht i është premtuar vazhdimi i kohës për qasje për datën 27 nëntor 2017, atij në këtë ditë nuk iu lejua qasja. Duke iu referuar nenit 10 të LQDP-së, ankuesi, më 29 nëntor 2017, i është drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP).

Avokati i Popullit, më 18 janar, më 7 mars dhe më 17 prill 2018, i është drejtuar me shkresa ministrit, përkatësisht Sekretarit të Përgjithshëm në MI, me të cilat ka kërkuar informata lidhur me veprimet që kjo Ministri i ka ndërmarrë përkitazi me çështjen e z. Naim Sallahut. Më 26 qershor 2018, përfaqësuesja e IAP-së është takuar me Sekretarin e Përgjithshëm në MI, dhe përkundër pohimit të tij që do t'i përgjigjen ankuesit dhe Avokatit të Popullit në shkresat e dërguara, deri më sot Avokati i Popullit nuk ka pranuar përgjigje.

Avokati i Popullit vëren se mostrajtimi i kërkesës së ankuesit nga MI-ja, përveçse është në kundërshtim me LQDP-në, bie ndesh edhe me Ligjin nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht me parimin e administratës së hapur, të përcaktuar me nenin 9, paragrafi 1, sipas të cilit: *“Organet publike duhet të veprojnë me transparencë.”* Për më tepër, mungesa e një vendimi në formën e përcaktuar me ligj tërheq më vete edhe mungesën e njoftimit të palës për të drejtën në ankesë, gjë që paraqet edhe shkelje të së drejtës në përdorim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit konstaton se MI-ja, përveçse ka dështuar t'i përmbushë obligimet që burojnë nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës [neni 41], nga LQDP-ja dhe nga Ligji për Prokurimin Publik, kjo Ministri po ashtu ka dështuar t'i përmbushë obligimet që burojnë nga Ligji për Avokatin e Popullit [neni 25], në bazë të të cilit, të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij. Ndërsa refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative, duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyt në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare.

Për më tepër, Avokati i Popullit, vlerëson se qëllim i miradministrimit të organeve të administratës publike, ndër të tjera, duhet të jetë edhe krijimi i praktikave të mira, duke promovuar një kulturë administrative të harmonizuar dhe të fokusuar te qytetarët, e cila mëson nga bashkëveprimi me qytetarët dhe shoqëria civile. Avokati i Popullit i rekomandoi MI-së që ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t'i përgjigjet atij, në pajtim me LQDP-në dhe me legjislacionin përkatës në fuqi, e po ashtu t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Letër rekomandim – Ankesa nr. 519/2018

Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16, paragrafi 1 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 24 korrik 2018, ka pranuar ankesën e z. Miftar Gashit kundër Komunës së Ferizajt, për shkak të refuzimit të kërkesës për qasje në dokumente publike.

Në bazë të deklaratës së ankuesit dhe dokumenteve që kemi, me aktvendimin e datës 9 korrik 2018, atij i është refuzuar kërkesa për qasje në dokumente publike lidhur me procedurat e largimit të tij nga pozita teknikut të dhëmbëve në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, e cila kërkesë ka bazueshmëri të plotë në Ligjin për Qasje në Dokumente Publike nr. 03/L-215.

Më 13 gusht 2018, zyrtarja për Qasje në Dokumente Publike në Komunën e Ferizajt e ka njoftuar përfaqësuesin e Avokatit të Popullit se kërkesa e z. Gashit për qasje në dokumente publike nr. 68663/18, e datës 2 korrik 2018, është refuzuar për shkak se dokumentacionin e njëjtë ai e ka pranuar gjatë muajit janar të vitit 2018. Gjithashtu, palës lidhur me kërkesën e tij i është lëshuar aktvendimi për refuzimin e qasjes në dokumente publike më 9 korrik 2018.

Avokati i Popullit vëren se në rastin e ankuesit Komuna ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve pozitive lidhur me mundësimin, përkatësisht lejjimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar nga ankuesi, e cila e drejtë është e sanksionuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare.

Avokati i Popullit kupton se LQDP-ja, neni 12, paragrafi 1 parasheh arsyet e përjashtimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni përcakton se: *“Qasja në informata të përmbajtura në një dokument mund të refuzohet nëse zbulimi i tyre dëmton apo ka mundësi të dëmtojë, cilindo nga interesat e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, përveç nëse nuk ekziston ndonjë interes publik më i lartë për të bërë zbulimin”*.

Avokati i Popullit vëren se, LQDP nr. 03/L-215, në asnjë rast nuk përmban ndonjë kufizim lidhur me përsëritjen e kërkesës për qasje në dokumente publike. Prandaj, aktvendimi i datës 9 korrik 2018, me të cilin është refuzuar kërkesa e palës për qasje në dokumente publike, me arsyetim se kjo kërkesë është përsëritur, bie në kundërshtim të plotë me nenin 11, paragrafi 3 të këtij ligji, ku shprehimisht thuhet: *“Nëse dokumenti i plotë ose i pjesshëm, është kërkuar një apo më shumë herë më parë, nga i njëjti kërkuar, nëse institucioni ka dëshmi se informacioni publik ose dokumenti zyrtar është keqpërdorur më parë nga kërkuar, ... qasjen në informatë apo dokument mund ta kontestojë, respektivisht dhënien e tij, mund ta refuzojë në tërësi ose një pjesë përkatëse të tij”*.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), që sipas neni 53 të Kushtetutës, paraqet bazë për interpretimin e të drejtave të njeriut. Në rastin *Observer and Guardian V. The United Kingdom*, GjEDNj-ja ka vlerësuar se: *“T’i mohosh publikut informacione mbi funksiononim e organeve të shtetit, do të thotë të shkelësh të drejtën themelore të demokracisë.”*

Avokati i Popullit konstaton se kërkesa e ankuesit për qasjen në dokumentet publike lidhur me procedurat e largimit të tij nga pozita “teknik i dhëmbëve” në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Ferizaj, si e tillë ka bazueshmëri të plotë në LQDP nr. 03/L-215, ku në nenin 1 të tij shprehimisht thuhet: *“Ky ligj garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike”*. Për më tepër, një kërkesë e tillë është posaçërisht e justifikueshme, sepse në rastin e ankuesit kemi të bëjmë me kërkesën lidhur me dokumentacionin që lidhet kryesisht me çështjen e ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Avokati i Popullit konstaton se Aktvendimi i datës 9 korrik 2018, me të cilin është refuzuar kërkesa e ankuesit për qasje në dokumente publike, nuk është i përpiluar në përputhje me nenin 11, paragrafi 3 të LQDP, ku thuhet: *“ ... nëse institucioni ka dëshmi se informacioni publik ose dokumenti zyrtar është keqpërdorur më parë nga kërkuar, ... qasjen në informatë apo dokument mund ta kontestojë, respektivisht dhënien e tij, mund ta refuzojë në tërësi ose një pjesë përkatëse të tij”*. Ndërsa në arsyetimin e aktvendimit në fjalë nuk përmban asnjë përkrahim për keqpërdorimin e këtij dokumentacioni nga ana e ankuesit në ndonjë rast. Përkundrazi, vendimmarrësi as që është lëshuar në formulimin e arsyetimit të këtij aktvendimi, çka është dashur ta bënte duke iu referuar paragrafit 3 të nenit 11 të LQDP, për të justifikuar refuzimin e kërkesës së ankuesit.

Prandaj, me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për qasje në dokumente publike, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve në raport me kërkesat e qytetarëve, që ata ta realizojnë këtë të drejtë në mënyrë sa më efektive, Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Ferizajt që në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, t'i ofrojë ankuesit qasje në dokumentet publike lidhur me kërkesën e tij të parashtruar më 2 korrik 2018, si dhe të ndërmarrë hapa për ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve publikë lidhur me zbatimin Ligjit për Qasje në Dokumente Publike.

Mendimet Juridike të Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*)

Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në lidhje me çështjen e interpretimit të konceptit të “përvojës së punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike

Më 31 janar 2018, Avokati i Popullit publikoi Mendimin Juridik në lidhje me çështjen e interpretimit të konceptit të “përvojës së punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike. Ky Opinion Juridik i Avokatit të Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës, ka për qëllim ofrimin e ndihmës ligjore për krijimin e mundësisë së një interpretimi të drejtë të konceptit “përvojë e punës” në kontekstin e konkurseve për punësim në institucione publike që herë-herë paraqitet si mjaft sfidues për zbatuesin e ligjit, e me premisa të shkeljeve të mundshme të të drejtave të njeriut.

Për sa i përket çështjes nëse përvoja e punës e fituar përpara diplomimit duhet të llogaritet si pjesë e përvojës minimale që kërkohet për punësim, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *KPMK*) dhe Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore të Prishtinës (në tekstin e mëtejshëm *Gjykata*), kanë shprehur qëndrimin se “përvoja e punës” **nuk** përfshin përvojën e fituar përpara diplomimit.

Me Vendimin në lëndën nr. 02/471/2014, i nxjerrë me datën 12 dhjetor 2014, *KPMK*-ja ka trajtuar një ankesë kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, lidhur me dy vende të punës: “Zyrtar i lartë i verifikimit të të dhënave për letërnjoftime” dhe “Zyrtar i lartë i digjitalizimit të librave” (shih *po aty*, f. 1). Për vendin e parë “Zyrtar i lartë i verifikimit të të dhënave për letërnjoftime”, ndër kriteret kualifikuese kanë qenë “përgatitja universitare në shkencat ekonomike, juridik apo menaxhment” dhe “tri (3) vjet përvojë pune në përpunimin e të dhënave” (*po aty*, f. 3).

KPMK-ja ka vendosur se kandidati fitues nuk ka plotësuar kërkesën e përvojës trivjeçare, sepse “përvoja e punës e fituar para datës së diplomimit nuk merret parasysh si përvojë pune e kërkuar për një vend pune me kualifikim superior dhe sipas kësaj kandidatja e pranuar nuk e ka plotësuar kriterin e konkursit për përvojë pune pas datës së diplomimit” (*po aty*, f. 4). Megjithatë, për pretendimin që nuk mund të llogaritet përvoja e punës e fituar përpara diplomimit, *KPMK*-ja nuk ofron asnjë argument.

Të njëjtin përfundim si *KPMK*-ja, e ka arritur edhe *Gjykata* në Aktgjykimin e saj në rastin nr. 2276/2014, i nxjerrë më datën 24 maj 2016. Në këtë rast bëhej fjalë për “vendin e lirë të punës - operator i futjes së të dhënave në programin e tatimit në pronë, në Drejtorinë e Financave dhe Pronës të Komunës së Prishtinës” (*po aty*, f. 2). Sipas *Gjykatës*, “komisioni përzgjedhës (...) nuk ka vlerësuar drejtë përvojën e punës së kandidatëve përzgjedhës, ngase sipas provave që gjinden në shkresat e lëndës nuk i kanë plotësuar kushtin e konkursit ‘tri vite përvojë pune’” (*po aty*, f. 2). Arsyetimi i *Gjykatës* ishte njësoj si ai i *KPMK*-së: “*Gjykata* vlerëson se përvoja e punës në profesion duhet të

llogaritet, pas datës së diplomimit, të kandidatit, e jo (...) duke e llogaritur përvojën e punës së kandidatëve edhe para diplomimit të tyre” (*po aty*, f. 3).

Ndryshe nga KPMK-ja, Gjykata ka dhënë një argument për qëndrimin e saj. Sipas Gjykatës, llogaritja e përvojës së punës të fituar përpara diplomimit “është në kundërshtim me parimet e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht nenit 11.1 të tij, i cili përcakton se ‘Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve” (Aktgjykimi, f. 3, duke cituar Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës). Sipas Gjykatës, “nga interpretimi i drejtë i kësaj dispozite ligjore, ‘aftësia profesionale’ e kandidatëve nuk mund të merret para diplomimit të tyre në atë profesion, sepse vetëm pas diplomimit të tyre ata mund të quhen si profesionist dhe me përvojë pune në profesion” (Aktgjykimi, f. 3).

Mirëpo, ky argument i Gjykatës nuk është bindës, për dy arsye. Së pari, Ligji për Shërbimin Civil përcakton: “Nëpunësit civil punësohen në bazë të meritës, pasi t’i jenë nënshtruar procedurës përzgjedhëse, e përcaktuar në bazë të këtij ligji dhe **akteve përkatëse nënligjore.**” (*po aty*, neni 3, par. 2; theks i shtuar). Po ashtu, Ligji nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil përcakton: “Klasifikimi i përgjithshëm i pozicioneve të punës në Shërbimin Civil, standardet dhe procedurat për klasifikimin e secilës pozitë në gradën përkatëse, në bazë të përshkrimit të punës, si dhe përcaktimi i hapave të pagës, **përcaktohen nga Qeveria me akte nënligjore**, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për financa” (*po aty*, neni 6, par. 10; theks i shtuar).

Siç e bëjnë të qartë këto dispozita, është kompetencë e Qeverisë, me nxjerrjen e akteve nënligjore, që t’i përcaktojë kriteret minimale të çdo vendi të punës, në kuadër të klasifikimit të të gjitha vendeve të punës. Këtë përcaktim të kriterëve e ka kryer Qeveria me nxjerrjen e Rregullores nr. 05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil. Në këtë klasifikim përcaktohen gjithsej 14 grada të pagës (shih *po aty*, neni 6, par. 1). Për secilën gradë përcaktohen kushtet minimale për vendet e punës së asaj grade, duke përfshirë diplomë universitare dhe një sasi përvoje të punës. Mirëpo, në asnjë rast dhe për asnjë gradë nuk përcaktohet se përvoja e punës duhet patjetër të jetë fituar pas diplomimit. Shih, p.sh. nenin 13 “Niveli drejtues dy (2) – grada e pagës gjashtë (6)”, i cili kërkon “[d]iplomë universitare dhe së paku pesë (5) vite përvojë pune” (*po aty*, neni 13, par. 2, nënpar. 7). Prandaj, qëndrimi i KPMK-së dhe Gjykatës Themelore mbi këtë çështje nuk ka asnjë bazë në tekstin e Rregullores.

Së dyti, pretendimi i Gjykatës që “‘aftësia profesionale’ e kandidatëve nuk mund të merret para diplomimit të tyre në atë profesion” (Aktgjykimi, f. 3), është i gabuar. Është e vërtetë se Ligji për Shërbimin Civil përcakton se “[p]ranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e (...) aftësisë profesionale” (*po aty*, neni 11, par. 1),

por kjo dispozitë nuk thotë shprehimisht se “aftësia profesionale” mund të dëshmohet vetëm me përvojë pune pas diplomimit por jo edhe me përvojë përpara diplomimit.

Vlen të theksohet këtu se, për të gjitha vendet e punës në shërbimin civil, kushti që kandidatët të kenë përfunduar një periudhë të caktuar të përvojës së punës është kusht *përjashtues*, në kuptimin që kandidatët të cilët nuk kanë përvojën e duhur nuk kanë të drejtë as të futen në konkurs. Prandaj, në mënyrë që trupi vlerësues të ketë mundësi të konsiderojë sa më shumë kandidatë që të jetë e mundur, është e domosdoshme të interpretohet koncepti i “përvojës së punës” në mënyrën sa më të gjerë të mundshme.

Mirëpo, njëkohësisht, një interpretim i tillë liberal nuk do të thotë aspak se trupi vlerësues e ka për detyrë të vlerësojë përvojat e të gjithë kandidatëve njësoj. Është krejt normale që trupi vlerësues, kur i krahason të gjithë kandidatët që e kalojnë pragun minimal të përvojës së punës, të marrë parasysh *naturën* dhe *cilësinë* e përvojës që secili kandidat përkatës paraqet në aplikim. Ky proces i krahasimit të hollësishëm nuk pengohet aspak nga interpretimi i gjerë i konceptit të “përvojës së punës”.

Shembulli i Bashkimit Evropian konfirmon se, të paktën në nivelin më të përgjithshëm (d.m.th. në nivelin e përcaktimit të gradave), nuk është praktikë ndërkombëtare të përcaktohen kritere specifike për vlerësimin e përvojës së punës, përveçse të theksohet, sikurse në Rregulloren 5/2012 të Republikës së Kosovës, se përvoja duhet të jetë “relevante”. Për shembull, ueb-faqja e Zyrës Evropiane për Përzgjedhjen e Personelit tregon:

“Pozita e një udhëheqësi dallon në gradë prej AD 5 deri në AD 16, ku grada AD 5 është niveli minimal që kërkohet për këtë vend pune për ata që kanë diplomë universitare. Përzgjedhja dhe rekrutimi mund të bëhet edhe për grada më të larta AD 6 ose AD 7 për detyrat që janë më të veçanta, ku kandidati do të duhej të dëshmojë disa vite të përvojës relevante të punës. Gradat nga AD 9 – AD 12 janë për pozitat e nivelit të menaxhmentit të mesëm. Përzgjedhja/rekrutimi për këto grada kërkon përvojë paraprake në menaxhment” (theks i shtuar).⁴³⁸

Edhe pse nuk ka ndonjë formulë ekzakte për vlerësimin e përvojës së punës, që mund të vlejë për të gjithë shërbimin civil, mund të theksojmë se kjo nuk pengon aspak që shpallja e konkurseve të përfshijë kritere të hollësishme në mënyrën që praktikohet në shtete të tjera.

Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.252/2018 në lidhje me kërkesën për shqyrtimin e Kushtetutshmërisë në rastin KI-108/18

Më 26 shtator 2018, Avokati i Popullit i dërgoi Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), i cili ka për qëllim ta argumentojë bazën ligjore dhe të ofrojë një analizë ligjore përkitazi me rastin

⁴³⁸https://epso.europa.eu/how-to-apply_en.

KI-108/2018, të parashtreses znj. Rina Kika, avokate e autorizuar nga z. Blert Morina për shqyrtimin e pranueshmërisë së kësaj çështjeje nga Gjykata Kushtetuese. Avokati i Popullit i referohet parashtresit të kërkesës në gjininë mashkullore, për shkak se kjo është gjinia me të cilën ai identifikohet, pa paragjykuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese lidhur me kërkesën. Qëllimi i këtij Mendimi Juridik është ta mbështesë kërkesën për lirim nga detyrimi i shterimit të të gjitha mjeteve juridike, për shkak se rrethanat e rastit e bëjnë pritjen e procedimit të padisë nga Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative mjet joefektiv dhe të papërshtatshëm.

Garancitë procedurale të së drejtës për një Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm janë të zbatueshme në procedurat administrative, të cilat i nënshtrohen rishikimit gjyqësor – duke e konsideruar si pjesë të tërësisë së procesit gjyqësor (trial as a whole). Parimi i shtetit të së drejtës, si parim themelor i Kushtetutës dhe Konventës, obligon organet shtetërore ta respektojnë/zbatojnë legjislacionin e aprovuar nga legjislativi i vendit. Garancitë kushtetuese për të drejtat e njeriut janë vlera themelore të shoqërisë demokratike që i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut, lirisë dhe barazisë, sepse këto vlera janë baza themelore për funksionimin e shtetit dhe së drejtës, si dhe janë parakusht i respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve.

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) në praktikën e saj thekson: *“Do të ishte në kundërshtim me parimin e shtetit të së drejtës, nëse do t’i lihej ndonjë diskrecion ligjor ekzekutiv. Rrjedhimisht, ligji duhet të tregojë qëllimin e çdo diskrecioni të tillë dhe mënyrën e ushtrimit të tij me qartësi të mjaftueshme, për t’i dhënë mundësi individit në mbrojtje adekuate kundër arbitraritetit”* (Shih Vendimin e GjEDNj-së në rastin *Malone kundër Mbretërisë së Bashkuar*, i datës 2 gusht 1984 § 68).

Si pjesë përbërëse e parimit të sigurisë juridike garantohet edhe parimi i pritjes legjitime. *“Në bazë të doktrinës së pritjes legjitime, ata të cilët veprojnë me mirëbesim dhe në përputhje me ligjin, nuk duhet të jenë të frustruar nga pritjet e tyre legjitime. Kjo doktrinë nuk gjen zbatim vetëm në procedura të ligj dhënies, por edhe në nxjerrjen e vendimeve në rastet individuale nga autoritetit publik”* (Shih Vendimin e GjEDNj-së *Anhaeuser-Busch Inc. kundër Portugalisë*, 73049/01, i datës 11 janar 2007 § 65). Po ashtu, siguria juridike nënkupton që ligji të jetë i qartë dhe i zbatueshëm dhe që ai zbatohet në praktikë.

Sipas jurisprudencës së GjEDNj-së, (shih rastet *Kopecky v. Slovakia*, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, para 45-52; *Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke* (dec.), nr. 39794/98, para 73, GjEDNj 2002-VII), “pritja legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore ose në akte ligjore. Në rastin konkret, pritja legjitime për ndërrim të emrit dhe shënimit të gjinisë ishte bazuar në nenin 3, paragrafi 1.9 të Ligjit nr. 05/L-020 për Barazi Gjimore, në nenin 12 dhe 17 të Ligjit nr. 02/L-18 për Emrin Personal, dhe në Udhëzimin Administrativ të Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) nr. 19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal.

Avokati i Popullit gjen se, sipas praktikës së GjEDNj-së, lidhur me shterimin e mjeteve juridike parashtruesit e kërkesës duhet t'i shterin mjetet juridike efektive që i kanë në dispozicion para se çështja të kalojë në Gjykatë Kushtetuese, por ato duhet të garantojnë efektivitet dhe efikasitet. Sipas GjEDNj-së, rregulli i shterimit të mjeteve juridike duhet të zbatohet me një shkallë fleksibiliteti dhe pa formalizëm të tepruar duke sqaruar se rregulli i shterjes së mjeteve juridike nuk është absolut dhe nuk duhet të zbatohet në mënyrë automatike, por është më rëndësi të merren parasysh rrethanat e posaçme të secilit rast individual. GjEDNj-ja sqaron se duhet marrë parasysh jo vetëm ekzistimin e mjeteve juridike në sistemin ligjor të vendit në fjalë, por edhe kontekstin e përgjithshëm ligjor në të cilin veprohet, si dhe rrethanat personale të parashtruesit të kërkesës (shih aktgjykimin e GjEDNj-së në rastin *Akdivar kundër Turqisë*, i 16 shtatorit 1996.)

Kërkesa e parashtruesit të kërkesës që të lirohet nga detyrimi i shterimit të të gjitha mjeteve juridike bazuar në mungesën e mjetit efektiv dhe efikas si mjet juridik i papërshtatshëm dhe joefektiv në lidhje me rastin në shqyrtim e ka bazuar edhe në Raportin e Përgjithshëm Vjetor 2017 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, ku statistikisht tregojnë se janë gjithsej 5,304 lëndë të pazgjidhura, ndërkaq sipas Raportit të tremujorit të parë të vitit 2018, raportohet se janë gjithsej 5,297 lëndë administrative të pazgjidhura. Koha e llogaritur e zgjidhjes së lëndëve administrative në vitin 2017, sipas këtyre të dhënave, për një rast, sipas znj. Kika, llogaritet të jetë përafërsisht 853 ditë në shkallë të parë, ndërsa koha e llogaritur e zgjidhjes së lëndëve administrative për një rast llogaritet të jetë përafërsisht 412 ditë në shkallë të dytë. Rrjedhimisht, znj. Kika konsideron se koha mesatare e llogaritur për zgjidhjen e një lënde administrative që procedohet në Gjykatën Themelore dhe në Gjykatën e Apelit është 3 vjet e 4 muaj.

Duke marrë parasysh këtë vonesë të tej zgjatur, procedimi i rastit nëpër gjykatat e rregullta nuk mund të cilësohet si mjet efektiv, në kontekstin e kërkesës që parashtruesi të shterojë të gjitha mjetet juridike përpara se ta paraqesë rastin tek Gjykata Kushtetuese. Praktikën e kësaj Gjykate e vërtetojnë këtë konstatim. Përkatësisht, në rastet nr. KI99/14 dhe KI100/14, parashtrues Shyqyri Sylja dhe Laura Pula, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (2014), kjo Gjykatë ka trajtuar kërkesën që të anulohet procedura e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit. Në Aktgjykimin e këtij rasti, Gjykata ka konstatuar se kërkesa e parashtruesve ishte e pranueshme, duke pohuar se: *“Edhe në qoftë se ka mjete juridike, në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase. Për më tepër, duke marrë parasysh specificitetin e procedurës së zgjedhjes për postin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim”* (po aty, § 50; theks i shtuar).

Rasti i znj. Kika është i ngjashëm me këtë rast, në të dyja aspektet. Së pari, njësoj si në rastin e zgjedhjes së Kryeprokurorit, në rastin e znj. Kika, *“edhe në qoftë se ka mjete*

juridike, në rastin e parashtruesit nuk janë dëshmuar si efikase". Përkundrazi, në bazë të statistikave të lartpërmendura, Avokati i Popullit konstaton jo vetëm se mjetet juridike "nuk janë dëshmuar si efikase", por edhe se mjetet juridike janë dëshmuar pozitivisht si joefikase. Së dyti, në rastin e zgjedhjes së Kryeprokurorit, kjo Gjykatë ka theksuar "domosdoshmërinë që [procedura e zgjedhjes] të bëhet në kohën e duhur". Për shkak të kësaj urgjence, Gjykata ishte "e mendimit që nuk ka mjete juridike për shterim". Po ashtu, Avokati i Popullit e konsideron rastin e z. Morina si urgjent dhe, prandaj, konsideron se është e domosdoshme që rasti të zgjidhet "në kohën e duhur" dhe sa më shpejt që të jetë e mundur.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen tek rasti i GjEDNj-së i përmendur më lart *Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar* [Grand Chamber], GjEDNj, Aplikimi Nr. 28957/95 (2002). Në këtë rast, Gjykata Evropiane ka theksuar: "Duhet pranuar se mund të krijohet ndërhyrje serioze në jetën private kur gjendja e ligjit të brendshëm bie në konflikt me një aspekt të rëndësishëm të identitetit personal" (po aty, § 77). Kjo për arsye se: "Stresi dhe tjetërsimi, të cilat rrjedhin prej një mospërputhje ndërmjet pozitës në shoqëri të adoptuar nga një transseksual pas operimit dhe statusit të imponuar nga ligji që refuzon ta njohë ndryshimin në gjini, nuk mund (...) të shihen si një shqetësim i parëndësishëm që rrjedh prej një formaliteti" (po aty, theks i shtuar). Përkundrazi, "[k]rijohet një konflikt ndërmjet realitetit shoqëror dhe ligjit që e vë transseksualin në një pozitë të çrregullt, në të cilën ai ose ajo mund të përjetojë ndjenja të cenusshmërisë, poshtërimit dhe ankthit" (po aty, theks i shtuar).

Avokati i Popullit konstaton se znj. Kika, mungesën e mjetit efektiv dhe efikas e ka bazuar në mundësitë reale që Gjykata Themelore të mos e vendosë rastin sipas meritave por vetëm ta kthejë në procedurë administrative që e bën kohëzgjatjen e procedurës së paku dyfish më të gjatë duke theksuar se Avokati i Popullit në Raportin *ex officio* nr. 425/2015 dhe në rastin *A.nr.72/2015*, lidhur me mungesën e mjeteve efektive juridike drejtuar Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale dhe Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka konstatuar se në kontestet administrative gjykatat në asnjërin nga procedurat e përkatëse nuk janë lëshuar në shqyrtimin e meritave të rastit por vetëm kanë konstatuar shkeljet procedurale dhe kanë vendosur se rastet kthehen në rishqyrtim tek organi i cili e ka marrë fillimisht vendimin dhe ai vendos sërish njëjtë dhe pala sërish paraqet padi pranë gjykatës. Ndër të tjera, Avokati i Popullit ka konstatuar se te këto raste ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut nga se paditë e ushtruara nga ankuesit në cilësi të mjetit efektiv juridik ishin joefikase dhe nuk siguronin realizimin e të drejtës që u takonte me ligj.

Avokati i Popullit konstaton se, bazuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me trajtimin e çështjeve pa i shteruar mjetet juridike në rastet *Tomë Krasniqi kundër Radio Televizionit të Kosovës dhe Korporatës Energjetike të Kosovës*, Numri i Lëndës KI 11/09, datë 16 tetor 2009, si dhe në rastin *Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë*

së Drejtësisë, Numri Lëndës KI 06/10, datë 30 tetor 2010, kishte qasje fleksibile ndaj shterjes së mjeteve juridike, me ç' rast parashtruesit kishin kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve juridike edhe pa i shterur mjetet juridike në gjyqësorin e rregullt, Gjykata Kushtetuese kishte konstatuar se parashtruesit nuk kishin qasje në mjet juridik efektiv dhe kishte lejuar shfrytëzimin e këtij juridiksioni pa i shteruar mjete juridike, prandaj përshtatshmërisht mund të konstatohet se kemi situatë të njëjtë edhe në rastin e parashtrueses së kërkesës.

Avokati i Popullit ka parasysh faktin se Gjykata Kushtetuese ka juridiksion *Ex post*, sepse mekanizmi i kontrollit të kushtetutshmërisë në një shkelje të supozuar individuale, aktivizohet pasi parashtruesi/ja të ketë pësuar ndonjë pasojë nga shkeljet eventuale të së drejtës kushtetuese, por në raste të caktuara mund të jetë fleksibile, meqenëse ekzistojnë situata ku lejohet shfrytëzimi i këtij juridiksioni pa i shteruar mjetet juridike me kusht që të vlerësohet interesi i drejtpërdrejtë i parashtruesit/es, pasi që duhet dëshmuar se është viktimë e shkeljes nga autoriteti publik i shtetit (shih rastin *Scordino kundër Italisë Nr.36813/97*), prandaj përshtatshmërisht kjo situatë po proklamohet edhe në rastin në shqyrtim.

Avokati i Popullit konstaton se parashtruesja e ankesës ka ofruar prova të mjaftueshme për shqyrtimin e kësaj çështjeje nga Gjykata Kushtetuese, duke kërkuar të lirohet nga detyrimi i shterimit të të gjitha mjeteve juridike, për shkak se rrethanat e rastit e bëjnë pritjen e procedimit të padisë nga Gjykata Themelore mjet joefektiv dhe të papërshtatshëm. Avokati i Popullit ka lëshuar disa raporte me rekomandime, me të cilat ka konstatuar se në shumë raste pritja e procedimit të shqyrtimit të padisë nga Gjykata Themelore është dëshmuar mjet joefektiv dhe i papërshtatshëm, duke pasur parasysh zvarritjet e procedurës gjyqësore deri në shqyrtimin e rasteve. Prandaj, nga sfondi i rasteve të mëhershme kemi gjetur se edhe kur rasti shqyrtohej, nga gjykata nuk nxirrej vendim meritor, por rasti kthehej në rishqyrtim tek organi i shkallës së parë, i cili në rishqyrtim nuk vepronte sipas rekomandimeve të gjykatës, por sërish e refuzonte kërkesën dhe kësaj gjendja futej në një rreth vicioz, i cili në shumë raste ka zgjatur për shumë vjet.

Gjithashtu, Avokati i Popullit konstaton se, bazuar në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, lidhur me trajtimin e çështjeve pa i shteruar mjetet juridike në rastet ku parashtruesit kishin kërkuar vlerësimin e kushtetutshmërisë së akteve juridike edhe pa i shterur mjetet juridike në gjyqësorin e rregullt, Gjykata Kushtetuese kishte qasje fleksibile dhe kishte konstatuar se parashtruesit nuk kishin qasje në mjet juridik efektiv, prandaj kishte lejuar shfrytëzimin e këtij juridiksioni pa i shterur mjete juridike,

Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.215/2018 në lidhje me iniciimin në Gjykatën Kushtetuese të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës dhe vlerësimin e pajtueshmërisë me dispozitat kushtetuese

Më 4 korrik 2018, Avokati i Popullit i drejtoi Gjykatës së Apelit Mendimin Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.215/2018, që ka të bëjë me iniciimin në Gjykatën Kushtetuese të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës dhe vlerësimin e pajtueshmërisë me dispozitat kushtetuese. Qëllimi i këtij Mendimi të dhënë nga Avokati i Popullit është njoftimi i Gjykatës së Apelit për mundësinë që ka kjo gjykatë që të iniciojë në Gjykatën Kushtetuese procedurën për vlerësimin e pajtueshmërisë së Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës.

Më 22 mars 2018, Avokati i Popullit ka pranuar ankesë nga z. Sami Mazreku, përfaqësues i tetë (8) kompanive të sigurimeve, lidhur me kontestimin e nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Po ashtu, më 30 mars 2018, Avokati i Popullit ka pranuar ankesë nga znj. Vjosa Misini – Qehaja dhe z. Ardian Rexha, përfaqësues të kompanisë së sigurimeve “Illyria” lidhur me kundërshtimin e nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës.

Ndër të tjera, Avokati i Popullit vëren se rasti Misini – Qehaja dhe Rexha gjendet në Gjykatën e Apelit, e cila ka në shqyrtim ankesën e ankuesve kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr 546/13, e cila i ka detyruar ankuesit që t'i përmbushin detyrimet për Kryqin e Kuq të Kosovës, të cilat detyrime rrjedhin nga dispozitat e Ligjit nr. 03/L-179 për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, konkretisht nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7.

Sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës, Kryqi i Kuq siguron mjete financiare nga sigurimi i obligueshëm i automjeteve, përkatësisht 1% nga bruto primi i vlerës së sigurimit të automjetit.

Avokati i Popullit vëren se në një rast krejtësisht të ngjashëm, Gjykata Kushtetuese e Kroacisë ka nxjerrë vendim nr. U-I-2441, U-I-1107/2002, i datës 12 shkurt 2003, sipas të cilit janë shfuqizuar neni 12, paragrafi 3 dhe neni 24, paragrafi 1, pika 1 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kroacisë. Dispozitat e shfuqizuara nga Gjykata Kushtetuese e Kroacisë kanë përmbajtje krejtësisht të ngjashme me nenin 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Republikës së Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë kishte theksuar se, nëse ligjvënësi ka vlerësuar se është në interes të shoqërisë që t'i përmirësojë kushtet e Kryqit të Kuq të Kroacisë, atëherë obligimin për mbështetjen e Kryqit të Kuq duhet ta bartin të gjitha subjektet ekonomike, në pajtim me mundësitë e tyre. Gjykata Kushtetuese e Kroacisë me këtë rast i referohet nenit 52 të Kushtetutës së Kroacisë, sipas të cilit: *“Secili është i obliguar që të marrë pjesë në pagimin e borxheve publike, në pajtim me mundësitë e tyre ekonomike.”*

Para se të ofrohet sqarim mbi kriteret e pranueshmërisë së një kërkesë të tillë para Gjykatës Kushtetuese, Avokatit të Popullit i rikujton Gjykatës së Apelit se praktika kushtetuese ia njuh të drejtën palës që në procedurë, derisa nuk është vendosur rasti në merita, të kërkojë nga Gjykata që të referojë kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë.

Rrjedhimisht, në përputhje me kriteret e pranueshmërisë të vendosur me Aktvendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës KO126/16, i datës 27 mars 2017, i publikuar më 1 qershor 2017, i rikujtojmë Gjykatës së Apelit se termi “Gjykatë referuese” në kuptim të nenit 113, paragrafi 8 të Kushtetutës së Kosovës, nënkupton gjyqtarin apo trupin gjykues, i cili është kompetent për të gjykuar çështjen/rastin para saj. Për më tepër, me qëllim që të parandalohet shpallja proceduralisht e papranueshme e kërkesës, trupi gjykues duhet që kërkesën për referim ta procedojë si trup gjykues, dhe jo vetëm kryetari i trupit gjykues. Për këtë arsye, Avokati i Popullit i propozon Gjykatës së Apelit që të nxjerrë Aktvendim përmes të cilit: aprovon kërkesën e parashtruesit të kërkesës për referim të çështjes në Gjykatën Kushtetuese për vlerësimin e pajtueshmërisë së nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës; pezullon procedurën e vendimmarrjes në rastin konkret deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës; njofton Gjykatën Kushtetuese se vendimi i Gjykatës së Apelit në rastin konkret varet nga zbatimi i drejtpërdrejtë i normës ligjore të kontestuar dhe se kjo e fundit nuk mund ta vendosë rastin duke mos zbatuar asnjë normë tjetër ligjore; vendos që dosja origjinale e tërë rastit t’i bartet Gjykatës Kushtetuese me qëllim që kjo e fundit të ketë prova se ekziston rasti konkret para Gjykatës së Apelit dhe se vendimi i saj varet nga vendimmarrja e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me përputhjen e normës ligjore me Kushtetutën

Më tej, Gjykata (në frymën e nenit 113, paragrafi 8 të Kushtetutës, pra trupi gjykues) duhet që Gjykatës Kushtetuese t’i sqarojë se janë plotësuar kriteret e pranueshmërisë si në vijim: gjykata referuese duhet ta ketë lëndën në shqyrtim e sipër; ligji i kontestuar duhet të zbatohet drejtpërdrejt nga gjykata referuese në lëndën në shqyrtim e sipër; pajtueshmëria me Kushtetutën e ligjit të kontestuar është parakusht për vendimin mbi çështjen në pritje; dhe gjykata referuese duhet të specifikojë se cilat dispozita të ligjit të kontestuar konsiderohen të papajtueshme me Kushtetutën.

Konkretisht, Gjykata e Apelit duhet ta njoftojë Gjykatën Kushtetuese se lënda, dosja e të cilës është dorëzuar së bashku me kërkesën për vlerësim të kushtetutshmërisë (aktvendimin e lartpërmendur), ka të bëjë me një rast/çështje e cila ende nuk është vendosur nga Gjykata. Së dyti, se trupi gjykues që e referon çështjen është kompetent për të gjykuar rastin. Së treti, se vendimi i gjykatës referuese varet pikërisht nga zbatimi apo moszbatimi i nenit 14, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7 të Ligjit për Kryqin e Kuq të Kosovës.

Arsyetimi mbi zbatimin e drejtpërdrejtë të normës ligjore të kontestuar në rastin konkret duhet të shërbejë si dëshmi për Gjykatën Kushtetuese se vendimi i Gjykatës së Apelit është i lidhur vetëm me zbatimin e nenit konkret. Nuk ekziston asnjë dispozitë në asnjërin

nga ligjet tjera në Republikën e Kosovës, i cili do të zgjidhte kontestin në mes palëve, prandaj ekziston nevoja e interpretimit të përputhshmërisë së normës ligjore me Kushtetutën.

Institucioni i Avokatit të Popullit, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruesit, vëren se janë paraqitur arsyetime substanciale të cilat ngrenë dyshime serioze se norma ligjore nga e cila varet vendimmarrja e Gjykatës së Apelit në rastin konkret mund të jetë e papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Institucioni i Avokatit të Popullit rikujton se parimi i shtetit të së drejtës obligon autoritetet publike, përfshirë gjykatat, që t'i kushtojnë rëndësi dhe kujdes të veçantë supremacisë së Kushtetutës ndaj ligjeve dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, në procedurat që zhvillohen para tyre. Rrjedhimisht, duke marrë parasysh se janë paraqitur dyshime serioze, të cilat mbështeten edhe me praktikën gjyqësore kushtetuese të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, se norma ligjore mund të jetë e papajtueshme me Kushtetutën, me qëllim të parandalimit të zbatimit të një norme të pavlefshme në nivel kushtetues, Gjykata e Apelit e Republikës së Kosovës duhet të referojë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës rastin në përputhje me nenin 113, paragrafi 8 të Kushtetutës së Kosovës.

Për më tepër, neni 113, paragrafi 8 shërben si garanci e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave themelore të individit dhe në shoqëritë demokratike është përfshirë si mekanizëm i mbrojtjes së individit nga procedura arbitrare gjyqësore, të cilat do të ishin të tilla nëse do të zbatohesh një normë që nuk është në përputhje me Kushtetutën e vendit.

Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.903/2017 në lidhje me padinë e ankuesit z. Mufail Salihaj, kundër Universitetit Publik të Prishtinës “Hasan Prishtina”

Më 29 qershor 2018, Avokati i Popullit i drejtoi Gjykatës Themelore në Prishtinë Mendim Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.903/2017, që ka të bëjë me padinë e ankuesit z. Mufail Salihaj, kundër Universitetit Publik të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Mendim Juridik përqendrohet në sqarimin e procedurave ligjore përkitazi me kufizimin e moshës si kriter për punësimin e ankuesit në pozitën e mësimdhënësit në konkursin e shpallur nga Universiteti Publik i Prishtinës “Hasan Prishtina”, gjegjësisht Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Më 24 nëntor 2016, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë kishte shpallur konkursin për pozitën *Profesor Asistent për lëndët: Fitopatologji, Epidemiologji dhe Sëmundjet e Bimëve, Sëmundjet Abiotike, Fito Bakteriologji dhe Virusologji*.

Më 13 dhjetor 2017, Avokati i Popullit pranoi ankesën e z. Mufail Salihaj (më tej *ankuesi*) parashtruar kundër Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” në Prishtinë (UP), lidhur me Vendimin e Senatit të UP-së, me nr. prot.2/885, i datës 11 tetor 2017, përkitazi me kufizimin e moshës si kriter për punësimin e tij në këtë pozitë, ndërsa më 6 prill 2018, për

të njëjtën çështje ankuesi kishte parashtruar padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, me numër të lëndës C.nr.875/2018.

Nisur nga faktet e mësipërme, Avokati i Popullit i paraqet Gjykatës Themelore në Prishtinë këtë Mendim Juridik, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), për ta njoftuar lidhur me gjetjet dhe konstatimet e tij.

Ankuesi pohon se nga Komisioni Vlerësues, në Raportin me nr.06-321, i datës 28 shkurt 2016, ai zgjidhet si kandidat që i plotëson të gjitha kushtet e konkursit për pozitën e lartcekur. Rrjedhimisht, propozohet që Këshilli i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë ta miratojë këtë raport, si dhe ankuesi të zgjidhet si Profesor Asistent për lëndët e shpallura në konkurs. Raporti recensues është miratuar nga ana e Këshillit të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë. Megjithatë, Senati i UP, në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2017, mori Vendimin nr. prot.1/501, i datës 1 qershor 2017, sipas të cilit ankuesi nuk mund të zgjidhet në pozitën e lartcekur, për shkak se, sipas Senatit, zgjedhja e tij është në kundërshtim me nenin 177, pika 1.6 të Statutit të UP, që përcakton: “*Kandidati i cili zgjidhet për herë të parë, nuk duhet të jetë më i vjetër se 50 vjet*”. Ankuesi pohon se kjo dispozitë ligjore është diskriminuese, e paarsyeshme dhe në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare.

Kundër Vendimit të Senatit të UP-së, i datës 1 qershor 2017, ankuesi parashtrroi ankesë në Komisionin e Ankesave dhe Parashtresave të Senatit të UP-së, ku mes tjerash theksoi se është i vetmi fitopatolog në Kosovë i cili ka përvojë pune prej 8 vjetësh. Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i Senatit të UP-së e refuzoi si të pabazë ankesën e ankuesit.

Më 7 shtator 2017, Senati i UP-së mbajti mbledhjen në të cilën mori Vendimin me nr.prot. 2/885, datë 11 tetor 2017, sipas të cilit, në pikën e parë (I) thuhet se miratohet propozimi i Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa, i datës 29 qershor 2017, për refuzim të zgjedhjes së kandidatit z. Salihaj, në pozitën *mësimdhënës në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë*. Në pikën e dytë (II) të këtij vendimi thuhet se Komisioni për Ankesa dhe Parashtresa i Senatit të UP-së ka shqyrtuar ankesën e kandidatit z. Salihaj, e datës 13 qershor 2017, të ushtruar kundër Vendimit të Senatit të datës 1 qershor 2017, për refuzim të zgjedhjes si mësimdhënës. Kurse në pikën e tretë (III) të vendimit thuhet se vendimi është përfundimtar për organet e universitetit. Për më shumë, në Vendimin e Senatit të UP, theksohet se, pas shqyrtimit të raportit të Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa, i datës 29 qershor 2017, në të cilin refuzohet ankesa e kandidatit z. Salihaj, e datës 13 qershor 2017, konstatohet se Komisioni i lartcekur ka shqyrtuar me kujdes ankesën e kandidatit në fjalë. Gjithashtu, bazuar në argumentet e këtij raporti, potencohet se kandidati nuk i ka punimet shkencore sipas platformës së UP-së dhe mosha e kandidatit z. Salihaj nuk është në pajtim me Statutin e UP-së.

Kundër Vendimit të Senatit të UP-së, ankuesi parashtrroi ankesë edhe në Inspektoratin e Punës (IP). Më 22 janar 2018, IP-ja nxori raportin zyrtar me nr. 01/37-142/17, lidhur me rastin e inspektimit në njësinë akademike në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë. Mes tjerash, IP-ja konstaton se procedura lidhur me rastin e ankuesit është zhvilluar në

kundërshtim me dispozitën e nenit 173, par. 2 të Statutit të UP-së, sipas së cilës dispozitë, nëse propozimi refuzohet, ai i kthehet për rishqyrtim Këshillit të njësisë akademike, që në rastin në fjalë nuk ishte vepruar në përputhje me këtë. Ndërsa, sipas dispozitës të paragrafit 3 të nenit 173, nëse Këshilli i njësisë akademike edhe pas rishqyrtimit sjell të njëjtin propozim në këtë rast, Senati nxjerr vendim përfundimtar.

Sipas vlerësimit të IP-së, vendimi me të cilin është refuzuar zgjedhja e kandidatit, nuk mund të konsiderohet përfundimtar nga organet e UP-së, nëse i njëjti nuk është kthyer paraprakisht në Këshillin e njësisë përkatëse.

Z. Salihaj, duke konsideruar se dispozita ligjore në Statutin e UP-së, të cilat përcaktojnë kufizimin e moshës si kriter për punësimin në pozitën e mësimit në UP, është diskriminuese dhe si e tillë është e kundërligjshme, parashtroua padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, e cila u evidentua me shifrën C.nr.875/2018

Avokati i Popullit në vitin 2010 kishte trajtuar një çështje për afërsisht të njëjtë, duke e konsideruar diskriminuese dispozitën e cila vendos si kriter moshën në Statutin e UP-së dhe i kishte rekomanduar UP-së që ta rishqyrtojë vendimin e atëhershëm nr. 1/499, i datës 25 maj 2010, të Senatit të UP-së.

Meqenëse nuk ishte pranuar asnjë lloj përgjigje në rekomandimet e dhëna, kishte parashtruar kërkesëpadi në gjykatë lidhur me ligjshmërinë e vendimit, që të mos rekrutojë mësimit në cilët kanë arritur moshën mbi 50 vjeçare.

Në bazë të provave dhe pas shqyrtimit të kërkesës së IAP-së, e datës 21 dhjetor 2010, lidhur me ligjshmërinë e Vendimit nr. 1/499, i datës 25 maj 2010, i Senatit të UP-së, që të mos rekrutojë mësimit në cilët kanë arritur moshën mbi 50 vjeçare, Gjykata Themelore në Prishtinë ka miratuar kërkesëpadinë e IAP-së, sipas Aktgjykimit A.nr.1242/2010, i datës 9 dhjetor 2013, si të bazuar dhe ka kërkuar anulimin e vendimit të Senatit të Universitetit të Prishtinës, nr. 1/499, i datës 25 maj 2010.

Mbi bazën e ankesës së ankuesit vërehet se Rektori i UP-së edhe më tej vazhdon të mos e zbatojë Aktgjykimin A.nr.1242/2010, i datës 9 dhjetor 2013. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se një veprim i tillë përbën shkelje të nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit 03/L-199 për Gjykatat, sipas të cilit *“Vendimet e gjykatës janë të detyrueshme për të gjithë personat fizik dhe juridik”*.

Avokati i Popullit vlerëson se parimi i sigurisë juridike është baza e shtetit të së drejtës dhe siguron besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit përmes veprimeve të organeve administrative, parim ky i cili, ndër të tjerash, konsiston në saktësinë, qartësinë dhe qëndrueshmërinë në tërësi të të gjithë rendit juridik të një shteti. Pra, jo vetëm normat e veçanta, por i gjithë rendi juridik kërkohet të jetë i kuptueshëm dhe i parashikueshëm dhe jo kundërtënë. Rrjedhimisht, sipas kësaj konstatohet se Vendimi nr. 2/885, i datës 11 tetor 2017, i Senatit të UP-së, jo vetëm që është i kundërligjshëm, por është në kundërshtim edhe me konceptin e sigurisë juridike.

Bazuar ne përfundimet e mësipërme, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës sugjeron që Gjykata Themelore në Prishtinë, gjatë vlerësimit të kësaj çështjeje, ta marrë për bazë Aktgjykimin A.nr.1242/2010, i datës 9 dhjetor 2013, si dhe të anulojë dhe përcaktojë si të kundërligjshëm dhe diskriminues Vendimin nr. 2/885, i datës 11 tetor 2017, i Senatit në UP.

Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.499/2017 në lidhje me Padinë e ankuesit z. Xhafer Kadrija, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së të Verbërve në Gjakovë, kundër Komunës së Gjakovës

Më 21 qershor 2018, Avokati i Popullit i përcolli Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjegjësisht Departamentit për Çështje Administrative, Mendimin Juridik në cilësinë e mikut të gjykatës për rastin A.nr.499/2017 në lidhje me padinë e ankuesit z. Xhafer Kadrija, Drejtor Ekzekutiv i Shoqatës së të Verbërve në Gjakovë, kundër Komunës së Gjakovës. Mendimi Juridik i Avokatit të Popullit përqendrohet në sqarimin e bazës ligjore përkitazi me lirim nga detyrimi i pagesës së tatimit në pronë për personat e verbër.

Më 19 janar 2017, Shoqata e të Verbërve në Gjakovë (ShVGj) kishte parashtruar ankesë për faturimin e tatimit në pronën e paluajtshme për personat e verbër dhe kishte kërkuar nga autoritet komunale të respektojnë nenin 6 të Ligjit nr. 04/L- 092 për Personat e Verbër, duke prezantuar dëshmi se ky ligj po zbatohet në Komunën e Prishtinës, e cila kishte miratuar Rregulloren për Tatim në Pronën e Paluajtshme 01 nr. 110-246609, datë 3 tetor 2016, e cila në nenin 7, pika 7.2, përcaktonte: *“Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme për të verbrit, do të bëhet konform dispozitave të nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-092, për Personat e Verbër dhe fillon të zbatohet nga data 1 Janar 2017.”* Bordi Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Gjakovës kishte refuzuar ankesën si e pabazuar, me arsyetimin e Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Financave që i ishte drejtuar drejtorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Gjakovës, sipas të cilit Ministria e Financave dhe komunat e Republikës së Kosovës janë të obliguara ta zbatojnë Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme nr. 03/L-204, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-100.

Më 1 gusht 2017, ShVGj-ja ka iniciuar konflikt administrativ kundër vendimit të Bordit Komunal për Shqyrtimin e Ankesave për Tatimin në Pronën e Paluajtshme të Komunës së Gjakovës, duke parashtruar padi në Gjykatën Themelore të Prishtinës, gjegjësisht në Departamentin për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, dhe lënda po zhvillohet pranë kësaj gjykate e evidentuar me shifrën A.nr.1306/2017.

Avokati i Popullit thekson se Ligji nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme është ligj i përgjithshëm (legi generalis), cili ka për qëllim vendosjen e tatimit mbi pronën e paluajtshme, përcakton standardet dhe procedura të cilat duhet t'i respektojnë komunat gjatë administrimit të tatimit në pronë. Në anën tjetër, Ligji nr. 04/L-092 për Personat e

Verbër është ligj i veçantë (lex specialis), i cili ka për qëllim rregullimin e statusit juridik të personave të verbër. Ky ligj, gjithashtu përcakton të drejtat dhe përfitimet e tyre.

Ligji 04/L-092 për Personat e Verbër ka hyrë në fuqi dy (2) vjet pas Ligjit nr.03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, si ligj special i cili garanton trajtim të dinjitetshëm të kësaj kategorie të personave në Republikën e Kosovës. Ligji nr. 04/L-092 do të vlejë si ligj i veçantë (lex specialis) ndaj të gjitha ligjeve tjera të cilat kanë qenë në fuqi apo janë aprovuar pas tij. Përfundimisht nga ky rregull bëjnë vetëm ligjet të cilat shprehimisht përcaktojnë përjashtimin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji.

Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se ligjet e lartpërmendura nuk janë në kontradiktë me njëri-tjetrin. Ligji i përgjithshëm ka paraparë kategori të caktuara të institucioneve të cilat lirohen nga tatimi në pronë. Ndërsa në anën tjetër, ligji i veçantë ka rregulluar përfitimet e një kategorie të caktuar dhe shprehimisht në nenin 6 përcakton: *“Personat e verbër lirohen nga çdo lloj takse dhe tatimi të drejtpërdrejtë...”*. Ligji nr. 03/L-204 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme, në asnjë dispozitë të tij nuk ndalon përjashtimin nga tatimi në pronën e paluajtshme të kategorive tjera. Në nenin 8 të këtij ligji janë numëruar disa nga kategoritë e liruar, por as ky ligj dhe asnjë ligj tjetër nuk ndalon legjislativin që të nxjerrë ligj të veçantë, përmes të cilit grupe të caktuara lirohen nga obligimet financiare.

Avokati i Popullit konsideron se parashtruesi i ankesës ka pasur pritje legjitime nga Ligji nr. 04/L-092 për Personat e Verbër. Parimi i sigurisë juridike i garanton individit parashikueshmërinë e efektit të ligjit, sipas formulimit të tij. Në rastin konkret, Ligji është i qartë për nga përmbajtja dhe shprehimisht u garanton personave të verbër lirin nga çdo lloj takse dhe tatimi i drejtpërdrejtë.

Mendim Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me rastin Driton Hajdari, çështja nr. ED.nr. 155/18.

Më 21 shkurt 2018, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës, iu drejtua Gjykatës Themelore në Prishtinë për rastin Driton Hajdari, çështja nr. ED.nr. 155/18, lidhur me shkeljen e së drejtës së personave të privuar nga liria për trajtim të duhur mjekësor, të garantuar me nenin 27 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 43 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, me nenin 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, me Rregullat Evropiane të Burgjeve, me Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës dhe Konventat tjera ndërkombëtare që përcaktojnë qartë obligimin e shtetit për trajtimin e personave të sëmurë të privuar nga liria.

Qëllimi i këtij Mendimi Juridik në cilësi të mikut të gjykatës është tërheqja e vëmendjes për nevojën e trajtimit adekuat shëndetësor të personave të privuar nga liria në institucionet korrektuese dhe qendrat e paraburgimit, në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve dhe aktet tjera relevante të Republikës së Kosovës dhe bazohet në ankesën e znj. Teuta Hajdari, e cila ankohet në emër të

bashkëshortit të saj z. Driton Hajdari, i cili gjendet në vuajtje të dënimit në Qendrën Korrektuese në Dubravë

Znj. Hajdari ankohet kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë lidhur me trajtimin shëndetësor dhe akomodimin e ofruar për bashkëshortin e saj z. Driton Hajdari, i cili është person i privuar nga liria dhe vuan dënimin në Qendrën Korrektuese në Dubravë. Sipas dokumenteve të pranuar nga ankuesja dhe Departamenti i Shëndetësisë në Burgje (në tekstin e mëtejme *DShB*), i dënuari në fjalë vuan nga një sëmundje e rëndë progresive për çka pacienti ka qenë i shtrirë disa herë në spital, për shkak të përkeqësimit të gjendjes shëndetësore. Nëpërmjet këtij raporti, *DShB*-ja e njoftoi Avokatin e Popullit se të dënuarit në fjalë nuk mund t'i ofrojë kujdesin e duhur shëndetësor bazuar në natyrën e sëmundjes së tij.

Më 2 shkurt 2018, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit e vizituan Klinikën e Neurologjisë, me ç'rast u takuan me personelin mjekësor dhe e vizituan pacientin. Personeli i Klinikës së Neurologjisë i njoftoi përfaqësuesit e Avokatit të Popullit me gjendjen shëndetësore të të dënuarit z. Driton Hajdari dhe me veprimet që i ka ndërmarrë deri më tani. Sipas personelit mjekësor, i dënuari nuk do të mbahet gjatë në këtë klinikë dhe do të kthehet në stacionarin e Burgut të Dubravës.

Avokati i Popullit e ka pranuar me shqetësim njoftimin nga Departamenti për Shëndetësi në Burgje (Ministria e Shëndetësisë) për të burgosurit në fjalë, në të cilin thuhet: *“Bazuar në dokumentacionin relevant të cilin e posedojmë dhe gjendjen shëndetësore të pacientit, prognozën dhe ecurinë e sëmundjes sipas të dhënave të fundit shkencore, si dhe bazuar në kushtet profesionale, arkitektonike dhe funksionale të Njësive Shëndetësore në Burgje, ju informojë si më poshtë: Ne nuk kemi ende institucione për trajtim të personave me nevoja të veçanta; ne nuk kemi mundësi për trajtimin e personave me pamundësi kujdesi për vetveten dhe me përcjellës, por vetëm kujdes infermierie 24 orësh; ne nuk kemi neurolog për trajtim të vazhdueshëm sipas rekomandimeve të Klinikës së Neurologjisë dhe indikacioneve shëndetësore; ne po ashtu nuk kemi në listën tonë esenciale barëra për trajtimin e një sëmundjeje të tillë të avancuar e cila është specifike dhe e nivelit terciar e për të cilën QKUK ka vështirësi për furnizim të tillë.”*

Bazuar në këtë raport, organi kompetent i cili vepron në emër të shtetit, thekson se ky institucion nuk mund t'i ofrojë të dënuarit shërbimet mjekësore dhe trajtimin në pajtim me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta, në nenin 27, shprehimisht përcakton: *“Askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues.”*

Po ashtu, Kushtetuta e Republikës së Kosovës garanton se askush nuk i nënshtrohet torturës, ndëshkimit a trajtimit mizor, çnjerezor ose poshtëruës. Për më shumë, Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton: *“Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”*.

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, e cila është në mesin e konventave ndërkombëtare të inkorporuara në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të cilat zbatohen drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike, përcakton obligimet pozitive të shtetit bazuar në nenin 3 të kësaj Konvente. Po ashtu, neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e Kosovës, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Neni 3 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut shprehimisht përcakton: *“Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose dënimeve ose trajtimeve çnjerezore ose degraduese”*. Në kuptim të nenit 3 (Ndalimi i torturës dhe trajtimit poshtëruës) të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut shteti duhet të sigurojë se personi i privuar nga liria mbahet në kushte të cilat janë në pajtueshmëri me respektin ndaj dinjitetit të tij njerëzor, se mënyra dhe metoda e ekzekutimit të masës nuk e nënshtrojnë të privuarin nga liria ndaj ankthit apo vështirësisë të një intensiteti të nivelit të pashmangshëm të vuajtjes së natyrshme në paraburgim dhe duke pasur parasysh kërkesat praktike të burgimit, gjendja e tij shëndetësore dhe mirëqenia të mbrohen në mënyrë adekuate, përveç të tjerash, duke ia siguruar atij ndihmën e duhur mjekësore.

Në rastin *Mouisel kundër Francës*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjeti shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut lidhur me trajtimin mjekësor të të burgosurit me sëmundje terminale. Gjykata theksoi obligimin pozitiv të shtetit për të ofruar trajtim të duhur mjekësor. Po ashtu në rastin *Tekin Yildiz kundër Turqisë*, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjeti shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke theksuar në veçanti se gjendja shëndetësore e parashtruesit të kërkesës vazhdimisht u konstatua si e papajtueshme me paraburgimin dhe se në këtë rast nuk pati elemente për të dyshuar në konstatimet e tilla. Autoritetet vendore të cilat kishin vendosur për ta kthyer parashtruesin e kërkesës në burg dhe ta mbajnë aty edhe për afërsisht tetë muaj, pavarësisht mungesës së ndryshimeve në gjendjen e tij shëndetësore, nuk mund të konsideroheshin të kenë vepruar në pajtim me kërkesat e nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Vuajtja e cila iu shkaktua parashtruesit të kërkesës kishte shkuar përtej nivelit që në mënyrë të pashmangshme lidhet me paraburgimin dhe trajtimin në kushte të vuajtjes nga sëmundja, siç është sindromi *Wernicke-Korsakoff*, përbënte trajtim çnjerezor dhe degradues. Gjykata po ashtu konstatoi se shkelja e nenit 3 të Konventës do të ndodhte edhe nëse parashtruesi i kërkesës do të kthehej në burg pa një përparim domethënës të gjendjes së tij shëndetësore për të përballuar një lëvizje të tillë.

Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (në tekstin e mëtejshëm *KPT*) në raportin për vizitën në Spanjë, në prill të vitit 1994, lidhur me gjetjet sa i përket trajtimit të të dënuarve me sëmundje serioze apo në fazën terminale të jetës, u rekomandoi autoriteteve spanjolle: *“KPT thekson se të gjithë pacientët, pavarësisht gjendjes së tyre serioze, përfshirë ata në fazën terminale të sëmundjes, duhet të trajtohen në atë mënyrë që të respektohet dinjteti i tyre njerëzor.”*

Rregulli 43 i Rregullave Evropiane të Burgjeve përcakton obligimin e shtetit që të tregojë konsideratë të veçantë ndaj të burgosurve, të cilët sëmuren aq shumë sa që kalojnë në fazën terminale të jetës.

Rregullat Minimale Standarde të OKB-së për Trajtim të Burgosurve, apo siç quhen ndryshe Rregullat e Mandelës, përcaktojnë: *“Të gjithë të burgosurit duhet të trajtohen me respekt për shkak të dinjitetit të tyre të pandashëm dhe të vlerësohen si qenie njerëzore. Asnjë i burgosur nuk duhet t’i nënshtrohet dhe të gjithë të burgosurit duhet të mbrohen nga tortura dhe nga trajtimet, a ndëshkimet tjera të vrazhda, çnjerëzore ose poshtëruese, për të cilat veprime nuk mund të ketë justifikim në asnjë rrethanë.”*

Më tej në Rregullin 24 (trajtimi shëndetësorë) të Rregullave të Manadelës përcaktohet përgjegjësia e shtetit për të ofruar shërbimet mjekësore ndaj të burgosurve. Ndërsa në Rregullin 25 theksohet obligimi i autoriteteve për të treguar kujdes të veçantë shëndetësor ndaj të burgosurve me nevoja të veçanta shëndetësore.

Nëse i referohemi legjislacionit vendor, respektivisht Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, në nenin 5 përcaktohet shprehimisht se sanksionet penale ekzekutohen në mënyrën e cila siguron trajtimin human dhe respektimin e dinjitetit të secilit individ. Personi i dënuar nuk i nënshtrohet torturës ose trajtimit, apo ndëshkimit çnjerëzor apo degradues.

Avokati i Popullit konsideron se mungesa e kujdesit adekuat mjekësor dhe çdo kujdesi tjetër të nevojshëm, e kombinuar me vuajtjet fizike, çojnë në trajtimin degradues të paraparë në kuptimin e nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe shkel të gjitha standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria. Prandaj, vazhdimi i mbajtjes së të dënuarit në fjalë në kushtet e theksuara në raportin e Departamentit të Shëndetësisë në Burgje do të përbënte shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe akteve tjera ndërkombëtare të lartpërmendura.

Opinionet e Avokatit të Popullit

Opinion i Avokatit të Popullit për rastin A.nr. 421/2018 në lidhje me kriterin për dorëzimin e vendimit të nostrifikimit, për aplikim në konkursin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”

Më 17 gusht 2018, Avokati i Popullit publikoi Opinionin në lidhje me kriterin për dorëzimin e vendimit të nostrifikimit, për aplikim në konkursin e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”.

Duke marrë parasysh kriterin e parashikuar në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit Publik të Prishtinës “Hasan Prishtina” (më tej *UP*), i datës 27 prill 2018, nr.prot.1/173, në pikën II (f) që përcakton se *“kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit duhet të sjellin edhe vendimin për nostrifikim (barasvlerën) e diplomës përkatëse (bachelor, master, magistraturë, doktoratë). Nuk do të merret në konsideratë dëshmia e aplikimit për nostrifikim”*, Avokati i Popullit paraqet këtë Opinion.

Opinionin ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e UP-së që kriteri i lartcekur (pika II (f)) në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e UP-së, i datës 27 prill 2018, nr.prot.1/173, nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi, shkel parimin e barazisë dhe të drejtat e tjera në lidhje me procedurën e rekrutimit të personelit akademik në UP, dhe si i tillë, ky kriter është diskriminues për kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit, duke parandaluar kështu aplikimin e tyre, përkatësisht pjesëmarrjen e tyre në konkurs.

Sipas pohimeve të ankueses, ka vite që ajo studion dhe punon jashtë Kosovës, si në Hagë, Gjenevë dhe Tiranë. Aktualisht znj. Shala punon në pozitën e këshilltares në Ministrinë e Brendshme në Republikën e Shqipërisë. Ajo ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Juridik të UP-së dhe më pas ka vazhduar studimet Master në Bashkëpunim Ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar financiar, në Universitetin e Teramos në Itali, pastaj Master në Kriminologji dhe Drejtësi Penale, në Universitetin e Oxfordit në Angli, dhe mban gradën Doktor në të Drejtën Ndërkombëtare nga “Graduate Institute of International and Development Studies” në Zvicër, ku mbrojti temën me titull: “Garancitë për mos përsëritje shkeljeve të të drejtave të njeriut”, nga fusha e së drejtës ndërkombëtare penale, por ka pasur dhe vazhdon të ketë dëshirë që të kthehet dhe të kontribuojë në Kosovë.

Sipas ankueses, më 27 prill 2018, UP-ja ka shpallur konkursin për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e UP-së, me nr.prot.1/173. Në këtë konkurs kërkohet që qytetarët e Kosovës, të diplomuar jashtë vendit, të dorëzojnë gjatë procedurës së aplikimit dokumentin e njohjes së studimeve jashtë shtetit. Ankuesja pretendon që është i kundërligjshëm dhe diskriminues një kriter i tillë në procesin e rekrutimit të stafit akademik në UP, ndaj të diplomuarve jashtë Kosovës, kurse sipas të njëjtit konkurs,

kandidatëve të doktoruar në UP u lejohej aplikimi edhe vetëm me certifikatë të diplomimit, një gjë e tillë e përcaktuar në pikën II (c) të Konkursit të datës 27 prill 2018, me nr.prot.1/173, që përcakton: *“Kandidatët që kanë doktoruar në UP dhe për të cilët ende nuk është bërë promovimi solemn dhe pajisja me diplomë, mund të aplikojnë me certifikatë origjinale të diplomimit në doktoratë”*. Për më tepër, kërkesa për të dorëzuar që në aplikim (për dallim nga kushti për të themeluar marrëdhënie të punës) dokumentin e njohjes së diplomave të fituara jashtë vendit, nuk gjen bazë në dokumentet themelore, konkretisht në Ligjin për Arsimin e Lartë, as në aktet nënligjore të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe të Teknologjisë, as në Statutin e UP-së dhe as në aktet tjera që rregullojnë procedurat e përzgjedhjes lidhur me emërimin e personelit akademik në UP. Njëherësh, është haptazi diskriminuese për studentët kosovarë që kanë dëshmuar të jenë të suksesshëm edhe jashtë Kosovës, sikurse rasti i vetë ankueses.

Më 29 qershor 2018, përfaqësues të Avokatit të Popullit kanë realizuar një takim me Rektorin dhe Sekretarin e Universitetit të Prishtinës, ku mes tjerash, kanë diskutuar edhe lidhur me pretendimet e ankueses të parashtruara në ankesën e saj në IAP. Sekretari i UP-së ka pohuar se në të gjitha konkurset për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e UP-së kërkohet që qytetarët e Kosovës, të diplomuar jashtë vendit, të dorëzojnë gjatë procedurës së aplikimit dokumentin e njohjes së studimeve jashtë shtetit, sepse, sipas tij, mund të ndodhë që diplomat e tyre edhe mund të mos njihen nga ana e MASHt-it.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës, zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t’i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë, përfshirë edhe UP-në në lidhje me rastin konkret.

Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Avokati i Popullit vlerëson se kërkesa për të dorëzuar që në aplikim dëshminë për njohje të studimeve jashtë vendit nuk gjen bazë në dokumentet themelore që rregullojnë procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin e personelit akademik në UP, prandaj, si e tillë është diskriminuese për faktin se kërkesa për njohje shërben si kusht për themelimin e marrëdhënies së punës (apo nënshkrimin të kontratës së punës ndërmjet UP dhe kandidatit të caktuar) dhe jo për t’i vënë në pozitë të pabarabartë gjatë procedurës së aplikimit kandidatët konkurrentë të cilët kanë nivelin e njëjtë të shkollimit. Avokati i Popullit konsideron se kriteri i përcaktuar në konkursin e UP-së me nr.prot.1/173, i datës 27 prill

2018, për përzgjedhjen e personelit akademik, për dorëzimin e dokumentit të njohjes së studimeve jashtë shtetit si dëshmi që në fazën e aplikimit është jashtëligjor, nuk është në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, Udhëzimin Administrativ (MASHT) - nr.16/2016 për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, Statutin e UP-së dhe as në Rregulloren nr.465, e datës 2 mars 2018, për Procedurat Përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP, për të gjitha fakultetet, përveç Fakultetit të Arteve.

Për më tepër, konkursi në fjalë specifikon: *“Kushtet e Përgjithshme për zgjedhjen e personelit akademik janë të përcaktuara me dispozitat e Statutit të UP, Rregulloren nr.465, të datës 2 mars 2018, për procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP për të gjitha fakultetet, përveç Fakultetit të Arteve dhe Rregulloren 990, të datës 19 prill 2018, për Procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në Fakultetin e Arteve (faqe 15), por në këto dokumente nuk parashihet detyrimi që të paraqitet dëshmia për nostrifikim, siç përcaktohet në konkursin në fjalë (pikën II (f)). Madje, as në nenin 178 të Statutit të UP-së, në të cilën pjesë përcaktohen kushtet që kandidati duhet plotësuar për titullin e asistentit të universitetit nuk përcaktohet një kriter i tillë (siç është pik II(f) e konkursit), ndërsa në Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Kosovë, përkatësisht në nenin 26, par. 10 përcaktohet: “Kriteret për secilin nga titujt nuk duhet të dekurajojnë aplikimet nga jashtë institucionit”. Prandaj, Avokati i Popullit konsideron se rrjedhimisht konkursi në fjalë, parashikon një kërkesë shtesë për të diplomuarit jashtë Kosovës, prandaj edhe është në kundërshtim me këto dokumente.*

Avokati i Popullit vëren se Udhëzimi Administrativ nr.16/2016 për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave, Gradave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, nuk e përcakton se kandidatët për të aplikuar në konkurset publike duhet t’i kenë të nostrifikuara diplomat e fituara jashtë vendit. Përkundrazi, në nenin 2, par. 1, pika 1.1 përcakton që termi/shprehja: *“Njohje- do të thotë një pranim zyrtar nga ana e MASHT-it, i një diplome të fituar jashtë vendit, e cila konfirmon saktësinë dhe vërtetësinë e saj dhe shërben për punësim në RKS”*. Kjo, sipas Avokatit të Popullit është tregues i qartë që njohja e diplomave të fituara jashtë vendit duhet të shërbejë si kusht për themelimin e marrëdhënies së punës (nënshkrimin të kontratës së punës) dhe assesi nuk mund të shërbejë si kusht për të fituar të drejtën e aplikimit apo edhe për t’u përzgjedhur në një pozitë të caktuar pune. Prandaj, Avokati i Popullit vlerëson se në një situatë hipotetike, do të ishte plotësisht e vlefshme dhe në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë dhe aktet tjera nënligjore në fuqi, që UP-ja të vendosë kusht për themelimin e marrëdhënies së punës (pra nënshkrimin e kontratës së punës) paraqitjen e dëshmisë së njohjes së diplomës së fituar jashtë vendit, përkatësisht para se të bëhet akti final i punësimit (nënshkrimi i kontratës).

Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se në nenin 3, par. 1, përcaktohet: *“Të gjitha diplomat e shkollave të larta profesionale si dhe ato universitare të fituara jashtë vendit me qëllim punësimi, do t’u nënshtrihen procedurave të njohjes/barasvlerës në MASHT.”* Në këtë kontekst, mund të kuptohet që ky udhëzim nuk kërkon që me qëllim të aplikimit, diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara. Për më shumë, fakti që në Udhëzimin Administrativ përmendet fjalia *“do t’u nënshtrihen procedurave të njohjes”*, mund t’ua japë të drejtën kandidatëve, përfshirë edhe ankuesen, të aplikojnë në konkurse të punësimit ende pa u bërë njohja apo nostrifikimi i tyre. Në këtë kuptim, UP-ja do të duhej të njihte të drejtën e ankueses, që të mos diskriminohet në lidhje me aplikimin dhe procedurat e rekrutimit për pozitën që ka aplikuar në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e UP-së, i datës 27 prill 2018, nr.prot.1/173, sa i përket kriterit për nostrifikim para mbylljes së konkursit (siç parashihet në pikën II (f) të konkursit në fjalë), duke e konsideruar të arsyeshëm vetëm detyrimin që kandidatja të dorëzojë dëshminë për nostrifikim vetëm para se të kryhet akti final i punësimit, përkatësisht nënshkrimi i kontratës.

Ndër të tjera, Avokati i Popullit ngre shqetësimin edhe tek afatet kohore për dorëzimin e dokumenteve. Në këtë konkurs përcaktohet: *“Konkursi mbetet i hapur për 15 ditë kalendarike, përkatësisht nga data 27 prill deri më 14 maj 2018”*. Sipas Udhëzimit Administrativ (MASHT), nr.16/2016, në pjesën që ka të bëjë me parimet dhe procedurat e njohjes së diplomave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, parashikojnë afat 1 muhor për vlerësimin të kërkesës nga ana e Këshillit Shtetëror për Njohje dhe afat 4 muhor për përmbylljen e procedurës së njohjes. Prandaj, një afat i tillë ligjor për aplikim si dhe kushtëzimi i kandidatëve për paraqitje të diplomave të nostrifikuara të kandidatëve të shkolluar jashtë Republikës së Kosovës, të cilët nuk mund të kenë njohuri se kur do të mund të hapej konkursi, koha prej 2 javësh për dorëzimin e dokumentacionit, ashtu siç kërkon konkursi, nuk është kohë e mjaftueshme nga MASHT-i për të kryer procesin e njohjes dhe kjo i privon kandidatët e shkolluar jashtë shtetit të trajtohen në mënyrë të barabartë me kandidatët të cilët kanë diploma nga Republika e Kosovës.

Bazuar në analizën e mësipërme, Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenin 18, paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, dhe nga vlerësimi i ankesës, përkatësisht vlerësimi i gjendjes faktike, vlerëson se: Në dokumentet themelore që rregullojnë procedurat e përzgjedhjes lidhur me emërimin e personelit akademik në UP, përfshirë Statutin e UP-së, Ligjin nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, Rregulloren nr.465, e datës 2 mars 2018, për Procedurat përzgjedhëse lidhur me emërimin, riemërimin dhe avancimin e personelit akademik në UP, nuk është e përcaktuar që kandidatët janë të detyruar, që me qëllim të aplikimit dhe pjesëmarrjes në procedurën e përzgjedhjes në konkurset e shpallura nga UP-ja, të dorëzojnë dokumentin e njohjes/nostrifikimit të diplomave të fituara jashtë vendit. Për më tepër, Statuti i UP-së, për punësim, marrje të thirrjeve akademike, përcakton vetëm se kandidatët duhet t’i kenë të përfunduara studimet,

përkatësisht që kandidati: *“Të ketë gradën e doktorit të shkencës, (në fakultetin e Arteve ekuivalente me të)”* (neni 177, par. 1, pika 1.1); *“të ketë të përfunduar me sukses studimet Master...”*; *“nëse ka gradën e doktorit të shkencës”* (neni 178, par. 1, pika 1.1 dhe 1.3). Të gjitha këto kriterë nënkuptohen si kriterë të domosdoshme për krijimin e marrëdhënies së punës. Kësisoj, askund nuk përcaktohen kriterë që parandalojnë aplikimin apo pjesëmarrjen në konkurs, siç është përcaktuar kriteri në pikën II (f) të konkursit të datës 27 prill 2018. Udhëzimi Administrativ (MASHT)-Nr.16/2016 për Parimet dhe Procedurat e Njohjes së Diplomave dhe Kualifikimeve të Shkollave të Larta Profesionale dhe Universitare të Fituara Jashtë Republikës së Kosovës, nuk përcakton se kandidatët janë të detyruar që me qëllim të aplikimit dhe procedurës së përzgjedhjes për pozitë e shpallura në konkurs, të dorëzojnë dokumentin e njohjes/nostrifikimit të diplomave të fituara jashtë vendit, që në momentin e aplikimit, dhe as që ndalohej pjesëmarrja në konkurs mbi këtë kriter. Përkundrazi, ky Udhëzim është hartuar në atë mënyrë që përcakton se diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara me qëllim të punësimit në Republikën e Kosovës, gjë e cila nënkupton vetëm themelimin e marrëdhënies së punës (nënshkrimit të kontratës së punës apo aktit të emërimit). Kjo vlen edhe në lidhje me konkurset e shpallura nga UP-ja. Nga kjo bazë normative që u theksua me lart dhe duke iu referuar Kushtetutës, Ligjit në fuqi për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe dispozitave të tjerat ligjore që janë kundër diskriminimit dhe cenimit të parimit të barazisë, konstatohet se kriteri i parashikuar në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik në fakultetet e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, i datës 27 prill 2018, nr.prot.1/173, në pikën II (f) që përcakton se *“kandidatët që i kanë mbaruar studimet jashtë vendit duhet të sjellin edhe vendimin për nostrifikim (barazvlerën) e diplomës përkatëse (bachelor, master, magistraturë, doktoratë)...”*, është diskriminues dhe cenon parimin e barazisë për kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit. Diskriminimi dhe trajtimi i pabarabartë qëndron në faktin se ky kriter parandalon pjesëmarrjen në konkurs dhe procedurat përzgjedhëse për pozitë e shpallura për personel akademik për kandidatët që kanë përfunduar studimet jashtë vendi, që posedojnë diplomat, por që të njëjtat nuk kanë arritur t’i nostrifikojnë para mbylljes së konkursit. Në pajtim me aktet normative në fuqi, që janë analizuar edhe në këtë Opinion, Avokati i Popullit rikujton se UP-ja mund t’i kushtëzojë kandidatët që kanë diploma të fituara jashtë vendit, që të sjellin dëshminë e njohjes/nostrifikimit të diplomave të tyre para themelimit të marrëdhënies së punës (nënshkrimit të kontratës së punës), nëse kandidatët e tillë përzgjidhen nga organet gjegjëse të UP-së. Rrjedhimisht, vetëm kjo do të ishte brenda kërkesave legjitime të përcaktuara në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe në Udhëzimin Administrativ nr. 16/2016 për njohjen e diplomave të fituara jashtë vendit; UP-ja të mundësojë që të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë vendit të marrin pjesë në konkursin për zgjedhjen e personelit akademik, i datës 27 prill 2018, nr.prot.1/173; t’i nënshtrohen pa asnjë pengesë proceduarve për t’u përzgjedhur nga komisionet vlerësuese profesionale dhe organet tjera vendimmarrëse, dhe të mos diskriminohen për shkak të dëshmisë për nostrifikim (barazvlerë) të diplomave, duke u *tërhequr kriteri i vendosur në pikën II (f) të këtij konkursi*. Në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe me qëllim që të konfirmohet

saktësia dhe vërtetësia e diplomave të fituara jashtë vendi, UP-ja mund t'i kushtëzojë kandidatët që dëshminë për nostrifikim (barasvlerë) të diplomave ta dorëzojnë para se të bëhet akti final i punësimit, përkatësisht nënshkrimi i kontratës së punës; ky kriter (*sic përcaktohet në pikën II (f) në konkursin e datës 27 prill 2018*), të mos vendoset as në konkurset që mund të shpallen në të ardhmen, në mënyrë që të mos parandalohet pjesëmarrja në konkurse dhe procedura përzgjedhëse për pozitat për personel akademik në UP, të kandidatëve që kanë përfunduar studimet jashtë vendit, vetëm pse nuk kanë arritur që para mbylljes së konkursit ta bëjnë nostrifikimin (barasvlerësimin) e diplomave; MASHT-i të kujdeset që UP-ja dhe institucionet e tjera të arsimit në Republikën e Kosovës ta zbatojnë me saktësi parimin e mosdiskriminimit dhe barazisë në raport me kandidatët që studimet i kanë mbaruar jashtë vendi, në lidhje me nostrifikimin e diplomave për qëllime të punësimit, që të njëjtët të mos diskriminohen gjatë procedurave të rekrutimit/përzgjedhjes për vendet e punës që aplikojnë; MASHT-i ta plotësojë bazën ligjore në lidhje me nostrifikimin/barasvlerësimin e diplomave të fituara jashtë vendit, në pajtim të plotë me parimin e mosdiskriminimit në lidhje me procedurat për punësim në Republikën e Kosovës, përfshirë edhe punësimin në institucionet e arsimit; MASHT-i t'i trajtojë me prioritet kërkesat për nostrifikim (barasvlerë) të diplomave të fituara jashtë vendit, për kandidatë që janë në proces të konkurrimit në konkurse publike dhe krijimit të marrëdhënies së punës.

Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me faturimin e ujit për konsumatorët me ujëmatës të përbashkët

Avokati i Popullit, më 11 janar 2017, ka adresuar Raportin me rekomandime, nëpërmjet të cilit kishte rekomanduar që faturimi i ujit të bëhet në bazë të konsumit real, si dhe kishte rekomanduar që ARRU-ja ta kryejë monitorimin e rregullt të ofruesve të shërbimeve të ujit. Në bazë të shkëmbimit të shkresave dhe takimeve ndërmjet IAP-së dhe ARRU-së, janë vlerësuar angazhimet e ARRU-së në monitorimin e ofruesve të shërbimeve dhe po ashtu edhe çështjet teknike të cilat e pamundësojnë faturimin e ujit, sipas konsumit real në një numër banesash kolektive. Me këtë rast, ARRU-ja ka kërkuar nga Avokati i Popullit bashkëpunim në gjetjen e një zgjidhjeje sa më të përshtatshme dhe sa më të drejtë për faturimin e konsumatorëve, aty ku nuk ka mundësi teknike dhe praktike për vendosjen e ujëmatësve, apo ku edhe vetë konsumatorët hezitojnë t'i vendosin ujëmatës.

Lidhur me këtë, Avokati i Popullit, në rend të parë i referohet Ligjit nr. 04/L-121 për Mbrojtje të Konsumatorit, i cili duhet të zbatohet përkitazi me faturimin e ujit.⁴³⁹ Ky Ligj nuk parasheh ndonjë përjashtim nga obligimi që faturimi të bëhet në bazë të konsumit real.

Avokati i Popullit konsideron se një zgjidhje e mundshme për faturimin me ujëmatës të përbashkët, do të mund të gjendej në kuadër të Ligjit nr. 04/L-134 për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi, në bashkëpunim me ofruesit e shërbimeve të ujit, komunat përkatëse, si

⁴³⁹ Neni 29, paragrafi 1

dhe me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Në këtë rast, Avokati i Popullit sugjeron që ARRU-ja, në bashkëpunim me MMPH-së, të vlerësojnë nëse ligji në fjalë, praktikisht, ofron mundësi të tilla.

Sidoqoftë, Avokati i Popullit, duke kuptuar faktin se ARRU-ja i ka marrë me seriozitet rekomandimet e Avokatit të Popullit lidhur me faturimin e ujit dhe duke marrë parasysh se ARRU-ja kërkon që të gjejë një zgjidhje të arsyeshme dhe të drejtë për faturimin e konsumatorëve me ujëmatës të përbashkët, tërheq vëmendjen edhe tek Ligji nr. 04/L-077 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.⁴⁴⁰ Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve parasheh detyrimin e pjesëtueshëm, pastaj parasheh prezumimin e solidaritetit të debitorëve etj., që do të mund të zbatoheshin nga ana e ofruesve të shërbimeve të ujit.

Avokati i Popullit përshëndet iniciativën dhe përpjekjet e ARRU-së për gjetjen e një zgjidhjeje sa më të drejtë dhe inkurajon që çfarëdo zgjidhje e propozuar të jetë në suaza të ligjit dhe/apo praktikave më të mira, rajonale dhe ndërkombëtare.

Opinion i Avokatit të Popullit në lidhje me parandalimin e nepotizmit në Universitetin e Prishtinës

Më 16 mars 2018, Avokati i Popullit publikoi Opinionin në lidhje me parandalimin e nepotizmit në Universitetin e Prishtinës. Në një Raport me rekomandime, i nxjerrë më 12 shkurt 2018, Avokati i Popullit e ka cilësuar si diskriminues ndalimin e “rekrutimit/angazhimit të kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtët kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë” (Rregullorja nr. 2/475 e Procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, e nxjerrë më 7 shtator 2017, neni 7, par. 11). Ky Opinion ka dy qëllime kryesore: Të sqarojë se ky konstatim nuk e ndalon aspak Universitetin e Prishtinës që ta luftojë problemin e nepotizmit në bazë të procedurave të parashikuara me Statutin e Universitetit të Prishtinës; të theksojë se luftimi i nepotizmit është i domosdoshëm për respektimin e plotë të të drejtave të njeriut të të gjithë kandidatëve për punësim në Universitetin e Prishtinës; dhe të propozojë disa masa për të përforcuar edhe më shumë parandalimin e nepotizmit, duke u bazuar në politikat e të dy universiteteve që njihen botërisht për standarde të larta akademike: Harvard University, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe University of Cambridge, i Mbretërisë së Bashkuar.

Në një Raport me rekomandime, i nxjerrë më 12 shkurt 2018 (në tekstin e mëtejshëm *Raporti*), Avokati i Popullit ka marrë në shqyrtim Rregulloren nr. 2/475 të Procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina,” e nxjerrë më 7 shtator 2017 (në tekstin e mëtejshëm *Rregullorja*).

Neni 7, par. 11 të kësaj Rregulloreje parashikon: “Në Universitet të Prishtinës, nuk do të lejohet rekrutimi/angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore

⁴⁴⁰ Kreu 3, Detyrimet e Pjesëtueshme

organizative (departament/degë apo program), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë (në relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas)”. Në Raport, Avokati i Popullit ka konstatuar se kjo dispozitë është diskriminuese, sipas Kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës.

Për shembull, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 24, par. 2, përcakton: “Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”. Siç shpjegohet në paragrafin 10 të Raportit: “Kushtetuta në mënyrë eksplicite garanton barazinë e të gjithë personave para Kushtetutës dhe ligjit, të drejtën e secilit për mbrojtje të barabartë ligjore pa diskriminim dhe ndalon çdo diskriminim në bazë të cilësdo bazë të listuar, *por po ashtu shton edhe në bazë të ndonjë statusi tjetër personal që nuk përmendet në mënyrë eksplicite në këtë nen*” (theks i shtuar). Prandaj, Raporti vazhdon në paragrafin 17: “Një person për shkak të disa prej karakteristikave të tij personale, ose në rastin konkret, raporteve të ngushta familjare si dhe raporteve të punës që kanë brenda departamentit ose programit të UP-së, nuk mund të privohet nga e drejta për punësim, e cila për të tjerët është e qasshme dhe u njihet në masë të plotë, sepse me këtë ky person vihet në pozitë të pafavorshme, krahasuar me kandidatët e tjerë dhe të njëjtit nuk i lejohet në kushte të barabarta të konkursit të marrë pjesë në garë gjatë procedurës së rekrutimit”.

Për këtë arsye, Avokati i Popullit e ka cilësuar si diskriminues ndalimin e rekrutimit ose angazhimit të kandidatëve që kanë familjarë të ngushtë të punësuar ose të angazhuar brenda degës ose departamentit ku këta kandidatë konkurrojnë. Avokati i Popullit qëndron pas këtij konstatimi. Mirëpo, siç theksohet në paragrafin 16 të Raportit: “Avokati i Popullit në mënyrë specifike e kupton problemin e nepotizmit si një formë e veçantë e konfliktit të interesit, që është jashtëzakonisht i shpeshtë me rastin e punësimit në sektorin publik”.

Madje, Avokati i Popullit konsideron se vetë ndalimi i diskriminimit, i përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj, e bën të domosdoshëm luftimin e dukurisë së nepotizmit. Sipas vendimeve gjyqësore të GjENDj-së, “[e] drejta (...) për të mos u diskriminuar (...) shkelet kur shtetet *trajtojnë në mënyrë jo të barabartë persona në situata të ngjashme pa dhënë një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm*” (*Thlimmenos v. Greece*, Aplikimi Nr. 34369/97, GjEDNj, 6 prill 2000, par. 44; theks i shtuar).

Nga ky këndvështrim, problemi i nepotizmit ka pasojë pikërisht që kandidatët për punësim të *mos* trajtohen në mënyrë të barabartë, vetëm për shkak të lidhjeve familjare. Është e dukshme që lidhjet familjare që kandidatët kanë (ose që u mungojnë), nuk mund të shërbejnë si “justifikim objektiv dhe i arsyeshëm” për t’i trajtuar në mënyrë jo të barabartë. Për këtë arsye, nepotizmi mund të cilësohet si formë diskriminimi. Si i tillë, është e domosdoshme që UP-ja, si dhe të gjitha institucionet publike, ta luftojë

nepotizmin në mënyrën më efikase të mundshme, në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e vendit.

Mirëpo, mund të duket se, mbi këtë pikë, Avokati i Popullit e ka zhytur UP-në në një dilemë të pashmangshme: nga njëra anë, dukuria e nepotizmit është diskriminuese, sepse rezulton në diskriminimin e atyre kandidatëve të cilëve *u mungojnë* lidhje familjare brenda departamentit ose degës ku po aplikojnë; por nga ana tjetër, sipas Raportit të fundit të Avokatit të Popullit, masa e rreptë e vendosur nga Universiteti i Prishtinës i diskriminon ata kandidatë që *kanë* lidhje familjare brenda departamentit ose degës ku po aplikojnë. Shtrohet pyetja, pra, si duhet të veprojë UP-ja, në mënyrë që të mos i diskriminojë as ata të cilëve u mungojnë lidhje familjare dhe as ata që i kanë këto lidhje, pa fajin e tyre?

Duke i kuptuar këto shqetësime, Avokati i Popullit, në vijim propozon disa masa të tjera që UP-ja mund t'i ndërmarrë kundër problemit të nepotizmit, përtej masës së lartpërmendur që është tashmë e përfshirë në Statut. Masat e propozuara në vijim bazohen në politikat e dy universiteteve me reputacion botëror: Harvard University, i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe University of Cambridge, i Mbretërisë së Bashkuar. Të dyja universitetet renditen në mesin e 5 universiteteve më të mira në botë, sipas një vlerësimi të kohëve të fundit (shih QS World University Rankings 2018, tek: <https://www.topuniversities.com/university-rankings/world-university-rankings/2018>).

Që të dyja janë të respektuara botërisht për zbatimin e standardeve më të larta akademike. Prandaj, këto universitete mund të shërbejnë si modele për rregullimin e çështjeve akademike, duke përfshirë parandalimin e nepotizmit në stafin akademik.

Së pari, Avokati i Popullit vëren se politikat e të dyja universiteteve për parandalimin e nepotizmit, mbulojnë marrëdhënie edhe përtej familjes së ngushtë. Siç kemi parë më sipër, Rregullorja e Universitetit të Prishtinës përdor termin “familjarë të ngushtë,” i cili përfshin vetëm “relacionin prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas” (*po aty*, neni 7, par. 11). Ndërsa, Harvard University përfshin në listë edhe marrëdhëniet si në vijim: marrëdhënia bashkëshortore; njerka(nj)-thjeshtë; gjysh(e)-[nip/mbesë]; kunetër; vjehërr-[dhëndër/nuse]; dhe vëlla/motër nga njerka/njerku (*shih* Harvard University Staff Personnel Manual, Work Relationships, Section 1). Përveç këtyre, Harvard e trajton në të njëjtën mënyrë edhe marrëdhënien bashkëjetesore (*shih po aty*).

University of Cambridge ka kritere edhe më gjithëpërfshirëse, duke shtuar edhe: partnerët jashtëmartesorë; ish-bashkëshortët; marrëdhënien [dajë/teze/xhaxha/hallë]-[nip/mbesë]; kushërinjtë; dhe miqtë e ngushtë (*shih* University of Cambridge Human Resources Policies and Procedures, Employing and Working with Relatives and Related Matters). Cambridge thekson gjithashtu se lista nuk është shteruese dhe “është përgjegjësia e anëtarëve të stafit për të marrë çfarëdo mase të nevojshme në bazë të logjikës dhe arsyeshmërisë” për t’iu shmangur nepotizmit në rast të lidhjeve të tjera që nuk përfshihen shprehimisht në listë (*po aty*).

Përveç politikave konkrete kundër nepotizmit, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme të theksohet se këto politika kanë për qëllim jo vetëm që të gjithë kandidatët për punësim, por edhe të gjithë të punësuarit, të trajtohen në mënyrë të barabartë. Këto politika kanë për qëllim edhe ***që publiku ta dijë dhe të ndihet i sigurt për këtë trajtim të barabartë***. Si universiteti më i madh dhe më i rëndësishëm i vendit, Universiteti i Prishtinës, përkatësisht udhëheqësit dhe i gjithë stafi i vet, e ka për detyrë ta përmirësojë imazhin e Universitetit në sytë e publikut.

Në këtë drejtim, edhe politika e Cambridge-it thekson se “anëtarët e stafit nuk duhet të vendosen prej të tjerëve, as ta vendosin veten, në një situatë ku të tjerët ***do të kishin arsye të besojnë*** se ekziston ose mund të ekzistojë një konflikt interesi ose sjellje jo e rregullt” dhe duhet të sigurojnë që “Universiteti të mos diskreditohet dhe që atij të mos i dëmtohet reputacioni për shkak të sjelljeve jo të rregullta nga ana e stafit të vet” (University of Cambridge Human Resources Policies and Procedures, Employing and Working with Relatives and Related Matters; theks i shtuar). Avokati i Popullit konsideron se të njëjtat parime vlejné edhe për stafin e Universitetit të Prishtinës.

Mbetet një çështje e fundit për të sqaruar: Cili është organi kompetent për të inkorporuar këto reforma të propozuara në politikat e Universitetit të Prishtinës kundër nepotizmit? Këtu ka dy mundësi. Së pari, këto reforma mund të futen drejtpërsëdrejti në Statutin e Universitetit, e cila do të kërkonte ndryshimin e Statutit nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Së dyti, autoritetet e Universitetit të Prishtinës, edhe pa ndryshimin e Statutit, mund t’i miratojnë këto reforma në formë të një rregulloreje. Një hap i tillë do të ishte në përputhje të plotë me Statutin aktual, i cili i jep Senatit të Universitetit të drejtën *carte blanche* për të rregulluar proceset vlerësuese të kandidatëve, të paktën kur nuk bie në kundërshtim me pjesët e tjera të Statutit. Mbi këtë pikë, shih Statutin e Universitetit të Prishtinës, neni 173, par. 8 (“Çështje tjera për procedurat vlerësuese përcaktohen me rregullat e nxjerra nga Senati në pajtim me këtë Statut”). Dhe, në përgjithësi, Universiteti gëzon autonomi për t’i rregulluar të gjitha aspektet e funksionimit të vet (*shih po aty*, neni 12 “Të drejtat dhe detyrat”).

Avokati i Popullit konsideron se të dyja këto mundësi duhet të shfrytëzohen njëkohësisht. Zgjidhja më ideale do të ishte që Kuvendi ta ndryshojë Statutin për t’i përfshirë reformat drejtpërdrejt në të. Kjo do të siguronte që reformat të jenë të qëndrueshme dhe të mos ndryshohen lehtë prej udhëheqësve të ardhshëm të Universitetit, të cilët ndërrohen relativisht shpesh. Mirëpo, ndryshimi i Statutit kërkon më shumë kohë, meqenëse të gjitha ndryshimet duhet të kalojnë nëpër procesin legjislativ të Kuvendit. Prandaj, derisa të ndryshohet Statuti, Avokati i Popullit propozon që autoritetet e Universitetit menjëherë të marrin masa për t’i miratuar këto reforma, duke ushtruar kompetencat e veta për rregullimin e të gjitha aspekteve të funksionimit të Universitetit. Në bazë të vlerësimit të mësipërm, Avokati i Popullit konsideron se është i nevojshëm miratimi i reformave në politikat e Universitetit kundër nepotizmit, si në vijim: (1) Politikat e Universitetit të Prishtinës kundër nepotizmit duhet të mbulojnë jo vetëm marrëdhëniet e “familjarëve të

ngushtë” (prind-fëmijë, vëlla-motër, motër-motër, vëlla-vëlla dhe anasjelltas), por edhe marrëdhëniet e të afërmeve të tjerë, si në vijim: bashkëshortët; njerka(n)-thjeshtë; gjysh(e)-[nip/mbesë]; kunetër; vjehërr-[dhëndër/nuse]; vëlla/motër nga njerka/njerku; marrëdhënia bashkëjetësore; marrëdhënia e partnerëve jashtëmartesorë; ish-bashkëshortët; [dajë/teze/xhaxha/hallë]-[nip/mbesë]; kushërinjtë; dhe marrëdhënia e miqve të ngushtë. Duhet të theksohet gjithashtu se kjo listë nuk është shteruese dhe se është përgjegjësia e anëtarëve të stafit për të marrë çfarëdo mase të nevojshme në bazë të logjikës dhe arsyeshmërisë për t’iu shmangur nepotizmit në rast të lidhjeve të tjera që nuk përfshihen shprehimisht në listë; (2) Anëtarëve të stafit të Universitetit duhet t’u ndalohej jo vetëm që të marrin pjesë si anëtarë të Këshillit vlerësues kur ndonjë i afërm i vet është kandidat për punësim, por duhet t’u ndalohej edhe që të marrin pjesë në çfarëdo procesi tjetër që mund t’i sjellë ndonjë dobi të afërmit të vet, duke përfshirë (por duke mos u kufizuar) proceset e punësimit, të të ardhurave dhe rritjes së të ardhurave, ngritjes së pozitës dhe detyrave të punës; (3) Anëtarët e stafit duhet të jenë të detyruar që ta deklarojnë nëse janë të angazhuar në një proces rekrutimi ose ndonjë proces tjetër që mund t’i sjellë ndonjë dobi të afërmi të vet. Mosdeklarimi i një lidhjeje të tillë duhet të rezultojë në masa ndëshkuese.

Kërkesa për masën e përkohshme

Kërkesa e Avokati i Popullit drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizimin e disa neneve të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate

Më 2 nëntor 2018, Avokati i Popullit i parashtrori kërkesë Gjykatës Kushtetuese për (1) shfuqizimin e neneve 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (nënpagrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *Ligji për Këshillin*), dhe (2) masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të këtyre dispozitave deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate.

Kërkesa e Avokatit të Popullit për shfuqizimin e dispozitave të lartpërmendura, si dhe për masë të përkohshme, janë brenda juridiksionit lëndor të Gjykatës Kushtetuese. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm *Kushtetuta*), në pjesën relevante, përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të referojë çështje në Gjykatën Kushtetuese, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute*” (po aty, neni 135, par. 4); dhe në veçanti, Avokati i Popullit: “*Është i autorizuar të ngrenë (...) çështjen e përputhshmërisë së ligjeve (...) me Kushtetutën*” (po aty, neni 113, par. 2, nënpar. 1).

Për sa i përket kërkesës për masë të përkohshme, Ligji nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, përcakton: “*Gjykata, me kërkesë të palës, mund të vendosë përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë të nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik*” (po aty, neni 27, par. 1).

Kërkesa e Avokatit të Popullit parashtrohet gjithashtu brenda juridiksionit kohor të Gjykatës: “*Kërkesa e ngritur në pajtim me nenin 113, paragrafi 2 të Kushtetutës do të parashtrohe[t] (...) nga ana e Avokatit të Popullit (...) brenda afatit prej gjashtë (6) muajve pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar*” (Ligji për Gjykatën Kushtetuese, neni 29, par. 1 dhe neni 30). Ligji që po kontestohet në këtë kërkesë hyri në fuqi më 25 gusht 2018, pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës (shih Ligjin për Këshillin, neni 32). Prandaj, kërkesa e Avokatit të Popullit parashtrohet brenda afatit gjashtëmujor të përcaktuar nga Ligji për Gjykatën Kushtetuese.

Mënyra se si Ligji për Këshillin e përcakton fushëveprimin e vet, e bën të qartë se Institucioni i Avokatit të Popullit përfshihet në këtë fushëveprim. Sipas nenit 2 të Ligjit: “*Fushëveprimi i këtij ligji përfshin Këshillin dhe të gjitha institucionet e administratë publike që kanë të punësuar nëpunës civil*”. Termi “nëpunës civil”, ashtu siç përdoret në këtë ligj, “nënkupton nëpunësin civil sipas përkufizimit në Ligjin për Shërbimin Civil” (po aty, neni 3, para. 1, nënpar. 2).

Rrjedhimisht, fushëveprimi i Ligjit për Këshillin varet drejtpërsëdrejti prej përkufizimit të termit “nëpunës civil” në Ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton: “Ky ligj rregullon statusin e nëpunësve civilë, si dhe marrëdhënien e tyre të punës në **institucionet e administratës qendrore dhe komunale**”; dhe se: “Për qëllim të këtij ligji, institucionet e administratës qendrore dhe komunale, që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji përfshijnë: administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, **agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administratën komunale**” (po aty, neni 1, par. 1 dhe 2; theks i shtuar).

Për rrjedhojë, Ligji për Këshillin i jep Këshillit kompetencën për të mbikëqyrur jo vetëm institucionet e Qeverisë, por të gjitha llojet e institucioneve të lartcekura. Këtu përfshihet edhe Institucioni i Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur.

Funksionet dhe kompetencat që Ligji ia përcakton Këshillit në mbikëqyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit, mes institucioneve të tjera, e cenojnë rëndë pavarësinë kushtetuese të këtij Institucioni. Kjo pavarësi kushtetuese garantohet me nenin 132, par. 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili përcakton: “Avokati i Popullit është i pavarur në ushtrimin e detyrës dhe nuk pranon udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera, të cilat ushtrojnë pushtetin në Republikën e Kosovës”.

Edhe kjo Gjykatë, në Aktgjykimin e saj në Rastin KO73/16, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Qarkores Administrative nr. 01/2016, të nxjerrë nga Ministria e Administratës Publike të Republikës së Kosovës më 21 janar 2016, ka theksuar: “Zyra e Avokatit të Popullit është institucion i pavarur që është krijuar për të siguruar llogaridhënie nga autoritetet publike vis-a-vis të drejtave dhe lirive të individëve. Në përmbushjen e kësaj detyre, ky institucion ushtron në mënyrë të pavarur mandatin e tij **duke mos pranuar asnjë instruksion apo ndërhyrje nga ndonjë autoritet tjetër shtetëror**” (po aty, par. 69; theks i shtuar).

Duke autorizuar udhëzime dhe ndërhyrje të drejtpërdrejtë në Institucionin e Avokatit të Popullit, Ligji ia jep Këshillit të drejtën: “Të shqyrtojë dhe marrë vendime për ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në shërbimin civil (neni 6, par. 1, nënpar. 1); “ të mbikëqyrë procedurën e përzgjedhjes dhe vendosë nëse emërimet e nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të nivelit drejtues, janë zhvilluar në pajtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil (neni 6, par. 1, nënpar. 2); “t’i monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil” (neni 6, par. 1, par. 3); “të ketë qasje dhe të kontrollojë dosjet dhe çdo dokument lidhur me zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil” (neni 7, par. 1, nënpar. 2); “të intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit” (neni 7, par. 1, nënpar. 3); “të kërkojë dhe marrë nga institucionet çdo informacion të nevojshëm për kryerjen e detyrave të tij” (neni 7, par. 1, nënpar. 4); “të vendosë (...) shfuqizimin ose anulimin e aktit

administrativ” (neni 18, par. 1, nënpar. 2); “*të vendosë (...) ndryshimin e aktit administrativ*” (neni 18, par. 1, nënpar. 3); “*të anulojë procedurën e përzgjedhjes, kur konstaton që është zhvilluar në kundërshtim me rregullat dhe parimet e legjislacionit për shërbimin civil* (neni 19, par. 5, nënpar. 2); dhe “*për çdo vit t’i monitorojë institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë (...) përmes monitorimit të rregullt që realizohet sipas planit vjetor të monitorimit, dhe përmes monitorimit të jashtëzakonshëm që realizohet në raste të veçanta që ndërlidhen me shkelje të rënda të legjislacionit për shërbimin civil*” (neni 20, par. 1 dhe 2).

Po ashtu, sipas Ligjit, të gjitha këto udhëzime dhe ndërhyrje të Këshillit konsiderohen **të obligueshme** për Avokatin e Popullit. Për shembull, pas monitorimit, “[i]nstitucioni përkatës i administratës publike është **i obliguar** për zbatimin e rekomandimeve të Këshillit, brenda afatit të përcaktuar me vendimin e Këshillit” (neni 20, par. 5; theks i shtuar).

Për sa i përket vendimeve të Këshillit, Ligji përcakton: “*Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës*”; dhe: “*Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit, paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës*” (neni 21, par. 1 dhe 3; theks i shtuar).

Së fundi, Ligji përcakton: “*Institucionet e administratës publike që kanë të punësuar nëpunës civilë, si dhe çdo funksionar publik ose nëpunës civil, që ka kompetenca në administrimin e shërbimit civil, apo ka informacion në këtë fushë, janë të obliguar të bashkëpunojnë me Këshillin*” (neni 25, par. 2; theks i shtuar).

Këto dispozita e bëjnë të qartë se Avokati i Popullit nuk mund t’i trajtojë vendimet dhe veprimet e tjera të Këshillit thjesht si **rekomandime** ose **sugjerime**. Përkundrazi, Ligji pretendon ta detyrojë Avokatin e Popullit që t’u bindet këtyre vendimeve dhe veprimeve.

Në këtë drejtim, Ligji parashikon edhe sanksione për moszbatimin e vendimeve dhe për mosbashkëpunim: “*Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk e zbaton vendimin e Këshillit brenda afatit të paraparë me nenin 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur ka kaluar afati për zbatim, në të gjitha rastet duhet të njoftojë me shkrim Kryetarin e Kuvendit, Komisionin përkatës për administratë publike dhe eprorin e drejtpërdrejtë të personit përgjegjës për zbatim*” (neni 23, par. 1). Po ashtu: “*Në rastet kur organi i punësimit apo personi përgjegjës nuk bashkëpunon, Këshilli i raporton për këtë mosbashkëpunim Kuvendit, i cili njoftimin ia përcjell Kryeministrit ose eprorit të drejtpërdrejtë të personit përgjegjës*” (neni 25, par. 3).

Madje, moszbatimi i vendimeve ka edhe pasoja financiare: “*Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit (...), Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit*” (neni 24, par. 1).

Të gjitha këto dispozita të Ligjit për Këshillin e kanë edhe **qëllimin** edhe **efektin** që ta detyrojnë Avokatin e Popullit të pranojë udhëzime dhe ndërhyrje nga Këshilli. Në këtë

mënyrë, Ligji paraqet një shkelje të drejtpërdrejtë të nenit 132, par. 2 të Kushtetutës, i cili e detyron Avokatin e Popullit pikërisht që *“të mos pranojë udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera”*.

Avokati i Popullit thekson se udhëzimet dhe ndërhyrjet që parashikohen me Ligjin për Këshillin, nuk janë të parëndësishme. Përkundrazi, këto udhëzime dhe ndërhyrje e prekin vetë thelbin e pavarësisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, duke e cenuar rëndë pavarësinë *organizative* të këtij Institucioni.

Sipas Vendimit V-19-07 të Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë në rastin nr. 43/13 (2007) (të cituar nga kjo Gjykatë në Aktgjykimin e saj në Rastin KO73/16, të cituar më lart), pavarësia organizative e Avokatit të Popullit përfshin të drejtën për të zgjedhur vetë punonjësit e Institucionit, pa ndërhyrje prej institucioneve të tjera: *“Përveç çështjeve që kanë të bëjnë me zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e drejtuesve apo funksionarëve të tjerë të lartë (...), pavarësia organizative gjen shprehje edhe në të drejtën e tyre që të hartojnë e caktojnë vetë, në përputhje me kritere të caktuara, strukturën dhe organikën e tyre, përfshirë këtu edhe të drejtën e caktimit të drejtorëve dhe këshilltarëve, numrin dhe përbërjen e funksionarëve të kabineteve ndihmëse, emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta, rekrutimin e personelit në nivele të ndryshme, etj.”*

Duke i dhënë Këshillit të drejtën për të ndërhyrë në të gjitha aspektet e procesit të rekrutimit brenda Institucionit të Avokatit të Popullit, në “zgjedhjen, emërimin apo shkarkimin e drejtuesve apo funksionarëve të tjerë të lartë”, si dhe në “emërimin e funksionarëve të niveleve më të ulëta”, Ligji për Këshillin jo vetëm që e obligon Avokatin e Popullit, në mënyrë qartazi kundër kushtetuese, “të pranojë udhëzime e ndërhyrje” nga një organ tjetër, po edhe e shkatërron pavarësinë organizative të këtij Institucioni.

Për më tepër, Ligji për Këshillin vuan prej së njëjtës mangësi si Qarkorja Administrative, të cilën kjo Gjykatë e shfuqizoi si të papajtueshme me Kushtetutën, në Rastin KO73/16. Kjo mangësi ishte se “Qarkorja Administrative e kontestuar (...) nuk e parashikon dallimin e domosdoshëm ndërmjet institucioneve të pavarura dhe organeve të tjera të shtetit” (*po aty*, par. 95). Sipas Gjykatës, “nuk mund të mjaftohet duke aplikuar kritere identike me ato që aplikohen për agjencitë qeveritare, t’i aplikojë në mënyrë të njëjtë edhe për institucionet e pavarura të përcaktuara në Kushtetutë” (*po aty*, par. 74). Përkundrazi, “[n]jë qasje teknike dhe unifikuese shpërfill rolin dhe autoritetin e [Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Kushtetuese] të definuar me Kushtetutë dhe, si e tillë, prek në pavarësinë që u është akorduar atyre me Kushtetutë dhe që është elaboruar më tej me ligjet e tyre organike dhe me rregulloret e tyre të punës” (*po aty*, par. 87).

Ligji për Këshillin është kushtetutshmërisht i mangët, për arsye se ai e imponon mbi Avokatin e Popullit pikërisht këtë qasje “teknike dhe unifikuese”, e cila i jep Këshillit të njëjtat kompetenca kundrejt të gjitha institucioneve, pa bërë “dallimin e domosdoshëm ndërmjet institucioneve të pavarura dhe organeve të tjera të shtetit”. Madje, kjo qasje “teknike dhe unifikuese” dallon, për shembull, prej Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili parashikon shprehimisht: *“Gjatë zbatimit të këtij ligji, respektohet pavarësia*

kushtetuese e institucioneve të pavarura nga ekzekutivi” (po aty, neni 3, par. 7). Asnjë dispozitë e tillë, e cila mund të kishte theksuar se, gjatë zbatimit të Ligjit për Këshillin, “respektohet pavarësia kushtetuese e institucioneve të pavarura nga Këshilli”, nuk përfshihet askund në Ligj. Pa përfshirjen e këtij diferencimi, Ligji për Këshillin paraqet shkelje të pavarësisë kushtetuese jo vetëm të Avokatit të Popullit, por të të gjitha institucioneve të pavarura.

Megjithatë, Avokati i Popullit dëshiron të theksojë se, edhe pse sipas Kushtetutës, ai nuk mund të **detyrohet** të pranojë udhëzime e ndërhyrje nga Këshilli, sikundër nga asnjë organ tjetër, Këshilli prapëseprapë mund të luajë një rol **këshillues** për Avokatin e Popullit, lidhur me çështjet në fushëveprimin e Këshillit, si p.sh., zhvillimin e konkurseve për punësim. Mirëpo, në fund të fundit, duhet të jetë vetë Avokati i Popullit ai që vendos nëse do të zbatojë sugjerimet e Këshillit apo jo. Me fjalë të tjera, në mënyrë që të jenë në përputhje me Kushtetutën, këto sugjerime duhet të mbeten thjesht **sugjerime**, jo udhëzime të obligueshme, e cila është mënyra se si paraqiten në Ligjin aktual.

Ky dallim, ndërmjet sugjerimeve jo të obligueshme dhe udhëzimeve të obligueshme, është i rëndësishëm për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dispozitave të ndryshme të Ligjit. Për shembull, Avokati i Popullit nuk ka asnjë kritikë a kundërshtim ndaj nenit 25, par. 1 të Ligjit, i cili përcakton: *“Këshilli bashkëpunon me institucionet e administratës publike për të kryer funksionet e tij në përputhje me këtë ligj”*. Përkundrazi, Avokati i Popullit e mirëpret një bashkëpunim të tillë, në bazë vullnetare. Mirëpo, paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, të cilët e **obligojnë** Avokatin e Popullit të bashkëpunojë me Këshillin, paraqesin shkelje të pavarësisë së Avokatit të Popullit dhe, si të tillë, duhen shfuqizuar si të papajtueshëm me Kushtetutën

Siç u vërejt më sipër, Ligji i jep Këshillit kompetencën për të mbikëqyrur çdo institucion që konsiderohet pjesë e shërbimit civil, sipas përkufizimit të dhënë me Ligjin për Shërbimin Civil, duke përfshirë “administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministritë, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administratën komunale” (Ligji për Shërbimin Civil, neni 1, par. 2).

Mirëpo, ky fushëveprim jashtëzakonisht i gjerë i Këshillit bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me fushëveprimin e tij të ngushtë që parashikohet në Kushtetutë.

Këshilli përmendet vetëm një herë në të gjithë Kushtetutën, në Kapitullin VI të saj (“Qeveria e Republikës së Kosovës”), përkatësisht në nenin 101 (“Shërbimin Civil”) të këtij Kapitulli. Sipas nenit 101, par. 2: *“Një Këshill i Pavarur Mbikëqyrës për shërbimin civil siguron respektimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil dhe i cili pasqyron diversitetin e popullit të Republikës së Kosovës”*.

Kushtetuta nuk e përkufizon shprehimisht termin “shërbimi civil”, as nuk e përcakton se punonjësit e cilave institucione konsiderohen pjesë e këtij “shërbimit civil”. Mirëpo, edhe në mungesë të një përkufizimi të tillë, fakti që neni 101 përfshihet brenda Kapitullit VI, tregon qartë se, **në nivelin kushtetues**, shërbimi civil konsiderohet pjesë e **Qeverisë**.

Jo vetëm në këtë rast, por në të gjithë strukturën e Kushtetutës, klasifikimi i institucioneve sipas kapitullit ku paraqiten, përbën një parim të rëndësishëm të interpretimit. Për shembull, Kushtetuta, në asnjë dispozitë të saj, nuk përcakton shprehimisht se Auditori i Përgjithshëm e ka statusin e institucionit të pavarur (*shih* Kushtetutën, nenet 136–138). Mirëpo, fakti që neni 136 (“Auditori i Përgjithshëm i Kosovës”) përfshihet brenda Kapitullit XII (“Institucionet e Pavarura”), mjafton për të vërtetuar statusin e këtij institucioni si institucion i pavarur, edhe në mungesën e një përcaktimi të tillë eksplicit.

Sipas të njëjtit arsyetim, fakti që neni 101 (“Shërbimi Civil”) paraqitet në Kapitullin VI (“Qeveria e Republikës së Kosovës”), mjafton për të vërtetuar statusin e shërbimit civil si pjesë e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, kur Kushtetuta ia jep Këshillit kompetencën për të mbikëqyrur “shërbimin civil”, ky i fundit duhet kuptuar si *pjesë e Qeverisë*. Kushtetuta nuk i jep Këshillit asnjë bazë për të mbikëqyrur “shërbimin civil” në kuptimin më të gjerë të atij termi që përdoret në Ligjin për Shërbimin Civil. Prandaj, kur Ligji për Këshillin e përcakton fushëveprimin e Këshillit për të përfshirë jo vetëm institucionet e Qeverisë, por edhe institucionet e tjera, sikurse Institucionin e Avokatin e Popullit, ai e bën që Këshilli ta tejkalojë kompetencën e tij kushtetuese, e cila është *ekskluzivisht* për të mbikëqyrur shërbimin civil në kuadër të Qeverisë.

Për më tepër, duke marrë parasysh faktin e evidentuar më lart, që Kushtetuta e detyron Avokatin e Popullit që të mos pranojë “udhëzime e ndërhyrje nga organet, institucionet ose autoritetet e tjera”, është e domosdoshme që Kushtetuta të mos interpretohet në atë mënyrë që t’i jepet Këshilli kompetenca për të mbikëqyrur Institucionin e Avokatit të Popullit. Në të kundërtën, do të kishte një kontradiktë të drejtpërdrejtë ndërmjet nenit 101 të Kushtetutës, i cili do t’i jepte Këshillit të drejtën për të udhëzuar dhe për të ndërhyrë në Institucionin Avokatit të Popullit, dhe nenit 132, i cili e ndalon pikërisht një gjë të tillë. Në mënyrë që të shmanget kjo kontradiktë, është e domosdoshme që termi “shërbimi civil” të interpretohet në mënyrë të kufizuar, duke mos përfshirë stafin e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ky interpretim i ngushtë konfirmohet edhe nga Enver Hasani dhe Ivan Cukalovic në udhëzuesin e tyre, *Kushtetuta e Republikës së Kosovës: Komentar*. Në këtë Komentar, ata shkruajnë se shërbimi civil “është i varur institucionalisht për *qeverinë*” dhe se ai “ushtron (...) funksionin e zbatimit administrativ të detyrave administrative të *qeverisë*” (*po aty*, f. 470; theks i shtuar). Ky interpretim e konfirmon edhe një herë se e vetmja kompetenca kushtetuese e Këshillit është që t’i mbikëqyrë institucionet e Qeverisë, por jo edhe institucionet tjera jashtë saj, sikurse Institucionin e Avokatit të Popullit.

Duhet theksuar se këtë interpretim nuk e pengon aspak fakti që Ligji për Shërbimin Civil i jep një kuptim më të gjerë termit “shërbimi civil”. Një parim i rëndësishëm i interpretimit është që termat kushtetues kanë një kuptim *autonom* që nuk varen prej akteve të tjera më të ulëta juridike.

Ky parim gjen shprehje edhe në vendimet e kësaj Gjykate. Mund ta marrim si shembull interpretimin e termit “penale” në nenin 31, par. 2 të Kushtetutës, i cili përcakton: *“Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet (...) për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij”* (theks i shtuar). Në interpretimin e kësaj dispozite, kjo Gjykatë ka pohuar se klasifikimi i një veprë si “penale” ose jo në nivelin **ligjor**, nuk mund të jetë vendimtar për çështjen nëse ajo veprë konsiderohet “penal” në nivelin **kushtetues**. Me fjalë të tjera, autoritetet shtetërore nuk mund ta mohojnë të drejtën e garantuar me nenin 31 të Kushtetutës thjesht duke riklasifikuar dhe ripërkufizuar një veprë **penale** si veprë **kundërvajtëse** (shih Aktgjykimin e kësaj Gjykate në Rastin KO12/17, *Vlerësim i përputhshmërisë me Kushtetutën të neneve 55 (paragrafët 4 dhe 5), 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67 dhe 68) të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje* (2017), par. 61–62). Në të njëjtën mënyrë dhe sipas të njëjtit arsyetim, termi “shërbimi civil” ka një kuptim autonom në nivelin kushtetues, një kuptim që përfshin vetëm stafin e institucioneve të Qeverisë. Ky kuptim i ngushtë kushtetues nuk mund të shmanget duke ia dhënë termit një kuptim më të gjerë në nivelin ligjor.

Për këto arsye, duke i dhënë Këshillit kompetencën për të mbikëqyrur institucionet jashtë Qeverisë, Ligji bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Kapitullin VI të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili qartazi e përcakton shërbimin civil si pjesë të Qeverisë.

Neni 11, par. 3 të Ligjit përcakton: *“Kryetari dhe anëtarët e Këshillit lidhur me vendimmarrjen në kuadër të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi”*.

Ky imunitet i gjerë nuk ka asnjë bazë në Kushtetutë. Kushtetuta shprehet shumë qartë dhe shumë hollësisht se cilët zyrtarë shtetërorë gëzojnë imunitet, dhe se sa i gjerë është ky imunitet në secilin rast. Në këtë drejtim, sipas Kushtetutës, vetëm deputetët e Kuvendit (neni 75), presidenti (neni 89), anëtarët e Qeverisë (neni 98), gjyqtarët e gjykatave të rregullta (neni 107), gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese (neni 117) dhe Avokati i Popullit (neni 134) gëzojnë imunitet. Për dallim prej këtyre, Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës nuk i jepet asnjë lloj imuniteti në tekstin e Kushtetutës. Për këtë arsye, në bazë të praktikës së kësaj Gjykate, edhe nuk duhet të gëzojë asnjë lloj imuniteti.

Në Aktgjykimin e Rastit Nr. KO 98/1, *Lidhur me imunitetin e deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Presidentit të Republikës së Kosovës dhe anëtarëve të Qeverisë së Republikës së Kosovës*, kjo Gjykatë ka konsideruar, mes të tjerash, çështjen nëse neni 22(3) i Rregullores së punës së Kuvendit, i cili përcaktonte se *“Deputeti gëzon imunitet ndaj (...) ndjekjes penale, përderisa Kuvendi nuk merr vendim për heqjen e imunitetit të tij”*, ishte apo nuk ishte në përputhje me Kushtetutën. Gjykata i dha përgjigje negative kësaj pyetjeje, duke konstatuar se kjo dispozitë ishte *“pa vlerë juridike, pasi në Kushtetutë nuk ka imunitet të tillë ndaj ndjekjes penale të deputetit”* (po aty, par. 70; theks i shtuar).

Ky konstatim i Gjykatës bazohej në një parim kyç: *“Imuniteti nuk mund të jepet me akte të tjera juridike nëse nuk parashikohet nga vetë Kushtetuta.”* Kushtetuta është i vetmi akt juridik që përcakton se cilët zyrtarë gëzojnë imunitet dhe sa i gjerë është ky imunitet.

Me fjalë të tjera, është Kushtetuta ajo që e ka fjalën e parë dhe të fundit për sa i përket çështjes së imunitetit të zyrtarëve shtetërorë.

Në bazë të argumenteve të lartcekura, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës, me anë të kësaj parashtrëse, kërkon që Gjykata të vendosë masë të përkohshme për pezullimin e menjëhershëm të dispozitave të kontestuara, përkatësisht, nenet 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (nënpagrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ***ose të paktën pezullimin e zbatimit të këtyre dispozitave në raport me Avokatin e Popullit.***

Avokati i Popullit konsideron se argumentet e parashtruara në këtë kërkesë japin bazë më shumë se *prima facie* për shfuqizimin e dispozitave të kontestuara.

Në mungesën e miratimit të masës së përkohshme, funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit do të pengohet rëndë prej ndërhyrjeve të vazhdueshme të Këshillit në këtë institucion. Deri tani, Këshilli ka anuluar rezultatet e katër konkurseve për punësim të shpallura prej Avokatit të Popullit. Mungesa e stafit të mjaftueshëm për të trajtuar ankesat e qytetarëve që vijnë nëpër dyert e Institucionit do të rezultojë në pamundësinë e stafit ekzistues për t'u dhënë vëmendjen e duhur këtyre ankesave, duke përfshirë ankesat e natyrës urgjente. Sidomos në këto raste urgjente, ndërhyrjet e vazhdueshme të Këshillit do të shkaktojnë dëme të riparueshme për qytetarët e Republikës së Kosovës. Në mënyrë që të shmangen këto dëme, Avokati i Popullit konsideron, me respekt, se është e domosdoshme që kjo Gjykatë t'i pezullojë menjëherë dispozitat e kontestuara, në bazë të të cilave Këshilli po pengon punën efikase të Avokatit të Popullit dhe punonjësve të tij.

Institucioni i Avokati i Popullit shërben shpeshherë si shpresa e fundit për viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut që t'i adresojnë këto shkelje si dhe t'u japin zgjidhje. Pamundësia e funksionimit normal dhe ushtrimit të mandatit të Avokatit të Popullit, si institucion i vetëm kombëtar për të drejtat e njeriut pashmangshëm do të pamundësonte mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të Republikës së Kosovës. Për këtë arsye, Avokati i Popullit konsideron se miratimi i masës së përkohshme, me qëllim që të sigurohet plotësimi sa më i shpejtë i stafit të Institucionit, është qartazi me interes publik.

Për arsyet e lartpërmendura, Avokati i Popullit propozon që nenet 2, 3 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 4 (paragrafi 1) 6, 7 (paragrafi 1, nënparagrafët 2, 3 dhe 4), 11 (paragrafi 3), 18, 19 (nënpagrafët 5, 6, 7 dhe 8), 20 (paragrafi 5), 21, 23, 24 dhe 25 (paragrafët 2 dhe 3) të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, të shfuqizohen, si dhe të pezullohen menjëherë deri në vendimin përfundimtar të kësaj Gjykate.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj), të cilat janë të themeluara në pajtueshmëri me standardet e përcaktuara në Parimet e Parisit⁴⁴¹, luajnë rol thelbësor në mbikëqyrjen dhe promovimin e zbatimit efektiv të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në nivel kombëtar, rol ky që po vlerësohet gjithnjë e më shumë nga sistemi ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Marrëdhënia ndërmjet IKDNj-së dhe sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut është marrëdhënie e dyanshme dhe shumë e rëndësishme. Në njërin anë, sistemi ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ndihmon dhe promovon IKDNj-të dhe ka miratuar Parimet e Parisit si standarde normative kryesore për funksionimin e tyre, në anën tjetër, IKDNj-të i kontribuojnë sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut me pjesëmarrjen në sesionet e Këshillit për të Drejtat e Njeriut të Kombeve të Bashkuara, duke përdorur procedurën e ankesës për të sjellë në vëmendjen e Këshillit shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, apo duke bashkëpunuar me organet tjera të Kombeve të Bashkuara.

Rëndësinë e IKDNj-ve në sistemin ndërkombëtar e pohon edhe Komisionerja e Lartë për të Drejtat e Njeriut e Këshillit të Evropës, znj. Dunja Mijatović, e cila në deklaratën e saj me rastin e 25-vjetorit të miratimit të Parimeve të Parisit, thotë: *“IKDNj-të e pavarura dhe efektive janë një thesar i çmuar i sistemit të të drejtave të njeriut. Ato i sjellin detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në shtetet e tyre për t’i bërë ato një realitet në jetën e përditshme të njerëzve dhe veprojnë si organe të kontrollit për të ruajtur demokracinë dhe sundimin e ligjit. Ne kemi nevojë për të mbrojtur IKDNj-të në mënyrë që ato të jenë të forta dhe të na mbrojnë të gjithëve.”*⁴⁴²

Institucioni i Avokatit të Popullit, si institucion i pavarur kushtetues për të drejtat e njeriut në Kosovë, është i përkushtuar që të veprojë si urë lidhëse në shkëmbimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut. Prandaj, një nga prioritetet e tij ka vazhduar të jetë edhe bashkëpunimi me institucionet homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut.

Megjithatë, meqë Republika e Kosovës ende nuk është anëtarësuar në Kombet e Bashkuara, Institucioni i Avokatit të Popullit e ka të kufizuar mundësinë për të kontribuar në sistemin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, për shkak të barrierave politike. Mirëpo, si institucion i pavarur kushtetues është i përkushtuar që të bashkëpunojë dhe të kontribuojë aty ku ka mundësi, por gjithashtu t’i përgatisë kapacitetet e tij që, në një të ardhme, kurdo që të ndodhë anëtarësimi, të jetë në gjendje të marrë përsipër obligimet e veta në kuadër të sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

⁴⁴¹ Parimet e Parisit janë kritere minimale që duhet t’i ketë një Institucion Kombëtar për të Drejtat e Njeriut që të konsiderohet kredibil, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare

⁴⁴² Parimet e Parisit në 25-vjetorin e tyre: Institucione të forta Kombëtare për të Drejtat e Njeriut na duhen më shumë se kurrë, <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/paris-principles-at-25-strong-national-human-rights-institutions-needed-more-than-ever>, (25.01.2019)

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke e ditur rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe ndërveprimit me organizata dhe rrjete të ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, ka marrë pjesë në një sërë takimesh, të cilat janë të paraqitura në tabelën e mëposhtme.

Nr.	Përshkrimi i aktivitetit	Data
1.	Takimi i ENNHRI lidhur me projektin “Roli i IKDNj-së në situatat e konfliktit dhe post-konfliktit” Bruksel, Belgjikë	30-31 janar 2018
2.	Trajnim mbi aktin themelues për të drejtat themelore të Agjencionit të Bashkimit Evropian për të Drejtat e Njeriut Vjenë, Austri	6-7 shkurt 2018
3.	Konferenca rajonale për çështjet e anti-diskriminimit dhe anti-gypsyismit Berlin, Gjermani	13-14 shkurt 2018
4.	Konferenca Shkencore mbi “Rolin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në procedurat administrative dhe gjyqësore”, Sarajevë, Bosnje	15-16 shkurt 2018
5.	Punëtori mbi rolin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të zhvendosur brenda vendit Gjenevë, Zvicër	20 shkurt 2018
6.	Takimi vjetor i Aleancës Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (GANHRI) Gjenevë, Zvicër	21-23 shkurt 2018
7.	Punëtori mbi monitorimin dhe raportimin mbi të drejtat e njeriut Chişinău, Moldova	5-7 mars 2018
8.	Konferencë Nderkombetare mbi “Monitorimin e Shtëpive të Pleqve” Trier, Gjermani	12-13 mars 2018
9.	Punëtori mbi zhvillimin e strategjisë Beograd, Serbi	12-13 mars 2018
10.	Forumi i pestë rajonal mbi Sundimin e Ligjit në Evropën Juglindore Shkup, Maqedoni	16-17 mars 2018
11.	Trajnim Rajonal për monitoruesit e kthimit me forcë Beograd, Serbi	9-13 prill 2018

12.	“Trajnimi i Eskorteve në procesin e kthimit të migrantëve” (IAP në cilësinë e trajnuesit) Danilovgrad, Mal e Zi	18-19 prill 2018
13.	Forumi i Mekanizmave Kombëtarë të Parandalimit Astana, Kazakistan	23-26 prill 2018
14.	Takimi i NPM-ve të Evropës Juglindore me fokus në temën: “Parandalimi i vetëvrasjeve dhe mbidozave në qendrat e paraburgimit, si dhe statusi i stafit të NPM-ve në shtetet anëtare të BE-së Podgoricë, Mali i Zi	29-30 maj 2018
15.	Takim në mes të CoE-FRA-ENNHRI-EQUINET për platformën tematike mbi të drejtat sociale dhe ekonomike Belfast, Irlanda Veriore.	15-16 maj 2018
16.	Takimi për shënimin e 20-vjetorit të themelimit të Avokatit të Popullit të Maqedonisë dhe Takimi i Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheur, me temën: “Ombudsmani si mbrojtës i të drejtave sociale, kulturore dhe mjedisore” Shkup, Maqedoni	30-31 maj 2018
17.	Punëtori lidhur me rishikimin e Ligjit të Familjes për format e veçanta për mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror Tiranë, Shqipëri	24-28 qershor 2018
18.	Vizitë studimore për stafin e Mekanizimit Kombëtar të Parandalimit Varshavë, Poloni	24-29 qershor 2018
19.	Vizitë studimore Tiranë, Shqipëri	20-22 qershor 2018
20.	Akademia Verore e Institutit Suedez për profesionistë të rinj të Ballkanit Perëndimore 2018	3-16 gusht 2018
21.	Programi i lidershit për vizitorët ndërkombëtarë lidhur me “Të drejtat e njeriut dhe të drejtat civile të komuniteteve të margjinalizuara” Shtetet e Bashkuara të Amerikës	6-24 gusht 2018
22.	Trajnimi “Procedurat kolektive të dëmshpërblimeve përmes urdhrave” Bratislavë, Sllovaki	3-6 shtator 2018
23.	Vizitë studimore në kuadër të projektit me shoqërinë civile “Together for social inclusion in Kosovo” Pragë, Republika e Çekisë	9-14 shtator 2018
24.	Forumi i punës për bashkëpunim ndërinstytucional: Parandalimi i keqtrajtimit në shërbimet e shëndetit mendor dhe të kujdesit social Beqiq, Mali i Zi	17 – 19 shtator 2018

25.	Takimi i 22-të vjetor i Rrjetit të Ombudsmanëve Evropianë për Fëmijë dhe Konferenca Vjetore për shëndetin mendor të fëmijëve Paris, Francë	19-21 shtator 2018
26.	Asambleja e Përgjithshme e Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve Bruksel, Belgjikë	1-3 tetor 2018
27.	Takimi i Grupit Punues të ENNHRI për Konventën për Personat me Aftësi të Kufizuar Riga, Letoni	2-4 tetor 2018
28.	Konferenca Vjetore e me temën “Ne kërkojmë të ardhmen edhe përkundër mundësive” Shkup, Maqedoni	4-8 tetor 2018
29.	Takimi i Këshillit të Përgjithshëm të OSBE-së Vjenë, Austri	9 – 11 tetor 2018
30.	Takimi ballë për ballë në kuadër të projektit të përbashkët të BE/Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik (PECKII) Strasburg, Francë	11-12 tetor 2018
31.	Takimi për rastet me vetiniciativë Belfast, Irlanda e Veriut	22-23 tetor 2018
32.	Asambleja e Përgjithshme e ENNHRI dhe Konferenca Vjetore 2018 Athinë, Greqi	24-25 tetor 2018
33.	Vizitë studimore lidhur me praktikat më të mira gjermane mbi monitorimin e pavarur të situatës së të miturve në institucione korrektuese dhe ofrimin e shërbimeve në komunitet që kanë ndikim në jetën e fëmijëve nëpërmjet zhvillimit dhe ofrimit të shërbimeve të parandalimit, mbrojtjes dhe riintegritimit Berlin, Gjermani	22-26 tetor 2018
34.	Konferenca e Tretë e Përbashkët e Organeve të Barazisë Tiranë, Shqipëri	29 tetor 2018
35.	Konferenca rajonale “Përfshija e Romëve pas Dekadës së Romëve: Situata e tanishme dhe sfidat e së ardhmes” Shkup, Maqedoni	7-8 nëntor 2018
36.	Takimi i Grupit Punues për Azil dhe Migrim të ENNHRI Bruksel, Belgjikë	13-14 nëntor 2018
37.	Konferenca rajonale “Shoqëritë Tolerante dhe Gjithëpërfshirëse të Ballkanit Perëndimor” Podgoricë, Mali i Zi	14-15 nëntor 2018

38.	Forumi i Ombudsmanëve të Ballkanit, me temën “Mbrojtja e të drejtave të njeriut: Sfidat për bashkëpunim në Ballkan” Sofje, Bulgari	19 nëntor 2018
39.	Takim në mes të CoE-FRA-ENNHRI-EQUINET mbi platformën tematike mbi të drejtat sociale dhe ekonomike Strasburg, Francë	27-28 nëntor 2018
40.	Konferenca ndërkombëtare për lirinë e shprehjes Budapest, Hungari	26-27 nëntor 2018
41.	Konferenca rajonale “Avokimi për të drejtat e njeriut dhe jodiskriminimi nga Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut të Ballkanit Perëndimor” Sarajevë, Bosnje	29-30 nëntor 2018
42.	Takimi i komunitetit praktik në angazhimin e Institucioneve Kombëtare për të drejtat e njeriut në të drejtat në shëndetin seksual dhe riprodhues Stamboll, Turqi	5-6 dhjetor 2018
43.	Tryeza rajonale “Ndalimi i migrantëve dhe alternativat efektive” Podgoricë, Mali i Zi	12 dhjetor 2018
44.	Punëtori për finalizimin e Programit të MSA-së – Kriterët politike dhe sundimi i ligjit Tiranë, Shqipëri	9-12 dhjetor 2018
45.	Punëtorja “Rishikimi FunkSIONAL i Sektorit të Drejtësisë si pararendës i procesit drejt Integritimit Europian” Durrës, Shqipëri	14-16 dhjetor 2018

Tabela: Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

Bashkëpunimi me homologë dhe organizata të tjera ndërkombëtare

Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare në Kosovë është një element i rëndësishëm i punës së Institucionit të Avokatit të Popullit. Kemi kënaqësinë të raportojmë që bashkëpunimi me homologë nga vende të ndryshme, me rrjete dhe organizata ndërkombëtare jashtë vendit dhe ato që janë me mision në Kosovë, është jashtëzakonisht i mirë. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar një sërë aktivitete, të cilat janë të pasqyruara më poshtë.

Në sesionin paraprak u raportua se IAP-ja gjatë vitit 2018 ka marrë pjesë në 45 aktivitete të ndryshme ndërkombëtare. Pjesëmarrja në këto aktivitete ka qenë edhe mundësi e mirë e shkëmbimit të informatave dhe praktikave më të mira, në mënyrë që të njëjtat të zbatohen edhe në Kosovë.

Në vijim do t'i përmendim disa nga takimet më të rëndësishme ndërkombëtare:

Më 13 dhe 14 shkurt 2018, Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën shkencore mbi “Rolin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në procedurat administrative

dhe gjyqësore”, e organizuar nga Ombudsmeni i Bosnjë dhe Hercegovinës në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, OSBE-në, Fakultetin Juridik të Universitetit të Sarajevës dhe Fakultetin Juridik të Uiversitetit të Banja Lukës. Konferenca u mbajt në Asamblenë Parlamentare në Sarajevë të Bosnje e Hercegovinës. Organizimi i kësaj konference kishte për qëllim shkëmbimin e njohurive shkencore, profesionale dhe praktike të pozitës së Avokatit të Popullit (Ombudsmanëve) dhe organeve të barazisë në procedurat administrative dhe gjyqësore.

Avokati i Popullit z. Hilmi Jashari, në këtë konferencë kontribuoi me një artikull shkencor mbi “Rolin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut në procedurat administrative dhe gjyqësore” në rastin e Republikës së Kosovës. Nëpërmjet këtij artikulli, Avokati i Popullit argumenton se *IKDNj duhet të gëzojnë të paktën katër kompetenca specifike ndaj autoriteteve gjyqësore: 1) fuqinë për t’iu referuar ligjeve dhe akteve të tjera normative në Gjykatën Kushtetuese për shqyrtim abstrakt; 2) kompetencën për të kërkuar anulimin e akteve administrative; 3) fuqia për të paraqitur informatat e amicus curiae në rastet e pazgjidhura para gjykatave; dhe 4) fuqia për të marrë pjesë në monitorimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Gjithashtu argumenton se në vendet me tradita demokratike relativisht të reja ose më pak të zhvilluara, është akoma më e rëndësishme që IKDNj-ve t’u jepen këto kompetenca.*

Gjithashtu, vlen të përmendet takimi i Asociacionit të Ombudsmanëve Mediteran – AOM, me temë “Ombudsmeni si mbrojtës i të drejtave sociale, kulturore dhe mjedisore”, që u organizua me qëllim të shënimit të 10-vjetorit të themelimit të Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) dhe 20-vjetorit të themelimit të Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë, mbajtur më 30 dhe 31 maj 2018, në Shkup të Maqedonisë.

Gjatë këtij takimi, Avokati i Popullit z. Hilmi Jashari sjelli diskursin e Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, në drejtim të mbrojtjes dhe promovimit të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe prezantoi shkurtimisht gjendjen e përgjithshme të realizimit të kësaj të drejte në Republikën e Kosovës. Ndërsa u zotua se Institucioni i Avokatit të Popullit do të vazhdojë të ushtrojë me përkushtim mandatin e tij në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve dhe mbrojtjes së mjedisit për gjeneratat e ardhshme, e në veçanti të fuqizojë kapacitetet e institucionit për mbrojtjen e së të drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, në mënyrë që interpertimi i së drejtës të bëhet në harmoni me vendimet e GjEDNj-së.

Po ashtu, siç edhe ishte planifikuar, Asociacioni i Ombudsmanëve të Medheut (AOM) gjatë takimit të Asamblesë Gjenerale vendosi në rend të ditës letrën e Avokatit të Popullit, që më 14 nëntor 2017 ua dërgoi rrjeteve të Ombudsmanëve dhe Institucioneve për të Drejtat e Njeriut me kërkesë dhe propozime që së bashku të marrin hapa konkret drejt zhvillimit të një sërë standardesh të unifikuara dhe praktikave më të mira për IKDNj në mbarë botën, të cilat mund të shërbejnë si burim i këshillave të dobishme dhe jo të detyrueshme për të udhëhequr punën e IKDNj-vë. Këto propozime u diskutuan hollësisht dhe u vlerësuan lart nga të gjithë anëtarët e AOM, të cilët propozuan që të shqyrtohen

mundësitë për identifikimin e veprimeve nga Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) me qëllim të realizimit të këtyre propozimeve.

Avokati i Popullit, në cilësinë e anëtarit me të drejtë vote në Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI),⁴⁴³ mori pjesë në Konferencën “Ombudsmani në një shoqëri të hapur dhe pjesëmarrëse”, si dhe në Asamblenë Gjenerale për Evropë të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), organizuar nga Ombudsmani i Belgjikës dhe Institutit Ndërkombëtar i Ombudsmanëve, që u zhillua më 1 – 3 tetor 2018 në Parlamentin e Belgjikës, në Bruksel.

Duke vlerësuar mbështetjen e Avokatit të Popullit, edhe këtë vit, ERA – Shoqata LGBTI për të drejtat e barabarta për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, kishte ftuar Avokatin e Popullit për të kontribuar në Konferencën Vjetore, me temë “Përkundër gjasave, ne pretendojmë të ardhmen”, e cila u mbajt më 4 – 6 tetor 2018 në Shkup të Maqedonisë. Në këtë konferencë Avokati i Popullit mori pjesë së bashku me zëvendësen e tij znj. Marija Radulovic.

Në cilësinë e panelistit, Avokati i Popullit foli për rolin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në promovimin e përfshirjes së komunitetit LGBTI, konkretisht për rëndësinë e rolit të Institucionit të Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI. Më tutje, prezantoi dy qëllime kryesore:

- *se si Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNj), siç është Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës, mund të luajnë një rol jetësor në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI me qëllim të promovimit të përfshirjes së tyre të plotë në shoqëri; dhe*
- *se si puna e këtij institucioni në Kosovë është zgjeruar në mënyrë progresive për të adresuar nevojat dhe interesat specifike të nevojave dhe interesave të njerëzve transgjnorë që mund të ndryshojnë nga ato të lesbikeve, homoseksualëve dhe biseksualëve.*

Të dy pikat u pasqyruan me një seri shembujsh nga puna e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Ndërsa konkludoi se janë tri mjete të rëndësishme që Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut kanë në dispozicion për të promovuar përfshirjen e plotë sociale të personave LGBTI:

- *ata mund të marrin një qëndrim të fortë publik, përfshirë përmes mediave, në mbrojtjen e të drejtave të personave LGBTI dhe promovimin e përfshirjes së tyre;*
- *ata mund ta përdorin autoritetin e tyre të monitorimit mbi institucionet e tjera shtetërore për të siguruar respektimin e plotë të të drejtave të njeriut të personave LGBTI, veçanërisht nga policia dhe organet e tjera hetimore;*

⁴⁴³ Institucioni i Avokatit të Popullit është anëtar institucional me të drejtë vote, që nga data 7 dhjetor 2012. Për më shumë informata rreth Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, vizitoni këtë uebfaqe: www.theioi.org

- të paktën në rastin e Kosovës, Avokati i Popullit është në gjendje të paraqesë informata për *amicus curiae* në gjykata për të mbështetur të drejtat ligjore të komunitetit LGBTI.

Këto veprime përbëjnë një forcë të fuqishme në luftën kundër diskriminimit dhe promovimin e barazisë së plotë dhe përfshirjen e komunitetit LGBTI.

Ky prezantim dhe analizë e Avokatit të Popullit u mirëprit dhe u vlerësua shumë lart nga të gjithë pjesëmarrësit e kësaj konference.

Avokati i Popullit vazhdoi të jetë prezent dhe për të dhënë kontribut edhe në disa takime të tjera ndërkombëtare. Ndër të tjera, vlen të përmendet që, me ftesë të Këshillit të Evropës, Avokati i Popullit, së bashku me zëvendësen e tij znj. Edona Hajrullahu, morën pjesë në Konferencën Rajonale “Shoqëri tolerante dhe gjithëpërfshirëse në Ballkanin Perëndimor”, që është mbajtur më 14 dhe 15 nëntor 2018 në Podgoricë të Malit e Zi. Gjatë takimit u diskutua rreth vendosjes së standardeve, monitorimit dhe bashkëpunimit në fushën e anti-diskriminimit, luftimit të gjuhës së urrejtjes, si dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave. Ndër të tjera, Avokati i Popullit, në kuadër të panelit “Iniciativat e suksesshme për mbrojtjen e minoriteteve në Ballkanin Perëndimor”, prezantoi kornizën ligjore në fuqi si dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e minoriteteve në Republikën e Kosovës.

Për më tepër, duhet të përmendim se me mbështetje të Këshillit të Evropës është realizuar një vizitë studimore tek Ombudsmani i Polonisë, që kishte në fokus shkëmbimin e praktikave të mira ndërkombëtare duke iu referuar mandatit shtesë të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Kjo vizitë u realizua në kuadër të projektit “Forcimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në Kosovë”, i mbështetur nga Këshilli i Evropës, Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Norvegjisë.

Bashkëpunim i mirë ekziston edhe me institucione të tjera homologe në rajon dhe më gjerë, me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit i Republikës së Kosovës është në komunikim të përhershëm për çështje të interesit të përbashkët.

Projektet me mbështetje të organizatave ndërkombëtare

IAP-ja edhe gjatë vitit 2018 ka vazhduar bashkëpunimin me Komisionin Evropian, Këshillin e Evropës, OSBE-në, UNICEF-in, UNMIK-un, UNDP-në dhe shumë organizata të tjera që veprojnë në vend, me qëllim të zbatimit të projekteve të ndryshme në lidhje me promovimin, mbrojtjen dhe edukimin e të drejtave të njeriut, të cilët kanë dhënë ndihmë të pakursyer për fuqizimin e institucionit, ngritjen e kapaciteteve të tij dhe promovimin e mandateve.

Një nga këto organizata është padyshim edhe Këshilli i Evropës, i cili vite me radhë ka ndihmuar institucionin në fuqizimin e rolit dhe mandatit, si dhe në ngritjen e kapaciteteve. Projekti “Forcimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin në Kosovë”, i mbështetur nga Këshilli i Evropës, Qeveria e Zvicrës dhe Qeveria e Norvegjisë, i cili ka filluar në korrik të vitit, ka vazhduar me shumë sukses edhe këtë vit. Ky projekt do të

përfundojë në prill të vitit 2019. Nëpërmjet këtij projekti synohet të ngrihen kapacitetet e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), i themeluar në kuadër të Institucionit të Avokatit të Popullit, për të zbatuar standardet ndërkombëtare dhe evropiane në fushën e parandalimit të torturës dhe keqtrajtimit dhe për të rritur ndërgjegjësimin e akterëve përkatës mbi rolin dhe mandatin e MKPT-së.

Gjithashtu, angazhimi i 4 këshilltarëve të jashtëm ligjorë, në kuadër të këtij projekti, ka dhënë një rezultat të lartë në ngritjen e kapaciteteve të institucionit për të përbashkuar një mandat të gjerë, siç e ka Institucioni i Avokatit të Popullit, pas hyrjes në fuqi të Pakos Ligjore për të drejtat e njeriut.⁴⁴⁴ Të gjitha këto aktivitete kanë pasur ndikim të qëndrueshëm në ngritjen e performancës dhe realizimin më të mirë të mandatit të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Gjithashtu, edhe këtë vit, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), si në të kaluarën, e mbështeti IAP-në me disa aktivitete. Në kuadër të këtij bashkëpunimi janë realizuar këto aktivitete të përbashkëta:

- Avokati i Popullit, së bashku me një grup të organizatave joqeveritare, të profileve të ndryshme, të përfaqësuara nga komunitetet joshumicë, personat me aftësi të kufizuara, forumet rinore, komuniteti i grave dhe grupet e marginalizuara, në muajin prill 2018, ka mbajtur një punëtori në kuadër të së cilës është bërë shqyrtimi i planit të përbashkët të veprimit të hartuar në vitin 2017, si dhe është bërë përcaktimi i prioriteteve për vitin 2018.
- Gjatë muajit qershor është mbajtur edhe tryeza e përbashkët me organizatat joqeveritare, shoqërinë civile dhe përfaqësues të institucioneve publike mbi të drejtën e qasjes në dokumente publike, me ç’ rast është diskutuar korniza ligjore në fuqi që rregullon këtë fushë, praktika e IAP-së në zbatimin e Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, sfidat dhe kufizimet me të cilat ballafaqohen qytetarët gjatë ushtrimit të kësaj të drejte.
- Gjatë muajit korrik – gusht 2018, ka mbajtur ciklin e punëtorive “Unë jam NJERI dhe kam të DREJTA”, në 10 (dhjetë) komuna të Kosovës, përkatësisht në Prishtinë, Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Mitrovicë, duke përfshirë edhe pjesën veriore, Pejë, Gjilan, Dragash dhe Graçanicë. Qëllimi i këtij cikli të punëtorive ka qenë zgjerimi i njohurive dhe ngritja e vetëdijesimit për të drejtat e njeriut, çështjen e barazisë dhe mosdiskriminimit në mesin e të rinjve të moshës 15-25 vjeç. Punëtoritë janë mbajtur në rajone të ndryshme të Kosovës, ku vëmendje të veçantë i është kushtuar gjithpërfshirjes së të rinjve të të gjitha komuniteteve në vend, si: serbë, turq, romë, ashkalinj, egjiptianë, boshnjakë e goranë. Punëtoritë ka pasur për qëllim edhe promovimin e garës “Të drejtat e njeriut përmes artit”, për poezinë dhe fotografinë më të mirë për të drejtat e njeriut, e organizuar nga

⁴⁴⁴ Për më shumë informata për kornizën ligjore mbi të cilat IAP realizon mandatin e tij, shih linkun <https://www.oik-rks.org/legjislacioni/ligjet/>

OSBE-ja. Aktiviteti ka pasur për qëllim paraqitjen e të drejtave të njeriut përmes artit, si dhe inkurajimin e të rinjve për të menduarit me reflektim përmes artit, për të drejtat e njeriut dhe shkeljet apo kufizimet e tyre. Aktiviteti ka përfunduar më 10 dhjetor 2018, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, me organizimin e ekspozitës me poezi dhe fotografi të të rinjve nga mbarë Kosova, dhe ndarjen e çmimeve për veprat më të mira artistike.

- Gjatë vitit 2018, Misioni i OSBE-së në Kosovë, në kuadër të projektit “Promovimi i sektorëve ligjor dhe juridik duke respektuar të drejtën e barazisë para ligjit, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike, feja apo karakteristikat e tjera personale”, ka mbështetur Institucionin e Avokatit të Popullit në zhvillimin e ueb-faqes së re të institucionit dhe platformës “online” për raportet e OJQ-ve. Në këtë drejtim është lansuar ueb-faqja e re e IAP-së dhe platformë e qasshme në ueb-faqen e IAP-së, e cila është dizajnuar me qëllim të ofrimit të një qasjeje gjithëpërfshirëse ndërinstitucionale dhe pa kufizim, në të cilën platformë do të ekspozohen raportet dhe rekomandimet e organizatave të shoqërisë civile, që punojnë dhe kontribuojnë për të drejtat e njeriut në Kosovë.

Në kuadër të bashkëpunimit me UNICEF-in janë realizuar takime të përbashkëta vazhdimisht, me qëllim të ngritjes së nivelit të respektimit të të drejtave të fëmijëve. Ndërsa, me mbështetjen e UNICEF-it, dy përfaqësues të IAP-së morën pjesë në një vizitë studimore, e cila u mbajt më 23-24 tetor 2018, në Gjermani. Qëllimi i kësaj vizite ishte njoftimi me punën dhe përvojat e institucioneve qeveritare dhe joqeveritare gjermane në fushën e delikuencës së të miturve.

Gjithashtu ka vazhduar bashkëpunim i mirë edhe me *Terre de Hommes*, të cilët gjatë vitit 2018 e kanë mbështetur IAP-në me realizimin e një trajnimit për stafin, lidhur me teknikat e intervistimit të fëmijëve si dhe janë në proces të krijimit të procedurave për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave, që lidhen me çështjet e të drejtave të fëmijëve, të cilat do të jenë shumë të dobishme për Departamentin për të Drejtat e Fëmijëve në kuadër të IAP-së.

Ndërsa edhe këtë vit ka vazhduar bashkëpunimi dhe mbështetja nga UNMIK-u në promovimin e IAP-së, duke financuar një fushatë mediale nëpërmjet debateve mediale (në televizionet dhe radiot që veprojnë në pjesën e Mitrovicës Jugore dhe Veriore), publikimin dhe shpërndarjen e broshurave, me qëllim të informimit të qytetarëve të Mitrovicës Jugore dhe Veriore rreth të drejtave të njeriut, rolin dhe mandatin e IAP-së. Kjo mbështetje ka ndikuar pozitivisht në informimin e qytetarëve ku vërehet se kjo ka qenë një nga arsyet që kemi evidentuar një ngritje të numrit të ankesave në IAP nga qytetarët e kësaj pjese.

Ndërsa gjatë këtij viti (20 mars – 19 korrik 2018), UNDP-ja ka mbështetur Institucionin e Avokatit të Popullit nëpërmjet angazhimit të një këshilltari ligjor, me qëllim të rritjes së kapacitetit të institucionit për të identifikuar çështjet sistematike të paraqitura në gjykata, që të veprojnë sipas mandatit *amicus curiae* apo edhe duke kontribuar në opinionet e

Avokatit të Popullit për adresim në gjykatat themelore, Gjykatën e Apelit ose Gjykatën Supreme.

Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare

Anëtarësimi në mekanizma që merren me të drejtat e njeriut është një mjet i rëndësishëm në punën e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe ka ndikim të jashtëzakonshëm në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Ai gjithashtu ofron mundësi për ngritjen e njohurive për të drejtat e njeriut përmes shkëmbimit të praktikave më të mira, të cilat shpalosen në takimet dhe aktivitetet e përbashkëta që organizohen përgjatë vitit.

IAP-ja, siç është raportuar edhe në raportin vjetor të vitit të kaluar, është e anëtarësuar në këta mekanizma ndërkombëtarë:

- Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)⁴⁴⁵
- Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)⁴⁴⁶
- Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)⁴⁴⁷
- Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)
- Asociacioni i Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF)⁴⁴⁸
- Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)⁴⁴⁹
- Aderues në *Deklaratën e Sarajevës për Bashkëpunim*⁴⁵⁰
- Rrjeti i Ombudsmanëve për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut⁴⁵¹

IAP-ja gjithashtu ftohet dhe merr pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe rrjeteve të tjera, në të cilat, për shkak të barrierave politike, është vetëm anëtar vëzhgues, si në:

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNj-ve me Parimet e Parisit)
- Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë- ENOC

⁴⁴⁵ Për më shumë informata rreth Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, vizitoni këtë ueb-faqe: www.theioi.org

⁴⁴⁶ Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë ueb-faqe: www.eoi.at

⁴⁴⁷ Për më shumë informata rreth Rrjetit Evropian të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, vizitoni këtë ueb-faqe: www.ennhri.org

⁴⁴⁸ Për më shumë informata rreth Institutit Evropian të Ombudsmanëve, vizitoni këtë ueb-faqe: <http://www.aomf-ombudsmans-francophonie.org/>

⁴⁴⁹ Për më shumë informata rreth Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut, vizitoni këtë ueb-faqe: www.ombudsman-med.org

⁴⁵⁰ Kjo deklaratë ka formalizuar bashkëpunimin dhe aktivitetet e të gjitha institucioneve të Ombudsmanëve në regjion. Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë e ka nënshkruar këtë Deklaratë, me datën 4 prill 2014.

⁴⁵¹ Ky rrjet është themeluar në vitin 2017 dhe është nënshkruar nga këto shtete: Bosnja, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia

- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtar për Parandalimin e Torturës të Evropës Juglindore-SEE NPM (në kuadër të të cilit IAP-ja merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).

Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë

IAP-ja çdo vit pranon pyetësor të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe këtë vit janë dërguar pesë pyetësorë të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

Data	Tema e raportit/hulumtimit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
17 janar 2018	IKDNj-të dhe roli i tyre në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të zhvendosur	OHCHR
19 janar 2018	Roli i IKDNj-ve në promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në vendet rurale	GANHRI
7 mars 2018	Të drejtat e personave të moshuar	ENNHRI
30 mars 2018	Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe krijimin e standardeve me të larta të arritshme shëndetësore	Reporteri Special i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar
17 gusht 2018	Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar	ENNHRI

Tabela: Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare

Komunikimi me publikun dhe mediat

Avokati i Popullit, në funksion të përmbushjes së misionit si mbrojtës dhe garantues i lirive dhe të drejtave të njeriut në vend, vlerëson lart punën dhe rolin e mediave dhe i sheh si një aleat të rëndësishëm në realizimin e misionit të vet.

Paraqitjet publike të Avokatit të Popullit, zëvendësve të tij, por edhe të bashkëpunëtorëve të tjerë të institucionit, kanë qenë të shumta dhe të herëpashershme.

Përveç konferencave për shtyp të mbajtura në institucion, edhe nëpërmjet komunikatave për media janë prezantuar dokumente dhe rekomandime drejtuar institucioneve dhe organeve përkatës të niveleve të ndryshme, për të pasur reagime të duhura në funksion të miradministrimit.

Në promovimin e punës dhe aktiviteteve të institucionit janë përdorur si mjet alternativ i komunikimit edhe rrjetet sociale – Facebook-u. Rëndësia e mediave sociale nuk mund të anashkalohet, si një mundësi shumë e mirë dhe e shpejtë për të qenë sa më pranë dhe sa më të drejtpërdrejtë me publikun. IAP-ja ka një faqe zyrtare, si një mundësi alternative e komunikimit me qytetarët edhe nëpërmjet platformës Facebook.

Një rol të rëndësishëm në krijimin e një atmosfere bashkëpunimi dhe korrektese me median kanë luajtur edhe kontaktet e drejtpërdrejta të Zyrës me gazetarë, por edhe e Avokatit të Popullit si dhe bashkëpunëtorëve të tij.

Klima e besueshmërisë ndaj IAP-së është krijuar edhe përmes integritetit dhe saktësisë së informacioneve të bëra publike nga institucioni.

Promovimi i punës dhe aktiviteteve të IAP-së në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, është bërë përmes konferencave për media, komunikatave dhe njoftimeve mbi punën e institucionit, prononcimeve dhe intervistave të Avokatit të Popullit dhe të stafit të tij dhënë në mediat e shkruara, pjesëmarrjes në debatet të ndryshme në programet e radios dhe televizionit publik si dhe në ato private, lidhur me të drejtat e njeriut. IAP-ja, edhe përmes publikimit të broshurave të ndryshme në funksion të vetëdijesimit e qytetarëve, por edhe institucioneve përkatëse për të drejtat e njeriut, ka bërë promovimin e punës së institucionit.

“Platformë e Raporteve të OJQ-ve” në ueb-faqe të institucionit është konceptuar si një mundësi e mirë për të rritur nivelin e përfshirjes demokratike të qytetarëve, do të thotë, të OJQ-ve relevante, në të cilën plasohen raporte të ndryshme të OJQ-ve lidhur me mbrojtjen dhe gjendjen e të drejtave të njeriut.

Zyra për Komunikim me Publikun gjatë vitit raportues, në përputhje me obligimet dhe me objektivat e përcaktuara me Strategjinë e Zyrës për Marrëdhënie me Publikun dhe Mediat 2016 – 2018, ka fokusuar punën në rritjen e informimit të vazhdueshëm dhe proaktiv të qytetarëve, me qëllim ngritjen e vetëdijes përkitazi me të drejtat dhe liritë e garantuara në Republikën e Kosovës, si dhe mbi rolin e mandatin që ka Avokati i Popullit.

Në këtë drejtim janë shpërndarë raporte, opinione, njoftime dhe komunikime në format elektronik, të zyrtarëve të autoriteteve publike, të nivelit qendror dhe lokal, OJQ-ve përkatëse, si publikime të veçanta:

- Raportin vjetor 2018
- Raporti i MKPT-së
- Përmbledhjen e raporteve gjatë vitit 2018

Janë publikuar 61 raporte, prej tyre, 33 Raporte mbi rastet, 14 Raporte Ex-Officio, 14 Raporte të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT). Plasimi i tyre, i pasqyruar në statistika sipas muajve duket si në tabelën 1:

Tabela 1: 46 Raporte/ opinione/Amicus Curiae të publikuara në ueb-faqen zyrtare, sipas muajve

2018	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Total
Raportet e rasteve	-	1	1	2	23	-	2	-	-	-	4	-	33
Raportet Ex-officio	1	1	2	3	-	-	1	1	1	2	1	1	14
Raportet e MKPT	3	-	1	-	1	1	-	1	1	4	2	-	14

Këto Raporte janë publikuar në ueb-faqen zyrtare të IAP-së, të përcjella me informatë përmbledhëse. Më tej, Raportet dhe informatat janë përcjellë tek mediat dhe janë shpërndarë po ashtu përmes faqes zyrtare dhe profilit të IAP-së në rrjetin social Facebook.

Po ashtu, në periudhën raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2018, nëpërmjet ueb-faqes zyrtare të IAP-së, si dhe nëpërmjet postës elektronike dhe faqes së profilit të IAP-së në rrjetin social Facebook, janë shpërndarë edhe informata e njoftime të tjera lidhur me aktivitete dhe angazhime të Avokatit të Popullit. Numri i përgjithshëm i tyre arrin në 79. Të shpërndara në numra, sipas muajve, duken si në tabelën 2.

Tabela 2: 79 informata/deklarata/njoftime të publikuara në ueb-faqe, sipas muajve

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
2018	5	4	11	6	10	5	4	3	7	8	9	7
TOTALI	79											

Duke pasur prioritet informimin publikut të gjerë, Avokati i Popullit me bashkëpunëtorë ka realizuar 168 paraqitje mediale, në radio dhe televizione, portalet online dhe në mediat e shkruar (në këtë numër të paraqitjeve mediale të Avokatit të Popullit dhe stafit të IAP-së nuk përfshihet shpërndarja apo afishimi i mëtejme i të njëjtave, ashtu siç nuk

përfshihen edhe rastet kur mediat i janë referuar qëndrimeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit, qoftë në mediat tradicionale apo në ato të reja).

Tabela 3 liston shpërndarjen e paraqitjeve mediale sipas medimeve, bazuar në kërkesa të mediave dhe gazetarëve për prononcime, intervista, emisione të hapura për pyetje të qytetarëve, debate e të tjera. Duhet theksuar se prezenca e vazhdueshme, në rritje, e Avokatit të Popullit në media, të shumtën e herëve vjen si rrjedhojë e mënyrës proaktive të ndërveprimit IAP – media dhe efektit që kanë pasur për interesin e publikut kryesisht raste të trajtuara nga IAP-ja, apo aktivitete ku Avokati i Popullit i ka prezantuar qëndrimet e tij.

Tabela 3: Lajmet të ndryshme të publikuar dhe të emituar në medie, sipas medimeve

IAP në medie-lajme			
Agjencia e Lajmeve Kosovapress	4	Portali Arberesha.com	2
BIRN/Kalxo.com	6	Periskopi	1
Ekonomia Online	1	Telegrafi	7
Gazeta Bota Sot	6	Insajderi	3
Gazeta Epoka e Re	5	Indeksonline	8
Gazeta Koha Ditore	2	Koha.net	3
Gazeta Kosova Sot	2	Kosova.info	2
Gazeta Zeri	2	Zeri.info	4
Gazeta Express	2	Bota sot	1
Gazeta Metro	1	Faks.mk	3
RTK 1	6	Lajmi.net	3
RTK 2	2	Zhurnal.mk	1
KTV	5	Time Ballkan	2
TV 21	1	Albakos	1
Klan Tv	2	Gazeta Tribuna	1
TV Dukagjini	1	Faks.al	1
TV 7	2	Kosova Today	1
RTV Lira	1	Kosova e Lire	1
RTV Gracanica	1	Kosovo24sata	1
TV Plus	1		

Kërkesat e mediave për prononcime/intervista të Avokatit të Popullit, zëvendësve dhe udhëheqësve të departamenteve ka ndryshuar në varësi prej raporteve të publikuara si dhe

në bazë të ngjarjeve – zhvillimeve në shoqërori me pretendime që ka pasur shkelje të të drejtave të njeriut.

Në shumicën e rasteve të prononcimet/intervistat e Avokatit të Popullit fokusi ka qenë në çështje të ngritura nga Avokati i Popullit nëpërmjet Raporteve të publikuara apo aktiviteteve të zhvilluara. Numri i kërkesave për prononcime/intervista është gjithsejtë 58. Në tabelën më poshtë është bërë ndarja e kërkesave për prononcime/intervista të Avokatit të Popullit sipas muajve.

Tabela 4: Kërkesat e mediave për prononcimet e AP-së, të shpërndara në numra, sipas muajve

	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
2018	-	-	2	-	5	7	4	1	8	11	13	7
TOTALI	58											

Në funksion të drejtpërdrejtë të partneritetit me mediat dhe me qëllim të diskutimit të përbashkët lidhur me çështje që ndërlidhin natyrën e punës së ndërsjellë, janë zhvilluar takimet të ndryshme. Siç është bërë tanimë traditë.

Avokati i Popullit në fund të vitit, në një konferencë të veçantë për media, prezantoi të dhënat preliminare të statistikave dhe punës së bërë përgjatë vitit 2018.

Zyra për Komunikim me Publikun dhe Mediat, po ashtu menaxhon procesin e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike (QDP) që i drejtohen IAP-së, si dhe procedimin tek palët të përgjigjeve të institucionit.

Gjatë vitit 2018, IAP-ja ka pranuar 21 kërkesa për QDP, që në krahasim me vitin paraprak përbën një rritje prej afër qind për qind.

Lidhur me kërkesat e zgjidhura pozitivisht, palëve u janë dorëzuar dokumentet e kërkuara, në pajtim me kërkesat (në format fizik, në format elektronik, por herë-herë edhe në të dyja format). Shumica e kërkesave janë drejtuar për më shumë se një dokument, e nganjëherë kërkues të ndryshëm kanë kërkuar dokumente të njëjta.

Financimi

IAP-ja është institucion i pavarur kushtetues, i cili financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit: “IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës, i cili nuk mund të jetë më i vogël se buxheti i miratuar për vitin e mëparshëm”.⁴⁵² Po ashtu, sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Avokatin e Popullit, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm shtesë edhe për rastet e shtimit të obligimeve dhe kompetencave me këtë ligj dhe ligjet tjera, respektivisht edhe burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.⁴⁵³

Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës

Duke u bazuar në procesin ligjor për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, Avokati i Popullit e ka parashtruar kërkesën e vet buxhetore për vitin 2018 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Kërkesa buxhetore e Avokatit të Popullit për vitin 2018 është përgatitur mbi bazën e planit të punës dhe të aktiviteteve të planifikuara për realizim gjatë vitit 2018. Buxheti i IAP-së për vitin 2018 është ndarë në masën monetare prej 1.373.167.00 €, i cili ka qenë i destinuar për këto kategori buxhetore si në vijim:

- a) Paga dhe mëditje, në shumë prej 957.313.99 €;
- b) Mallra dhe shërbime, në shumë prej 324.353.00 €;
- c) Shpenzime komunale, në shumë prej 25.500.00 €;
- d) Shpenzime kapitale, në shumën prej 66.000.00 €.

Pasqyrimin e buxhetit të IAP-së për vitin 2018, sipas kërkesës buxhetore, të buxhetit fillestar, të shpenzimeve buxhetore si dhe të kursimeve buxhetore do ta paraqesim në formën tabelare mbi bazën e dhënave të përgjithshme sipas kategorive ekonomike buxhetore. Kurse raportimi financiar i detajuar edhe për vitin buxhetor 2018, për të gjitha kategoritë ekonomike buxhetore dhe nënkategoritë e veçanta ekonomike buxhetore, është hartuar veçmas dhe do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës mbi bazën e formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, ashtu siç kërkohet nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.⁴⁵⁴

Në paraqitjen tabelare në vijim pasqyrohet gjendja e buxhetit të IAP-së për vitin 2018.

Tabela 1: Buxheti i IAP-së sipas Kërkesës buxhetore, të Ligjit të buxhetit, të deklaratimit të kursimeve buxhetore nga IAP-ja dhe me shkurtimet buxhetore me vendim të Qeverisë dhe buxhetin final për vitin 2018.

⁴⁵² Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 35, paragrafi 3.

⁴⁵³ Po aty.

⁴⁵⁴ Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t’i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

<i>Kategoria Ekonomike</i>	Kërkesa buxhetore	Buxheti i ndarë për vitin 2018	Deklarimi i kursimeve nga IAP	Shkurtimi i buxhetit me vendim të Qeverisë	Buxheti Final 2018
Paga dhe mëditje	1.053825.87	957.314.00	110.000.00	14.627.31	832.686.68
Mallra dhe shërbime	384.353.00	324.353.00	80.000.00	0.00	244.353.00
Shpenzime komunale	25.500.00	25.500.00	10.000.00	0.00	15.500.00
Shpenzimet kapitale	66.000.00	66.000.00	3.000.00	18.181.00	44.819.00
Gjithsej buxheti	1.529.678.87	1.373.167.00	203.000.00	32.808.31	1.137.358.68

Planifikimi i buxhetit, shpenzimi i buxhetit dhe deklarimi i kursimeve buxhetore për vitin 2018 është realizuar sipas nevojave të planifikuara dhe destinacionit të përcaktuar për plotësimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së, të cilat kanë qenë me interes të sigurimit të ushtrimit të mandatit, të mbarëvajtjes së punës dhe funksionimit të IAP-së. Kurse nuk ka munguar monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të buxhetit.

Për vitin 2018, sipas procedurave ligjore, IAP-ja ka bërë edhe deklarimin e kursimeve buxhetore në muajin tetor 2018, në shumën totale 203.000.00 € . Mirëpo, me propozim nga Ministria e Financave (MF), me *vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës në muajin dhjetor 2018 është bërë harmonizimi dhe shkurtimi i buxhetit të IAP nëpër kategoritë e ndryshme buxhetore 32.808.31 €*.

Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2018

Buxheti IAP për vitin buxhetor 2018 është realizuar në nivelin prej 96.80%, në raport me buxhetin final të fundvitit. Në tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2018. Paraqitja tabelare e të dhënave buxhetore është sipas kategorive ekonomike dhe sipas shpenzimeve të shprehura në përqindje.

Tabela 2: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2018

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti Final për 2018	Buxheti i shpenzuar	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	832.686.68	832.686.68	0.00	100.00

2.	Mallra dhe shërbime	244.353.00	211.055.62	33.297.38	86.37
3.	Shpenzime komunale	15.500.00	12.472.93	3.027.07	80.47
4.	Shpenzime kapitale	44.819.00	44.816.32	2.68	99.99
Gjithsej		1.137.358.68	1.101.031.55	36.327.13	96.80

Financimi i IAP-së nga donatorët

Më 10 korrik 2018, IAP-ja ka nënshkruar Marrëveshje për grant me Këshillin e Evropës, për periudhën 11 korrik 2018 deri më 11 prill 2019, në vlerë prej 40,500.00 eurosh. Kjo marrëveshje është nënshkruar me qëllim të financimit të aktivitetit të mbështetur nga Këshilli i Evropës për angazhimin e 4 këshilltarëve të jashtëm ligjorë për Institucionin e Avokatit të Popullit. Ky aktivitet ka dhënë një rezultat të lartë në ngritjen e kapaciteteve të institucionit për të përballuar një mandat të gjerë, pas hyrjes në fuqi të Pakos Ligjore për të drejtat e njeriut.⁴⁵⁵

⁴⁵⁵ Për më shumë informata për kornizën ligjore mbi të cilat IAP-ja realizon mandatin e tij, shih linkun <https://www.oik-rks.org/legislacioni/ligjet/>

Statistikat

Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve për vitin 2018

Nga 1 janari 2018 deri më 31 dhjetor 2018, në selinë e IAP-së në Prishtinë dhe në zyrat rajonale janë parashtruar 1986 ankesa dhe kërkesa nga qytetarët e Kosovës për këshillë apo ndihmë juridike.

Numri më i madh i rasteve të hetuara nga IAP-ja, gjatë periudhës raportuese, kanë qenë kryesisht përkitazi me *të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; të drejtën për mjete juridike; të drejtën e punës dhe ushtrimin të profesionit; mbrojtjen shëndetësore dhe sociale; mbrojtjen e pronës* etj.

Në tabelat e mëposhtme, në mënyrë të hollësishme paraqitet numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura dhe rasteve të hetuara, numri i rasteve të hetuara sipas detyrës zyrtare, përkatësia etnike e ankuesve, gjinia e ankuesve, numri i rasteve të zgjidhura, autoritetet përgjegjëse kundër të cilave janë drejtuar ankesat, numri i raporteve me rekomandime dhe letër rekomandimeve për rastet e hetuara etj.

Tabela 1: Ankesat e paraqitura në IAP gjatë vitit 2018

	Numri i përgjithshëm i ankesave të paraqitura në IAP	1986
	Numri i personave të përfshirë në ankesat e paraqitura	5554
Përkatësia etnike e ankuesve		
	Shqiptarë	1767
	Serbë	112
	Romë	28
	Boshnjakë	28
	Ashkalinj	17
	Egjiptianë	14
	Turq	11
	Të tjerë	9
Gjinia e ankuesve të paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit		
	Meshkuj	1459
	Femra	527
Autoritetet përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse).		
	Gjykatat	562

	Ministritë	529
	Komunat	325
	Policia	138
	Prokuroritë shtetërore	85
	Person privat	80
	Ndërmarrjet publike	56
	Kompanitë private	57
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	30
	Autoritetet e huaja	30
	Agjencia Kosovare e Pronës	6
	Të tjera	220

Tabela 2: Ankesat e shpallura të papranueshme gjatë vitit 2018

	Numri i ankesave të shpallura të papranueshme	1131
Baza ligjore e papranueshmërisë së ankesave bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit		
	Mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 22, pika 1.4	505
	S'ka shkelje, keqadministrim - neni 22, pika 1.1	305
	Jashtë juridiksionit - neni 21, pika 1.3.1	187
	Në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 22, pika 1.3	73
	Mosinteresim, dështim i palës - neni 22, pika 1.2	49
	E parashtruar pas afatit ligjor - neni 21, pika 1.3.2	6
	Ankesë anonime - neni 21, pika 1.3.3	6

Tabela 3: Rastet e hapura për hetim në IAP gjatë vitit 2018

	Rastet e hapura për hetim nga ankesat e paraqitura nga qytetarët	855
	Rastet e hapura sipas detyrës zyrtare (Ex Officio)	72
<i>Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hetuara</i>		
	Shqiptarë	743

	Serbë	71
	Boshnjakë	15
	Romë	10
	Ashkalnj	5
	Goranë	3
	Egjiptianë	2
	Turq	2
	Të tjerë	4
Gjinia e ankuesve bazuar në rastet e hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit		
	Meshkuj	621
	Femra	234
Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP-ja (një rast mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)		
	Gjykatat	311
	Ministritë	228
	Komunat	156
	Policia	66
	Prokuroritë shtetërore	51
	Ndërmarrjet publike	20
	Agjencia Kosovare e Privatizimit	16
	Kompanitë private	12
	Persona privat	10
	Agjencia Kosovare e Pronës	2
	Autoritetet e huaja	2
	Të tjera	98

Tabela 4: Lënda e rasteve të hetuara, bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë (një rast mund të përfshijë më shumë se një shkelje të të drejtave të garantuara)

	E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	317
--	---	-----

E drejta për mjete juridike	169
E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit	134
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	108
Mbrojtja e pronës	103
E drejta e qasjes në dokumente publike	55
Barazia para ligjit	52
Të drejtat e të akuzuarit	40
Të drejtat e fëmijës	35
E drejta për arsimin	29
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues	29
Përgjegjësia për mjedisin jetësor	16
E drejta e martesës dhe familjes	14
E drejta për jetën	9
Liria e lëvizjes	8
Dinjiteti i njeriut	7
E drejta e lirisë dhe sigurisë	6
E drejta e privatësisë	5
Raste për ndërmjetësim	4
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	3
E drejta e integritetit personal	3
Liria e shprehjes	2
Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	2
Interpretimi i dispozitave për të drejtat e njeriut	2
Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë	1

Tabela 5: Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura nga IAP-ja gjatë vitit 2018 (jo vetëm rastet e vitit 2018, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)

Numri i përgjithshëm i rasteve të mbyllura	1301
Baza ligjore e mbylljes së rasteve bazuar në Ligjin për Avokatin e Popullit	

I zgjedhur pozitivisht, në pajtim me kërkesën e ankuesit - neni 21, pika 1.5.	463
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - neni 22, pika 1.1	229
I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - neni 22, pika 1.3	220
I mbyllur me raport – neni 24.3	201
I papranueshëm, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - neni 22, pika 1.4	104
I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - neni 22, pika 1.2	76
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - neni 21, pika 1.3.1	8

Tabela 6: Raportet me rekomandime nga IAP-ja

Raporte për rastet e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	33
Raporte për rastet e hetuara <i>ex officio</i>	14
Raportet e MKPT-së	14
Letra me rekomandime	20
<i>Rekomandime në Raportet dhe letrat me rekomandime</i>	263
Amicus Curiae	6
Opinione	3
Kërkesë për masë të përkohshme	1

Tabela 7: Implementimi i rekomandimeve të nxjerra në raportet dhe letër rekomandimet për rastet e hetuara nga IAP-ja gjatë vitit 2018

Autoriteti përgjegjës	<i>Rekomandime të implementuara</i>	<i>Rekomandime të paimplementuara</i>	<i>Në pritje për implementim</i>
Ministria e Drejtësisë	19	3	20
Ministria e Shëndetësisë	3	0	3
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	5	3	4
Ministria e Punëve të Brendshme	12	1	12
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë	2	0	3

Ministria e Infrastrukturës	2	0	2
Ministria e Financave	0	1	0
Ministria e Zhvillimit Ekonomik	1	1	0
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1	0	0
Ministria e Mjedisit dhe dhe Planifikimit Hapësinor	0	0	11
Ministria e Punëve të Jashtme	0	1	0
Ministria e Integritimit Evropian	0	0	2
Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik	0	0	1
Qeveria e Kosovës	1	1	3
Shërbimi Korrektues i Kosovës	0	0	3
Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar	3	1	19
Administrata Tati. e Kosovës	0	0	1
Kuvendi i Kosovës	0	0	8
Gjykata e Apelit	2	9	7
Gjykata Themelore në Prishtinë	2	3	2
Gjykata Supreme e Kosovës	0	0	1
Prokuroria Themelore në Prizren	0	0	1
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	0	0	4
Këshilli Prokurorial i Kosovës	0	0	1
Policia e Kosovës	3	0	4
Telekomi i Kosovës	0	0	1
KEK-u	0	0	1
Komisioni Qendror Zgjedhor	1	0	0
Universiteti i Prishtinës	4	0	1
Agjencioni Kosovar për Krah. dhe Verifikim të Pronës	0	0	1
Autoriteti i Rregullator i	1	0	0

Hekurudhave			
Komuna e Ferizajt	3	4	0
Komuna e Prishtinës	3	1	0
Komuna e Shtimes	0	0	2
Komuna e Istogut	3	0	0
Komuna e Podujevës	2	0	0
Komuna e Pejës	2	0	0
Komuna e Lipjanit	1	0	0
Komuna e Zveçanit	0	0	1
Komuna e Novobërdës	0	0	2
Komuna e Skenderajt	0	0	2
Komuna e Mitrovicës Jugore	1	0	0
Komuna e Deçanit	1	0	1
Komuna e Drenasit	2	0	0
Komuna e Klinës	3	0	0
Komuna e Kamenicës	0	0	2
Komuna e Obiliqit	2	0	1
Komuna e Suharekës	2	0	0
Komuna e Vitisë	3	0	0
Komuna e Gjilanit	2	0	0
Komuna e Fushë Kosovës	2	0	0
Komuna e Rahovecit	3	0	0
Komuna e Malishevës	2	0	0
Komuna e Kaçanikut	0	0	2
Komuna e Hanit të Elezit	0	0	2
Komuna e Dragashit	0	0	2
Komuna e Mitrovicës Veriore	0	0	1
Komuna e Gjakovës	0	0	1
Totali	99	29	135

Paraqitja grafike e statistikave për vitin 2018




Figura 1: Shqyrtimi i ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2018




Figura 2: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP




Figura 3: Gjinia e qytetarëve bazuar në ankesat e paraqitura në IAP




Figura 4: Autoritetet përgjegjëse të ankesave të paraqitura në IAP gjatë vitit 2018




Figura 5: Përkatësia etnike e qytetarëve bazuar në rastet e hapura për hetim




Figura 6: Autoritetet përgjegjëse të rasteve të hetuara nga IAP




Figura 7: Lënda e rasteve të hetuara bazuar në të drejtat e garantuara me Kushtetutë




Figura 8: Rastet e mbyllura nga IAP gjatë vitit 2018 (jo vetëm rastet e vitit 2018, por edhe rastet e regjistruara më herët e të mbyllura gjatë këtij viti)




Figura 9: Implementimi i rekomandimeve të nxjerra në raportet dhe letër rekomandimet për rastet e hetuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit

Statistikat mbi treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike⁴⁵⁶

Më 7 dhjetor 2017, u nënshkrua Marrëveshja financiare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimin - IPA 2016 pjesa e dytë, për Reformën e Administratës Publike. Kontributi maksimal i Bashkimit Evropian në këtë marrëveshje është në vlerë prej 25,000,000.00 EUR.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj marrëveshjeje “synon përkrahjen e procesit të reformës së administratës në Kosovë me qëllim të rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe efektivitetit të administratës publike, me fokus më të madh në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Ky program synon të ndihmojë Qeverinë e Kosovës në zbatimin e pakos strategjike të reformës së administratës publike e miratuar në vitin 2015 e fokusuar veçanërisht në përmirësimin e llogaridhënies së administratës, harmonizimin e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, në prezantimin e menaxhimit modern të burimeve njerëzore dhe modernizimin e shërbimeve publike të orientuar drejt konsumatorit. Programi gjithashtu do t'i fuqizojë kapacitetet administrative të nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin e acquis të BE-së”.⁴⁵⁷

⁴⁵⁶ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>

⁴⁵⁷ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707> fq. 18; qasur më 13/02/2019

Vlen të theksohet se me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, kjo çështje është përfshirë po në këtë marrëveshje, përmes treguesit (indiktorit) nr. 7, i cili parashikon që deri në vitin 2020, zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e nivelit qendror të arrijë jo më pak se 60%. Ndërsa, kujtojmë se në vitin 2016, sa i përket rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror, zbatimi i tyre ka qenë në shkallën 16%. Kjo marrëveshje ka hyrë në fuqi më 15 dhjetor 2017.

Më poshtë do t'i paraqesim të arriturat mbi zbatimin e treguesit nr. 7.1.1 dhe 7.1.2 për vitin 2018, nëpërmjet statistikave:

Treguesi 7.1.1 kërkon që të paktën 70% e institucioneve të nivelit qendror, të cilave Avokati i Popullit ua ka adresuar rekomandimet ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2018, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.


Avokati i Popullit, gjatë periudhës 1 janar deri më 30 nëntor 2018, ua ka adresuar 141 rekomandime institucioneve të nivelit qendror⁴⁵⁸, nga të cilat, vetëm për 50 rekomandime ka pranuar përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar me nenin 25 dhe 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit.⁴⁵⁹ Me këtë konkludohet se shkalla e zbatimit për treguesin 7.1.1 është mjaft e ulët, sepse Avokati i Popullit gjatë periudhës së përcaktuar ka pranuar përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh vetëm për 35% të rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror. Prandaj, sipas këtyre të dhënave, treguesi 7.1.1 nuk është përmbushur.⁴⁶⁰

⁴⁵⁸ Institucionet e nivelit qendror të përcaktuara me treguesin 7 të Marrëveshjes financiare në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Kjo marrëveshje mund të gjindet ne gazetën zyrtare nën linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>

⁴⁵⁹ <https://www.oik-rks.org/2018/08/20/ligji-per-avokatin-e-popullit-nr-051-019/> qasur më 13/02/2019

⁴⁶⁰ Metoda e kalkulimit për treguesin 7.1.1 është bërë sipas formulës:

$X = \frac{\text{numri i rekomandimeve me përgjigje nga institucionet e nivelit qendror të pranuar nga Avokati i Popullit brenda afatit ligjor}}{\text{numri total i rekomandimeve të Avokatit të Popullit adresuar institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar}} \times 100$



Treguesi 7.1.2 kërkon që të paktën 40% e rekomandimeve për institucionet e nivelit qendror të adresuara në vitin 2017 dhe 2018, në të cilat institucionet e nivelit qendror janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar.

Avokati i Popullit, gjatë periudhës 1 janar 2017 deri me 30 nëntor 2018, ua ka adresuar 212 rekomandime institucioneve të nivelit qendror⁴⁶¹, nga të cilat, vetëm 79 rekomandime janë zbatuar. Ndërsa në rekomandimet e adresuara gjatë së njëjtës periudhë dhe për të cilat kemi pranuar përgjigje pozitive apo përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, kemi 135 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 70 prej tyre apo shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, sipas indikatorit 7.1.2 ka arritur në 52%.⁴⁶²

⁴⁶¹ Institucionet e nivelit qendror të përcaktuara sipas listës në metodologjinë e treguesit 7 (7.1.1 dhe 7.1.2) të Marrëveshjes financiare në mes të Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Kjo marrëveshje mund të gjendet në gazetën zyrtare në linkun <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>

⁴⁶² Metoda e kalkulimit është bërë sipas formulës së përcaktuar me treguesin 7.1.2:

$X = \frac{\text{numri i rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar, për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, janë implementuar}}{\text{numri total i rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve}} \times 100$

